



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR “PËR AUDITIMIN E ZBATIMIT TË
REKOMANDIMEVE, TË VITIT 2022”.

RAPORT I KONSOLIDUAR I ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE
TË LËNA NË AUDITIMET E MËPARSHME TË EVADUARA NGA
01.01.2022-31.12.2022

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË INSTITUCIONEVE QENDRORE

Tiranë, Nëntor 2023

Nr.	Përmbajtja	Faqja
1	Përmbledhje ekzekutive	3 - 4
1.1	Hyrje	4
1.2	Objektivat	4
1.3	Qëllimi	5
1.4	Metodologjia	5
1.5	Konkluzione	5
2	Opinion i përgjithshëm mbi zbatimin e rekomandimeve	5
3	Zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme të evaduara për periudhën 2022	2 - 261
3.1	Kuvendi i Shqipërisë	5 - 13
3.2	Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare	13 - 19
3.3	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	19 - 24
3.4	Ministria e Arsimit	24 - 53
3.5	Ministria e Kulturës	53 - 63
3.6	Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore	63 - 95
3.7	Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore	95 - 125
3.8	Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural	125 - 150
3.9	Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut	150 - 154
3.10	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit	154 - 172
3.11	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	172 - 202
3.12	Cirku i Tiranës	202 - 207
3.13	Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës	207 - 219
3.14	Institucioni Rezidencial i Përkujdesit Shoqëror për Fëmijë, Zyber Hallulli	219 - 238
3.15	Bashkia Vlorë (Deinstitucionalizimi)	238 - 245
3.16	Bashkia Korçë (Deinstitucionalizimi)	245 - 250
4	Anekse	250 - 261
4.1	Rekomandimet për përmirësime/ndryshime legjislacioni / Masa organizative	261
4.2	Masa shpërblim dëmi	261
4.3	Masa për eliminimin e efekteve negative (3E)	261
4.4	Masa disiplinore / Masa administrative	261
4.5	Shkalla e pranueshmërisë dhe zbatimit të rekomandimeve sipas llojit të masës për secilin subjekt të audituar	261
5	Dokumentacioni shoqërues	261

1. Përmbledhje ekzekutive

Nga auditimi mbi zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH, gjatë auditimeve të evaduara në vitin 2022, në zbatim të Programeve të Auditimit nr. 613/16 deri nr. 613/29 prot., datë 06.07.2023 dhe nr. 613/30 prot., datë 10.07.2023 në institucionet:

- Kuvendi i Shqipërisë
- Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare
- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes
- Ministria e Arsimit
- Ministria e Kulturës
- Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore
- Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore
- Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural
- Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut
- Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit
- Fondi Shqiptar i Zhvillimit
- Cirku i Tiranës
- Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës
- Institucioni Rezidencial i Përkujdesit Shoqëror për Fëmijë, Zyber Hallulli
- Bashkia Vlorë (Deinstitucionalizimi)
- Bashkia Korçë (Deinstitucionalizimi)

ka rezultuar si në vijim:

Konstatohet se nga 16 auditimet e kryera:

- **15 subjekte kanë respektuar afatin prej 20 ditë** për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, në përputhje me nenin 15 shkronja (j) të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”.
- **1 subjekt (Bashkia Vlorë)** nuk ka hartuar programin (Plan veprimin) dhe **nuk ka respektuar afatin prej 20 ditë** për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, jo në përputhje me nenin 15 shkronja (j) të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”.

Konstatohet se nga 16 auditimet e kryera:

- **9 subjekte (Kuvendi i Shqipërisë, Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare, Cirku i Tiranës, Bashkia Korçë, Ministria e Arsimit, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut, Fondi Shqiptar i Zhvillimit), kanë kthyer përgjigje në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6 muajor** në zbatim të pikë 2, të nenit 30, të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- **7 subjekte (Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore, Bashkia Vlorë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Kulturës, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës dhe Institucionet Rezidenciale të Kujdesit për Fëmijë, Zyber Hallulli) nuk kanë kthyer përgjigje në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6 muajor** në zbatim të pikë 2, të nenit 30, të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Niveli i realizimit të masave sipas llojit të tyre, paraqitet si më poshtë:

-**Masa për përmirësime/ndryshime legjislativi:** Nga 10 masa të rekomanduara, janë pranuar plotësisht 10 rekomandime ose 100%.

- ✓ Nga masat e pranuar janë zbatuar plotësisht 7 rekomandime ose 70 % pjesërisht, 3

rekomandime ose 30 % janë në proces zbatimi.

-Masa organizative: Nga 336 masa të rekomanduara, janë pranuar plotësisht 296 rekomandime ose 88 % dhe 40 rekomandime nuk janë pranuar ose 12 %.

- ✓ Nga masat e pranuar janë zbatuar plotësisht 197 rekomandime ose 66 %; janë zbatuar pjesërisht 12 rekomandime ose 4 %, janë në proces zbatimi 66 rekomandime ose 23 % si dhe 21 rekomandime rezultojnë të pa zbatuara ose 7 %.

-Masa me efekt negativ financiar (3E) “Të ardhura të munguara”: Nga 44 masa të rekomanduara në vlerën 43,640,189,616 lekë, janë pranuar plotësisht 32 rekomandime ose 73 % e tyre (në vlerën 336,823,620 lekë %) dhe nuk janë pranuar 12 rekomandime ose 27 % e tyre (në masën 303,365,996 lekë).

- ✓ Nga masat e pranuar janë zbatuar plotësisht 15 rekomandime ose 47 % në vlerën 143,849,704 lekë, janë në proces zbatimi 11 rekomandime ose 34 % e tyre (në vlerën 181,140,399 lekë) dhe rezultojnë pa zbatuar 6 rekomandime ose 19 % e tyre (në vlerën 11,833,517 lekë).

-Masa shpërblim dëmi: Nga 40 masa të rekomanduara në vlerën 38,021,369 lekë, janë pranuar plotësisht 37 rekomandime ose 93 % e tyre (në vlerën 20,927,078 lekë) dhe nuk janë pranuar 3 rekomandime ose 7 % (në vlerën 17,094,291 lekë).

- ✓ Nga masat e pranuar janë zbatuar plotësisht 30 rekomandime ose 81 % me vlerën 7,023,525 lekë; janë në proces zbatimi 5 rekomandime ose 14 % me vlerën 12,809,130 lekë si dhe 2 rekomandime rezultojnë të pa zbatuara ose 5 % me vlerën 1,227,000.

-Masa disiplinore: Nga 15 masa të rekomanduara, janë pranuar plotësisht 12 rekomandime ose 80 % dhe 3 rekomandime nuk janë pranuar ose 20 %.

- ✓ Nga masat e pranuar 6 rekomandime ose 50 % e tyre janë zbatuar plotësisht, 1 rekomandim ose 8 % e tyre është në proces zbatimi dhe 5 rekomandime ose 42 % e tyre rezultojnë të pa zbatuara.

-Masa administrative: Nga 2 masa të rekomanduara, është pranuar plotësisht 1 rekomandim ose 50 % dhe nuk është pranuar 1 rekomandim ose 50 %

- ✓ Nga masat e pranuar 1 rekomandim ose 100 % e totalit është në proces zbatimi.

1.1 Hyrje

Kontrolli i Lartë i Shtetit auditori Zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshme në subjektet e lartpërmendur mbështetur në programet respektive të auditimit të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, me objekt: “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH, në auditimet e vitit 2022”, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” dhe në zbatim të Rregullores së Procedurave të Auditimit dhe të Manualit për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të auditimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe Regjistrimit elektronik institucional.

Auditimi u krye nga:

1. A.K, përgjegjës grupi
2. A.Xh
3. G.P
4. J.K

Auditimi filloi më datë 07.07.2023

Auditimi përfundoi më datë 31.07.2023.

1.2 Objektivat

1. Hartimi i programit (Planit të veprimit). Respektimi i afateve ligjore për njoftimin e KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afateve të përcaktuara në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.
2. Zbatimi i rekomandimeve për përmirësime në legjislacionin në fuqi.
3. Zbatimi i rekomandimeve për masat me karakter organizativ.
4. Zbatimi i rekomandimeve për shpërblimin e dëmit ekonomik.
5. Zbatimi i rekomandimeve për përdorim me efektivitet dhe ekonomikitet.
6. Zbatimi i rekomandimeve për masa disiplinore dhe administrative.
7. Të tjera që rezultojnë gjatë auditimit.

1.3 Qëllimi

Vlerësimi i nivelit të zbatimit të rekomandimeve të lëna, nga auditimet e mëparshme, koherencës së tyre dhe përgjegjshmërisë menaxheriale referuar standardeve të auditimit.

1.4 Metodologjia

Duke pasur në fokus përmbushjen e qëllimit të procedurës së auditimit dhe dhënien e një vlerësimi sa më objektiv, profesional e të pavarur, të saktë, të plotë e të qartë në lidhje me zbatimin e rekomandimeve, u auditua niveli i zbatimit të secilit rekomandim në subjektet e përzgjedhura, vlerësuar sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion gjatë fazës së kryerjes së auditimit në terren.

1.5 Konkluzione

Për çështjet e shqyrtuara janë zhvilluar ballafaqime gjatë fazës së auditimit në terren dhe në përfundim të tij janë mbajtur akt verifikime për çdo subjekt të audituar, mbi rezultat e të cilit është përgatitur ky Raport Auditimi.

2. Opinion i përgjithshëm mbi zbatimin e rekomandimeve

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve konstatohet se shkalla e pranueshmërisë së rekomandimeve kundrejt atyre të pa pranuar rezulton në nivel të konsiderueshëm, konkretisht nga 447 masa të rekomanduara gjithsej, janë pranuar 388 masa ose 87 %, si dhe nuk janë pranuar 59 masa ose 13 %.

Niveli i zbatimit të rekomandimeve të pranuar rezulton: zbatuar plotësisht 255 masa ose 65 %, zbatuar pjesërisht 12 masa ose 4 %, janë në proces zbatimi 87 masa ose 22 % si dhe rezultojnë 34 masa të pa zbatuara ose 9 %.

3. Zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme të evaduar për periudhën 2022

Të analizuara dhe të detajuara sipas çdo subjekti dhe sipas llojit të masave të rekomanduara, niveli i zbatimit të tyre paraqitet si vijon:

3.1 Kuvendi Shqipërisë

PËRMBLEDHJE

Në zbatim të Programit të Auditimit nr. 613/19 prot., datë 06.07.2023, “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e evaduar në 6-mujorin e dytë të vitit 2022”, në ambientet e Kuvendit të Shqipërisë më datë 19.07.2023, u mbajt aktverifikimi nga audituesit e autorizuar të KLSH-së znj. A.Xh dhe znj. A.K dhe nga ana e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë me

znj. E.Z në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm Administrativ dhe znj. M.F, në cilësinë e Drejtorit të Burimeve Njerëzore.

Objekt i këtij akt verifikimi është:

Verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të KLSH të lëna me shkresën nr. 190 datë 04.10.2022 për Raportin Përfundimtar të Auditimit me objekt “Mbi auditimin e përputhshmërisë”, të ushtruar në Kuvendin e Shqipërisë, sipas programit të auditimit nr.350/2, datë 16.05.2022, për veprimtarinë nga data 01.01.2017 deri më datë 30.04.2022, në lidhje mbi statusin e zbatimit të rekomandimeve, afateve dhe niveli i zbatueshmërisë së tyre, koherencën e tyre si dhe përgjegjshmërinë menaxheriale referuar standardeve të auditimit.

Auditimi u krye nga:

1. A.Xh
2. A.K

Auditimi ka filluar më datë 10.07.2023

Auditimi ka përfunduar më datë 19.07.2023

Auditimi është kryer në bazë të Programit të Auditimit të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit nr.613/19 prot., datë 06.07.2023 me objekt: “Mbi verifikimin e zbatimit të rekomandimeve”, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” si dhe në zbatim të Rregullores së Procedurave të Auditimit dhe të Manualit për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të auditimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe Regjistrisë elektronik institucionale, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 67, datë 13.06.2020

TRAJTIMI I ÇËSHTJEVE TË AUDITIMIT

Nga auditimi i ushtruar në Kuvendin e Shqipërisë, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, “Mbi Auditimin e Përputhshmërinë” për periudhën 01.01.2017 deri më 30.04.2022 trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin nr. 190, datë 04.10.2022, të Kryetarit të KLSH-së të cilat janë përcjellë me shkresën nr. 350/7 prot., datë 04.10.2022, rezulton se:

I. Hartimi i programit (Plan veprimit) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në nenin 15 shkronja (j) të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Nga auditimi u konstatua se, subjekti ka miratuar planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, duke e dërguar në KLSH me shkresë nr. 2966/5 datë 28.10.2022 kjo në përputhje me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” nenit 15, shkronja j.

Sa më sipër rezulton se është zbatuar afati 20 ditor për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve.

II. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Në lidhje mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve dhe afatet e përcaktuara, sipas strukturave përgjegjëse, Kuvendi Shqipërisë ka përgatitur planin e masave të marra lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të miratuara nga titullari brenda afatit 6 mujor, duke e dërguar në KLSH me shkresë nr. 1392 datë 24.04.2023, kjo në përputhje me Ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” nenit 30.

Sa më sipër rezulton se është zbatuar afati 6 mujor për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve.

III. Realizimi i rekomandimeve

Nga ana e KLSH-së, janë lënë 7 Masa Organizative, 2 Masa për Ndryshime apo Përmirësime në Legjislacionin në Fuqi, nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

- a) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë, 2 masa për ndryshime apo përmirësime në legjislacionin në fuqi nga ku 2 rekomandime, të cilat janë pranuar dhe zbatuar
- b) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 7 Masa organizative nga ku 11 rekomandime, nga të cilat: 11 rekomandime janë pranuar plotësisht të cilat kanë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon: 9 zbatuar dhe 2 në proces zbatimi.

Më hollësisht, auditimi i ndjekjes së rekomandimeve në Kuvendin e Shqipërisë paraqitet si vijon:

PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN DHE AKTET NËNLIGJORE NË FUQI:

1.1. Rekomandim: Të merren masat e përmirësimit të kuadrit ligjor dhe nënligjor në fuqi mbi

statusin, trajtimin financiar dhe kompensimin e shpenzimeve për deputetët e Kuvendit të Shqipërisë, duke u mbështetur në praktikat dhe modelet më të mira të vendeve evropiane si dhe reflektuar ndryshimet e mjedisit të kontrollit të brendshëm në vend.

Për këtë, të gjejnë përcaktimin në Ligjin nr. 8550, datë 18.11.1999 "Statusi i deputetit", i ndryshuar, ose të bëhen përmirësimet e nevojshme në Vendimin e Kuvendit nr. 114/2014, datë 24.12.2014, duke u shprehur në mënyrë përfundimtare në kuadër të trajtimit financiar të deputetëve të Kuvendit, lidhur me faktin nëse:

- a. deputetët e Kuvendit duhet të përfitojnë pagën dhe përfitimet financiar për rastet e bojkotimit të punimeve të Kuvendit pas fitimit të mandatit, si pasojë e vendimmarrjes politike të një partie apo e një grupi parlamentar, dhe
- b. deputetët e Kuvendit, duhet të përfitojnë trajtim financiar, në lidhje me kategoritë të tilla si dieta, karburant etj. në periudhën ndërmjet sesioneve parlamentare, apo gjatë periudhës së fushatave zgjedhore, edhe në referim të vendimi nr. 74, datë 25.02.2021 të Byrosë së Kuvendit, pasi si rregull, Kuvendi në këto kohë nuk zhvillon punime.

Në vijimësi

Përgjigjja e institucioni:

Nga ana e institucionit me Urdhër të Sekretarit të Përgjithshëm nr. 320, datë 21.09.2022 është ngritur grupi i punës për rishikimin e kuadrit ligjor dhe nënligjor në fuqi mbi statusin, trajtimin financiar dhe kompensimin e shpenzimeve për deputetët e Kuvendit të Shqipërisë. Me shkresën nr. 112 prot., datë 29.03.2023 është përcjellë pranë Byrosë Kombëtare të Kuvendit relacioni dhe projektvendimi "Për disa ndryshime në vendimin nr. 114/2014 "Për mënyrën e trajtimit të Deputetëve", i ndryshuar".

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe i zbatuar**

2.1. Rekomandim: Të rishikohet dhe përmirësohet Rregullorja e Organizimit dhe Funkcionit të Shërbimeve të Kuvendit të Shqipërisë, miratuar me Vendimin nr. 42, datë 16.07.2015 të Byrosë së Kuvendit, e ndryshuar, përkatësisht në:

- Nenin 12/3, që përcakton se: "Pranë Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm funksionon Njësia e Auditit të Brendshëm dhe Sektori i Projekteve";

- Nenin 14/1, “Mbikëqyrja, ndihma dhe kontrolli nga eprori”, që përcakton se: “Njësia e Auditit të Brendshëm dhe Sektori i Projekteve janë struktura që raportojnë direkt te Sekretari i Përgjithshëm”;
- Nenin 16 “Auditit”, që parashikon se: “1. Shërbimi i Auditit përgatit Planin Strategjik dhe Vjetor të Auditimit, i cili miratohet nga Sekretari i Përgjithshëm. Pas miratimit, Shërbimi i Auditit ia njofton atë Ministrisë së Financave, brenda datës 15 tetor të çdo viti. 2. Plani Strategjik dhe Vjetor i Auditimit analizon fushat apo çështjet që paraqesin risk më të lartë për institucionin e Kuvendit dhe planifikon kontrole auditimi duke u siguruar mbulimi i zonave me risk. Ky plan pasqyron edhe nevojat për trajnime të Njesisë së Auditimit. 3. Njësia e Auditit të Brendshëm ushtron kontrole të plota pranë Shërbimit të Financës dhe Buxhetit, Shërbimit të Burimeve Njerëzore dhe Trajtimit të Deputetëve, Sektorit të Prokurimeve, Shërbimit të Transportit. 4. Pas çdo kontrolli, Njësia e Auditit të Brendshëm i raporton me shkrim Sekretarit të Përgjithshëm, për gjetjet dhe rekomandimet për shërbimet që auditohen. 5. Njësia e Auditit të Brendshëm, me urdhër të Sekretarit të Përgjithshëm, kryhen auditime të tjera të posaçme.”

Në vijimësi.

Përgjigjja e institucionit:

Nga ana e institucionit me Urdhër të Sekretarit të Përgjithshëm nr. 166, datë 20.04.2023 është ngritur grupi i punës për rishikimin e Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funkcionimit të Shërbimeve të Kuvendit të Shqipërisë.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe i zbatuar**

MASA ORGANIZATIVE:

1.1. Rekomandim: Duke pasur parasysh rëndësinë e këtij procesi për të pasqyruar vlerën e drejtë të këtyre aktiveve në pasqyrat financiare të institucionit, pasaktësitë e informacionit të mbartur dhe trashëguar të Kuvendit të Shqipërisë për vlerën e këtyre godinave, Sekretari i Përgjithshëm duhet të sigurojë që objektet ndërtimore në administrim të institucionit të Kuvendit të pasqyrohen me vlerën e drejtë e të saktë në kontabilitetin e institucionit. Për sa sipër, Sekretari i Përgjithshëm të marrë masat për kryerjen e një procesi vlerësimi të pavarur, me qëllim përcaktimin e vlerës aktuale të këtyre aktiveve, për t’ia pasqyruar dhe për ta sjellë vlerën e tyre të drejtë në kontabilitet në llogarinë 212 “Ndërtesa” në përputhje me kërkesat e Standardit Ndërkombëtar të Kontabilitetit 16 “Aktivet Afatgjata Materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje)” dhe nga ana e Nëpunësit Zbatues të kryhen regjistrimet e vlerës së re të aktiveve të institucionit.

Në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Institucioni i Kuvendit sipas VKM nr. 324, datë 16.05.2012 “Për miratimin e Listës së Inventarëve të Pronave të Paluajtshme Shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Kuvendit të Republikës së Shqipërisë” ka në administrim 3 (tre) objekte, godinën e Kryesisë së Kuvendit, Sallën e Seancës Plenare dhe Parkun e Automjeteve të Kuvendit. Aktualisht administrohen certifikata pronësie për godinën e Kryesisë së Kuvendit dhe Sallën e Seancës Plenare. Në lidhje me Parkun e Automjeteve të Kuvendit, institucioni ka aplikuar në e-Albania në datë 03.04.2023 për pajisje me certifikatë pronësie dhe gjithashtu i është drejtuar zyrtarisht ASHK – së me shkresën nr. 1321 prot., datë 13.04.2023 për vijimin e procedurave. Në programin buxhetor administrativ janë programuar fonde në llogarinë ekonomike 231 për vitin 2023, për kryerjen e kësaj procedure bazuar në vlerësimin nga shërbimi i mirëmbajtjes.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe zbatuar**

2.1. Rekomandim: Sekretari i Përgjithshëm dhe Drejtoria e Shërbimit Administrativ të ngrenë një grup pune me qëllim identifikimin me planimetri dhe genplane të sipërfaqes së tokës truall që i përket institucionit dhe pas përlllogaritjes së vlerave nga ekspertët e fushës, të ndërmerren veprimet e nevojshme të regjistrimit të saj në kontabilitet, duke evidentuar situatën e duhur në pasqyrat financiare të institucionit dhe në pajtueshmëri me legjislacionin për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare.

Në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Institucioni i Kuvendit sipas VKM nr. 324, datë 16.05.2012 “Për miratimin e Listës së Inventarëve të Pronave të Paluajtshme Shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Kuvendit të Republikës së Shqipërisë” ka në administrim 3 (tre) objekte, godinën e Kryesisë së Kuvendit, Sallën e Seancës Plenare dhe Parkun e Automjeteve të Kuvendit. Aktualisht administrohen certifikata pronësie për godinën e Kryesisë së Kuvendit dhe Sallën e Seancës Plenare. Në lidhje me Parkun e Automjeteve të Kuvendit, institucioni ka aplikuar në e – Albania në datë 03.04.2023 për pajisje me certifikatë pronësie dhe gjithashtu i është drejtuar zyrtarisht ASHK – së me shkresën nr. 1321 prot., datë 13.04.2023 për vijimin e procedurave.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe zbatuar**

2.2. Rekomandim: Për një pasqyrim të drejtë në kontabilitet të vlerës së tokave, trojeve dhe terreneve në pronësi dhe administrim të Kuvendit, bëhet domosdoshmëri azhurnimi, rakordimi dhe pasqyrimi në kontabilitetin e Kuvendit i vlerave të këtyre pasurive bazuar në informacionin e administruar nga vlerësuesi i pavarur.

Në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Nga ana e Kuvendit është përgatitur dokumentacioni që administrohet për regjistrimin dhe pajisjen me certifikatë pronësie të parkut të Kuvendit. Me përfundimin e këtij procesi, përcjellë në ASHK me shkresën nr. 1321 prot., datë 13.04.2023, do të vijohet me vlerësimin e tokës, trojeve dhe terreneve në pronësi të Kuvendit.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe i zbatuar**

3.1. Rekomandim: Institucioni i Kuvendit të marrë masat dhe të rikërkojë pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Kryeministrisë, autorizimin për fillimin e procedurave për shitjen me përparësi nëpërmjet ankandit publik të këtyre pjesëve të këmbimit, mallrave stok dhe me qarkullim të ngadalshëm, duke i trajtuar si “objekte të tjera, pronë publike” në kuptimin e nenit 4, të Ligjit nr.9874, datë 14.2.2008, “Për ankandin publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se “Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për ekonomisë, autorizon shitjen nëpërmjet ankandit publik edhe për objekte të tjera, pronë publike”, me qëllim rritjen e të ardhurave të institucionit dhe të rikuperimit të fondeve të ngurtësuar të aktiveve qarkulluese.

Në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Nga ana e institucionit është dërguar në MFE shkresa nr. 4002 prot., datë 25.11.2022, për marrjen e autorizimit për shitjen e pjesëve të këmbimit në ankand. Nga ana e MFE është kthyer përgjigje për kryerjen e procesit të privatizimit të pronave të luajtshme dhe vijimin e procedurave.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe i zbatuar**

4.1. Rekomandim: Institucioni i Kuvendit të Shqipërisë të marrë masat e duhura për kryerjen e një analize të thelluar të gjendjes së debitorëve dhe rritjes së detyrimeve ndaj furnitorëve, me qëllim nxjerrjen e shkaqeve dhe përgjegjësive të rritjes së tyre. Gjithashtu të marrë masa të menjëhershme dhe plane konkrete për ndjekjen dhe të vendosin në kushtet e arkëtimit vlerat e debive të regjistruara në kontabilitet sidomos në kushtet që një pjesë e madhe e tyre kërcënohen nga risku i parashkrimit.

Të merren masat që të evidentohen në mënyrë kontabël, të gjitha detyrimet financiare të angazhimit dhe ato të konstatuara në zbatim të kërkesave ligjore, me qëllim njohjen e detyrimeve financiare në kohën e krijimit, programimin e likuidimit të detyrimeve ndaj të tretëve dhe zvogëlimin e borxhit financiar, sidomos për kreditorët gjyqfitues dhe detyrimet e papaguara të kuotizacioneve të prapambetura kundrejt organizatave ndërkombëtare.

Nëpunësi zbatues, të marrë masat që të dërgohen shkresa zyrtare dhe nga Shërbimet e Kuvendit të kërkohet në rrugë gjyqësore arkëtimi i debive nëpërmjet ngritjes së padisë për këtë qëllim për arkëtimin e detyrimeve, për debitorët që janë me shpresë arkëtimi, ndërsa për debitorët që janë pa ndonjë shpresë arkëtimi, t'i propozohet Ministrisë së Financave që ti mbajnë në llogaritë jashtë bilancit, ose të ndiqet procedurat ligjore për parashkrimin e tyre.

Në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Shërbimi i Financës dhe Buxhetit me shkresën nr. 3628 prot., datë 01.11.2022, ka paraqitur analizën e debitorëve që rezultojnë me gjendje më 31.12.2022. Në vijim të kësaj analize institucioni ka vijuar me veprimet për uljen e gjendjes së këtyre debitorëve.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe i zbatuar**

4.2. Rekomandim: Të hartohet dhe miratohet Gjurma e Auditimit për ndjekjen, regjistrimin dhe ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë për institucionin e Kuvendit të Shqipërisë. Shërbimi i Financës dhe Buxhetit, në çdo rast, me marrjen dijeni për vendimet gjyqësore të formës së prerë në favor të ish-punonjësve të larguar padrejtësisht nga puna, të marrin masat për likuidimin në kohë të këtyre detyrimeve që lindin nga vendimet gjyqësore të formës së prerë dhe mos lejojnë krijimin e kostove shtesë apo shpenzimeve të panevojshme për pagesat e përmbaruesve gjyqësorë. Kjo në përputhje me procedurat e parashikuara në Ligjin nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Udhëzimin e Këshillit të Ministrave nr.2, datë 18.08.2011 “Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të institucioneve buxhetore në llogari të thesarit dhe Udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”. Në këtë kuadër, të merren masat për ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë për kreditorët e pa përfshirë në data bazën e vendimeve gjyqësore të institucionit të Kuvendit, duke kryer përllogaritjet e detyrimit financiar për çdo rast. Vlera e këtyre detyrimeve të regjistrohet në kontabilitet dhe të evidentohet në pasqyrat financiare të institucionit.

Në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Me urdhër nr. 92, datë 08.03.2023 të Sekretarit të Përgjithshëm është ngritur grupi i punës, i cili po punon për draftimin e gjurmëve të auditimit për regjistrimin, ndjekjen dhe ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe i zbatuar**

5.1. Rekomandim: Institucioni i Kuvendit të marrë masat dhe të organizojë kryerjen e inventarizimit të përgjithshëm e vjetor të pasurisë së institucionit duke informuar rregullisht mbi rezultatet e këtij procesi Byronë e Kuvendit, si organizmi vendimmarrës për aspektin financiar dhe administrativ. Nga ana e Nëpunësit Autorizues dhe atij Zbatues të zbatohen procedurat për kontrollin një herë në vit të ekzistencës dhe vlerësimit të aktiveve afatgjata materiale, duke përfshirë verifikimin dhe kontrollin e ekzistencës fizike nëpërmjet inventarizimit të përvitshëm të gjendjeve të inventarit të Zyrave Zgjedhore në qarqe, inventarizimin e fondeve të Bibliotekës, të Sallës së Seancave Plenare etj. Për diferencat eventuale të konstatuara dhe për vlerat jashtë përdorimit nga inventarizimi, të nxirren përgjegjësitë përkatëse dhe të procedohet sipas Ligjit për sistemimin e llogarive kontabël.

Në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Me urdhër nr. 101, datë 10.03.2023 të Sekretarit të Përgjithshëm është ngritur grupi i punës për inventarizimin e gjendjes së magazinës në institucion. Nga komisioni i inventarizimit është përcjellë me shkresën nr. 890/1, dt. 31.05.2023 relacioni për gjendjen në magazinën qendrore të Kuvendit, dhe me shkresën nr. 890/2, dt. 31.05.2023 relacioni për gjendjen në magazinën në Parkun e Automjeteve të Kuvendit. Për artikujt e cilësuar si të papërdorshëm është në proces ngritja e grupit të punës për asgjësimin/tjetërsimin e tyre.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe në proces zbatimi**

5.2. Rekomandim: Të merren masa për rishikimin e dokumentit “Rregullore e Bibliotekës së Kuvendit Popullor”, e miratuar në vitin 1993, duke e harmonizuar me legjislacionin në fuqi për bibliotekat, librin dhe menaxhimin financiar e kontrollin, rregulloren e brendshme të organizimit dhe funksionimit të shërbimeve të Kuvendit të Shqipërisë, (miratuar më 16.7.2015), duke përcaktuar kritere dhe rregulla të qarta mbi kryerjen e inventarizimit vjetor e periodik të këtyre fondeve, klasifikimin, regjistrimin bibliografik, kriteret për dhurimin e materialeve bibliotekare apo huazimin e materialeve, etj., bazuar në standardet më të mira ndërkombëtare në bazë të cilave punon shërbimi bibliotekar dhe kuadrit të Bibliotekës Kombëtare, me qëllim sigurimin e ekzistencës dhe mbrojtjen e këtyre aktiveve të institucionit

Në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Me urdhër nr. 98, datë 10.03.2023 të Sekretarit të Përgjithshëm është ngritur grupi i punës për hartimin e rregullores së funksionimit të Bibliotekës, i cili ka përgatitur dhe paraqitur kërkesën në Byronë e Kuvendit për miratimin e rregullores së Institucionit Parlamentar i cili në përbërjen e tij ka dhe Bibliotekën.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe i zbatuar.**

6.1. Rekomandim: Nga ana e Shërbimeve të Kuvendit, të hartohet dokumenti i Strategjisë Afatmesme të Menaxhimit të Riskut për vitet 2022-2024 dhe në zbatim të përcaktimeve të nenit 8, “Byroja e Kuvendit”, të Rregullores së Kuvendit, miratuar me vendimin nr. 166, datë 16.12.2004, i ndryshuar, që përcakton se: “Byroja e Kuvendit është organi vendimmarrës për aspektin administrativ dhe financiar të Kuvendit dhe organeve të tij. Byroja garanton respektimin e parimeve të pavarësisë organizative, funksionale dhe financiare të Kuvendit si institucioni më i lartë përfaqësues e ligjvënës dhe që bazohet në parimin e ndarjes e të balancimit të pushteteve”, ky dokument të paraqitet për miratim në Byronë e Kuvendit.

Në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Me urdhër nr. 94, datë 10.03.2023 të Sekretarit të Përgjithshëm është ngritur grupi i punës për hartimin e strategjisë së riskut, i cili ka përgatitur strategjinë afatmesme të riskut dhe e ka përcjellë në Byronë e Kuvendit për miratim.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe i zbatuar**

6.2. Rekomandim: Shërbimet e Kuvendit të azhurnojnë dhe përditësojnë Regjistrin e Riskut për programe dhe objektiva specifike 2 herë në vit, në përputhje me kërkesat e pikës nr. 3.2.5 të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 16, datë 20.7.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinorit të riskut në njësitë publike”.

Në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Byroja e Kuvendit me Vendimin nr. 48, datë 28.03.2023 ka miratuar Regjistrin e Riskut dhe Planin e masave për vitin 2023.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe i zbatuar**

7.1. Rekomandim: Nga ana e institucionit të Kuvendit të ndërmerren veprimet e nevojshme në funksion të rishikimit të strukturës organike të institucionit të Kuvendit¹, me qëllim harmonizimin e saj me përmasat dhe misionin e institucionit, vendosjen e një hierarkie të përshtatshme dhe të linjave të komunikimit, në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor në fuqi mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin, duke mbajtur në konsideratë rekomandimet e dërguara nga ana e Ministrisë së Financave.

Për sa sipër, Titullari i njësisë publike Kuvendi i Shqipërisë, të marrë masa konkrete, duke i propozuar Byrosë së Kuvendit rishikimin strukturor dhe riorganizimin e Njësisë së Auditimit të Brendshëm (duke e organizuar atë së paku në nivel Sektorit), dhe pas miratimit të këtyre propozimeve të bëhet rishikimi i Kartës së Auditimit të Brendshëm, e miratuar me datën 01.12.2017 nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm, (pika nr. 6, pavarësia dhe objektiviteti).

Në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Institucioni po ndërmerr veprimet e nevojshme procedurale në funksion të rishikimit të strukturës së njësisë së auditit si njësi përbërëse e strukturës organike të institucionit të Kuvendit. Riformatimi i kësaj strukture të rëndësishme është në proces vlerësimi, në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor në fuqi, Ligji nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin

¹ -Rekomandimet e Raportit të SKB të Kuvendit, hartuar për v.2021, faqe 15.

publik”, dhe rekomandimet e lëna nga KLSH si institucion kontrollues. Referuar strategjisë së Burimeve Njerëzore mbështetur nga OSBE dhe Qendra “Future” është propozuar sipas planit të veprimit, ngritja e Njesisë së Auditimit në nivel drejtorie, neni 10 i ligjit të sipërcituar.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe në proces zbatimi.**

KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve në Kuvendin e Shqipërisë për Raportin Përfundimtar të Auditimit “Për auditimin e përputhshmërisë” dërguar me shkresën nr. 190 datë 04.10.2022 për veprimtarinë nga data 01.01.2017 deri më datë 30.04.2022, rezulton se subjekti i audituar ka respektuar afatin 20 ditor për hartimin e planit të masave për zbatimin e rekomandimeve në përputhje me kërkesat e nenit 15 shkronja (j) të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, ka respektuar afatin për njoftimin brenda 6 muajve mbi ecurinë e zbatimit të këtyre masave në përputhje me kërkesat e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Konkretisht ecuria e zbatimit të rekomandimeve paraqitet sipas tabelës “Ecuria e zbatimit të rekomandimeve”

Rekomandime	Gjithsej		Pranuar		Zbatuar plotësisht		Pjesërisht		Në proces		Pa zbatuar	
	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë
Përmirësime në legjislacionin në fuqi	2	-	2	-	2	-	-	-	-	-	-	-
Organizative	11	-	11	-	9	-	-	-	2	-	-	-
Gjithsej	13	-	13	-	11	-	-	-	2	-	-	-

Sa sipër rezulton se janë dhënë gjithsej 13 rekomandime të cilët janë pranuar plotësisht (100 %), dhe rezultojnë të zbatuar plotësisht 11 masa (85 %).

Për të gjitha rekomandimet që konsiderohen në proces zbatimi, inkurajohet përshpejtimi i realizimit të plotë të tyre.

3.2 DREJTORIA E SHËRBIMEVE QEVERTARE

PËRMBLEDHJE

Në zbatim të Programit të Auditimit nr.613/29 prot., datë 06.07.2023 “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e evaduar në 6-mujorin e dytë të vitit 2022”, në ambientet e institucionit, më datë 18.07.2023, u mbajt aktverifikimi nga audituesit e autorizuar të KLSH-së A.K dhe A.Xh, me z. J.B në cilësinë e Titullarit të institucionit (i deleguar) dhe znj. D.K Shef Sektori Burimeve Njerëzore.

Objekt i këtij akt verifikimi është:

Verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të KLSH të lëna me shkresën nr.380/11 datë 29.07.2022 për Raportin Përfundimtar të Auditimit “Për auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” të ushtruar në Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare sipas programit të auditimit nr.380/1 prot., datë 12.04.2022, për veprimtarinë nga data 01.01.2019 deri më datën 31.03.2022, në lidhje mbi statusin e zbatimit të rekomandimeve, afateve dhe niveli i zbatueshmërisë së tyre, koherencën e tyre si dhe përgjegjshmërinë menaxheriale referuar standardeve të auditimit.

Auditimi u krye nga:

1. A.K

2. A.Xh

Auditimi ka filluar më datë 07.07.2023

Auditimi ka përfunduar më datë 18.07.2023

Auditimi është kryer në bazë të Programit të Auditimit të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit nr.613/29 prot., datë 06.07.2023 me objekt: “Mbi verifikimin e zbatimit të rekomandimeve”, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” si dhe në zbatim të Rregullores së Procedurave të Auditimit dhe të Manualit për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të auditimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe Regjistrit elektronik institucional, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 67, datë 13.06.2020.

TRAJTIMI I ÇËSHTJEVE TË AUDITIMIT

Nga auditimi i ushtruar në Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, “Mbi auditimin financiar dhe të përputhshmërisë” për periudhën 01.01.2019 deri më datën 31.03.2022 trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin nr.131, datë 28.07.2022, të Kryetarit të KLSH-së të cilat janë përcjellë me shkresën nr.380/11, datë 29.07.2022, rezulton se:

I. Hartimi i programit (Plan veprimit) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në nenin 15 shkronja (j) të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”.

Nga auditimi u konstatua se, subjekti ka miratuar planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, duke e dërguar në KLSH me shkresë nr.2295/18 prot., datë 22.08.2022 kjo në përputhje me ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” nenit 15, shkronja j.

Sa më sipër rezulton se është zbatuar afati 20 ditor për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve.

II. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Në lidhje mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve dhe afatet e përcaktuara, sipas strukturave përgjegjëse, DSHQ ka përgatitur planin e masave të marra lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të miratuara nga Titullari brenda afatit 6 mujor dhe e ka dërguar me shkresën nr.5362 prot., datë 05.12.2022 përputhje me ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 30.

Sa më sipër rezulton se është zbatuar afati 6 mujor për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve.

III. Realizimi i rekomandimeve

Nga ana e KLSH-së, janë lënë 6 Masa Organizative, 2 Masa për Shpërblim Dëmi, nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

a) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 6 Masa organizative nga ku 8 rekomandime, janë pranuar plotësisht 8 të cilat kanë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon, 8 Zbatuar.

b) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 2 Masa shpërblim dëmi nga ku 2 rekomandime, janë pranuar plotësisht 2 të cilat kanë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon, 2 Zbatuar.

Më hollësisht, auditimi i ndjekjes së rekomandimeve në Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare paraqitet si vijon:

MASA ORGANIZATIVE:

1.1. Rekomandim: DSHQ të marrë masa në vazhdimësi, që të përpilojë raportet e monitorimit 12 mujore, ku të relatohet në lidhje me realizimin e treguesve në raport me parashikimin, me qëllim menaxhimin sa më efektiv të fondeve buxhetore.

- DSHQ të hartojë një pasqyrë të plotë të objektivave që synon të arrijë institucioni dhe bazën e objektivave, të përgatitet një program zhvillimi afatmesëm për qëndrueshmërinë ekonomike-financiare të institucionit.

Në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare në përmbushje të këtij Rekomandim si dhe në zbatim të Ligjit Nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Udhëzimin e Ministrisë së Financave Nr.7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm”, si dhe Udhëzimit Nr.9, datë 28.02.2022 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025”, buxheti për vitin 2023 – 2025, miratuar me VKD nr.26 datë 26.08.2022, është bërë parashikim i buxhetit afatmesëm.

Ky rekomandim është pranuar dhe me shkresën nr.1116 prot., datë 15.03.2023 është dërguar në Ministrinë e Financave, në Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit, tek Drejtoria e Menaxhimit të Investimeve Publike, raporti i monitorimit 12- mujor

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

2.1. Rekomandim: Sektori i Burimeve Njerëzore të marrë masa nga për plotësimin e dosjeve të personelit me të gjithë dokumentacionin përkatës, sipas bazës ligjore në fuqi.

Në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Ky rekomandim është pranuar dhe është reflektuar plotësimi në dosjet e personelit.

Në zbatim dhe të rregullave të përcaktuara në VKM nr. 833, datë 28.10.2020 “Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit” të gjitha dosjet e nëpunësve janë plotësuar me të gjitha elementët që duhet të përmbajë dhe janë pjesë e dokumentacionit të dosjes së personelit, (raportet mjeko ligjore, certifikatat, diplomatat dhe kualifikimet që janë të lidhura me pozicionet e punës origjinale ose të noterizuara), fleta e inventarit të dosjes së të punësuarit e nënshkruar nga i punësuarit dhe nëpunësi i burimeve njerëzore.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

3.1. Rekomandim: Titullari i institucionit të DSHQ-së të marrë masa në vazhdimësi, që menjëherë pas marrjes së relacionit nga Komision i Inventarizimit, për ngritjen e komisionit të vlerësimit të aktiveve, si dhe nëse konstatohen aktive të dëmtuara ngritjen e komisionit të nxjerrjes jashtë përdorimi.

Në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Në zbatim të këtij Rekomandim, u ngrit Komisioni i Vlerësimit dhe Komisioni i Asgjësimit me Urdhër nr.1616, nr.4980 prot., datë 11.11.2022. Komisioni i vlerësimit ka mbajtur proces verbalin e vlerësimit, miratuar nga titullari i institucionit, me shkresën me nr.253 prot., datë 18.01.2023. Gjithashtu edhe Komisioni i Asgjësimit ka mbajtur proces verbalin për asgjësimin e materialeve me shkresën me nr.253/1, datë 26.01.2023.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

4.1. Rekomandim: Me qëllim shmangien e risqeve të tjetërsimit dhe/ose humbjes së dokumentit, nga ana e Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare, të merren masa për kryerjen e inventarizimit dhe arkivimit të dosjeve për të cilat janë përfunduar procedurat përkatëse, por edhe për të gjitha rastet në vijim, në mënyrë që çdo dokument i administruar nga ky institucion të ketë të gjithë elementët e dokumenteve sipas normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor.

Në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Ky rekomandim është pranuar dhe është reflektuar plotësisht në dosjet e prokurimit. Nga zyra e protokoll-arkiva në bashkëpunim me Sektorin e Prokurimeve janë numëruar dhe inventarizuar të gjitha dosjet e procedurave të prokurimit të përfunduara, si dhe janë arshivuar në Protokoll arkiv sipas rregullave dhe Ligjit Nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat”, “Norma tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”, proces i cili është realizuar edhe për praktikat dhe dosjet e përfunduara në vijim.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

4.2. Rekomandim: Nga ana e Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare të merren masa për të gjitha rastet e procedurave të prokurimit në vijim, hartimi i procesverbalit nr.2 të hapjes dhe vlerësimit të ofertave të kryhet në përputhje me bazën ligjore në mënyrë respektimin e transparencës në këto procedura.

Në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Ky rekomandim është pranuar dhe është reflektuar plotësisht në dosjet e prokurimit. Ky rekomandim gjeti zbatim të menjëhershëm, në të gjitha procedurat e prokurimit janë hartuar procesverbalet përkatëse sipas udhëzimeve dhe rekomandimeve të lëna nga KLSH dhe në përputhje të Ligjit të Prokurimit Publik dhe Rregullat e Prokurimit Publik. (Bashkëlidhur kopje dokument të procesverbalit Nr.1 dhe Nr.2 të një procedure prokurimi të realizuar në gjatë vitit 2022)

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

5.1. Rekomandim: Drejtorja e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse të marrë masa për punonjësit që të kryejnë trajnimet mbi menaxhimin e riskut, element ky shumë i rëndësishëm në veprimtarinë e një institucioni bazuar në Ligjin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollit si dhe referuar kapitullit III të “Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit” i cili citon se punonjësit duhet të kryejnë trajnime në fushën e përdorimit të metodikës së pranuar në identifikimin, analizën dhe menaxhimin e riskut.

Përgjigjja e institucionit:

Ky rekomandim është pranuar dhe nga ana e Sektorit të Burimeve Njerëzore, bazuar në publikimet, njoftimet që janë përcjellë nga ASPA elektronikisht, për pjesëmarrje dhe zhvillime trajnimesh online, sipas kalendarëve javorë me ëëbinaret e trajnimeve sipas temave dhe fushave përkatëse i ka përcjell punonjësve të administratës të gjitha kalendarët përkatës së bashku me linket e regjistrimeve. Për specialist të Drejtorisë Ekonomike gjatë vitit 2022 dhe në vijim janë përcjell të gjithë kalendarët të cilat kanë pas në Tema trajnimi mbi të gjitha fushat financiare ku përmendim:

- Menaxhim i aktivëve në Sektorin Publik (Qershor 2022),
- Planifikimi buxhetor Afatmesëm dhe monitorimi i tij; konceptet bazë (Qershor 2022),
- Kuadri rregullator i kontabilitetit të sektorit publik i përditësuar dhe procedurat për mbylljen e llogarive vjetore të buxhetit (Qershor 2022),
- Menaxhimi i Riskut (Qershor 2022),
- Menaxhimi Programet Buxhetore Afatmesëm dhe Monitorimi i tij për pushtetin qendror (Nëntor 2022),
- Kontrolli i brendshëm financiar publik, statusi de zhvillimet në këtë fushë(Mars 2023),
- Vlerësimet e sistemit të kontrollit të brendshëm nga Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme dhe Raportimit në Ministrinë Financave dhe Ekonomisë (Janar 2023),
- Parimet Kontabël mbi të cilat mbështetet kuadri rregullator të sektorit publik si dhe trajtimi i aktivëve në sektorin publik (Prill 2023),
- Kuadri rregullator i kontabilitetit të sektorit publik i përditësuar dhe procedurat për mbylljen e llogarive vjetore të buxhetit (Maj 2023).

Sektorin e Burimeve Njerëzore, në lidhje me trajnimet e punonjësve të administratës të cilat kanë në fokus përmbushjen e detyrave funksionale, arritjen e objektivave konkretet të punës, si dhe zhvillimin personal të individëve, në nëntor të vitit 2022, ka përcjell korrespondencë të vazhdueshme zyrtare me Institucionin e Kryeministrit për ASPA-n mbi nevojat për trajnim për vitin 2023, numrin e punonjësve për fusha trajnimit për punonjësit e DSHQ-së.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

5.2. Rekomandim: Titullari i Institucionit duhet të marr masa për krijimin e faqes zyrtare ËEBSITE të Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare me qëllim rritjen e transparencës së institucionit.

Përgjigjja e institucionit:

Ky rekomandim është pranuar dhe DSHQ ka krijuar faqen eëbsite e cila pasqyron informacion të përgjithshëm rreth Institucionit të DSHQ-së, si baza ligjore e funksionimit të saj, struktura organizative e autoritetit publik, adresa dhe kontakte etj.

DSHQ, gjatë vitit 2022, nëpërmjet AKEP ka realizuar regjistrimin e domain-it dshq.gov.al e cila i ka dhënë mundësinë e përfshirjes në rrjetin .gov.al dhe nëpërmjet AKSH-it ka implementuar me shërbimet e postës elektronike zyrtare. Referuar sulmeve kibernetike të ndodhur gjatë vitit 2022, që goditi shumë prej sistemeve qeveritare, të hostuara pranë AKSH-it, rrjeti gov.al dhe çdo shërbim i tyre ka qenë i pezulluar, si rrjedhojë DSHQ ka pasur pamundësi e nisjes së kërkesave për asistencë për bashkëpunim për hostim dhe krijimin e faqes eëb për DSHQ.

Në fazën në vijim, në kuadër të rritjes së transparencës, nëpërmjet përdorimit të internetit, dhe përmirësimit të faqeve ekzistuese, institucioni jonë po bashkëpunon me AKSH-in, ku përveç

komunikime me asistentë specialist të akshit, janë përcjell me shkresë zyrtare kërkesë për "Hostim" dhe krijimin e një faqe WEB për institucionin ku të jetë me prapashtesën identifikuese: "gov.al" dhe të pasqyrojë të gjitha informacionet e detyrueshme të përcaktuara dhe sipas Urdhrit Nr. 199, datë 26.10.2013 "Për një shtesë në urdhrin nr. 202, datë 16.12.2005 të Kryeministrit "Për forcimin e transparencës, nëpërmjet rritjes së përdorimit të internetit dhe përmirësimit të faqeve ekzistuese të internetit". Në vijim, nga AKSHI nëpërmjet shkresës së fundit me nr. 2338/2 datë 06.07.2023 bëjnë me dije se për DSHQ-në është krijuar serveri virtual për hostimin e faqes ëeb *dshq.gov.al*, për sa i përket zhvillimit dhe mirëmbajtjes së saj mbetet përgjegjësi e institucionit. DSHQ, referuar përgjigjes së tyre, ka ngritur një grup pune i cili do të ndjek praktikën e mëtejshme për krijimi dhe zhvillimin e faqes web.
(Bashkëlidhur shkresa përcjellëse drejtuar AKSHIT si dhe urdhri i grupit të punës)

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

6.1. Rekomandim: Titullari i Institucionit të marr masa, për plotësimin e vendit vakant pasi mungesa e përgjegjësit të sektorit të auditimit cenon procesin e auditimit dhe reflektohet në performancën e këtij sektori e cila ka çuar në uljen e numrit të auditimeve dhe gjithashtu në mungesën e kontrollit të cilësisë nga strukturat përgjegjëse.

Në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Ky rekomandim është pranuar dhe bazuar në Rregulloren e Brendshme të DSHQ-së, për rekrutimin e punonjësve, sipas metodologjisë së përcaktuar, në muajin shtator u shpall në portalin AKPA pozicioni vakant Shef i Sektorit të Auditit të Brendshëm. U zhvilluan të gjitha fazat përkatëse për përzgjedhjen dhe vlerësimin kandidatëve nga ku u përzgjedh dhe kandidati fitues për pozicionin vakant Shef i Sektorit të të Auditit të Brendshëm, i cili nëpërmjet Urdhrit për Emërim në Detyrë nr. 1345 datë dhe nr prot., 4193 datë 26.09.2022, më datë 3 tetor 2022 ka filluar të ushtrij detyrën dhe funksionet pranë DSHQ-së.

(Bashkëlidhur urdhri i emërimit në detyrë i Shef i Sektorit të Auditit të Brendshëm,)

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1.1. Rekomandim: Nga Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare të merren masa për arkëtimin e shumës së përfitur padrejtësisht nga operatori ekonomik BOE "B." sh.p.k. dhe "E. K." sh.p.k. në vlerën 170,846 lekë pa tvsh.

Menjëherë

Përgjigja e institucionit:

Në zbatim të këtij Rekomandim, Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare, përgatiti xhirimin e brendshëm, Urdhër Shpenzimin me nr.13 datë 24.08.2022, me vlerë totale 205,015 me TVSH, për Degën e Thesarit, për kalimin e kësaj shume në buxhetin e shtetit duke e marrë nga fondi i garancisë së ngurtësuar në Degën e Thesarit në emër të operatorit.

Ky rekomandim është pranuar dhe nga ana e Institucionit është kryer mbajtja e penalitetit për rikonstruksionin e Pallatit të Kongreseve kryer në përputhje me kontratën 1871/9 prot., datë 24.08.2021.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

2.1. Rekomandim: Nga Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare të merren masa për arkëtimin e shumës së përfituar padrejtësisht nga operatori ekonomik BOE “T.” sh.p.k. dhe “Sh.” sh.p.k. në vlerën 249,900 lekë pa tvsh.

Menjëherë

Përgjigja e institucionit:

Në zbatim të këtij Rekomandim, Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare, përgatiti xhirimin e brendshëm, Urdhër Shpenzimin me nr.12 datë 24.08.2022, me vlerë totale 299,880 me TVSH, për Degën e Thesarit, për kalimin e kësaj shume në buxhetin e shtetit duke e marrë nga fondi i garancisë së ngurtësuar në Degën e Thesarit në emër të operatorit.

Ky rekomandim është pranuar dhe nga ana e Institucionit është kryer mbajtja e penalitetit për suvatim me suva plastike të Pallatit të Kongreseve kryer në përputhje me kontratën 617/20 prot., datë 06.05.2021.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve në DSHQ për Raportin Përfundimtar të Auditimit “Për auditimin e përputhshmërisë” dërguar me shkresën nr.380/1 prot., datë 12.04.2022, për veprimtarinë nga data 01.01.2019 deri më datën 31.03.2022 rezulton se subjekti i audituar ka respektuar afatin 20 ditor për hartimin e planit të masave për zbatimin e rekomandimeve në përputhje me kërkesat e nenit 15 shkronja (j) të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, ka respektuar afatin për njoftimin brenda 6 muajve mbi ecurinë e zbatimit të këtyre masave në përputhje me kërkesat e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Konkretisht ecuria e zbatimit të rekomandimeve paraqitet sipas tabelës “Ecuria e zbatimit të rekomandimeve”

lekë

Masa	Gjithsej		Pranuar		Zbatuar plotësisht		Pjesërisht		Në proces		Pa zbatuar	
	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë
Organizative	8	-	8	-	8	-	-	-	-	-	-	-
Shpërblim dëmi	2	-	2	420,746	2	420,746	-	-	-	-	-	-
Gjithsej	10	420,746	10	420,746	2	420,746	-	-	-	-	-	-

Sa sipër rezulton se janë dhënë gjithsej 10 rekomandime të cilët janë pranuar plotësisht (100 %), dhe rezultojnë të zbatuar plotësisht 10 masa (100 %).

3.3 MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

PËRMBLEDHJE

Në zbatim të Programit të Auditimit nr. 613/22 prot, datë 06.07.2023 “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e evaduara në 6-mujorin e parë të vitit 2022”, në ambientet e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, më datë 31.07.2023, u mbajt aktverifikimi nga audituesit e autorizuar të KLSH-së S.K dhe J.K me znj. M. K.Sekretar i Përgjithshëm (i ngarkuar me detyrë).

Objekt i këtij akt verifikimi është:

Verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të KLSH të lëna me shkresën nr.1267/26 prot., datë

07.06.2022, për Raportin Përfundimtar të Auditimit “Mbi auditimin e përputhshmërisë dhe vlerësues me fokus Planin Kombëtar të Deinstitutionalizimit të Fëmijëve 2020-2022”, të ushtruar në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (këtu e më poshtë: MSHMS), sipas programit të auditimit nr.1267/1 prot, datë 22.11.2021, i ndryshuar, për periudhën nga 01.09.2020 deri me 31.11.2021, lidhur me statusin e zbatimit të rekomandimeve, afateve dhe niveli i zbatueshmërisë së tyre, koherencën e tyre si dhe përgjegjshmërinë menaxheriale referuar standardeve të auditimit.

Auditimi u krye nga:

1. S.K

2. J.K

Auditimi ka filluar më datë 07.07.2023

Auditimi ka përfunduar më datë 27.07.2023

Auditimi është kryer në bazë të Programit të Auditimit të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit nr.613/22 prot., datë 06.07.2023 me objekt: “Mbi verifikimin e zbatimi të rekomandimeve”, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” si dhe në zbatim të Rregullores së Procedurave të Auditimit dhe të Manualit për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të auditimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe Regjistrisë elektronik institucionale, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 67, datë 13.06.2020.

TRAJTIMI I ÇËSHTJEVE TË AUDITIMIT

Nga auditimi i ushtruar në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, “Mbi auditimin e përputhshmërisë dhe vlerësues me fokus Planin Kombëtar të Deinstitutionalizimit të Fëmijëve 2020-2022” për periudhën 01.09.2020 deri më datën 31.11.2021 trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin nr.29, datë 16.03.2021, të Kryetarit të KLSH-së të cilat janë përcjellë me shkresën nr.380/11, datë 07.06.2022, rezulton se:

I. Hartimi i programit (Plan veprimit) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në nenin 15 shkronja (j) të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Nga auditimi u konstatua se, subjekti ka miratuar planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, duke e dërguar në KLSH me shkresë nr.430/5 prot., datë 27.07.2022 me 21 ditë vonesë, *ne kundërshtim* me ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” nenit 15, shkronja j.

Sa më sipër rezulton se është zbatuar afati 20 ditor për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve.

II. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Në lidhje mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve dhe afatet e përcaktuara, sipas strukturave përgjegjëse, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, nuk ka përgatitur planin e masave të marra lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të miratuara nga titullari brenda afatit 6 mujor, në kundërshtim me ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” pika 2 e nenit 30, pika 2 e tij.

Sa më sipër rezulton se nuk është zbatuar afati 6 mujor për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve.

III. Realizimi i rekomandimeve

Nga KLSH janë lënë 3 masa organizative dhe 1 masë disiplinore nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

- a) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 3 masa organizative, janë pranuar plotësisht 3 të cilat kanë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon, 2 Zbatuar, 1 në proces zbatimi.
- b) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 1 Masë Disiplinore, e cila nuk është pranuar.

Më hollësisht, auditimi i ndjekjes së rekomandimeve në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale paraqitet si vijon:

MASA ORGANIZATIVE:

1.1. Rekomandim: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ,nëpërmjet Drejtorisë, së Përgjithshme të Politikave dhe Zhvillimit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të marrë masa për të integruar Planin e Veprimit me afatet e rivendosura me Progres raportin e vitit 2021, miratuar në janar të vitit 2022, me qëllim zbatimin e Planit të Veprimit në kohë dhe me cilësi.

Menjëherë

Përgjigja e institucionit:

Lidhur me këtë rekomandim sqarojmë se në Planin e masave të hartuara nga MSHMS dhe dërguar KLSH, më 27.07.2022, me nr. prot. të MSHMS 430/4 dhe 430/5 shprehemi si më poshtë:

Lidhur me këtë rekomandim sqarojmë se nisur nga fakti se jemi në momentet e shkrimit të draftit të zgjatjes së Planit Kombëtar për Deinstitutionalizimin për tre vitet e ardhshme 2023-2025, propozojmë shkrimin dhe miratimin nga Komiteti Drejtues i një plani veprimi afatshkurtër për periudhën Shtator-Dhjetor 2022.”

Në këtë kontekst Komitetit Drejtues i sigurimit të zbatimit të Planit të deinstitutionalizimit, pas konsultimeve të vazhdueshme, gjatë vitit 2022, mori Vendimin Nr.1, datë 31.01.2023, Për miratimin e vijimësisë së Planit të veprimit për zbatimin e Planit Kombëtar të deinstitutionalizimit 2020-2022, për vitin 2023”. (bashkëlidhur vendimet)

Ky vendim vjen dhe bazuar në raportin e vlerësimit të arritjeve të këtij plani kombëtar (Dhjetor 2022), ku u konsiderua i nevojshëm shtyrja e planit të veprimit në zbatim të tij për vitin 2023, propozim i cili u miratua nga Komiteti, në mbledhjen e parë të vitit 2023.

Një nga gjetjet kryesore për shtyrjen e afatit të realizimit të planit të veprimit për vitin 2023 është mospërbushja e disa prej objektivave dhe nënobjektivave të planit të veprimit.

Një nga arsyet për mosrealizimin e tyre ka qenë miratimi i Planit Kombëtar të Deinstitutionalizimit në Shtator 2020, çka solli vonesa, si në zbatimin e afateve, po ashtu edhe në kontrollin e zbatimit të detyrave të përcaktuara në këtë plan.

Nga ana tjetër, situata pandemike COVID 19 pati ndikimin e vet, vështirësi dhe vonesa në realizimin e disa masave/aktiviteteve.

Propozimi për vijimësinë e realizimit të këtij plani vetëm për 2023, vjen, gjithashtu, pasi parashikohet që vazhdimësia e procesit/reformës së Deinstitutionalizimit, të jetë pjesë integrale e Dokumentit Strategjik të Mbrojtjes Sociale 2024-2030, që do të miratohet me Vendim të Këshillit të Ministrave.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

2.1. Rekomandim: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale , nëpërmjet Drejtorisë, së Përgjithshme të Politikave dhe Zhvillimit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të marrë masa

për të realizuar në afat dhe me cilësinë e kërkuar të gjithë objektivat e përcaktuara në Planin e Veprimit për zbatimin e PKD.

Menjëherë

Përgjigja e institucionit:

MSHMS ka zhvilluar një analizë të thelluar të kuadrit ligjor që lidhet direkt dhe ndihmon procesin e deinstitutionalizimit, duke iu referuar paketës së funksionimit të shërbimeve shoqërore dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve. (analiza është vënë në dispozicion të Ekipit të Auditimit të përputhshmërisë dhe vlerësues me fokus Planin Kombëtar për Deinstitutionalizimin e fëmijëve 2020 – 2022)

Bazuar në rekomandimet e analizës ligjore, të sipërcituar, MSHMS, në kuadër të propozime të ardhura nga Ministria e Drejtësisë, për ndryshime të Ligjit 9695, datë 19.03.2007 “Për procedurat e birësimit dhe Komitetin Shqiptar të Birësimit” dhe Ligjin nr. 9062, datë 08.05.2003 “Kodi i Familjes”, i ndryshuar, ka propozuar ndryshime të mëtejshme, të këtyre dy ligjeve, që lidhen me shërbimin e kujdestarisë alternative (e cila është baza e reformës së DE-D). Ndryshimet e të dy akteve ligjore, nuk u miratuan nga Kuvendi i Shqipërisë.

Me qëllim përmirësimit të kujdesit alternativ për fëmijët pa kujdes prindëror, MSHMS, ka realizuar, së fundmi, analizën ligjore të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 149/2018 datë 13.3.2018 “Për kriteret, dokumentacionin dhe procedurat për evidentimin e familjes kujdestare për fëmijët pa kujdes prindëror dhe masës së financimit për shpenzimet e fëmijës së vendosur në familje kujdestare”, e cila ka rimarrë analizën e të gjithë kuadrit rregullator (përfshirë dhe ligjet e sipërcituara) të shërbimit të kujdestarisë. Gjithashtu është realizuar dhe analiza ligjore e Ligjit 8153/1996 “Statusi i Jetimit”, protokolluar me nr. 388/1, datë 20.10.2022.

Bazuar në gjetjet e këtyre analizave, grupi i punës ka dalë me disa rekomandime, si më poshtë vijon:

- Rishikimi si paketë i shtesave dhe ndryshimeve në Kodin e Familjes, Kodin e Procedurës Civile, ligjit për Birësimin dhe Komitetit Shqiptar të Birësimit, ligjin për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës, ligjin për perkujdesjen shoqërore në Republikën e Shqipërisë dhe paraqitja e shtesave dhe ndryshimeve në ligjet e mësipërme së bashku me projektligjin për kujdestarinë alternative në Republikën e Shqipërisë;
- Hartimi një tabele të akteve nënligjore të miratuara, të ndryshuara, të shfuqizuara në lidhje me KA;
- Rishikimi i të gjithë akteve nënligjore në fuqi dhe “ekstraktimi” prej tyre i elementëve që duhet të rregullohen me ligj dhe çështjeve që do të rregullohen me akte nënligjore. Miratimi i ligjit për KA dikton nevojën e miratimit të akteve nënligjore;
- Përgatitja e projektligjit për kujdesin alternativ së bashku me paketën e projekt akteve nënligjore, me qëllim shmangien mbivendosjeve, të vonesave në miratimin e tyre dhe me qëllim harmonizimit e tyre;

Në rishikimin e afateve të realizimit Planit të DEI, për vitin 2023, është parashikuar, konsultimi dhe miratimi i të gjitha analizave, të sipërcituara, gjatë muajve Tetor-Dhjetor 2023.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

3.1. Rekomandim: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale , nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Politikave dhe Zhvillimit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të marrë masa për të inkuadruar dhe ngarkuar me detyra konkrete SHSSH në procesin e realizimit të

objektivave të Planit të Veprimit për deinstitutionalizimin.

Menjëherë

Përgjigja e Institucionit:

Sqarojmë se në Planin për vitin 2023 të DEI Shërbimit Social Shtetëror i ngarkohen detyra konkrete (Plani 2023 bashkëlidhur vendimit, të sipërcituar)

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

MASA DISIPLINORE

D.1 Për punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil

Në mbështetje të shkronjës(c) neni 15-Te drejtat dhe detyrat e KLSH-së të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, shkronjat (b,c dhe ç), neni 58 –“Llojet e masave disiplinore”, të Ligjit nr.153/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar si dhe VKM nr. 115, datë 5.3.2014 për “Përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmartjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, shkronja (e dhe ç) të nenit 11, Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për të gjithë punonjësit e konstatuar me përgjegjësi sipas çështjeve të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, si dhe të marrë masa disiplinore nga “Vërejtje” deri në “Largim nga shërbimi civil”.

Përgjigja e institucionit:

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, pasi ka vlerësuar raportin final të auditimit, ka vlerësuar dhe ka pranuar rekomandimet që lidhen me masat organizative, për të cilat ka hartuar planin e masave të dërguara pranë KLSH, më 27.07.2022, me nr. prot. të MSHMS 430/4 dhe 430/5.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i papranuar** nga subjekti.

Observacion dërguar me shkresën nr.2572/5 prot., datë 06.10.2023 protokolluar me tonën me nr.613/63 prot., datë 16.10.2023.

Komenti lidhet me Rekomandimn e lënë “Masa Disiplinore”, konkretisht “Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për të gjithë punonjësit e konstatuar me përgjegjësi sipas çështjeve të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, si dhe të marrë masa disiplinore nga “Vërejtje” deri në “Largim nga shërbimi civil”.

Komenti nga ana e institucionit tonë lidhur me këtë rekomandim ka qenë si më poshtë:

“Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, pasi ka vlerësuar raportin final të auditimit, ka vlerësuar dhe ka pranuar rekomandimet që lidhen me masat organizative, për të cilat ka hartuar planin e masave të dërguara pranë KLSH, më 27.07.2022, me nr. prot. të MSHMS 430/4 dhe 430/5.”

Pra Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nuk e ka pranuar Rekomandimn e lënë për masën disiplinore. Sa më sipër lutemi riformulimin e “komentit të grupit të auditimit”, si vijon: “Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet i papranuar nga subjekti”.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet i papranuar nga subjekti.

Sa më sipër observacioni merret në konsideratë.

KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve në MSHMS për Raportin Përfundimtar të Auditimit “Mbi auditimin e përputhshmërisë dhe vlerësues me fokus Planin Kombëtar të Deinstitutionalizimit të Fëmijëve 2020-2022” dërguar me shkresën nr. 1267/1 prot, datë 22.11.2021, i ndryshuar, rezulton se subjekti i audituar ka respektuar afatin 20 ditor për hartimin e planit të masave për zbatimin e rekomandimeve në përputhje me kërkesat e nenit 15 shkronja (j) të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, por nuk ka njoftuar brenda 6 muajve mbi ecurinë e zbatimit të këtyre masave, në kundërshtim me kërkesat e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Konkretisht ecuria e zbatimit të rekomandimeve paraqitet sipas tabelës “Ecuria e zbatimit të rekomandimeve”

lekë

Masa	Gjithsej		Pranuar		Pa Pranuar		Zbatuar plotësisht		Pjesërisht		Në proces		Pa zbatuar	
	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë
Organizative	3	-	3	-	-	-	2	-	-	-	1	-	-	-
Disiplinore	1	-	-	-	1	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Gjithsej	4	-	3	-	1	-	2	-	-	-	1	-	-	-

Sa sipër rezulton se janë dhënë gjithsej 4 rekomandime të cilët janë pranuar 3 (100%), dhe rezultojnë të zbatuar plotësisht 2 masa (67%).

Për të gjitha rekomandimet që konsiderohen në proces zbatimi, inkurajohet përshpejtimi i realizimit të plotë të tyre.

3.4 MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SPORTIT

PËRMBLEDHJE

Në zbatim të Programit të Auditimit nr. 613/20 datë 06.07.2023 “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e evaduara, në ambientet e institucionit MAS, më datë, 31.07.2023 u mbajt akt-verifikimi nga audituesit e autorizuar të KLSH-së z. G.H dhe znj. A.K me përfaqësues nga subjekti z. E. T. në cilësinë e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe znj. A. D. e autorizuar për trajtimin e rekomandimeve të KLSH-së.

Objekt i këtij akt verifikimi është:

Verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të KLSH të lëna me shkresën nr. 933/1 prot., datë, 17.05.2021 për Raportin Përfundimtar të Auditimit “Për auditimin financiar dhe përputhshmëri” të ushtruar në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, sipas programit të auditimit nr. 933/1 prot, datë, 03.09.2021, për periudhën 01.09.2019 deri në datën 31.08.2021, si dhe auditimit “Tematik të përputhshmërisë” sipas programit nr 895/1 datë 14.10.2022, për periudhën nga data 01.01.2021 deri në datën 30.06.2022 që i përket 6 mujorit të dytë, në lidhje mbi statusin e zbatimit të rekomandimeve, afateve dhe niveli i zbatueshmërisë së tyre, koherencën e tyre si dhe përgjegjshmërinë menaxheriale referuar standardeve të auditimit.

Auditimi u krye nga:

1. G.H
2. A.K

Auditimi ka filluar më datë 07.07.2023

Auditimi ka përfunduar më datë 31.07.2023

Auditimi është kryer në bazë të Programit të Auditimit të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit nr.613/24 prot., datë 06.07.2023 me objekt: “*Mbi verifikimin e zbatimi të rekomandimeve*”, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” si dhe në zbatim të Rregullores së Procedurave të Auditimit dhe të Manualit për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të auditimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe Regjistrisë elektronik institucionale, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 67, datë 13.06.2020.

TRAJTIMI I ÇËSHTJEVE TË AUDITIMIT

Nga auditimi i ushtruar në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, “*Mbi auditimin financiar dhe përputhshmëri*” për periudhën e veprimtarisë nga data 01.09.2019 deri në 31.08.2021 trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit me nr.933/13, datë 04.04.2022, dhe vendimit të Kryetarit të KLSH-së, rezultojnë se:

I. Hartimi i programit (Plan veprimit) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në nenin 15 shkronja (j) të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Nga auditimi u konstatua se, subjekti i audituar MAS ka hartuar një procesverbal të mbajtur në datën 25.02.2022, me nr. 2642/45 prot, dërguar në KLSH në lidhje me temën “Për marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga projekt raporti i auditimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit” kjo në përputhje me ligjin nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” nenit 15, shkronja ‘j’.

Sa më sipër rezultojnë se është zbatuar afati 20 ditor për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve.

II. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Në lidhje mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve dhe afatet e përcaktuara, sipas strukturave përgjegjëse, MAS ka përgatitur planin e masave të marra lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të miratuara nga Titullari brenda afatit 6 muajor, dërguar me shkresën nr.2248/14prot, datë 16.05.2022 kjo në përputhje me Ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” nenit 30, pika 2 e tij.

Sa më sipër rezultojnë se është zbatuar afati 6 muajor për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve.

III. Realizimi i rekomandimeve

Nga ana e KLSH-së, janë lënë 24 masa organizative, 2 masa për shpërblimin e dëmit dhe 7 masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin dhe menaxhimin me ekonomikitet, eficence dhe efektivitet të fondeve publike. *Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:*

a) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 24 masa organizative nga ku 25 rekomandime, të cilat janë pranuar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit ku nga këto 13 janë të zbatuara, 3 janë të pazbatuara dhe 9 janë në proces zbatimi.

b) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 2 masa për shpërblimin e dëmit me 3 rekomandime të cilat kanë statusin, 1 zbatuar dhe 2 në proces zbatimi.

c) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 7 masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin dhe menaxhimin me ekonomikitet, eficence dhe efektivitet të fondeve publike me 9 rekomandime ku nga këto 9 rekomandime janë të zbatuara.

d) Për përmirësimin e gjendjes te masa disiplinore i rekomandohet Titullarit të Institucionit që në përputhje me ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të vlerësojë, shkallën e përgjegjësisë

për secilin punonjës të përfshirë, në lidhje me mangësitë dhe shkeljet e konstatuara, të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, si dhe të kërkojë marrjen e masave për personat që vlerësohen me përgjegjësi në këtë raport përfundimtar auditimi ky rekomandim është i pazbatuar.

Më hollësisht, auditimi i ndjekjes së rekomandimeve në MAS paraqitet si vijon:

MASA ORGANIZATIVE:

1.1. Rekomandim: Nga Nëpunësi Autorizues të merren masat në të ardhmen që mos të ndërmerret asnjë angazhim financiar pa fondet e nevojshme në dispozicion.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e Institucionit

Lidhur me gjetjen 1 dhe Rekomandimn 1.1 sqarojmë se, bazuar në ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe vendimit nr.285, datë 19.05.202. të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, i ndryshuar, Sektori i Prokurimeve në MAS në vijimësi përpara nisjes së procedurave prokuruese merr konfirmimin e Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar për disponueshmërinë e fondeve dhe njofton me shkresë Degën e Thesarit Tiranë.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

2.1. Rekomandim: Nga Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të merren masa që në të ardhmen mos të përsëriten më raste kur nuk raportohet vlera e plotë e mbetur e kontratës për planifikimin e fondeve buxhetore lidhur me detyrimet e prapambetura, si dhe të merren masa që alokimi i fondeve në të ardhmen të bëhet pa krijuar dhe pa akumuluar detyrime të prapambetura në kuadër të likuidimit të shpenzimeve të tjera.

Menjëherë

Përgjigjja e Institucionit

Lidhur me gjetjen e cituar më lart dhe Rekomandimn 2.1, në zbatim të Urdhërit nr.88, datë 22.02.2022”Për pagesën e fondit të garancisë në zbatim të kontratës “Rikonstruksioni i Godinës së IZHA”, me urdhër shpenzimin nr.638 datë22.12.2021, detyrimi i MAS për këtë kontratë është përfunduar, pas çeljes së fondeve nga MFE me shkresën nr.19.968/1 datë 23.11.2021 “Transferim fondi për shpenzime kapitale”, i cili ka miratuar transferimin e fondit në shumën 4.332.496 lekë, për mbylljen e detyrimit të sipërcituar.

Në vijimësi Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar me shkesën nr.3926, datë 13.07.2021“Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm për periudhën 2022 -2024”, dhe udhëzuesin për hartimin e buxhetit të institucioneve të sistemit të arsimit, për periudhën afatmesme 2022-2024, u është drejtuar institucioneve të varësisë për plotësimin me përgjegjshmëri të kërkesave buxhetore 2022-2024, dhe ndër të tjera dhe me qëllim shlyerjen e detyrimeve koherente, brenda vitit buxhetor dhe minimizimin e mbartjes së tyre në vitin pasardhës, për të minimizuar dhe eliminuar në të ardhmen rialokomin e fondeve buxhetore për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura.

(Bashkëlidhur do të gjeni kopje të Urdhërit nr.88, datë 22.02.2022, urdhër shpenzimin nr.638 datë 22.12.2021, shkresës nr.3926, datë 13.07.2021).

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim, konsiderohet i **pranuar** dhe e **zbatuar**

3.1. Rekomandim: Nga Aparati MAS si dhe institucionet e varësisë: ZVA Mallakastër, Librazhd, Peqin, Skrapar dhe Kolonjë, të merren masa për raportimin dhe likuidimin në kohë të detyrimeve që të mos krijohen detyrime të prapambetura. Gjithashtu të merren masa të raportohen në kohë detyrimet e prapambetura për hartimin e raporteve të monitorimit brenda kuadrit ligjor në fuqi. Nga personat përgjegjës për hartimin e pasqyrave financiare të merren masat për provizionimin e shpenzimeve për vendimet gjyqësore në pasqyrat Financiare të vitit 2021.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigja e Institucionit

Nga Aparati i të MAS janë marrë masa dhe likuiduar detyrimet për vendimet gjyqësore me: urdhër shpenzimi nr.36, datë 08.02.2022, likuiduar kreditori M. P., në shumën 1.335.372 lekë; urdhër shpenzimi nr. 37 datë 08.02.2022 me përfitues S. M., në shumën 801.847 lekë; urdhër shpenzimi nr. 38 datë 08.02.2022, likuiduar kreditori A. Zh., në shumën 1.343.563 lekë; urdhër shpenzimi nr.39 datë 08.02.2022, likuiduar kreditori Sh. N., në shumën 915.840 lekë; me urdhër shpenzimin nr.638 datë 22.12.2021, është bërë likuidimi dhe shlyerja e detyrimit në shumën 4.332.496 lekë, për subjektin “A. S.” sh.p.k.

Lidhur me detyrimet e institucioneve të varësisë: ZVA Mallakastër, Librazhd, Peqin, Skrapar dhe Kolonjë nga ana e MAS në vijim të kërkesave të DRAP/ZVA respektive është bërë çelja e fondeve me shkresat nr.3896/1, datë 04.08.2021; nr.3545/1, datë 28.06.2021; nr.4831/1, datë 07.10.2021; nr.7683/1, datë 09.12.2022; janë bërë ndryshime në planin e buxhetit të vitit 2021 dhe 2022 dhe është bërë likuidimi i detyrimeve të prapambetura sa më poshtë:

-Zyra Vendore Arsimore Skrapar me urdhër shpenzimi nr.129, datë 20.07.2022, likuiduar detyrimi ndaj kreditorit M. C. në masën 708.411 lekë.

-Zyra Vendore Arsimore Peqin me urdhër shpenzimi nr.190, datë 20.10.2021, nr.212, datë 11.11.2021, është likuiduar detyrimi ndaj kreditorit B. G. në masën 4.135.672 lekë.

-Zyra Vendore Arsimore Librazhd me urdhër shpenzimi nr.224, datë 27.08.2021, likuiduar detyrimi ndaj kreditorit B. A. në masën 960.260 lekë; urdhër shpenzimi nr.223, datë 27.08.2021, likuiduar detyrimi ndaj kreditorit Sh. K. në masën 1055758 lekë, urdhër shpenzimi nr.373, datë 12.12.2022, likuiduar detyrimi fakt 85, datë 6.12.2019 në masën 47,500 lekë. Lidhur me detyrimet e tjera në masën 693.730 lekë ZVA Librazhd sqaron se me shkresën nr.1789, datë 22.12.2022 ka bërë heqjen e këtyre detyrimeve nga sistemi SIFQ pasi dokumentacioni për ta nuk është i plotë.

-Zyra Vendore Arsimore Kolonjë me urdhër shpenzimi nr.149, datë 18.10.2021 ka likuiduar detyrimin ndaj kreditorit A. G. në masën 167.250 lekë; urdhër shpenzimi nr.202, datë 16.12.2022, likuiduar detyrimi ndaj kreditorit V. P. në masën 332.500 lekë, urdhër shpenzimi nr.70, datë 10.05.2022, likuiduar detyrimi udhëtim i brendshëm ndaj kreditorit V.Q. në masën 35.640 lekë.

Lidhur me detyrimet e Zyrës Vendore Arsimore Mallakastër kjo njësi me shkresën nr.461, datë 23.07.2018 “Kërkesë për apelim”, i është drejtuar Drejtorisë së Apelit Tatimor në DPT Tiranë, për apelimin e detyrimeve dhe me shkresën nr.1043, datë 05.12.2022 “Kërkesë për marrje informacioni”, i është drejtuar Gjykatës së Apelit Administrativ Tiranë e cila me shkresën 1964/1, datë 12.12.2022 “Kthim përgjigje”, informon se është në proces gjykimi.

Drejtorja Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar në MAS në vijim për minimizimit të detyrimeve të prapambetura me shkresën nr.7077, datë 13.12.2021, “Tërheqje vëmendje mbi mosraportimin periodik të detyrimeve të prapambetura në degën e thesarit sipas udhëzimit nr.37, datë 6.10.2020”, në zbatim të ligjit nr. 137/2020 “Për buxhetin e vitit 2021”, të

ndryshuar, udhëzimit plotësues nr.4, datë 25.01.2021 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2021”, u është drejtuar institucioneve të varësisë për raportimit të detyrimeve të prapambetura të krijuara rishtazi dhe në nivel progresiv deri më 31 Dhjetor 2021, konform udhëzimit nr. 5, datë 27.02.2014, të ministrit përgjegjës për financat, “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, Shtojca 3, si dhe udhëzimit nr.37, datë 6.10.2020 (duke vendosur bashkëlidhur “Urdhër regjistrimi i detyrimit të prapambetur” dhe të gjithë dokumentacionin justifikues), si dhe të informojnë mbi masat e marra për të mos lejuar në vazhdimësi krijimin e detyrimeve të prapambetura, të cilat rëndojnë drejtpërdrejt mbi buxhetin e shtetit, nxjerrjen e përgjegjësve/përgjegjësive konkrete për situatën e krijuar deri në momentin e raportimit si dhe hapat e mëtejshëm në këtë drejtim.

(Bashkëlidhur do të gjeni kopje të urdhër shpenzimeve të Aparatit të MAS :nr. 36, 37, 38, 39, datë 08.02.2022,nr.638 datë22.12.2021, shkresat të MAS nr.3896/1, datë 04.08.2021; nr.3545/1, datë 28.06.2021; nr.4831/1, datë 07.10.2021; nr.7683/1, datë 09.12.2022; urdhër shpenzimet: ZVA Skrapar nr.129, datë 20.07.2022; ZVA Peqin nr.190, datë 20.10.202, nr.212, datë 11.11.2021; ZVA Librazhd me urdhër shpenzimi nr.224, datë 27.08.2021; urdhër shpenzimi nr.223, datë 27.08.2021, nr.373, datë 12.12.2022 si dhe shkresa nr.1789, datë 22.12.2022; shkresa MAS nr.7077, datë 13.12.2021)

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe e zbatuar.**

4.1. Rekomandim: Nga Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, në veçanti Sektori i Financës të marrë masa për të reflektuar të gjitha mangësitë e konstatuara gjatë procesit të hartimit të pasqyrave financiare në vijimësi, me qëllim paraqitjen e saktë të zërave në bilancin e institucionit.

Në vijimësi

Përgjigja e Institucionit

Lidhur me gjetjen 4 dhe Rekomandimn 4.1, sqarojmë se në zbatim të ligjit nr.9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”; Vendimit nr.248, datë 10.04.1998, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Planit Kontabël Publik të Organeve të Pushtetit Lokal, Institucioneve Shtetërore Qendrore e Lokale si dhe njërive që varen prej tyre”, Udhëzimit nr.8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Rekomandim është konsideruar nga Sektori i Financës në MAS dhe janë paraqitur saktë në zërat e bilancit dhe është bërë reflektimi i tyre në pasqyrat financiare të institucionit për vitin 2021, duke bërë të gjithë korrigjimet e nevojshme sipas problematikave të konstatuara të cilat janë reflektuar gjatë hartimit të pasqyrave financiare të vitit 2021 të paraqitura dhe sqaruar në relacionin shoqërues të bilancit dorëzuar përkatësisht me shkresën nr.421. datë 28.03.2022 “Dërgohen pasqyrat financiare vjetore 2021”, si dhe shkresën nr.1802, datë 16.03.2023 “Dërgohen pasqyrat financiare vjetore 2022”, (Bashkëlidhur do të gjeni kopje të shkresave: nr.421. datë 28.03.2022, nr.1802, datë 16.03.2023).

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe zbatuar**

5.1. Rekomandim: Nga Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar si dhe Drejtoria Juridike të merren masa për analizimin e hollësishëm të debitorëve. Të bashkëpunohet, për ndjekjen e procesit të arkëtimit të detyrimeve të këtyre debitorëve ose në rast se janë ezauruar të gjitha proceset dhe kanë rezultuar me pamundësi arkëtimi, të merren masa për fshirjen e detyrimeve

nga kontabiliteti.

Menjëherë

Përgjigja e Institucionit

Lidhur me gjetjen 5 dhe Rekomandimn 5.1, sqarojmë se Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar ka evidentuar të gjithë debitorët, dhe akti i konstatimit me shumat respektive sipas tabelës “Gjendja e llogarisë “Debitorë të ndryshëm”, dhe informacioni është përcjellë me Memo nr.2642/44. Prot, datë 21.02.2022, në Drejtorinë e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të kuadrit Rregullator, me qëllim ndjekjen me procedurat përkatëse ligjore të procesit të arkëtimit të detyrimeve të këtyre debitorëve. theksojmë se aktualisht nuk është kryer asnjë arkëtim të këtyre debitorëve pasi nuk janë ezauruar të gjitha proceset. Do shikohet në të ardhmen.

Bashkëlidhur gjeni Memo nr.2642/44. Prot, datë 21.02.2022.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** dhe e **pazbatuar**

6.1. Rekomandim: Nga MAS dhe grupi i përgatitur për inventarizimin e aktiveve në fund të vitit 2021 të merren masat që të kryhet inventarizimi i imtësisishëm i aktiveve dhe të verifikohen me përpikëri gjendja dhe vlera e aktiveve. Nga personat përgjegjës për kontabilitetin dhe hartimin e Pasqyrave financiare të marrë masa duke kryer veprimet përkatëse për sistemimin dhe saktësimin e vlerës të aktiveve në vijimësi dhe pasqyrimin e tyre në pasqyrat financiare/formatet përkatëse për vitin 2021.

Brenda datës 31.04.2022

Përgjigja e Institucionit

Lidhur me gjetjen 6 dhe Rekomandimn 6.1, sqarojmë se në zbatim të udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011, MAS ka kryer procesin e inventarizimit të aktiveve të Aparatit të MAS. Në vijim të detyrimeve ligjore si dhe te Rekomandim të KLSH, për vitin 2022 janë miratuar nga Ministri i Arsimit dhe Sportit urdhrat sa më poshtë:

-Urdhër nr.55, datë 09.12.2022 “Për inventarizimin e vlerave materiale”,

-Urdhër nr.56, datë 09.02.2022 “Për dajlen nga përdorimi të inventarit në Aparatit MAS”

-Urdhër nr.57, datë 09.02.2022 “Për vlerësimin e aktiveve të propozuara për dalje jashtë përdorimi të Aparatit të MAS”

Pas përfundimit të inventarizimit me shkresën nr.4970, datë 25.07.2022 “Relacion vlerësimi”, komisioni i vlerësimit të aktiveve të propozuara për dalje jashtë përdorimi të Aparatit të MAS paraqiti te Sekretari i Përgjithshëm në MAS “Relacionin e vlerësimit të Aktiveve të propozuara për nxjerrjen nga përdorimi në Aparatin e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit”.Me shkresën nr.8467, datë 30.12.2022”Relacion”, Komisioni i nxjertjes jashtë përdorimi i ngritur me Urdhër nr.512, datë 06.09.2022, të Ministrit të MAS “Për një ndryshim të urdhrat nr.56, datë 09.02.2022 “Për dajlen nga përdorimi të inventarit në Aparatit MAS”, u bë asgjësimi i materialeve që u miratuan për të dalë jashtë përdorimi.

(Bashkëlidhur gjeni kopje të urdhrave nr.55, 56, 57, datë 09.02.2022, nr.512, datë 06.09.2022, shkresën nr.4970, datë 25.07.2022, shkresën nr.8467, datë 30.12.2022) .

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** dhe **i zbatuar**

7.1. Rekomandim: Nga MAS në bashkëpunim me AKSHI-n të merren masat për kalimin e sistemeve dhe infrastrukturës ekzistuese nën administrimin dhe inventarin e AKSH-t, së

bashku me të drejtat dhe detyrimet juridiko-civile përkatëse sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Menjëherë

Përgjigja e Institucionit

Lidhur me gjetjen 7 dhe Rekomandimn 7.1 sqarojmë se, kjo detyrë është konsideruar dhe është bërë sistemimi i aktiveve referuar:

-Urdhër nr.55, datë 09.12.2022 “Për inventarizimin e vlerave materiale”,

-Urdhër nr.56, datë 09.02.2022 “Për dajlen nga përdorimi të inventarit në Aparatit MAS”

-Urdhër nr.57, datë 09.02.2022 “Për vlerësimin e aktiveve të propozuara për dalje jashtë përdorimi të Aparatit të MAS”

Pjesa e aktiveve funksionale, akoma të përdorshme (të pa amortizuara), të shprehura në vlerë, janë azhurnuar në kontabilitetin e Aparatit të MAS, duke sistemuar menjëherë në kontabilitet dhe gjendje fizike dhe kontabël të dhomës së “Serverave, pasqyruar në Pasqyrat Financiare të vitit 2022, paraqitur me shkresën nr.1802, datë 16.03.2023 “Dërgohen pasqyrat financiare vjetore 2022”, (Bashkëlidhur do të gjeni kopje të shkresave: nr.1802, datë 16.03.2023).

Nga Agjencia Kombëtare e Informacionit në baze të kërkesës së bërë nga MAS ka kthyer përgjigje me shkresën nr. 125 prot datë 09.01.2023 e cila shpreh gadishmërinë për finalizimin e procesit të kalimit të kapitaleve për cdo sistem dhe infrastrukturë TIK.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** dhe në **proces zbatimi**

8.1. Rekomandim: Nga Nëpunësi Autorizues i MAS, të merren masa për ngritjen e një grupi pune për vlerësimin e aktiveve të cilat janë konstatuar si jashtë përdorimit nga grupi i inventarizimit dhe më vonë të vijohet me ngritjen e një grupi pune për asgjësimin e tyre sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Brenda datës 31.04.2022

Përgjigja e Institucionit

Lidhur me gjetjen 8 dhe Rekomandimn 8.1, sqarojmë se, kjo detyrë do të ndiqet më përparësi pasi të kryhet vlerësimi i aktiveve të Aparatit të MAS nga Grupi i Punës ngritur me Urdhër nr.55, datë 09.12.2022 “Për inventarizimin e vlerave materiale”. Pjesa e aktiveve jo funksionale do të vlerësohen nga Grupi i Punës i ngritur me Urdhër nr.56, datë 09.02.2022 “Për daljen nga përdorimi të inventarit në Aparatit të MAS”, dhe pas hartimit të raportit të gjithë materialet do të vlerësohen nga Grupi i Punës i ngritur me Urdhër nr.57, datë 09.02.2022 “Për vlerësimin e aktiveve të propozuara për dalje jashtë përdorimi të Aparatit të MAS”. Me shkresën nr.8467, datë 30.12.2022 “Relacion”, Komisioni i nxjerrjes jashtë përdorimi i ngritur me Urdhër nr.512, datë 06.09.2022, të Ministrit të MAS “Për një ndryshim të urdhrit nr.56, datë 09.02.2022 “Për dajlen nga përdorimi të inventarit në Aparatit MAS”, u bë asgjësimi i materialeve që u miratuan për të dalë jashtë përdorimi.

(Bashkëlidhur gjeni kopje të urdhrave nr.55, 56, 57, datë 09.02.2022, nr.512, datë 06.09.2022, shkresën nr.4970, datë 25.07.2022, shkresën nr.8467, datë 30.12.2022) .

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** dhe **e zbatuar**

Rekomandim 9.1: MAS të marrë masa të menjëhershme për të analizuar dhe reflektuar me hollësi në Rregulloren e Brendshme, gjithë ndryshimet që do të ndërronin në strukturën e re që është ende draft si dhe të detajojë përshkrimet e punës, në funksion të të kuptuarit nga punonjësit e institucionit marrëdhëniet ndërmjet strukturave administrative të veçanta, vendin që ato zënë në njësi, të njohurit me të drejtat dhe detyrimet, të cilat i korrespondojnë

pozicioneve të tyre si dhe të rifreskojë bazën ligjore mbi të cilën mbështeten nene të veçanta brenda rregullores.

Menjëherë

Përgjigjja e Institucionit

Lidhur me gjetjen 9 dhe Rekomandimn 9.1, sqarojmë se, me Urdhrin Nr. 238, datë 05.05.2022 "Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e rregullores së brendshme të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit", në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit u ngrit grupi i punës për hartimin e rregullores së brendshme të MAS, ku u përcaktuan rregullat dhe detyrat e organizimit dhe funksionimit të brendshëm të institucionit. Me Urdhrin Nr. 689, datë 15.11.2022 "Për miratimin e rregullores së brendshme të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit", u miratua rregullorja e brendshme e institucionit (Bashkëlidhur dokumentacioni provues).

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**

9.2. Rekomandim: Njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore në ministri të hartojë planin e konsoliduar të nevojave për rekrutim për të gjithë sistemin përkatës që përfshin aparatit e tij dhe institucionet e varësisë", brenda afatit të përcaktuar pra brenda muajit nëntor sipas VKM nr. 108, datë 26.2.2014 "Për Planin Vjetor të Pranimit në Shërbimin Civil".

Menjëherë

Përgjigjja e Institucionit

Lidhur me gjetjen e cituar më lart dhe propozimin e Rekomandim 9.2, sqarojmë se; Sektori i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore të Aparatit të Ministrisë, në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore në MAS, me shkresën nr. 2032 prot., 29.03.2022 me lëndë "Dërgohet plani i konsoliduar i nevojave për rekrutim për vitin 2022", i ka dërguar Departamentit të Administratës Publike planin e konsoliduar të nevojave për rekrutim, i cili është hartuar pas ristrukturimit të institucionit. Në vijim, me shkresën nr. 7766 Prot, datë 24.11.2022 me lëndë "Dërgohet plani i konsoliduar i nevojave për rekrutim", MAS brenda afateve të përcaktuara në VKM nr.108, datë 26.2.2014 "Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil", dërgon në Departamentin e Administratës Publike planin e konsoliduar të nevojave për rekrutim për vitin 2023.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**

10.1. Rekomandim: Nga Personi Përgjegjës për Prokurimet në MAS, të merren masa për përditësimin e Regjistrit të Realizimit të Prokurimeve Publike të Institucionit të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

Në vijimësi

Përgjigjja e Institucionit

Lidhur me gjetjen 10 dhe propozimin e Rekomandim 10.1, sqarojmë se Rekomandim është marrë në konsideratë menjëherë dhe bazuar në ligjin nr.162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", në vijimësi Personi Përgjegjës për Prokurimet në MAS, ka përditësuar Regjistrin e Realizimit të Prokurimeve Publike të Institucionit të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, duke përjashtuar blerjet e vogla të regjistrit të prokurimit të cilat janë realizuar me blerje nën 100 mijë lekë, të cilat ishin ezauruar menjëherë në kohën e lënies së rekomandimeve.(Bashkëlidhur dhe fotokopjet e regjistrave)

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**

11.1. Rekomandim: Sekretari i Përgjithshëm i MAS, në cilësinë e nëpunësit autorizues, të marrë masa për ngritjen e një grupi pune i cili të kryejë procesin e vlerësimit për artikujt që janë gjendje në magazinën e MAS, me qëllim evidentimin e atyre artikujve që janë të përdorshëm, ndërsa për ato artikuj që nuk gjejnë përdorim të veprohet në përputhje me dispozitat ligjore përkatëse.

Brenda datës 31.04.2022

Përgjigjja e Institucionit

Lidhur me gjetjen e cituar më lart dhe propozimin e Rekomandimt 11.1, sqarojmë se, ne zbatim të Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011, të Ministrisë së Financave, Grupet e Punës ngritur me Urdhër nr.56, datë 09.02.2022, të Ministrit të Arsimit dhe Sportit “Për daljen nga përdorimi të inventarit në Aparatit MAS”, dhe Urdhër nr.57, datë 09.02.2022, të Ministrit të Arsimit dhe Sportit “Për vlerësimin e aktiveve të propozuara për dalje jashtë përdorimi të Aparatit të MAS”, do të kryejnë procesin e vlerësimit dhe për artikujt që janë gjendje në magazinën e MAS, me qëllim evidentimin e atyre artikujve që janë të përdorshëm, ndërsa për ato artikuj që nuk gjejnë përdorim do të veprohet në përputhje me dispozitat ligjore përkatëse.

Ky rekomandim është konsideruar menjëherë nga ana jonë dhe do të vijojë të ndiqet me prioritet brenda afateve të përcaktuara. (Bashkëlidhur fotokopje e materialeve)

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

12.1. Rekomandim: Nga Sektori i Prokurimeve në MAS, të merren masa për përditësimin e Regjistrit të Realizimit të Prokurimeve Publike të Institucionit të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

Në vijimësi

Përgjigjja e Institucionit

Lidhur me gjetjen e cituar më lart dhe propozimin e Rekomandimt 12.1, sqarojmë se, Rekomandim është marrë në konsideratë menjëherë dhe bazuar në ligjin nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në vijimësi, Personi Përgjegjës për Prokurimet në MAS, ka përditësuar Regjistrin e Realizimit të Prokurimeve Publike të Institucionit të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, duke përjashtuar blerjet e vogla të regjistrit të prokurimit të cilat janë realizuar me blerje nën 100 mijë lekë, të cilat ishin ezauruar në kohën e lënies së rekomandimeve. (Bashkëlidhur fotokopjet e regjistrave)

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**

13.1. Rekomandim: Nga Ministri i Arsimit dhe Sportit, të merren masa për njoftimin e Agjencisë së Prokurimit Publik për operatorët ekonomikë të shpallur fitues që janë tërhequr nga nënshkrimi i kontratës.

Brenda datës 31.03.2022

Përgjigjja e Institucionit

Lidhur me gjetjen e cituar më lart dhe propozimin e Rekomandimt 13.1, sqarojmë se, Sektori i

Prokurimeve ka respektuar ligjin 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, vendimin nr. 285, datë 19.05.2021, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në lidhje me të gjitha procedurat që MAS ka realizuar. Në të gjitha rastet e prokurimeve me vlerë mbi kufirin e blerjeve të vogla nuk është evidentuar asnjë rast i cili është tërhequr pasi është shpallur fitues. Ndërsa në vijim të komunikimeve me Agjencinë e Prokurimit Publik për procedurat me vlerë të vogël nuk është e nevojshme njoftimi i APP. (Bashkëlidhur komunikimi elektronik me APP, email datë 21 Shkurt 2022)

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**

14.1. Rekomandim: Titullari i institucionit në cilësinë e NA të marrë të gjitha masat e duhura për të shmangur në të ardhmen përfshirjen e Nëpunësit Zbatues në procese të punës të cilat mund ta vendosin atë në konflikt interesi, kjo në përfitim të qëndrueshmërisë së sistemeve të kontrollit të brendshëm që duhet të funksionojë në një institucion.

Në vijimësi

Përgjigjja e Institucionit

Lidhur me gjetjen 14 dhe Rekomandimn 14.1, referuar nenit 56, të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se “Titullari i autoritetit kontraktor/nëpunësi Autorizues nuk lejohet të jetë pjesë e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave (KVO). Për më tepër, në nenin 58 të këtij ligji përcaktohet se Kryetari i KVO duhet të përzgjidhet dhe të jetë punonjës i nivelit të lartë të njësisë publike.

Pra, ligji për prokurimin publik, në mënyrë eksplicite i ka ndaluar nëpunësit autorizues prezencën e tij në KVO, dhe në asnjë dispozitë të këtij ligji, nuk ndalohet nëpunësi zbatues, dhe për më tepër, neni 58 i këtij ligji, e bën detyruese prezencën edhe të nëpunësit zbatues si kryetar në KVO, pasi përcaktohet se kryetari i Kvo-së duhet të jetë punonjës i nivelit të lartë të njësisë publike. Referuar ligjit nr.10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, në mënyrë eksplicite përcaktohet se nëpunësi zbatues është punonjës i nivelit të lartë drejtues, dhe referuar këtij përcaktimi, ky ligj, jo vetëm nuk e ndalon prezencën e nëpunësit zbatues si kryetar i KVO-së, por për më tepër e bën detyruese prezencën e tij.

Sqarojmë se Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, është një komision ad-hoc, i cili ngrihet me urdhër të Titullarit/nëpunësit autorizues dhe ka për detyrë vetëm vlerësimin e dokumentacionit të paraqitur nga OE, në përputhje me dokumentet standarde të procedurës së prokurimit dhe nuk ka në asnjë rast konflikt me përgjegjësitë ligjore dhe veprimtarinë e nëpunësit zbatues, sipas përcaktimeve të dhëna në nenin 22 të ligjit 10296 datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar.

Për nëpunësin zbatues është zbatuar Rekomandim i mësipërm.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** dhe **proces zbatimi**

15.1. Rekomandim: Njësia e prokurimit në MAS të marrin të gjitha masat e duhura, me qëllim argumentimin e nevojave për prokurim në përputhje me kërkesat e bazës ligjore në fuqi, me qëllim shmangien dhe mos përsëritjen në të ardhmen e mangësive të sipërcituara.

Në vijimësi

Përgjigjja e Institucionit

Lidhur me gjetjen 15 dhe Rekomandimn 15.1, sqarojmë se, nevojat për prokurim janë identifikuar në fillim të vitit në momentin e krijimit të regjistrit të parashikimeve të

prokurimeve publike, ku dhe në koordinim me Drejtorinë e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar janë planifikuar zërat për vitin buxhetor në përputhje me fondet në dispozicion. Hartimi dhe më pas miratimi i këtyre zërave ka qenë baza e zhvillimit të procedurave. Njësitë e prokurimeve janë ngritur për procedurat respektive në përputhje me regjistrin e parashikimeve dhe janë koordinuar veprimet për ngritjen rast pas rasti të grupeve për miratimin e specifikimeve teknike dhe fondit limit, pas vlerësimit të nevojave objektive dhe duke respektuar plotësisht ligjin nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe vendimit nr.285, datë 19.05.2021, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, i ndryshuar, neni 78, pika 2.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**

16.1. Rekomandim: Titullari i AK të marrë masa në të ardhmen që të mos pranojë Raportin Përmbledhës nga anëtarët e KVO, nëse nuk është i protokolluar më parë, si dhe në çdo rast të sigurohet ky dokument të përmbajë të gjithë elementët e duhur ligjorë.

Në vijimësi

Përgjigja e Institucionit

Lidhur me gjetjen e cituar më lart dhe propozimin e Rekomandimit 16.1, sqarojmë se, shprehim dakortësinë tonë për përmbushjen në vijimësi me korrektësi nga ana e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, duke marrë masat që raporti përmbledhës i procedurës së prokurimit të jetë i protokolluar dhe të përmbajë të gjitha elementët e duhur ligjor. Ky rekomandim është konsideruar menjëherë nga MAS dhe do të vijojë të ndiqet me prioritet në vijimësi.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**

17.1. Rekomandim: Titullari i AK të marrë masa që t'i kushtojë vëmendjen e duhur institucionale procesit të hartimit të kërkesave për kualifikim nga grupet e punës/njësia e prokurimit dhe procesit të shqyrtimit e vlerësimit të dokumentacionit ligjor dhe administrativ të operatorëve ekonomik dhe ofertave të ofertuesve nga komisionet e vlerësimit të ofertave, pasi në disa raste hartimi i kërkesave për kualifikim dhe vlerësimi i ofertave konstatohet jo korrekt, kjo për rritjen e efikasitetit në shpenzimet publike, duke zhvilluar procedura prokurimi në përmbushje të kriterëve ligjorë, kapaciteteve ekonomike, financiare dhe profesionale në përzgjedhjen e ofertës më të mirë ekonomike, duke siguruar që Autoriteti Kontraktor të pranojë oferta të cilat janë të përballueshme, të qëndrueshme, të pakushtëzuara dhe të plotësisht të nevojave të saj.

Në vijimësi

Përgjigja e Institucionit

Lidhur me gjetjen 17 dhe Rekomandimn 17.1, sqarojmë se, MAS si autoritet kontraktor ka respektuar dhe do të vijojë të respektojë çdo rekomandim të dhënë nga grupet e auditimit për rritjen e efikasitetit në shpenzimet publike, duke zhvilluar procedura prokurimi në mbështetje të kriterëve ligjorë, kapaciteteve ekonomike, financiare dhe profesionale në përzgjedhjen e ofertës më të mirë ekonomike. MAS do të angazhohet plotësisht në koordinime të veprimeve me APP për të mundësuar aftësimin profesional të stafit për të njohur e respektuar plotësisht Ligjin e ri të prokurimeve publike, Ligjin 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe VKM 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, i ndryshuar.

Gjithashtu MAS është angazhuar në marrjen e masave për të respektuar plotësisht zbatimin e akteve ligjore në ngritjen e grupeve të punës me anëtarë me integritet të plotë dhe njohës të mirë të akteve ligjore për përcaktimin objektiv të kërkesave për kualifikim dhe vlerësimin me korrektësi të ofertave ekonomike.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**

18.1. Rekomandim: MAS, Njësia e Prokurimit të rishikojë mënyrën e hartimit të kriterëve duke u bazuar në të dhëna të matshme dhe realiste mbi tregun e operatorëve, sa i përket numrit të punonjësve të tyre, kualifikimeve në staf, për të rritur konkurrencën në treg dhe përmbushur frymën e ligjit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e Institucionit

Lidhur me gjetjen e cituar më lart dhe propozimin e Rekomandimit 18.1, sqarojmë se MAS si autoritet kontraktor po zbaton politikat rekomanduese të grupeve të auditimit për krijimin e njësive të prokurimit eficiente në përcaktimin e kriterëve objektive të bazuara në të dhëna të matshme dhe realiste, me qëllim rritjen e konkurrencës në treg duke respektuar plotësisht ligjin 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, i ndryshuar, neni 78.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**

19.1. Rekomandim: MAS, Njësia e Prokurimit, të hartojë kriteret e veçanta kualifikuese në përputhje me vlerën dhe madhësinë e kontratës që do prokurohet, me qëllim nxitjen e konkurrencës, trajtimin e barabartë të operatorëve ekonomikë, për zbatimin korrekt të parimit mbi ekonomikitetin, eficiencën dhe efektivitetin në përdorimin e fondeve buxhetore.

Në vijimësi

Përgjigjja e Institucionit

Lidhur me gjetjen e cituar më lart dhe propozimin e Rekomandimit, sqarojmë se, në vijimësi të këtij Rekomandim Ministria e Arsimit dhe Sportit në vijimësi është angazhuar në ngritjen e grupeve eficiente për hartimin e kriterëve të veçanta kualifikuese në përputhje me vlerën dhe madhësinë e kontratës që do prokurohet, me qëllim nxitjen e konkurrencës, trajtimin e barabartë të operatorëve ekonomikë, për zbatimin korrekt të parimit mbi ekonomikitetin, eficiencën dhe efektivitetin në përdorimin e fondeve buxhetore.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**

20.1. Rekomandim: Ministria e Arsimit dhe Sportit të marrë masa për miratimin e një dokumenti/ udhëzimi, i cili detajon dhe standardizon konvertimin e vlerësimeve të Universiteteve në shtete të ndryshme, të cilat nuk përdorin të njëjtin sistem me vendin tonë.

Brenda Qershorit 2022

Përgjigjja e Institucionit

Lidhur me gjetjen e cituar më lart dhe propozimin e Rekomandimit, sqarojmë se nga grupi i punës i ngritur për ndryshimet e Udhëzimit "Për kriteret dhe procedurat për njohjen dhe njësimin në Republikën e Shqipërisë, të diplomave, certifikatave, gradave shkencore dhe titujve akademikë, të lëshuara nga institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuara", nuk është dakortësuar për ta bërë pjesë të udhëzimit konvertimin e vlerësimeve të universiteteve në shtete të ndryshme, të cilat nuk përdorin të njëjtin sistem me vendin tonë. Për të bërë një udhëzim më vete nuk ka reference ligjore që e vendos si detyrim. Aktualisht ky proces kryhet nga QSHA në bazë të tabelave të publikuara në faqet zyrtare të rrjetit ENIC/NARIC.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** dhe **i pazbatuar**

21.1. Rekomandim: Drejtoria e Derregullimit , Lejeve, Licencave dhe Monitorimit në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit të marrë masa që në shqyrtimin e aplikimeve të subjekteve për licencim të kërkojë përcaktimin e tarifave përkatëse dhe modaliteteve të pagesave në rregulloret e funksionimit të tyre.

Në vijimësi

Përgjigjja e Institucionit

Lidhur me gjetjen e cituar më lart dhe Rekomandimin, sqarojmë se nga Drejtoria e Derregullimit ,Lejeve, Licencave dhe Monitorimit në Ministrinë e Arsimit është ngritur vetëm grupi i punës për hartimin e dy projekt-akteve

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** dhe **i pazbatuar**

22.1. Rekomandim: Nga Ministri i Arsimit dhe Sportit, të merren masa për tërheqjen e mobilieve të shkollës 9-vjeçare "Niko Hoxha" në vlerën 4,767,500 lekë nga OE Erald SHPK, për të cilat ZVAP Kamëz sipas Akt verifikimit të pranimit dhe Akt Marrjes në dorëzim të datës 15.12.2020, është shprehur se janë marrë në dorëzim dhe instaluar por me anë të Akt-Marrëveshjes për Magazinim Malli nr 1130 prot., datë 15.12.2020, rezulton se këto mallra nuk kanë dalë nga fabrika e OE E. SHPK.

Menjëherë

Përgjigjja e Institucionit

Lidhur me gjetjen 22 dhe Rekomandimin 22.1, sqarojmë se Titullari i Autoritetit Kontraktor në MAS me shkresën Nr.2248/2, datë 21.04.2022 "Për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së", i është drejtuar ZVA Kamëz për tërheqjen e pajisjeve të mobilierisë të shkollës 9-vjeçare "Niko Hoxhi" objekt të kontratës së furnizimit nr. 4074/3, datë 4.09.2020 "Blerje pajisje mobilierie në kuadër të rindërtimit të shkollave të dëmtuara nga tërmeti.

ZVA Kamëz me shkresën nr.901, datë 03.06.2022 informon MAS se Bashkia Kamëz në përgjigje të shkresës nr.604, datë 28.04.2022 të ZVA Kamëz, ka bërë tërheqjen e pajisjeve të mobilierisë nga ambjentet e kontraktuesit dhe sistemimin e tyre në ambjentet e shkollës "Niko Hoxha", Valias, Kamëz.

(Bashkëlidhur do të gjeni kopje të shkresës Nr.2248/2, datë 21.04.2022, nr.901, datë 03.06.2022, nr.604, datë 28.04.2022).

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** dhe **i zbatuar**

23.1. Rekomandim: Nga Ministri i Arsimit dhe Sportit, të merren masa për ngritjen e një grupi pune për verifikimin e mobilieve të furnizuara sipas kontratës së furnizimit nr.4074/3 prot, datë 4.09.2020 "Blerje pajisje mobilierie në kuadër të rindërtimit të shkollave të dëmtuara nga tërmeti", grup i cili duhet të kryejë verifikimin fizik të zërit "Dërrasa të zeza", për të cilin nga auditimi u konstatua se malli i ofruar nuk ishte në përputhje me specifikimet teknike sipas kontratës, por që pas konstatimit të grupit të auditimit , nga ZVAP Shijak konfirmohet se kontraktori ka sjellë mallrat e duhura sipas specifikimeve teknike të kërkuara.

Menjëherë

Përgjigjja e Institucionit

Lidhur me gjetjen 24 dhe Rekomandimn 24.1, sqarojmë se Titullari i Autoritetit Kontraktor në MAS me shkresën Nr.2248/2, datë 21.04.2022 "Për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së", i është drejtuar DRAP Durrës dhe DRAP Lezhë për ngritjen e grupeve të punës për verifikimin e mobilieve të furnizuara sipas kontratës së furnizimit nr. 4074/3, datë 4.09.2020 "Blerje pajisje mobilierie në kuadër të rindërtimit të shkollave të dëmtuara nga tërmeti", grup i cili duhet të kryejë verifikimin fizik të zërit "Dërrasa të zeza", për të cilin nga auditimi u konstatua se malli i ofruar nuk ishte në përputhje me specifikimet teknike.

Me shkresën nr.330/3, datë 26.05.2022, DRAP Durres informon MAS se grupet e punës të ngritur me urdhër nr.43, datë 27.04.2022 "Për ngritjen e grupit të punës për fizik të artikujve të mobilierisë objekt të kontratës së furnizimit nr. 4074/3, datë 4.09.2020 "Blerje pajisje mobilierie në kuadër të rindërtimit të shkollave të dëmtuara nga tërmeti" të lidhur ndërmjet MAS dhe kontraktuesit "E." sh.p.k, në Raportin e Monitorimit datë 30.04.2022, kanë konstatuar se pajisjet e mobilierisë objekt i kontratës nr. 4074/3, datë 4.09.2020, me Proces Verbal datë 28.04.2022 është bërë vlerësimi për shkollat për shkollat e ZVA Shijak dhe ZVA Durrës.

Me shkresën nr.779, datë 29.05.2022, DRAP Lezhë informon MAS se grupet e punës të ngritur me urdhër nr.102, datë 26.04.2022 "Për ngritjen e grupit të punës për fizik të artikujve të mobilierisë objekt të kontratës së furnizimit nr. 4074/3, datë 4.09.2020 "Blerje pajisje mobilierie në kuadër të rindërtimit të shkollave të dëmtuara nga tërmeti" të lidhur ndërmjet MAS dhe kontraktuesit "E." sh.p.k, në Raportin Përmbledhës datë 28-29/04/2022, është bërë vlerësimi për shkollat e ZVA Lezhë dhe ZVA Kurbin.

(Bashkëlidhur do të gjeni kopje të shkresës Nr.2248/1, datë 21.04.2022, shkresës nr.330/3, datë 26.05.2022, urdhër nr.43, datë 27.04.2022, Raportin e Monitorimit datë 30.04.2022, Proces Verbal datë 28.04.2022; nr.779, datë 29.05.2022, urdhër nr.102, datë 26.04.2022, Raporti Përmbledhës datë 28-29/04/2022)

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** dhe **i zbatuar**

24.1. Rekomandim: Nga Ministri i Arsimit dhe Sportit, të merren masa për tërheqjen e pajisjeve laboratorike të shkollës 9-vjeçare "Niko Hoxha" në vlerën 3,829,704 lekë nga BOE "A. M.", SHPK e "D.", për të cilat ZVAP Kamëz sipas Akt verifikimit të pranimit dhe Akt Marrjes në dorëzim të datës 15.12.2020, është shprehur se janë marrë në dorëzim por realisht ato nuk janë as në ambientet e shkollës dhe as në ambientet e ZVA Kamëz.

Menjëherë

Përgjigjja e Institucionit

Lidhur me gjetjen 24 dhe Rekomandimn 24.1, sqarojmë se Titullari i Autoritetit Kontraktor në MAS me shkresën Nr.2248/1, datë 21.04.2022 "Për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së",

i është drejtuar ZVA Kamëz për ngritjen e grupit të punës për tërheqjen e pajisjeve laboratorike të shkollës 9-vjeçare "Niko Hoxha", ZVA Kamëz", sipas kontratës së furnizimit nr. 4036/3, datë 14.09.2020, të lidhur ndërmjet MASR dhe BOE "A. M.", Shpk & "D.", me objekt "Blerje pajisje didaktike dhe laboratorike në kuadër të rindërtimit të shkollave të dëmtuara nga tërmeti".

Me shkresën nr.793, datë 19.05.2022, ZVA Kamëz na informon se grupi i punës i ngritur me urdhër nr.24, datë 28.04.2022 "Për ngritjen e grupit të punës për verifikimin e laboratorëve dhe pajisjeve laboratorike të shkollës 9-vjeçare "Niko Hoxha", ZVA Kamëz, ardhur nga MAS Tiranë", në Proces verbalin datë 11.05.2022, ka konstatuar se pajisjet laboratorike janë inventarizuar në shkollën "Ahmet Zogu", janë në përdorim dhe funksion të procesit mësimorreferuar dhe korespondencës me Bashkinë Kamëz. (shkresa nr.607 datë 28.04.2022 ZVA Kamëz, Bashkia Kamëz shkresën nr.4000, datë 9.05.2022).ne shkresën me nr 1000 datë 09.05.2022 Bashkia Kamëz njofton ZVA Kamëz se Shkolla @Niko Hoxha' është në rikonstrukcion dhe në këto kushte laboratopri i fizës me vlerë 2.264.670 lekë dhe laboratori i kimisë me vlerë 1.565.034 lekë ka kaluar në inventarin e shkollës @Ahmet Zogu' dhe keto pajisje janë në përdorim dhe funksion të mesimdhënies.

Bashkëlidhur do të gjeni kopje të shkresës Nr.2248/1, datë 21.04.2022, shkresës nr.793, datë 19.05.2022, urdhër nr.24, datë 28.04.2022, shkresa nr.607 datë 28.04.2022, shkresa nr.4000, datë 09.05.2022)

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe i zbatuar**

MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1.1. Rekomandim: Nga MAS, të merren masa dhe të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës prej 2,199,947 lekë, e cila përbën dëm ekonomik për Buxhetin e Shtetit, si vlerë e përfituar padrejhtësisht nga dëmshpërblimet e marra nga gjyq fituesit. Kjo vlen edhe për dëmshpërblimet e pa marra ende për gjyq fituesit për periudhën shtator 2020 - dhjetor 2021.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigja e Institucionit

Lidhur me gjetjen e cituar më lart dhe propozimin e Rekomandimt 1.1, sqarojmë se, nga Aparati i MAS, menjëherë janë përllorgaritur detyrimet për tatimin mbi të ardhurat personale në masën 15%, për pagesat e realizuara si dëmshpërblim për të gjithë gjyq fituesit, për periudhën shtator 2020- dhjetor 2021, dhe me përparësi janë ndjekur procedurat ligjore për arkëtimin e këtyre detyrimeve.

Ju informojmë se menjëherë dhe në vijimësi, në pagesat e realizuara për vendimet gjyqësore në vazhdim, të Aparatit të MAS, janë likuiduar:

- me urdhër shpenzimi nr.36 datë 08.02.2022 me përfitues M. P., në shumën 1.335.372 lekë, është njoftuar Shoqëria Përmbartimore "Gramoz Guri" me shkresën nr.990, datë 14.02.2022 "Njoftim për zbatim ligji";

- me urdhër shpenzimi nr. 37 datë 08.02.2022 me përfitues S. M., në shumën 801.847 lekë, është njoftuar Shoqëria Përmbartimore "E. G.", me shkresën nr.990, datë 14.02.2022 "Njoftim për zbatim ligji";

- me urdhër shpenzimi nr. 38 datë 08.02.2022 me përfitues A. Zh., në shumë 1.343.563 lekë, është njoftuar Shoqëria Përmbartimore "S." sh.p.k, me shkresën nr.990, datë 14.02.2022 "Njoftim për zbatim ligji";

- me urdhër shpenzimi nr.39 datë 08.02.2022 me përfitues Shpresa Noka, në shumën 915.840 lekë, është njoftuar znj. Sh. N., me shkresën nr.990, datë 14.02.2022 “Njoftim për zbatim ligji”. Për të gjithë pagesat e realizuara më sipër është bërë ndalesa e tatimit mbi të ardhurat personale në masën 15%. (Bashkëlidhur do të gjeni kopje të urdhër shpenzimeve 36,37, 38, 39, datë 08.02.2022)

Sqarojmë se vlera e nxjerrë nga KLSH-ja e cila është në shumën 2,199,947 lekë nga ana jonë është proceduar duke u mbajtur tatimi për gjyqfituesit e likuiduar në vlerën 1,005,978 lekë, pjesa tjetër nuk kanë marrë pagesë dhe automatikisht nuk është mbajtur tatimi.

Ky rekomandim është konsideruar dhe zbatuar menjëherë nga MAS dhe do të vijojë të ndiqet me prioritet në vijimësi.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** dhe në **proces zbatimi**.

1.2. Rekomandim: Nga Drejtoria e Planifikimit të Buxhetit dhe Financës në MAS të merren masa dhe të kërkohen në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative në të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerave të përfituara padrejtësisht nga z. A. A. prej 154,738 lekë si dhe z. Z. E. vlerën 311,599 lekë e cila përbën dëm ekonomik për Buxhetin e Shtetit.

Brenda datës 31.04.2022

Përgjigja e Institucionit

Lidhur me gjetjen e cituar më lart dhe propozimin e Rekomandimit 1.2, sqarojmë se, menjëherë, Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar ka njoftuar për masat e dëmshpërblimeve të përfituara padrejtësisht dhe marrjen e masave për shlyerjen e tyre menjëherë, me shkresat:

- nr. 990/1, datë 14.02.2021, drejtuar dhe Zyrës Vendore Arsimore Tiranë; Me shkresat nr.1558, datë 19.05.2023, nr.6126, datë 05.12.2023, ZVA Tiranë ka njoftuar fillimin e ndalesës në pagë ndaj debitorit z. Z. E.
- nr.990/2, datë 14.02.202, drejtuar z. A. A. dhe Zyrës Vendore Arsimore Kamëz; Me shkresën nr.795, datë 19.05.2023, ZVA Kamëz ka njoftuar fillimin e ndalesës në pagë ndaj debitorit z. A. A.

(Bashkëlidhur do të gjeni kopje të shkresave: nr.990/2, datë 14.02.202, nr. 990/1, datë 14.02.2021, nr.1558, datë 19.05.2023, nr.795, datë 19.05.2023, nr.6126, datë 05.12.2023).

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** dhe **i zbatuar**.

Observacion dërguar me shkresën nr.4338/3 prot., datë 06.10.2023 protokolluar me tonën me nr.613/58 prot., datë 09.10.2023

Përgjigje e subjektit të audituar

“Masa për shpërblim dëmi” Lidhur me gjetjen e cituar më lart dhe Rekomandimn 1.2, sqarojmë se, menjëherë, Drejtoria e e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar ka njoftuar për masat e dëmshpërblimeve të përfituara padrejtësisht dhe marrjen e masave për shlyerjen e tyre menjëherë, me shkresat:

-nr. 990/1, datë 14.02.2021, drejtuar dhe Zyrës Vendore Arsimore Tiranë; Me shkresat nr.1558, datë 19.05.2023, nr.6126, datë 05.12.2023, ZVA Tiranë ka njoftuar fillimin e ndalesës në pagë ndaj debitorit z. Z. E. është likuiduar detyrimi në masën 346,599 lekë dhe diferenca prej 4,577 lekë është ndaluar në listë pagesën e muajit Korrik 2023.

-nr.990/2, datë 14.02.202, drejtuar z. A. A. dhe Zyrës Vendore Arsimore Kamëz; Me shkresën

nr.795, datë 19.05.2023, ZVA Kamëz ka njoftuar fillimin e ndalesës në pagë ndaj debitorit z. A. A. detyrimi është likuiduar në masën 128,000 lekë dhe diferenca prej 28,738 lekë është ndaluar në pagën e muajit Korrik 2023.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** janë kryer likuidimet dhe janë ndaluar diferenat në muajin Korrik 2023.

Rekomandim **I Zbatuar.**

Sa më sipër observacioni merret në konsideratë.

2.1. Rekomandim: Nga Ministri i Arsimit dhe i Sportit, të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës 329,414 lekë, si pasojë e përllogaritjes së gabuar të fondit limit në procedurën e prokurimit me objekt Loti II: "Blerje pajisje elektronike dhe elektro shtëpiake për konviktet e studentëve Shkodër, Vlorë dhe Korçë".

Menjëherë

Përgjigja e Institucionit

Titullari i MAS me Urdhër nr.242, datë 6.05.2022 "Për zhdëmtimin e vlerës së përfituar padrejtësisht nga subjekti "OE L. – O." sh.p.k", urdhëron arkëtimin e vlerës 329,414 lekë nga subjekti "OE L.-O." sh.p.k. Me shkresën nr.2248/13, datë 12.05.2022 "Për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së", është bërë me dije subjekti "OE L. – O." sh.p.k, për shlyerjen e detyrimit dhe kthimin e shumës 329,414 lekë, në llogari të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Kodi i Institucionit 1011001, Dega Thesarit Tiranë, Kodi i Llogarisë Ekonomike 7115600.

Në përgjigje sa më sipër Subjekti "OE L. – O.", sh.p.k, me shkresën datë 23.05.2022, protokolluar ne MAS nr.2248/21, datë 16.06.2022, bën me dije se nuk është dakord për zhdëmtimin e vlerës 329,414 lekë së përfituar padrejtësisht.

Për sa më sipër DBMF në MAS me Memo datë 28.06.2022 ka përcjellë për ndjekje në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, për të bërë të mundur arkëtimin e vlerës 329,414 lekë, nga Subjekti "OE L. – O.", sh.p.k, përcaktuar qartë dhe në rekomandimet e lëna nga KLSH.

Nga Drejtoria e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit është hartuar praktika për ndjekjen e këtij procesi gjyqësor, e provuar edhe sipas autorizimit bashkëlidhur, nr. 5073 prot., datë 29.07.2023

(Bashkëlidhur do të gjeni kopje të Urdhër nr.242, datë 6.05.2022, shkresës nr.2248/13, datë 12.05.2022, shkresës datë 23.05.2022, autorizim nr. 5073 prot., datë 29.07.2023).

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** dhe në proces zbatimi

MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN, MENAXHIMIN PA EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1.1. Rekomandim: Nga MAS të merren masa në bashkëpunim me DAP, për rikthimin e menjëhershëm në punë të të gjithë punonjësve që kanë përfituar këtë të drejtë si dhe të ndërpritet procesi i largimeve nga puna në mënyrë të padrejtë dhe të njëanshme në arsim si një nga sektorët shtetërorë më të rëndësishëm të punësimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigja e Institucionit

Lidhur me gjetjen e cituar më lart dhe propozimin e Rekomandim 1.1, sqarojmë se, Drejtoria e Burimeve Njerëzore në MAS në bashkëpunim me DAP, ka bërë sistemimin e 6 (gjashtë) gjyqfituesve. Me Urdhrin nr. 148, datë 24.03.2022, të Sekretarit të Përgjithshëm “Për ngritjen e Komisionit të Posaçëm për zbatimin e vendimeve të formës së prerë në MAS”, të ndryshuar, është përcaktuar përbërja e Komisionit të Posaçëm, organ kolegjal i cili shqyrton faktet dhe rrethanat pas marrjes së vendimeve gjyqësore të formës së prerë për nëpunësit gjyqfitues. Në bashkëpunim me Departamentin e Administratës Publike, janë sistemuar në shërbimin civil gjyqfituesit si më poshtë:

- Z. S. M., me shkresën nr. 6319/3 Prot., datë 07.12.2022, emërohet në pozicionin Specialist.
- Z. Z.E., me shkresën nr. 6443/3, datë 07.12.2022, emërohet në pozicionin Specialist.
- Z. A. Zh., me shkresën nr. 6317/11 Prot., datë 26.01.2023, emërohet në pozicionin Specialist.
- Znj. E. K., me shkresën nr. 7536/2 Prot., datë 12.12.2022, MAS i ka kërkuar DAP ndërprerjen e procedurave të emërimit të znj. Kokomani, pasi Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin Nr. 00- 2022 -2367 (345), ka vendosur “Prishjen e vendimit nr. 1712, datë 07.07.2015 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 1436 (80-2015-384), datë 19.03.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë”, ku është vendosur rrëzimi i padisë së ngritur nga paditësja Ederina Husi (Kokomani) si e pabazuar në prova dhe në ligj.
- Znj. M. P., me shkresën nr.6320 prot., datë 07.12.2022 emërohet në pozicionin përgjegjës sektori. Me vendimin Nr. 5, datë 31.03.2023, të Komisionit të Disiplinës në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, largohet nga shërbimi civil, për shkak të refuzimit të vendit të punës.
- Znj. Sh. N., ka plotësuar moshën për përfitimin e pensionit të plotë të pleqërisë.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim 1.1 konsiderohet **i pranuar** dhe **i zbatuar**

1.2. Rekomandim: Titullari i MAS të shqyrtojë vlerën 61,330 mijë lekë. Kjo vlerë ka të bëjë me parregullsitë e konstatuara në ekzekutimin e vendimeve gjyqësore (aparati), për rikthimin në punë të të punonjësve që e kanë fituar këtë të drejtë. Te evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimet përkatëse, vlerë e cila për MASH dhe Buxhetin e Shtetit përbën efekt financiar negativ.

Në vijimësi

Përgjigje e institucionit audituar

Nga ana e Institucionit janë kryer pagesat e personave të larguar nga MAS dhe me vendime të formës së prerë të Gjykatave janë kryer këto pagesa deri në momentin e rikthimit të tyre në punë. Kjo është masa që ka mare Institucioni. Likuidimet e vendimeve Gjyqësore të Gjykatave të Apelit janë të padiskutueshme. Personat janë rikthyer të gjithë në punë.

Komenti i grupit të auditimit

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti i **zbatuar**

2.1. Rekomandim: Nga MAS dhe të gjithë institucionet e varësisë së saj (D. Arsimore, ZA, Institucione të Arsimit Parauniversitar dhe IAL) të merren masa në bashkëpunim me DAP, për rikthimin e menjëhershëm në punë të të gjithë punonjësve që kanë fituar këtë të drejtë si dhe të ndërpritet procesi i largimeve nga puna në mënyrë të padrejtë dhe të njëanshme në arsim.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigja e Institucionit

Lidhur me gjetjen e cituar më lart dhe propozimin e Rekomandim 2.1, sqarojmë se, në vijimësi

me përfundimin e procesit të ristrukturimit të MAS, ndër të tjera do të kërkohet nga sektori i burimeve njerëzore të sistemit ministror, marrja e masave për mirë menaxhimin e burimeve njerëzore të Aparatit të MAS dhe në vijimësi të merren masat për rikthimin e menjëhershëm në punë të të gjithë punonjësve që kanë përfituar këtë të drejtë sipas vendimeve gjyqësore si dhe ndërprerjen e procesit të largimeve nga puna në mënyrë të padrejtë dhe të njëanshme nga Drejtoria Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar në MAS janë njoftuar me shkresat:

- nr. 4880/64, datë 18.10.2021 “Kthim përgjigje”, nr.69/72, datë 9.2.2022, “Tërheqje vëmendje mbi mosraportimin periodik të detyrimeve të prapambetura”; drejtuar ZVA Mirditë; DRAP Lezhë,

- nr. 4880/62, datë 18.10.2021 “Mbi krijimin e detyrimeve të prapambetura”, nr.69/73, datë 9.2.2022, “Tërheqje vëmendje mbi mosraportimin periodik të detyrimeve të prapambetura”, drejtuar ZVA Dibër, DRAP Durrës

- nr.4880/23, datë 18.10.2021 “Mbi krijimin e detyrimeve të prapambetura”, drejtuar ZVA Skrapar; DRAP Korçë,

Për sa më sipër MAS NË zbatim të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, udhëzimit të Këshillit të Ministrave nr.1, datë 04.06.2014 “Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të institucioneve të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit”, i ndryshuar, ligjit nr.48, datë 24.04.2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”, vendimit nr.50, datë 5.2.2014, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit”, i ndryshuar, udhëzimit nr.5, datë 27.02.2014 të Ministrit të Financave “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, si dhe të vendimit nr.99, datë 27.2.2019, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të drejtorisë së përgjithshme të arsimit parauniversitar”, u kërkon konform të drejtave dhe detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë, për çdo rast do të paraqesin pranë DRAP kërkesën për miratimin e likuidimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë të shoqëruar me:

Kopje te vendimit gjyqësor të formës së prerë.

Akti i titullarit të ZVA që provon: përfituesin, masën në lekë të detyrimit, gjurmën e auditimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë dhe nxjerrjen e përgjegjësive administrative brenda institucionit.

Masat e marra për rikthimin e menjëhershëm në punë të gjithë punonjësve që kanë fituar këtë të drejtë.

Urdhër regjistrimi i detyrimit të prapambetur në Degën e Thesarit në rreth.

Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar pasi shqyrton kërkesat e ZVA-ve, me miratim të aktit të titullarit të DRAP që provon gjurmën e auditimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, nxjerrjen e përgjegjësive administrative brenda institucionit, si dhe masat e marra për rikthimin e menjëhershëm në punë të gjithë punonjësve që kanë fituar këtë të drejtë, bën me dije DPAP dhe përcjell në MASR në rrugë zyrtare kërkesën për rishpërndarje të fondit për palën debitorë dhe likuidimin e detyrimeve të vendimeve gjyqësore të formës së prerë.

(Bashkëlidhur do të gjeni kopje të shkresave 4880/23, 4880/62, 4880/64, 69/72, 69/73, datë 9.02.2021)

Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit ka marrë masat e nevojshme për sistemimin e gjyqfituesve në institucionet e varësisë. Aktualisht, znj. M. L.është e punësuar në bashkinë Bulqizë që nga 10. 01. 2020. E pa sistemuar në shërbimin civil është vetëm një rast, znj. B.M.edhe pse në vijimësi ka qenë në marrëdhënie pune në sistemin arsimor parauniversitar. MAS po e ndjek rastin me institucionin përkatës për sistemimin e znj. M.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** dhe **i zbatuar**.

Observacion dërguar me shkresën nr.4338/3 prot., datë 06.10.2023 protokolluar me tonën me nr.613/58 prot., datë 09.10.2023

Përgjigje e subjektit të audituar

“Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin, menaxhimin pa ekonomikitet, efencë dhe efektivitet të fondeve publike” Rekomandim 2.1 është realizuar plotësisht pasi me vendimin me nr. 39 e datës 14.09.2023, shtetasja B. M. është punësuar si mësuese, profili “Fizikë”, të shkollës Koreografike, Tiranë.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i zbatuar**.

Sa më sipër observacioni merret në konsideratë.

2.2. Rekomandim: Titullari i MAS të shqyrtojë vlerën 78,370 mijë lekë. Kjo vlerë ka të bëjë me parregullsitë e konstatuara në ekzekutimin e vendimeve gjyqësore në Drejtorinë Arsimore apo Zyrat vendore të arsimit parauniversitar, për rikthimin në punë të të punonjësve që e kanë fituar këtë të drejtë. Te evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimet përkatëse, vlerë e cila për MAS dhe Buxhetin e Shtetit përbën efekt financiar negativ. Drejtoria e Planifikimit të Buxhetit dhe Financës të planifikojë dhe të analizojë në mënyrë korrekte, detyrimet e prapambetura që në fazat e PBA-së, në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, me qëllim shlyerjen e detyrimeve koherente, brenda vitit buxhetor dhe minimizimin e mbartjes së tyre në vitin pasardhës, duke nxjerrë shkaqet dhe përgjegjësitë e këtij veprimi të përsëritur çdo vit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigja e Institucionit

Nga ana e Institucionit në Rekomandimn e mësipërm nuk mund të merret masë sepse likuidimi nga ana e ZVA-ve respektive është bazuar në vendimet gjyqësore të formës së prerë.(vendimet e formës së prerë janë të cituara në shkresat e çeljes së fondeve nga ana e MASH për likuidimin e tyre,bashkëlidhur fotokopjet e çeljeve së fondeve). Nga ana e ZVA-ve janë kryer likuidimet dhe për personat që janë rikthyer në punë deri në momentin e rikthimit në punë dhe më pas është ndërprerë procesi i pagesës.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim 2.2 konsiderohet **i pranuar** dhe **i zbatuar**.

3.1. Rekomandim 3.1: Titullari i Autoritetit Kontraktor të shqyrtojë vlerën 3.829,704 lekë. Kjo vlerë ka të bëjë me parregullsitë e konstatuara në instalimin dhe vendosjen në punë të laboratorëve dhe pjesëve laboratorike në shkollën "Shaqe Mazreku", të furnizuar sipas kontratës së furnizimit nr 4036/3, datë 14.09.2020 "Blerje pajisje didaktike dhe laboratorike në kuadër të rindërtimit të shkollave të dëmtuara nga tërmeti", në ZVA Durrës, vlerë e cila për MAS dhe Buxhetin e Shtetit përbën efekt financiar negativ. Në vijim MAS të ngrejë një grup pune i cili duhet të kryejë verifikimin fizik të të gjithë artikujve laboratorikë dhe vënien e tyre në funksion të mësim dhënies.

Brenda datës 31.03.2022

Përgjigja e Institucionit

Lidhur me gjetjen 3 dhe Rekomandimn 3.1, sqarojmë se Titullari i Autoritetit Kontraktor në MAS me shkresën Nr.2248/7, datë 21.04.2022 “Për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së”, i është drejtuar ZVA Durrës për ngritjen e grupit të punës për verifikimin e laboratorëve dhe pjesëve laboratorike në shkollën “Shaqe Mazreku”, në ZVA Durrës, të furnizuara sipas kontratës së furnizimit nr.4036/3, datë 14.09.2020, të lidhur ndërmjet MASR dhe BOE “AL M.”, Shpk & “D.”, me objekt “Blerje pajisje didaktike dhe laboratorike në kuadër të rindërtimit të shkollave të dëmtuara nga tërmeti”.

Me shkresën nr.1073, datë 29.04.2022, ZVA Durrës na informon se grupi i punës i ngritur me urdhër nr.44, datë 26.04.2022, në Raportin Përmbledhës nr.982/1, datë 28.04.2022, ka konstatuar se në shkollën “Shaqe Mazreku”, sasia e artukujve të laboratorëve të Fizikës, Kimisë dhe Biologjisë janë në përputhje me planin e shpërndarjes dhe sasinë e marrë në dorëzim dhe janë në gjendje pune (bashkëlidhur foto).

Bashkëlidhur do të gjeni kopje të shkresës Nr.2248/7, datë 21.04.2022, urdhër nr.44, datë 26.04.2022, Raporti Përmbledhës nr.982/1, datë 28.04.2022.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** dhe **i zbatuar**

4.1. Rekomandim: Titullari i Autoritetit Kontraktor të shqyrtojë vlerën 3.829,704 lekë. Kjo vlerë ka të bëjë me parregullsitë e konstatuara në instalimin dhe vendosjen në pune të laboratorëve dhe pjesëve laboratorike në shkollën "Halit Coka", të furnizuar sipas kontratës së furnizimit nr 4036/3, datë 14.09.2020 "Blerje pajisje didaktike dhe laboratorike në kuadër të rindërtimit të shkollave të dëmtuara nga tërmeti", në ZVA Kamëz, vlerë e cila për MAS dhe Buxhetin e Shtetit përbën efekt financiar negativ. Në vijim MAS të ngrejë një grup pune i cili duhet të kryejë verifikimin fizik të të gjithë artikujve laboratorikë dhe vënien e tyre në funksion të mësim dhënies.

Brenda datës 31.03.2022

Përgjigjja e Institucionit

Lidhur me gjetjen 4 dhe Rekomandimn 4.1, sqarojmë se Titullari i Autoritetit Kontraktor në MAS me shkresën Nr.2248/6, datë 21.04.2022 "Për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së", i është drejtuar ZVA Kamëz për ngritjen e grupit të punës për verifikimin e laboratorëve dhe pjesëve laboratorike në shkollën “Halit Çoka”, në ZVA Kamëz, të furnizuara sipas kontratës së furnizimit nr. 4036/3, datë 14.09.2020, të lidhur ndërmjet MASR dhe BOE “AL M.”, Sh.p.k & “D.”, me objekt “Blerje pajisje didaktike dhe laboratorike në kuadër të rindërtimit të shkollave të dëmtuara nga tërmeti”.

Me shkresën nr.637, datë 04.05.2022, ZVA Kamëz na informon se grupi i punës i ngritur me urdhër nr.23, datë 18.04.2022, në Proces verbalin datë 29.04.2022, ka konstatuar se në shkollën “Halit Çoka”, sasia e artukujve të laboratorëve të Fizikës, Kimisë dhe Biologjisë janë në përputhje me planin e shpërndarjes dhe sasinë e marrë në dorëzim dhe janë në funksion të mësimdhënies.

Bashkëlidhur do të gjeni kopje të shkresës Nr.2248/6, datë 21.04.2022, shkresën nr.637, datë 04.05.2022, urdhër nr.23, datë 18.04.2022, në proces verbalin datë 29.04.2022.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** dhe **i zbatuar**

5.1. Rekomandim: Titullari i Autoritetit Kontraktor të shqyrtojë vlerën 3.829,704 lekë. Kjo vlerë ka të bëjë me parregullsitë e konstatuara në instalimin dhe vendosjen në pune të

laboratorëve dhe pjesëve laboratorike në shkollën "Lidhja e Prizrenit", të furnizuar sipas kontratës së furnizimit nr 4036/3, datë 14.09.2020 "Blerje pajisje didaktike dhe laboratorike në kuadër të rindërtimit të shkollave të dëmtuara nga tërmeti", në ZVA Shijak, vlerë e cila për MAS dhe Buxhetin e Shtetit përbën efekt financiar negativ. Në vijim MAS të ngrejë një grup pune i cili duhet të kryejë verifikimin fizik të të gjithë artikujve laboratorikë dhe vënien e tyre në funksion të mësim dhënies.

Brenda datës 31.04.2022

Përgjigjja e Institucionit

Lidhur me gjetjen 5 dhe Rekomandimn 5.1, sqarojmë se Titullari i Autoritetit Kontraktor në MAS me shkresën Nr.2248/5, datë 21.04.2022 "Për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së", i është drejtuar ZVA Shijak për ngritjen e grupit të punës për verifikimin e laboratorëve dhe pjesëve laboratorike në shkollën "Lidhja e Prizrenit", në ZVA Shijak, të furnizuara sipas kontratës së furnizimit nr.4036/3, datë 14.09.2020, të lidhur ndërmjet MASR dhe BOE "AL M.", Sh.p.k & "D.", me objekt "Blerje pajisje didaktike dhe laboratorike në kuadër të rindërtimit të shkollave të dëmtuara nga tërmeti. Me shkresën nr.425, datë 27.04.2022, ZVA Shijak na informon se grupi i punës i ngritur me urdhër nr.21, datë 22.04.2022, në Raportin nr.413/2, datë 26.04.2022, ka konstatuar se në shkollën "Lidhja e Prizrenit", sasia e artikujve të laboratorëve të Fizikës, Kimisë dhe Biologjisë janë në përputhje me planin e shpërndarjes dhe sasinë e marrë në dorëzim dhe janë në funksion të mësimdhënies.

Bashkëlidhur do të gjeni kopje të shkresës Nr.2248/5, datë 21.04.2022, shkresës nr.425, datë 27.04.2022, urdhër nr.21, datë 22.04.2022, raportin nr.413/2, datë 26.04.2022.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** dhe **i zbatuar**

6.1. Rekomandim: Nga Ministri i Arsimit dhe Sportit, të merren masa për ngritjen e një grupi pune për verifikimin e mobilieve të furnizuara sipas kontratës së furnizimit nr 4074/3, datë 4.09.2020 "Blerje pajisje mobilierie në kuadër të rindërtimit të shkollave të dëmtuara nga tërmeti", grup i cili duhet të kryejë verifikimin fizik të të gjithë artikujve të mobilierisë objekt i kësaj kontrate.

Brenda datës 31.04.2022

Përgjigjja e Institucionit

Lidhur me gjetjen 6 dhe Rekomandimn 6.1, sqarojmë se Titullari i Autoritetit Kontraktor në MAS me shkresën Nr.2248/2, datë 21.04.2022 "Për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së", i është drejtuar DRAP Durrës për ngritjen e grupit të punës për verifikimin e mobilieve të furnizuara sipas kontratës së furnizimit nr. 4074/3, datë 4.09.2020 "Blerje pajisje mobilierie në kuadër të rindërtimit të shkollave të dëmtuara nga tërmeti", grup i cili duhet të kryejë verifikimin fizik të të gjithë artikujve të mobilierisë objekt i kësaj kontrate.

Me shkresën nr.779, datë 29.05.2022, DRAP Lezhë na informon se grupi i punës i ngritur me urdhër nr.102, datë 26.04.2022, në Raportin Përmbledhës datë 30.04.2022, ka konstatuar se në shkollat e ZVAP Lezhe dhe Kurbin sasia e artikujve të pajisjeve të mobilerisë (artikulli dërrasa të zeza) janë në përputhje me specifikimet teknike dhe sasinë e marrë në dorëzim dhe janë në funksion të mësimdhënies (bashkëlidhur foto).

(Bashkëlidhur do të gjeni kopje të shkresës Nr.2248/2, datë 21.04.2022, shkresën nr.779, datë 29.05.2022, urdhër nr.102, datë 26.04.2022, Raporti Përmbledhës datë 30.04.2022).

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** dhe **i zbatuar**.

7.1. Rekomandim: Ministria e Arsimit dhe e Sportit të marrë masat në të ardhmen në lidhje me menaxhimin e fondeve në shumën prej 128,784,222 lekë duke ndjekur të gjithë procedurat ligjore për zgjidhjen e çështjes, sipas legjislacionit në fuqi, përfshirë kërkimin e kthimit të shumës me proces gjyqësor, për të gjithë kandidatët, të cilët nuk kanë zbatuar detyrimin për t'u punësuar në Shqipëri.

Menjëherë

Përgjigja e Institucionit

Lidhur me gjetjen e cituar më lart dhe propozimin e Rekomandimit 7.1, sqarojmë se, nga ana e Sektorit të Këshillimit të Çështjeve Ligjore në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit janë hartuar në disa kërkesë padi për zhvillim procesi gjyqësor kundër përfituesve të Fondit të Ekselencës të listuara më poshtë, të cilat janë regjistruar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Lidhur me ecurinë e kërkesë padive të depozituara pranë gjykatës, ju bëjmë me dije si vijon:

1. Kërkesë padi nr. 21 prot, datë 04.01.2023. Padi të: Ministria e Arsimit dhe Sportit; E paditur: Znj. A. S. I.Me objekt detyrimin e palës paditëse znj.A. I. të kthejë shumën në vlerën totale 76,016 USD të përfituar nga Fondi i Ekselencës për shkak të mospërmbushjes së detyrimeve kontraktuale, sipas Akt-Marrëveshjes me nr.8780/13 prot, datë 25.09.2017.
2. Kërkesë padi nr.8469 prot, datë 30.12.2022. Padi të: Ministria e Arsimit dhe Sportit; E paditur: Znj. I.A.B.Me objekt detyrimin e palës paditëse znj.I. B. të kthejë shumën në vlerën totale 38,025 GBP+ 350 Euro të përfituar nga Fondi i Ekselencës për shkak të mospërmbushjes së detyrimeve kontraktuale, sipas Akt-Marrëveshjes me nr.6374/4 prot, datë 22.06.2018.
3. Kërkesë padi nr.8470 prot, datë 30.12.2022. Padi të: Ministria e Arsimit dhe Sportit; I paditur: Z. K. Sh.K.Me objekt detyrimin e palës paditëse z. K. K. të kthejë shumën në vlerën totale 33,000 GBP të përfituar nga Fondi i Ekselencës për shkak të mospërmbushjes së detyrimeve kontraktuale, sipas Akt-Marrëveshjes me nr.9671/6 prot, datë 26.12.2014.
4. Kërkesë padi nr.8471 prot, datë 30.12.2022. Padi të: Ministria e Arsimit dhe Sportit; I paditur: Z. K.P.T.. Me objekt detyrimin e palës paditëse z. K. T. të kthejë shumën në vlerën totale 60,931 USD të përfituar nga Fondi i Ekselencës për shkak të mospërmbushjes së detyrimeve kontraktuale, sipas Akt-Marrëveshjes me nr.11256/8 prot, datë 30.12.2015.
5. Kërkesë padi nr.8468 prot, datë 30.12.2022. Padi të: Ministria e Arsimit dhe Sportit; E paditur: Znj. K. Gj. M.Me objekt detyrimin e palës paditëse znj. K. M.të kthejë shumën në vlerën totale 60,933 USD të përfituar nga Fondi i Ekselencës për shkak të mospërmbushjes së detyrimeve kontraktuale, sipas Akt-Marrëveshjes me nr.11256/10 prot, datë 30.12.2015.

Detyrimin e palës paditëse znj. K. M. të kthejë shumën në vlerën totale 71,890 USD të përfituar nga Fondi i Ekselencës për shkak të mospërmbushjes së detyrimeve kontraktuale, sipas Akt-Marrëveshjes me nr.9858/4 prot, datë 07.10.2016.

Detyrimin e palës paditëse znj. K.M. të kthejë shumën në vlerën totale 69,126 USD të përfituar nga Fondi i Ekselencës për shkak të mospërmbushjes së detyrimeve kontraktuale, sipas Akt-Marrëveshjes me nr.11214/2 prot, datë 07.12.2017.

Detyrimin e palës paditëse znj. K.M. të kthejë shumën në vlerën totale 67,195 USD+850 Euro të përfituar nga Fondi i Ekselencës për shkak të mospërmbushjes së detyrimeve kontraktuale, sipas Akt-Marrëveshjes me nr.8722/9 prot, datë 29.08.2018.

6. Kërkesë padi nr.7758 prot, datë 23.11.2022. Paditës: Ministria e Arsimit dhe Sportit; I paditur: Z. P.E. P.. Me objekt detyrimin e palës paditëse z. P. P. të kthejë shumën në vlerën totale 10,158 USD të përfituar nga Fondi i Ekselencës për shkak të mospërmbushjes së detyrimeve kontraktuale, sipas Akt-Marrëveshjes me nr.7311/1 prot, datë 16.10.2014.
7. Kërkesë padi nr.7756 prot, datë 23.11.2022. Paditës: Ministria e Arsimit dhe Sportit; I paditur: Z. E. P. D.Me objekt detyrimin e palës paditëse z. E.D. të kthejë shumën në vlerën totale 41,061 GBP të përfituar nga Fondi i Ekselencës për shkak të mospërmbushjes së detyrimeve kontraktuale, sipas Akt-Marrëveshjes me nr.8780/11 prot, datë 25.09.2017.
8. Kërkesë padi nr. 7754 prot, datë 23.11.2022. Paditës: Ministria e Arsimit dhe Sportit; E paditur: Znj. O. Q. Sh.Me objekt detyrimin e palës paditëse znj.O. Sh. të kthejë shumën në vlerën totale 34,725 GBP+ 350Euro të përfituar nga Fondi i Ekselencës për shkak të mospërmbushjes së detyrimeve kontraktuale, sipas Akt-Marrëveshjes me nr.9958/3 prot, datë 10.10.2018.
9. Kërkesë padi nr. 137/1 prot, datë 10.01.2023. Paditës: Ministria e Arsimit dhe Sportit; E paditur: Znj. A. Sh. L.Me objekt detyrimin e palës paditëse znj.A. L. të kthejë shumën në vlerën totale 30,000 GBP të përfituar nga Fondi i Ekselencës për shkak të mospërmbushjes së detyrimeve kontraktuale, sipas Akt-Marrëveshjes me nr.9671/3 prot, datë 26.12.2014.

Detyrimin e palës paditëse znj. A. L. të kthejë shumën në vlerën totale 27,156 GBP të përfituar nga Fondi i Ekselencës për shkak të mospërmbushjes së detyrimeve kontraktuale, sipas Akt-Marrëveshjes me nr.11256/9 prot, datë 30.12.2015.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** dhe **i zbatuar**

MASA DISIPLINORE, ADMINISTRATIVE DHE TË TJERA

Mbështetur në nenin 15, shkronja c dhe nenin 30 të Ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, i rekomandojmë Titullarit të Institucionit që, në përputhje me ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të vlerësojë, shkallën e përgjegjësisë për secilin punonjës të përfshirë, në lidhje me mangësitë dhe shkeljet e konstatuara, të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, si dhe të kërkojë marrjen e masave për personat që vlerësohen me përgjegjësi në këtë raport përfundimtar auditimi.

Përgjigjja e Institucionit

Nga ana e Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve nuk është vlerësuar shkalla e përgjegjësisë për punonjësit e kësaj Ministrie për dhënie të masave disiplinore

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** dhe **i pazbatuar**.

KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve në MAS me shkresën me nr. 933/8 prot., datë 13.10.2021 për Raportin Përfundimtar të Auditimit “Për auditimin financiar dhe përputhshmëri” të ushtruar në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, sipas programit të auditimit nr. 933/1 prot, datë, 03.09.2021, për periudhën 01.09.2019 deri në datën 31.08.2021, rezulton se

subjekti i audituar ka respektuar afatin 20 ditor për hartimin e planit të masave për zbatimin e rekomandimeve në përputhje me kërkesat e nenit 15 shkronja (j) të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, si dhe ka respektuar afatin për njoftimin brenda 6 muajve mbi ecurinë e zbatimit të këtyre masave në përputhje me kërkesat e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Konkretisht ecuria e zbatimit të rekomandimeve paraqitet sipas tabelës “*Ecuria e zbatimit të rekomandimeve*”

lekë

Masa	Gjithsej		Pranuar		Zbatuar plotësisht		Pjesërisht		Në proces		Pa zbatuar	
	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë
Organizative	25	-	25	-	13	-	-	-	9	-	3	-
Shpërblim dëmi	3	2,840,960	3	2,840,960	1		-	-	2	2,840,960	-	-
Eliminim i Efekteve Negative	9	279,973,334	9	279,973,334	9	279,973,334	-	-		-	-	-
Disiplinore	1	-	1	-	-	-	-	-	-	-	1	-
Gjithsej	38	282,814,294	38	282,814,294	23	279,973,334	-	-	11		4	-

Sa sipër rezulton se janë dhënë gjithsej 38 rekomandime të cilët janë pranuar plotësisht (100 %), dhe rezultojnë të zbatuar plotësisht 23 rekomandime (61%).

Për të gjitha rekomandimet që konsiderohen në proces zbatimi, inkurajohet përshpejtimi i realizimit të plotë të tyre.

Për sa më sipër ri kërkojmë që, Ministria e Arsimit dhe Sportit të marrë të gjitha masat e nevojshme me qëllim zbatimin e të gjitha rekomandimeve që rezultojnë të pazbatuar brenda 3-mujorit të parë të vitit 2024. Si dhe kërkojmë marrjen e masave disiplinore për zyrtarët përgjegjës, në lidhje me rekomandimet e KLSH të pranuarra prej institucionit dhe që efektivisht rezultojnë të pa zbatuara.

MBI AUDITIMIN TEMATIK NË MINISTRINË E ARSIMIT DHE SPORTIT:

PËRMBLEDHJE

Në zbatim të Programit të Auditimit nr. 613/20 datë 06.07.2023 “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e evaduara, në ambientet e institucionit MAS, më datë, 31.07.2023 u mbajt akt-verifikimi nr.9 nga audituesit e autorizuar të KLSH-së z.G.H dhe znj. A.K, me përfaqësues nga subjekti z. E. T. në cilësinë e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe znj. A. D. e autorizuar për trajtimin e rekomandimeve të KLSH-së.

Objekt i këtij akt verifikimi është:

Verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të KLSH të lëna me shkresën nr. 933/1 prot., datë, 17.05.2021 për Raportin Përfundimtar të Auditimit “Për auditimin financiar dhe përputhshmëri” të ushtruar në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, sipas programit të auditimit nr. 933/1 prot, datë, 03.09.2021, për periudhën 01.09.2019 deri në datën 31.08.2021, si dhe auditimit “Tematik të përputhshmërisë” sipas programit nr 895/1 datë 14.10.2022,për periudhën nga data 01.01.2021 deri në datën 30.06.2022 që i përket 6 mujorit të dytë, në lidhje mbi statusin e zbatimit të rekomandimeve, afateve dhe niveli i zbatueshmërisë së tyre, koherencën e tyre si dhe përgjegjshmërinë menaxheriale referuar standardeve të auditimit.

Auditimi u krye nga:

1. G.H

2. A.K

Auditimi ka filluar më, 07.07.2023

Auditimi ka përfunduar më, 31.07.2023

Auditimi është kryer në bazë të Programit të Auditimit të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit nr.613/24 prot., datë 06.07.2023 me objekt: “*Mbi verifikimin e zbatimit të rekomandimeve*”, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” si dhe në zbatim të Rregullores së Procedurave të Auditimit dhe të Manualit për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të auditimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe Regjistrisë elektronik institucionale, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 67, datë 13.06.2020.

TRAJTIMI I ÇËSHTJEVE TË AUDITIMIT

Nga auditimi i ushtruar në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, “*Mbi auditimin financiar dhe përputhshmëri*” për periudhën e veprimtarisë nga data 01.09.2019 deri në 31.08.2021 trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit me nr.933/13, datë 04.04.2022, dhe vendimit të Kryetarit të KLSH-së, rezultojnë se:

I. Hartimi i programit (Plan veprimit) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në nenin 15 shkronja (j) të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Nga auditimi u konstatua se, subjekti i audituar MAS ka hartuar një procesverbal të mbajtur në datën 25.02.2022, me nr. 2642/45 prot, dërguar në KLSH në lidhje me temën “Për marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga projekt raporti i auditimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit” kjo në përputhje me ligjin nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” nenit 15, shkronja ‘j’.

Sa më sipër rezultojnë se është zbatuar afati 20 ditor për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve.

II. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Në lidhje mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve dhe afatet e përcaktuara, sipas strukturave përgjegjëse, MAS *ka përgatitur planin e masave të marra lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të miratuara nga Titullari brenda afatit 6 muajor*, dërguar me shkresën nr.2248/14prot, datë 16.05.2022 kjo në përputhje me Ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” nenit 30, pika 2 e tij.

Sa më sipër rezultojnë se është zbatuar afati 6 muajor për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve.

III. Realizimi i rekomandimeve

Nga ana e KLSH-së, janë lënë 3 masa për përmirësim ligjor, 5 masa organizative

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

a) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 3 masa për përmirësim ligjor nga ku 3 rekomandime, të cilat janë pranuar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit ku nga këto 1 është e zbatuar dhe 2 janë në proces zbatimi.

b) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 5 masa organizative me 5 rekomandime, të pranuar plotësisht, ku nga këto 4 janë zbatuar dhe 1 e pa zbatuar.

Më hollësisht, auditimi i ndjekjes së zbatimit rekomandimeve “Mbi auditimin tematik të përputhshmërisë” paraqitet si vijon:

PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI

1.1. Rekomandim: Të merren masa nga MAS-i për propozimin për përmirësimin e legjislacionit për sportin duke bërë shtesat e nevojshme në Ligjin Nr. 79/2017 “Për sportin” i ndryshuar, për vendosjen e afateve ligjore nëpër të cilën kalon procedura e shpërblimit të sportistëve elitare, që nga shpallja e rezultateve zyrtare, përgjigja zyrtare për testet antidoping nga organizmat përkatës të njohur me ligj deri në finalizimin për dhënien e shpërblimit, si dhe parashikimin e të drejtës së ankimit dhe organit që e shqyrton, në rastet kur kërkesa për shpërblim nuk pranohet, nuk merret në shqyrtim apo refuzohet.

Në vijimësi

Përgjigja e Institucionit

Nga ana e MAS është ngritur grupi i punës me urdhrin me nr. 416, datë 26.07.2023” Për ngritjen e grupit të punës për draftimin e ndryshimeve në aktet ligjore dhe nënligjore në fushën e sportit” (Bashkëlidhur dhe Memo me nr .4244 datë 04.07.2023).

Komenti i grupit të auditimit

Për sa më sipër trajtuar **Rekomandim i pranuar** dhe **në proces zbatimi**

2.1. Rekomandim: Të merren masa nga MAS për propozimin për përmirësim të legjislacionit për sportet duke kërkuar shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 79/2017 “Për sportin” i ndryshuar, konkretisht të nenit 27, pika 1, germa “c”, me qëllim përcaktimin e saktë të të gjithë eventeve të listuara për të cilat ligji njih të drejtën e shpërblimit.

Menjëherë

Përgjigja e Institucionit

Për sa më sipër në nenin 27 të ligjin Nr. 79/2017 “Për sportin” i ndryshuar dhe VKM Nr.789, datë 15.12.2021, “ Për kriteret, mënyrën e shpërblimit dhe trajtimin e sportistëve, që përfitojnë statusin e nivelit të lartë, dhe trajnerëve të tyre ” përcaktohen qartë veprimtaritë ndërkombëtare të cilat shpërblehen. Pra ’Ifbb Diamond Cup Portugal & IFBB Elite Pro World Championships’’, nuk shpërblehen pasi nuk është veprimtari e përcaktuar në VKM-në e lartpërmendur.

Nga ana e MAS me urdhrin me nr. 416, datë 26.07.2023” Për ngritjen e grupit të punës për draftimin e ndryshimeve në aktet ligjore dhe nënligjore në fushën e sportit”.

Komenti i grupit të auditimit

Për sa më sipër trajtuar **Rekomandim i pranuar** dhe **në proces zbatimi**

3.1. Rekomandim: Të merren masa nga titullari i MAS-it që të propozojë përmirësim në VKM Nr. 146, datë 26.2.1998 me ndryshime, Aneksi 1, Pasqyra 1 “Çmimet e biletave të transportit të udhëtarëve me autobus sipas distancës kilometrike” duke bashkëpunuar në këtë drejtim me organet e vetëqeverisjes vendore për unifikimin e distancave në km, shprehur për qytet dhe fshat të RSH si dhe çmimit të miratuar nga njësitë e vetëqeverisjes vendore sipas distancave, me qëllim që Aneksi 1, Pasqyra 1, të jetë gjithëpërfshirës në hartën e transportit ndërqytetës për arsimtarët.

Menjëherë

Përgjigja e Institucionit

Nga ana e MAS me vendimin me nr.119 datë 01.03.2023, është zgjidhur “Përdorimi i fondeve publike për transportin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit”(Bashkëlidhur fotokopje e vendimit)

Komenti i grupit të auditimit

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim i **pranuar** dhe i **zbatuar**

MASA ORGANIZATIVE

1.1. Rekomandim: Të merren masa nga titullari i institucionit/MAS, për përditësimin e rregullores së brendshme të funksionimit me ndryshimet e reja strukturore duke përcaktuar qartë përshkrimin e proceseve të punës për drejtoritë përkatëse, specifikisht ngritjen dhe funksionimin e grupit të punës për shqyrtimin dhe vlerësimin e shpërblimit për sportistët elitari ku në përbërje të jetë specialisti i fushës, si dhe miratimin si pjesë integrale të rregullores së data bazës së të dhënave për shpërblimin e sportistëve elitari.

Menjëherë

Përgjigja e Institucionit

MAS është dakord me Rekomandimn 1.1 dhe me urdhrin me nr. 689, datë 15.11.2022, është miratuar “Rregullorja e brendshme e Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve”.

Komenti i grupit të auditimit

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim i **pranuar** dhe i **zbatuar**.

2.1. Rekomandim: Të merren masa nga MAS për shqyrtimin e kërkesës së Federatës nr.46 prot., datë 30.03.2022 për shpërblimin e sportistit Marin Meksi në përputhje me kriteret e përcaktuara në Ligjin Nr. 79/2017 “Për sportin” i ndryshuar.

Menjëherë

Përgjigja e Institucionit

Nga ana e MAS ne shkresën me nr.7341/1prot, e datës 15.03.2022, i kthehet përgjigje Federatës Shqiptare të Bodybuilding and Fitness e cila ka kërkuar shpërblim për rezultate te mira të sportistit Marin Meksi.Në VKM-në me nr.789 e Këshillit të Ministrave datë 15.12.2021” Për kriteret, mënyrën e shpërblimit dhe trajtimin e sportistëve, që përfitojnë statusin e nivelit të lartë të trajnerëve të tyre” nuk ka parashikuar shpërblim për aktivitet Turne Botëror.

Federata Shqiptare e Bodybuilding and Fitness me shkresën drejtuar MAS në datën 10.03.2023 sqaron se, pretendimi i sportistit Marin Meksi për shpërblim financiar bie poshtë duke mos plotësuar kriteret e parashikuara në ligj ku me të drejte është vënë në dukje nga Drejtoria e Sporteve të MAS, gjithashtu kjo federatë sqaron se gara ndërkombëtare “IFBB Diamond Cup Lusofonia” nuk konsiderohet “Kampionat Botëror”.(Bashkëlidhur shkresat e përshkruara më lart)

Komenti i grupit të auditimit

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim i **pranuar** dhe i **zbatuar**

3.1. Rekomandim: Të merren masa nga Drejtoria e Politikave të Sportit/Spektori i Zhvillimit të Sportit Elitar për plotësimin e dokumentacionit të shpërblimit për sportistët B. C., E.V., E.Q. dhe A.B. e në vijimësi me praktikat e tjera dhe inventarizimin e dosjeve.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigja e Institucionit

Nga ana e MAS janë marrë të gjitha masat dhe janë kryer urdhrat e shpërblimeve për sportistët B. C. shoqëruar urdhrin me nr.210 datë 21.04.2022, urdhri me nr.457, datë 26.07.2022 për sportistin A.B., urdhri me nr.557, datë 26.09.2022, për sportistin E. Q., urdhëri me nr.16 i datës 19.01.2022 për E. V., urdhëri me nr.348 datë 17.06.2022 për E. V.

Komenti i grupit të auditimit

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim i **pranuar** dhe i **zbatuar**

4.1. Rekomandim: Të merren masa nga Nëpunësi Zbatues për procesin e inventarizimit të praktikave/dosjeve për shpërblimin e sportistëve elitare.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e Institucionit

Nga ana e institucionit është realizuar inventarizimi i praktikave dhe dosjeve të shpërblimeve të sportistëve elitare nga sektori i arkiv/protokoll.

Sa më sipër mbështetur në VKM nr.789, datë 15.12.2021, pika 13 nga ana e sektorit të arkiv/protokoll janë hartuar urdhërat me nr. 457 datë 26.07.2022 për sportistin A.B. dhe trajneri S. B., memo nr. 4245 datë 26.07.2022 bashkëlidhur kërkesa e Federatës Shqiptare të boksit, rezultati përfundimtar dhe analiza antidoping,

Urdhri nr.557 datë 26.09.2022 për sportistin E. Q. dhe trainierin S. B. Bashkëlidhur rezultati përfundimtar, memo me nr. 4930, datë 26.09.2022, testi i rezultatit antidoping,

Urdhri me nr. 16 datë 19.01.2022, për sportisten E. V. trajneri O. F. e shoqëruar me kërkesën e Federatës Shqiptare me nr.7399 datë 21.12.2021, rezultati përfundimtar dhe kontrolli antidoping ardhur me e-mail nga Federata Shqiptare e Peshëngritjes.

Urdhëri me nr. 210 datë 21.04.2022, për sportistin B. C. dhe trajneri G. T. Kërkesa Federatës Shqiptare peshëngritjes me nr.2464 datë 12.04.2022, rezultati përfundimtar, analiza antidoping me e-mail nga Federata Shqiptare dhe memo e datës 27.01.2022.(Bashkëlidhur gjithë dokumentacioni i përshkruar më lart)

Komenti i grupit të auditimit

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim i **pranuar** dhe i **zbatuar**

5.1 Rekomandim: Të merren masa nga MAS që Drejtoria e Auditit të Brendshëm të përfshijë në planin e auditimit vjetor 2023 dhe auditimin në ZVAP Gjirokastrë, me tematikë procedurat e ndjekura nga shkollat në rastet e konkurrimit për vend të lirë pune. (*Referuar ankimit të znj. E. Ç.*).

Deri në qershor 2023

Përgjigjja e Institucionit

Po punohet nga Drejtoria e Auditit të Brendshëm të përfshijë në planin e auditit vjetor 2023 ZVAP Gjirokastrë por deri tani nuk është marrë asnjë masë në lidhje me Rekomandimn e mësipërm.

Komenti i grupit të auditimit

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim i **pranuar** dhe i **pazbatuar**

KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve në MAS me “Mbi auditimin tematik të përputhshmërisë” trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit me nr. 895/9 prot., datë 30.12.2022, dhe Vendimit të Kryetarit të KLSH-së, më nr.252 datë 30.12.2022 rezulton se subjekti i audituar ka respektuar afatin 20 ditor për hartimin e planit të masave për zbatimin e

rekomandimeve në përputhje me kërkesat e nenit 15 shkronja (j) të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, ka respektuar afatin për njoftimin brenda 6 muajve mbi ecurinë e zbatimit të këtyre masave në përputhje me kërkesat e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Konkretisht ecuria e zbatimit të rekomandimeve paraqitet sipas tabelës “*Ecuria e zbatimit të rekomandimeve*”

lekë

Masa	Gjithsej		Pranuar		Zbatuar plotësisht		Pjesërisht		Në proces		Pa zbatuar	
	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë
Përmirësim Ligjor	3	-	3	-	1	-	-	-	2	-	-	-
Organizative	5	-	5	-	4	-	-	-	-	-	1	-
Gjithsej	8		8		5		-	-	2	-	1	-

Sa sipër rezulton se janë dhënë gjithsej 8 rekomandime të cilët janë pranuar plotësisht (100 %), dhe rezultojnë të zbatuar plotësisht 5 rekomandime (63 %).

Për të gjitha rekomandimet që konsiderohen në proces zbatimi, inkurajohet përsheptimi i realizimit të plotë të tyre.

Për sa më sipër ri kërkojmë që Ministria e Arsimit dhe Sportit të marrë të gjitha masat e nevojshme me qëllim zbatimin e të gjitha rekomandimeve që rezultojnë të pazbatuar brenda 3-mujorit të parë të vitit 2024. Si dhe kërkojmë marrjen e masave disiplinore për zyrtarët përgjegjës, në lidhje me rekomandimet e KLSH të pranuar prej institucionit dhe që efektivisht rezultojnë të pa zbatuara.

3.5 MINISTRIA E KULTURËS

PËRMBLEDHJE

Në zbatim të Programit të Auditimit nr. 613/27 prot., datë 06.07.2023, “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e evaduara në 6-mujorin e dytë të vitit 2022”, në ambientet e institucionit, më datë 26.07.2023, u mbajt aktverifikimi nga audituesit e autorizuar të KLSH-së znj. A.Xh dhe z. G.H, me znj. Z. B. në cilësinë e Sekretarit të Përgjithshëm të institucionit dhe z. S. G., përfaqësues i sektorit të Auditit të Brendshëm.

Objekt i këtij akt verifikimi është:

Verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të KLSH të lëna me shkresën nr. 1420/24 prot. datë 18.07.2022 për Raportin Përfundimtar të Auditimit me objekt “Auditim financiar dhe përputhshmërie”, të ushtruar në Ministrinë e Kulturës, sipas programit të auditimit nr.1420/1 prot, datë 12.01.2022, për veprimtarinë nga data 01.01.2020 deri më datë 31.12.2021, në lidhje mbi statusin e zbatimit të rekomandimeve, afateve dhe niveli i zbatueshmërisë së tyre, koherencën e tyre si dhe përgjegjshmërinë menaxheriale referuar standardeve të auditimit.

Auditimi u krye nga:

1. A.Xh
2. G.H

Auditimi ka filluar më datë 07.07.2023

Auditimi ka përfunduar më datë 26.07.2023

Auditimi është kryer në bazë të Programit të Auditimit të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit nr.613/27 prot., datë 06.07.2023 me objekt: “Mbi verifikimin e zbatimit të

rekomandimeve”, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” si dhe në zbatim të Rregullores së Procedurave të Auditimit dhe të Manualit për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të auditimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe Regjistrit elektronik institucional, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 67, datë 13.06.2020.

TRAJTIMI I ÇËSHTJEVE TË AUDITIMIT

Nga auditimi i ushtruar në Ministrinë e Kulturës për zbatimin e rekomandimeve të KLSH mbi “*Auditimin financiar dhe përputhshmëri*” për periudhën 01.01.2020 deri më datë 31.12.2021 trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin nr. 113, datë 15.07.2022, të Kryetarit të KLSH-së të cilat janë përcjellë me shkresën nr. 1420/24 prot., datë 18.07.2022, verifikohet se:

I. Hartimi i programit (Plan veprimit) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në nenin 15 shkronja (j) të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Nga auditimi u konstatua se, subjekti ka *miratuar planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH*, duke e dërguar në KLSH me shkresë nr. 6761/12 datë 08.08.2022 kjo në përputhje me ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” nenit 15, shkronja j.

Sa më sipër rezulton se është zbatuar afati 20 ditor për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve.

II. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Në lidhje mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve dhe afatet e përcaktuara, sipas strukturave përgjegjëse, MK ka përgatitur planin e masave të marra lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të miratuara nga titullari, por nuk e ka dërguar në KLSH, në kundërshtim me ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” nenit 30.

Sa më sipër rezulton se nuk është zbatuar afati 6 mujor për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve.

III. Realizimi i rekomandimeve

Nga ana e KLSH-së, me shkresat përcjellëse janë lënë 24 masa në total për të cilat janë dhënë 26 rekomandime, Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

- a) Për përmirësimin e gjendjes është lënë, 1 masë për ndryshime apo përmirësime në legjisllacionin në fuqi nga ku 1 rekomandim, i cili është i pranuar dhe i zbatuar.
- b) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 14 Masa organizative nga ku 15 rekomandime, të cilat janë pranuar plotësisht dhe kanë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon: 5 janë zbatuar, 5 janë në proces zbatimi dhe 5 janë pazbatuar.
- c) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 2 Masa për Shpërblim Dëmi nga ku 2 rekomandime, të cilat janë pranuar dhe janë zbatuar plotësisht.
- d) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 7 Masa për menaxhimin e Efektivitetit dhe Ekonomicitetit të Fondeve Buxhetore nga ku 7 rekomandime, të cilat janë pranuar dhe kanë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon: 6 janë në proces zbatimi dhe 1 është e pazbatuar.
- e) Për përmirësimin e gjendjes është lënë, 1 masë disiplinore e cila është pranuar dhe është në proces zbatimi.

Më hollësisht, auditimi i ndjekjes së rekomandimeve në Ministrinë e Kulturës paraqitet si vijon:

PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI

1.1. Rekomandim: Nga ana e Ministrisë së Kulturës të ngrihet një grup pune për përmirësimin ligjor të VKM-së nr.425, datë 27.5.2020 “Për procedurat e përzgjedhjes së subjekteve të pajisura me licencë për projektim, zbatim, mbikëqyrje dhe kolaudim në pasuritë kulturore, për kryerjen e investimeve me fonde publike në Pasuritë Kulturore”, me qëllim arritjen e një procesi të konkurrencës publik sa më transparent, rritjen e konkurrencës dhe menaxhimin me efikasitet, efikasitet dhe ekonomicitet të fondeve publike duke përcaktuar qartë në VKM komisionin dhe mënyrën e llogaritjes së fondit limit.

-Në nenin 13 të VKM-së nr.425, datë 27.5.2020 “Për procedurat e përzgjedhjes së subjekteve të pajisura me licencë për projektim, zbatim, mbikëqyrje dhe kolaudim në pasuritë kulturore, për kryerjen e investimeve me fonde publike në Pasuritë Kulturore”, duhet të përcaktohet në mënyrë të saktë rubrika e dedikuar për procedurat e konkurrencës publik, në mënyrë lehtësimin e marrjes së informacionit për të gjithë operatorët ekonomik të interesuar.

Në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Drejtorja e Koncesioneve, Prokurimeve dhe Partneriteteve pranë Ministrisë së Kulturës, nëpërmjet Memos nr. 4567 prot., datë 23.08.2022 ka kërkuar ngritjen e një grupi pune për të bërë ndryshimet sipas rekomandimeve të APP. Ndryshimet janë miratuar me VKM 708, datë 04.11.2022.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet i **pranuar** dhe i **zbatuar**

MASA ORGANIZATIVE

1.1. Rekomandim: Titullari i Institucionit të marrë masa për ngritjen e një grupi pune me qëllim vlerësimin dhe saktësimin e vlerës së aktiveve afatgjata jo materiale “Toka troje terren”, në administrim të institucionit MK. Nga Drejtorja e Buxhetimit dhe Menaxhimit Financiar (Sektori i Financës) të merren masa për të kontabilizuar dhe paraqitur në pasqyrat financiare vlerën e drejtë të Aktiveve Afatgjata Materiale, menjëherë pas përfundimit të procesit të vlerësimit nga grupi i punës. Të ngrihet një grup pune për të pasqyruar dinamikën dhe lëvizjet e aktiveve afatgjata materiale, të ndërtojë gjurmën e auditimit të këtyre pasurive, duke saktësuar dhe administruar dokumentacionin enevojshëm.

Në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Nga ana e institucionit me Urdhrin e Sekretarit të Përgjithshëm nr. 963, datë 29.12.2022 është ngritur grupi i punës për vlerësimin dhe saktësimin e vlerës ekonomike/financiare së aktiveve afatgjata materiale “toka, troje, terren” në administrim të MK. Sektori i administrimit të aseteve dhe shërbimeve të përgjithshme ka hartuar listën e inventarizimit të pronave me vlerat financiare sipas procesverbaleve dhe akteve të dorëzimit. Ky informacion i është dërguar Drejtorisë së Financës për rakordim dhe vijim procedure.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet i **pranuar** dhe **në proces zbatimi**

2.1. Rekomandim: Nga Drejtoria e Buxhetimit dhe Menaxhimit Financiar (Sektori i Financës) të merren masat që në vijimësi, pyetësi dhe shënimet shpjeguese për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore (formati nr.5), të përgatiten dhe paraqiten në përputhje me standardet kontabël kombëtare dhe ky seksion të plotësohet me të dhëna të sakta për elementë të ndryshme të raportimit financiar të njësisë.

Në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Nga ana e institucionit nuk janë paraqitur evidenca për verifikimin e nivelit të zbatueshmërisë së Rekomandimit.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet i **pranuar** dhe i **pazbatuar**

3.1. Rekomandim: Nga Titullari i Institucionit, të merren masa që pas ardhjes së ftesës nga organizatorët për takime/evente jashtë vendit, të nxirret menjëherë autorizimi i pjesëmarrjes në to, në mënyrë që të minimizohet risku i blerjes së biletave me çmim më të lartë si rezultat i kryerjes së procedurës së prokurimit në data të afërta me datën e nisjes së udhëtimit.

Përgjigjja e institucionit:

Nga ana e institucionit janë marrë masat që çdo praktikë për shërbime jashtë vendit të ketë ftesën e vendit pritës. Janë paraqitur disa praktika në të cilat autorizimi i pjesëmarrjes në takime/evente jashtë vendit është nxjerrë në një periudhë të shkurtër pas marrjes së ftesës.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet i **pranuar** dhe i **zbatuar**.

3.2. Rekomandim: Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të marrë masa që në të gjitha praktikatat për udhëtime dieta për jashtë shtetit, dokumentit të pagesave të bashkëngjitet ftesa e vendit pritës dhe draft agjenda e punimeve.

Në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Nga ana e institucionit janë marrë masa për plotësimin e praktikave për udhëtime dieta për jashtë shtetit, me ftesat e vendit pritës dhe draft agjendës së punimeve

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet i **pranuar** dhe i **zbatuar**

4.1. Rekomandim: Institucioni të ndjekë hapat e mëtejshëm bazuar në konkluzionet e grupeve të inventarizimit për procesin e vlerësimit të aktiveve të propozuara për dalje nga përdorimi në njësinë shpenzuese, duke bërë të mundur kështu përfundimin e procesit të inventarizimit si dhe heqjen nga kontabiliteti referuar masave të cilat do merren për aktivet e vlerësuara për tu nxjerrë jashtë përdorimit.

Në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Institucioni me Urdhrin e Sekretarit të Përgjithshëm nr. 974, datë 30.12.2022 ka ngritur grupin e punës, për vlerësimin për nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të dëmtuara. Grupi i punës nëpërmjet memos nr. 7333/1 prot., datë 26.01.2023, ka sqaruar se procesi i vlerësimit dhe nxjerrjes jashtë përdorimit nuk është përfunduar plotësisht dhe duhet të vijojë pas përfundimit të inventarizimit të vitit 2022.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet i **pranuar** dhe në **proçes zbatimi**.

5.1. Rekomandim: Nëpunësi Zbatues të marrë masat të paraqesë në strukturën e thesarit dokumentacionin justifikues të shpenzimeve për rastet e pagesave ndaj operatorëve ekonomikë, brenda 30 ditëve nga data e faturës origjinale të OE-ik, dhe jo ndryshe, me qëllim respektimin e disiplinës buxhetore dhe shmangien e riskut për krijimin e detyrimeve të prapambetura.

Në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Nga grupi i auditimit janë marrë me përzgjedhje urdhërshpenzime të muajit Dhjetor 2022, në të cilat nuk janë evidentuar tejkalime të afatit 30 ditor të likuidimit të faturave. Nga ana e institucionit do të vijojë të ndiqet praktika e pagesave të faturava brenda 30 ditëve nga data e marrjes së faturës origjinale

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet i **pranuar** dhe në **proçes zbatimi**.

6.1. Rekomandim: Sektori i administrimit të aseteve dhe shërbimeve të përgjithshme të marrë masa që për çdo fletë-udhëtimi të dorëzuar nga shoferet, në fund të muaj të jenë të plotësuara në mënyrë të saktë me të gjithë elementet e nevojshme siç janë 1. intenerari i udhëtimit të përshkruar, 2. kilometrat e udhëtimit të përshkruar si dhe litrat e karburantit të harxhuar për intenerarin e udhëtimit, 3. Punonjësi i MK në me të cilin ka udhëtuar shoferi për arsye pune si dhe firma e tij. Në fund të fletë udhëtimeve të bëhet përmbledhja e kilometrave të përshkruara si dhe litrat e harxhuara.

Në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Fletë udhëtimet dorëzohen çdo muaj para se shoferët të furnizohen me naftë për konsumin mujor duke respektuar elementet e nevojshëm për përlogaritjen e kilometrave të përshkruar prej tyre dhe personat të cilët udhëtojnë. Nga ana e institucionit janë paraqitur një pjesë e fletëve të udhëtimit të vitit 2022, sipas makinave, ku evidentohet plotësimi i tyre me elementët e nevojshëm.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet i **pranuar** dhe i **zbatuar**.

7.1. Rekomandim: Institucioni të marrë masa që në procedurat e ardhshme kur situata është emergjente dhe e pa parashikuar, të mos tejkalohej shuma e lejuar për procedura të kësaj natyre.

Në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Nga ana e institucionit nuk janë paraqitur evidenca për verifikimin e nivelit të zbatueshmërisë së Rekomandimt.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet i **pranuar** dhe i **pazbatuar**

8.1. Rekomandim:

-Nga ana e Ministrisë së Kulturës, të merren masa që në çdo procedurë konkurrimi , llogaritja e fondit limit të bëhet në bazë të ofertave reale dhe të përkojnë në kohën e zhvillimit të procedurës së konkurrimit.

-Nga ana e Ministrisë së Kulturës të ngrihet një grup pune me qëllim verifikimin e planimeve dhe preventivave fillestarë të Kalave, objekte të investimeve.

Në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Nga ana e institucionit nuk janë paraqitur evidenca për verifikimin e nivelit të zbatueshmërisë së Rekomandimit.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet i **pranuar** dhe i **pazbatuar**

9.1. Rekomandim: Nga ana e Ministrisë së Kulturës të ngrihet një grup pune me qëllim evidentimin e ndërhyrjeve që janë bërë në faqen zyrtare të Ministrisë së Kulturës dhe nxjerrjen e përgjegjësve që e kanë shkaktuar këtë situatë.

Në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Nga ana e institucionit nuk janë paraqitur evidenca për verifikimin e nivelit të zbatueshmërisë së Rekomandimit.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet i **pranuar** dhe i **pazbatuar**

10.1. Rekomandim: Nga ana e Ministrisë së Kulturës dhe strukturat përkatëse të merren masa dhe nevojshme për pajisjen me leje ndërtimi ose leje për miratimin e ndërhyrjes nga KKTKM sipas legjislacionit në fuqi për të gjitha projektet në vijimësi.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Nga ana e institucionit nuk janë paraqitur evidenca për verifikimin e nivelit të zbatueshmërisë së Rekomandimit.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet i **pranuar** dhe i **pazbatuar**

11.1. Rekomandim: Ministri i Kulturës të marrë masa për nxjerrjen e urdhrimit për mënyrën e funksionimit të Kolegjiumeve, si kërkesë e Ligjit 10352 “Për Artin dhe Kulturën”, neni 27, pika 2.

Në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Institucioni me urdhërin nr 123, datë 28.02.2023 ka miratuar rregulloren “Për mënyrën e funksionimit të Kolegjiumit”.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet i **pranuar** dhe i **zbatuar**.

12.1. Rekomandim: Ministria e Kulturës të marrë masa për planifikimin dhe trajnimin e punonjësve saj, në lidhje me komponentët e MFK-së dhe veçanërisht për menaxhimin e riskut.

Menjëherë

Përgjigjja e institucionit:

Njësia e Burimeve Njerëzore pranë Drejtorisë së Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve ka hartuar planin e nevojave për trajnim të stafit të MK në bashkëpunim me ASPA-n. Sipas planifikimit të ASPA-s, stafi vijon trajnimet sipas nevojave, specifikisht me shkresën nr. 7330, datë 30.12.2022, është kërkuar që ASPA të planifikojë trajnimin e stafit të MK -së në lidhje me menaxhimin e riskut.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet i **pranuar** dhe i **zbatuar**.

13.1. Rekomandim: Ministria e Kulturës të marrë masa për të nxitur institucionet në varësi të saj të hartojnë dhe miratojnë dokumentin përkatës të gjurmës së auditimit.

Menjëherë

Përgjigjja e institucionit:

Nga ana e institucionit me shkresën e Sekretarit të Përgjithshëm nr.4903 prot., datë 13.09.2022 dhe lëndë: "Hartimi dhe miratimi i gjurmëve specifike të auditimit" , i është kërkuar gjithë subjekteve të varësisë zbatimi i këtij Rekomandim. Aktualisht pranë Sektorin të AB nga 27 institucione varësie, administrohen përgjigjet e 17 prej tyre (IKRTK, DRTK Gjirokastrë, TKEKS Tiranë, DRTK Korçë, MKAM Korçë, TKOBAP, QM Durrës, MHK, DRTK Tiranë, DRTK Berat, IKTK, QKKF&TK, DRTK Vlorë, ZAKPA Apolloni dhe Bylis, TK, QM Berat, QM Krujë).

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet i **pranuar** dhe në **proçes zbatimi**.

14.1. Rekomandim: Ministria e Kulturës të trajtojë me prioritet plotësimin e vendeve vakante, veçanërisht në sektorin e auditimit të brendshëm, me qëllim korrigjimin e parregullsive që vijnë si pasojë e mungesës së burimeve njerëzore në misionet audituese.

Në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Nga ana e institucionit është ndjekur me prioritet plotësimin e vendeve vakante të krijuara apo të mbartura në strukturën dhe organikën e institucionit. Në Sektorin e Auditimit të Brendshëm u plotësua me numrin e nevojshëm të specialistëve, por aktualisht është krijuar përsëri 1 vend vakant për shkak të lëvizjes me procedurën e ngritjes në detyrë të një prej specialistëve. Me shkresën nr. 7105/1 prot., datë 28.12.2022, MK i ka kërkuar DAP, planifikimi i nevojave për rekrutime me qëllim plotësimin e vendeve vakante.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet i **pranuar** dhe në **proçes zbatimi**.

MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1.1. Rekomandim: Nga Ministria e Kulturës të merren masa për arkëtimin e shumës së përfituar padrejtësisht nga operatori ekonomik BOE "6." shpk & "B." shpk në vlerën 95,211 lekë pa tvsh.

Menjëherë

Përgjigjja e institucionit:

Nga ana e institucionit janë njoftuar Operatorët ekonomikë me shkresën nr.740 prot., datë 10.02.2023, por shuma nuk është arkëtuar ende.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe i zbatuar.**

2.1. Rekomandim: Nga Ministria e Kulturës të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 852,265 lekë pa tvsh nga OE “6.” sh.p.k., në cilësinë e sipërmarrësit të punimeve sipas kontratës me nr. 5173 prot., datë 03.12.2020, me objekt “Rikonstruksioni/Rivitalizimi i Magazinave të TKOBAP, nëBrar” (Faza I)”, vlerë kjo që përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit.

Menjëherë

Përgjigjja e institucionit:

Nga ana e institucionit është njoftuar Operatori ekonomik është njoftuar me shkresën 235 prot., datë 19.01.2023. Aktualisht këtij OE nuk i është lëshuar 5% i garancisë deri në momentin e sqarimit të situatës.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe i zbatuar.**

MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1.1. Rekomandim: Nga ana e Ministrisë së Kulturës të merren masa të menjëhershme për ngritjen e grupit të punës për evidentimin e shkaqeve që kanë sjellë mos zhvillimin e projekt zbatimit të kësaj procedure, duke rrezikuar përdorim jo efektiv të fondeve prej 6,833,000 lekë.

Menjëherë

Përgjigjja e institucionit:

Ministria e Kulturës me shkresën nr. 5248 prot., datë 27.09.2022, i është drejtuar IKTK, DRTK Tiranë, DRTK Shkodër, DRTK Berat dhe DRTK Gjirokastër, për caktimin e një eksperti i cili do të jetë pjesë e grupit të punës që do të verifikojë preventivët dhe punimet e kryera. Gjithashtu për punimet elektrike MK, me shkresën nr. 5247 prot, datë 27.09.2022 , i është drejtuar OSHEE për caktimin e një eksperti (Inxhinier elektrik).

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe në proces zbatimi.**

2.1. Rekomandim: Ministria e Kulturës të marrë masat duke ngritur një grup pune për të saktësuar,njoftuar dhe kërkuar nga subjekti OE “R” shpk + “AL. V” shpk, plotësimin e punimeve të pakryera sipas preventivit për vlerën 2,980,544 lekë me efekte negative ndaj buxhetit të shtetit.

Menjëherë

Përgjigjja e institucionit:

Ministria e Kulturës me shkresën nr. 5248 prot., datë 27.09.2022, i është drejtuar IKTK, DRTK Tiranë, DRTK Shkodër, DRTK Berat dhe DRTK Gjirokastër, për caktimin e një eksperti i cili do të jetë pjesë e grupit të punës që do të verifikojë preventivët dhe punimet e kryera. Gjithashtu për punimet elektrike MK, me shkresën nr. 5247 prot, datë 27.09.2022, i është drejtuar OSHEE për caktimin e një eksperti (Inxhinier elektrik).

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** dhe **në proces zbatimi**.

3.1. Rekomandim: Ministria e Kulturës të marrë masat duke ngritur një grup pune për të saktësuar, njoftuar dhe kërkuar nga subjekti OE “R” shpk + “AL. V” shpk, plotësimin e punimeve të pakryera sipas preventivit për vlerën 1,748,264 lekë me efekte negative ndaj buxhetit të shtetit.

Menjëherë

Përgjigjja e institucionit:

Ministria e Kulturës me shkresën nr. 5248 prot., datë 27.09.2022, i është drejtuar IKTK, DRTK Tiranë, DRTK Shkodër, DRTK Berat dhe DRTK Gjirokastër, për caktimin e një eksperti i cili do të jetë pjesë e grupit të punës që do të verifikojë preventivët dhe punimet e kryera. Gjithashtu për punimet elektrike MK, me shkresën nr. 5247 prot, datë 27.09.2022, i është drejtuar OSHEE për caktimin e një eksperti (Inxhinier elektrik).

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** dhe **në proces zbatimi**.

4.1. Rekomandim: Ministria e Kulturës të marrë masat duke ngritur një grup pune për të saktësuar, njoftuar dhe kërkuar nga subjekti OE “R” shpk + “AL.V” shpk, plotësimin e punimeve të pakryera sipas preventivit për vlerën 1,671,440 lekë me efekte negative ndaj buxhetit të shtetit.

Menjëherë

Përgjigjja e institucionit:

Ministria e Kulturës me shkresën nr. 5248 prot., datë 27.09.2022, i është drejtuar IKTK, DRTK Tiranë, DRTK Shkodër, DRTK Berat dhe DRTK Gjirokastër, për caktimin e një eksperti i cili do të jetë pjesë e grupit të punës që do të verifikojë preventivët dhe punimet e kryera. Gjithashtu për punimet elektrike MK, me shkresën nr. 5247 prot, datë 27.09.2022 , i është drejtuar OSHEE për caktimin e një eksperti (Inxhinier elektrik).

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** dhe **në proces zbatimi**.

5.1. Rekomandim: Ministria e Kulturës të marrë masat duke ngritur një grup pune për të saktësuar, njoftuar dhe kërkuar nga subjekti OE “R” shpk + “AL.V” shpk, plotësimin e punimeve të pakryera sipas preventivit për vlerën 1,622,607 lekë me efekte negative ndaj buxhetit të shtetit.

Menjëherë

Përgjigjja e institucionit:

Ministria e Kulturës me shkresën nr. 5248 prot., datë 27.09.2022, i është drejtuar IKTK, DRTK Tiranë, DRTK Shkodër, DRTK Berat dhe DRTK Gjirokastër, për caktimin e një eksperti i cili do të jetë pjesë e grupit të punës që do të verifikojë preventivët dhe punimet e kryera. Gjithashtu për punimet elektrike MK, me shkresën nr. 5247 prot, datë 27.09.2022 , i është drejtuar OSHEE për caktimin e një eksperti (Inxhinier elektrik).

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** dhe **në proces zbatimi**.

6.1. Rekomandim: Ministria e Kulturës të marrë masat duke ngritur një grup pune për të saktësuar, njoftuar dhe kërkuar nga subjekti “L.K” sh.p.k, plotësimin e punimeve të pakryera sipas preventivit për vlerën 551,336 lekë me efekte negative ndaj buxhetit të shtetit.

Menjëherë

Përgjigjja e institucionit:

Nga ana e institucionit me urdhër të Titullarit nr. 812, datë 23.01.2022 është ngritur grupi i punës për verifikimin e planimetrive, verifikimin e preventiit të investimit, saktësimin, njoftimin dhe kërkimin nga subjekti "L.K." plotësimin e punimeve të pakryera.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe në proces zbatimi.**

7.1. Rekomandim: Nga ana e Ministrisë së Kulturës të merren masa të menjëhershme për ngritjen e grupit të punës për evidentimin e diferencave të volumeve dhe certifikimin e tyre në situacionin përfundimtar. Mos evidentimi i diferencave të mësipërme në situacionin përfundimtar i vlerës prej 1,883,454 lekë pa tvsh, nga BOE “C” sh.p.k & “6.” sh.p.k., në cilësinë e sipërmarrësit të punimeve sipas kontratës me nr.2455 prot., datë 12.05.2021 me objekt “Rikonstruksioni/Rivitalizimi i Magazinave të TKOBAP, në Brar” (Faza II)”, përbën efekt negativ ndaj buxhetit të shtetit.

Menjëherë

Përgjigjja e institucionit:

Nga ana e institucionit nuk janë paraqitur evidenca për verifikimin e nivelit të zbatueshmërisë së Rekomandimt.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe i pazbatuar**

MASA DISIPLINORE, ADMINISTRATIVE DHE TË TJERA

Mbështetur në nenin 15, shkronja c dhe nenin 30 të Ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, i rekomandojmë Titullarit të Institucionit që, në përputhje me ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të vlerësojë, shkallën e përgjegjësisë për secilin punonjës të përfshirë, në lidhje me mangësitë dhe shkeljet e konstatuara, të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, si dhe të kërkojë marrjen e masave për personat që vlerësohen me përgjegjësi në këtë raport përfundimtar auditimi.

Përgjigjja e institucionit:

Nga ana e Drejtorisë së Mirëadministrimit të Burimeve Njërëzore, Aseteve dhe Shërbimeve është dërguar memo për vlerësimin e shkallës së përgjegjësisë për secilin punonjës, në lidhje me shkeljet e konstatuara.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe në proces zbatimi.**

KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve në Ministrinë e Kulturës për Raportin Përfundimtar të Auditimit “Për auditimin e përputhshmërisë” dërguar me shkresën nr. 1420/24 prot., datë 18.07.2022 për veprimtarinë nga data 01.01.2020 deri më datë 31.12.2021, rezulton se subjekti i audituar ka respektuar afatin 20 ditor për hartimin e planit të masave për zbatimin e

rekomandimeve në përputhje me kërkesat e nenit 15 shkronja (j) të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, nuk ka respektuar afatin për njoftimin brenda 6 muajve mbi ecurinë e zbatimit të këtyre masave në përputhje me kërkesat e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Konkretisht ecuria e zbatimit të rekomandimeve paraqitet sipas tabelës “*Ecuria e zbatimit të rekomandimeve*”

Rekomandime	Gjithsej		Pranuar		Zbatuar plotësisht		Pjesërisht		Në proces		Pa zbatuar	
	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë
Përmirësime në legjislacionin në fuqi	1	-	1	-	1	-	-	-	-	-	-	-
Organizative	15	-	15	-	5	-	-	-	5	-	5	-
Shpërblim Dëmi	2	947,476	2	947,476	2	947,476	-	-	-	-	-	-
Menaxhimin e Efektivitetit dhe Ekonomicitetit të Fondeve Buxhetore	7	17,290,708	7	17,290,708	-	-	-	-	6	615,407,254	1	1,883,454
Disiplinore	1	-	1	-	-	-	-	-	1	-	-	-
Gjithsej	26	18,238,184	26	18,238,184	8	947,476	-	-	12	615,407,254	6	1,883,454

Sa sipër rezulton se janë dhënë gjithsej 26 rekomandime të cilët janë pranuar plotësisht (100 %), dhe rezultojnë të zbatuar plotësisht 8 rekomandime (30,8 %).

Rekomandim: Për sa më sipër ri kërkojmë që Ministria e Kulturës të marrë të gjitha masat e nevojshme me qëllim zbatimin e të gjitha rekomandimeve që rezultojnë të pazbatuara brenda 3-mujorit të parë të vitit 2024. Si dhe kërkojmë marrjen e masave disiplinore për zyrtarët përgjegjës, në lidhje me rekomandimet e KLSH të pranuar prej institucionit dhe që efektivisht rezultojnë të pa zbatuara. Për të gjitha rekomandimet e tjera, që konsiderohen në proces zbatimi, inkurajohet përsheptimi i realizimit të plotë të tyre.

3.6 AGJENCIA KOMBËTARE E BARNAVE DHE PAJISJEVE MJEKËSORE

PËRMBLEDHJE

Në zbatim të Programit të Auditimit nr. 613/23 datë 06.07.2023 “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e evaduar në 6-mujorin e dytë të vitit 2022”, në ambientet e Agjencisë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore, më datë 31.07.2023, u mbajt aktverifikimi nga audituesit e autorizuar të KLSH-së A.K dhe z. G.H, me përfaqësues nga ana e AKBPM znj. J. B. në cilësinë e Titullarit të Institucionit, znj. M. R. në cilësinë e personit të autorizuar për trajtimin e rekomandimeve të KLSH-së si dhe znj. F. Z. në cilësinë e shefit të sektorit të financës dhe shërbimeve mbështetëse.

Objekti i këtij aktverifikimi është:

Verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të KLSH të lëna me shkresën nr.382/18 datë 16.12.2022 për Raportin Përfundimtar të Auditimit “Për auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” të ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore, sipas programit të auditimit nr.382/1 prot, datë 15.04.2022 për veprimtarinë nga data 01.01.2019 deri më datën 31.12.2021, në lidhje mbi statusin e zbatimit të rekomandimeve, afateve dhe nivelin e zbatueshmërisë së tyre, koherencën e tyre si dhe përgjegjshmërinë menaxheriale referuar standardeve të auditimit.

Auditimi u krye nga:

1. A.K

2. G.H

Auditimi ka filluar më datë 07.07.2023

Auditimi ka përfunduar më datë 31.07.2023

Auditimi është kryer në bazë të programit të auditimit nr. 613/23 datë 06.07.202, me objekt: “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e evaduara në 6-mujorin e dytë të vitit 2022”, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” dhe në zbatim të Rregullores së Procedurave të Auditimit dhe të Manualit për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të auditimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe Regjistrit elektronik institucional, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 67, datë 13.06.2020.

TRAJTIMI I ÇËSHTJEVE TË AUDITIMIT

Nga auditimi i ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, “Mbi auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” për periudhën 01.01.2019 deri më datën 31.12.2021 trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin nr. 235, datë 16.12.2022, të Kryetarit të KLSH-së të cilat janë përcjellë në AKBPM me shkresën nr.382/18, datë 16.12.2022, rezulton se:

I. Hartimi i programit (Plan veprimit) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në nenin 15 shkronja (j) të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”.

Nga auditimi u konstatua se, subjekti ka miratuar planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, duke e dërguar në KLSH me shkresë nr.2814/70 datë 10.01.2023 kjo në përputhje me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” nenit 15, shkronja j.

Sa më sipër rezulton se është zbatuar afati 20 ditor përkthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve.

II. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Në lidhje mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve dhe afatet e përcaktuara, sipas strukturave përgjegjëse, AKBPM nuk ka përgatitur planin e masave të marra lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të miratuara nga Titullari brenda afatit 6 mujor, operuar jo në përputhje me Ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” nenit 30, pika 2 e tij.

Sa më sipër rezulton se nuk është zbatuar afati 20 ditor përkthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve.

III. Realizimi i rekomandimeve

Nga ana e KLSH-së, janë lënë masat, 1 Propozim për Ndryshim apo Përmirësim në Legjislacionin në Fuqi, 25 Masa Organizative, 2 Masa për Shpërblim Dëmi, 2 Masa për Eliminimin e Efekteve Negative të Konstatuara në Administrimin e Fondeve Publike dhe për Menaxhimin me Ekonomicitet, Eficiencë dhe Efektivitet të fondeve publike dhe 1 Masë Disiplinore.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

- a) Për përmirësimin e gjendjes është lënë 1 Propozim Ligjor për ndryshim apo përmirësim, nga ku 2 rekomandime, janë pranuar plotësisht 2 të cilat kanë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon, 1 është zbatuar dhe 1 është në proces zbatimi.
- b) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 25 Masa organizative nga ku 41 rekomandime, të cilat kanë statusin si më poshtë vijon:
- 5 janë papranuar
 - 36 janë pranuar plotësisht, të cilat kanë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon, 14 janë në proces zbatimi, 16 janë zbatuar, 4 janë zbatuar pjesërisht dhe 2 janë të pazbatuara.
- c) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 2 Masa shpërblim dëmi nga ku 2 rekomandime, të cilat kanë statusin si më poshtë vijon:
- 1 janë papranuar
 - 1 është pranuar plotësisht dhe është në proces zbatimi.
- d) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 2 Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike nga ku 2 rekomandime janë pranuar plotësisht 2 të cilat kanë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon,
- 2 është pranuar plotësisht dhe është në proces zbatimi.
- e) Për përmirësimin e gjendjes është lënë 1 Masë Disiplinore nga ku 1 rekomandim, i cili nuk është pranuar.

Më hollësisht, auditimi i ndjekjes së rekomandimeve paraqitet si vijon:

PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI

1.1. Rekomandim: AKBPM në bashkëpunim me MSHMS, të ngrejë një grup pune për nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të neneve 4,9,10,11 dhe 13, të Ligjit nr. 21/2020 Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr.89/2014 “Për pajisjet Mjekësore”.

Në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Ky rekomandim është ezauruar në kohë, nga MSHMS me nxjerrjen e akteve nënligjore si vijon:

Neni 4 - Urdhëri i Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale Nr.249/1, datë 06.05.2022 “Për Miratimin e Udhëzuesit “Për Hetimet Klinike të Pajisjeve Mjekësore”;

Neni 9 - Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.731, datë 02.09.2015 “Rregulli Teknik për Vlerësimin e Konformitetit, Klasifikimin dhe Markimin CE të Pajisjeve Mjekësore”;

Neni 10, dhe Neni 11 - Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.227, datë 13.4.2022, “Për Përcaktimin e Kushteve Specifike të Licencimit, Dokumenteve Shoqëruese, Procedurave të Shqyrtimit, Vlefshmërisë, Procedurave të Pezullimit dhe të Shfuqizimit të Licencës për Prodhuesit dhe Tregtuesit me Shumicë të Pajisjeve Mjekësore në Republikën e Shqipërisë”;

Neni 13 - Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.229 datë 13.4.2022 “Për një ndryshim në Vendimin nr.61 datë 3.2.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e paketave të pajisjeve mjekësore të rimbursueshme”, të ndryshuar.

Komenti i grupit të auditimit:

Referuar dokumentacionit të vendosur në dispozicion nga ana e AKBPM u konstatua prania e VKM konkretisht Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.227, datë 13.4.2022 dhe Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.229 datë 13.4.2022, VKM Nr.731, datë 2.9.2015 dhe Urdhër i Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale Nr.249/1, datë 06.05.2022

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

1.2. Rekomandim: AKBPM në bashkëpunim me MSHMS të ngrejë një grup pune për ndryshimin e pikës 5 të udhëzimit të MSHMS, për të reflektuar saktë kategorinë e klasës së pajisjeve mjekësore në zbatim të Nenit 3 të Ligjit nr.21/2020.

Në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Referuar masave të përcjella nga MSHMS rezulton se:

Ky proces do të realizohet gjatë vitit 2024 me rishikimin e ligjit për pajisjet mjekësore.

Si bashkëpunim mes MSHMS dhe AKBPM (Sektori i Pajisjeve Mjekësore). AKBPM do të propozojë pjesëmarrjen e specialistëve të fushës në grupin e punës që do të ngrihet për këtë qëllim.

Komenti i grupit të auditimit:

Referuar dokumentacionit të vendosur në dispozicion nga ana e AKBPM u konstatua prania e korrespondencës me formë elektronike për bërjen me dije mes punonjësve brenda AKBPM lidhur me situatën e rekomandimeve 1.1 dhe 1.2.

Prej institucionit specifikohet se, Referuar masave të përcjella nga MSHMS rezulton se ky proces do të realizohet gjatë vitit 2024 me rishikimin e ligjit për pajisjet mjekësore, por mungon gjurmë dokumentare e marrjes së sigurisë së arsyeshme mbi zbatueshmërinë e këtij Rekomandim.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

MASA ORGANIZATIVE

1.1. Rekomandim: Nëpunësi autorizues në bashkëpunim me Nëpunësin zbatues të AKBPM, të marrë masa për të hartuar dhe dorëzuar raportet e monitorimit tek Nëpunësi i Parë Autorizues (MSHMS), deri në fund të javës së katërt mbas përfundimit të katër mujorit dhe konkretisht deri në 30 Maj, 30 Shtator, ndërsa raporti vjetor deri në fund të muajit Shkurt të vitit të ardhshëm, sipas të dhënave përfundimtare.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

I pazbatueshëm për arsye se:

Hartimi i raporteve të monitorimit bazuar në nenin 65 të ligjit Nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ku përcaktohet se:

“Monitorimi Nëpunësit autorizues të njërive të qeverisjes qendrore i paraqesin, sa herë që kërkohet, por jo më pak se katër herë në vit, nëpunësit të parë autorizues raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit për performancën financiare, produktet dhe objektivat e realizuar për çdo program të përcaktuar në vitin e parë të dokumentit përfundimtar të programit buxhetor afatmesëm.”-

Monitorimi është detyrim për Organin Epror që në rastin tonë është MSHMS. Mënyra e raportimit janë Tabela- Formatet Tip të përpiluara prej tyre, kur sa herë është kërkuar nga MSHMS janë kryer dhe ndryshimet në planin e buxhetit të AKBPM.

Treguesit e monitorimit janë nën juridiksionin e MSHMS (neni 65 i Ligjit Nr.9936/2008).

Komenti i grupit të auditimit:

Referuar planit të masave dërguar në Kontrollin e Lartë të Shtetit me shkresën nr.2814/70 prot., datë 10.01.2023 rezulton se nga ana e institucionit në kolonën e planit të veprimit lidhur me

këtë rekomandim janë shprehur si të pazbatueshëm, ku me këtë kanë reflektuar mos pranueshmërinë e tyre lidhur me Rekomandimin.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i papranuar** nga subjekti.

2.1. Rekomandim: Nëpunësi autorizues të marrë masa ku të ngrëjë Ekipin e Menaxhimit të Programit, dhe të përcaktojë personat përgjegjës për realizimin e detyrave teknike për zbatimin e procedurave të përgatitjes së kërkesave buxhetore, të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm, të cilat lidhen me programin e tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

1. Është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik: Urdhër i Drejtorit të AKBPM-së Nr.56, datë 21.07.2022 “Mbi ngritjen e Grupit të Menaxhimit Strategjik”.
2. Sektorët teknikë do të marrin masa dhe të hartojnë objektivat dhe programet e punës mbi bazën e të cilave do të hartojnë kërkesat buxhetore për realizimin e tyre.
3. Monitorimi nga niveli i lartë menaxhues
 - 2) Sektorët teknikë do të marrin masa dhe të hartojnë objektivat dhe programet e punës mbi bazën e të cilave do të hartojnë kërkesat buxhetore për realizimin e tyre.
 - 3) Monitorimi nga niveli i lartë menaxhues
 - Zv/Drejtori Teknik;
 - GSM;
 - Sektorët teknikë të AKBPM.

Komenti i grupit të auditimit:

Nga ana e grupit të auditimit në Rekomandimn e lënë në raportin final është specifikuar ngritja e EMP dhe nuk është trajtuar GMS. Ndërkohë që, nga ana juaj kthehet përgjigje lidhur me ngritjen e Grupit të Menaxhimit Strategjik. Të dy këto grupe i gjeni specifikuar rolin dhe funksionet respektive në Ligjin nr.10296 datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pazbatuar**.

2.2. Rekomandim: Nëpunësi zbatues pas mbledhjes së kërkesave buxhetore të hartojë relacionin përkatës i cili përmban, Deklaratën e Politikës së Programit, Produktet e programit si dhe Aktivitetet e programit si dhe të marre masa në hartimin, miratimin dhe dorëzimin në MSHMS të të dy fazave të PBA, fazës strategjike dhe fazës teknike të institucionit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Hartimi, miratimi dhe dorëzimi në MSHMS (sipas afateve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi). NA, NZ.

Më datë 6 Korrik 2023 nga MSHMS janë përcjellë në rrugë elektronike njoftimi në lidhje me “Përgatitjen e PBA (2024-2026)” dhe udhëzimet për mënyrën e plotësimit të formularëve me protokoll hyrës Nr.Prot.2565, datë 11.07.2023. Me delegimin nga NA, me shkresën Nr.Prot.2565/1, datë 11.7.2023 të përpiluar nga NZ u është përcjellë të gjithë sektorëve njoftimi në lidhje me “Hartimin e Projekt-Buxhetit 2024-2026” me qëllim përgatitjen e kërkesave për shpenzime operative dhe investime për periudhën në fjalë bazuar në kërkesat faktike të sektorëve, veçanërisht sektorët teknikë.

(kopje bashkëlidhur).

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces**

zbatimi.

3.1. Rekomandim: AKBPM të marrë masa ku kërkesat buxhetore të çdo drejtorie apo sektori, të hartohen duke pasur parasysh kostot për njësi ekzistuese të produktit si bazë për përcaktimin e kostove për atë produkt për vitet pasardhës, për të shmangur mosrealizimet e fondeve buxhetore. Në këtë mënyrë, përcaktohen marrëdhënie të qarta midis inputeve, aktiviteteve dhe produkteve, bazuar në eksperiencën e viteve të mëparshme, për të llogaritur shpenzimet për politikën ekzistuese.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Grup Pune i ngritur për këtë qëllim sipas nevojës konkrete (punë/mall/shërbim). Në zbatim të Ligjit Nr.162/2020 dhe VKM Nr.285/2021, neni 3/3, në varësi të nevojave, gjatë periudhës shtator – dhjetor të çdo viti, përgatit regjistrin për vitin ushtrimor në vijim, bazuar në ligjin që miraton parashikimet buxhetore afatmesme. Bazuar në parashikimet buxhetore, çdo sektor për plotësimin e nevojave për vitin pasardhës përcaktojnë produktet shoqëruar me kosto, për të shmangur mosrealizimin e fondeve buxhetore.

Konkretisht: Me Urdhrin e Brendshëm Nr.25, datë 21.2.2023 (akt shkresor Nr.Prot.960, datë 21.2.2023) të Drejtorit të AKBPM-së është ngritur Grupi i Punës për prokurimin me objekt: “Shërbime riparimi, mirëmbajtje dhe kalibrimi të aparaturave të laboratorit” i cili duhet të:

Përgatisë listën e aparaturave që do të përfshihen në këtë shërbim;

Hartojë dhe argumentojë specifikimet teknike dhe termat e referencës;

Përlllogarisë dhe argumentojë fondin limit për këtë procedurë, bazuar në specifikimet teknike të objektit që do të prokurohet;

Hartojë sasishtë dhe grafikun e ekzekutimit duke ju referuar VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 63/1, marrëveshje kuadër; Çdo informacion tjetër të nevojshëm për objektin e prokurimit.”

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi.**

4.1. Rekomandim: Institucioni të marrë masa të menjëhershme ku të hartojë rregulloren e brendshme, në mënyrë që çdo pozicion pune dhe punonjës të ketë të përcaktuar detyrat e tij funksionale.

Menjëherë

Përgjigjja e institucionit:

Me Urdhrin e Brendshëm Nr.78, datë 14.9.2022 të Drejtorit të AKBPM-së (akt shkresor Nr.Prot.6715, datë 14.09.2022) është ngritur Grupi i Punës për “Hartimin e Draft Rregullore “Për procedurat, funksionet dhe detyrat standarde të punës së sektorëve të AKBPM”.

Aktualisht është hartuar Drafti i Parë i Projekt-Rregullore dhe është diskutuar nga Grupi i Punës. Është dakortësuar rishikimi sipas sektorëve e në vijim hartimi i draftit final. Në vijim do të përcillet për miratim në MSHM.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar.**

4.2. Rekomandim: AKBPM të koordinohet me MSHMS me qëllim për të miratuar rregulloren

e brendshme të funksionimit të Agjencisë dhe mënyrën që përcaktojnë metodat e brendshme të punës.

Menjëherë

Përgjigjja e institucionit:

Realizimi i këtij Rekomandim lidhet me atë më sipër. Me përfundimin e hartimit të draftit final të Projekt-Rregullores së Brendshme të AKBPM-së do të bëhet përcjellja në MSHMS.

Komenti i grupit të auditimit:

Referuar dokumentacionit të vendosur në dispozicion rezulton se, ky rekomandim është i lidhur me Rekomandimn e mësipërm 4.1, fillimisht duhet finalizuar draft rregullorja e më pas miratimi i saj.

Duke marr parasysh Urdhrin e Brendshëm nr.78 datë 14.09.2022 Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e draft Rregullores “Për procedurat, funksionet dhe detyrat standarde të punës së sektorëve të AKBPM” vlerësojmë se ndodhemi në proces zbatimi të këtij Rekomandim. Por nevojitet të vendoset korrespondencë me MSHMS-në referuar gjetje Rekomandim të mësipërm edhe përgjatë kohës së draftimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

5.1. Rekomandim: AKBPM në bashkëpunim me MSHMS të marrë masa për zhvillimin e procedurave të rekrutimit të personelit për të minimizuar vakancat e krijuara, me qëllim arritjen e një kapaciteti sa më të plotë në personelin e AKBPM dhe si rrjedhojë rritjen e performancës së institucionit në realizimin e objektivave.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Raportimet e fundit janë dërguar me shkresat Nr.Prot.25/20 dt. 21.11.2022 për nevojat urgjente të institucionit dhe me Nr.Prot. 25/21, dt. 30.12.2022 për vendet vakante në AKBPM. Në vijim është bërë raportimi me shkresën nr.1753/1 prot. datë 25.4.2023 me objekt “Kërkesë”.

Aktualisht është bërë plotësimi i pozicioneve të punës për të cilat ka pasur urgjenca apo mungesë në sektorë specifikë. Mbeten 15 vende pune vakante sipas funksioneve organike të pasqyruara në shkresën me Nr.Prot,2814/98, datë 7.7.2023 (dokumentacioni bashkëlidhur).

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

6.1. Rekomandim: Eprorët për çdo sektor të marrin masa të menjëhershme ku në fund të çdo viti kalendarik të kryejnë vlerësimin e rezultateve individuale në punë për çdo nëpunës referuar standardit të vlerësimit të miratuar nga MSHMS për të deklaruar nëse janë arritur objektivat kryesore të punës prej tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Me anë të shkresës Nr.Prot.115,datë 11.01.2021 me objekt “Mbi vlerësimin e arritjeve individuale të punonjësve të AKBPM”, nga Sektori i Burimeve Njerëzore është përcjellë Formati i Vlerësimit të Performancës i miratuar nga Drejtori i AKBPM-së, dhe udhëzimi për plotësimin e tij. Vlerësimi i punonjësve është bërë vetëm nga sektorët si më poshtë:

Sektori i Çështjeve Juridike shkresë Nr.115/1prot., datë 16.02.2023 me objekt “Mbi përcjelljen e Formularit të Vlerësimit të Performancës së punonjësve”;

Sektori i Burimeve Njerëzore shkresë Nr.115/2 prot., datë 17.02.2023 me objekt “Mbi përcjelljen e Formularit të Vlerësimit të Performancës së punonjësve”;

Sektori i Pajisjeve Mjekësore shkresë Nr.115/3 prot., datë 17.02.2023 me objekt “Mbi vlerësimin e arritjeve individuale të specialistëve të Sektorit të Pajisjeve Mjekësore”;

Sektori i Autorizimit për Tregtim dhe Çështjeve Rregullatore shkresë Nr.115/4 prot., datë 25.02.2023 me objekt “Mbi vlerësimin e arritjeve individuale të specialistëve të Sektorit të Autorizimit për Tregtim”.

Sektori i Shpërndarjes së Barnave shkresë Nr.115/5 prot., datë 17.07.2023 me objekt “Mbi përcjelljen e Formularit të Vlerësimit të Performancës së punonjësve”;

Sektori i Financës dhe Shërbimeve mbështetëse shkresë Nr.115/6 prot., datë 17.07.2023 me objekt “Mbi përcjelljen e Formularit të Vlerësimit të Performancës së punonjësve”;

Laboratori Kontrollit shkresë Nr.115/7 prot., datë 17.07.2023 me objekt “Mbi përcjelljen e Formularit të Vlerësimit të Performancës së punonjësve”;

Komenti i grupit të auditimit:

Referuar dokumentacionit të vendosur në dispozicion si dhe përgjigjes së dhënë nga ana e institucionit rezulton se, vlerësimi i punonjësve është bërë vetëm nga 6 sektorë, ndërkohë që Rekomandim i dhënë ka qenë eksplicite në shprehje: Eprorët për çdo sektor të marrin masa të menjëhershme ku në fund të çdo viti kalendarik të kryejnë vlerësimin e rezultateve individuale në punë për çdo nëpunës referuar standardit të vlerësimit të miratuar nga MSHMS për të deklaruar nëse janë arritur objektivat kryesore të punës prej tyre.

Po ashtu grupi auditimit ka specifikuar se vlerësimi duhet kryer sipas formatit të miratuar nga MSHMS ndërkohë nga ana juaj është operuar sipas formatit të miratuar nga ana e AKBPM.

Sektorët në vijim nuk kanë kryer vlerësimi i punonjësve, Sektori Teknologjisë, Informacioni dhe Komunikimi, Sektori i Farmakovigjilencës dhe Sektori Inspektimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **pjesërisht i zbatuar**.

7.1. Rekomandim: AKBPM të marrë masa ku në rast nevojash për ekspert të fushës, të njoftojë dhe bëjë kërkesë pranë MSHMS si Institucioni Epror.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjia e institucionit:

Rekomandim nuk referon kuadrin ligjor ku mbështetet inicimi i kësaj procedure e për pasojë dhe efektiviteti i këtij Rekomandim. Do të përcillet kërkesa formale në MSHMS (rast pas rasti).

Konkretisht:

a) Në zbatim të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, VKM-së Nr.285, 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, dhe akteve të tjera nënligjore të dalë në zbatim të tij, Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore (AKBPM) në cilësinë e “Autoriteti Kontraktor” për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje pulla kontrolli me elementë sigurie për barnat, dhe aksesorë për shtypjen e tyre” ka përcjellë respektivisht pranë MSHMS dhe Shtypshkronjës së Letrave me Vlerë:

- Shkresën me Nr.Prot.890, datë 17.02.2023 me objekt “Kërkesë për vënien në dispozicion të një specialisti fushe”;

- Shkresën me Nr.Prot.890/2, datë 11.05.2023 me objekt “Kërkesë e përsëritur për vënien në dispozicion të një specialisti fushe”; Nga SHLV nuk ka asnjë përgjigje zyrtare

b) Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore (AKBPM) në cilësinë e “Autoriteti Kontraktor” për procedurën e prokurimit me objekt “Shërbime riparimi, mirëmbajtje dhe kalibrimi të aparaturave të laboratorit” ka përcjellë pranë Qendrës Kombëtare Teknike Bio-Mjekësore:

- Me shkresën Nr.Prot.4499/17,datë 02.02.2023 me objekt “Kërkesë për specialisti fushe” AKBPM i është drejtuar MSHMS;
- Me shkresën Nr.Prot.4499/18, datë 13.02.2023 me objekt “Kërkesë për specialisti fushe”. Nga QKTBM është vendosur në dispozicion specialisti i fushës.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

8.1. Rekomandim: Nëpunësi Zbatues të marrë masat të paraqesë në strukturën e thesarit dokumentacionin justifikues të shpenzimeve për rastet e pagesave ndaj operatorëve ekonomikë, brenda 30 ditëve nga data e faturës origjinale të OE-ik, dhe jo ndryshe, me qëllim respektimin e disiplinës buxhetore dhe shmangien e riskut për krijimin e detyrimeve të prapambetura.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Raportimi dhe dorëzimi i dokumentacionit brenda afateve të përcaktuara nga Udhëzimi i Ministrisë të Financave Nr.30/2011, pika 42 e në vijim nga Komisioni i Marrjes në Dorëzim të aktiveve të furnizuara.

Në çdo rast nga NZ pagesa e operatorit ekonomik është dërguar në degën e thesarit menjëherë pas vënies në dispozicion të dokumentacionit dhe proces-verbaleve të marrjes në dorëzim nga grupet e punës të ngarkuar për këtë qëllim. Komisioni i Marrjes në Dorëzim të Aktiveve të Furnizuara të ngarkuar për ndjekjen e kontratave. Sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse.

Komenti i grupit të auditimit:

Nga ana e institucionit grupit të auditimit mbi zbatimin e rekomandimeve ju vendos në dispozicion dokumentacioni justifikues si më poshtë vijon:

- Urdhër Shpenzimi nr.69 datë 04.05.2023 pas marrjes së praktikës dokumentare përbërë nga Memo drejtuar titullarit më datë 04.04.2023; fatura elektronike më datë 13.03.2023; Proces Verbal marrjes në dorëzim të aktiveve të furnizuara më datë 13.03.2023
- Urdhër Shpenzimi nr.45 datë 11.04.2023 pas marrjes së praktikës dokumentare përbërë nga Memo drejtuar shef sektorit të financës dhe shërbimeve mbështetëse më datë 04.04.2023; fatura elektronike më datë 31.03.2023; Proces Verbal marrjes në dorëzim të aktiveve të furnizuara më datë 16.01.2023
- Urdhër Shpenzimi nr.183 datë 19.12.2022 pas marrjes së praktikës dokumentare përbërë nga Memo drejtuar Titullarit më datë 09.12.2022; fatura elektronike më datë më datë 09.12.2022; fatura elektronike më datë 09.12.2022; Proces Verbal marrjes në dorëzim të aktiveve të furnizuara më datë 09.12.2022

Referuar këtij dokumentacioni në 1 nga 3 rastet u konstatua kryerja e pagesës më vonë se afati 30 ditor nga data e faturës së OE-ik.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **pjesërisht i zbatuar**.

9.1. Rekomandim: Titullari i Institucionit të marrë masa për ngritjen e grupit të punës me qëllim vlerësimin dhe saktësimin e vlerës së aktiveve afatgjata materiale “Toka troje terren”, në administrim të institucionit Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore.

Menjëherë

Përgjigja e institucionit:

I pazbatueshëm për arsye se:

Është në kundërshtim me Ligjin Nr.8743, datë 22.02.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”

të azhornuar me Ligjin Nr.9558, datë 8.6.2006, ku përcaktohet shprehimisht se:

Neni 2 “Përkufizime”: “Për qëllimet e këtij ligji, përkufizimet e mëposhtëm kanë këto kuptime:.....b) "Pronë e paluajtshme publike" kuptohet ajo pjesë e pronave të paluajtshme të shtetit që përmbush funksione themelore dhe të pandashme të shtetit dhe që sjell përfitime në favor të publikut të gjerë....-;

Neni 6 “Regjistrimi i pronave të paluajtshme”: - “1.Të gjitha pronat e paluajtshme të shtetit regjistrohen në Regjistrin e Pronave të Paluajtshme në përputhje me ligjin Nr.7843, datë 13.7.1994 “Për regjistrimin e pronave të paluajtshme“. 2. Regjistrimi i Pronave të Paluajtshme bëhet përkatësisht: a) Nga Këshilli i ministrave për pronat në varësi të pushtetit qendror, të cilat regjistrohen me pronar Republikën e Shqipërisë.”-

Neni 10- “Këshilli i Ministrave përcakton, për të gjitha pronat e paluajtshme që mbeten në pronësi të pushtetit qendror, përgjegjësitë e administrimit nga organet e ndryshme shtetërore për administrimin e këtyre pronave”-.

Për rrjedhojë në mungesë të njohjes së pronës me VKM nuk mund të kryhen veprime vlerësimi të tokës apo të ndërtesës së AKBPM-së, deri sa për pronat e MSHMS të dalë akti nënligjor për njohjen dhe rregjistrimin e tyre në zyrat e hipotekës.”- bazuar në Programin e Masave të AKBPM-së, të miratuar për implementimin e rekomandimeve të KLSH-së.

Aktualisht në kuadrin e inicimit të procesit të inventarizimit të pronave nga MSHMS, institucioni pavarësisht se nuk e ka pranuar këtë rekomandim të lënë nga KLSH, ka filluar procedurën për regjistrimin në ASHK të pronës ndërtese dhe truall.

Bazuar në Urdhrin e Brendshëm Nr.40, datë 18.04.2023 “Mbi ngritjen e strukturës së posaçme për inventarizimin, plotësimin, përditësimin dhe ndjekjen e procesit deri në regjistrimin e pronës në regjistrin publik të pasurive të paluajtshme dhe pajisjen me certifikatë pronësie të pasurisë”, është ngritur struktura e posaçme e AKBPM-së që vepron sipas udhëzimeve të MSHMS e unifikuar për të gjitha institucionet e varësisë.

Komenti i grupit të auditimit:

Referuar planit të masave dërguar në Kontrollin e Lartë të Shtetit me shkresën nr.2814/70 prot., datë 10.01.2023 rezulton se nga ana e institucionit në kolonën e planit të veprimit lidhur me këtë rekomandim janë shprehur si të pazbatueshëm, ku me këtë kanë reflektuar mos pranueshmërinë e tyre lidhur me Rekomandimn.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i papranuar** nga subjekti.

9.2. Rekomandim: Nga Sektori i Financës të merren masa për të kontabilizuar dhe paraqitur në pasqyrat financiare vlerën e drejtë të Aktiveve Afatgjata Materiale, menjëherë pas përfundimit të procesit të vlerësimit nga grupi i punës.

Menjëherë

Përgjigjja e institucionit:

I pazbatueshëm për arsye se: Ky rekomandim është i lidhur me arsyetimin e pazbatueshmërisë së Rekomandimn më sipër.

Komenti i grupit të auditimit:

Referuar planit të masave dërguar në Kontrollin e Lartë të Shtetit me shkresën nr.2814/70 prot., datë 10.01.2023 rezulton se nga ana e institucionit në kolonën e planit të veprimit lidhur me këtë rekomandim janë shprehur si të pazbatueshëm, ku me këtë kanë reflektuar mospranueshmërinë e tyre lidhur me Rekomandimn.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i papranuar**.

10.1. Rekomandim: Nga Sektori i Financës të merren masat që në vijimësi, pyetësi dhe

shënime shpjeguese për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore (formati nr.5), të përgatiten dhe paraqiten në përputhje me standardet kontabël kombëtare dhe ky seksion të plotësohet me të dhëna të sakta për elementë të ndryshme të raportimit financiar të njësisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Për vitin 2023 në kuadër të përmbylljes së llogarive vjetore 2022 është plotësuar Formati 5 dhe është shoqëruar me relacion, komente për postet e llogarive ekonomike.

Bashkëlidhur kopje e Formatit 5 që i bashkëlidhet “Pasqyrat financiare për vitin ushtrimor 2022”- me Nr.Prot.18/9, datë 29.3.2023 (me protokoll hyrës Nr.787/265, datë 30.3.2023 i Degës së Thesarit- 8 fletë.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

11.1. Rekomandim: Sektori i shpërndarjes së barnave dhe pajisjeve mjekësore si dhe sektori i autorizimit për tregtim dhe i çështjeve rregullatorë në bashkëpunim me sektorin e inspektimit të marrin masa të menjëhershme, ku të gjithë aplikantët të cilët aplikojnë për shërbimet e ofruara nga AKBPM, të sigurohen fillimisht për likuidimet e tyre kundrejt tarifimit të detyrueshëm, e më pas të marrin shërbimin e kërkuar.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Sektori i Pajisjeve Mjekësore: Kjo procedurë është e rregulluar me programin e përditësuar SIRKB në administrim të AKSHI-it i cili mundëson aplikimin online, e për rrjedhojë faturimi dhe konfirmimi i pagesës bëhet online.

Sektori i Financës dhe SHM: Për shërbimet që u ofrohen subjekteve, në zbatim të Urdhrit të Ministrisë të Shëndetësisë dhe MS, në të cilën thuhet se pagesa duhet të kryhet paraprakisht, është vënë në zbatim aplikimi online me anë të portalit e-Albania, i cili mundëson faturimin me anë të faturës elektronike, pagesa kryhet paraprakisht nga subjekti ngarkohet në sistem, konfirmohet nga specialisti i Sektorit të Financës, e në vijim praktika kalon për shqyrtim pranë Sektorit të Pajisjeve Mjekësore. Bashkëlidhur kopje e printuar e konfigurimit të sistemit nga portali “e-Albania”.

Komenti i grupit të auditimit:

Referuar dokumentacionit të vendosur në dispozicion rezulton se kjo procedurë është e rregulluar vetëm për Sektorin e Pajisjeve Mjekësore me programin e përditësuar SIRKB në administrim të AKSHI-it i cili mundëson aplikimin online, e për rrjedhojë faturimi dhe konfirmimi i pagesës bëhet online, ndërkohë për sektorin e autorizimit për tregtim dhe çështjeve rregullatorë nuk rezulton prania e gjurmës rregulluese të kësaj procedure.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **pjesërisht i zbatuar**.

11.2. Rekomandim: Titullari i institucionit të marrë masa ku për rastet, nga ku aplikanti ka ankumuar për faturim të dyfishtë apo pretendimet se ka gabime në lëshimin e faturës, të kryhet verifikimi i tyre si dhe të bëhen zbritje nga kontabiliteti për të pasur një pasqyrim të saktë të vlerës në lidhje me pasqyrat financiare.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Sektori i Financës dhe SHM: Për shërbimet që u ofrohen subjekteve, për të cilët pagesa duhet

të kryhet paraprakisht, është vënë në zbatim aplikimi on-line me anë të portalit e-Albania, i cili mundëson faturimin me anë të faturës elektronike, pagesa kryhet paraprakisht nga subjekti ngarkohet në sistem, konfirmohet nga specialisti i Sektorit të Financës, e në vijim praktika kalon për shqyrtim në sektor.

Ky rekomandim lidhet me zbatimin e Rekomandimt si më sipër.

Komenti i grupit të auditimit:

Referuar përgjigjes së dhënë nga ana e institucion rezulton se, për shkak të operimit me sistem on line faturimi i dyfishtë automatikisht eliminohet prej sistemit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

11.3. Rekomandim: Nga Sektori i Financës të merren masa ku në mënyrë të vazhdueshme të bëhet njoftimi i sektorëve të cilët shqyrtojnë dokumentacionet për dhënien e shërbimeve si dhe i titullarit të institucionit, në lidhje me pagesat e kryera apo jo nga aplikantët.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Është zbatuar dhe vijon të zbatohet me raportimet e vazhdueshme të Sektorit të Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse në lidhje me faturat, dhe arkëtimet dhe detyrimet e pashlyera drejtuar sektorëve që ofrojnë shërbimet përkatëse në AKBPM.

Komenti i grupit të auditimit:

Referuar dokumentacionit të vendosur në dispozicion, u konstatua prania e shkresës me nr.988 prot., datë 23.02.2023 me objekt “*Informacion mbi fatura të pa likuiduara deri më 31.12.2022*”, në të cilën jepet informacion mbi fatura të pa likuiduara të vitit 2022 dhe detyrime të prapambetura. Shkresë e cila nga Sektori i Financës është dërguar drejtuar Sektorit të Inspektimit, Sektorit të çështjeve Juridike, Sektorit të Autorizimit për Tregtim dhe çështjeve Rregullatore dhe për djepi titullarit të institucionit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

11.4. Rekomandim: Titullari i institucionit të marrë masa të menjëhershme, nga ku të bëhet njoftimi i të gjithë debitorët të cilët vazhdojnë të marrin shërbim nga AKBPM apo subjekteve të tjera debitorë për të arkëtuar vlera prej 3,736,981 lekë. Të ndiqet në mënyrë ligjore vjelja e këtyre të drejtave debitorë të arkëtueshme.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Masat e marra:

1. Azhurnimi i subjekteve debitorë.

2. Saktësimi i listës përfundimtare të debitorëve.

- Me shkresën Nr.Prot.988, datë 23.02.2023 me objekt “*Informacion mbi fatura të pa likuiduara deri më 31.12.2022*”, është azhurnuar lista dhe jemi në proces të njoftimit sipas adresave të subjekteve nga sektorët që ofrojnë shërbime.

- Me shkresën Nr.Prot.988/1, datë 27.02.2023 me objekt “*Kthim përgjigje*” të Sektorit të Çështjeve Juridike është relatuar i hollësishëm informacioni mbi ecurinë e procedurave për ekzekutimin e dënimeve me gjobë që përbëjnë tituj ekzekutiv (faza procedurale aktuale) për vitet 2019-2022 të përmbledhur në tabelat respektive pa ndërhyrë në të dhënat e plotësuara nga Sektori i Financës dhe SHM, dhe duke shtuar në të djathtë kolonën “*Statusi*” të ndarë sipas viteve 2022-2021-2020-2019. (Në proces)

3. Njoftimi për vlerën e detyrimit sipas faturës së lëshuar nga AKBPM.

- Sektorët përkatës që ofrojnë shërbimin.

Komenti i grupit të auditimit:

Referuar dokumentacionit të vendosur në dispozicion, u konstatua prania e shkresës me nr. 988 prot., datë 23.02.2023 me objekt “*Informacion mbi fatura të pa likuiduara deri më 31.12.2022*”, në të cilën jepet informacion mbi fatura të pa likuiduara të vitit 2022 dhe detyrime të prapambetura. Shkresë e cila nga Sektori Financës është dërguar drejtuar Sektorit të Inspektimit, Sektorit të çështjeve Juridike, Sektorit të Autorizimit për Tregëtim dhe çështjeve Rregullatore dhe për dijeni titullarit të institucionit. Në vijim të kësaj praktike ngelet rregullimi i plotë i kuadrit të detyrimeve nga ana e sektorit të financës dhe ndjekja rast pas rasti nga ana e Titullarit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

12.1. Rekomandim: AKBPM, në bashkëpunim me MSHMS, të marrin masa për hartimin dhe miratimin e aktit nënligjor, ku të përcaktohet specifikisht numri i analizave të detyrueshme dhe sondazheve gjatë një viti, të ndara këto sipas subjekteve tregtarë të sektorit farmaceutik.

Menjëherë

Përgjigjja e institucionit:

Institucioni do të marrë masa dhe do të ngrejë grupin e punës për hartimin e projekt-aktit të rekomanduar. Për shkak të ngarkesës së punës të sektorëve që duhet të angazhohen në këtë proces ka qenë e pamundur realizimi në kohë Rekomandimt.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pazbatuar**.

12.2. Rekomandim: AKBPM, të hartojë dhe miratojë procedurën për marrjen e mostrave nga sektori i inspektimit dhe procedurat për të gjithë sektorët për përcjelljen dhe analizimin e tyre nga sektori i laboratorit, me qëllim rritjen e eficiencës dhe efektivitetit të këtyre sektorëve si dhe për garantimin e cilësisë dhe sigurisë së barnave që qarkullojnë në tregun vendas .

Menjëherë

Përgjigjja e institucionit:

Me Urdhrin e Brendshëm Nr.48, datë 09.03.2020 të Drejtorit të AKBPM-së (akt shkresor Nr.Prot.3/155, datë 09.03.2020) është miratuar “Udhëzuesi mbi Procedurat e Marrjes së Mostrave të Barnave për Analizë”.

Ky udhëzues është një akt administrativ i brendshëm i përgatitur me qëllim që të udhëzojë inspektorët e Sektorit të Inspektimit, të cilët ndjekin procedurat e marrjes së mostrave të barnave për analizë nga tregu farmaceutik në përmbushje të misionit të Agjencisë: garantimin e sigurisë dhe cilësisë së barnave që vendosen në treg në RSH -kopje bashkëlidhur.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

12.3. Rekomandim: Sektori i laboratorit të hartojë planin vjetor, duke bashkërenduar veprimtarinë me sektorin e autorizimeve, sektorin e inspektimit dhe sektorin e shpërndarjes së barnave, për të përcaktuar numrin dhe llojin e mostrave që do të merren, si dhe të analizave që do kryhen gjatë një viti, me qëllim fuqizimin dhe rritjen e efektivitetit të aktivitetit të tij.

Menjëherë

Përgjigjja e institucionit:

Referuar këtij Rekomandim dhe në zbatim të Urdhrit të Brendshëm të Drejtorit të AKBPM-së

Nr.5 datë 11.01.2023 (me Nr.Prot.116, datë 11.01.2023) Laboratori i Kontrollit ka përgatitur analizën e veprimtarisë për vitin 2022 si edhe objektivat dhe Planin Vjetor për vitin 2023. (Bashkëlidhur materiali me Nr.116/2 Prot., datë 24.01.2023.)

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

13.1. Rekomandim: Titullari i institucionit në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në rolin e institucionit Epror, të marrë masa të menjëhershme ku të ngrëjë grupin e punës, për të kryer analizimin e nevojave për akreditimin e laboratorit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Me Urdhër të Brendshëm të Drejtorit të AKBPM Nr.24, datë 17.02.2023 (me Nr.Prot.344/2, datë 17.2.2023) është ngritur Grupi i Punës për “Hartimin e strategjisë dhe hapat proceduralë që do të ndiqen për Akreditimin e Laboratorit të Kontrollit”.

Grupi i Punës ka dorëzuar materialin mbi këtë urdhër me Nr.344/3 Prot. datë 10.03.2023 sipas të cilit ndër të tjera citon që nuk disponon asnjë diskutim apo vendim që do të ndiqet për akreditimin e laboratorit, të mos kenë informacion mbi planin vjetor etj.

Në këto kushte Titullari i Institucionit realizoi një takim me Grupin e Punës dhe në vijim u konkludua me vendosjen e masave disiplinore për analistët e këtij grupi.

- “Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna” Urdhër i Brendshëm Nr.31, datë 21.3.2023 (me Nr.Prot.344/5) për analisten A.H.;

- “Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna” Urdhër i Brendshëm Nr.32, datë 21.03.2023 (me Nr.Prot.344/6) për analisten A.Ç.;

Sa më sipër me motivacionin:

1. Për mospërmbushje me korrektësi të detyrave funksionale të ngarkuara nga titullari i institucionit, ardhur si pasojë e tejkalimit të kompetencave të përcaktuara në urdhër duke penguar vijueshmërinë e procedurave për Akreditimin e Laboratorit të Kontrollit;

2. Për shkelje të vazhdueshme të rregullave të Etikës në Administratën Shtetërore, ardhur si rezultat i mosrespektimit të autoritetit të Drejtorit të AKBPM.”-

- “Vërejtje me shkrim” Urdhër i Brendshëm Nr.33, datë 21.03.2023 (me Nr.Prot.344/7) për analisten E.Gj.,

me motivacionin:

Për mospërmbushje me korrektësi të detyrave funksionale të ngarkuara nga titullari i institucionit, ardhur si pasojë e tejkalimit të kompetencave të përcaktuara në urdhër duke penguar vijueshmërinë e procedurave për Akreditimin e Laboratorit të Kontrollit.”

Komenti i grupit të auditimit:

Referuar dokumentacionit të sipërcituar në përgjigjen e institucionit, dokumentacion i cili ju vendos në dispozicion grupit të auditimit për zbatimin e rekomandimeve, risjellmin në vëmendjen Tuaj se, kjo procedurë mban muajin mars ndaj duhen përsheptuar hapat për të ringritur grupin e ri me qëllim finalizimin e zbatimit të Rekomandimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

13.2. Rekomandim: AKBPM referuar konsulencës së Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit, të krijojë një strategji të qartë që do ti duhet ta ndjek për akreditimin e Laboratorit, për të paraprirë një metodologji të mire përcaktuar mbi hapa konkret që institucioni duhet të marrë, për të siguruar saktësinë dhe cilësinë e këtyre analizave.

Përgjigja e institucionit:

Me shkresën Nr.Prot.344, datë 19.01.2023 “Kërkesë për informacion” i jemi drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit (bashkëlidhur shkresa).

Në përgjigje të shkresës së Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit (me protokoll hyrës Nr.Prot.344/1, datë 31.1.2023) dhe pas një takimi të përfaqësuesve të palëve (mes AKBPM dhe DPA) për të avancuar në “Aplikimin për Akreditim të Laboratorit të Kontrollit” një ndër kushtet kryesore që nevojitet për akreditim është kalibrimi i aparaturave të Laboratorit.

Në këto kushte Laboratori i Kontrollit duhet të fokusohet në realizimin e shërbimit të riparimit mirëmbajtjes dhe kalibrimit të aparaturave.

Komenti i grupit të auditimit:

Referuar dokumentacionit të vendosur në dispozicion dhe përgjigjes Tuaj ritheksojmë se, Rekomandim i referohet krijimit të një strategjie të qartë që do ti duhet të ndiqet për akreditimin e Laboratorit. Duke marr parasysh korrespondencën e mbajtur me Drejtorinë e Përgjithshme të Akreditimit dhe kushtin kryesore që nevojitet për akreditim, i cili është kalibrimi i aparaturave të Laboratorit, të operohet mbi këtë frymë për zbatimin e plotë të Rekomandimit të dhënë.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe është **në porces zbatimi**

14.1. Rekomandim: Titullari i institucionit të marr masa, ku për aparaturat të cilat ju ka kaluar afati i kalibrimit të tyre të kryhen shërbimet e duhura nga ku kalibrimi sipas kërkesave të ISO 17025:2017 klauzola 6.4, për të siguruar saktësinë e pajisjeve të testimit me qëllim minimizimin e çdo pasigurie të matjes.

Përgjigja e institucionit:

Bazuar në:

- Ligjin Nr.9875, datë 14.2.2008 “Për metrologjinë” ku përcaktohet shprehimisht se: Neni 4 “Fushat e zbatimit”: Dispozitat e këtij ligji do të zbatohen në ato instrumente matëse, që përdoren për matje në transaksionet tregtare dhe zyrtare, kujdesin shëndetësor, mbrojtjen e mjedisit, rendin publik, sigurinë dhe mbrojtjen e konsumatorit.”;

- Urdhrin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës Nr.195, datë 9.3.2009 “Për Verifikimin Fillestar dhe Pasardhës të Instrumenteve Matëse Ligjërish të Kontrolluara” ku përcaktohet shprehimisht se: Pika 2 “Çdo instrument matës ligjërish i kontrolluar që përdoret brenda territorit shqiptar duhet të kontrollohet sipas afateve të përcaktuara në Aneksin 2.1.”-; Aneksi 2.1 “Tabela e intervaleve të verifikimit periodik të instrumenteve matës ligjërish të kontrolluara”-;

Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë (DPM) ofron shërbimin e kalibrimit vetëm për instrumentet e fushës së masës (grammar dhe peshore) dhe të fushës së temperaturës (banjomari dhe termostat).

Me kërkesën me Nr.Prot.1868, datë 8.3.2022 AKBPM i është drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë për kryerjen e shërbimit të kalibrimit për **11** instrumenta.

Me Urdhër të Brendshëm Nr.19 datë 11.03.2022 u ngrit Grupi i Punës në Laboratorin e Kontrollit për ndjekjen e procedurave për kryerjen e shërbimit të kalibrimit të aparaturave (grammar dhe peshore) (banjomari dhe termostat) deri në finalizimin e procesit kundrejt lëshimit të “Certifikatave të Kalibrimit” të përditësuara.

Specialistët e fushës të autorizuar nga DPM kanë bërë kalibrimin e secilës nga instrumentet e kërkuara, në ambientet e Laboratorit të Kontrollit dhe në prani të Grupit të Punës i ngritur për këtë qëllim, proces ky i finalizuar me lëshimin e “Certifikatave të kalibrimit” të përditësuara

për vitin 2022-2023.

Në zbatim të Urdhrit të Brendshëm të Drejtorit të AKBPM-së Nr.25 datë 21.2.2023 (me Nr.Prot.960) është ngritur Grupi i Punës për prokurimin me objekt: “Shërbime riparimi, mirëmbajtje dhe kalibrimi të aparaturave të laboratorit” i cili duhet të:

Përgatisë listën e aparaturave që do të përfshihen në këtë shërbim;

Hartojë dhe argumentojë specifikimet teknike dhe termat e referencës;

Përlllogarisë dhe argumentojë fondin limit për këtë procedurë, bazuar në specifikimet teknike të objektit që do të prokurohet;

Hartojë sasi të dhe grafikun e ekzekutimit duke ju referuar VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 63/1, marrëveshje kuadër; Çdo informacion tjetër të nevojshëm për objektin e prokurimit.”-

Ky grup pune i ka dorëzuar Titullarit të Institucionit “Relacionin” me Nr.Prot.960/25, datë 08.06.2023, ku citohet se:

Grupi i punës kanë paraqitur tabelat me të gjithë ofertuesit por nuk kanë llogaritur fondin limit sepse mungojnë ofertat për 4 aparatura.

Aparaturat e tjera kanë 3 ose më shumë oferta.

Asnjë ofertues nuk ofron shërbim për të gjitha aparaturat.

Titullari i Institucionit ka deleguar për Zv.Drejtorin Teknik dhe Shefin e Laboratorit të Kontrollit detyrën për ngritjen e një grupi pune në nivel teknik për vlerësimin e materialit dhe nxjerrjen e rezultatit përfundimtar me qëllim realizimin e këtyre shërbimeve, që i paraprijnë procesit për Akreditimin e Laboratorit të Kontrollit.

Me shkresën Nr.Prot.960/25, datë 22.6.2023, Zv.Drejtori Teknik dhe Shefi i Laboratorit të Kontrollit kanë propozuar që për vlerësimin e materialit “Relacion” të ngrihet një grup pune i përbërë nga Shefi i Laboratorit, dy analistë, një ekonomist dhe një jurist (bashkëlidhur material).

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

15.1. Rekomandim: AKBPM në bashkëpunim me MSHMS të marrë masa të menjëhershme që të ngrejë një grup pune të specializuar për vlerësimin e funksionimit të pajisjeve ekzistuese të laboratorit të kontrollit, nga ku referuar këtij relacioni përfundimtar, të gjykohet fillimisht se cilat nga këto pajisje përmbushin funksionin për të cilën ato janë blerë si dhe me pas të kryhet mirëmbajtja dhe kalibrimi i tyre.

Menjëherë

Përgjigjja e institucionit:

Lidhur me procedurën e prokurimit me objekt: “Riparim, mirëmbajtje dhe validim i aparaturave” të Laboratorit të Kontrollit i është bërë kërkesë për specialist fushe.

- Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (Nr.4499/17Prot., datë 2.2.2023).

- Qendrës Kombëtare të Inxhinierisë Bio-Mjekësore (Nr.4499/18Prot., datë 13.2.2023).

Sa më sipër për të vlerësuar pajisjet ekzistuese të Laboratorit të Kontrollit dhe për të përcaktuar shërbimet që kanë nevojë secila pajisje.

Sekretari i Përgjithshëm i MSHMS i është drejtuar Qendrës Kombëtare të Inxhinierisë Bio-Mjekësore dhe Telemjekësisë për të marrë masat për vënien në dispozicion të një specialisti (me shkresën me protokoll hyrës Nr.Prot.4499/19, datë 15.02.2023).

Qendra Kombëtare Teknike Bio-Mjekësore me shkresën me protokoll hyrës Nr.Prot.4499/20, datë 16.02.2023, është përgjigjur duke ofruar për asistencë teknike një nga specialistët e institucionit (B.P.). Qendra Kombëtare Teknike Bio-Mjekësore, Sektori Inxhinierisë Klinike

me anë të shkresës “Kthim përgjigje” me protokoll hyrës Nr.Prot.960/3, datë 16.3.2023 ka dhënë vlerësimin për të gjitha pajisjet (bashkëlidhur dokumentacioni).

Komenti i grupit të auditimit:

Referuar përgjigjes së dhënë nga ana e institucionit si dhe dokumentacionit justifikues vendosur në dispozicion, u konstatua mbajtja e korrespondencës me MSHMS për kërkesë lidhur me specialist fushe. Megjithatë ky proces duhet të vijohet deri në finalizimin e zbatimit të Rekomandimit i cili kërkon ngritjen e një grupi pune të specializuar për vlerësimin e funksionimit të pajisjeve ekzistuese të laboratorit të kontrollit, i cili do të përpilojë relacionin final.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

16.1. Rekomandim: Sa më lart, situata paraqet nevojën imediate për përmbushjen e rolit të MSHMS si organ epror në mirëfunksionimin institucioneve, realizimin e objektivave të miratuara mbi ligjshmërinë dhe përshtatshmërinë e veprimeve të tyre administrative, administrimin e burimeve njerëzore, ekzekutimin e buxhetit, administrimin e pasurive dhe menaxhimin financiar, çka nuk rezulton në rastin konkret.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Zbatimi: Rekomandim i atribuohet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i papranuar** nga subjekti.

17.1. Rekomandim: AKBPM në lidhje me dhënien e autorizimit për tregtim aplikantit “F. G.” sh.p.k, referuar konstatimit nga grupi i auditimit të kërkojë dokumentacion e nevojshëm në lidhje me autorizim për tregtim të “Oksigjen të lëngshëm 100%”, i cili duhet të qarkullojë në njërin nga vendet e Bashkimit Evropian, Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Kanada, Turqi, Zvicër, Izrael, Japoni, Australi dhe Mbretëri e Bashkuar ose të jetë i prodhuar në një nga vendet e Ballkanit, vetëm kur kanë marrë autorizim për tregtim dhe qarkullojnë në vendin e tyre, ose në rast të mos dorëzimit të këtij dokumentacioni të kryej anulimin e autorizimit të tregtim për barin.

Menjëherë

Përgjigja e institucionit:

Referuar Rekomandimit të lënë nga KLSH do të njoftohet specifikisht vetëm subjekti në fjalë për plotësimin e dokumentacionit (aplikanti “F. G.” sh.p.k, AKBPM i cituar në Raportin Përfundimtar të Auditimit)- bazuar në Programin e Masave të AKBPM-së, të miratuar për implementimin e rekomandimeve të KLSH-së.

Me anë të shkresës me Nr.Prot.2814/81, datë 31.01.2023 i janë përcjellë Mbajtësit të Autorizimit për Tregtim (kompanisë LG West Balkan Industrial and Medical Gases Doel Skopje, Republika e Maqedonisë së Veriut), gjetjet dhe kërkesat e KLSH-së në lidhje me barin MEDICAL OXYGEN 100%.

Konkretisht i është kërkuar kompanisë CPP (certifikatë e produktit farmaceutik) në njërin nga vendet e Bashkimit Evropian, Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Kanada, Turqi, Zvicër, Izrael, Japoni, Australi dhe Mbretëri e Bashkuar ose CPP nga një vend i Ballkanit ku edhe prodhohet, ka marrë autorizim tregtimi dhe qarkullon ky bar. Ky informacion i është përcjellë kompanisë edhe në rrugë elektronike me e-mail.

Në datën 24 Maj 2023, kompania përfaqësuese e Mbajtësit të Autorizimit për Tregtim “D.-A. sh.p.k” ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar me anë të shkresës me protokoll hyrës

Nr.Prot.2814/85, datë 24.5.2023. Me dorëzimin e dokumentacionit të kërkuar u lëshua Certifikata e Autorizimit për Tregtim të barit MEDICAL OXYGEN 100% me Nr.Prot.2814/86, datë 25.5.2023 (bashkëlidhur dokumentacioni).

Komenti i grupit të auditimit:

Referuar planit të masave dërguar në Kontrollin e Lartë të Shtetit me shkresën nr.2814/70 prot., datë 10.01.2023 rezulton se nga ana e institucionit në kolonën e planit të veprimit lidhur me këtë rekomandim janë shprehur si të pazbatueshëm, ku me këtë kanë reflektuar mospranueshmërinë e tyre lidhur me Rekomandimn.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti i **zbatuar**.

18.1. Rekomandim: Titullari i Institucionit të marrë masa të menjëhershme nga ku brenda 30 ditëve, pas konfirmimit bankar të pagesës së tarifës përkatëse të subjektit, të lëshojë certifikatën e autorizimit të tregtimit aplikantit, certifikatë e cila është mjeti i vetëm dhe i domosdoshëm zyrtar për të kryer importin e ilaçeve në Republikën e Shqipërisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Janë marrë të gjitha masat për lëshimin e certifikatave brenda 30 ditëve pune, duke impenjuar të gjithë specialistët e sektorit me këtë detyrë. Ky rekomandim ka gjetur zbatim prej Shtatorit 2022.

Gjatë procesit të punës për implementimin e platformës elektronike e-Albania është propozuar lëshimi i Certifikatës së Autorizimit/ Rinovimit për Tregtim online, me akses të menjëhershëm të dokumentacionit që shoqëron këtë certifikatë, për të cilin aktualisht nevojitet kohë fizike e konsiderueshme për t'u përgatitur.

Bashkëlidhur dokumentet provuese:

1. Certifikatë Autorizim për Tregtim Nr.Prot.6875/24, datë 21.11.2022 për barin “TYBICID, Lyophilized powder for solution for infusion x 50mg/vial, box x 10 vial”- Urdhër Ministri Nr.593, datë 21.10.2022;

2. Certifikatë Rinovim Autorizim për Tregtim Nr.Prot.7701/28, datë 2.12.2022 për barin “ZIMAKS, powder for oral suspension, 100mg/5ml, box x 1 plastic bottle”- Urdhër Ministri Nr.610, datë 02.11.2022;

3. Certifikatë Autorizim për Tregtim Nr.Prot. 8683/21, datë 17.2.2023 për barin “SNUP D FOR ADULTS, nasal spray solution (1mg/ml + 50mg/ml), box x 1 plastic bottle”- Urdhër Ministri Nr.25, datë 18.1.2023.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

19.1. Rekomandim: Titullari i Institucionit të marrë masa ku brenda 15 ditëve, pas përfundimit të procedurës doganore për banat e importuara si dhe mbas paraqitjes së kërkesës për barnat e prodhuar në Republikën e Shqipërisë, të kryej pajisjen e barit me pullë e kontrollit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Në përputhje me Nenin 19/1, Nenin 20 të Ligjit Nr.105/2014, dhe VKM Nr.339/2015 operohet rast pas rasti. (shembull)

Importuesi	Autorizim Importi	Autorizim zhdoganimi	Procedura e zhdoganimit	Akt-verifikim/ Kontroll fizik	Autorizim Përdorimi/ Pajisja me pulla (Urdhër shtypi)	Afati (brenda 15 ditëve nga zhdoganimi)
I. sh.p.k. aplikim online	Nr.35115/23.11.2022	datë 24.11.2022	24.11.2022	25.11.2022	Nr.38179, datë 06.12.2022	Në afat

D. P.- AL shpk	Nr.34211/21.07.2022	Nr.prot.5495/3, datë 25.07.2022	28.07.2022	29.07.2022	Nr.37371, datë 01.08.2022	Në afat
F. F. shpk aplikim online	Nr.43652/12.05.2023	datë 16.05.2023	18.05.2023	19.05.2023	Nr.39503, datë 23.05.2023	Në afat

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

20.1. Rekomandim: Titullari i Institucionit të marrë masa për fillimin e procedurave ligjore për ekzekutimin e detyrimeve që lidhen me masat administrative të vendosura për vlerën 7,179,720 lekë. Të ndiqet në mënyrë ligjore vjelja e këtyre të drejtave debitorë të arkëtushme.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Informacionit të datës 06.01.2023 “Analiza e subjekteve debitorë 2019-2020-2021” që i bashkëlidhet Oponencës me shkrim dhe ankesë mbi Rekomandimn e grupit të auditimit të KLSH-së të shefit të Sektorit të Çështjeve Juridike të depozituar pranë KLSH-së më datë 9.1.2023; si dhe,

Informacionit me Nr.Prot.988/1, datë 27.04.2023 të Sektorit të Çështjeve Juridike mbi ecurinë e procedurave për ekzekutimin e dënimeve me gjobë që përbëjnë tituj ekzekutiv (faza procedurale aktuale) për vitet 2019-2022 të përmbledhur në tabelat respektive pa ndërhyrë në të dhënat e plotësuar nga Sektori i Financës dhe SHM, dhe duke shtuar në të djathtë kolonën “Statusi” të ndarë sipas viteve 2022-2021-2020-2019.

Ndjekja e subjekteve debitorë është proces i vazhdueshëm që:

daton në momentin e raportimit të tyre si debitorë nga sektori përkatës deri në ekzekutimin e tyre sipas procedurave ligjore të përcaktuara shprehimisht në ligj (neni 22, neni 23-27, neni 30 i Ligjit Nr.10279 datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”) duke respektuar dhe parashikimet e Nenit 46 të Ligjit Nr.10279/2010 ku përcaktohet shprehimisht se:

“Me përjashtim të rasteve kur ligji i posaçëm parashikon ndryshe, dënimi administrativ, i nxjerrë nga organi i administratës publike, i cili nuk ekzekutohet me kalimin e dy viteve nga data e nxjerrjes së vendimit për kundërvajtjen administrative, parashkruhet. Në këtë rast, organi administrativ, që ka nxjerrë vendimin për kundërvajtjen administrative, me vendim konstaton parashkrimin. Në vendimin, ku konstatohet parashkrimi i dënimit administrativ, listohen Në zbatim të Urdhrit të Brendshëm të Drejtorit të AKBPM-së Nr.46, datë 22.05.2023 me objekt “Mbi ecurinë e programit të masave sipas rekomandimeve të KLSH-së”, të programit të masave të hartuar për këtë qëllim.

Komenti i grupit të auditimit:

Referuar dokumentacionit të vendosur në dispozicion, konkretisht shkresa nr.2814/91 prot., datë 20.06.2023 me informacion mbi ecurinë e rekomandimeve të lëna për zbatim nga KLSH-ja rezulton se në të është përcjell informacion i detajuar mbi subjektet debitorë të paraqitura në raportin final të grupit të auditimit, ku për secilin rast është specifikuar situata respektive. Ende nuk është finalizuar vjelja e këtyre të drejtave debitorë të arkëtueshme.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

21.1. Rekomandim: Titullari i Institucionit të marrë masa të menjëhershme për planifikimin dhe realizimin e inspektimeve për pajisjet mjekësore në spitale, laborator dhe klinikat ku janë të instaluar këto pajisje.

Në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Nga AKBPM janë marrë masa dhe në “Programin e Inspektimit për vitin 2023” do të kryhen

inspektime në këto subjekte si klinika, laborator, etj.. (si inspektime jashtë programi). Pranë Inspektoratit Qendror është dërguar shkresa me Nr.Prot 7257/1 datë 14.10.2022 “Program vjetor 2023”, për të cilin është marrë mendimi këshillimor për zbatimin nga IQ.

Vazhdimisht në përputhje me programin e miratuar (plani i punës për muajin Korrik 2023).

Bashkëlidhur:

- Praktika e inspektimit Nr.AKBPM-DQ-2022-000428-1, datë 10.6.2022 – Klinika “A.B.” sh.p.k. Tiranë;

- Praktika e inspektimit Nr.AKBPM-DQ-2021-000386-1, datë 11.8.2021 – Klinika “K.” sh.p.k. Bilisht-Korçë;

- Praktika e inspektimit Nr.AKBPM-DQ-2021-000387-1, datë 11.8.2021 – Klinika “K.” sh.p.k. Korçë;

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

22.1. Rekomandim: Sektori i Inspektimit të marrë masa ku për medikamentet të cilat gjatë inspektimit konstatohen se janë për përdorim spitalor dhe jo për tu tregtuar të kryhet konfiskimi fizik i tyre, duke çuar deri në fund procedurën e inspektimit.

Në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Bazuar në Raportin Përfundimtar të Mbikëqyrjes Online me Nr.Prot.147/1, datë 29.03.2023 të Inspektoratit Qendror, me protokoll hyrës Nr.Prot.1265/1, datë 31.03.2023, nga mbikëqyrja online e veprimtarisë inspektuese të AKBPM-së për vitin 2022 rezultojnë në total të kryera 1033 inspektime (referuar të dhënave faqe 8-Tabela 1 Të dhëna statistikore për procedurat e inspektimit të kryera në sistemin e-inspektimi për vitin 2022).

Nuk rezultojnë të ketë raste praktikash sipas Rekomandimt “barna për përdorim spitalor”.

Në çdo rast sektori inspektimit në kushtet e evidentimit të rasteve të tilla kryen procedurat në përputhje me legjislacionin në fuqi. Procedura e Sektorit të Inspektimit është deri në konfiskim. Vazhdimisht në përputhje me legjislacionin në fuqi (rast pas rasti).

Komenti i grupit të auditimit:

Referuar Raportit Përfundimtar të Mbikëqyrjes Online me Nr.Prot.147/1, datë 29.03.2023 dhe përgjigjes së marr nga ana e institucionit rezulton se, përgjatë kësaj periudhe nuk ka pasur raste të evidentimit të tregtimit të barnave për tregtim spitalor, referuar kontrolleve me përzgjedhje që janë kryer nga ana e AKBPM. Ky rekomandim do të mbahet në konsideratë rast pas rasti dhe ngelet në vijim për tu verifikuar zbatueshmëria e tij.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

22.2. Rekomandim: Nga AKBPM të merren masa të menjëhershme për inventarizimin e barnave të sekuestruara, ndarjen e barnave sipas qëllimit të përdorimit të tyre duke u bazuar në afatet e përdorimit të tyre.

Menjëherë

Përgjigja e institucionit:

Është kryer inventarizimi nga komisioni përkatës dhe është bërë seleksionimi sipas afatit të përdorimit.

Sqarojmë se: plotësimi i këtij kriteri është i parëndësishëm pasi këto barna kanë destinacion të vetëm asgjësimit, për arsye se në asnjë rast këto barna nuk plotësojnë kushtet për t’u vendosur në treg në RSH, përse kohë nuk kanë autorizim tregtimi dhe autorizim përdorimi dhe vendosja

në treg e tyre është në kundërshtim me Ligjin Nr.105/2014 “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik” të ndryshuar Neni 11/1, Neni 19/1, Neni 20, Neni 32, Neni 61.

E zbatuar në çdo rast të procesit të inventarizimit të barnave në cilësinë “Mall në ruajtje” Aktualisht në ambientet e magazinës janë hapur dy ambiente për sistemimin e barnave që janë në proces gjykimi dhe përbëjnë provë materiale, si dhe ato që janë të skaduara dhe kanë kaluar procesin e regjistrimit.

Janë përpiluar listat dhe ka filluar procesi i inventarizimit për këtë qëllim (Urdhër i Brendshëm i Drejtorit të AKBPM-së Nr.55 datë 27.6.2023 (me Nr.Prot.2433) është ngritur Grupi i Punës për inventarizimin e barnave që kanë statusin “mall në ruajtje” në magazinë).

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

22.3. Rekomandim: Për barnat e skaduara apo dhe në limitet e kohës së përdorimit të tyre, ti kërkohet miratimi dhe bashkëpunimi i menjëhershëm Ministrisë së Mjedisit për asgjësimin e tyre sipas parashikimeve të bëra në ligjin për Mbrojtjen e Mjedisit.

-Procedura e asgjësimit të dokumentohet me dokumentacion shkresor dhe financiar shoqëruar me pamje të qarta fotografike dhe filmike si gjatë daljes së tyre nga ambientet e AKBPM-s si dhe gjatë asgjësimit në vendin e përcaktuar nga Ministria e Mjedisit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

I pazbatueshëm pasi është në kundërshtim me:

- 1) Ligjin Nr.10431, datë 9.6.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”, të ndryshuar me Ligjin Nr.31/2013;
- 2) Ligjin Nr.10463, datë 22.9.2011 “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve”;
- 3) Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.798, datë 29.9.2010 “Për Miratimin e Rregullores “Për Administrimin e Mbetjeve Spitalore”;
- 4) Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.371, datë 11.6.2014 “Për Miratimin e Rregullave për Dorëzimin e Mbetjeve të Rrezikshme dhe të Dokumentit të Dorëzimit të tyre”.

Procedura e asgjësimit të mbetjeve të rrezikshme pjesë e të cilave janë dhe mbetjet spitalore bëhet nga kompanitë e licencuara nga Ministria e Mjedisit për trajtimin dhe asgjësimin e mbetjeve të rrezikshme. Në këto kushte institucioni në cilësinë e Autoritetit Kontraktor duhet të ndjekë procedurat e prokurimit për realizimin e këtij prokurimi me fondet e vëna në dispozicion nga njësia e qeverisjes së përgjithshme sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara për fondet buxhetore.

Sqarojmë se: të gjitha barnat e sekuestruara janë të papërdorshme pasi janë barna të cilat nuk kanë autorizim tregtimi në RSH nga AKBPM, dhe janë vendosur në treg në kundërshtim me ligjin.”- bazuar në Programin e Masave të AKBPM-së, të miratuar për implementimin e rekomandimeve të KLSH-së.

Komenti i grupit të auditimit:

Referuar planit të masave dërguar në Kontrollin e Lartë të Shtetit me shkresën nr.2814/70 prot., datë 10.01.2023 rezulton se nga ana e institucionit në kolonën e planit të veprimit lidhur me këtë rekomandim janë shprehur si të pazbatueshëm, ku me këtë kanë reflektuar mospranueshmërinë e tyre lidhur me Rekomandimin.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i papranuar** nga subjekti.

22.4. Rekomandim: AKBPM të marrë masa nga ku për medikamentet të cilat janë sekuestruar nga ku të cilat janë brenda afateve të përdorimit të tyre të ruhen në kushtet përkatëse apo dhomat

specifike referuar standardeve për ruajtjen e Medikamenteve.

Menjëherë

Përgjigja e institucionit:

Barnat janë sistemuar në magazinën e institucionit në përputhje me kushtet e ruajtjes. Sqarojmë se: plotësimi i këtij kriteri është i parëndësishëm pasi këto barna kanë destinacion të vetëm asgjësimin, për arsye se në asnjë rast këto barna nuk plotësojnë kushtet për t'u vendosur në treg në RSH, përse kohë nuk kanë autorizim tregtimi dhe autorizim përdorimi dhe vendosja në treg e tyre është në kundërshtim me Ligjin Nr.105/2014 "Për barnat dhe shërbimin farmaceutik" të ndryshuar Neni 11/1, Neni 19/1, Neni 20, Neni 32, Neni 61.

Aktualisht në ambientet e magazinës janë hapur dy ambiente për sistemimin e barnave që janë në proces gjykimi dhe përbëjnë provë materiale, si dhe ato që janë të skaduara dhe kanë kaluar procesin e regjistrimit. Magazina nuk ka funksion ruajtjen e tyre për qëllim përdorimi.

Për procesin e ruajtjes së mirë të tyre janë krijuar dy ambiente që plotësojnë kushtet e ruajtjes frigoriferike (barnat që kërkojnë kushte specifike), për barnat e ardhura në Sektorin e Autorizimit për Tregtim dhe Ç.Rr. dhe barnat e ardhura në Laboratorin e Kontrollit.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

23.1. Rekomandim: Titullari i Institucionit të marrë masa ku mos të përcaktojë persona të njëjtë për të njëjtat procedura prokurimi nga ku saktësisht në përbërje të komisioneve, personat përgjegjës për hartimin e dokumenteve të tenderit të mos jenë anëtarë të komisionit të vlerësimit të ofertave.

Në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Për procedurën e prokurimit "Procedurë e Hapur e Thjeshtuar-Mallra-prokurim me mjete elektronike, Marrëveshje Kuadër me 1(një) operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara me objekt "Blerje reagjentë dhe qelqurina për Laboratorin e Kontrollit për mbulimin e nevojave për një periudhë 24-muaj" me REF-63376-03-23-2023, dhe Fond limit: 3,347,500 (tremilion e treqind e dyzetë e shtatë mijë e pesëqind) Lekë pa TVSH.

1. Me Urdhrin e Prokurimit Nr.1, datë 21.3.2023 "Për hapjen e procedurës së prokurimit elektronik: "Blerje reagjentë dhe qelqurina"-Marrëveshje kuadër me afat 24 muaj" të Titullarit të Autoritetit Kontraktor (me Nr.Prot.1349, datë 20.3.2023), pika 4 është përcaktuar si vijon:

Njësia e Prokurimit dhe personi përgjegjës për këtë procedurë prokurimi janë:

E. L. (Spec.Jurist/Person përgjegjës për prokurimet/ Sektori i Çështjeve Juridike)

K. D. (Analist (farmacist)/Laboratori i Kontrollit)

V. M. (Spec. Ekonomist/ Sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse).

2. Me Urdhërin e Titullarit të Autoritetit Kontraktor Nr.34 datë 21.3.2023, të ndryshuar me Urdhër Nr.36, datë 30.3.2023 është ngritur Komisioni i Vlerësimit të Ofertave i përbërë nga:

J. K. Kryetar-Analist, Laboratori i Kontrollit

E. G. Anëtar -Analist, Laboratori i Kontrollit

S. H. Anëtar -Analist, Laboratori i Kontrollit

M. R. Anëtar - Shef Sektori i Çështjeve Juridike

I.G. Anëtar - Specialist ekonomist, Sektori i Financës dhe SHM"

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

23.2. Rekomandim: Titullari i Institucionit të marrë masa, që për çdo procedurë prokurimi të

ngrejë grupe pune për “Hartimin e specifikimeve teknike” me specialistë të fushës si dhe të dokumentojë në çdo rast përcaktimin e specifikimeve teknike apo ndryshimet e tyre.

-Titullari i Institucionit për kontratat e ardhshme të marrë masa ku grupi i punës për specifikimet teknike i përbërë nga specialist i fushës të hartojë elementët e sigurisë së pullës, duke i argumentuar dhe specifikuar secilin prej tyre në një procesverbal për të unifikuar ndryshimet e ndodhura në mënyrë të vazhdueshme.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Në lidhje me pikën 1 të Rekomandimn rezulton e zbatuar si vijon:

a) Me Urdhërin e Brendshëm Nr.25, datë 21.02.2023 (akt shkresor Nr.Prot.960, datë 21.2.2023) të Drejtorit të AKBPM-së është ngritur Grupi i Punës për prokurimin me objekt: “Shërbime riparimi, mirëmbajtje dhe kalibrimi të aparaturave të laboratorit” i cili duhet të:

Përgatisë listën e aparaturave që do të përfshihen në këtë shërbim;

Hartojë dhe argumentojë specifikimet teknike dhe termat e referencës;

Përllogarisë dhe argumentojë fondin limit për këtë procedurë, bazuar në specifikimet teknike të objektit që do të prokurohet;

Hartojë sasisë dhe grafikun e ekzekutimit duke ju referuar VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 63/1, marrëveshje kuadër; Çdo informacion tjetër të nevojshëm për objektin e prokurimit.”-

Me shkresën Nr.Prot.4499/17,datë 02.02.2023 me objekt “Kërkesë për specialisti fushe” AKBPM i është drejtuar MSHMS; Me shkresën Nr.Prot.4499/18, datë 13.2.2023 me objekt “Kërkesë për specialisti fushe”. Nga QKTBM është vendosur në dispozicion specialisti i fushës.

Sekretari i Përgjithshëm i MSHMS i është drejtuar Qendrës Kombëtare të Inxhinierisë Bio Mjekësore dhe Telemjekësisë për të marrë masat për vënien në dispozicion të një specialisti (me shkresën me protokoll hyrës Nr.Prot.4499/19, datë 15.2.2023).

Qendra Kombëtare Teknike Bio-Mjekësore me shkresën me protokoll hyrës Nr.Prot.4499/20, datë

16.2.2023, është përgjigjur duke ofruar për asistencë teknike një nga specialistët e institucionit (B.P.)- referohu zbatimit të Rekomandimt 7.1 dhe 15.1.

Në lidhje me pikën 2 të Rekomandimn rezulton e zbatuar si vijon:

Në zbatim të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, VKM-së Nr.285, 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, dhe akteve të tjera nënligjore të dalë në zbatim të tij, Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore (AKBPM) në cilësinë e “Autoriteti Kontraktor” për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje pulla kontrolli me elementë sigurie për barnat, dhe aksesore për shtypjen e tyre” ka përcjellë respektivisht pranë MSHMS dhe Shtypshkronjës së Letrave me Vlerë:

Me shkresën me Nr.Prot.890, datë 17.02.2023 me objekt “Kërkesë për vënien në dispozicion të një specialisti fushe”;

Me shkresën me Nr.Prot.890/2, datë 11.05.2023 me objekt “Kërkesë e përsëritur për vënien në dispozicion të një specialisti fushe”.

Institucioni deri më tani nuk ka asnjë përgjigje zyrtare nga Shtypshkronja e Letrave me Vlerë. Për rrjedhojë ka qenë e pamundur ngritja e grupit të punës me ekspertë të jashtëm për hartimin e specifikimeve teknike siç rekomandon KLSH.

Komenti i grupit të auditimit:

Në mungesë të gjurmës dokumentare justifikuese të pjesës së dytë të Rekomandimt grupi auditimit nuk mund të shprehet me siguri të arsyeshme mbi statusin e zbatueshmërisë së plotë

të këtij Rekomandim.(lidhur me Rekomandimn 7.1 ekspertët e fushës)

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

24.1. Rekomandim: Nga institucioni të merren masa ku të përgatitet deklarata dhe Raporti Vjetor për Cilësinë e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm si dhe pyetësorin e vetëvlerësimit sipas Ligjit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin si dhe Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollin.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Me miratimin nga GSM (Memo-Infomuese Nr.Prot.2814/94, datë 26.6.2023) të “Strategjisë së Menaxhimit të Riskut në AKBPM” me Nr.Prot.2814/95, datë 26.06.2023, si dhe të formatit të “Regjistrin të Riskut” çdo sektor do të hartojë regjistrin e riskut sipas prioriteteve dhe objektivave afatmesëm të tij.

Komenti i grupit të auditimit:

Referuar dokumentacionit justifikues vendosur në dispozicion, risjellim në vëmendjen tuaj se, Rekomandim i lënë nga grupi auditimit i referohet deklaratës dhe Raportit Vjetor për Cilësinë e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm si dhe pyetësorit të vetëvlerësimit sipas Ligjit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin dhe jo vetëm GSM/Regjistrin të Riskut.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe është **në proces zbatimi**.

24.2. Rekomandim: Të caktohet koordinatori i riskut dhe strategjia e menaxhimit të riskut, për identifikimin, analizimin dhe kontrollin e risqeve që mund të vënë në rrezik përmbushjen e objektivave të AKBPM, të përcaktuara gjatë planifikimit të buxhetit afatmesëm dhe vjetor.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Me miratimin nga GSM të “Strategjisë së Menaxhimit të Riskut në AKBPM” me Nr.Prot.2814/95, datë 26.6.2023, si dhe të formatit të “Regjistrin të Riskut” masat e marra do të vijojnë me:

Hartimin e Regjistrin të Riskut nga çdo sektor sipas prioriteteve dhe objektivave afatmesëm; Caktimin e Koordinatorit të Riskut.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

24.3. Rekomandim: Të monitorohen nga Titullari dhe strukturat e tij, efektiviteti i të gjitha sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të sektorëve dhe të raportohet në vijimësi rezultatet e këtij monitorimi.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Për çdo problematikë që haset gjatë përmbushjes së veprimtarisë së AKBPM të iniciuar me kërkesë të subjekteve apo nga Titullari i Institucionit, problemi delegohet tek Shefi i Sektorit ose/dhe specialisti përkatës, dhe raportohet në rrugë të shkruar (MEMO-Infomuese) tek Titullari i Institucionit përfshirë dhe propozimin për zgjidhjen e problematikës.

Bashkëlidhur kopje e:

- Praktikës së raportimit me Nr.Prot.1345/1, datë 3.4.2023 pranë Titullarit të Institucionit, nga specialisti i Farmakovigjilencë në lidhje me procedurat e shqyrtimit dhe vlerësimit të aplikimit për miratimin e fletëudhëzuesit në gjuhën shqipe të barit “*ELLAONE, film coated tablet x 30mg*”.

- Praktikës së raportimit me Nr.Prot.2475/1, datë 4.7.2023 pranë Titullarit të Institucionit, fillimisht nga inspektorët e Sektorit të Inspektimit, në vijim me shkresën Nr.Prot. 2475/2, datë 11.7.2023 të Sektorit të Shpërndarjes së Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore në lidhje me procedurat e importit dhe vendosjes në treg të barit “Fixnove 1200IU, Faktori IX të koagulimit” për plotësimin e nevojave të QSUNT Tiranë (*problematikë e përcjellë me shkresën nr.prot.875/4, datë 30.6.2023, me prot.hyrës Nr.2475*) e në vijim informimin e Drejtorisë Farmaceutike në MSHMS në lidhje me këtë praktikë me shkresën Nr.Prot.2475/3, datë 12.7.2023.

- Raportit të Kontrollit me Nr.Prot.445/4, datë 26.1.2023 e Grupit të Kontrollit të Brendshëm të ngritur me Urdhër të Drejtorit të AKBPM-së Nr.10, datë 25.1.2023 në lidhje me procedurat administrative të inspektimit, vlerësimin e fakteve dhe rrethanave të bëra prezent në ngjarjen e transmetuar nga emisioni investigativ “Stop-Klan” më datë 25 Janar 2023 për dy inspektorët e Sektorit të Inspektimit dhe nxjerrjen e përgjegjësisë për punëmarrësit në funksion të përmbushjes së detyrimeve kontraktuale sipas legjislacionit në fuqi për marrëdhëniet e punës në RSH.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

25.1. Rekomandim: Nga Titullari i institucionit, në AKBPM, nëpunësi zbatues si dhe përgjegjës i sektorit të financës, të hartohen dhe të miratohen rregullat për gjurmët e auditimit, për procedurat standarde për administrimin e aseteve dhe materialeve të institucionit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Zbatuar në kohë lidhur me procedurat standarde për administrimin e aseteve dhe materialeve të institucionit. Me Urdhër të Drejtorit të AKBPM-së Nr.118, datë 29.12.2021 “Për Miratimin e Rregullores për Menaxhimin dhe Administrimin e Aktiveve në AKBPM” janë miratuar kriteret, rregullat dhe procedurat për menaxhimin e aktiveve të institucionit.

Bashkëlidhur praktikat në zbatim të Urdhërit Nr.118, datë 29.12.2021 me:

- 1) Nr.Prot.322/2, datë 11.7.2023 “Mbi vendosjen në magazinë të aktiveve për rikupero” në zbatim të Urdhërit Nr.118, datë 29.12.2021, të Sektorit të Pajisjeve Mjekësore e shoqëruar me Procesverbalin sipas Aneksit 7 drejtuar Sektorit të Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse;
- 2) Nr.Prot.4736/2, datë 19.7.2022 “Informacion në lidhje me procedurat e dorëzimit të vlerave materiale në ngarkim të Laborantes”, të Laboratorit të Kontrollit e shoqëruar me Procesverbalin e dorëzimit të aktiveve sipas Aneksit 8 drejtuar Sektorit të Burimeve Njerëzore, dhe Sektorit të Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse;
- 3) Nr.Prot.2197, datë 2.6.2023 “Kërkesë për kalimin e aktiveve në magazinë” në zbatim të Urdhërit Nr.118, datë 29.12.2021, të Sektorit të Pajisjeve Mjekësore e shoqëruar me Procesverbalet sipas Aneksit 7 drejtuar Sektorit të Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **pjesërisht i zbatuar**.

25.2. Rekomandim: Të ngrihet një protokoll i brendshëm për korrespondencat midis strukturave lart-poshtë e paralel, apo raportimet e kryera në nivelin e lartë të strukturave pasi kryerja e këtyre veprimeve do të ul riskun e shmangies së përgjegjësisë institucionale të gjithsecilit në realizimin e funksioneve të ngarkuara.

Menjëherë

Përgjigjja e institucionit:

Bashkëpunimi dhe bashkëveprimi i sektorëve të AKBPM-së është realizuar dhe vijon të realizohet nëpërmjet protokollit të AKBPM-së, pas delegimit nga Titullari i Institucionit në përputhje me VKM Nr.103, datë 4.2.1998 “Për rregullat e përgjithshme të punës në administratën shtetërore”.

Administrimi i dokumentacionit hyrës-dalës, dhe i brendshëm, ka qenë dhe vijon të funksionojë i organizuar nëpërmjet “Regjistrit të Korrespondencës” së institucionit që është një dhe i vetëm, sikundër parashikohet në ligjin për Arkivat dhe në normat tekniko-profesionale të shërbimit arkivor në fuqi në RSH”

- referuar “Programit të Masave” të AKBPM-së, të miratuar për implementimin e rekomandimeve të KLSH-së.

Bashkëlidhur kopje e Regjistrit të Korrespondencës- 3 fletë, sipas Formatit tip të miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave që funksionon për korrespondencat hyrëse-dalëse të institucionit dhe ato të brendshme midis sektorëve.

Komenti i grupit të auditimit:

Administrimi i dokumentacionit hyrës-dalës, dhe i brendshëm, funksionon i organizuar nëpërmjet “Regjistrit të Korrespondencës” së institucionit i cili është në proces miratimi.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

MASA SHPËRBLIM DËMI

1.1. Rekomandim: Nga AKBPM të kërkohet në rrugë ligjore arkëtimi i vlerës prej 350,013 lekë i përfituar padrejtësisht nga shpenzimet honorarë për 4 (katër) ekspertët e jashtëm, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjyqimit.

Menjëherë

Përgjigjja e institucionit:

I pazbatueshëm pasi është në kundërshtim me:

- Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë Neni 116 e vijues;
- Ligjin Nr.7961, datë 12.7.1995 ”Kodi i Punës” të ndryshuar, konkretisht: Nenin 11, 12, 21, 23, 24 e vijues, Nenin 109-110 e vijues, Neni 125 e vijues; Neni 140 e vijues, Neni 149 e vijues;
- Kontratat Individuale të Punës respektive me ekspertët e jashtëm të marrë në punë për shkak të profesionit (diplomës universitare), dhe jo për shkak të funksionit organik në institucionin buxhetor. Më sipër referuar “Programit të Masave” të AKBPM-së, të miratuar për implementimin e rekomandimeve të KLSH-së.

Komenti i grupit të auditimit:

Referuar planit të masave dërguar në Kontrollin e Lartë të Shtetit me shkresën nr.2814/70 prot., datë 10.01.2023 rezulton se nga ana e institucionit në kolonën e planit të veprimit lidhur me këtë rekomandim janë shprehur si të pazbatueshëm, ku me këtë kanë reflektuar mospranueshmërinë e tyre lidhur me Rekomandimn.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i papranuar** nga subjekti.

2.1. Rekomandim: Titullari i AKBPM-së të ngrejë një grup pune për analizimin e situatës mbi mungesat e aktiveve referuar raportit të dorëzuar nga grupi i inventarizimit si dhe pas daljes së rezultatit të nxirren përgjegjësit e tyre me qëllim arkëtimin e vlerës prej 4,154,363 lekë.

Menjëherë

Përgjigja e institucionit:

- Është ngritur Grupi i Punës për inventarizimin dhe verifikimin e aktiveve të institucionit (me Urdhër të Drejtorit të AKBPM-së Nr.85, datë 11.10.2022 “Mbi inventarizimin e aktiveve afatgjata materiale, jomateriale dhe financiare”) është ngritur komisioni për inventarizim.
- Zbardhja e rezultatit përfundimtar nga Komisioni i Inventarizimit.

Aktualisht Komisioni ka hartuar listat e aktiveve sipas rezultatit të arritur nga gjendja faktike (fiziku i aktiveve në AKBPM dhe ISHP). Paraqet vështirësi fakti që aktivet janë të vendosura në disa ambiente në ISHP, janë të vjetra, të shkatërruara për shkak të lagështisë dhe mykut që ndodhet në këto ambiente dhe të mbyllura për një kohë relativisht të gjatë (shtator 2020 e deri më tani), dhe jo të ndarë sipas llojit të aktivitetit (orendi zyre, karrike, pajisje laboratorike, pajisje elektronike etj). Kryetari i Komisionit ka kërkuar kohë për zbardhjen e gjendjes fizike me atë kontabël për shkak të kushteve dhe vështirësisë në identifikimin sipas përshkrimit në regjistrat kontabël dhe krahasimin e tyre deri në zbardhjen përfundimtare (*Memo-Informuese e Kryetarit të Komisionit me Nr.Prot.7313/3, datë 09.01.2023*).

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

MASA PËR ELEMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFIÇENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE

1.1. Rekomandim: Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore të marri masa për të kryer ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë nëpërmjet ekzekutimit vullnetar apo të gjejë mekanizmat e nevojshme për arritjen e një marrëveshje me gjyq fituesit për likuidimin e tyre, me qëllim shkëputjen e zyrës përmbartimore duke bërë të mundur reduktimin e shpenzimeve të AKBPM-së.

Përgjigja e institucionit:

Nga Janari 2023 e deri më tani nuk ka asnjë vendim gjyqësor të formës së prerë që përmban detyrime monetare, titull ekzekutiv që të jetë bërë i ekzekutueshëm për organin publik debitor. Vlerësimi rast pas rasti në vijimësi

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

2.1. Rekomandim: Titullari i institucionit për çdo rast të nevojave për pajisje mjekësore, duhet që paraprakisht të bëjë vlerësimin e aparaturave që janë gjendje në këtë laborator, e cila përfshin Instalimin, Vlerësimin dhe Kalibrimin e pajisjeve ekzistuese.

- Titullari i Institucionit të marrë masa, që për çdo procedurë prokurimi të ngrejë grupe pune për “Hartimi i specifikimeve teknike” me specialistë të fushës si dhe të dokumentojë në çdo

rast përcaktimin e specifikimeve teknike.

- Titullari i Institucionit të marrë masa, që në grupin e ngritur për marrjen në dorëzim të pajisjeve të laboratorit të këtij ekspert teknik të fushës për të siguruar cilësinë e pajisjeve. Vlera prej 26,800,800 lekë përbën një shpenzim pa ekonomikitet, efizienz dhe efektivitet për buxhetin e shtetit.

Përgjigja e institucionit:

Së pari: Zbatimi i këtij Rekomandim është në funksion të realizimit të Rekomandim: 7.1 më sipër.

Rekomandim nuk referon kuadrin ligjor ku mbështetet inicimi i kësaj procedure e për pasojë dhe efektiviteti i këtij Rekomandim. Do të përcillet kërkesa formale në MSHMS (rast pas rasti).

Së dyti: Konkretisht:

1. Në zbatim të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, VKM-së Nr.285, 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, dhe akteve të tjera nënligjore të dalë në zbatim të tij, Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore (AKBPM) në cilësinë e “Autoriteti Kontraktor” për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje pulla kontrolli me elementë sigurie për barnat, dhe aksesore për shtypjen e tyre” ka përcjellë respektivisht pranë MSHMS dhe Shtypshkronjës së Letrave me Vlerë:

- Shkresën me Nr.Prot.890, datë 17.02.2023 me objekt “Kërkesë për vënien në dispozicion të një specialisti fushe”;

- Shkresën me Nr.Prot.890/2, datë 11.05.2023 me objekt “Kërkesë e përsëritur për vënien në dispozicion të një specialisti fushe”; Nga SHLV nuk ka asnjë përgjigje zyrtare.

Sekretari i Përgjithshëm i MSHMS me shkresën Nr.Prot.974/1, datë 28.02.2023 ka shprehur dakordësinë për të marrjen e masave për vënien në dispozicion të një specialisti të fushës në shtypshkrimet me karakter sekret (elementë siguri) me protokoll hyrës Nr.Prot.890/1, datë 1.3.2023.

2. Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore (AKBPM) në cilësinë e “Autoriteti Kontraktor” për procedurën e prokurimit me objekt “Shërbime riparimi, mirëmbajtje dhe kalibrimi të aparaturave të laboratorit” ka përcjellë pranë Qendrës Kombëtare Teknike Bio-Mjekësore:

- Me shkresën Nr.Prot.4499/17, datë 2.2.2023 me objekt “Kërkesë për specialisti fushe” AKBPM i është drejtuar MSHMS;

- Me shkresën Nr.Prot.4499/18, datë 13.2.2023 me objekt “Kërkesë për specialisti fushe”. Nga QKTBM është vendosur në dispozicion specialisti i fushës.

Së dyti Zbatimi i këtij Rekomandim është në funksion të realizimit të Rekomandim: 15.1 më sipër.

Lidhur me procedurën e prokurimit me objekt: “Riparim, mirëmbajtje dhe validim i aparaturave” të Laboratorit të Kontrollit i është bërë kërkesë për specialist fushe

- Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (Nr.4499/17Prot., datë 2.2.2023).

- Qendrës Kombëtare të Inxhinierisë Bio-Mjekësore (Nr.4499/18Prot., datë 13.2.2023).

Sa më sipër për të vlerësuar pajisjet ekzistuese të Laboratorit të Kontrollit dhe për të përcaktuar shërbimet që kanë nevojë secila pajisje.

Sekretari i Përgjithshëm i MSHMS i është drejtuar Qendrës Kombëtare të Inxhinierisë Bio-Mjekësore dhe Telemjekësisë për të marrë masat për vënien në dispozicion të një specialisti (me shkresën me protokoll hyrës Nr.Prot.4499/19, datë 15.2.2023).

Qendra Kombëtare Teknike Bio-Mjekësore me shkresën me protokoll hyrës Nr.Prot.4499/20, datë 16.2.2023, është përgjigjur duke ofruar për asistencë teknike një nga specialistët e institucionit (B.P.). Qendra Kombëtare Teknike Bio-Mjekësore, Sektori Inxhinierisë Klinike

me anë të shkresës “Kthim përgjigje” me protokoll hyrës Nr.Prot.960/3, datë 16.3.2023 ka dhënë vlerësimin për të gjitha pajisjet (bashkëlidhur dokumentacioni).

Së treti: Zbatimi i këtij Rekomandim është në funksion të realizimit të Rekomandim: 23.2 më sipër.

1. Me Urdhërin e Brendshëm Nr.25, datë 21.2.2023 (akt shkresor Nr.Prot.960, datë 21.2.2023) të Drejtorit të AKBPM-së është ngritur Grupi i Punës për prokurimin me objekt: “Shërbime riparimi, mirëmbajtje dhe kalibrimi të aparaturave të laboratorit” i cili duhet të:

Përgatisë listën e aparaturave që do të përfshihen në këtë shërbim;

Hartojë dhe argumentojë specifikimet teknike dhe termat e referencës;

Përlllogarisë dhe argumentojë fondin limit për këtë procedurë, bazuar në specifikimet teknike të objektit që do të prokurohet;

Hartojë sasitë dhe grafikun e ekzekutimit duke ju referuar VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 63/1, marrëveshje kuadër; Çdo informacion tjetër të nevojshëm për objektin e prokurimit.”

Me shkresën Nr.Prot.4499/17, datë 2.2.2023 me objekt “Kërkesë për specialisti fushe” AKBPM i është drejtuar MSHMS; Me shkresën Nr.Prot.4499/18, datë 13.2.2023 me objekt “Kërkesë për specialisti fushe”. Nga QKTBM është vendosur në dispozicion specialisti i fushës.

Sekretari i Përgjithshëm i MSHMS i është drejtuar Qendrës Kombëtare të Inxhinierisë Bio-Mjekësore dhe Telemjekësisë për të marrë masat për vënien në dispozicion të një specialisti (me shkresën me protokoll hyrës Nr.Prot.4499/19, datë 15.2.2023).

Qendra Kombëtare Teknike Bio-Mjekësore me shkresën me protokoll hyrës Nr.Prot.4499/20, datë 16.2.2023, është përgjigjur duke ofruar për asistencë teknike një nga specialistët e institucionit (B.Palushaj)- referohu zbatimit të Rekomandim 7.1 dhe 15.1.

2. Në zbatim të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, VKM-së Nr.285, 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, dhe akteve të tjera nënligjore të dalë në zbatim të tij, Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore (AKBPM) në cilësinë e “Autoriteti Kontraktor” për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje pulla kontrolli me elementë sigurie për barnat, dhe aksesore për shtypjen e tyre” ka përcjellë respektivisht pranë MSHMS dhe Shtypshkronjës së Letrave me Vlerë:

Me shkresën me Nr.Prot.890, datë 17.2.2023 me objekt “Kërkesë për vënien në dispozicion të një specialisti fushe”;

Me shkresën me Nr.Prot.890/2, datë 11.5.2023 me objekt “Kërkesë e përsëritur për vënien në dispozicion të një specialisti fushe”; Nga SHLV nuk ka asnjë përgjigje zyrtar

Së katërti: Zbatimi i këtij Rekomandim është në funksion të realizimit të Rekomandim: 23.1 si më sipër.

Për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar-Mallra-prokurim me mjete elektronike, Marrëveshje Kuadër me 1(një) operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara me objekt “Blerje reagentë dhe qelqurina për Laboratorin e Kontrollit për mbulimin e nevojave për një periudhë 24-muaj” me REF-63376-03-23-2023, dhe Fond limit: 3,347,500 (tremilion e treqind e dyzetë e shtatë mijë e pesëqind) Lekë pa TVSH.

Me Urdhërin e Prokurimit Nr.1, datë 21.3.2023 “Për hapjen e procedurës së prokurimit elektronik: “Blerje reagentë dhe qelqurina”-Marrëveshje kuadër me afat 24 muaj” të Titullarit të Autoritetit Kontraktor (me Nr.Prot.1349, datë 20.3.2023), pika 4 është përcaktuar si vijon:

Njësia e Prokurimit dhe personi përgjegjës për këtë procedurë prokurimi janë:

E.L. (Spec.Jurist/Person përgjegjës për prokurimet/ Sektori i Çështjeve Juridike)

K. D. (Analist (farmacist)/Laboratori i Kontrollit)

V.M.(Spec. Ekonomist/ Sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse).

Me Urdhërin e Titullarit të Autoritetit Kontraktor Nr.34 datë 21.3.2023, të ndryshuar me Urdhër Nr.36, datë 30.3.2023 është ngritur Komisioni i Vlerësimit të Ofertave i përbërë nga:

J. K.	Kryetar-Analist, Laboratori i Kontrollit
E. G.	Anëtar -Analist, Laboratori i Kontrollit
S. H.	Anëtar -Analist, Laboratori i Kontrollit
M. R.	Anëtar- Shef Sektori i Çështjeve Juridike
I. G.	Anëtar - Specialist ekonomist, Sektori i Financës dhe SHM”-.

Komenti i grupit të auditimit:

Referuar dokuemntacionit sipërcituar, vendosur në dispozicion nga ana e AKBPM , në vijimësi dhe lidhje edhe me Rekomandimn 7.1 tek Masa Organizative na specifikohet se, vijnë të jenë në pritje për përgjigjen nga ana e shtypshkronjës së letrave me vlerë me qëllim procedimin e mëtejshëm.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**

MASA DISIPLINORE, ADMINSTRATIVE DHE TË TJERA

Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin e Punës apo me statute të parashikuar në ligje të veçanta.

I. Mbështetur në nenin 15 të Ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, si dhe pika 6 e VKM nr.24 datë 14.01.2015 “Për miratimin e strukturës dhe mënyrës së funksionimit e organizimit të AKBPM” i ndryshuar i rekomandojmë Ministrin të Shëndetësisë si titullar i organit qendror të analizojë parregullsitë dhe mangësitë e konstatuara nga KLSH për Titullarët e Agjencisë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit për fillimin e procedurës për dhënien e masës disiplinore.

II. Mbështetur në nenin 15, shkronja c dhe nenin 30 të Ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, i rekomandojmë Titullarit të Institucionit që, në përputhje me nenin 37 të ligjit nr.7961 “*Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë*” i ndryshuar, të vlerësojë, shkallën e përgjegjësisë për secilin punonjës të përfshirë, në lidhje me mangësitë dhe shkeljet e konstatuara, të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, për fillimin e procedurës për dhënien e masës disiplinore nga “*vërejtje*” deri në “*largim*”, për punonjësit (M.R; F.Fh; D.K; L.D; I.G; I.A; A.L; J.N; M.K; R.C)

Përgjigja e institucionit:

I pazbatueshëm- referuar “**Programit të Masave**” të AKBPM-së, të miratuar për implementimin e rekomandimeve të KLSH-së si vijon:

1. Znj. Migena Rizaj në cilësinë e shefe së Sektorit Juridik për vitin 2019-2021, për mangësitë e konstatuara: Për hartimin e 5 (pesë) kontratave të punës me ekspertë të jashtëm dhe shpërblimin e tyre në vlerën 350,013 lekë, bazuar mbi një VKM të shfuqizuar; Mbi mungesën e ndërmarrjes së procedurave ligjore për arkëtimin e shumave dhe detyrimeve të prapambetura, për mos vazhdimin e procedurave të kalimit në mbledhjen me përmbarues për 53 subjekte në vlerën 7,179,720 lekë duke krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit.”- i lidhur me: Argumentimin e: - Rekomandim Nr.29 tek “Masa Organizative”; - Rekomandim Nr.1 tek “Masa Shpërblim Dëmi”:

A) Në lidhje me subjektet debitore bazuar në faktet dhe provat shkresore të vëna në dispozicion të grupit të auditimit, rezultati në lidhje me kategorinë/klasifikimin si “Subjekte në procedurë” nga grupi i auditimit duhet të ishte dhe është:

0(zero) subjekte të pandjekura për vitin 2019-2020-2021;

0(zero) Kërkesa për “Lëshim të Urdhrit të Ekzekutimit” të refuzuara nga Gjykata për vitin

2019-2020-2021;

0(zero)lekë detyrime të pambledhura, e të pa-riskuara për buxhetin e shtetit.

Ndjekja e subjekteve debitorë është një proces i vazhdueshëm që daton në momentin e raportimit të tyre si debitorë nga sektori përkatës deri në ekzekutimin e tyre sipas procedurave ligjore të përcaktuara shprehimisht në ligj, duke respektuar parashikimet e Nenit 46 të Ligjit Nr.10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”.

Procedurat në lidhje me subjektet debitore datojnë më herët se periudha kur grupi i auditimit të KLSH-së ka filluar punën audituese në AKBPM, dhe efektivisht nuk ka as subjekt debitor të pandjekur dhe nuk ekziston asnjë risk për krijimin e të ardhurave të munguara për buxhetin e shtetit sikurse pretendohet nga grupi i auditimit. (*Analizën e munguar të grupit të auditimit rast pas rasti të subjekteve debitore 2019-2020-2021, bazuar në faktet dhe provat shkresore të depozituara pranë KLSH-së).

B) Në lidhje me hartimin e kontratave të punës me ekspertët e jashtëm rezulton se janë zbatuar:

1. Parimet kushtetuese mbi hierarkinë e akteve nënligjore të përcaktuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë Neni 116 e vijues;
2. Dispozitata ligjore të parashikuara shprehimisht në Ligjin Nr.7961, datë 12.7.1995 ”Kodi i Punës” të ndryshuar, konkretisht: Nenin 11, 12, 21, 23, 24 e vijues, Nenin 109-110 e vijues, Neni 125 e vijues; Neni 140 e vijues, Neni 149 e vijues,

Nuk ka rast për përgjegjësi disiplinore sipas Nenit 37 të Kodit të Punës.

2. Znj. F. Dh. në cilësinë e nëpunësit zbatues për Vendimet gjyqësore të cilat nuk janë ekzekutuar vullnetarisht nga AKBPM, por janë kryer në bazë të urdhër ekzekutimeve të lëshuara nga përmbartuesit privat duke paguar tarifa përmbartimore në vlerën 148,123 lekë; Në cilësinë e kryetarit të grupit, për mos zbatim të urdhrit të ngritur nga Titullari i Institucionit me shkresë nr.9373/4 datë 24.04.2019 komisionin e vlerësimit të aktiveve për dalje nga përdorimi; Për likuidimit të faturave duke tejkaluar afatin ligjor 30 ditor, Për mos hartim dhe dorëzim të raporteve të monitorimit; Për mos pasqyrim në kontabilitet të vlerës së tokës-truall, Tejkallim i ndjeshëm i kërkesave buxhetore; Mos hartim dhe dorëzim i fazës së parë të PBA.”- i lidhur me:

Argumentimin e: - Rekomandimt Nr.1, Nr.2, Nr.3, Nr.4, Nr.10, Nr.11, Nr.12, Nr.16, Nr.17 tek “Masa Organizative”; - Rekomandimt Nr.2 tek “Masa Shpërblim Dëmi”

A) Bazuar në parimin kushtetues: Organet e shtetit janë të detyruara të ekzekutojnë vendimet gjyqësore (Neni 142/3 i Kushtetutës së RSH), dhe faktit që është në disponim të Gjykatës të shprehet se kur vendimi gjyqësor kthehet në titull ekzekutiv dhe kush e ekzekuton atë (praktikë e konsoliduar e Gjykatës Kushtetues) rezulton se:

Vendimet gjyqësore janë ekzekutuar në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara shprehimisht për Titujt Ekzekutivë në Kodin e Procedurës Civile, dhe Urdhërin e Kryeministrit Nr.1/2014 “Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njëjësive të qeverisjes së përgjithshme për llogari të thesarit” dhe pikën 60 të Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë Nr.9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” të ndryshuar.

Në lidhje me respektimin e afateve të likjudimit të faturave për arsytet e kundërshtuara me shkrim (Nr.2814/36prot. dt.15.07.2022), në lidhje me Akt-Konstatimin Nr.3 të Znj.F. Z.(Dh.) Shef i Sektorit të Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, dhe me shkresën “Shpjegime dhe komente me shkrim në lidhje me “Projekt Raportin e Auditimit të KLSH-së” me Nr.Prot.382/11, datë 15.09.2022” të subjektit të audituar Nr.Prot.2814/65, datë 18.10.2022.

B) Në lidhje me raportet e monitorimit për arsytet e kundërshtuara me sipër në pikën "Masa Organizative"- Rekomandim Nr.1, duke qenë se: Treguesit e monitorimit janë nën juridiksionin e MSHMS (neni 65 i Ligjit Nr.9936/2008) të kundërshtuara me shkrim me

Nr.2814/33prot. dt.15.07.2022 dhe me shkresën “Shpjegime dhe komente me shkrim në lidhje me “Projekt Raportin e Auditimit të KLSH-së” me Nr.Prot.382/11, datë 15.09.2022” të subjektit të audituar Nr.Prot.2814/65, datë 18.10.2022.

C) Në lidhje me mospaqyrimin në kontabilitet të vlerës tokë-truall rezulton se: Në mungesë të njohjes së pronës me VKM nuk mund të kryhen veprime vlerësimi të tokës apo të ndërtesës së AKBPM-së, deri sa për pronat e MSHMS të dalë akti nënligjor për njohjen dhe regjistrimin e tyre në zyrat e hipotekës, dhe me shkresën “Shpjegime dhe komente me shkrim në lidhje me “Projekt Raportin e Auditimit të KLSH-së” me Nr.Prot.382/11, datë 15.09.2022” të subjektit të audituar Nr.Prot.2814/65, datë 18.10.2022.

D) Në lidhje me moshartimin dhe mosdorëzimin e fazës së parë të PBA rezulton se janë argumentuar me shkrim në kundërshtimet me shkrim në lidhje me Akt-Konstatimin Nr.1 të Znj.F. Z. (Dh.) Shef i Sektorit të Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse në kundërshtimet me shkrim (Nr.2814/33prot. dt.15.07.2022), dhe me shkresën “Shpjegime dhe komente me shkrim në lidhje me “Projekt Raportin e Auditimit të KLSH-së” me Nr.Prot.382/11, datë 15.09.2022” të subjektit të audituar Nr.Prot.2814/65, datë 18.10.2022.

Në këto kushte nuk ka rast për përgjegjësi disiplinore sipas nenit 37 të Kodit të Punës.

3. Znj. D. K., Kryetar, njësisë së prokurimit në procedurën “Blerje pullash, kontrolli me elementë sigurie për barnat dhe aksesoret për shtypjen e tyre”.

Punëmarrësi në fjalë nuk është pjesë e personelit të AKBPM-së që prej Shtatorit të vitit 2019.

4. Znj. L. D., Anëtar të njësisë së prokurimit në procedurën “Blerje pullash, kontrolli me elementë sigurie për barnat dhe aksesoret për shtypjen e tyre”.

5. Znj. I. G., Anëtar të njësisë së prokurimit në procedurën “Blerje pullash, kontrolli me elementë sigurie për barnat dhe aksesoret për shtypjen e tyre”.

Janë respektuar detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi në atë kohë për prokurimin publik- referuar kundërshtimeve me shkrim (Nr.2814/46prot. dt.15.07.2022), në lidhje me Akt-Konstatimin Nr.9 të Znj.L. D. dhe znj.I. G. (Njësia e Prokurimit për prokurimin me objekt “Blerje pulla kontrolli me elementë sigurie për barnat dhe aksesore për shtypjen e tyre- viti 2019”.

Në këto kushte nuk ka rast për përgjegjësi disiplinore sipas nenit 37 të Kodit të Punës.

6. Z. I. A., inspektorë të sektorit të inspektimeve.

7. Z. A. L. me detyrë inspektorë të sektorit të inspektimeve

8. Z. J. N. me detyrë inspektorë të sektorit të inspektimeve.

Punëmarrësit janë proceduar në rrugë disiplinore në kohën e konstatimit të kësaj shkelje-referuar kundërshtimeve me shkrim (Nr.2814/43prot. dt.15.07.2022), në lidhje me Akt-Konstatimin Nr.8 të Z.I. A., Z.A. L. dhe Z.J. N.

Në këto kushte nuk ka rast për përgjegjësi disiplinore për të njëjtën shkelje sipas nenit 37 të Kodit të Punës.

9. Znj Mikaela Kolaci me detyrë specialiste në sektorin e Autorizimit për Tregtim dhe i Çështjeve rregullatore.

10.Znj. Ranela Ceci me detyrë specialiste në sektorin e Autorizimit për Tregtim dhe i Çështjeve rregullatore”- i lidhur me:

Argumentimin e: - Rekmandimit Nr.17.1 tek “Masa Organizative”.

Kriteret ligjore të vlerësimit të dosjes së barit “Oksigjen i lëngshëm” dhe të dosjeve të barnave analoge me rastin me aplikant MAH nga vendet e Ballkanit, është bërë në përputhje me detyrimet e përcaktuara në Nenin 12, pika 2/c, dhe të mbështetura në ligj dhe VKM mbi bazën e të cilave është autorizuar për tregtim edhe bari në fjalë- referuar:

a) kundërshtimeve me shkrim (Nr.2814/41prot. dt.15.07.2022), në lidhje me Akt-Konstatimin Nr.6 të Znj. J. B. (Drejtor i AKBPM-së), Znj. M. K. (Shef i Sek. të Autorizimit për Tregtim

dhe Çështjeve Rregullatore) dhe Znj.Ranela Ceci (specialist, farmacist Sek.i Autorizimit për Tregtim dhe Çështjeve Rregullatore);

- b) shkresës “Shpjegime dhe komente me shkrim në lidhje me “Projekt Raportin e Auditimit të KLSH-së” me Nr.Prot.382/11, datë 15.09.2022” të subjektit të audituar Nr.Prot.2814/65, datë 18.10.2022.

Në këto kushte nuk ka rast për përgjegjësi disiplinore sipas nenit 37 të Kodit të Punës.

Komenti i grupit të auditimit:

Referuar planit të masave dërguar në Kontrollin e Lartë të Shtetit me shkresën nr.2814/70 prot., datë 10.01.2023 rezulton se nga ana e institucionit në kolonën e planit të veprimit lidhur me këtë rekomandim janë shprehur si të pazbatueshëm, ku me këtë kanë reflektuar mospranueshmërinë e tyre lidhur me Rekomandimn.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i papranuar nga subjekti**.

KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve në Drejtorinë e Përgjithshme të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore për Raportin Përfundimtar të Auditimit “Për auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” dërguar me shkresën nr.382/18 prot., datë 16.12.2022, rezulton se subjekti i audituar ka respektuar afatin 20 ditor për hartimin e planit të masave për zbatimin e rekomandimeve në përputhje me kërkesat e nenit 15 shkronja (j) të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, por nuk ka njoftuar brenda 6 muajve mbi ecurinë e zbatimit të këtyre masave, në kundërshtim me kërkesat e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Konkretisht ecuria e zbatimit të rekomandimeve paraqitet sipas tabelës “*Ecuria e zbatimit të rekomandimeve*”

lekë

Rekomandime	Gjithsej		Pranuar		Zbatuar plotësisht		Pjesërisht		Në proces		Pa zbatuar	
	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë
Përmirësim Ligjor	2	-	2	-	1	-	-	-	1	-	-	-
Organizative	41	-	36	-	16	-	4	-	14	-	2	-
Shpërbllim dëmi	2	4,504,376	1	4,154,363	-	-	-	-	1	4,154,363	-	-
Eliminim Efekteve Negative	2	26,948,923	2	26,948,923	-	-	-	-	2	26,948,923	-	-
Disiplinore	1	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Gjithsej	48	31,453,299	41	31,103,286	17	-	4	-	18	31,103,286	2	-

Sa sipër rezulton se janë dhënë gjithsej 48 rekomandime të cilët janë pranuar plotësisht 41 rekomandime (83%), dhe rezultojnë të zbatuar plotësisht 17 masa (41.5%).

Për të gjitha rekomandimet që konsiderohen në proces zbatimi, inkurajohet përshpejtimi i realizimit të plotë të tyre.

Për sa më sipër ri kërkojmë që Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore të marrë të gjitha masat e nevojshme me qëllim zbatimin e të gjitha rekomandimeve që rezultojnë të zbatuara pjesërisht dhe të pazbatuara brenda 3-mujorit të parë të vitit 2024. Si dhe kërkojmë marrjen e masave disiplinore për zyrtarët përgjegjës, në lidhje me rekomandimet e KLSH të pranuar prej institucionit dhe që efektivisht rezultojnë të pa zbatuara.

3.7 AGJENCIA KOMBËTARE E BURIMEVE NATYRORE

PËRMBLEDHJE

Në zbatim të Programit të Auditimit nr.613/25 prot., datë 06.07.2023 “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e evaduara në 6-mujorin e parë të vitit 2021”, në ambientet e Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, më datë 31.07.2023, u mbajt aktverifikimi nga audituesit e autorizuar të KLSH-së S.K dhe J.K, me z. A. B.në cilësinë e Titullarit të institucionit, Drejtor Ekzekutiv.

Objekt i këtij akt verifikimi është:

Verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të KLSH të lëna me shkresën nr.1418/15 datë 19.07.2022 për Raportin Përfundimtar të Auditimit “Për auditimin e përputhshmërisë” të ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore, sipas programit të auditimit nr. 1418/1, datë 12.01.2022, për veprimtarinë nga data 01.09.2018 deri me datë 31.12.2021, në lidhje mbi statusin e zbatimit të rekomandimeve, afateve dhe niveli i zbatueshmërisë së tyre, koherencën e tyre si dhe përgjegjshmërinë menaxheriale referuar standardeve të auditimit.

Auditimi u krye nga:

1. S.K
2. J.K

Auditimi ka filluar më datë 07.07.2023

Auditimi ka përfunduar më datë 27.07.2023

Auditimi është kryer në bazë të Programit të Auditimit të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit nr.613/25 prot., datë 06.07.2023 me objekt: “Mbi verifikimin e zbatimi të rekomandimeve”, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” si dhe në zbatim të Rregullores së Procedurave të Auditimit dhe të Manualit për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të auditimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe Regjistrit elektronik institucional, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 67, datë 13.06.2020.

TRAJTIMI I ÇËSHTJEVE TË AUDITIMIT

Nga auditimi i ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, “Mbi auditimin e përputhshmërisë” për periudhën 01.09.2018 deri me datë 31.12.2021 trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin nr.115, datë 18.07.2022, të Kryetarit të KLSH-së të cilat janë përcjellë me shkresën nr. 1418/15 datë 19.07.2022, rezulton se:

I. Hartimi i programit (Plan veprimit) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në nenin 15 shkronja (j) të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”.

Nga auditimi u konstatua se, subjekti ka miratuar planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, duke e dërguar në KLSH me shkresë nr.216/41 datë 04.08.2022 kjo në përputhje me me ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” nenit 15, shkronja j.

Sa më sipër rezulton se është zbatuar afati 20 ditor për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve.

II. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Në lidhje mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve dhe afatet e përcaktuara, sipas strukturave

përgjegjëse, AKBN ka përgatitur planin e masave të marra lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të miratuara nga titullari brenda afatit 6 mujor duke e dërguar në KLSH me shkresë nr.87 prot., datë 09.01.2023, kjo në përputhje me ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” nenit 30.

Sa më sipër rezulton se është zbatuar afati 6 mujor për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve.

III. Realizimi i rekomandimeve

Nga ana e KLSH-së, me shkresat përcjellëse janë 1 Masë përmirësime në legjislacionin, 40 Masa Organizative, 1 masë për menaxhimin e Efektivitetit dhe Ekonomicitetit të Fondeve Buxhetore, 1 masë Disiplinore.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

- a) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 1 masë për Propozime ndryshime ose Përmirësim të legjislacionit në fuqi nga ku 1 rekomandim, i cili ka statusin e ecurisë në proces zbatimi.
- b) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 40 Masa organizative me 52 rekomandime, nga ku janë pranuar plotësisht 52 të cilat kanë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon, 34 Zbatuar, 2 pa zbatuar, 12 në proces zbatimi dhe 4 zbatuar pjesërisht.
- c) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 1 Masa për menaxhimin e Efektivitetit dhe Ekonomicitetit të Fondeve Buxhetore nga ku 1 rekomandime të cilat janë pranuar plotësisht dhe ka statusin e ecurisë së zbatimit si vijon, 1 zbatuar pjesërisht.
- d) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 1 Masë Disiplinore nga ku 1 rekomandim, i cili ka statusin e ecurisë së zbatimit si vijon, 1 zbatuar.

Më hollësisht, auditimi i ndjekjes së rekomandimeve në AKBN paraqitet si vijon:

Nga ana e KLSH-së, me shkresat përcjellëse janë 1 Masë përmirësime në legjislacionin, 40 Masa Organizative, 1 masë shpërblim dëmi, 1 masë për menaxhimin e Efektivitetit dhe Ekonomicitetit të Fondeve Buxhetore, 1 masë Disiplinore.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

- a) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 1 masë për Propozime ndryshime ose Përmirësim të legjislacionit në fuqi nga ku 1 rekomandim, i cili ka statusin e ecurisë i zbatuar.
- b) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 40 Masa organizative me 52 rekomandime, nga ku janë pranuar plotësisht 52 të cilat kanë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon, 36 Zbatuar, 2 pa zbatuar, 10 në proces zbatimi dhe 4 zbatuar pjesërisht.
- c) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 1 Masa për menaxhimin e Efektivitetit dhe Ekonomicitetit të Fondeve Buxhetore nga ku 1 rekomandime të cilat janë pranuar plotësisht dhe ka statusin e ecurisë së zbatimit si vijon, 1 zbatuar.
- d) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 1 Masë Disiplinore nga ku 1 rekomandim, i cili ka statusin e ecurisë së zbatimit si vijon, 1 zbatuar.

A. MASA PËR PROPOZIME PËR NDRYSHIME OSE PËRMIRËSIM TË LEGJISLACIONIN NË FUQI.

1.1. Rekomandim: Drejtoria Ekzekutive e AKBN të hartojë propozimet për përmirësim të legjislacionit pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, për ndryshimin e nenit 4, të ligjit nr. 9975, datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar, që pagesa e rentës minerare të bëhet në % të vlerës së produktit të shitur.

Gjithashtu të hartojë propozime për rishikimin e Shtojcës nr. 2 “Renta minerale sipas klasifikimit”, që i bashkëlidhet ligjit nr. 9975, datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar, me qëllimin e unifikimit të mënyrës së pagesës së rentës minerare, duke propozuar dhe rishikimin e përqindjes së rentës minerare për çdo kategori të mineralit, për t’i harmonizuar këto dy norma ligjore midis tyre, me qëllim shmangien nga favorizimi që mund t’i bëhen subjekteve të veçanta nëpërmjet pagimit të diferencuar të rentës minerare nëpërmjet sistemit me tarifë fikse për emërtesa të mineraleve që nuk specifikohen posaçërisht në këtë shtojcë.

Menjëherë

Përgjigja e institucionit

Trajtimi i këtij problemi ka qenë i domosdoshëm për shkak të mospërputhjes së emërtimeve të vendosur në formatin e lejes minerare dhe atij të mineraleve në shtojcën 2 të ligjit Nr. 9975, datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare”. Për sa i përket rekomandimeve të KLSH lidhur me parregullsitë në pagesën e rentës minerare për shkak të mospërputhjes së emrit të mineralit të vendosur në akt miratimin e lejes minerare nga ministri kompetent me llojin e mineralit në objektin që shfrytëzohet si dhe me emërtesën e vendosur në ligjin Nr. 9975, dt. 28.07.2008, “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar, kemi mbajtur korrespondencë të vazhdueshme me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Ministrinë e Financave për unifikimin e rentës minerare si me poshtë:

1. Shkresa me nr 2368 prot. datë 28.03.2019, ku ne kemi kërkuar pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë që pagesa e rentës minerare të mos bëhet me vlerë fikse por në përqindje, të ndarë sipas grupeve të mineraleve.
2. Shkresa me Nr. Prot. 233/5, dt. 30.07.2019, me lëndë: “Mbi problematikat për saktësimin e emërtimeve të llojit të mineralit në lejet minerare dhe të pagesave të rentës”, drejtuar MIE për unifikimin dhe saktësimin e pagesave të rentës minerare, përfshirë dhe Subjektin "Stone Production" dhe zonën Melovë, Skrapar dhe Lepenicë, Vlorë
3. Shkresa me Nr. Prot. 772, dt. 23.01.2020, me lëndë: “Kërkesë për unifikim të pagesës së rentës minerare”, dërguar MIE dhe MFE.
4. Shkresa me Nr. Prot. 1687/2, dt. 28.02.2020, dhe me Nr. Prot. hyrës 772/1, dt. 02.03.2020, me lëndë: “Mbi ngritjen e një grupi pune”, nga MFE.
5. Shkresa me Nr. Prot. 772/3, dt. 07.07.2020, me lëndë: “Per ngritjen e grupit te punës”, dërguar MFE.
6. Shkresa me Nr. Prot. 4432, dt. 07.12.2021, me lëndë: “Propozim për rishikimin e emërtimeve të mineraleve dhe rentës minerare” dërguar MIE dhe MFE.
7. Shkresa me Nr. Prot. 2268/1, dt. 11.01.2022 dhe me Nr. Prot. Hyrës 212, dt. 13.01.2022, me lëndë: “Kthim përgjigje” nga MFE për dakordësinë e rishikimit të rentës minerare dhe ngritjes së grupit të punës.
8. Shkresa me Nr. Prot. 212/1, dt. 18.01.2022, me lëndë: “Ngritja e grupit të punës për rishikimin e rentës minerare”, dërguar MFE-së.
9. Shkresa me Nr. Prot. 4212, dt. 03.03.2022, me Nr. Prot hyrës 1268, dt. 07.03.2022, me lëndë: “Për ngritjen e Komisionit AD-HOC”, dërguar nga MFE për ngritjen e Komisionit AD-HOC
10. Shkresa me Nr. Prot. 1268/1, dt. 10.03.2022, me lëndë: “Kthim përgjigje”, dërguar MFE për propozimin e 2 punonjësve në komisionin AD-HOC.

Me propozimin e dërguar me vlerat e reja të rentës në varësi të çmimit të shitjes dhe duke përfshirë në ligjin e taksave të gjitha emërtimeve të mineraleve që janë në ligjin minerar si dhe në listen e subjekteve aktive të dhëna nga MIE, po presim organizimin e mbledhjes për të dhënë kontributin tonë në përmirësimin e legjislacionit në fuqi lidhur me rentën minerare.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe i zbatuar**

MASA ORGANIZATIVE

1.1. Rekomandim: Në funksion të zbatimit të kuadrin rregullator përkatës si dhe duke zbatuar planin e veprimit përcaktuar në shkresën Nr. 06/33 prot., datë 26.08.2019, Drejtori Ekzekutiv i AKBN të marrë masat e duhura për zbatimin plotësisht të rekomandimeve të pranuar por ende të pazbatuara ose në proces zbatimi, sipas auditimit paraardhës të kryer nga KLSH.

Në vijimësi

Përgjigja e institucionit

Lidhur me gjetjen e grupit të Auditimit “Drejtoria e Monitorimit të HEC-ve dhe Drejtoria e Administratës, nuk ka analizuar dhe vlerësuar shkallën e përgjegjësisë për secilin punonjës, për mangësitë dhe shkeljet e konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit.” dhe në zbatim të këtij Rekomandim, AKBN ka marrë masat konkrete si më poshtë :

1. Është ngritur Urdhëri Nr.158 datë 29.07.2022 nga Drejtori Ekzekutiv “Për Zbatimin e Rekomandimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit të lënë në Raportin Përfundimtar me Nr.1418/15, date 19.07.2022 (Masat Disiplinore),” ku janë ngarkuar për zbatimin e këtij Urdhëri të gjithë Drejtoritë e AKBN dhe Drejtoria e Administratës.
2. Shkresa Nr.216/37Prot.,date 02.08.2022 me lëndë “Mbi propozimin e masave disiplinore nga Drejtorët e Drejtorive” k u Drejtoria e Administratës i kërkon të gjitha Drejtorive që të dërgohen vlerësimet dhe propozimet e tyre për dhënien e masave disiplinore.
3. MEMO Nr.216/52Prot.,date 19.10.2022 me lëndë “Dërgohen propozimet e masave disiplinore”, Drejtoria e Monitorimit të Heceve i përcjell Drejtorisë së Administratës dhe Drejtorit Ekzekutiv propozimet për masat disiplinore “Tërheqje vëmëndje” për dy punonjës dhe propozimin për masë disiplinore “Paralajmërim për largim nga puna” për një punonjës.
4. Lidhur me masat e marra për intensifikimin e përdorimit të sistemit online të raportimit nëpërmjet platformës RevZone, përveç propozimeve konkrete që AKBN i ka bërë MIE-s konkretisht Drejtorisë së Auditit të Brendshëm të saj me shkresën Nr.519/6Prot.,datë 08.06.2021 për vendosje penaliteti në rastet e mosrespektimit të nenit “Raportimi” si detyrim kontraktual, AKBN ka vijuar dhe intensifikuar kërkesën për raportim në RevZone ndaj shoqërive konçesionare pothuajse në çdo komunikim shkresor që ka mbi monitorimin e kontratave. Përmendim këtu disa shembuj si më poshtë gjatë vitit 2022 dhe në vijim gjatë vitit 2023 :
 - Nr.906/5Prot., datë 01.06.2022 drejtuar shoqërisë “S.”shpk.
 - Nr.2214/5Prot., datë 18.07.2022 drejtuar shoqërisë “L. & K. E.”shpk.
 - Nr.1153/5Prot.,datë 10.06.2022 drejtuar shoqërisë “E. H.”shpk.
 - Nr.308/2Prot.,datë 08.02.2023 drejtuar shoqërisë “H. E.”shpk.
 - Nr.1045Prot.,datë 09.02.2023 drejtuar shoqërisë “D. B.”shpk.
 - Nr.528Prot.,datë 24.01.2023 drejtuar shoqërisë “L. K.”shpk.

Si rezultat i intensifikimit të kërkesës tonë ndaj shoqërive konçesionare për përdorimin e platformës online të raportimit (ku në çdo kërkesë ndaj tyre informohet edhe MIE) , situata ka ndryshuar si më poshtë nëse krahasojmë dy periudhat para Auditimit të KLSH dhe pas

Sistemi REVZONE		
Vitet	Fundi 2021	2023
LLogari të shoqërive për raportim online në REVZONE		
Shoqëri me llogari në REVZONE	165	170
Shoqëri pa llogari në REVZONE	110	105

Raportimet e bera nga shoqërite në sistemin REVZONE		
Raportime të HEC-eve në ndertim	56	86
Raportime të HEC-eve në shfrytëzim	47	91

(tabela nr.1). Lidhur me gjetjen e Grupit të Auditimit për sa i përket 2 masave për shpërblim dëmi në shumën prej 5,537,463 lekë ose 64,11% të dëmit të konstatuar, sqarohet se:

Pasi u ezaurua njoftimi i subjekteve për ekzekutim vullnetar të detyrimit nga ana e Drejtorisë së Monitorimit të HEC-eve me shkresë Nr.107/1Prot., datë 10.01.2022 Drejtoria e Monitorimit të Hec-eve përcolli në Drejtorinë e Shërbimeve Ligjore për ndjekje të mëtejshme materialet për 4 subjektet debitoare. Drejtoria e Shërbimeve Ligjore, në zbatim të këtij Rekomandim, hartoi dhe dergoi në gjykatë Kërkesë Padite përkatëse për subjektet koncensionare 1. “N.S.E.” shpk, 2. S. AK "sh.p.k" dhe “E.”sh.p.k, 3. Hec “H.” sh.p.k. dhe 4. “E.V.” sh.p.k.

Aktualisht Drejtoria e Shërbimeve Ligjore po ndjek proceset gjyqësore që po zhvillohen në Gjykatën e Shkallës së Parë, Tiranë dhe Elbasan sipas të dhënave të paraqitura në tabelën e mëposhtme.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

2.1. Rekomandim: Drejtori Ekzekutiv i AKBN-së të marrë masat e duhura për përmirësimin e nenit 10, pika 8, të Statut Rregullores së AKBN-së për përcaktimin e kriterëve në rastet e shpërblimit për anëtarët e Këshillit Drejtues për performancë në punë, duke reflektuar ndryshimet në aktet e dala në zbatim Statut Rregullores.

Menjëherë

Përgjigjja e institucionit

Për zbatimin e këtij Rekomandim, AKBN përgatiti relacionin dhe dokumentacionin përkatës sqarues dhe iu drejtua Keshillit Drejtues me shkresë Nr.216/47, datë 26.09.2022 "Relacion mbi një shtesë në nenin 10 (Kompetencat Keshillit Drejtues) të Statut Rregullores së AKBN nëpërmjet së cilës është kërkuar "...përcaktimin e kriterëve në rastet e shpërblimit për anëtarët e Këshillit Drejtues për performancë në punë..." sipas orientimeve të KLSH në këtë rekomandim.

Me proces verbal të datës 21.11.2022 i mbajtur nga Keshilli Drejtues i AKBN lidhur me mbledhjen e këtij këshilli me rend dite "Miratimi i disa shtesave dhe ndryshimeve në Statut Rregullorin e AKBN-së"... etj ka vendosur që të mos e marrë në shqyrtim këtë pikë të rendit të ditës(bashkëlidhur proces verbali).

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

3.1. Rekomandim: Drejtori Ekzekutiv i AKBN-së të ndalojë shpërblimin për performancë në punë për anëtarët e Këshillit Drejtues, deri në përmirësimin e kriterëve të duhura për përmirësimin e nenit 10 Statut Rregullores së AKBN-së lidhur me shpërblimin mbi pagë.

Menjëherë

Përgjigjja e institucionit

Për zbatimin e këtij Rekomandim, AKBN përgatiti relacionin dhe dokumentacionin përkatës sqarues dhe iu drejtua Keshillit Drejtues me shkresë Nr.216/47 datë 26.09.2022 "Relacion mbi një shtesë në nenin 10 (Kompetencat Keshillit Drejtues) të Statut Rregullores së AKBN nëpërmjet së cilës është kërkuar "...përcaktimin e kriterëve në rastet e shpërblimit për anëtarët e Këshillit Drejtues për performancë në punë..." sipas orientimeve të KLSH në këtë

rekomandim.

Me proces verbal te datës 21.11.2022 i mbajtur nga Keshilli Drejtues i AKBN lidhur me mbledhjen e këtij keshilli me rend dite "Miratimi i disa shtesave dhe ndryshimeve në Statut Rregulloren e AKBN-se"... etj ka vendosur që të mos e marrë në shqyrtim këtë pikë të rendit të ditës(bashkëlidhur proces verbali).

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pazbatuar**.

4.1 Rekomandim:Titullari i institucionit të AKBN-së të marrë masa për krijimin Ekipin e Menaxhimit të Programit, çdo vit për përgatitjen e PBA-së, me qëllim për të mundësuar një planifikim sa më real të shpenzimeve korrente dhe investimeve, për përmbushjen e objektivave të institucionit.

Në vijimësi

Përgjigja e institucionit

AKBN është institucion varësie i MIE-s dhe si e tillë programet që zbaton, respektivisht mbështetje për Energjinë i cili mbulon aktivitetin e Drejtorisë Hidroenergjetike, Hidrokarbure dhe Energjive të Rinovueshme dhe "Mbështetje për Burimet Natyrore", i cili mbulon aktivitetin e Drejtorisë Minerare janë nënprograme apo pjesë e programeve të MIE-s. Në këto kushte nuk ka ekipe të veta të menaxhimit, por Drejtori Ekzekutiv (ose Drejtor Drejtorie) i institucionit janë pjesë e ekipeve të menaxhimit sipas programeve të Ministrisë së Linjës. AKBN i është drejtuar MIE-s, me shkresën NR 216/45 Date 14.09.2022 dhe ka marrë përgjigje me shkresën NR 6927/1 datë 10.10.2022.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

4.2. Rekomandim: Nga strukturat drejtuese dhe menaxhuese të institucionit, të punohet për një programim real të shpenzimeve dhe të ardhurave, duke u bazuar në mundësitë dhe kërkesat reale që ka institucioni, me qëllim eliminimin e formaliteteve në programimin e këtyre fondeve. Realizimi i burimeve të financimit të monitorohet në mënyrë sistematike, ku ndryshimet apo devijimet e mëdha nga plani fillestar të reflektohen në një plan të rishikuar.

Në vijimësi

Përgjigja e institucionit

Për hartimin e projekt buxhetit afatmesëm të institucionit, Drejtoria Ekonomike është bazuar në kërkesat specifike më të domosdoshme të drejtorive të institucionit në drejtim të shpenzimeve si dhe në planifikimin sa më real të të ardhurave të financuara nga buxheti i shtetit nëpërmjet projekteve si dhe të ardhurave të tjera të planifikuara dhe të siguruara nga puna e drejtorive teknike. Realizimi i burimeve të financimit monitorohet sistematikisht nga Drejtoria Ekonomike, edhe raporohet periodikisht pranë Drejtorit Ekzekutiv. Gjithashtu Drejtoria Ekonomike informon rast pas rasti Drejtoritë Teknike përkatëse për të ardhurat respektive në llogaritë e institucionit.

Drejtorja Ekonomike me shkresën Nr 3943 Prot., datë 26.09.2022 iu është drejtuar Drejtorive teknike për informacion mbi realizimin e të ardhurave për periudhën 8 mujore . Gjithashtu me shkresën Nr. 4282 Prot., datë 12.10.2022 , Drejtoria Ekonomike ju ka kërkuar të gjithë drejtorive planifikimin sa më real të të ardhurave dhe shpenzimeve për projekt buxhetin afatmesëm 2023-2025.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

4.3. Rekomandim: AKBN të hartojë një pasqyrë të plotë të objektivave që synon të arrijë institucioni dhe mbi këtë bazë të përgatitet një program zhvillimi afatmesëm për qëndrueshmërinë ekonomike-financiare të institucionit.

Në vijimësi

Përgjigjja e institucionit

Në zbatim të këtij Rekomandim AKBN ka hartuar programin ekonomik e financiar dhe e ka dërguar për miratim në Këshill Drejtues i cili e ka miratuar me vendim Nr.2 dt 25.05.2023

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

5.1. Rekomandim: Drejtoria e Shërbimeve Ligjore në AKBN të marrë masat që me marrjen e njoftimit të vendimit të formës së prerë nga gjykata t'i kërkojë fituesit paraqitjen e titullit ekzekutiv të vendimit pranë AKBN-së, për ekzekutimin vullnetar të detyrimit.

Në vijimësi

Përgjigjja e institucionit

Me shkresë nr.216/42 datë 11.08.2022 është urdhëruar i gjithë stafi i Drejtorisë së Shërbimeve Ligjore që menjëherë sapo një vendim gjyqësor të marrë formë të prerë të njoftoj palë fituese për gadishmërinë e institucionit për ekzekutimin vullnetar të detyrimi.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

6.1 Rekomandim: AKBN të marrë masat që në ngritjen e komisionit të inventarizimit të verifikojë dhe vërtetojë mungesën e konfliktit të interesit, për të ruajtur plotësinë e aktiveve dhe regjistrimin e duhur në dokumentet kontabël.

Në vijimësi

Përgjigjja e institucionit

Drejtoria Ekonomike ka vijuar me nxjerjen e urdhrave të inventarizimit për vitin 2021, ku specialistja e Sektorit të Financës dhe Buxhetit u zëvendësua me një ekonomiste nga sektorë të tjerë (Referuar Urdhrit Nr. 10 Datë 01.02.2022 dhe Urdhrit Nr. 11 Datë 02.02.2022). Kjo praktikë do të ndiqet edhe për komisionet në vijim.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

Mbi shfrytëzimin e burimeve hidrokarbure

7.1. Rekomandim: AKBN, MIE, Albpetrol të bashkëpunojnë me kompaninë BPAL, që të intensifikojë operacionet që mundësojnë rritjen e prodhimit të naftës, duke optimizuar investimet dhe kostot hidrokarbure për të bërë të mundur arritjen e pikës së kthimit të raportit të ardhura-shpenzime në vlera më të larta së, R=1, me qëllim rritjen e fitimit të Kompanisë dhe pagimin e tatimit mbi fitimin në buxhetin e shtetit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e institucionit

Në vijim të këtij Rekomandim, Drejtoria Hidrokarbure ka përgatitur dhe ka dërguar në adresë të Kompanisë Bankers Petroleum Albania Ltd., shkresën nr. 216/64 prot., datë 22.11.2022 (bashkëlidhur).

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

8.1. Rekomandim: AKBN në bashkëpunim me “Albetrol” sha dhe MIE në zbatim të nenit 15.2 të Licencë Marrëveshjes, të marrin zyrtarisht nga Bankers Petroleum Albania Ltd (BPAL) të gjithë dokumentacionit e hollësishëm të kostove hidrokarbure të realizuar për vitin 2018, 2019, 2020, 2021 dhe 6 mujorin e parë të vitit 2022, dhe në bazë të tyre të analizojë dhe të llogarisë saktë faktorin R.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e institucionit

AKBN me shkresën nr. 3923 prot., datë 22.09.2022 ka kërkuar prej Kompanisë BPAL plotësimin e dokumentacionit sipas Rekomandim të lënë prej KLSH. (bashkëlidhur shkresa).

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

9.1. Rekomandim: AKBN, MIE, Albpetrol në bashkëpunim me kompaninë BPAL të gjejnë rrugët e bashkëpunimit dhe të mirëkuptimit, për të përmirësuar marrëveshjet hidrokarbure në lidhje me të drejtën e auditimit të librave të llogarisë dhe dokumentacionin e kontabilitetit të LICENSUAR-it në lidhje me Operacionet Hidrokarbure. Kjo e drejte Auditit të përfundojë 1 (një) vit pas datës në të cilën i LICENSUAR-i dorëzon dokumentacionin e tij të kontabilitetit për atë Vit Fiskal.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e institucionit

AKBN ka marrë të gjitha masat e nevojshme brënda strukturave të saj për të realizuar brënda periudhës 1 vjeçare auditimet e MH. Kjo vërtetohet me nxjerrjen e urdhërave të auditimit të MH me qëllim realizimin brënda afatit 1 vjeçar te procesit te auditit dhe realizimin e këtij Rekomandim. (bashkëlidhur urdhëri auditit).

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

10.1. Rekomandim: AKBN, MIE, Albpetrol të monitorojnë në mënyrë të vazhdueshme realizimin e proceseve hidrokarbure, për parandalimin e përfshirjes të shpenzimeve të cilat nuk konsiderohen të rikuperueshme. Nga ana e AKBN dhe Albpetrol të merren masa për realizimin e proceseve audituese, duke u referuar në standardet më të pranuar ndërkombëtarisht.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e institucionit

AKBN për realizimin e këtij Rekomandim ka vijuar me monitorimet e kryera pranë Kompanisë BPAL (proceset e auditit) e cila është dhe një e drejtë që i takon AKBN-së sipas Licencë Marrëveshjes. Megjithatë, AKBN-së kjo e drejtë i është cënuar për shkak të pamundësive financiare të institucionit.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

11.1. Rekomandim: AKBN dhe Albpetrol, në bashkëpunim me ministrinë e linjës të marrin masa për vlerësimin rast pas rasti, në nivel ekspertësh të fushës për shkeljet e përsëritura nga

ana e kontraktorëve jo vetëm për mos realizimin e planit të zhvillimit, apo programeve vjetore, por edhe për përfshirje të shpenzimeve në kosto hidrokarbure të pa rikuperueshme në kundërshtim me marrëveshjet, në mënyrë të përsëritur, për arritjen e konkluzionit për bërjen e njoftimeve për thyerje të marrëveshjes, sipas përcaktimeve në marrëveshjet hidrokarbure dhe licencë marrëveshjet. AKBN, t'i kërkojë kontraktorëve zbritjen e shpenzimeve të përfshira padrejtësisht në kosto hidrokarbure të rikuperueshme, duke bërë edhe njoftimin përkatës për shkelje të marrëveshjes licence dhe marrëveshjes hidrokarbure.

Në vijimësi

Përgjigjja e institucionit

AKBN brënda strukturës së Drejtorisë Hidrokarbure ka kryer analizimin e përputhshmërisë së planit të zhvillimit të BPAL me planet e punës si dhe raportet tremujore të realizimit të treguesve. AKBN nëpërmjet auditimit të librave kontabël dhe pasqyrave financiare është në monitorim të vazhdueshëm për moslejimin e përfshirjes në kostot hidrokarbure të shpenzimeve të kryera në kundërshtim me parashikimet e Marrëveshjes Hidrokarbure.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

11.2. Rekomandim: AKBN dhe Albpétrol, të marrin masa për kordinim me institucionet ligjzbatuese, për monitorimin sa është e mundur nëpërmjet instrumenteve ligjore, të operacioneve hidrokarbure të kompanive, duke monitoruar edhe zbatimin e kontratave të kontraktorit me nënkontraktorë si për punime, mallra dhe shërbime, ashtu edhe për marrje me qira të pronës.

Në vijimësi

Përgjigjja e institucionit

Ligji 153/2020 "Për sistemin fiskal në sektorin hidrokarbur" ka parashikuar bashkëpunimin e autoriteteve tatimore dhe AKBN-së mbi një audit të përbashkët për këto kompani. Ky audit i përbashkët do të bëjë të mundur edhe monitorimin e kontratave me nënkontraktorët ashtu sikurse dhe moslejimin e futjes në kostot hidrokarbure të shpenzimeve të kryera në kundërshtim me parashikimet e Marrëveshjes Hidrokarbure.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

11.3. Rekomandim: AKBN në bashkëpunim me Albpétrol SHA dhe MIE, të marrin masa për hartimin e manualeve dhe udhëzuesve të auditimit, me referenca standarde të pranuar ndërkombëtare të auditimit dhe të bëhen negociata për pranimin e tyre nga palët.

Në vijimësi

Përgjigjja e institucionit

Ligji 153/2020 Për sistemin fiskal në sektorin hidrokarbur ka parashikuar në nenet 11 dhe 12 një listë lidhur me shpenzimet e zbritshme dhe shpenzimet e pazbritshme për këto kompani.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

14.1. Rekomandim: AKBN, MIE dhe Albpétrol të marrin masa për diskutimin dhe shqyrtimin e planeve vjetore brenda periudhës së përcaktuar në marrëveshje, duke kërkuar respektimin e

planit të zhvillimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e institucionit

AKBN si Palë pa të drejtë vote në mbledhjet e Komiteteve Këshillimore me Kompanitë që operojnë në sektorin e prodhimit ka ngritur në çdo mbledhje shqetësimin e saj lidhur me afatet e tejzgjatura mbi mbajtjet e këtyre mbledhjeve të cilat janë të domosdoshme për diskutimet e planeve vjetore të punës për këto kompani, të cilat duhet të jenë përpara fillimit të çdo viti kalendarik.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **pazbatuar**.

15.1. Rekomandim: AKBN, MIE dhe Albpetrol të marrin masa, të analizojë me grup pune të veçantë, shkaqet dhe arsyet e humbjes në Arbitrazhin Ndërkombëtar.

Menjëherë

Përgjigjja e institucionit

Lidhur me këtë rekomandim, sqarojmë se AKBN nuk ka qënë Palë në proces ashtu sikurse as Palë në Marreveshje Hidrokarbure. Gjithashtu për sqarim të mëtejshëm edhe Urdhëri i MIE nr. 508 datë 07.06.2018 AKBN është zhveshur totalisht nga detyrimi për pjesëmarrje dhe pagim shpenzimesh, i cili përcakton se të gjitha shpenzimet, pagesat apo kostot e dala prej këtij procesi do të kryheshin në masën 100% prej Albpetrol sh.a., si shoqëria Kontraktore e Marreveshjes Hidrokarbure. (bashkëlidhur urdhri).

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

15.2. Rekomandim: AKBN, MIE dhe Albpetrol të mos tolerojnë praktikatat e miratimit në heshtje dhe formal të Planeve Vjetore dhe buxheteve të paraqitura. Të miratojnë sa më shpejtte Programin e Punës dhe Buxhetin e vitit 2020. Të ndiqen me rigorozitet kërkesat e përcaktuara në MH dhe LM për shqyrtimin dhe dakordësimin e Planeve Vjetore dhe buxheteve të paraqitura nga kompania “A. O.&G.”.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e institucionit

AKBN nëpërmjet shkresës nr. 216/74 prot., datë 20.12.2022 i është drejtuar Albpetrol sh.a., për marrjen e masave për zbatimin e këtij Rekomandim. AKBN miraton planet e punës dhe buxhetet e kompanive që operojnë në sektorin e prodhimit vetëm pasi ka marrë miratimin e këtyre planeve nga ana e Albpetrol.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

16.1. Rekomandim: AKBN, MIE, Albpetrol të bashkëpunojnë me kompaninë “D.G. C.”, për intensifikimin e operacioneve që mundësojnë rritjen e prodhimit të gazit, duke optimizuar investimet dhe kostot hidrokarbure për të bërë të mundur arritjen e pikës së kthimit të raportit të ardhura-shpenzime në vlera më të larta ($R > 1$).

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e institucionit

Në vijim të këtij Rekomandim, Drejtoria Hidrokarbure ka përgatitur dhe ka dërguar në adresë të Kompanisë D. G. C., shkresën nr. 216/63 prot., datë 22.11.2022 (bashkëlidhur).

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

17.1. Rekomandim: AKBN, MIE, Albpetrol të bashkëpunojnë me kompaninë “F. P.P.”, për intensifikimin e operacioneve që mundësojnë rritjen e prodhimit të naftës, duke optimizuar investimet dhe kostot hidrokarbure për të bërë të mundur arritjen e pikës së kthimit të raportit të ardhura-shpenzime në vlera më të larta ($R>1$).

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e institucionit

Në vijim të këtij Rekomandim, Drejtoria e Hidrokarbureve ka përgatitur dhe ka dërguar në adresë të Kompanisë F.-P. P., shkresën nr. 216/65 prot., datë 22.11.2022 (bashkëlidhur).

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

18.1. Rekomandim: AKBN, MIE, Albpetrol të bashkëpunojnë me kompaninë “T.G.”, për intensifikimin e operacioneve që mundësojnë rritjen e prodhimit të naftës, duke optimizuar investimet dhe kostot hidrokarbure për të bërë të mundur arritjen e pikës së kthimit të raportit të ardhura-shpenzime në vlera më të larta ($R>1$).

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e institucionit

Në vijim të këtij Rekomandim, Drejtoria Hidrokarbure ka përgatitur dhe ka dërguar në adresë të Kompanisë T.G. (T.), shkresën nr. 216/67 prot., datë 22.11.2022 (bashkëlidhur).

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

19.1. Rekomandim: AKBN, MIE, Albpetrol të bashkëpunojnë me kompaninë “Sh. I.”, që të intensifikojë operacionet që mundësojnë rritjen e prodhimit të naftës, duke optimizuar investimet dhe kostot hidrokarbure për të bërë të mundur arritjen e pikës së kthimit të raportit të ardhura-shpenzime në vlera më të larta së, $R=1$.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e institucionit

Në vijim të këtij Rekomandim, Drejtoria Hidrokarbure ka përgatitur dhe ka dërguar në adresë të Kompanisë Sherëood International., shkresën nr. 216/62 prot., datë 22.11.2022 (bashkëlidhur).

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

Mbi shfrytëzimin e burimeve minerare.

20.1. Rekomandim: Drejtoria Minerare pranë AKBN-së dhe Komisioni i Shqyrtimit të Planeve Vjetore të Punës të bëjnë një përditësim për të gjitha subjektet që kanë leje shfrytëzimi minerar dhe situatën e tyre mbi miratimin e planit vjetor për subjektet e licensuara. Drejtoria

Minerare pranë AKBN të marrë masa për zbatimin e sanksioneve që parashikohen në legjislacion nëse subjektet zotërues të lejeve minerare nuk paraqesin për miratim planin vjetor të veprimtarisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e institucionit

DM pranë AKBN ka ndjekur në mënyrë të vazhdueshme dhe mban të azhornuar (përditësuar) listën më subjektet që miratojnë ose jo planet vjetore. Për çdo subjekt që nuk ka dorëzuar ose dorëzuar me vonesë kërkesën për miratimet e planeve vjetore janë vendosur masat administrative përkatëse.

Lista me masat administrative për vitin 2022 dhe vazhdimësi Qershor 2023 (tabela nr.2).

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

19.1. Rekomandim: Drejtoria Minerare pranë AKBN-së të marrë masa për zbatimin e sanksioneve që parashikohen në legjislacion për subjektet zotërues të lejeve minerare të cilat nuk kanë kryer raportimet vjetore apo tre mujore apo i kanë bërë këto raportime me vonesë.

Menjëherë

Përgjigjja e institucionit

DM pranë AKBN me marrjen e njoftimit të Projekt Raportit Final dhe pas verifikimit të listës së dërguar nga grupi auditues, u vendosën masat administrative përkatëse.

Për subjektet ndaj të cilëve nuk janë vendosur masa administrative janë dhënë shpjegimet përkatëse në observacionin e parë pasi një pjesë kanë raportuar online ose në protokoll, gjithashtu një pjesë e subjekteve janë konstatuar për të njëjtën masë dy herë.

Për masat administrative viti 2018, janë ankimuar nga subjektet pranë Njësisë së Vlerësimit të Ankimimeve Administrative, në MIE, për 6 masa administrative nga ku 5 janë lënë në fuqi dhe 1 është shfuqizuar. Për vitin 2019, janë ankimuar nga subjektet për 13 masa administrative nga ku të 13-ta janë lënë në fuqi. Për vitin 2020, janë ankimuar nga subjektet për 3 masa administrative nga ku të 3-ja janë shfuqizuar. Për vitin 2021, janë ankimuar nga subjektet për 6 masa administrative nga ku 3 janë lënë në fuqi dhe 3 janë shfuqizuar.

Më poshtë ju japin tabelën me masat administrative për çdo subjekt dhe komentet përkatëse për shkeljen e konstatuar. (tabela nr.3)

Në zbatim të rekomandimeve të KLSH-së nga auditimi i zbatimit të kërkesave të ligjit minerar dhe akteve të tjera të Ministrisë së Industrisë dhe Energjisë në vitet 2018- 2021 nga Drejtoria Minerare, i janë përcjellë Drejtorisë së Shërbimeve Ligjore 139 masa administrative me shkresën nr.prot. 4257 datë 10.10.2022 (vënë në dispozicion në datën 19.10.2022).

Drejtoria e Shërbimeve Ligjore menjëherë me ardhjen e shkresës nr.prot. 4257 datë 10.10.2022 nga Drejtoria Minerare ka filluar punën dhe po ndjek në mënyrë të vazhdueshme procedurat ligjore me qëllim ekzekutimin e gjobave nga subjektet minerare ndaj të cilëve janë marrë 139 Masa Administrative dhe për të cilat po japim informacionin si më poshtë:

- Janë ankimuar 8 Masa Administrative nga subjektet ndaj të cilat është marrë masa nga ku Ministria(MIE) ka shfuqizuar 7 Masa Administrative dhe 1 masë e ka lënë në fuqi.
- Për 132 masat e mbetura sqarojmë se – për 27 masa, subjektet nuk kanë marrë dijeni dhe për 30 masa posta nuk ka informacion nëse subjektet kanë marrë dijeni apo jo.
- 10 masa janë ekzekutuar në mënyrë vullnetare nga subjektet minerare.
- Për 3 masa janë depozituar Kërkesë Padi nga subjektet dhe për të cilat Gjykata ka marrë vendim për shfuqizim të të 3 masave administrative.
- Për 1 Masë Administrative është depozituar Kërkesë Padi nga subjekti dhe është akoma

në proces gjyqësor.

- Për 1 Masë Administrative është depozituar Kërkesë Padi nga subjekti, dhe është fituar nga AKBN, ku gjykata e ka lënë në fuqi masën administrative.

- Kanë dalë nga Gjykata 9 Urdhëra Ekzekutimi dhe po ndiqet procedura për vjeljen e gjobës nga Drejtoria e Shërbimeve Ligjore.

- Aktualisht janë dhe 7 kërkesa të depozituara në Gjykatë për nxjerrjen e Urdhërave të Ekzekutimit.

- Për 44 Masa Administrative të mbetura DSHL po ndjek përgatitjen e dokumentacionit për të depozituar kërkesat për nxjerrje të urdhërave të ekzekutimit në gjykatë.

Më poshtë do të gjeni Tabelen ku janë evidentuar hapat ligjore që po ndiqen nga Drejtoria e Shërbimeve Ligjore për 139 masat deri në ekzekutimin e gjobave (tabela nr.4) : Në zbatim të rekomandimeve të KLSH-së(Viti 2018-2022), Drejtoria Minerare, i ka përcjellë Drejtorisë së Shërbimeve Ligjore edhe 72 masa administrative me shkresat nr.prot. Nr.4487 datë 25.10.2022, Nr. 1195 datë 20.02.2023, Nr. 1195 datë 20.02.2023(Marrë në dorëzim datë 27.03.2023),Nr.21450 Prot. Datë 24.04.2023 (Marrë në dorëzim datë 04.05.2023)

- 8 Masa Administrative janë shfuqizuar nga Ministria pas ankimimit të subjekteve minerare

- Janë depozituar në gjykatë 12 kërkesa për nxjerrjen e Urdhërave të Ekzekutimit

- Janë ekzekutuar vullnetarisht 3 masa administrative

- Gjykata ka nxjerrë 2 Urdhëra ekzekutimi

Më poshtë do të gjeni Tabelen ku janë evidentuar hapat ligjore që po ndiqen nga Drejtoria e Shërbimeve Ligjore për 72 masat deri në ekzekutimin e gjobave :

Totali	Shfuqizuar nga MIE	Janë depozituar në gjykatë kërkesat për nxjerrjen e UE	Përgjigje nga Posta Shqiptare	Përgjigje nga MIE	Janë ekzekutuar vullnetarisht	Urdhëra Ekzekutimi
72 Masa Administrative	8 Masa Administrative	12 kërkesa për nxjerrjen e UE	Për 47 masa administrative AKBN shkresë Nr.prot.782, datë 02.02.2023, shkresë nr.prot.2296, datë 04.05.0223 dhe nr.prot.2296/1, datë 17.05.2023 Posta Shqiptare përgjigje me shkresën Nr.269/1 date 10.03.2023 dhe shkresën nr.prot 2296/2, date 31.05.2023. Për këto 47 masa, 27 subjekte kane marre dijeni, 14 subjekte nuk kane marre dijeni, per 6 subjekte posta nuk ka informacion.	Për 47 masa administrative AKBN shkresë nr.prot.2295, date 04.05.2023 dhe shkrese nr.prot.3286, Date 11.07.2023 MIE përgjigje me shkresen nr.prot 2295/1, date 16.06.2023 Për këto 47 masa, 23 masa nuk jane ankimuar, 1 mase eshte ankimuar dhe Njesia e Ankimit, MIE me vendimin nr.449, date 15.02.2023 ka vendosur lenien ne fuqi te mases nr.5359, date 29.12.2022(Ky vendim nuk i eshte dorezuar AKBN-se), per 23 masa pritet përgjigje nga MIE	3 masa administrative	2 Urdhëra ekzekutimi

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **zbatuar**.

20.1. Rekomandim: Këshilli Drejtues dhe Drejtori Ekzekutiv i AKBN të analizojnë rastet për të cilat nuk janë bërë monitorimet dhe në përputhje me përcaktimet e Statut-Rregullores së AKBN, t'i propozojnë ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë ndryshimet e nevojshme në

lidhje me kapacitetet e burimeve njerëzore dhe strukturën organizative të Drejtorisë Minerare në AKBN në funksion të mbikëqyrjes dhe monitorimit të subjekteve me leje shfrytëzimi.

Menjëherë

Përgjigjja e institucionit

Për sa i përket kësaj gjetjeje, bëjmë të ditur se, në raportet 6 mujore dhe Vjetore që AKBN-ja dërgon në MIE në respekt të kërkesave të Ligjit Nr.10304 datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 43 pika 3 e tij, ka përcjellë edhe shqetësimin lidhur me problematikat e krijuara për shkak të fondeve të pamjaftueshme dhe mungesës së mjeteve të transportit të cilat krijojnë vështirësi në përmbushjen e misionit të institucionit në këtë sektor.

Përveç raporteve periodike, këto problematika, AKBN-ja i ka bërë pjesë të diskutimeve në mbledhjet e Këshillit Drejtues si dhe nëpërmjet shkresës nr. 1501/23, datë 29.04.2022 ka informuar MIE-n për situatën financiare të krijuar e cila e vë institucionin në kushtet e pamundësisë për realizimin në mënyrën e duhur të objektivave të saj.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar pjesërisht**.

20.2. Rekomandim: AKBN të marrë masa për përcaktimin në planin vjetor të monitorimit dy herë në vit, të të gjithë subjekteve minerare, si dhe inicimi i inspektimeve dhe kontrolleve të subjekteve në terren me grupe të përbashkëta me përfaqësues të Drejtorive Rajonale të Tatimeve, me qëllim saktësimin e treguesve të vetë raportuar nga subjektet e licencuar në sistemin elektronik, dhe përlllogaritjet e efekteve të mundshme për buxhetin e shtetit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e institucionit

Nisur nga situata vështirë financiare në të cilën ndodhet AKBN sic kemi shpjeguar edhe me lart, ka qënë e vështirë mbikëqyrja e përbashkët, pasi kjo kërkon një sasi të shtuar në mjete transporti, financiare dhe logjistike. Pavarësisht nga sa më sipër, në të gjitha rastet kur është kërkuar ekspertiza e AKBN, Drejtoria Minerare ka marrë pjesë aktive duke dhënë kontributin e saj.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe në **proces zbatimi**.

21.1. Rekomandim: Drejtoria Minerare pranë AKBN-së të marrë masa dhe të informojë operatorët ekonomikë me leje shfrytëzimi se duhet të paraqesë pranë strukturës përgjegjëse informacionet tremujore mbi realizimin e prodhimit, investimeve, vlerën e produkteve të shitura, punimeve minerare të realizuara dhe gjithë operacioneve të kryera për rehabilitimin e mjedisit dhe menaxhimin e mbetjeve minerare, në përputhje me detyrimet e tij të lejes minerare dhe planin vjetor”.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e institucionit

Drejtorja Minerare pranë AKBN ka marrë masa menjëherë dhe vazhdon dërgon njoftime në rrugë elektronike mbi zbatimin e detyrimeve të lejeve minerare.

Shembull format emaili dërguar për njoftim subjekteve minerare.



Njohfime Revzone
Wed 11/2/2022 12:59 PM

← REPLY ← REPLY ALL → FORWARD ☰
Mark as unread

Show all 165 recipients

To: indrit.hilaj@yahoo.com; skender.muco@gmail.com; albr.999@hotmail.com; bledi.2011.shpk@gmail.com; shireton.shpk@gmail.com; mali-1958@hotmail.co.uk; bledarzenelaj@yahoo.com; ...

Njoftimi

Ju njoftojmë se në informacionet 6-mujore dhe vjetore që do të paraqiten pranë AKBN-së duhet të informoni saktë:

- mbi realizimin e prodhimit,
- investimet e kryera,
- vlerën e produkteve të shitura brenda dhe jashtë vendit,
- të ardhurat nga shitjet,
- rentën minerare,
- produktet dhe mbetjet minerare,
- punimet minerare të realizuara për rehabilitimin e mjedisit dhe menaxhimin e mbetjeve minerare,
- vlerat e garancisë së rehabilitimit.

Për raportimet vjetore duhet të plotësohet saktë edhe tabela e lëvizjes së rezervave.

Treguesit e mësipërm janë në përputhje me Urdhrin nr.201 dhe nr.202, datë 20.06.2016, aneksi 1 dhe 2.

Në rast se subjekti nuk ka punuar, tek rubrika komente të jepni sqarimet përkatëse si:

- heqje nga fondi pyjor
- pecullim i përkohshëm i aktivitetit minerar
- eti.

Për subjektet të cilët bëjnë raportim 0 (zero) të të gjitha treguesve të mësipërm, të pa argumentuar në rubrikën komente, informacioni nuk do të quhet i plotë dhe do të merret masë administrative me globë.

Ju rikujtojmë se informacioni i 6-mujorit të dytë, të vitit 2022 duhet të bëhet nga data 1-15 janar 2023, ndërsa informacioni vjetor i vitit 2022 duhet të bëhet nga data 1-30 janar 2023.

Informacionet 6-mujore dhe vjetore duhen të dërgohen në programin Revzone të AKBN-së ose nëpërmjet shërbimit postar.

Për subjektet të cilat nuk paraqesin informacionet e kërkuara, si dhe jashtë afatit ligjor do të merret masë administrative sipas legjislacionit në fuqi.

Faleminderit për mirëkuptimin.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

22.1. Rekomandim:AKBN të marrë masa për përmirësimet e duhura në Statut-Rregulloren e funksionimit të AKBN-së në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 547, datë 09.08.2006, pika 7, për të normuar detyrimin e kontrollit prej strukturës së Drejtorisë Minerare, të fabrikave të pasurimit të mineraleve, duke e shoqëruar këtë veprim me masat për rekrutimin në përbërje të Drejtorisë Minerare të inxhinierëve të pasurimit.

Në vijimësi

Përgjigjja e institucionit

Në zbatim të raport auditimit përfundimtar të KLSH-së.

Në Drejtorinë Minerare të AKBN, është emëruar një inxhinier pasurimi në Mars 2022, për monitorimin e specializuar të objekteve përpunuese.

Gjithashtu, në zbatim të këtij Rekomandim, me shkresë Nr.216/46 dt.22.09.2022 është dërguar në Këshill Drejtues Relacioni “Mbi disa shtesa dhe ndryshime të nenit 16 i Statut Rregullores së AKBN-së (Objekti i veprimtarisë së Drejtorisë Minerare dhe miratimi i Rregullores së Laboratorit Minerar.) Me proces verbal të datës 21.11.2022 i mbajtur nga Këshilli Drejtues i AKBN lidhur me mbledhjen e këtij keshilli me rend dite "Miratimi i disa shtesave dhe ndryshimeve në Statut Rregulloren e AKBN-së"... etj ka vendosur që të mos e marrë në shqyrtim këtë pikë të rendit të ditës.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar pjesërisht**.

22.2. Rekomandim: Të merren masa për planifikimin e kryerjes me përparësi të inspektimeve për impiantet e pasurimit, të cilat janë subjekte të licencuara, në bashkëpunim me strukturat tatimore vendore, për të konfirmuar nëpërmjet akt-konstatimeve në terren të saktësisë së deklarimeve të këtyre subjekteve, mbi gjendjen e stokut të prodhimit, duke krahasuar dhe rakorduar të dhënat dhe informacionet periodike e raportimet vjetore të subjekteve të licencuar mbi sasi të mineralit të përpunuar dhe pasuruar për qëllim tregtimi.

Në vijimësi

Përgjigjja e institucionit

Në zbatim të raport auditimit përfundimtar të KLSH-së, për kontrollin dhe monitorimin e fabrikave të pasurimit gjatë vitit 2022, sqarojmë se:

Gjatë vitit 2022, janë monitoruar dhe pasqyruar në raportet vjetore 16 fabrika pasurimi kromi, 2 fabrika pasurimi bakri dhe 2 uzina ferrokromi përkatësisht Uzinat e ferrokromit “ALBCHROME” dhe “GSA”

në Elbasan.

Në zbatim të kërkesave të ligjit Nr. 10 304 datë 15.7.2010, i ndryshuar, ka dal Urdhëri i Ministrit Nr. 269, datë 11.11.2022”. Për kontrollin dhe monitorimin në veprimtarinë minerare të përpunimit për operacionet e seleksionimit, thyerjes, fraksionimit, pasurimit dhe proceseve metalurgjike për grupin e mineraleve metalorë e ndëtimorë” ku plotësohet baza ligjore e monitorimit si për fabrikat e pasurimit të mineraleve metalore ashtu dhe për uzinat e ferrokromit dhe impiantet e përpunimit të mineraleve ndërtimore, të gjitha fabrikat e pasurimit dhe Uzinat e Ferrokromit kanë bërë raportimet on-line sipas kërkesave të aneksit Nr.1, të këtij Urdhëri. Këto raportime janë dokumentuar në raportin e monitorimit të AKBN, për vitin 2022.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

23.1. Rekomandim: AKBN në zbatim të marrëveshjes dypalëshe të lidhura, me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave (respektivisht me nr. 1920 dhe 1922, datë 12.02.2016), të marrë masa për të shkëmbyer informacione periodike dhe në kohë reale për të parandaluar dhe luftuar aktivitetet e paligjshme dhe evazionin fiskal në fushën minerare, duke ndarë informacione mbi lëvizjen e rezervave, stokun e prodhimit dhe diferencat e tij në vite, fuqinë punëtore reale të subjekteve që zotërojnë leje minerare dhe që paguajnë sigurime shoqërore si objekt për të ardhurat tatimore, etj.

Në vazhdimësi

Përgjigjja e institucionit

DM pranë AKBN ka mbajtur dhe vazhdon të mbajë korespondencë të vazhdueshme me DPT.

Nisur dhe nga rekomandimet e lëna nga KLSH është mbajtur korespondenca si më poshtë vijon:

1. Shkresa Nr. 3589 Prot, date 18.08.2022 drejtuar Drejtorisë së Përgjithme të Tatimeve dhe Doganave me lëndë “Kërkesë” për informacion për sasinë e mineralit të shitur në vend dhe eksport, shitjet, çmimin mesatar dhe vlerën e rentës minerare.
2. Shkresa Nr. 15171 Prot Hyrës, datë 31.08.2022, dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave me lëndë “Dërgim të dhënash”.
3. Shkresa Nr.8518 Prot Hyrës, datë 03.10.2022, dërguar nga Drejtoria Rajonale Tatimore, Elbasan me lëndë “Kthim përgjigje”.
4. Shkresa Nr.2369 Prot Hyrës, datë 10.10.2022, dërguar nga Drejtoria Rajonale Tatimore, Sarandë me lëndë “Kthim përgjigje”.
5. Shkresa Nr.1917 Prot Hyrës, datë 10.10.2022, dërguar nga Drejtoria Rajonale Tatimore, Lezhë me lëndë “Përgjigje shkresë”.
6. Shkresa Nr.2412/1 Prot Hyrës, datë 19.10.2022, dërguar nga Drejtoria Rajonale Tatimore, Dibër me lëndë “Kthim përgjigje”.
7. Shkresa Nr.2636 Prot. datë 19.10.2022, dërguar nga Drejtoria Rajonale Tatimore, Dibër me lëndë “Kërkesë për informacion”.
8. Shkresa Nr. 4447/1 Prot Hyrës, datë 31.10.2022 drejtuar Drejtorisë Rajonale Tatimore, Dibër me lëndë “Kthim përgjigje”.
9. Shkresa Nr.8439/2 Prot Hyrës, datë 21.10.2022, dërguar nga Drejtoria Rajonale Tatimore, Korçë me lëndë “Kthim përgjigje”.
10. Shkresa Nr. 7309/2 Prot Hyrës, datë 24.10.2022, dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimpaguesve të Mëdhenj me lëndë “Dërgim informacioni”.
11. Shkresa Nr. 2041/1 Prot Hyrës, datë 28.10.2022, dërguar nga Drejtoria Rajonale Tatimore, Gjirokastrë me lëndë “Dërgim informacioni për Rentën Minerare”.
12. Shkresa Nr. 12747/1 Prot Hyrës, datë 12.12.2022, dërguar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Fier me lëndë “Kthim përgjigje”.

13. Shkresa Nr. 5197 Prot, date 19.12.2022 drejtuar Drejtorisë së Përgjithme të Tatimeve dhe Doganave me lëndë “Kërkohen të dhëna për rentën minerare”, për sasinë e mineralit të shitur në vend dhe eksport, shitjet, çmimin mesatar dhe vlerën e rentës minerare të paguar për vitin 2022.
14. Shkresa Nr. 21319/1 Prot Hyrës, datë 11.01.2023, dërguar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, me lëndë “Kthim përgjigje”.
15. Shkresa Nr. 22031/1 Prot Hyres, date 10.01.2023, dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave me lëndë “Dërgim të dhënash”.
16. Shkresa Nr. 231/1 Prot, datë 19.01.2023, drejtuar Drejtorisë së Përgjithme të Tatimeve, me lëndë “Kërkohen të dhëna për rentën minerare”, për sasinë e mineralit të shitur në vend dhe eksport, shitjet, çmimin mesatar dhe vlerën e rentës minerare të paguar për vitin 2022 për secilin objekt që operon në sektorin minerar.
17. Shkresa Nr. 21319/3 Prot Hyrës, datë 03.02.2023, dërguar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, me lëndë “Kthim përgjigje”.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

24.1. Rekomandim: Drejtoria Minerare pranë AKBN të marrë masa për zbatimin e kërkesave të rregullores për shqyrtimin e dokumentacionit dhe miratimit të planeve vjetore të punës të zotëruesve të lejeve minerare të shfrytëzimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e institucionit

Rekomandim i realizuar nga komisioni për shqyrtimin e planeve vjetore të punës. Çdo dosje është trajtuar në këtë komision brenda afateve ligjore të përcaktuara sipas rregullores së miratuar. Në rastet kur dosja ka pasur mangësi të dokumentacionit sipas përcaktimeve në Urdhërin 201 & 202 të Ministrisë, subjektit i është lënë një afat prej 7 ditësh për plotësime. Në komisionin e rradhës, subjekti ka bërë plotësimet për të cilat është mbajtur një proces-verbal të ri me dokumentat e plotësuara të firmosur nga specialistët përkatës, përfaqësuesi i shoqërisë dhe sekretari dhe kryetari i komisionit. Në rastet kur, edhe pas lënies së afatit, subjekti nuk plotëson dokumentacionin e munguar, subjektit i është dërguar pezullimi për aktivitetin minerar për vitin përkatës, dukë vënë në dijeni edhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Drejtorinë Vendore të Policisë. Në rastet e plotësimit të dokumentacionit, subjekteve u është dërguar Miratimi përkatës.

Në përfundim të dosjes bëhet inventarizimi i dosjes me dokumentacionin që ndodhet në dosje e firmosur nga sekretari i komisionit dhe dorëzohet në arkivën teknike.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

24.2. Rekomandim: Drejtoria Minerare pranë AKBN të marrë masa për zbatimin e kërkesave të rregullores për shqyrtimin e dokumentacionit dhe miratimit të planeve vjetore të punës të zotëruesve të lejeve minerare të shfrytëzimit.

Brenda vitit

Përgjigjja e institucionit

Rekomandim i realizuar. Për një funksionim më efikas dhe në zbatim të ligjit 10304, i ndryshuar, Drejtoria Minerare ka bërë ndryshimin e rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e komisionit për shqyrtimin e dokumentacionit dhe miratimit të planeve vjetore të punës të zotëruesve të lejeve minerare" me Urdhërin Nr. 153 (nr. 2690/2 prot., datë

27.07.2022). Gjithashtu, u bë një ndryshim i kësaj rregullore sipas Urdhërit Nr. 122 (nr. 490/6 prot., datë 05.06.2023), ku janë përcaktuar koha e dorëzimit të dosjeve nga Sektori i Statistikës në Komisionin e shqyrtimit të planeve vjetore 15 ditë para përfundimit të afatit ligjor të lejes.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

25.1. Rekomandim: Drejtoria Minerare pranë AKBN, të marrë masa për shqyrtimin në afat dhe kthimin përgjigje të planeve vjetore që paraqiten nga subjektet e licencuara për miratim.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigja e institucionit

Në zbatim të këtij Rekomandim çdo dosje e paraqitur është trajtuar brenda afateve ligjore konform rregullores dhe legjislacionit të fushës.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

26.1. Rekomandim: Drejtoria Minerare pranë AKBN të marrë masa duke u kërkuar subjekteve me leje shfrytëzimi minerar, shlyerjen e detyrimeve për garancitë financiare të rehabilitimit, në të kundërt të aplikohen sanksionet e parashikuara në ligjin përkatës.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigja e institucionit

Drejtoria Minerare pranë AKBN mban evidencë dhe bën njoftimet përkatëse për këto subjekte të cilët nuk kryejnë paguajnë pagesat e garancive financiare të rehabilitimit të mjedisit.

Për subjektet që nuk kanë kryer pagesat e garancive financiare të rehabilitimit janë bërë propozimet përkatëse (janë marrë masat për propozim për revokim), një pjesë e tyre me marrjen e njoftimeve kanë kryer pagesat.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

26.2. Rekomandim: Drejtoria Minerare pranë AKBN të mbajë korespondencë të vazhdueshme me ministrinë e linjës (MIE) për revokimin e lejeve të shfrytëzimit për subjektet që nuk kryejnë pagesën e garancisë financiare të rehabilitimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigja e institucionit

Për vitin 2022 janë dërguar 16 propozime për revokim në MIE për mospagesë të garancisë së rehabilitimit. Nga këto 16 subjekte 5 prej tyre i kanë bërë pagesat, për 5 subjekte kanë filluar procedurat për revokim, 5 subjekte janë revokuar. (tabela nr.5)

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

27.1. Rekomandim: Drejtoria Ekzekutive e AKBN të marrë masa për plotësimin e kriterëve dhe aplikimin për akreditim, me qëllim rritjen e numrit dhe cilësisë së analizave, rrjedhimisht rritjen e monitorimit të aktivitetit minerar dhe të ardhurave të institucionit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigja e institucionit

Në vijim të sqarimeve të dhëna, sqarojme se organi drejtues i AKBN-së si dhe strukturat

përkatëse të varësisë përkatësisht, Drejtoria Minerare dhe Laboratori Minerar kanë qënë dhe mbeten të angazhuara në marrëdhëniet me DPA-në (Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit) dhe Akreditimi i Laboratorit është kryer me sukses ku Çertifikata e Akreditimit mban datën:15.09.2022 dhe me Numër Regjistrimi LT 116 për një afat 4 vjeçar deri me datë: 14.09.2026.

Gjithashtu jemi të angazhuar maksimalisht për mbarëvajtjen e procesit të kushteve dhe kritereve të DPA-së (Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit) për mbarëvajtjen e titullit të Çertifikimit të Laboratorit sipas rregullave që ky institucion ndjek.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

27.2 Rekomandim: AKBN të marrë masa për hartimin e një rregulloreje të funksionimit të Sektorit të Laboratorit që është në përbërje të Drejtorisë Minerare pranë AKBN-së, si dhe përfshirja e këtij sektori në Statut-Rregulloren e funksionimit të AKBN-së.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e institucionit

Në vijim të sqarimeve, sqarojme se Drejtoria Minerare dhe Laboratori Minerar kanë qënë dhe mbeten të angazhuara për funksionimin e rregullores të Sektorit të Laboratorit që është në përbërje të Drejtorisë Minerare pranë AKBN-së, si dhe përfshirja e këtij sektori në Statut-Rregulloren e funksionimit të AKBN-së.

Për sa i përket hartimit të rregullores është kryer nga ana jone një draft rregulloreje sipas nevojave dhe mirëfunksionimit të Sektorit të Laboratorit dhe është dërguar për miratim në Këshillin Drejtues.

Në zbatim të këtij Rekomandim, me shkresë Nr.216/46 dt.22.09.2022 është dërguar në Këshill Drejtues Relacioni “Mbi disa shtesa dhe ndryshime të nenit 16 i Statut Rregullores së AKBN-së (Objekti i veprimtarisë së Drejtorisë Minerare dhe miratimi i Rregullores së Laboratorit Minerar). Me proces verbal të datës 21.11.2022 i mbajtur nga Këshilli Drejtues i AKBN lidhur me mbledhjen e këtij këshilli me rend dite "Miratimi i disa shtesave dhe ndryshimeve në Statut Rregulloren e AKBN-se"... etj ka vendosur që të mos e marrë në shqyrtim këtë pikë të rendit të ditës.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**

28.1. Rekomandim: Drejtoria Minerare pranë AKBN-së, të hartojë një plan rehabilitimi për këto zona si dhe të përcaktojë listën e minierave që do të kalojnë në mbyllje të përhershme.

Menjëherë

Përgjigjja e institucionit

Nga ana e AKBN-së është dërguar lista e objekteve minerare, të cilat do të kalojnë në mbyllje të përhershme (objekte në të cilat kanë përfunduar rezervat gjeologjike ose nuk kanë interes për rivënie në punë) me shkresë nr.216/51 prot., date 12.10.2022. Kjo procedurë do të ndiqet në vijimësi.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**

28.2. Rekomandim: AKBN të marrë masa për përgatitjen e propozimeve për realizimin e rehabilitimit të këtyre zonave dhe të mbylljes së përhershme të minierave të përcaktuara në listë dhe t'i dërgojë në MIE.

Menjëherë

Përgjigja e institucionit

Shkresat e sipërcituara në pikën 28.1

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

29.1. Rekomandim: Nga ana e AKBN të bëhet kërkesë në MIE për publikimin e zonave të reja për shfrytëzim mineral.

Menjëherë

Përgjigja e institucionit

AKBN ka paraqitur në MIE zonat për miratimin e programit të veprimit 3-vjeçar për zbatimin e strategjisë minerare sipas Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010 “Për Sektorin Mineral të Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar dhe akteve nën ligjore në zbatim të tij, sipas nenit 8 pika 4, 5, 6, 7 të ligjit mineral.

Pika 4. Programi i veprimit për zbatimin e strategjisë minerare hartohet nga ministria pas këshillimit me ministrinë përgjegjëse për mjedisin, pyjet, zona të mbrojtura, tokën bujqësore, trashëgiminë kulturore, turizmin e mbrojtjen dhe njësitë e qeverisjes vendore përkatëse, dhe miratohet nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit.

Pika 5. Në zbatim të programit të veprimit miratohet plani vjetor mineral, i cili përmban zonat minerare, për të cilat do të jepen të drejtat minerare, në vitin përkatës, zonat minerare, të drejtat minerare të cilave përfitohen në bazë të një konkurimi publik, në vijim zona konkurruese, dhe zonat e hapura, të drejtat minerare të cilave përfitohen nga subjektet e interesuara, që plotësojnë kushtet e lejitimit, në vijim zona të hapura.

Pika 6. Plani vjetor mineral hartohet nga struktura përgjegjëse dhe miratohet nga Ministri. Plani vjetor mineral është kalendarik dhe pas miratimit publikohet në faqen e internetit të ministrisë dhe në Fletoren Zyrtare dhe pasqyrohet në hartën minerare dixhitale.

Pika 7. Ministri miraton procedurat për përgatitjen e programit të veprimit për zbatimin e strategjisë minerare dhe të planit vjetor mineral, duke siguruar publikimin, transparencën dhe këshillimet me subjektet e interesuara gjatë këtij procesi.

Drejtorinë përgjegjëse në MIE realizojnë të gjitha procedurat e miratimit të Programit të veprimit për zbatimin e strategjisë minerare nga Këshilli i Ministrave (Urdhëri nr. 305, datë 13.04.2011).

Sa më sipër Drejtoria Minerare pranë AKBN-së ka kryer njoftimet dhe zbatimin e detyrave të saj me dërgimin e propozimeve për zonat minerare (pra ka kryer të gjitha detyrimet ligjore në bazë të ligjit mineral dhe akteve nën ligjore në zbatim të tij). Aktualisht, publikimi i këtyre zonave konkurruese dhe të hapura është kompetencë ligjore e “MIE”-s.

Nga ana e AKBN-së janë dërguar propozimet, plani 3-vjeçar 2022-2024 shkresa me nr 3653/1 datë 01.11.2021, shkresa me nr. 3653/2 datë 28.12.2021 dhe shkresa me nr 1048 prot. datë 22.02.2022, si dhe propozimet për planin vjetor mineral 2022 me shkresën nr.2677/1 prot, datë 13.07.2022.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

30.1. Rekomandim:Drejtoria Minerare pranë AKBN-së të vazhdojë korrespondencën me Ministrinë e linjës, me Organet e pushtetit vendor si dhe me organet ligj zbatuese për ndërprerjen e aktivitetit të subjekteve të cilëve u është revokuar leja, duke marrë masave ligjore për kundërvajtësit, si dhe rehabilitimin e këtyre zonave.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e institucionit

Në Bashkinë Krujë,mbas daljes së V.K.M-së nr. 468, datë 26.07.2018 “Për shpalljen e ekosistemit natyror Krastë-Verjon, Peisazh i Mbrojtur”, në Bashkinë e Krujës u revokuan 16 leje minerare shfrytëzimi, nga të cilat 4 leje minerare shfrytëzimi u revokuan gjatë muajit Dhjetor 2018, ndërsa 12 lejet e tjera u revokuan gjatë muajit Maj 2019.

Gjatë mbikqyrjes në terren të lejeve minerare të shfrytëzimit që janë aktive në Bashkinë Krujë në Tetor 2021, nga specialistët e Drejtorisë Minerare është vërejtur se, në ish lejet minerare të shfrytëzimit të revokuara në zonën “Krastë -Verjon” që është shpallur zonë e mbrojtur sipas V.K.M nr. 468, datë 26.07.2018, kryhet aktivitet minerar nga individë të palicensuar duke shmangur detyrimet e rentës minerare, pagesën e detyrimeve për rehabilitimin e zonës së dëmtuar dhe duke kryer aktivitet minerar jashtë kushteve teknike.

AKBN ka njoftuar rregullisht MIE, Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit dhe Bashkinë Krujë lidhur me situatën e krijuar në këtë zonë. (shkresa Nr. 2670 prot., datë 10.06.2022) dhe shkresa nr. 354/1 prot., datë 24.01.2023, drejtuar MIE në lidhje me situatën aktuale në këtë zonë.

Subjektet, zotërues të ish lejeve minerare të shfrytëzimit në këtë zone (6 prej tyre), të revokuara, janë në proces gjyqësor në Gjykatën Administrative të Shkallës së Dytë.

AKBN-ja, në vijimësi do të bëjë verifikimin duke informuar instancat përgjegjëse si Ministrinë e linjës, Pushtetin vendor dhe organet ligj zbatuese për zbatimin e kompetencave ligjore.

Në Bashkinë e Skraparit,

Bazuar në VKM Nr. 611, datë 11.09.2019 "Për zgjerimin e sipërfaqes së parkut kombëtar “Mali i Tomorit”, dhe në zbatim të Urdhërit të Ministrit nr. 378, datë 07.10.2019 “Për caktimin e grupeve të inspektimit në terren për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vlerësimin e përmbushjes së kërkesave ligjore nga subjektet që ushtrojnë veprimtari për shfrytëzimin minerar, brenda dhe në afërsi të parkut kombëtar të "Malit të Tomorit” u be revokimi i 11 lejeve minerare me datë 19.12.2019.

Nga vrojtimit e kryera prej specialistëve të AKBN-së rezulton se; në zonën Novaj është kryer aktivitet minerar në të gjitha ish lejet minerare të shfrytëzimit dhe sipërfaqja e prekur nga shfrytëzimi është rritur në raport me atë që ka qenë në momentin e revokimit të lejeve minerare të shfrytëzimit.

AKBN ka njoftuar rregullisht MIE, Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit dhe Bashkinë Skrapar lidhur me situatën e krijuar në këtë zonë. (shkresa Nr. 2523 prot., datë 01.06.2022)

Ndalimi i aktivitetit minerar në zonë, është në kompetencë të pushtetit lokal dhe organeve ligj-zbatuese të Policisë së Shtetit, duke i paraprirë rehabilitimit të zonës.

Sqarojmë se 6 (gjashtë) subjekte minerare jane në proces gjyqësor, në Gjykatën e Apelit Vlorë.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

Mbi shfrytëzimin e burimeve hidroenergjitike.

31.1. Rekomandim: AKBN të marrë masa për rritjen e monitorimit të aktivitetit të realizimit të veprave hidrike, sipas përcaktimeve në marrëveshjet përkatëse dhe akteve ligjore në fuqi.

Në vijimësi

Përgjigja e institucionit

Procesi i monitorimit të aktivitetit të realizimit të veprave hidrike është i kushtëzuar nga buxheti i akorduar nga MIE për këtë proces, buxhet i cili ka ardhur duke u reduktuar nga viti në vit. AKBN i ka kërkuar vazhdimisht MIE-s rritjen e buxhetit në menyrë që të realizohet një proces monitorimi sa më i plotë, ku së fundmi është dërguar shkresa Nr.265 Prot., datë 13.01.2023 me lëndë “*Kërkesë për përmirësimin e fondit në procesin e monitorimit të kontratave koncesionare në fushën e hidroenergjisë*”. Në varësi të fondit të vënë në dispozicion nga MIE për fushën e monitorimit të kontratave koncesionare, Drejtoria e Monitorimit të heceve pasi rakordon edhe me Drejtorinë Ekonomike përshtat Planin e Monitorimit Vjetor në terren ku të kushtëzuar edhe nga buxheti bëhet një kategorizim i përzgjedhjes së kontratave që do të monitorohen në terren. Drejtoria e Monitorimit të Heceve ka për qëllim përfshirjen e sa më shumë kontratave në planin e monitorimit në terren. Duke pasur parasysh pamundësinë e monitorimit çdo tre muaj sipas përcaktimit të këtyre kontratave të kufizuar nga buxheti dhe struktura e vogël e Drejtorisë së Monitorimit të Hidrocentraleve, kriteret për përzgjedhjen e kontratave që do të monitorohen në terren janë si më poshtë :

-Kontrata të cilat kanë objekte në fazë ndërtimit.

-Kontrata të cilat kanë rezultuar në përfundim të fazes ndërtimore një vit më parë ose në fazë testimi ose prag testimi.

-Kontrata të cilat janë në fazë prodhimi jo të plotë, pra kanë ende objekte të papërfunduara të cilat mund të jenë në fazë ndërtimi ose jo.

-Kontrata për të cilat nuk kemi informacion zyrtar që të kenë filluar ndërtimin por disponojmë informacion mbi pajisjen e tyre me Leje.

-Kontrata për të cilat janë konstatuar, raportuar apo deleguar për trajtim problematika të ndryshme pavarësisht fazës në të cilën ndodhen.

-Kontrata në fazë prodhimi të cilat janë në prag të përmbushjes së 15 – vjeçarit të parë në prodhim.

Mbi këto baza u hartua edhe Planin e Monitorimit në terren në vijim për vitin 2023 me Nr.2547Prot., datë 22.05.2023.

Pavarësisht vështirësive serioze nga pamjaftueshmëria e buxhetit për monitorim dhe struktura e kufizuar në staf e Drejtorisë së Monitorimit të hidrocentraleve, prej vitit 2020 raportohet për të gjitha kontratat pavarësisht nëse janë pjesë e planit të monitorimit në terren ose jo duke informuar MIE mbi ecurinë e kontratave. Nëse bëjmë një krahasim me raportimin para vitit 2020, raportet e monitorimit që i dërgoheshin MIE do të përfaqësonin 30% të raportimit që bëhet sot. Përveç raporteve të monitorimit AKBN vijon monitorimin e vazhdueshëm shkresor “*mbi përmbushjen e detyrimeve kontraktuale*” që zhvillohet në një hark kohor edhe më të shkrurtër se çdo tre muaj për kontratat e koncesionit apo VKM 822 që nuk kanë filluar punimet në komunikimet e shpeshta me kompanitë.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**

32.1. Rekomandim: Drejtori Ekzekutiv i AKBN të marrë masa për të siguruar një shpërndarje të përafërt të monitorimeve gjatë gjithë vitit, si dhe të sigurojë monitorimin e plotë të të gjitha kontratave koncesionare, duke informuar në mënyrë të detajuar MIE mbi problematikën evidentuara dhe inkurajuar bashkëpunimin me institucionet e tjera publike për disiplinimin e

fushës së prodhimit të energjisë elektrike.

Në Vijimësi

Përgjigja e institucionit

Shpërndarja e përafërt e monitorimeve gjatë vitit do të ishte një element shumë praktik për punën e Drejtorisë së Monitorimit të heceve, por theksojmë se hartimi i Planit të Monitorimit, rakordimi i tij me vlerën e përcaktuar në buxhet për monitorim dhe rakordimi me Drejtorinë Ekonomike janë të mundura të realizohen vetëm pas miratimit dhe dërgimit të buxhetit nga MIE për AKBN. Në përgjithësi kjo vonesë është konsiderueshme dhe si pasojë ndikon që AKBN të ketë në dispozicion për të realizuar të gjitha proceset e përmendura vetëm gjysmën e vitit. Kjo situatë ashtu siç me të drejtë është konstatuar edhe nga Auditi i KLSH krijon problematika në menaxhimin e kohës së mbetur, realizimin e objektivave dhe shkakton ngarkesë të tepërt tek punonjësit e Drejtorisë së Monitorimit të Heceve, ku duhet theksuar se dhe vet struktura e kufizuar në staf e Drejtorisë krijon vazhdimisht ngarkesë të tepërt të punës. Kështu për sa më sipër përmendim këtu se buxheti i miratuar dhe akorduar për të vijuar monitorimin e kontratave konçesionare nga AKBN ka ardhur me shkresën Nr.1561/2Prot., datë 03.05.2023, pra në muajin Maj. Drejtoria e Monitorimit të heceve në rakordim me Drejtorinë Ekonomike përshpejtuan rakordimet përkatëse dhe me shkresën Nr.2547Prot., datë 22.05.2023 Drejtoria e Monitorimit të Heceve dërgoi për Miratim tek Dr.Ekzekutiv Planin e Monitorimit në terren për vitin 2023 ku deri tani në rakordim me të gjitha strukturat e Drejtorisë Ekonomike dhe Drejtorisë së Administratës dhe mbështetjen e Drejtorit Ekzekutiv Plani ka vijuar zbatimin e tij pa ndërprerje.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**

33.1. Rekomandim: Drejtori Ekzekutiv i AKBN të marrë masa për të evidentuar në mënyrë të hollësishme të gjitha kontratat konçesionare, në të cilat ka rritje të prodhimit të energjisë elektrike nga oponenta teknike por që nuk është ndryshuar sasia e prodhimit në kontratë fuqia e hidrocentraleve, duke njoftuar për këtë qëllim Autoritetin kontraktor (MIE).

Brenda muajit nëntor 2022

Përgjigja e institucionit

Në zbatim të Rekomandimit të KLSH por edhe në vijim të zbatimit të kompetencave të AKBN për raportimin e situatës tek Autoriteti Kontraktor, me shkresën Nr.216/70 Prot., datë 25.11.2022 me lëndë “Mbi zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së” është dërguar informacioni me kontratat e evidentuara në mënyrë të hollësishme, në të cilat ka rritje të prodhimit të energjisë elektrike nga oponenta teknike por që nuk është ndryshuar sasia e prodhimit në kontratë. Më herët dhe në përmbajtje të një informacioni më të zgjeruar se kjo problematikë, AKBN ka informuar MIE me shkresën Nr.3505Prot., datë 30.09.2021 me lëndë “Informacion i përmbledhur në vijim të monitorimit mbi përmbushjen e detyrimeve kontraktuale të shoqërive konçesionare në fushën hidroenergjitike” ku jepet informacion mbi të gjitha kontratat konçesionare të kategorizuara sipas të gjitha problematikave që kanë dalë nga monitorimi i AKBN në funksion të vendimarrjes nga ana e MIE në cilësinë e Autoritetit Kontraktor.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**

34.1. Rekomandim:Drejtori Ekzekutiv i AKBN të njoftojë me shkrim MIE në mënyrë të detajuar lidhur me problematikat ligjore, funksionale dhe të menaxhimit të burimeve njerëzore që ka nxjerrë dhe janë evidentuar në praktikë nga zbatimi i VKM dhe Udhëzimit të mësipërm.

Deri në fund të vitit 2022

Përgjigjja e institucionit

Në zbatim të Rekomandimit të KLSH por edhe në vijim të kërkesave tona të më hershme dhe të vazhdueshme lidhur me shumë paqartësi në zbatimin e Udhëzimeve të VKM Nr.332 datë 6.6.2018, Drejtoria e Monitorimit të Heceve ka njoftuar me shkrim MIE me shkresën Nr.216/77Prot.,date 29.12.2022 me lëndë “Mbi zbatimin e rekomandimeve të KLSH” ku problematikat e konstatuara nga KLSH lidhur me Udhëzimin e MIE Nr.10496,datë31.07.2018 të VKMsë Nr.332,datë 06.06.2018 janë zbërthyer në çështje dhe pyetje konkrete nga AKBN për MIEn ku në thelb është një korrespondencë e cila ka nisur më herët dhe ende është e paqartë. Ashtu si konstatohet edhe nga KLSH, përveç paqartësisë për të vepruar sipas Udhëzimit Nr.10496,datë31.07.2018 të VKMsë Nr.332,datë 06.06.2018, Drejtoria e Monitorimit të Heceve përballet edhe me vështirësinë e stafit të kufizuar për monitorim.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **zbatuar pjesërisht**.

35.1. Rekomandim: Drejtori Ekzekutiv i AKBN t`i propozojë Ministrit rregullimin e raporteve midis ekspertëve të jashtëm e të brëndshëm, në favor të këtyre të fundit duke përcaktuar kriteret e duhura, si dhe të rekrutojë staf profesional në përputhje me detyrat funksionale institucionale.

Brenda muajit tetor 2022

Përgjigjja e institucionit

Në zbatim të Rekomandimit të KLSH, AKBN me shkresën Nr.216/56 Prot.,datë 24.10.2022 iu drejtua MIEs për të përmbushur këtë rekomandim. Në vijim MIE me shkresën Nr.1061Prot.,datë 09.02.2023 pranoi kërkesën e AKBN për të dërguar një propozim konkret. AKBN me shkresën Nr.27.02.2023 ka dërguar në MIE propozimin sipas kërkesës.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

36.1. Rekomandim: Drejtori Ekzekutiv i AKBN të marrë masa për të siguruar performancë të plotë të grupit të oponencës teknike, duke zhvilluar mbledhjet e nevojshme për shmangien e vonesave dhe disiplinimin e sektorit të prodhimit të energjisë elektrike.

Në vijimësi

Përgjigjja e institucionit

Pavaresisht se mungesa e rakordimit nga ana e MIE në shqyrtimin e propozimeve(AKBN i drejtohet MIE me shkresën Nr.281/1Prot.,datë 21.01.2022 dhe sërish për të njëjtën arsye dhe mungesën e përgjigjes me shkresën Nr.1500/1Prot.,datë 07.04.2022) për ndryshime në anëtarët e Grupit të Oponencës Teknike krijoi vonesa në pjesën e parë të vitit 2022 dhe ende sot nuk kemi përgjigje mbi propozimet e AKBN sipas Rregullores se Oponencës Teknike, AKBN vijoi organizimin e mbledhjeve për të shmangur tejzgjatjen e mëtejshme të procedurës. Referuar numrit të praktikave në pritje per oponencë teknike gjatë kohës së auditimit dhe në vijim të zbatimit të rekomandimeve situata ka ndryshuar në përputhje me zbatimin e Rekomandimit të KLSH ku janë marrë masa për zhvillimin e mbledhjeve dhe uljen e numrit të praktikave në pritje ku janë organizuar në vijim 8 mbledhje të Grupit të Oponencës Teknike. Pavarësisht se situata e kërkesave apo delegimeve nga MIE për kryerje të procedurës së Oponencës Teknike

ka ardhur në ulje drastike krahasuar me vite më pare, theksojmë se duke pasur parasysh që anëtarët e jashtëm të Grupit të Oponencës Teknike paguhen nga AKBN (*pavarësisht se në gjykimin tonë ky diferencim nga anëtarët e brendshëm është i padrejtë për sa kohë procesi i kryerjes së Oponencës Teknike të projekt zbatimeve për ndërtimin e hidrocentraleve është njësoj kompleks dhe kërkon njësoj angazhim të shtuar edhe për anëtarët e brendshëm të grupit të oponencës teknike që janë pjesë e AKBN*), në cdo rast janë marrë masat që mos të zhvillohen mbledhje vetëm për një praktikë të vetme pasi kjo do të sillte kosto të shtuar për AKBN në kushtet ku pamjaftueshmëria e buxhetit është një pengesë reale në kryerjen e detyrave të Drejtorisë së Monitorimit të Heceve. Një ndër përpjekjet kryesore në këtë drejtim ka qenë organizimi i mbledhjeve duke rritur numrin e praktikave për shqyrtim në një mbledhje dhe duke zvogëluar numrin e mbledhjeve në total. Nga ana tjetër edhe në zbatim të Rekomandimeve të KLSH nuk janë futur në mbledhje asnjë praktikë pa përmbushur detyrimin e plotësimit të dokumentacionit të nevojshëm.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

37.1. Rekomandim: Drejtori Ekzekutiv i AKBN të marrë masat e nevojshme për të rritur frymën e bashkëpunimit me MIE për shkëmbimin e informacionit lidhur me ecurinë e zgjidhjes së problematikave të evidentuara gjatë monitorimit të kontratave koncesionare në fushën energjetike.

Në vijimësi

Përgjigja e institucionit

AKBN ka vijuar komunikimin e panderprere me MIE në këtë drejtim duke paraqitur të gjithë informacionin e grumbulluar të mundshëm jo vetëm nëpërmjet Raporteve Periodike të Monitorimit (*në vijim pas Auditimit është dërguar Raporti Nr.4612/1 Prot., datë 04.11.2022*) por edhe shkresave të veçanta dhe intesifikimit të komunikimeve me shoqëritë koncesionare ku në cdo rast MIE në cilësinë e Autoritetit Kontraktor është në dijeni. Angazhimi nga AKBN ka qenë i vazhdueshëm duke vënë në dispozicion të raportimit të gjithë informacionin e grumbulluar nga monitorimi dhe duke paraqitur të detajuar situatën për MIE në cdo rast kur është kërkuar. Lidhur me ndryshimin e prodhimit të energjisë elektrike nga oponenca teknike në kontratat koncesionare ky element evidentohet në cdo rast në raportin teknik që i përcillet MIE dhe ashtu sic është përmendur edhe me lart përveç se në raportet e monitorimit ky informacion i dërgohet MIE edhe me shkresa të veçanta ku përmbledhen problematikat e monitorimit si shkresa Nr.3505 Prot., datë 30.09.2021 ose shkresa Nr.216/70 Prot., datë 25.11.2022.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

38.1. Rekomandim: Drejtori Ekzekutiv i AKBN të hartojë një dokument pune të veçantë me propozime konkrete për institucionalizimin e marrëdhënieve me MIE, në zgjidhje të problematikave të evidentuara nëpërmjet informacioneve përkatëse të AKBN.

Brenda vitit 2022

Përgjigja e institucionit

Duke pasur parasysh se AKBN here pas here i është Drejtuar MIEs duke raportuar fillimisht problematikat që shoqërojnë procesin e monitorimit e kryesisht vështirësitë me të cilat përballet AKBN në këtë proces kompleks dhe voluminoz, ka propozuar vazhdimisht se cilat janë drejtimet kryesore për të ndërhyrë. Dy problematikat kryesore ku hasen dhe vështirësitë më të mëdha në procesin e monitorimit janë :

-Përcaktimi i qartë i Autoritetit të AKBN si Institucion Monitorues edhe në raport me institucionet e tjera për proçse apo proçedura që janë vazhdim i njëra tjetrës.

-Buxheti i pamjaftueshëm i monitorimit.

Për të dyja problematikat, AKBN vazhdimisht ka përcjellë shqetësimet e saj por jo vetëm, duke dërguar edhe propozimet përkatëse si për periudhën para Auditimit të KLSH ashtu edhe pas :

-Shkresa Nr.519/6Prot.,datë 08.06.2021 “Dërgohen Propozimet për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga Auditi i Brendshëm i MIE”.

-Shkresa Nr.4487 Prot.,datë 14.12.2021 “Kërkesë për përmirësim të fondit për procesin e monitorimit të Kontratave Konçesionare në Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore”.

-Shkresa Nr.265Prot.,datë 13.01.2023 “Kërkesë për përmirësimin e fondit në procesin e monitorimit të kontratave konçesionare në fushën e hidroenergjisë”.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga **i zbatuar**.

39.1 Rekomandim: Grupi i oponencës teknike të marrë masa për shqyrtimin me detaje të dokumentacionit teknik të projekteve, me synim garantimin e respektimit të kushteve teknike të projektimit, shfrytëzimin optimalë të burimeve ujore, si dhe realizimin e investimeve me efikasitet të lartë dhe ndikim sa më të ulët në mjedis.

Në vijimësi

Përgjigjja e institucionit

Theksojmë se pasi janë plotësuar vërejtjet për cdo praktikë, grupi i Oponencës Teknike ka konkluduar në vlerësimin tekniko-mjedisor të projektit të zbatimit dhe e ka dërguar në MIE. Raporti i oponences teknike hartohet pasi trajtohen dhe studiohen nga grupi të gjitha raportet inxhinierike. Ky raport hartohet nga anetarët që janë ekspert në fushat përkatëse, dhe vlerësimi i dhënë bazohet në standartet Shqiptare dhe Europiane të ndërtimit dhe projektimit, me qëllim kryesor garantimin e respektimit të kushteve teknike të projektimit, shfrytëzimin optimalë të burimeve ujore, si dhe realizimin e investimeve me efikasitet të lartë dhe ndikim sa më të ulët në mjedis.Rekomandimet që janë lënë në raportin e dërguar në MIE janë për të siguruar mbarëvajtjen e punimeve gjatë fazës së zbatimit (pra ndërtimit të veprës) për tu marrë në konsideratë, mirëfunksionimin e veprës dhe një pjesë e tyre ëshë lënë për tu marrë në konsideratë gjatë marrjes së lejeve përfundimtare si ajo e përdorimit të Burimit Ujore, Leja e Mjedisit, Leja nga Bashkia përkatëse, Leja e lidhjes me Sistemin dhe Leja e Ndërtimit.

Në vijim grupi i Oponencës Teknike do të trajtojë me përgjigjësi maksimale dhe korrektësi cdo praktikë që do të trajtohet.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

40.1 Rekomandim: AKBN në bashkëpunim me MIE të marrin masa për analizimin e situatës së koncesionarëve në fushën e HEC-eve, për vështirësitë që paraqiten në plotësimin e dokumentacionit tekniko-ligjor të koncesionarëve, sidomos në marrjen e lejeve përkatëse, angazhimin maksimal për reduktimin e kohës së nevojshme për miratimin e projekteve, lejeve, oponencës teknike etj., me synim realizimin e afateve të parashikuara në kontrata për realizimin e veprave dhe hyrjen në një kohë sa më të shpejtë në prodhim të tyre.

Në vijimësi

Përgjigjja e institucionit

Në rastet e komunikimit me shoqëritë koncesionare të cilat janë në fazë procedurash mbledhet i gjithë informacioni i ecurisë së aplikimeve dhe kjo kategori kontratash evidentohet më vete në raportet e monitorimit me titullin “Kontrata në fazë procedurash”ku MIEs i pasqyrohet qartë në detaje ecuria e procedurave për pajisjen me lejet përkatëse. Gjithashtu në korrespondenca të

veçanta gjatë raportimit të shoqërive koncesionare, informohet MIE për raste të caktuara ku ka vështirësi në ecurinë e procedurave ashtu sikundër në mungesë të parashikimit të sanksioneve për vonesa, janë konstatuar raste ku nuk ka asnjë përpjekje në vijim nga shoqëritë për marrjen e lejeve përkatëse. Më poshtë paraqesim tre raste konkrete për periudhën pas auditimit të KLSH:

- Shkresa e AKBN Nr.989/7Prot.,datë 01.12.2022 mbi ecurinë e procedurave për kontratën “Ura e Tamarës” drejtuar MIE, për dijëni shoqëria koncesionare.
- Shkresa e AKBN Nr.269/4Prot.,datë 11.05.2022 drejtuar MIE mbi vakumin e konstatuar nga AKBN në kontratën shtesë për Hecet Bençë Tepelenë e si pasojë mbi tejzgjatjen e afateve për vijimin e procedurave nga shoqëria.
- Shkresa e AKBN Nr.1387/7Prot.,datë 23.12.2022 drejtuar MIE mbi problematikën e raportuar nga shoqëria koncesionare për vijimin e procedurave nga ana e saj në institucionet lokale të zonës.

Si tre rastet e sipërcituara, në çdo rast komunikohet me shoqëritë mbi ecurinë e procedurave të aplikimit dhe pajisjeve me lejet përkatëse ku mbahet e informuar MIE në cdo rast, si në rastet kur mund të duhet ndërhyrja e saj në institucionet e tjera ashtu edhe kur duhet të marrë masa për rastet e tjera kur konstatohet se nga ana e shoqërive nuk ka përpjekje për vijim procedurash.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe në **proçes zbatimi**.

40.2 Rekomandim: Për investime të cilat kanë një kohë të konsiderueshme për të cilat nuk kanë filluar zbatimet, të merren masa për ndërprerjen e kontratës, në mënyrë që të hapet mundësia për realizimin e këtyre investimeve nga operatorë të tjerë ekonomikë.

Në vijimësi

Përgjigjja e institucionit

Në rastet e komunikimit me shoqëritë koncesionare të cilat janë në fazë procedurash mblihdet i gjithë informacioni i ecurisë së aplikimeve dhe përveç se kjo kategori kontratash evidentohet më vete në raportet e monitorimit me titullin “Kontrata në fazë procedurash”ku MIEs i pasqyrohet qartë në detaje ecuria e procedurave për pajisjen me lejet përkatëse. Gjithashtu në korrespondenca të veçanta gjatë raportimit të shoqërive koncesionare, informohet MIE për raste të caktuara ku ka vështirësi në ecurinë e procedurave ashtu sikundër në mungesë të parashikimit të sanksioneve për vonesa, janë konstatuar raste ku nuk ka asnjë përpjekje në vijim nga shoqëritë për marrjen e lejeve përkatëse. Më poshtë paraqesim tre raste konkrete për periudhën pas auditimit të KLSH :

- Shkresa e AKBN Nr.989/7Prot.,datë 01.12.2022 mbi ecurinë e procedurave për kontratën “Ura e Tamarës” drejtuar MIE, për dijëni shoqëria koncesionare.
- Shkresa e AKBN Nr.269/4Prot.,datë 11.05.2022 drejtuar MIE mbi vakumin e konstatuar nga AKBN në kontratën shtesë për Hecet Bence Tepelenë e si pasojë mbi tejzgjatjen e afateve për vijimin e procedurave nga shoqëria.
- Shkresa e AKBN Nr.1387/7Prot.,datë 23.12.2022 drejtuar MIE mbi problematikën e raportuar nga shoqëria koncesionare për vijimin e procedurave nga ana e saj në institucionet lokale të zonës.

Lidhur investime të cilat kanë një kohë të konsiderueshme për të cilat nuk kanë filluar zbatimin, janë marrë masat e menjëherëshme në raportet e monitorimit të rradhës ku janë bërë propozimet përkatëse për MIE-n për të gjitha ato kontrata që sipas Rekomandimt të KLSH janë të ekspozuara për zgjidhjen e tyre të njëanshme. Kështu me raportin e monitorimit dërguar MIE

me Nr.2744/1Prot.,datë 06.06.2023 janë dhënë propozimet bazuar në Rekomandimn e KLSH për këto kontrata/hece :

Vendimarrja është kompetencë dhe ekskluzivitet i Autoritetit Kontraktor.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet i **pranuar** nga subjekti dhe i **pazbatuar**.

Nr.	Shoqëria Koncesionare	Hec-i/et
1	E. B.HPP shpk	Batra 1,2,3
2	S. E.shpk	Bershë Klos
3	HP Z. E. shpk	Bregu I Madh
4	L & G E. shpk	Guri I Kuq 1/1, 1/2
5	Hec H. shpk	Kaskada e Hec-eve Hotolisht
6	T.-ALB sha	Hec-et mbi Lumin Curraj
7	C.-As E.shpk	Zheja 1,2
8	A. E. shpk	Kiri, Gjuraj, Kashec,Rragam, Lepurushe
9	Z.I T. shpk	Sheba 1,2,3,4
10	M. E. shpk	Runja
11	A. H. 2013 shpk	Shkopet 1,2,3
12	C.E. AL shpk	Vajkal
13	Hi. C. shpk	Cangonj
14	N.S.E. shpk	Iballë 1,2, Sapac 1,2, Berishë, Liqeni
15	B.-I.E. shpk	Kalivar 1,2,3,4
16	H. L. F.shpk	Labinot Fushë
17	F. shpk	Nishan
18	H. shpk	Potam
19	H. Q. shpk	Quku 1,2
20	Hec V. shpk	Vernik 1,2,3,4
21	"B.E." sh.p.k	Vranisht, Stropan, Grapsh-Zicisht, Hociisht
22	"R. E." sh.p.k	Zaje, Tujan, Xhaferraj, Kollovoz, Novoseje, Meshteken
23	"G. E. A." sh.p.k	Hec-et mbi Zallin e Qarrishtes
24	"D6" sh.p.k	Dobjot, Arrez, Miras, Menkulas, Bracen, Kuc
25	"K. E." sh.p.k	Driza 1
26	"HP . 1 & 2 E." sh.p.k	Prishta 1,2
27	"EL-ER E. A." sh.p.k	Stojan

MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1.1 Rekomandim: Drejtori Ekzekutiv i AKBN të marrë masa duke njoftuar subjektet përkatëse për të kryer pagesat mësipërme, duke ngarkuar sektorin e financës për ndjekjen dhe zbatimin e këtij Rekomandim.

Menjëherë

Përgjigjja e institucionit

Në vijim të njoftimit të këtyre subjekteve të cilat janë njoftuar dy herë gjatë vitit 2020, pra menjëherë pas rekomandimeve të lëna nga Auditimi i KLSH në vitin 2019 dhe duke pasur parasysh se ky detyrim nuk u shlye nga të gjitha subjektet, AKBN kërkoi mbështetjen e MIE ku me shkresën Nr.216/22Prot.,datë 19.04.2022 bashkë me listën e subjekteve debitore kërkoi dhe propozoi në mënyrë të detajuar se :

Në përgjigje të kërkesave të AKBN-së kundrejt subjekteve për shlyerjen e detyrimit, 113 subjekte nga 191 që rezultojnë debitore, kanë shlyer detyrimin sipas kërkesës së AKBN, duke derdhur në llogarinë e institucionit shumën prej 5,060,000 lekesh e cila përfaqëson më shumë se 60% të vlerës totale.

Për subjektet të cilat nuk kanë paguar ende diferencën e TVSH sipas rekomandimeve të KLSH, AKBN pas ezaurimit të rrugëve administrative, do të fillojë ndjekjen e procedurave përkatëse për vjeljen e këtyre detyrimeve në rrugë gjyqësore. Nga ana tjetër AKBN e shqyrtoi këtë

problem të mbetur edhe nga ana financiare duke pasur parasysh vlerat jo të konsiderueshme të pagesave për t'u kryer dhe koston që mund të kishin proceset gjyqësore në raport me këto vlera. Për të shmangur kryerjen e shpenzimeve me pasoja financiare për institucionin, si dhe duke pasur parasysh se:

- Jane 78 subjekte detyrimet e të cilave kundrejt AKBN-se variojnë nga 40,000 lekë në 140,000 lekë;
- 53 subjekte i kanë adresat e selive në rrethe;
- Kostot e institucionit për ndjekjen e proceseve gjyqësore mund ta kalojnë disa here vlerën e objektit të padisë duke sjelle rezultat të kundërt nga ai që rekomandohet nga KLSH,
- Pjesa dërmuese e këtyre subjekteve janë në procedura për sigurimin e marrëveshjeve me MIE sipas VKM 822 Datë 07.10.2015 dhe në fazën aktuale nuk kanë procedura të tjera pasuese në AKBN, por vijnë në MIE ,

AKBN propozoi që, nga ana e MIE-s të mos kryhen veprime me këto subjekte deri në shlyerjen e plotë të detyrimeve të tyre kundrejt AKBN-së. Pra, propozimi i AKBN për MIE ishte bllokimi i procedurave pasardhëse për këto subjekte deri në shlyerjen e detyrimeve për AKBN.

MIE me shkresën Nr.216/3Prot.,datë 21.06.2022 iu drejtua të gjitha shoqërive debitoare dhe kërkoi shlyerjen e detyrimit sipas informacionit të dhënë nga AKBN. Përsëri me shkresën Nr.216/48Prot.,datë 29.09.2022 AKBN kërkoi mbështetjen e MIE duke dërguar listën e përditësuar të debitorëve numri i të cilëve mbetet sërish i lartë. Numri i subjekteve që kryen pagesat ishte sërish i ulët ashtu siç paraqitet edhe me shkresën e MIE Nr.216/31 Prot.,datë 08.07.2022.Në vijim të komunikimit të brendshëm, Drejtoria e Monitorimit të Hidrocentraleve ka përcjellë informacionin me të gjitha shoqëritë debitoare për Drejtorinë Juridike dhe Ekonomike me shkresën Nr.216/49Prot.,datë 06.10.2022.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar pjesërisht**.

MASA DISIPLINORE

Mbështetur në ligjin nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës”, i ndryshuar, nenet 37, 141 e 153 pikat 1 dhe 2, Statut-Rregulloren e Funkcionimit të Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, neni 26, si dhe kontratave individuale të punës, për shkeljet e evidentuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, i rekomandohet Drejtorit Ekzekutiv që të analizojë dhe të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për secilin punonjës, për mangësitë dhe shkeljet e konstatuara dhe të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, me qëllim fillimin e procedurave për dhënien e masave disiplinore.

Përgjigja e institucionit Në zbatim të Rekomandimit të KLSH, me Urdhër të Drejtorit Ekzekutiv dhe në bashkëpunim me Drejtorinë e Administratës janë marrë masat si më poshtë :

1. Është ngritur Urdhëri Nr.158 datë 29.07.2022 nga Drejtori Ekzekutiv “*Për Zbatimin e Rekomandimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit të lënë në Raportin Përfundimtar me Nr.1418/15,date 19.07.2022 (Masat Disiplinore),*” ku janë ngarkuar për zbatimin e këtij Urdhri të gjithë Drejtoritë e AKBN dhe Drejtoria e Administratës.
2. Shkresa Nr.216/37Prot.,date 02.08.2022 me lëndë “*Mbi propozimin e masave disiplinore nga Drejtorët e Drejtorive*”ku Drejtoria e Administratës i kërkon të gjitha Drejtorive që të dërgohen vlerësimet dhe propozimet e tyre për dhënien e masave disiplinore.
3. MEMO Nr.216/52Prot.,date 19.10.2022 me lëndë “*Dërgohen propozimet e masave disiplinore*”, Drejtoria e Monitorimit të Heceve i përcjell Drejtorisë së Administratës

dhe Drejtorit Ekzekutiv propozimet për masat disiplinore “*Tërheqje vëmëndje*” për dy punonjës dhe propozimin për masë disiplinore “*Paralajmërim për largim nga puna*” për një punonjës.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve në AKBN për Raportin Përfundimtar të Auditimit “Për auditimin financiar dhe përputhshmëri” dërguar me shkresën nr. 1418/1, datë 12.01.2022, rezulton se subjekti i audituar ka respektuar afatin 20 ditor për hartimin e planit të masave për zbatimin e rekomandimeve në përputhje me kërkesat e nenit 15 shkronja (j) të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, ka respektuar afatin për njoftimin brënda 6 muajve mbi ecurinë e zbatimit të këtyre masave, në përputhje me kërkesat e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Konkretisht ecuria e zbatimit të rekomandimeve paraqitet sipas tabelës “*Ecuria e zbatimit të rekomandimeve*”

Masa	Gjithsej		Pranuar		Zbatuar plotësisht		Pjesërisht		Në proces		Pa zbatuar	
	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë
Propozim për ndryshim legjislativ	1	-	1	-	1	-	-	-	-	-	-	-
Masa Organizative	52	-	52	-	36	-	4	-	10	-	2	-
Masa për menaxhimin e efektivitetit të fondeve buxhetore	1	320,000 4,460,000	1	320,000 4,460,000	1	-	-	-	-	-	-	-
Disiplinore	1	-	1	-	1	-	-	-	-	-	-	-
Gjithsej	55	4,720,000	55	4,720,000	39	-	4	320,000	10	-	2	-

Sa sipër rezulton se janë dhënë gjithsej 55 rekomandime të cilët janë pranuar plotësisht (100 %), dhe rezultojnë të zbatuar plotësisht 39 masa (71 %).

Për të gjitha rekomandimet që konsiderohen në proces zbatimi, inkurajohet përsheptimi i realizimit të plotë të tyre.

Për sa më sipër ri kërkojmë që Agjencia Kombëtare të Burimeve Natyrore të marrë të gjitha masat e nevojshme me qëllim zbatimin e të gjitha rekomandimeve që rezultojnë të zbatuara pjesërisht dhe pazbatuara brenda 3-mujorit të parë të vitit 2024. Si dhe kërkojmë marrjen e masave disiplinore për zyrtarët përgjegjës, në lidhje me rekomandimet e KLSH të pranuar prej institucionit dhe që efektivisht rezultojnë të pa zbatuara.

3.8 AGJENCIA PER ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL

PËRMBLEDHJE

Në zbatim të Programit të Auditimit nr. 613/26 datë 06.07.2023 “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e evaduar në 6-mujorin e parë të vitit 2021”, në ambientet e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural më datë, 25.07.2023 u mbajt akt-verifikimi nga audituesit e autorizuar të KLSH-së z. G.H dhe znj. A.K me përfaqësues nga subjekti z. O. M. në cilësinë e Titullarit të institucionit dhe znj. E. S. e autorizuar për trajtimin e rekomandimeve të KLSH-së.

Objekt i këtij akt verifikimi është:

Verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të KLSH të lëna me shkresën nr.526/8 datë 13.10.2021 për Raportin Përfundimtar të Auditimit “Për auditimin financiar dhe përputhshmëri” të ushtruar në Agjencinë e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural, sipas programit të auditimit nr. 526/1 prot., datë, 17.05.2021, në lidhje mbi statusin e zbatimit të rekomandimeve, afateve dhe niveli i zbatueshmërisë së tyre, koherencën e tyre si dhe përgjegjshmërinë menaxheriale referuar standardeve të auditimit.

Auditimi u krye nga:

1. G.H

2. A.K

Auditimi ka filluar më datë 07.07.2023

Auditimi ka përfunduar më datë 25.07.2023

Auditimi është kryer në bazë të Programit të Auditimit të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit nr.613/26 prot., datë 06.07.2023 me objekt: “Mbi verifikimin e zbatimi të rekomandimeve”, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” si dhe në zbatim të Rregullores së Procedurave të Auditimit dhe të Manualit për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të auditimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe Regjistrisë elektronik institucionale, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 67, datë 13.06.2020.

TRAJTIMI I ÇËSHTJEVE TË AUDITIMIT

Nga auditimi i ushtruar në Agjencinë e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, “Mbi auditimin financiar dhe përputhshmëri” për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2019 deri në 31.03.2021 trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin nr.156, datë 12.10.2021, të Kryetarit të KLSH-së, rezultojnë se:

I. Hartimi i programit (Plan veprimit) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në nenin 15 shkronja (j) të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Nga auditimi u konstatua se, subjekti ka hartuar një procesverbal i mbajtur në datën 05.11.2021 me nr 1565/10 prot., dërguar në KLSH në lidhje me temën “Për marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga raporti përfundimtar i auditimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Agjencia për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural ka miratuar miratuar planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, duke e dërguar në KLSH me shkresën nr.1497 prot., datë 15.04.2022 kjo në përputhje me me ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” nenit 15, shkronja j.

Sa më sipër rezultojnë se është zbatuar afati 20 ditor për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve.

II. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Në lidhje mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve dhe afatet e përcaktuara, sipas strukturave përgjegjëse Agjencia për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural ka përgatitur planin e veprimit me nr 1497 prot., datë 15.04.2022, dërguar në KLSH.

Sa më sipër rezultojnë se është zbatuar afati 6 muajor për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve.

III. Realizimi i rekomandimeve

Nga ana e KLSH-së, janë lënë **19 masa organizative, 1 masë për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimn dhe menaxhimin me ekonomicitet,eficence dhe efektivitet të fondeve publike.**

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

- a) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 19 masa organizative të cilat janë pranuar nga Agjencia për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural,ku nga këto janë 40 rekomandime nga të cilat 28 të zbatuara, 3 të pazbatuara, 7 në proces zbatimi dhe 2 zbatuar pjesërisht.
- b) Për përmirësimin e gjendjes është lënë 1 masë për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimn dhe menaxhimin me ekonomicitet, eficence dhe efektivitet të fondeve publike, ku nga këto janë 2 rekomandime të cilat janë në proces zbatimi.
- c) Për përmirësimin e gjendjes te masa disiplinore 1 rekomandim i pranuar dhe zbatuar.

Më hollësisht, auditimi i ndjekjes së rekomandimeve në AZHBR paraqitet si vijon:

MASA ORGANIZATIVE

1.1.Rekomandim: Titullari i Institucionit të AZHBR-së të marrë masa për krijimin “Ekipin e Menaxhimit Strategjik” cdo vit për përgatitjen e PBA-së, me qëllim për të mundësuar një planifikim sa më real të shpenzimeve korrente dhe investimeve, për përmbushjen e objektivave të institucionit.

Në Vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Po, Institucioni e ka pranuar Rekomandimn e lënë nga KLSH-ja dhe në planin veprimit me nr. prot. 1656/16 datë 05.11.2021 “Mbi masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga auditimi i kryer në Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”, janë përcaktuar qartë hapat që do të ndiqen nga instiucioni.Në vijim për ndjekjen e rekomandimeve konform nenit 30, pika 2, të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, AZHBR ka vijuar progresin e ndjekjes së rekomandimeve duke përditësuar veprimet e kryer nga institucioni me shkresën nr. 1497 prot. datë 15.04.2022.

Titullari i institucionit ka krijuar grupin e menaxhimit strategjik me Urdhërin nr.4, me nr. prot 84, datë 10.01.2022, i cili është përditësuar në përputhje me ndryshimet e bëra në organikë konkretisht Urdhërin nr.36, datë 30.01.2023 dhe Urdhërin nr 244, nr.prot 1159, datë 04.04.2023.

Bashkëngjitur urdhërat përkatës: Urdhëri nr. 36 datë 30.01.2023 “Ngritjen e Grupit të Menaxhimit Strategjik” (GMS), Urdhëri nr. 244 datë 04.04.2023 “ Për një ndryshim në urdhërin nr. 36 datë 30.01.2023 për Ngritjen e Grupit të Menaxhimit Strategjik”, Urdhëri nr. 04 datë 10.01.2022 “Ngritjen e Grupit të Menaxhimit Strategjik” (GMS).

Komenti i grupit të auditimit.

Në dispozicion të grupit të auditimit janë vënë dokumentat provuese: urdhërat përkatës: Urdhëri nr. 36 datë 30.01.2023 “Ngritjen e Grupit të Menaxhimit Strategjik” (GMS), Urdhëri nr. 244 datë 04.04.2023 “ Për një ndryshim në urdhërin nr. 36 datë 30.01.2023 për Ngritjen e Grupit të Menaxhimit Strategjik”, Urdhëri nr. 04 datë 10.01.2022 “Ngritjen e Grupit të Menaxhimit Strategjik” (GMS).

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**

1.2.Rekomandim: AZHBR-ja të marrë masa në vazhdimësi, që në përgatitjen e PBA-ve në pasqyrën “*Lista Permbledhëse e Projekteve të Investimeve Publike me Financim të Brendshëm të parashikuara*” të bëjë ndarjen e kërkesave buxhetore sipas politikave ekzistuese dhe politikave të reja.

Në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Po, Institucioni e ka pranuar Rekomandimn e lënë nga KLSH-ja dhe në planin veprimit me nr. prot. 1656/16 datë 05.11.2021 “Mbi masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga auditimi i kryer në Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”, janë përcaktuar qartë hapat që do të ndiqen nga instiucioni.

Projekt Buxhetet në vazhdim do të hartohen në përputhje me Udhëzimin nr. 7, datë 28.02.2018 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarde të përgatitjes së PBA-së”, konkretisht duke ngritur “Ekipi i Menaxhimit Strategjik”, si dhe duke dhënë informacion ne lidhje me : a. misionin e njësisë; b. përshkrimin e programeve; c. paraqitjen e qëllimit dhe objektivave të politikës së programeve të shoqëruar me treguesit përkatës të performancës; g. një relacion shoqërues për kërkesat buxhetore;

Në vijim për ndjekjen e rekomandimeve konform nenit 30, pika 2, të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, AZHBR ka vijuar me progresin e ndjekjes së rekomandimeve duke përditësuar veprimet e kryer nga institucioni me shkresën nr. 1497 prot. datë 15.04.2022.

Është hartuar Projekt Buxheti për vitet 2023-2025 bazuar në kërkesat buxhetore të drejtorive dhe sektorëve të Agjencisë së Zhvillimit Bujqësor dhe Rural përcjellë te Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural me shkresë Nr.Prot., 1325, datë 05.04.2022. Ky Projekt buxhet është hartuar në përputhje me Udhëzimin nr. 9, datë 28.02.2018 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarde të përgatitjes së PBA-së”, konkretisht duke ngritur “Ekipi i Menaxhimit Strategjik”, si dhe duke dhënë informacion ne lidhje me : a. misionin e njësisë; b. përshkrimin e programeve; c. paraqitjen e qëllimit dhe objektivave të politikës së programeve të shoqëruar me treguesit përkatës të performancës; g. një relacion shoqërues për kërkesat buxhetore;

Bashkëngjitur dokumentat provuese shkresa nr. 14293/3 datë 18.03.2022 “Mbi dorëzimin e kërkesave buxhetore 2023-2025, për institucionin tuaj” nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, shkresa nr. 1325 prot. datë 05.04.2022 “Dërgohen kërkesat buxhetore 2023-2025”, shkresa nr. 217 prot. datë 17.01.2023, “Dërgojmë buxhetin e vitit 2023-2025 për institucionin tuaj, në shpenzime korrente”.

Komenti i grupit të auditimit

Grupit të auditimit i janë vënë në dispozicion dokumentat provuese si shkresa nr. 14293/3 datë 18.03.2022 “Mbi dorëzimin e kërkesave buxhetore 2023-2025, për institucionin tuaj” nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, shkresa nr. 1325 prot. datë 05.04.2022 “Dërgohen kërkesat buxhetore 2023-2025”, shkresa nr. 217 prot. datë 17.01.2023, “Dërgojmë buxhetin e vitit 2023-2025 për institucionin tuaj, në shpenzime korrente”.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**

1.3.Rekomandim: AZHBR-ja të marrë masa në vazhdimësi që për projekte publike të cilat nuk janë pjesë e PBA-së, si dhe pjesë e planifikimeve vjetore të institucionit të mos merren angazhime për zhvillimin e procedurave të prokurimit dhe realizimit të tyre.

Përgjigja e institucionit:

Po, Institucioni e ka pranuar Rekomandimn e lënë nga KLSH-ja dhe në planin veprimit me nr. prot. 1656/16 datë 05.11.2021 “Mbi masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga auditimi i kryer në Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”, janë përcaktuar qartë hapat që do të ndiqen nga instiucioni:

Gjatë hartimit te PBA do të bëhet ndarja e kërkesave buxhetore sipas politikave ekzistuese dhe politikave të reja.

Në vijim për ndjekjen e rekomandimeve konform nenit 30, pika 2, të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, AZHBR ka vijuar me progresin e ndjekjes së rekomandimeve duke përditësuar veprimet e kryer nga institucioni me shkresën nr. 1497 prot. datë 15.04.2022.

Gjatë hartimit te PBA është bërë ndarja e kërkesave buxhetore sipas politikave ekzistuese dhe politikave të reja. Bashkëngjitur dokumentacioni provues shkresa nr. 14293/3 datë 18.03.2022 “Mbi dorëzimin e kërkesave buxhetore 2023-2025, për institucionin tuaj” nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, shkresa nr. 1325 prot. datë 05.04.2022 “Dërgohen kërkesat buxhetore 2023-2025”, shkresa nr. 217 prot. datë 17.01.2023, “Dërgojmë buxhetin e vitit 2023-2025 për institucionin tuaj, në shpenzime korrente”.

Komenti i grupit të auditimit

Grupit të auditimit i janë vënë në dispozicion dokumentat provuese shkresa nr. 14293/3 datë 18.03.2022 “Mbi dorëzimin e kërkesave buxhetore 2023-2025, për institucionin tuaj” nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, shkresa nr. 1325 prot. datë 05.04.2022 “Dërgohen kërkesat buxhetore 2023-2025”, shkresa nr. 217 prot. datë 17.01.2023, “Dërgojmë buxhetin e vitit 2023-2025 për institucionin tuaj, në shpenzime korrente”.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**

1.4.Rekomandim: AZHBR-ja të marrë masa që të planifikojë zërin “Blerje uniforme Drejtoria e Kontrollit” në vlerën 1,560 mijë lekë nga artikulli buxhetor 231 “Investime” në artikullin buxhetor 602 “Mallra e shërbime”.

Përgjigja e institucionit:

Po, Institucioni e ka pranuar Rekomandimn e lënë nga KLSH-ja dhe në planin veprimit me nr. prot. 1656/16 datë 05.11.2021 “Mbi masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga auditimi i kryer në Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”, janë përcaktuar qartë hapat që do të ndiqen nga instiucioni.

Në vijim për ndjekjen e rekomandimeve konform nenit 30, pika 2, të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, AZHBR ka vijuar me progresin e ndjekjes së rekomandimeve duke përditësuar veprimet e kryer nga institucioni me shkresën nr. 1497 prot. datë 15.04.2022.

AZHBR ka marrë masa të menjëhershme për të sistemuar zërin “Blerje uniforme Drejtoria e Kontrollit”. Në Projekt Buxhetin e vitit 2023-2025 zëri “Uniforma dhe veshje të tjera speciale” nuk është parashikuar në listën e Projekteve të Investimeve Publike me Financim të Brendshëm pra në artikullin buxhetor 231 “Investime” por është planifikuar në artikullin buxhetor 602 “Materiale dhe shërbime speciale”. Bashkëngjitur dokumentat provuese shkresa nr. 14293/3 datë 18.03.2022 “Mbi dorëzimin e kërkesave buxhetore 2023-2025, për institucionin tuaj” nga

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, shkresa nr. 1325 prot. datë 05.04.2022 “Dërgohen kërkesat buxhetore 2023-2025”, shkresa nr. 217 prot. datë 17.01.2023, “Dërgojmë buxhetin e vitit 2023-2025 për institucionin tuaj, në shpenzime korrente”.

Komenti i grupit të auditimit

Grupit të auditimit i janë vënë në dispozicion dokumentat provuese shkresa nr. 14293/3 datë 18.03.2022 “Mbi dorëzimin e kërkesave buxhetore 2023-2025, për institucionin tuaj” nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, shkresa nr. 1325 prot. datë 05.04.2022 “Dërgohen kërkesat buxhetore 2023-2025”, shkresa nr. 217 prot. datë 17.01.2023, “Dërgojmë buxhetin e vitit 2023-2025 për institucionin tuaj, në shpenzime korrente”, ku rezulton sistemim i artikullit buxhetor në seksionin përkatës.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

2.1. Rekomandim: AZHBR të marrë masa në vazhdimësi, që të përpilojë raportet e monitorimit 4, 8, 12 mujore, ku të relatohet në lidhje me realizimin e treguesve në raport me parashikimin, si dhe në raportet 8 mujore të jepen informacionet shtesë për parashikimin e realizimeve të pritshëm deri në fund të vitit, si për produktet edhe për shpenzimet, për të evidentuar nëse ky parashikim është më i lartë apo më i ulët se plani fillestar i parashikuar, me qëllim menaxhimin sa më efektiv të fondeve buxhetore, si dhe ndërmarrjen në kohë të vepimeve korigjuese duke ndryshuar alokimin e burimeve, si dhe duke evidentuar impaktin e mundshëm në performancën e objektivave të lidhura me to.

Në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Po, Institucioni e ka pranuar Rekomandimin e lënë nga KLSH-ja dhe në planin veprimit me nr. prot. 1656/16 datë 05.11.2021 “Mbi masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga auditimi i kryer në Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”, janë përcaktuar qartë hapat që do të ndiqen nga institucioni. Në vijim për ndjekjen e rekomandimeve referuar nenit 30, pika 2, të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, AZHBR ka vijuar me progresin e ndjekjes së rekomandimeve duke përditësuar veprimet e kryer nga institucioni me shkresën nr. 1497 prot. datë 15.04.2022. AZHBR ne përputhje me Udhëzimin nr. 22, datë 17.11.2016, “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e Qeverisjes Qendrore”, ka përpiluar raportet e monitorimit të buxhetit 4, 8, 12 mujore, konkretisht me shkresë nr. 527 Prot. datë 04.02.2022 i është dërguar Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural Raporti i Monitorimit i Vitit 2021 për AZHBR. *(Bashkëngjitur dokumentet provuese)*

Komenti i grupit të auditimit

Grupit të auditimit i janë vënë në dispozicion dokumentet provuese shkresë nr. 527 Prot. datë 04.02.2022 i është dërguar Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural Raporti i Monitorimit i Vitit 2021 për AZHBR.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**

3.1. Rekomandim: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në bashkëpunim me Ministrinë e Financës dhe Ekonomisë të marri masat, përpara miratimit të VKM-së për çeljen e fondit për skemat kombëtare, të bëjnë ndarjen e fondeve të planifikuara për programet e skemave kombëtare në programet “*pagesa direkte*” në llogarinë 606 “*Transfertë në buxhetet familjare*” dhe “*programin Investime*” në llogarinë 231 “*Investime*”.

Në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Po, Institucioni e ka pranuar Rekomandimn e lënë nga KLSH-ja dhe në planin veprimit me nr. prot. 1656/16 datë 05.11.2021 “Mbi masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga auditimi i kryer në Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”, janë përcaktuar qartë hapat që do të ndiqen nga instiucioni.

Në vijim për ndjekjen e rekomandimeve konform nenit 30, pika 2, të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, AZHBR ka vijuar me progresin e ndjekjes së rekomandimeve duke përditësuar veprimet e kryer nga institucioni me shkresën nr. 1497 prot. datë 15.04.2022.

(në vazhdimësi në momentin që do të pëfshihet si masë mbështetëse në VKM dhe Udhëzimin përkatës në skemat kombëtare)

AZHBR do të mbajë kontakt me MBZHR që te zbatohet ky rekomandim në momentin kur kemi të aplikuar një skemë të tillë. Për vitin 2022, 2023 nuk është parashikuar një masë mbështetëse e tillë.

Komenti i grupit të auditimit

Rekomandim konsiderohet i pranuar nga subjekti dhe në proces zbatimi.

4.1 Rekomandim:Drejtori i AZHBR-së të marrë masa në vazhdimësi, që menjëherë pas marrjes së relacionit nga komisioni i inventarizimit, të nxjerrë urdhrat për ngritjen e komisionit për vlerësimin e aktiveve, si dhe nëse konstatohen aktive të dëmtuara ngritjen e komisionit të nxjerrjes jashtë përdorimi.

Përgjigja e institucionit:

Po, Institucioni e ka pranuar Rekomandimn e lënë nga KLSH-ja dhe në planin veprimit me nr. prot. 1656/16 datë 05.11.2021 “Mbi masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga auditimi i kryer në Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”, janë përcaktuar qartë hapat që do të ndiqen nga instiucioni.

Në vijim për ndjekjen e rekomandimeve konform nenit 30, pika 2, të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, AZHBR ka vijuar me progresin e ndjekjes së rekomandimeve duke përditësuar veprimet e kryer nga institucioni me shkresën nr. 1497 prot. datë 15.04.2022.

AZHBR pas marrjes së relacionit nga Komisioni i inventarizimit i vitit 2020, nxori urdhrin për ngritjen e komisionit për vlerësimin e aktiveve me nr.160, datë 19.05.2021 “Per ngritjen e komisionit per vlerësimin e aktiveve te AZHBR të propozuara për nxjerrje jashtë përdorimit”. Me Urdhër nr 188, Prot 1728, datë 09.05.2022 është ngritur komisioni për vlerësimin e aktiveve të AZHBR të propozuara për nxerrje jashtë përdorimit. Pastaj është vijuar me procedurën e nxerrjes jashtë përdorimi të aktiveve konkretisht me Urdhërin nr 341, nr.prot 2840, datë 15.08.2022 është ngritur komisioni për nxerrje jashtë përdorimi të aktiveve. Në vijim është hartuar procesverbali për nxerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të propozuara për vitin 2021 me nr. prot. 2840/1, datë 23.08.2022.

Komisioni i asgjësimit ka përpiluar një memo nr.prot 2840/2, datë 23.08.2022 me anë të cilës informon Titullarin e institucionit për praktikën e ndjekur gjatë zbatimit të procedurës së asgjesimit. (*Bashkëngjitur praktika provuese*).

Komenti i grupit të auditimit.

Grupit të auditimit i janë vënë në dispozicion, urdhri për ngritjen e komisionit për vlerësimin e aktiveve me nr. 160, datë 19.05.2021 “Për ngritjen e komisionit për vlerësimin e aktiveve të AZHBR-së të propozuara për nxjerrje jashtë përdorimi”, urdhëri nr. 188 Prot. 1728, datë

09.05.2022 është ngritur komisioni për vlerësimin e aktiveve të AZHBR-së të propozuara për nxerrje jashtë përdorimit, procesverbali për nxerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të propozuara për vitin 2021 me nr.prot.2840/1, datë 23.08.2022, Memo nr.prot 2840/2, datë 23.08.2022 për informimin e Titullarit të institucionit për praktikën e ndjekur gjatë zbatimit të procedurës së asgjësimit. (*bashkëngjitur dokumentat provuese*)

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**

4.2 Rekomandim:Drejtoria e Financës të marrë masa për sistemimin e diferencës prej 1,945,026.56 lekë, duke kredituar llogaria 327 “**Materiale të imëta**” dhe debituar llogarinë 63 “*Ndryshimi i Gjendjes i Inventarit*” për të njëjtën vlerë.

Brenda datës 31.12.2021

Përgjigja e institucionit:

Po, Institucioni e ka pranuar Rekomandimn e lënë nga KLSH-ja dhe në planin veprimit me nr. prot. 1656/16 datë 05.11.2021 “Mbi masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga auditimi i kryer në Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”, janë përcaktuar qartë hapat që do të ndiqen nga instiucioni.

Në vijim për ndjekjen e rekomandimeve konform nenit 30, pika 2, të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, AZHBR ka vijuar me progresin e ndjekjes së rekomandimeve duke përditësuar veprimet e kryer nga institucioni me shkresën nr. 1497 prot. datë 15.04.2022.

Drejtoria e Financës ka bërë sistemimin e diferencës me vlerë 1,945,026.56 lekë me veprimin ndërmodular nr.23, datë 31.12.2021. (*Bashkëngjitur dokumentet provuese*).

Komenti i grupit të auditimit.

Grupit të auditimit i është vënë në dispozicion veprimi ndërmodular nr.23, datë 31.12.2021.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**

5.1. Rekomandim: Drejtoria e Financës së AZHBR-së të marri masat për sistemimin e vlerës prej 36,728,760 lekë, duke bërë veprinin kontabël kreditimin e llogarisë 35 “Mallra” dhe debitimin e llogarisë 21 “Aktive afatgjata”.

5.2. Rekomandim: Drejtoria e Financës së AZHBR-së të marri masat për sistemimin e vlerës prej 5,900,000 lekë, duke bërë veprimin kontabël debëtimin e llogarisë 1016 “Nga Transfertat e brendshme te AAGJ” dhe kreditimin e llogarisë 21 “*Aktive afatgjata*”.

Brenda datës 31.12.2021

Përgjigja e institucionit:

Po, Institucioni e ka pranuar Rekomandimn e lënë nga KLSH-ja dhe në planin veprimit me nr. prot. 1656/16 datë 05.11.2021 “Mbi masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga auditimi i kryer në Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”, janë përcaktuar qartë hapat që do të ndiqen nga instiucioni.

Drejtoria e Financës në momentin e mbylljes së pasqyrave financiare 2021 do të konsultohet me Ministrinë e Bujqesise dhe Zhvillimit Rural, i cili konsolidon bilancin dhe do te pasqyrojë në bilancin e 2021 të gjitha veprimet kontabël rregullues.

Në vijim për ndjekjen e rekomandimeve konform nenit 30, pika 2, të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, AZHBR ka vijuar me progresin e ndjekjes së rekomandimeve duke përditësuar veprimet e kryer nga institucioni me shkresën nr. 1497 prot. datë 15.04.2022.

Drejtoria e Financës ka përgatitur pasqyrat financiare 2021 dhe ka bërë konsolidimin bilancit me Ministrinë e Bujqesisë dhe Zhvillimit Rural, duke kryer veprimin ndërmodular nr.10, datë

31.12.2021 që reflekton lëvizjen e vlerave nga llog .3510 në llogarinë .2140210 Aktive Afatgjata me vlerë 30,828,759.63 lekë, veprimin ndërmodular nr. 15 datë 31.12.2021, veprimin ndërmodular nr. 16 datë 31.12.2021. *(bashkëngjitur dokumentat provuese)*

Komenti i grupit të auditimit.

Grupit të auditimit i janë vënë në dispozicion ndryshimet e nevojshme në konsolidimin e veprimit ndërmodular nr. 10, datë 31.12.2021 veprimin ndërmodular nr. 15 datë 31.12.2021, veprimin ndërmodular nr. 16 datë 31.12.2021.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**

6.1.Rekomandim: Drejtoria e Financës së AZHBR-së në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të marrin masat për analizimin e hollësishëm të debitorëve, për gjetjen e saktë të të dhënave të debitorëve fizik (ish-punonjës) dhe të subjekteve fizik e juridik, për të identifikuar shumat pa shpresë arkëtimi të klientëve/debitorëve të ndryshëm, si dhe të sigurojë inicimin e një procesi rivlerësimi, ku të gjitha të drejtat me palët e treta të analizohen në kuptimin e vjetërsisë dhe mundësive reale për arkëtimin dhe likuidimin e tyre, ku të propozohen masa konkrete, duke mos përjashtuar masat administrative si dhe të gjitha rrugët e inondshine ligjore për mbledhjen e tyre.

Përgjigja e institucionit:

Po, Institucioni e ka pranuar Rekomandimin e lënë nga KLSH-ja dhe në planin veprimit me nr. prot. 1656/16 datë 05.11.2021 “Mbi masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga auditimi i kryer në Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”, janë përcaktuar qartë hapat që do të ndiqen nga instiucioni.

Në vijim për ndjekjen e rekomandimeve referuar nenit 30, pika 2, të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, AZHBR ka vijuar me progresin e ndjekjes së rekomandimeve duke përditësuar veprimet e kryer nga institucioni me shkresën nr. 1497 prot. datë 15.04.2022.

Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike do të bëjnë një analizimin të hollësishëm të debitorëve të pasqyruar në llogarinë 423-429 “Personeli, paradhënie, deficite, gjoba” në vlerën 2,023,1585 lekë, për gjetjen e saktë të të dhënave të debitorëve fizik (ish-punonjës) dhe të subjekteve fizik e juridik. Me pas do të sigurojë inicimin e një procesi rivlerësimi, ku të gjitha të drejtat me palët e treta të analizohen në kuptimin e vjetërsisë dhe mundësive reale për arkëtimin dhe likuidimin e tyre, ku të propozohen masa konkrete, duke mos përjashtuar masat administrative si dhe të gjitha rrugët e mundshme ligjore për mbledhjen e tyre.

Komenti i grupit të auditimit

Nga ana e Institucionit nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij Rekomandim. Rekomandim konsiderohet **i pranuar** dhe **në proces zbatimi**

6.2. Rekomandim: Drejtoria e Financës së AZHBR-së të marra masa për krijimin e provizioneve për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme, pasi të jenë evidentuar të dhënat për klientët/debitorët, si shumën e detyrimit, vjetërsinë e tyre dhe situatën aktuale të tyre, si dhe pasi të jenë kaluar më parë të gjitha rrugët e mundshme ligjore për mbledhjen e tyre, duke prekur llogarinë 49 “Shuma të parashikuara për zhvlerësim”

Në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Po, Institucioni e ka pranuar Rekomandimin e lënë nga KLSH-ja dhe në planin veprimit me nr.

prot. 1656/16 datë 05.11.2021 “Mbi masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga auditimi i kryer në Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”, janë përcaktuar qartë hapat që do të ndiqen nga institucioni.

Në vijim për ndjekjen e rekomandimeve konform nenit 30, pika 2, të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, AZHBR ka vijuar me progresin e ndjekjes së rekomandimeve duke përditësuar veprimet e kryer nga institucioni me shkresën nr. 1497 prot. datë 15.04.2022.

Drejtoria e Financës do të bëjë krijimin e provizioneve për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme, duke prekur llogarinë 49 “Shuma të parashikuara për zhvlerësim”.

Komenti i grupit të auditimit

Nga ana e Institucionit nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij Rekomandim. Rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe i pazbatuar**

7.1. Rekomandim: Drejtoria e Financës së AZHBR-së të marrë masa për sistemimin e shumës 2,744,848 lekë, duke bërë veprimin kontabël kreditimën e llogarisë 4342 “Operacione me shtetin (t’ë drejta)” dhe debitimin e llogarisë 468 “Debitor të ndryshëm”.

Brenda datës 31.12.2021

Përgjigjja e institucionit:

Po, Institucioni e ka pranuar Rekomandimin e lënë nga KLSH-ja dhe në planin veprimit me nr. prot. 1656/16 datë 05.11.2021 “Mbi masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga auditimi i kryer në Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”, janë përcaktuar qartë hapat që do të ndiqen nga institucioni.

Në vijim për ndjekjen e rekomandimeve referuar nenit 30, pika 2, të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, AZHBR ka vijuar me progresin e ndjekjes së rekomandimeve duke përditësuar veprimet e kryer nga institucioni me shkresën nr. 1497 prot. datë 15.04.2022.

Drejtoria e Financës ka bërë debitimin e llogarisë 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” me vlerë 2,744,848 lekë e cila ka të bëjë me debitorë të trashëguar në vite dhe të paidentifikuara nga institucioni, konkretisht me veprimin ndërmodular nr. 21, datë 31.12.2021.

Komenti i grupit të auditimit

Nga subjekti, është kryer debitimi i llogarisë 4342 Operacione me shtetin (të drejta)” me vlerë 2,744,848 lekë debitorë të trashëguar në vite, (bashkëngjitur dokumentet provuese veprimi ndërmodular nr. 21, datë 31.12.2021).

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**

8.1. Rekomandim: Drejtoria e Financës së AZHBR-së të marrë masa për sistemimin e shumës 1,320,000 lekë, nga llogaria 202 “Studime dhe kërkime” në llogarinë 212 “Ndërtesa e Konstruksione”, sipas zërave për të cilën janë realizuar “Studim e projekte”.

Brenda datës 31.12.2021

Përgjigjja e institucionit:

Po, Institucioni e ka pranuar Rekomandimin e lënë nga KLSH-ja dhe në planin veprimit me nr. prot. 1656/16 datë 05.11.2021 “Mbi masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga auditimi i kryer në Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”, janë përcaktuar qartë hapat që do të ndiqen nga institucioni.

Në vijim për ndjekjen e rekomandimeve konform nenit 30, pika 2, të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, AZHBR ka

vijuar me progresin e ndjekjes së rekomandimeve duke përditësuar veprimet e kryer nga institucioni me shkresën nr. 1497 prot. datë 15.04.2022.

Drejtoria e Financës ka pasqyruar në bilancin e vitit 2021 vlerën prej 1,320,000 lekë, nga llogaria 202 “Studime dhe kërkime” në llogarinë 212 “Ndërtesa e Konstruksione”, sipas zërave për të cilën janë realizuar “Studim e projektim”, konkretisht me veprimin ndërmodular nr 19, datë 31.12.2021.

Komenti i grupit të auditimit.

Nga Institucioni, janë vënë në dispozicion dokumentet provuese konkretisht veprimi ndërmodular nr 19, datë 31.12.2021 ku pasqyrohet sistemimi i shumës 1,320,000 lekë, nga llogaria 202 “Studime dhe kërkime” në llogarinë 212 “Ndërtesa e Konstruksione”, sipas zërave për të cilën janë realizuar “Studim e projektme”.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**

9.1. Rekomandim: Drejtoria e Financës së AZHBR-së të marrë masa për riklasifikimin e artikullit “Kondicioner” në llogaritë kontabël 214 “Instalime teknike, pajisje, instrumente dhe vegla pune “, si dhe në ri përllogaritjen e amortizimit të akumuluar me normën 20% të këtyre artikujve, me qëllim përcaktimin e vlerës reale neto të gjendjes së aktiveve që institucioni disponon.

Brenda datës 31.12.2021

Përgjigjja e institucionit:

Po, Institucioni e ka pranuar Rekomandimn e lënë nga KLSH-ja dhe në planin veprimit me nr. prot. 1656/16 datë 05.11.2021 “Mbi masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga auditimi i kryer në Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”, janë përcaktuar qartë hapat që do të ndiqen nga institucioni.

Në vijim për ndjekjen e rekomandimeve konform nenit 30, pika 2, të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, AZHBR ka vijuar me progresin e ndjekjes së rekomandimeve duke përditësuar veprimet e kryer nga institucioni me shkresën nr. 1497 prot. datë 15.04.2022.

Drejtoria e Financës ka klasifikuar artikullin “Kondicioner” në llogaritë kontabël 214 “Instalime teknike, pajisje, instrumente dhe vegla pune “, si dhe ka përllogaritur amortizimin e akumuluar me normën 20% . Ky regjistrim është bërë me veprimin ndërmodular nr. 24, datë 31.12.2021.

Komenti i grupit të auditimit

Nga Institucioni, janë vënë në dispozicion dokumentet si veprimi ndërmodular nr.24, datë 31.12.2021 ku pasqyrohet klasifikimi i artikullit “Kondicioner” në llogaritë kontabël 214 “Instalime teknike, pajisje, instrumente dhe vegla pune “, si dhe ka përllogaritur amortizimin e akumuluar me normën 20% .

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**

10.1. Rekomadimi: Drejtoria e Financës së AZHBR -së të marrë masa për cgjistrimin e vlerës prej 225,432,829 lekë, duke debituar llogarinë 28 “Caktime te Aktiveve Afatgjata” dhe kredituar llogarine 106 “Nga grantet e Jashtme kapitale ”.

Përgjigjja e institucionit:

Po, Institucioni e ka pranuar Rekomandimn e lënë nga KLSH-ja dhe në planin veprimit me nr. prot. 1656/16 datë 05.11.2021 “Mbi masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të dhëna

nga auditimi i kryer në Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”, janë përcaktuar qartë hapat që do të ndiqen nga instiucioni.

Në vijim për ndjekjen e rekomandimeve konform nenit 30, pika 2, të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, AZHBR ka vijuar me progresin e ndjekjes së rekomandimeve duke përditësuar veprimet e kryer nga institucioni me shkresën nr. 1497 prot. datë 15.04.2022.

Drejtoria e Financës ka pasqyruar në bilancin e 2021 regjistrimin e vlerës prej 225,432,829 lekë, duke debituar llogarinë 28 “Caktime të Aktiveve Afatgjata” dhe kredituar llogarinë 106 “Nga grantet e Jashtme kapitale (+)”.

Llogaria nr 106 dhe nr 28 janë shtuar me vlerën 225,432,827 lekë.

Projekti i Shërbimeve Mjedisore mbahet në një program të veçantë ALPHA MJEDIS nga i cili gjenerohet raporti që dërgohet në Ministrinë e Mjedisit. (*bashkëngjitur dokumentet provuese*).

Komenti i grupit të auditimit

Nga Institucioni, janë vënë në dispozicion dokumentet provuese pasqyruar në bilancin e 2021 regjistrimin e vlerës prej 225,432,829 lekë, duke debituar llogarinë 28 “Caktime të Aktiveve Afatgjata” dhe kredituar llogarinë 106 “Nga grantet e Jashtme kapitale (+)”.

Llogaria nr 106 dhe nr 28 janë shtuar me vlerën 225,432,827 lekë.

Projekti i Shërbimeve Mjedisore mbahet në një program të veçantë ALPHA MJEDIS nga i cili gjenerohet raporti që dërgohet në Ministrinë e Mjedisit..

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**

10.2. Rekomandim: Drejtoria e Financës së AZHBR-së të marrë masa për sistemimin kontabël të vlerës prej 125,000,000 lekë, duke debituar llogarinë 105 “Nga grantet e brendshme kapitale (-)” dhe kredituar llogarinë 106 “Nga grantet e Jashtme kapitale (+)”, për të njëjtën shumë.

Brenda datës 31.12.2021

Përgjigjja e institucionit:

Po, Institucioni e ka pranuar Rekomandimin e lënë nga KLSH-ja dhe në planin veprimit me nr. prot. 1656/16 datë 05.11.2021 “Mbi masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga auditimi i kryer në Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”, janë përcaktuar qartë hapat që do të ndiqen nga instiucioni.

Në vijim për ndjekjen e rekomandimeve konform nenit 30, pika 2, të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, AZHBR ka vijuar me progresin e ndjekjes së rekomandimeve duke përditësuar veprimet e kryer nga institucioni me shkresën nr. 1497 prot. datë 15.04.2022. Drejtoria e Financës ka pasqyruar në bilancin e 2021 veprimin kontabel kontabël të vlerës prej 125,000,000 lekë, duke debituar llogarinë 105 “Nga grantet e brendshme kapitale (+)” dhe kredituar llogarinë 106 “Nga grantet e Jashtme kapitale (+)”, për të njëjtën shumë. (*Bashkëngjitur Pasqyrat financiare viti 2021*).

Komenti i grupit të auditimit

Nga Instiucioni janë vënë në dispozicion dokumentet provuese si pasqyrat financiare të vitit 2021 ku janë referur veprimet kontabël sipas Rekomandimit të dhënë.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**

11.2. Rekomandim: Drejtoria Financës të marrë masa për sistemimin e shumave të pasqyruar në llogarinë 16,17 “Hua Afat shkurtra”, duke bërë veprimin kontabël kreditimin e llogarisë 106 “Teprica e Granteve Capitale të Huaja” për pjesën e fondeve të IPARD dhe 105 “Teprica e

Granteve kapitale të brendshmen” për shumën e skemaxe kombëtare dhe debitimin e llogarisë 16,17 “Hua Afat shkurtra” për vlerën 42,961,518 lekë.

Brenda datës 31.12.2021

Përgjigjja e institucionit:

Po, Institucioni e ka pranuar Rekomandimn e lënë nga KLSH-ja dhe në planin veprimit me nr. prot. 1656/16 datë 05.11.2021 “Mbi masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga auditimi i kryer në Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”, janë përcaktuar qartë hapat që do të ndiqen nga instiucioni.

Në vijim për ndjekjen e rekomandimeve konform nenit 30, pika 2, të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, AZHBR ka vijuar me progresin e ndjekjes së rekomandimeve duke përditësuar veprimet e kryer nga institucioni me shkresën nr. 1497 prot. datë 15.04.2022.

Drejtoria e Financës ka pasqyruar ne bilancin e 2021 sistemimin e shumave të llogarive 16,17 “Hua Afat shkurtra”, konkretisht me veprimet ndëmodulare nr.11,12,13,14, datë 31.12.2021.

Komenti i grupit të auditimit

Nga AZHBR-ja janë kryer veprimet ndërmodulare nr.11,12,13,14, datë 31.12.2021 të cilat pasqyrojnë sistemimin e shumave të llogarive nr. 16, 17 “Hua Afat Shkurtra”.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**

12.1. Rekomandim: Drejtoria e Financës së AZHBR-së të marrë masa për sistemimin kontabël të vlerës prej 7,736,437 / lekë, duke debituar llogarine 106 “Nga grantet e Jashtme kapitale (+)” me të njëjtën vlerë.

12.2. Rekomandim: Drejtoria e Financës së AZHBR-së të marrë masat për të kryer sistemimet e nevojshme dhe regjistrimet në kontabilitet në bazë të klasifikimit ekonomik kontabël, duke tranzituar shumat e evidentuara në llogarinë 85, “Rezultati i veprimtarisë ushtrimore” në llogarinë 12 “Rezultate të mbartura nga funksioni”, për një pasqyrim më të drejtë të kundër partisë së disponibiliteteve në thesar, me qëllim që të parandalohen gabimet apo parregullsitë e mundshme në interpretimin e llogarive të pasqyrave financiare.

Brenda datës 31.12.2021

Përgjigjja e institucionit:

Po, Institucioni e ka pranuar Rekomandimn e lënë nga KLSH-ja dhe në planin veprimit me nr. prot. 1656/16 datë 05.11.2021 “Mbi masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga auditimi i kryer në Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”, janë përcaktuar qartë hapat që do të ndiqen nga instiucioni.

Në vijim për ndjekjen e rekomandimeve konform nenit 30, pika 2, të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, AZHBR ka vijuar me progresin e ndjekjes së rekomandimeve duke përditësuar veprimet e kryer nga institucioni me shkresën nr. 1497 prot. datë 15.04.2022.

Vlera prej 7,736,437 lekë, përbëhet nga 1,836,437 lekë që është amortizimi i magazinës i bërë në vitin 2015 dhe është stornuar në vitin 2019, pasi llogaria 35 nuk i nënshtrohet amortizimit si dhe vlera prej 5,900,000 lekë është transferim kapital i autokombanjës e cila ka lidhje me llogarinë 85. Ky transferim është bërë në përputhje me Rekomandimin nr. 5 përshkruar më sipër.

Komenti i grupit të auditimit.

Nga AZHBR-ja, grupit të auditimit i janë dhënë me sqarimet përkatëse bashkë me pasqyrat financiare 2021.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**

13.1. Rekomandim: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, në bashkëpunim me Ministrinë e Financës dhe Ekonomisë, të marrë masat e menjëhershme për tërheqjen e shumës prej 8,486.11 Euro dhe shumës prej 107,885.92 USD nga llogaria bankare “C. A. Banks”, në cilësinë e debitorit ndaj AZHBR-së.

Në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Po, Institucioni e ka pranuar Rekomandimin e lënë nga KLSH-ja dhe në planin veprimit me nr. prot. 1656/16 datë 05.11.2021 “Mbi masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga auditimi i kryer në Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”, janë përcaktuar qartë hapat që do të ndiqen nga institucioni.

Në vijim për ndjekjen e rekomandimeve konform nenit 30, pika 2, të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, AZHBR ka vijuar me progresin e ndjekjes së rekomandimeve duke përditësuar veprimet e kryer nga institucioni me shkresën nr. 1497 prot. datë 15.04.2022.

AZHBR ka inicuar korrespondencat me MBZHR në kuadrin e tërheqjes së fondeve nga C. A. Bank, shkresa nr. 1646 prot. dt. 15.05.2018. Ky proces rezulton në vijim. AZHBR do të mbajë komunikim të vazhdueshëm me MBZHR për të bërë të mundur realizimin e këtij Rekomandim.

Komenti i grupit të auditimit

Për sa më sipër Rekomandim konsiderohet **i pranuar** dhe **i pazbatuar**.

14.1. Rekomandim: Me qëllim shmangien e risqeve të tjetërsimit dhe/ose humbjes së dokumentit, nga ana e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, të merren masa për kryerjen e inventarizimit dhe arkivimit të dosjeve për të cilat janë përfunduar procedurat përkatëse, por edhe për të gjitha rastet në vijim, në mënyrë që çdo dokument i administruar nga ky institucion të ketë të gjithë elementët e dokumenteve sipas normave tekniko- profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor.

Në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Po, Institucioni e ka pranuar Rekomandimin e lënë nga KLSH-ja dhe në planin veprimit me nr. prot. 1656/16 datë 05.11.2021 “Mbi masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga auditimi i kryer në Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”, janë përcaktuar qartë hapat që do të ndiqen nga institucioni.

Në vijim për ndjekjen e rekomandimeve konform nenit 30, pika 2, të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, AZHBR ka vijuar me progresin e ndjekjes së rekomandimeve duke përditësuar veprimet e kryer nga institucioni me shkresën nr. 1497 prot. datë 15.04.2022.

Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural/ DJSHM, ka kryer inventarizimin dhe arkivimin e dosjeve për të cilat janë përfunduar procedurat përkatëse konkretisht janë dorëzuar në arkivë sipas procesverbaleve bashkëngjitur të firmosura nga përgjigjësi i njësisë së prokurimit dhe specialisti i arkivës në AZHBR. Gjithashtu nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave është dërguar shkresë me Nr.Prot.3879, datë 13.04.2023 mbi asistencën metodologjike në sekretari-arkiv për AZHBR. (*Bashkëngjitur shkresa*).

Komenti i grupit të auditimit.

Nga verifikimi i grupit të auditimit, Rekomandim konsiderohet **i pranuar** dhe **në proces zbatimi**.

14.2.Rekomandim: Nga ana e AZHBR, të merren masa që në çdo procedurë prokurimi, llogaritja e fondit limit të bëhet në bazë të ofertave reale, të cilat duhet të datojnë në kohën e zhvillimit të procedurës së prokurimit

Në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Po, Institucioni e ka pranuar Rekomandimn e lënë nga KLSH-ja dhe në planin veprimit me nr. prot. 1656/16 datë 05.11.2021 “Mbi masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga auditimi i kryer në Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”, janë përcaktuar qartë hapat që do të ndiqen nga instiucioni.

Në vijim për ndjekjen e rekomandimeve konform nenit 30, pika 2, të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, AZHBR ka vijuar me progresin e ndjekjes së rekomandimeve duke përditësuar veprimet e kryer nga institucioni me shkresën nr. 1497 prot. datë 15.04.2022.

Për periudhën 2021, gjatë procedurave të prokurimit janë pranuar oferta vetem me datë reale, e në vazhdim do ndiqet e njëjta procedurë, (bashkëngjitur dokumente provuese mbi procedurat e ndjekura nga Drejtoria Juridike dhe Shërbimeve Mbështetëse).

Komenti i grupit të auditimit

Për periudhën 2021, gjatë procedurave të prokurimit janë pranuar oferta vetem me datë reale, e në vazhdim do ndiqet e njëjta procedurë.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

14.3.Rekomandim: Nga ana e AZHBR, të merren masa që në çdo procedurë prokurimi me vlerë të vogël, Komisioni i Blerjeve të Vogla duhet të dokumentojë me anë të një procesverbali, pjesëmarrjen dhe kualifikimin e operatorëve ekonomikë.

Në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Po, Institucioni e ka pranuar Rekomandimn e lënë nga KLSH-ja dhe në planin veprimit me nr. prot. 1656/16 datë 05.11.2021 “Mbi masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga auditimi i kryer në Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”, janë përcaktuar qartë hapat që do të ndiqen nga instiucioni.

Në vijim për ndjekjen e rekomandimeve konform nenit 30, pika 2, të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, AZHBR ka vijuar me progresin e ndjekjes së rekomandimeve duke përditësuar veprimet e kryer nga institucioni me shkresën nr. 1497 prot. datë 15.04.2022.

Komisioni i Blerjeve të Vogla ka dokumentuar me anë të një procesverbali, pjesëmarrjen dhe kualifikimin e operatorëve ekonomikë në cdo procedurë prokurimi, (bashkëngjitur dokumentet provuese nga Drejtoria Juridike dhe Shërbimeve Mbështetëse, Procesverbal nr. 2331/3 datë 05.08.2021).

Komenti i grupit të auditimit

Nga verifikimi i grupit të auditimit rezulton se Komisioni i Blerjeve të Vogla ka dokumentuar me anë të një procesverbali, pjesëmarrjen dhe kualifikimin e operatorëve ekonomikë në cdo procedurë prokurimi.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

14.4. Rekomandim: Nga AZHBR të merren masa, që në vijim termat e referencës të hartohen me specifikimet përkatëse si dhe në çdo rast të hartohet dhe dokumentohet përlllogaritja e fondit limit.

Në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Po, Institucioni e ka pranuar Rekomandimn e lënë nga KLSH-ja dhe në planin veprimit me nr. prot. 1656/16 datë 05.11.2021 “Mbi masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga auditimi i kryer në Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”, janë përcaktuar qartë hapat që do të ndiqen nga instiucioni.

Në vijim për ndjekjen e rekomandimeve konform nenit 30, pika 2, të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, AZHBR ka vijuar me progresin e ndjekjes së rekomandimeve duke përditësuar veprimet e kryer nga institucioni me shkresën nr. 1497 prot. datë 15.04.2022.

AZHBR/DJSHM ka marrë masa, për hartimin e termave të referencës specifikimet përkatëse si dhe me dokumentimin e procedurës të përlllogaritjes të fondit limit. Konkretisht është përpiluar raporti mbi specifikimet teknike me shkresë nr.185/2, datë 14.01.2022, Aneks nr. 1 Specifikimet Teknike. (bashkëngjitur dokumentet provuese).

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**

15.1 Rekomandim: Titullari i institucionit të marr masa për ngritjen e një grupi pune për të verifikuar ligjshmërinë e procedurës së ndjekur për amendimin e kontratës, pa iu nënshtuar procedurës së prokurimit sikundër dikton VKM nr. 1195, datë 5.8.2008 “Për blerjen, zhvillimin, prodhimin e bashkëprodhimin e programeve e të reklamave për transmetim nga operatorët radiotelevizivë ose botim në median e shkruar, dhe për kontratat, për kohë transmetimi, nga organet e administratës shtetërore”, për të analizuar shkaqet dhe nxjerrë përgjegjësit me qëllim marrjen e masave për personat përgjegjës.

Menjëherë

Përgjigjja e institucionit:

Po, Institucioni e ka pranuar Rekomandimn e lënë nga KLSH-ja dhe në planin veprimit me nr. prot. 1656/16 datë 05.11.2021 “Mbi masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga auditimi i kryer në Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”, janë përcaktuar qartë hapat që do të ndiqen nga instiucioni.

Në vijim për ndjekjen e rekomandimeve konform nenit 30, pika 2, të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, AZHBR ka vijuar me progresin e ndjekjes së rekomandimeve duke përditësuar veprimet e kryer nga institucioni me shkresën nr. 1497 prot. datë 15.04.2022.

Titullari i institucionit ka ngritur urdhrin nr.310, datë 21.10.2021 për “Krijimin e Komisioni të Shqyrtimit të Rekomandimt nr. 15.1 të KLSH-së” si dhe raporti mbi rekomandimet e KLSH nr prot.3194/1, datë 10.12.2021 i përpiluar dhe i firmosur nga komisioni i shqyrtimit të Rekomandimt.

(bashkëngjitur dokumentet provuese).

Komenti i grupit të auditimit

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**

15.2.Rekomandim: Në vijim, grupet e punës të përfshira në procese të ngjashme, në asnjë rast

të mos ndryshojnë vlerën e kontratës për shërbime të kësaj kategorie, pa respektuar parimet e tranperencës, mosdiskriminimit dhe trajtimit të barabartë të ofertuesve.

Në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Po, Institucioni e ka pranuar Rekomandimn e lënë nga KLSH-ja dhe në planin veprimit me nr. prot. 1656/16 datë 05.11.2021 “Mbi masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga auditimi i kryer në Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”, janë përcaktuar qartë hapat që do të ndiqen nga instiucioni.

Në vijim për ndjekjen e rekomandimeve konform nenit 30, pika 2, të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, AZHBR ka vijuar me progresin e ndjekjes së rekomandimeve duke përditësuar veprimet e kryer nga institucioni me shkresën nr. 1497 prot. datë 15.04.2022.

Në vijim, grupet e punës të përfshira në procese të ngjashme, do të respektojnë parimet e transparencës, mosdiskriminimit dhe trajtimit të barabartë të ofertuesve.

Komenti i grupit të auditimit.

Rekomandim konsiderohet **i pranuar** dhe në **proces zbatimi**.

16.1. Rekomandim: Për të gjitha rastet e ngjashme ne vijim, AZHBR t’i drejtohet MBZHR që të merren masa që kriteret e vendosura për financim, në udhëzimet përkatëse të jenë proporcionale dhe të qarta, duke mos lënë hapësira për interpretime dhe paqartësi, konkretisht për raste kur parashikohen formula financiini për sipërfaqe toke, përshkallëzimit i përllogaritjes së tyre të jetë në proporcion me vlerën inaksimale të lejuar të sipërfaqes së financuar.

Në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Po, Institucioni e ka pranuar Rekomandimn e lënë nga KLSH-ja dhe në planin veprimit me nr. prot. 1656/16 datë 05.11.2021 “Mbi masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga auditimi i kryer në Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”, janë përcaktuar qartë hapat që do të ndiqen nga instiucioni.

Në vijim për ndjekjen e rekomandimeve konform nenit 30, pika 2, të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, AZHBR ka vijuar me progresin e ndjekjes së rekomandimeve duke përditësuar veprimet e kryer nga institucioni me shkresën nr. 1497 prot. datë 15.04.2022.

Për të gjitha rastet e ngjashme ne vijim, AZHBR do t’i drejtohet MBZHR-së që të merren masa që kriteret e vendosura për financim, të paraqiten në udhëzimet përkatëse.

Komenti i grupit të auditimit

Nga grupi i auditimit është verifikuar se Rekomandim është **i pranuar** dhe **i pazbatuar**.

16.2. Rekomandim :AZHBR në bashkëpunim me njësinë e qeverisjes vendore përkatëse, të kërkojë konfirmim për vërtetësinë në fakt të dy AMTP-ve të paraqitura dhe, në rast se konstatohet që njëra nga AMTP nuk është e vlefshme, të bëhen përllogaritjet dhe të kërkohet kthimi i grantit nga ana e perfituesit, për siperfaqen e tokës që do të rezultojë me probleine. AZHBR të marrë masa që, në raste të ngashme, t’i drejtohet njërive të qeverisjes vendore për konfirmim që në fazën e kontrollit administrativ.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Po, Institucioni e ka pranuar Rekomandimn e lënë nga KLSH-ja dhe në planin veprimit me nr.

prot. 1656/16 datë 05.11.2021 “Mbi masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga auditimi i kryer në Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”, janë përcaktuar qartë hapat që do të ndiqen nga institucioni.

Në vijim për ndjekjen e rekomandimeve konform nenit 30, pika 2, të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, AZHBR ka vijuar me progresin e ndjekjes së rekomandimeve duke përditësuar veprimet e kryer nga institucioni me shkresën nr. 1497 prot. datë 15.04.2022.

AZHBR ka ndërmarë hapat e nevojshëm duke marrë konfirmimin nga Agjencia Shtetërore e Kadasteres, zyra vendore Malesi e Madhe ku nëpërmjet shkresës nr. 1406 prot., date 27.08.2021 ku konfirmohet se në parcelat nuk kanë mbivendosje me njëra tjetrën, janë parcela të ndryshme, ky fakt konfirmohet edhe nga topografi i cili ka pranuar se është bërë një gabim njerëzor në shënim të numrave të pasurisë.

(bashkëngjitur dokumentacioni provues shkresa nr. 1406 prot. datë 27.08.2021 konfirmimi i parcelave).

Komenti i grupit të auditimit

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**

16.3. Rekomandim : AZHBR duhet të marrë masa që të instruktojë aplikantët në plotësimin e formularit të regjistrimit të fermave, në plotësimin e dokumentacionit, në mënyrë që të bëhet i mundur administrimi i të dhënave të sakta.

Në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Po, Institucioni e ka pranuar Rekomandimin e lënë nga KLSH-ja dhe në planin veprimit me nr. prot. 1656/16 datë 05.11.2021 “Mbi masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga auditimi i kryer në Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”, janë përcaktuar qartë hapat që do të ndiqen nga institucioni.

Në vijim për ndjekjen e rekomandimeve konform nenit 30, pika 2, të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, AZHBR ka vijuar me progresin e ndjekjes së rekomandimeve duke përditësuar veprimet e kryer nga institucioni me shkresën nr. 1497 prot. datë 15.04.2022.

Në zbatim të Udhëzimit të përvitshëm “Për kriteret, procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural” është zhvilluar fushatë informimi për njohjen me masat e reja, mënyrën e plotësimit të dokumentave në aplikim, bashkëngjitur lista e takimeve të zhvilluara në qarqe të ndryshme për vitin 2022, vitin 2023 si dhe fushatat publicitare të zhvilluara në kuadër informimi të grupeve të interesit. (bashkëngjitur dokumentet provuese).

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**

16.4.Rekomandim:MZHBR në përshkrimin e masave gjatë hartimit të Udhëzimit përkatës të Skemave Kombëtare vjetore, duhet të përcaktojë në mënyrë të qartë mënyrën e llogaritjes së financimit ,tavanet e rendimentit, kushtet dhe kriteret e përfitimit.

AZHBR-ja të marrë masa që të gjitha vlerat e hedhura në sistemin elektronik të jenë të sakta dhe të përkojnë me vlerat respektive në dosjet fizike.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Po, Institucioni e ka pranuar Rekomandimn e lënë nga KLSH-ja dhe në planin veprimit me nr. prot. 1656/16 datë 05.11.2021 “Mbi masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga auditimi i kryer në Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”, janë përcaktuar qartë hapat që do të ndiqen nga instiucioni.

Në vijim për ndjekjen e rekomandimeve konform nenit 30, pika 2, të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, AZHBR ka vijuar me progresin e ndjekjes së rekomandimeve duke përditësuar veprimet e kryer nga institucioni me shkresën nr. 1497 prot. datë 15.04.2022.

AZHBR-ja ka marrë masa që të gjitha vlerat e hedhura në sistemin elektronik të jenë të sakta dhe të përkojnë me vlerat respektive në dosjet fizike, bashkëngjitur praktika print nga sistemi.

Komenti i grupit të auditimit

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **zbatuar pjesërisht**

17.1.Rekomandim: Nga ana e strukturës përgjegjëse për monitorim, në AZHBR, të merren masa për hartimin e një plani monitorimi periodik, të kujdesshëm dhe përfaqësues, dhe me objektiva të qarta për programet e skemave kombëtare, me qëllim vlerësimin e përdorimit të fondeve publike në këto programe, me eficiencë dhe efektivitet.

Në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Po, Institucioni e ka pranuar Rekomandimn e lënë nga KLSH-ja dhe në planin veprimit me nr. prot. 1656/16 datë 05.11.2021 “Mbi masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga auditimi i kryer në Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”, janë përcaktuar qartë hapat që do të ndiqen nga instiucioni.

Në vijim për ndjekjen e rekomandimeve konform nenit 30, pika 2, të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, AZHBR ka vijuar me progresin e ndjekjes së rekomandimeve duke përditësuar veprimet e kryer nga institucioni me shkresën nr. 1497 prot. datë 15.04.2022.

Spektori i Monitorimit ka përpiluar Planin e Monitorimit për subjektet perfituese të Skemave Kombëtare për dy tremujorët e parë të vitit 2022 të cilat janë protokolluar me nr.1372 prot. datë 12.01.2022 , nr. 1435 prot. datë 12.04.2022. Gjithashtu Spektori i Monitorimit ka përpiluar Planin e Monitorimit dhe regjistrin e riskut për vitin 2023.(Evidencat Bashkëngjitur).

Komenti i grupit të auditimit

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **zbatuar**

17.2.Rekomandim: AZHBR në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, të marrin masa për rishikimin e Manualit të Kontrollit mbi përcaktimin e qartë të shpeshësisë së procesit të monitorimit, si një element i rëndësishëm kontrolli mbi funksionimin e skemave në përputhje me qëllimin e parashikuar dhe si pasojë mbi efektivitetin e përdorimit të fondeve në raport me objektivat respektive.

Brenda datës 31.12.2021

Përgjigja e institucionit:

Po, Institucioni e ka pranuar Rekomandimn e lënë nga KLSH-ja dhe në planin veprimit me nr. prot. 1656/16 datë 05.11.2021 “Mbi masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga auditimi i kryer në Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”, janë përcaktuar qartë hapat që do të ndiqen nga instiucioni.

Në vijim për ndjekjen e rekomandimeve konform nenit 30, pika 2, të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, AZHBR ka vijuar me progresin e ndjekjes së rekomandimeve duke përditësuar veprimet e kryer nga institucioni me shkresën nr. 1497 prot. datë 15.04.2022.

AZHBR ka marrë masa për zbatimin e këtij Rekomandim menjëherë. Në rishikimin e analizës së ngarkesës në punë “Work-load” janë bërë propozimet lidhur me nevojën për kapacitetet e sektorit të monitorimit. Është dërguar në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural propozime mbi ndryshimin e strukturës të AZHBR me shkresë nr.3746 Prot., datë 24.12.2021. Me Urdhër të Kryeministrit Nr.81, datë 10.05.2022 ndryshuar Urdhër nr 103, datë 27.06.2022. është miratuar struktura e re organizative e AZHBR bazuar në analizën Work load. Ku sektori i monitorimit është organizuar si drejtori më vete duke rritur kapacitetet. (Bashkëngjitur dokumentet provuese).

Komenti i grupit të auditimit

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**

17.3.Rekomandim: AZHBR të vlerësojë efektivitetin e strukturave monitoruese të skemave në vecanti dhe strukturës së AZHBR në përgjithësi, me qëllim analizimin e shkaqeve të performancës së dobët të tyre, dhe plotësimin me staf dhe ekspertize nëse rezultojnë të pamjaftueshëm. Këto struktura nevojitet të harmonizohen në ndërveprime të përbashkëta me sektorët e tjerë, duke rritur shkallën e profesionalizimit për të arritur qëllimin dhe objektivat e AZHBR-së.

Brenda datës 31.12.2021

Përgjigja e institucionit:

Po, Institucioni e ka pranuar Rekomandimin e lënë nga KLSH-ja dhe në planin veprimit me nr. prot. 1656/16 datë 05.11.2021 “Mbi masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga auditimi i kryer në Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”, janë përcaktuar qartë hapat që do të ndiqen nga institucioni.

Në vijim për ndjekjen e rekomandimeve konform nenit 30, pika 2, të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, AZHBR ka vijuar me progresin e ndjekjes së rekomandimeve duke përditësuar veprimet e kryer nga institucioni me shkresën nr. 1497 prot. datë 15.04.2022.

AZHBR pasi bëri analizën për nevojat lidhur me plotësimin me staf dhe ekspertizë dërgoi në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural propozime mbi ndryshimin e strukturës të AZHBR me shkresë nr.3746 Prot. **datë 24.12.2021**. Me Urdhër të Kryeministrit Nr.81, datë 10.05.2022 ndryshuar Urdhër nr 103, datë 27.06.2022. është miratuar struktura e re organizative të AZHBR-së. (bashkëngjitur dokumentet provuese)

Komenti i grupit të auditimit

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**

18.1. Rekomandim: AZHBR duhet të marrë masa për hartimin e programeve specifike të trajnimeve për menaxhimin e riskut.

AZHBR duhet të marrë masa për hartimin e një kodi etike në përmbushje të Rregullave të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.

Në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Po, Institucioni e ka pranuar Rekomandimin e lënë nga KLSH-ja dhe në planin veprimit me nr. prot. 1656/16 datë 05.11.2021 “Mbi masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të dhëna

nga auditimi i kryer në Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”, janë përcaktuar qartë hapat që do të ndiqen nga instiucioni.

Në vijim për ndjekjen e rekomandimeve konform nenit 30, pika 2, të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, AZHBR ka vijuar me progresin e ndjekjes së rekomandimeve duke përditësuar veprimet e kryer nga institucioni me shkresën nr. 1497 prot. datë 15.04.2022.

AZHBR ka marrë masa për hartimin e programeve specifike të trajnimeve për menaxhimin e riskut, konkretisht nëpërmjet fondeve USAID si dhe projektit të financuar nga delegacioni evropian. Titullari i Institucionit ka hartuar urdhërin nr.44, datë 07.02.2022 për ngritjen e grupit të punës, për hartimin e kodit të etikës në përmbushje të Rregullave të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit. Me urdhër nr 270,.prot 2252, datë 21.06.2022 janë miratuar rregullat e etikës për AZHBR. (Bashkëngjitur kodi i etikës i miratuar dhe rregullorja e brendshme. bashkëngjitur dokumentet provuese)

Komenti i grupit të auditimit

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**

18.2.Rekomandim: Të merren masa nga Sektori i Burimeve Njerëzore për plotësimin e dosjeve të personelit me të gjithë dokumentacionin përkatës.

-Në vijimësi, Drejtoria Juridike dhe e Shërbimeve Mbështetëse dhe Sektori i Burimeve Njerëzore të marrin masa të hartojnë një format të kontratë punës, që përfshin të gjithë elementët e cituar në Kodin e Punës.

Në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Po, Institucioni e ka pranuar Rekomandimn e lënë nga KLSH-ja dhe në planin veprimit me nr. prot. 1656/16 datë 05.11.2021 “Mbi masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga auditimi i kryer në Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”, janë përcaktuar qartë hapat që do të ndiqen nga instiucioni.

Në vijim për ndjekjen e rekomandimeve konform nenit 30, pika 2, të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, AZHBR ka vijuar me progresin e ndjekjes së rekomandimeve duke përditësuar veprimet e kryer nga institucioni me shkresën nr. 1497 prot. datë 15.04.2022.

Sektori i Burimeve Njerëzore ka bërë plotësimin e dosjeve të personelit me të gjithë dokumentacionin përkatës.. Në vijimësi, Drejtoria Juridike dhe e Shërbimeve Mbështetëse dhe Sektori i Burimeve Njerëzore ka hartuar formatin e kontratës së punës, duke përfshirë të gjitha elementët e cituar në Kodin e Punës. Bashkëngjitur formati i kontratës së punës. (Bashkëngjitur dokumentacioni)

Komenti i grupit të auditimit

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**

19.1 Rekomandim: AZHBR në bashkëpunim me Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, të marrë masat, të fillojë projektin për krijimin dhe zhvillimin e Regjistrit të fermës, duke aplikuar të gjitha hapat ligjorë për një data basë të konsoliduar kombëtare dhe përfshirjen e të gjithë aktorëve, për të përmbushur detyrimet ligjore sipas Ligjit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, si dhe Planit Kombëtar për Integrim Evropian.

Përgjigjja e institucionit:

Po, Institucioni e ka pranuar Rekomandimn e lënë nga KLSH-ja dhe në planin veprimit me nr.

prot. 1656/16 datë 05.11.2021 “Mbi masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga auditimi i kryer në Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”, janë përcaktuar qartë hapat që do të ndiqen nga institucioni.

Në vijim për ndjekjen e rekomandimeve konform nenit 30, pika 2, të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, AZHBR ka vijuar me progresin e ndjekjes së rekomandimeve duke përditësuar veprimet e kryer nga institucioni me shkresën nr. 1497 prot. datë 15.04.2022.

Eshte miratuar Udhëzimi i Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural Nr. 19, datë 07.10.2021 “Për krijimin e Regjistrit të Konsoliduar Kombëtar të fermës”, si dhe Urdhëri nr.503, datë 07.10.2021 “Për hartimin e metodologjisë për të zbatuar në mënyre të unifikuar procedurat dhe mbledhjen e të dhenave për rregjistrin e fermës.

Komenti i grupit të auditimit

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe në **proces zbatimi**.

19.2 Rekomandim: AZHBR, në bashkëpunim me MBZHR, të ngrenë komision të veçantë me specialistë të fushës që të ketë për objekt pune:

-“Analizimin e shkaqeve dhe arsyeve të krijimit të subjekteve debitorë, fermerë”. Nëse arsyet e krijimit dhe rritjes së debitorëve kanë ardhur si pasojë e mos subvencionimit të in puteve bujqësore dhe karburantit si dhe të mungesës së lehtësirave tatimore nga organet shtetërore, të mundësohet një marrëveshje bashkëpunimi dhe mirë kuptimin me subjektet debitorë, apo të marrin iniciativën ligjore për inicimin e një projektvendimi të Këshillit të Ministrave, për rishikimin dhe ristrukturimin e këtij borxhi, me qëllim nxitjen e aktivitetit dhe shmangien e falimentimit që mund të vijnë nga shlyerja e këtyre detyrimeve si pasojë e ekzekutimeve të vendimeve gjyqësore.

-Analizimin dhe llogaritjen e raportit kosto-përfitim të subjekteve debitorë që me vendime të gjykatave formës së prerë u kërkohet zgjidhja e kontratave dhe sekuestrimi i sendeve (makinerive pajisjeve dhe serave) apo shlyerja e detyrimeve. Nëse kosto e sekuestrimit (çmontimit, transportit, ruajtjes etj) del më e lartë se përfitimi, AZHBR në mirëkuptim me këto subjekte të mundësojë një akt-marrëveshje, apo të marrin iniciativën ligjore për inicimin e një Projektvendimi të Këshillit të Ministrave, me qëllim lejimin e ushtrimit të aktivitetit, stimulimin dhe nxitjen e zhvillimit të tyre për të shmangur falimentimit që mund të vijnë nga ekzekutimi i vendimeve gjyqësore.

Përgjigja e institucionit:

Po, Institucioni e ka pranuar Rekomandimin e lënë nga KLSH-ja dhe në planin veprimit me nr. prot. 1656/16 datë 05.11.2021 “Mbi masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga auditimi i kryer në Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”, janë përcaktuar qartë hapat që do të ndiqen nga institucioni.

Në vijim për ndjekjen e rekomandimeve konform nenit 30, pika 2, të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, AZHBR ka vijuar me progresin e ndjekjes së rekomandimeve duke përditësuar veprimet e kryer nga institucioni me shkresën nr. 1497 prot. datë 15.04.2022.

AZHBR ka ngritur një grup pune me urdhrin nr 291, date 07/10/2021 për fillimin e këtij procesi. Ky grup pune do të verifikojë në terren dhe do të japë një vlerësimin paraprak për një serë me ngrohje. Nga informacioni i këtij grupi mund të krijohet një tablo më e qartë e analizës kosto-përfitim me subjektet debitorë që me vendime të gjykatave formës së prerë u kërkohet zgjidhja e kontratave dhe sekuestrimi i sendeve (makinerive pajisjeve dhe serave) apo shlyerja

e detyrimeve. Më pas AZHBR mund të propozojë iniciativën ligjore për një projekt vendim të KM për rishikimin dhe ristrukturimin e vlerave debitorë të këtij grupi. Megjithatë kemi vetëm një subjekt me vendim të formës së prerë i është vendosur “Kthim Sendi”.

Komenti i grupit të auditimit

Nga grupi i auditimit mbas verifikimit të kryer ky rekomandim konsiderohet në **proces zbatimi**.

19.3 Rekomandim: AZHBR në bashkëpunim me MBZHR dhe me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë në kuadër të bashkëpunimit institucional dhe nisur nga statusi që subjektet debitorë, mund të kenë në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, të hartojnë një plan bashkëpunimi për të gjithë debitorët dhe veçanërisht për debitorët e linjave 2005-2009, për verifikimin e statusit në sistemin tatimor dhe marrjen e menjëhershme të masave bllokuese për ata subjekte që figurojnë aktivë dhe që prodhojnë të ardhura dhe realizojnë fitime pikërisht prej makinerive të linjave 2005-2009, të financuara nga AZHBR.

Përgjigja e institucionit:

Po, Institucioni e ka pranuar Rekomandimin e lënë nga KLSH-ja dhe në planin veprimit me nr. prot. 1656/16 datë 05.11.2021 “Mbi masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga auditimi i kryer në Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”, janë përcaktuar qartë hapat që do të ndiqen nga institucioni.

Në vijim për ndjekjen e rekomandimeve konform nenit 30, pika 2, të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, AZHBR ka vijuar me progresin e ndjekjes së rekomandimeve duke përditësuar veprimet e kryer nga institucioni me shkresën nr. 1497 prot. datë 15.04.2022.

Ka filluar puna për arritjen e një marrëveshjeje me Drejtorinë e Tatimeve. I është dërguar zyrtarisht kërkesa për caktimin e përfaqësuesit për hartimin e një marrëveshje bashkëpunimi me shkresë Prot nr 555, datë 07.02.2022 dhe jemi në pritje të përgjigjes së tyre për të iniciuar marrëveshjen për marrjen e masave bllokuese për operatorët që nxjerrin përfitime dhe realizojnë të ardhura nga makineritë e linjave 2005-2009. Bashkëngjitur Me Urdhër të Kryeministrit Nr.81, datë 10.05.2022 ndryshuar Urdhër nr 103, datë 27.06.2022. është miratuar struktura e re organizative e AZHBR-së.

Komenti i grupit të auditimit

Nga grupi i auditimit mbas verifikimit të kryer ky rekomandim konsiderohet në **proces zbatimi**.

19.4 Rekomandim: Nga auditimi i borxhit u konstatua se AZHBR-ja trashëgon në mënyrë të vazhdueshme debitorë të cilët në total deri më 31.12.2018 janë në vlerën 2,058,454,729 lekë, ku pjesën më të madhe e zënë debitorët e linjave të viteve 2005-2009, me një borxh të mbartur në vlerën 1,032,644,780 lekë që i përket linjave të vitit 2005 dhe një vlerë prej 169,388,097 lekë që i përket linjave të vitit 2009. Për sa më sipër rikërkojmë që AZHBR dhe MBZHR, të ngrejnë grup pune të vecantë, për analizimin e shkaqeve dhe arsyeve, të mos arkëtimit të vlerës prej **2,058,454,729** lekë, pasi nga ky veprim nuk është krijuar fondi kundërparti dhe për pasojë nuk është vazhduar me skemën e rifinancimit në dobi të fermerëve të tjerë

Përgjigja e institucionit:

Po, Institucioni e ka pranuar Rekomandimin e lënë nga KLSH-ja dhe në planin veprimit me nr. prot. 1656/16 datë 05.11.2021 “Mbi masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të dhëna

nga auditimi i kryer në Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”, janë përcaktuar qartë hapat që do të ndiqen nga instiucioni.

Në vijim për ndjekjen e rekomandimeve konform nenit 30, pika 2, të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, AZHBR ka vijuar me progresin e ndjekjes së rekomandimeve duke përditësuar veprimet e kryer nga institucioni me shkresën nr. 1497 prot. datë 15.04.2022.

AZHBR është në kontakt me MBZHR për ndjekjen më tej të procedurave. Rekomandim lidhur me të ardhurat e munguara është pranuar por nuk është zbatuar ende pasi Rekomandim për Analizimin dhe llogaritjen e raportit kosto-përfitim të subjekteve debitorë që me vendime të gjykatave të formës së prerë u kërkohet zgjidhja e kontratave dhe sekuestrimi i sendeve (makinerive pajisjeve dhe serave) apo shlyerja e detyrimeve. Nëse kosto e sekuestrimit (çmontimit, transportit, ruajtjes etj) del më e lartë se përfitimi, AZHBR në mirëkuptim me këto subjekte të mundësojë një akt-marrëveshje me qëllim lejimin e ushtrimit të aktivitetit, stimulimin dhe nxitjen e zhvillimit të tyre.

AZHBR herë pas here ka vënë në dijeni Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për problematikat lidhur me debitorët e ish – projektit 2KR, duke dhënë disa propozime për zgjidhjen e këtij problem, nëpërmjet shkresave të cituara më poshtë:

- Shkresa nr. 2941/1 datë 14.12.2017 dërguar MBZHR-së “Debitorët pa shpresë arkëtimi”;
- Shkresa 1487, datë 02.05.2018 dërguar MBZHR-së “Relacion për debitorët e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”.

Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural në ndjekje të këtij Rekomandim ka dërguar shkresën nr. 1864, datë 03.07.2020 me anë të së cilës i kërkoi MBZHR caktimin e një përfaqësuesi i cili të jetë pjesë e komisionit të veçantë sipas Rekomandim të lënë nga KLSH. Me shkresën nr. 5535/4 prot., datë 28.07.2020, MBZHR caktoi përfaqësuesin për të marrë pjesë në komision. Me Urdhrin nr. 366, datë 25.08.2020, të Drejtorit të Përgjithshëm të AZHBR u ngrit grupi i punës për “Analizimin dhe llogaritjen e raportit kosto-përfitim të subjekteve debitorë që me vendime të gjykatës së formës së prerë u kërkohet zgjidhja e kontratave dhe sekuestrimi i sendeve (makinerive pajisjeve dhe serave)”.

Komenti i grupit të auditimit

Nga grupi i auditimit mbas verifikimit të kryer ky rekomandim konsiderohet i **pranuar** dhe **zbatuar pjesërisht**

MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN DHE MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1.1.Rekomandim: Titullari i institucionit të marr masa të menjëhershine për ngritjen e grupit të punës për verifikimin e aktivitetit referuar kontratës së lidhur midis AZHBR-së dhe subjektit “O. O. E.” me nr. 2814/10 prot., datë 29.10.2018, si dhe për evidentimin e shkaqeve që kanë sjellë mosvënien në punë të investimit, duke rrezikuar përdorim jo efektiv të fondeve prej 10,000,000 lekë.

Menjëherë

1.2.Rekomandim : Drejtoria e Kontrollit në AZHBR të marrë masa që, verifikimi në terren i investimit të kryer nga subjektet përfitues, të konsistojë jo vetëin në përfundimin e zërave të parashikuar në kontratë, por edhe në gatishmërinë e subjektit për të zhvilluar aktivitetet, që është edhe qëllimi i masës së Skemës Mbështetëse.

Përgjigja e institucionit:

Po, Institucioni e ka pranuar Rekomandimn e lënë nga KLSH-ja dhe në planin veprimit me nr. prot. 1656/16 datë 05.11.2021 “Mbi masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga auditimi i kryer në Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”, janë përcaktuar qartë hapat që do të ndiqen nga instiucioni.Në vijim për ndjekjen e rekomandimeve konform nenit 30, pika 2, të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, AZHBR ka vijuar me progresin e ndjekjes së rekomandimeve duke përditësuar veprimet e kryer nga institucioni me shkresën nr. 1497 prot. datë 15.04.2022. Drejtoria e Kontrollit bazuar në Akt Verifikimin nr.2 Nr.1565/4-1565/8 datë 12.07.2021 (nga KLSH) për gjetje tek subjekti përfitues O. O. E., përpiloi programin e punës me Nr. 2544 Prot., date 05.08.2021 për kontroll monitorues tek ky subjekt. Në datën 09.08.2021 Inspektorët e Montiorimit u paraqitën në adresën e investimit Nivice/Tepelene/Gjirokaster. Kontrolli ex-post në vend nuk u realizua sepse përfituesi nuk u paraqit.

Në vazhdim, Drejtoria e Kontrollit, Sektori i Monitorimit përpiloi shkresën njoftuese për kontroll ex-post për subjektin O. O. E. (Nr. 2690 prot., datë 01.09.2021) ku bëjmë me dije përfituesin të marrë masat e nevojshme për realizimin e kontrollit monitorues.

Sektori i Monitorimit ka realizuar kontroll monitorues tek ky subjekt sipas programit të punës me Nr.Prot 870, datë 06.03.2023 dhe në vijimësi do të kryejë kontroll sërish për të verifikuar funksionalitetin e investimit në kuadër të përmbushjes së Rekomandimt të lënë.

Komenti i grupit të auditimit

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenet 57, 58 dhe 59 të ligjit nr. 153/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i ndryshuar, pasi të jenë identifikuar përgjegjësitë në lidhje me shkeljet e konstatuara e të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, i rekomandohet Titullarit të AZHBR st dhe Komisionit Disiplinor përkatës për vlerësim dhe dhënie masash disiplinore nga “Vërejtje deri “Largim nga shërbimi civil”, për punonjësit e ngarkuar me përgjegjësi, në raport me shkeljet e konstatuara. 2.Titullari i AZHBR, pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, të ndërmarrë veprimet si më poshtë:

a.Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar.

b.Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar.

Përgjigja e institucionit:

AZHBR në kuadër të gjetjeve dhe rekomandimeve të konstatuara nga KLSH gjatë auditimit financiar dhe të përputhshmërisë dhe në vijim të zbatimit të rekomandimeve dhe të kontrollit të punës së ushtruar nga stafi gjatë kryerjes së detyrave funksionale sipas përshkrimit të punës,

rregullores së brendshme të institucionit, manualët e procedurave përkatëse, në përputhje me nenet 57, 58 dhe 59 të ligjit nr.153/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, VKM nr.115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i ndryshuar, ka ngritur disa komisione disiplinore për shqyrtimin e shkeljeve të mundshme të konstatuara, në përfundim të këtyre komisioneve janë marrë masat përkatëse, ose bazuar në shqyrtimin administrativ është vendosur

ndërprerja e procedurës disiplinore nga komisioni disiplinor përkatës.

(Bashkëngjitur praktika përkatëse nga Drejtoria Juridike dhe Shërbimeve Mbështetese).

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **zbatuar**.

KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve në AZHBR me shkresën me nr. 526/8 prot, datë 13.10.2021 për Raportin Përfundimtar të Auditimit “Për auditimin financiar dhe përputhshmëri” të ushtruar në Agjencinë e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural, sipas programit të auditimit nr. 526/1 prot., datë, 17.05.2021 rezulton se subjekti i audituar ka respektuar afatin 20 ditor për hartimin e planit të masave për zbatimin e rekomandimeve në përputhje me kërkesat e nenit 15 shkronja (j) të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, ka respektuar afatin për njoftimin brenda 6 muajve mbi ecurinë e zbatimit të këtyre masave në përputhje me kërkesat e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit. Konkretisht ecuria e zbatimit të rekomandimeve paraqitet sipas tabelës “Ecuria e zbatimit të rekomandimeve”

Masa	Gjithsej		Pranuar		Zbatuar plotësisht		Pjesërisht		Në proces		Pa zbatuar	
	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë
Organizative	40	-	40	-	28	-	2	-	7	-	3	-
Disiplinore	1		1		1							
Eliminimi efekteve negative	2	10,000,000	2	-	-	-	-	-	2	10,000,000	-	-
Gjithsej	43	10,000,000	43	-	29		2	-	9	10,000,000	3	-

Si sipër rezulton se janë dhënë gjithsej 20 masa me 43 rekomandime të cilët janë pranuar plotësisht (100 %), dhe rezultojnë të zbatuar plotësisht 29 rekomandime (67 %).

Për të gjitha rekomandimet që konsiderohen në proces zbatimi, inkurajohet përsheptimi i realizimit të plotë të tyre.

Për sa më sipër ri kërkojmë që Agjencia për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural të marrë të gjitha masat e nevojshme me qëllim zbatimin e të gjitha rekomandimeve që rezultojnë të zbatuara pjesërisht dhe të pazbatuara brenda 3-mujorit të parë të vitit 2024. Si dhe kërkojmë marrjen e masave disiplinore për zyrtarët përgjegjës, në lidhje me rekomandimet e KLSH të pranuar prej institucionit dhe që efektivisht rezultojnë të pa zbatuara.

3.9 QËNDRA KOMBËTARE E TRANSFUZIONIT TË GJAKUT

PËRMBLEDHJE

Në zbatim të Programit të Auditimit nr. 613/18 datë 06.07.2023 “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin tematik të datës 01.07.2022”, në ambientet e Qendrës

Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut më datë 20.07.2023 u mbajt aktverifikimi nga audituesit e autorizuar të KLSH-së G.H dhe A.K me zj. Irena Seferi në cilësinë e Titullarit të institucionit dhe znj. Blerta Lukaj e autorizuar për trajtimin e rekomandimeve të KLSH-së.

Objekt i këtij akt verifikimi është:

Verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të KLSH të lëna me shkresën nr.548/11 datë 19.10.2022 për Raportin Përfundimtar të Auditimit “Për auditimin tematik” të ushtruar në Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut, sipas programit të auditimit nr. 548/4 prot., datë, 01.07.2022, në lidhje mbi statusin e zbatimit të rekomandimeve, afateve dhe niveli i zbatueshmërisë së tyre, koherencën e tyre si dhe përgjegjshmërinë menaxheriale referuar standardeve të auditimit.

Auditimi u krye nga:

1. G.H

2. A.K

Auditimi ka filluar më datë 07.07.2023

Auditimi ka përfunduar më datë 20.07.2023

Auditimi është kryer në bazë të Programit të Auditimit të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit nr.613/18 prot., datë 06.07.2023 me objekt: “Mbi verifikimin e zbatimit të rekomandimeve”, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” si dhe në zbatim të Rregullosës së Procedurave të Auditimit dhe të Manualit për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të auditimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe Regjistrisë elektronik institucionale, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 67, datë 13.06.2020.

TRAJTIMI I ÇËSHTJEVE TË AUDITIMIT

Nga auditimi i ushtruar në Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, “Mbi auditimin tematik” për periudhën 01.01.2021 deri më datën 30.06.2022 trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin nr.201, datë 18.10.2022, të Kryetarit të KLSH-së, verifikohet se:

I. Hartimi i programit (Plan veprimit) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në nenin 15 shkronja (j) të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Subjekti ka hartuar një procesverbal i mbajtur në datën 27.10.2022 në lidhje me temën “Për marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga Rapportit përfundimtar i auditimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut miratuar planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, duke e dërguar në KLSH me shkresën nr.252/9 datë 31.10.2022 kjo në përputhje me me ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” nenit 15, shkronja j.

Sa më sipër rezulton se është zbatuar afati 20 ditor për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve

II. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Në lidhje mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve dhe afatet e përcaktuara, sipas strukturave përgjegjëse Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut ka përgatitur planin e veprimit me nr 388 prot datë 27.10.2022, dërguar në KLSH me shkresën nr.252/9 datë 31.10.2022.

Sa më sipër rezulton se është zbatuar afati 6 mujor për kthimin e përgjigjes për zbatimin e

rekomandimeve:

III. Realizimi i rekomandimeve

Nga ana e KLSH-së, janë lënë 4 Masa Organizative dhe 1 Masë Disiplinore. Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

- a) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 4 Masa organizative nga ku 4 rekomandime, janë pranuar plotësisht 4 të cilat kanë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon, 4 Zbatuar.
- b) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 1 Masë disiplinore nga ku 1 rekomandim, është pranuar plotësisht 1 dhe ka statusin e ecurisë së zbatimit si vijon, 1 Zbatuar.

Më hollësisht, auditimi i ndjekjes së rekomandimeve në Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut paraqitet si vijon:

MASA ORGANIZATIVE.

1.1 Rekomandim: QKTGJ të marrë masa për publikimin e vendeve vakante duke respektuar detyrimin të raportojë në DQOSHKSH vendet vakant për të cilat do të shpallet konkurimi në 5 (pesë) ditët e para të çdo muaji.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Po, institucioni e ka pranuar Rekomandimn dhe në planin e veprimit me nr 388 date 27.10.2022 ngarkon Sektorin e Administratës dhe Burimeve Njerëzore për ndjekjen dhe zbatimin e shpalljes së procedurës duke njoftuar Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për miratimin e nisjes së procesit të shpalljes si dhe më pas dërgimin për publikim ne DQOSHKSH. Sa me sipër Sektori Administratës ka respektuar etapat e shpalljes dhe publikimit elektronikisht të vendeve vakante si dhe me kërkesë drejtuar Drejtorisë Qëndrore të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor. Në urdhërin nr. 270 prot, datë 18.07.2022 kërkohet ngritja e Komisionit të vlerësimit të kandidatit për mjek transfuziolog në QKTGjakut. Gjithashtu me shkresen nr. 270/4 datë 19.08.2022 është bërë njoftimi për shpalljen fitues për vendin vakant mjek transfuziolog duke ju referuar Udhëzimit me nr.499 datë 02.07.2019 “ Për procedurat e pranimit dhe emërimit të mjekëve në Institucionet Shëndetësore Publike” në Republikën e Shqipërisë.

Komenti i grupit të auditimit.

Në urdhërin nr. 270 prot, datë 18.07.2022 kërkohet ngritja e Komisionit të vlerësimit të kandidatit për mjek transfuziolog në QKT Gjakut.

Me shkresen nr. 270/4 datë 19.08.2022 është bërë njoftimi për shpalljen fitues për vendin vakant mjek transfuziolog duke ju referuar Udhëzimit me nr.499 datë 02.07.2019 “ Për procedurat e pranimit dhe emërimit të mjekëve në Institucionet Shëndetësore Publike” në Republikën e Shqipërisë.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**

2.1 Rekomandim: QKTGJ dhe MSHMS të bëjnë përditësimin e rregullores për funksionimin e shërbimit të transfuzionit të gjakut sipas ndryshimeve të ndodhura në strukturën e Qendrës Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut.

Brenda datës 31.12.2022

Përgjigjja e institucionit:

Po, institucioni e ka pranuar Rekomandimn dhe në planin e veprimit me nr 388 date 27.10.2022 ka ngarkuar sektorin e administratës e cila me shkresën Nr.420 datë 16.11.2022 ka

dërguar miratimin e Projekt Rregullores së brendshme të QKT Gjakut, Komitetit Kombëtar të Transfuzionit të Gjakut në Ministrinë e Shëndetësisë.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**

3.1 Rekomandim: Sektori i Administratës të marrë masa për plotësimin e dosjeve të personelit me të gjithë dokumentacionin përkatës.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Po, institucioni e ka pranuar Rekomandimn dhe me planin e veprimit me nr 388 date 27.10.2022 i është dhënë detyre sektorit të administratës të marrë masa për plotësimin e dosjeve të personelit me të gjithë dokumentacionin përkatës duke ju referuar VKM nr. 833, datë 28.10.2020 “Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër verifikuar nga ana jonë, Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**

4.1 Rekomandim: Sektori i Administratës të marrë masa që të hartojë një format tip të Kontratës Individuale së Punës, që përfshin të gjithë elementët e cituar në Kodin e Punës.

Brenda 6 muajve dhe në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Po, institucioni e ka pranuar Rekomandimn dhe me planin e veprimit me nr .388 date 27.10.2022 i jepet detyrë sektorit të administratës të marrë masa për plotësimin e elementëve në formatin e kontratës së punës dhe të plotësohen te dosjet e personelit referuar Ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Neni 21 pika 3.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër verifikuar nga ana jonë, Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**

MASA DISIPLINORE

B.1. Drejtorit të QKTGJ.

Në mbështetje të shkronjës (c) neni 15 -Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” në përputhje me Ligjin nr. 7691, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar si dhe kontratës individuale, i rekomandojmë Drejtorit të QKTGJ, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë, për shkeljet e konstatuar sipas çështjeve të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, si dhe të kërkojë marrjen e masave disiplinore për personat që vlerësohen me përgjegjësi në këtë raport përfundimtar auditimi.

B.2. MINISTRIT TË SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE.

Në mbështetje të shkronjës (c) neni 15 -Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në përputhje me Ligjin nr. 7691, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar si dhe kontratës individuale, i rekomandojmë Ministrin të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes

Sociale të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë dhe marrjen e masave disiplinore për Drejtuesin e QKTGJ për shkeljet e konstatuara sipas çështjeve të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH.

C. VLERËSIMI I ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE

Në përfundim të afateve të përcaktuara në rekomandimet e lëna në këtë auditim dhe afatin e caktuar, në nenin 15 dhe 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për masat e marra dhe për zbatimin e rekomandimeve të njoftohet Kontrolli i Lartë i Shtetit, nga Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut.

Përgjigjja e institucionit:

Po, institucioni e ka pranuar Rekomandimn dhe në planin veprimit me nr 388 date 27.10.2022 është përcaktuar qartë se personi përgjegjës i sektorit të administratës dhe burimeve njerëzore i jepet tërheqje vëmendje verbalisht dhe i lihet në zbatim plani i veprimit sipas afateve të përcaktuara.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**

KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve në QKTGJ me shkresën me nr.548/11 datë 19.10.2022 për Raportin Përfundimtar të Auditimit “Për auditimin tematik” të ushtruar në Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut, sipas programit të auditimit nr. 548/4 prot., datë, 01.07.2022, rezulton se subjekti i audituar ka respektuar afatin 20 ditor për hartimin e planit të masave për zbatimin e rekomandimeve në përputhje me kërkesat e nenit 15 shkronja (j) të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, ka respektuar afatin për njoftimin brenda 6 muajve mbi ecurinë e zbatimit të këtyre masave në përputhje me kërkesat e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Konkretisht ecuria e zbatimit të rekomandimeve paraqitet sipas tabelës “Ecuria e zbatimit të rekomandimeve”

Masa	Gjithsej		Pranuar		Zbatuar plotësisht		Pjesërisht		Në proces		Pa zbatuar	
	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë
Organizative	4	-	4	-	4	-	-	-	-	-	-	-
Disiplinore	1	-	1	-	1	-	-	-	-	-	-	-
Gjithsej	5	-	5	-	5	-	-	-	-	-	-	-

Sa sipër rezulton se janë dhënë gjithsej 5 masa me 5 rekomandime të cilët janë pranuar plotësisht (100 %), dhe rezultojnë të zbatuar plotësisht 5 rekomandime (100%).

3.10 DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHETIT

PËRMBLEDHJE

Në zbatim të Programit të Auditimit nr.613/24 datë 06.07.2023 “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e evaduara në 6-mujorin e parë të vitit 2022”, në ambientet e institucionit, më datë 25.07.2023, u mbajt aktverifikimi nga audituesit e autorizuar të KLSH-së A. K. dhe znj. A.Xh, z. M. Rrumbullaku në cilësinë e Titullarit të Institucionit si dhe me z. K. H.në cilësinë e personit të autorizuar për trajtimin e rekomandimeve të KLSH-së.

Objekt i këtij akt verifikimi është:

Verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të KLSH të lëna me shkresën nr.1020/8 datë 08.03.2022 për Raportin Përfundimtar të Auditimit “Për auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” të ushtruar në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, sipas programit të auditimit nr.1020/1 prot., datë 04.10.2021, i ndryshuar, për veprimtarinë nga data 01.01.2019 deri më datën 30.06.2021, në lidhje mbi statusin e zbatimit të rekomandimeve, afateve dhe niveli i zbatueshmërisë së tyre, koherencën e tyre si dhe përgjegjshmërinë menaxheriale referuar standardeve të auditimit.

Auditimi u krye nga:

1. A.K

2. A.Xh,

Auditimi ka filluar më datë 07.07.2023

Auditimi ka përfunduar më datë 25.07.2023

Auditimi është kryer në bazë të Programit të Auditimit të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit nr.613/24 prot., datë 06.07.2023 me objekt: “Mbi verifikimin e zbatimi të rekomandimeve”, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” si dhe në zbatim të Rregullores së Procedurave të Auditimit dhe të Manualit për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të auditimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe Regjistrorit elektronik institucional, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 67, datë 13.06.2020.

TRAJTIMI I ÇËSHTJEVE TË AUDITIMIT

Nga auditimi i ushtruar në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, “Mbi auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” për periudhën 01.01.2019 deri më datën 31.06.2021 trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin nr. 34, datë 03.03.2022, të Kryetarit të KLSH-së të cilat janë përcjellë me shkresën nr.1020/8, datë 08.03.2022, rezulton se:

I. Hartimi i programit (Plan veprimit) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në nenin 15 shkronja (j) të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Nga auditimi u konstatua se, subjekti ka miratuar planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, duke e dërguar në KLSH me shkresë nr.2295/18 prot., datë 22.08.2022 kjo në përputhje me me ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” nenit 15, shkronja j.

Sa më sipër rezulton se është zbatuar afati 20 ditor për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve.

II. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Në lidhje mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve dhe afatet e përcaktuara, sipas strukturave përgjegjëse, DPPSH nuk ka përgatitur planin e masave të marra lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të miratuara nga Titullari brenda afatit 6 mujor, në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” nenit 30, pika 2 e tij.

Sa më sipër rezulton se nuk është zbatuar afati 6 mujor për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve.

III. Realizimi i rekomandimeve

Nga ana e KLSH-së, me shkresat përcjellëse janë lënë në total 18 masa organizative, 1 Masë për shpërblim dëmi, 1 Masë për për menaxhimin me Efektivitet dhe Ekonomicitet të Fondeve Buxhetore, 1 Masë Administrative, 1 Masë Disiplinore, nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

- e) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 18 Masa organizative nga ku 21 rekomandime, janë pranuar plotësisht 21 të cilat kanë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon, 15 Zbatuar, 3 pa zbatuar dhe 3 në proces zbatimi.
- f) Për përmirësimin e gjendjes është lënë 1 Masë shpërblim dëmi nga ku 1 rekomandim i cili është pranuar plotësisht i cila ka statusin e ecurisë së zbatimit si vijon, 1 zbatuar.
- g) Për përmirësimin e gjendjes është lënë 1 Masë për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin dhe menaxhimin me ekonomikitet, eficientë dhe efektivitet të fondeve publike nga ku 1 rekomandim i cili është pranuar plotësisht dhe ka statusin e ecurisë së zbatimit si vijon, 1 zbatuar.
- h) Për përmirësimin e gjendjes është lënë 1 Masë Administrative nga ku 1 rekomandim të cilin nuk janë shprehur në plan veprimi, dhe ka statusin e ecurisë së zbatimit si vijon, 1 në proces zbatimi.
- i) Për përmirësimin e gjendjes është lënë 1 Masë Disiplinore nga ku 1 rekomandim, të cilat kanë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon, 1 pa zbatuar.

Më hollësisht, auditimi i ndjekjes së rekomandimeve në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit paraqitet si vijon:

B. MASA ORGANIZATIVE

1.1. Rekomandim: Sektori i Financës të marrë masa të menjëhershme për të rakorduar me sektorin e çështjeve juridike, sa i takon informacionit të plotë të vendimeve të gjykatës të formës së prerë, të cilat duhet të njihen në vlerën e tyre të plotë, si detyrime për tu shlyer në periudhat e ardhshme dhe për të cilat duhet të provigjionohen shumat përkatëse. Njëkohësisht vlera e tyre duhet njohur edhe si shpenzim periudhe në pasqyrat financiare të institucionit.

Menjëherë e në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Për periudhen pas auditimit dhe më 31.12.2022 kemi pasur vetëm një rast vendimi gjyqësor, për likuidim detyrime kontribute sigurime shoqërore, i cili është likuiduar më datë 28.02.2022. Për vitin 2023 kemi 3 vendime me status “pa zbatuar”, dy vendime gjyqësore të cilat janë regjistruar me kosto 7,200 mijë lekë, është kërkuar çelja e fondeve, dhe një vendim i Gjykatës së Apelit i cili është pezulluar nga Gjykata e Lartë i pa maturuar.

Drejtoria e Financave ka monitoruar në vijimësi ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë nëpërmjet aktiviteteve si më poshtë:

- Ka mbajtur databazën e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, me të dhëna për emrin e kreditorit, vlerën e detyrimit si dhe njësinë shpenzuese që do të realizojë likuidimin e detyrimit, databazë e cila është mbajtur në mënyrë kronologjike, sipas datës së protokollit të hyrjes në Drejtorinë e Financave;
- Ka rakorduar punën me Drejtorinë Juridike dhe të Burimeve Njerzore, për të kompletuar praktikën e secilit vendim gjyqësor me mendimin juridik dhe aktet e tjera sipas vendimmarrjes së gjykatave;

- Ka dërguar zyrtarisht pranë Njësive shpenzuese të varësisë, të gjitha praktikat e vendimeve gjyqësore për të vijuar më tej me likuidimin e detyrimeve financiare përkatëse në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi;
- Për çdo rast likuidimi të detyrimeve për vendime gjyqësore që kanë realizuar njësitë shpenzuese të varësisë, ka marrë kopje të Urdhër-Pagesës, të cilën e ka axhornuar në databazën e vendimeve gjyqësore si dhe e ka administruar në dosjen përkatëse të kreditorit;
- Ka ndjekur me prioritet procesin e rialokimit të fondeve tepricë, për të mundësuar likuidimin e detyrimeve për vendime gjyqësore;
- Ka përfshirë në Pasqyrat Financiare Vjetore vlerën e detyrimeve për vendime gjyqësore të palikujduara si në llogarinë “shpenzime të periudhave të ardhshme” ashtu edhe në llogarinë “kreditor të ndryshëm”;

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe i zbatuar.**

1.2. Rekomandim: Sektori i Financës në çdo rast të ndjekë dhe zbatojë me përpikmëri parimin FIFO, gjatë likuidimit të detyrimeve të prapambetura.

- Sektori juridik, të marrë masa për ndjekjen me kujdes të proceseve gjyqësore dhe përcjelljen në kohë të informacionit të plotë dhe të saktë në njësinë përkatëse, përgjegjëse për financë/kontabilitetin, në mënyrë që kjo e fundit të mund të provigjionojë fonde për shpenzime të këtij lloji, si edhe të njohë dhe kontabilizojë në kohë vlerat që lidhen me këto shpenzime/detyrime, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

Menjëherë e në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Dy vendimet gjyqësore regjistruar gjatë periudhës 6-mujori parë i vitit 2023, me nr V-4 prot., datë 09.02.2023 në vlerën 7,179 mijë lekë dhe nr.2778/1 datë 12.07.2023 në vlerën 48,000 lekë, me çeljen e fondeve do të likujdohen sipas parimit FIFO.

Rast pas rasti dhe menjëherë, çdo Vendim gjyqësor që bëhet hyrje në DPPSH, axhornohet në databazën e vendimeve gjyqësore dhe kalohet zyrtarisht në Njësinë shpenzuese përgjegjëse për shlyerjen e detyrimeve financiare në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi;

Në mënyrë të vazhdueshme është analizuar databaza e vendimeve gjyqësore të palikujduara, me qëllim respektimin e parimit “FIFO” në likuidimin e detyrimeve financiare;

Konkretisht të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore që janë të evidentuara në databazën e DPPSH dhe që nuk janë të kushtëzuara me dhënie grade apo me rikthim në detyrë janë ekzekutuar në varësi të fondeve në dispozicion

Drejtoria Juridike, përcjell në çdo kohë situatën ligjore për çdo rast që ndiqet nga kjo strukturë dhe do të vijojë rregullisht me kryerjen e detyrave funksionale të përcaktuara.

Komenti i grupit të auditimit.

Grupi auditimit ndodhet në kushtet e një vendimi i cili është regjistruar qysh në 09.02.2023 dhe ende nuk është likuiduar, e në mungesë të dokumentacionit justifikues verifikues të Rekomandimt dhënë nga auditimi mëparshëm nuk arrijmë të marrim siguri të arsyeshme mbi zbatueshmërinë e tij por ngelet në vijim të vlerësohet kjo zbatueshmëri.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe i zbatuar.**

2.1. Rekomandim: Sektori i financës së DPPSH të marrë masa për sistemimin e shumës 398,344 lekë nga llogaria 202 “Studime dhe kërkime” në llogarinë 212 “Ndërtesa e Konstruksione”, sipas zërave për të cilën janë realizuar “Studim e projekte”.

Menjëherë

Përgjigja e institucionit:

“Objekti Laboratori i Ndërlidhjes” është në pronësi të Njësisë Shpenzuese Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë, nga Drejtoria e Mbështetjes logjistike ka filluar procedura e transferimit të objektit në pronësi të Njësisë Shpenzuese Aparati i DPP Shtetit, me kalimin e objektit në pronësi tonën do të bëhet dhe transferimi i vlerave në klasën II “objekte ndërtimore”.

Komenti i grupit të auditimit.

Grupi auditimit ndodhet në kushtet kur ende nuk është kryer kalimi i pronësisë së objektit po ka filluar procedura për transferim në pronësi të DPPSh.

Afati për zbatim të masës lënë nga auditimi mëparshëm ka qenë i menjëhershëm, dhe ky pasqyrim duhej reflektuar në pasyrat financiare të vitit 2022, veprim i cili ende nuk është finalizuar për shkak të pronësisë.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe i pazbatuar**

3.1. Rekomandim: Sektori i Financës së DPPSH të marrë masat për klasifikimin e zërave të aktiveve në llogaritë përkatëse kontabël dhe vlerësimin e vlerës së mbetur të këtyre aktiveve.

- Sektori i Financës së DPPSH të marrë masa për sistemimin e llogarisë 24 “Aktive të Qëndrueshme të trupëzuara të dëmtuara”, duke mbajtur në këtë llogari në vlerën neto, vetëm ato aktive të cilat janë vlerësuar për jashtë përdorimi.

Menjëherë

Përgjigja e institucionit:

Në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2022, llogaria “24” është sistemuar, është pasqyruar me vlerën 0 lekë, vlerësimi i aktiveve për jashtë përdorimit është bërë pas inventarit të datës 31.12.2022, dhe procesi i vlerësimit dhe nxjerrjes jashtë përdorimit është realizuar gjatë periudhës Mars – Qershor 2023.

Gjithashtu në pasyrat financiare të vitit 2022 është bërë sistemimi i llogarive të pajisjeve teknike, pajisjeve të zyres dhe ato elektronike.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe i zbatuar**

4.1. Rekomandim: Sektori i financës së DPPSH të marrë masa për sistemimin e shumës 4,596,859 lekë të investimit me objekt “Ndërtimin e Datacenter për Policinë” nga 230 “Për Aktive Afatgjata jo materiale” në llogarinë në llogarinë 203 “Koncesione, Patenta, Licenca e të ngjashme”

- Sektori i financës së DPPSH të marrë masa për sistemimin e shumës 1,240,000 lekë “Studime e projektimit të Hanin të Hotit” dhe vlerës 82,553,292 lekë “Për TVSH ndërtimit të Hanin të Hotit” duke i kapitalizuar në llogarinë 212 “Ndërtesa e Konstruksione” në objektin e “Pikës Kufitare Hani i Hotit”.

Menjëherë

Përgjigja e institucionit:

Objekti ku është bërë Investimi për Datacentrin e Policisë Shtetit është Laboratori i Ndërlidhjes i cili është në pronësi të DVP Tiranë, me kalimin e pronësisë do të kapitalizohet vlera në këtë objekt.

Ndërsa për investimin e kryer në Pikën Kufitare “Hani i Hotit”, është bërë shkresa nr.643 datë 25.02.2022 për transferimin e shumës së investimit Drejtorisë Vendore të Kufirit dhe Migracionit Shkodër, shuma nuk është marrë në kontabilitet nga ana e tyre për arsye se objekti nuk është marrë në dorëzim përfundimtar.

Me urdhërin nr.2540 datë 11.07.2023 të Drejtorit të Departamentit të Shërbimeve Mbështetëse është ngritur grupi i punës për marrjen në dorëzim përfundimtar të projektit “Ndërtim i PKK Hani Hotit”, me përfundimin e procesit të marrjes në dorëzim do të bëhet transferimi i shumave përkatëse.

Komenti i grupit të auditimit.

Referuar dokumentacionit të vendosur në dispozicion lidhur me këtë rekomandim rezulton se, nga ana e institucionit janë vendos korrespondenca me DVKM Shkodër por nuk është kryer sistemimi i shumës 1,240,000 lekë “Studime e projektimit të Hanin të Hotit” dhe asaj 82,553,292 lekë “Për TVSH ndërtimit të Hanin të Hotit” duke i kapitalizuar në llogarinë 212 “Ndërtesa e Konstruksione” për arsye se objekti nuk është marr në dorëzim përfundimtar. Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe në proces zbatimi.**

5.1. Rekomandim: Sektori i Financës të marrë masat për të kryer sistemimet e nevojshme dhe regjistrimet në kontabilitet në bazë të klasifikimit ekonomik kontabël, duke tranzituar rezultatin e viti ushtrimor në llogarinë 85, “Rezultati i veprimtarisë ushtrimore”, si dhe duke tranzituar shumat e evidentuara në llogarinë 85, “Rezultati i veprimtarisë ushtrimore” të vitit paraardhës në llogarinë 12 “Rezultate të mbartura nga funksioni”, për një pasqyrim më të drejtë të kundër partisë së disponibiliteteve në thesar, me qëllim që të parandalohen gabimet apo parregullsitë e mundshme në interpretimin e llogarive të pasqyrave financiare.

Menjëherë e në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Në pasqyrat financiare të vitit 2022 Rekomandim i juaj është zbatuar, rezultati i veprimtarisë është tranzituar nëpërmjet llogarisë 85, dhe rezultatet e mëparshme në llogarinë 12.

Komenti i grupit të auditimit.

Referuar dokumentacionit justifikues të vendosur në dispozicion, konkretisht fotokopje e Aktiv Pasiv të Pasqyrave Financiare të vitit 2022, ky tranzitim llogarish nuk rezulton të jetë kryer. Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe i pazbatuar.**

6.1. Rekomandim: Grupi i komisionit qendror dhe vlerësimit të aktiveve i ngritur nga Titullari i Institucionit të DPPSH të marrë masa në vazhdimësi, për të përpiluar një raport përmbledhës, ku të bëjë një ndarje të aktiveve gjendje që disponon institucioni, sipas zërave duke bashkëngjitur listën e tyre në relacionin, me qëllim verifikimin reale të gjendjes së tyre, si dhe verifikimin më lehtësisht të diferencave të gjendjes së tyre fizike me të dhënat e regjistruara në kontabilitet sipas zërave.

Në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Gjatë procesit të Inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve për vitin 2022 është hartuar relacion përmbledhës dhe relacion i veçantë sipas strukturave ku është pasqyruar lista me aktivet e identifikuar për nxjerrje jashtë përdorimit.

Në kuadër të monitorimit të procesit të Inventarizimit vjetor në njësitë shpenzuese të varësisë, dhe kontrollit të situatës lidhur me realizimin e këtij detyrimi, Drejtoria e Financave ka dërguar në Njësitë e varësisë shkresën e DPPSH nr.7522, datë 07.10.2022 “Për inventarizimin e aktiveve për vitin 2022”, me anë të së cilës ka kërkuar ti vihen në dispozicion:

- Urdhërat e Titullarëve të Njësisë shpenzuese mbi krijimin e komisioneve për inventarizimin dhe vlerësimin e aktiveve për vitin buxhetor 2022”;

- Përfundimet e procesit të inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve për nxjerrje jashtë përdorimit;

në përgjigje të së cilës Njësia shpenzuese për Aparatin e DPPSH ka raportuar Urdhërin nr.591/1, datë 15.12.2022 “Për krijimin e komisioneve të inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve në Aparatin e DPPSH për vitin 2022”;

Komenti i grupit të auditimit.

Referuar dokumentacionit justifikues vendosur në dispozicion rezulton se, për vitin 2022 me shkresën nr.363 prot., datë 30.01.2023 është hartuar relacioni përmbledhës për procesin e inventarizimit të vitit 2022, por mungon relacioni veçantë lidhur me aktivet e identifikuar për nxjerrje jashtë përdorimit. Po ashtu nuk rezulton të ketë gjurmë të pranisë së një dokumentacioni me ndarje të aktiveve gjendje që disponon institucioni, sipas zërave. Me qëllim kjo verifikimin real të gjendjes së tyre, si dhe verifikimin më lehtësisht të diferencave të gjendjes së tyre fizike me të dhënat e regjistruara në kontabilitet sipas zërave.

Grupit të auditimit i është vendosur në dispozicion lista e aseteve dhe vlerave materiale gjendje më 31.12.2022 protokolluar me nr.591/1 datë 23.01.2023.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe i zbatuar.**

Observacion dërguar me shkresën nr.3853/1 prot., datë 06.10.2023 protokolluar me tonën me nr.613/59 prot., datë 09.10.2023

Grupi i komisionit qendror dhe vlerësimit të aktiveve i ngritur nga Titullari i Institucionit të DPPSH të marrë masa në vazhdimësi, për të përpiluar një raport përmbledhës, ku të bëjë një ndarje të aktiveve gjendje që disponon institucioni, sipas zërave duke bashkëngjitur listën e tyre në relacionin, me qëllim verifikimin reale të gjendjes së tyre, si dhe verifikimin më lehtësisht të diferencave të gjendjes së tyre fizike me të dhënat e regjistruara në kontabilitet sipas zërave, kërkojmë të rishikohet mbështetur në dokumentacionin që ndodhet në dosjen e verifikimit të aktiveve për jashtë përdorimit, nga ana e komisionit është hartuar proces verbali i identifikimit të aktiveve për jashtë përdorimit dhe proces verbali i verifikimit të aktiveve të grupuara sipas shërbimit.

Qendrimi i grupit të auditimit

Në kushtet e paraqitjes së dokumentacionit të ri justifikues të situatës, konkretisht shkresë nr.1949 prot., datë 31.05.2023 relacion për realizimin e procesit të vlerësimit të aseteve në Aparatin e DPPSH-së, si dhe shkresa nr.591/10 datë 15.01.2023; nr.591/2 datë 15.01.2023 dhe 591/5 datë 15.01.2023 lista e mallrave të identifikuar për vlerësim, shkresë nr.591/11 prot., datë 15.01.2023 Proces verbal vlerësimi nr.1 datë 09.01.2023 grupi auditimit pranon observacionin.

Sa më sipër observacioni merret në konsideratë.

6.2. Rekomandim: Komisioni i tjetërsimit/nxjerrjes jashtë përdorimi të aseteve të marrë masa të menjëhershme, që aktivet që janë vlerësuar për jashtë përdorimi, të vlerësojnë se ç’pjesë e tyre mund shiten me ankand ndërmarrjeve që i grumbullojnë, ndërsa për asetet e tjera të bëjë asgjësimin duke ndryshuar formën e tyre fillestare, groposur ose djegur.

Në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Komisioni ngritur me urdhërin nr. 591 datë 15.12.2022, ka realizuar procesin e asgjësimit të aktiveve të vlerësuar për nxjerrje jashtë përdorimit, në kopetencë të titullarit të Njesisë shpenzuese, është hartuar dhe relacioni përmbledhës në përfundim të procesit datë 24.06.2023

Komenti i grupit të auditimit.

Referuar dokumentacionit të vendosur në dispozicion rezulton se, me Urdhër nr 591 datë 15,12,2022 është krijuar komisioni i inventarizimit, vlerësimit e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve të Aparatit e DPPSH dhe me shkresën nr.367 prot., datë 24,06,2023 është hartuar relacioni përmbledhës për objektet e asgjësuar.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe i zbatuar.**

7.1. Rekomandim: Drejtoria e Burimeve Njerëzore në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit të marrë masa për plotësimin e dosjeve të personelit me librezat e punës së punonjësve dhe të sigurojë që fletët prezantuese të dosjes të jenë të plotësuara në të gjithë elementët përkatës.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Janë plotësuar dosjet e personelit me librezat e punës dhe janë plotësuar fletët prezantuese të dosjeve të personelit.

Komenti i grupit të auditimit.

Nga verifikimi me përzgjedhje që u krye mbi dosjet e personelit me librezat e punës së punonjësve dhe fletët prezantuese të dosjes u konstatua se ato ishin të plota referuar elementëve të cituar në Rekomandimn e lënë.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe i zbatuar.**

8.1. Rekomandim: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit të marrë masa për nisjen e procedurave ligjore, si ngritja e një komisioni apo zhvillimin e një mbledhjeje, me qëllim shqyrtimin e mundësisë së sistemimit të individëve, të cilët kanë fituar të drejtën e rikthimit në punë me vendim gjyqësor të formës së prerë.

Menjëherë

Përgjigja e institucionit:

Email nr.1

Referuar Ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit” dhe Rregullores së dal në zbatim të tij, janë ngritur Komisionet respektive në qendër dhe strukturat vendore për emërimin apo shqyrtimin e kërkesave për rikthim në zbatim të vendimeve gjyqësore.

Drejtoria Juridike, rast pas rasti verifikon përputhshmërinë e kërkesës së të interesuarit dhe dispozitivit të gjykatës.

Drejtoria Juridike ka përgatitur paraprakisht informacionin e kërkuar dhe realizon pjesëmarrjen në grupin e punës për shqyrtimin e kërkesave.

Jane miratuar aktet administrative të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, si me poshte:

- ✓ Urdhri i Drejtorit të Përgjithshëm të P.Shtetit nr. 1108, datë 20.09.2022 “Për ngritjen dhe funksionimin e këshillit të vlerësimit të propozimeve për emërim”;
- ✓ Urdhri i Drejtorit të Përgjithshëm të P.Shtetit nr. 1148 datë 26.09.2022, “Për ngritjen dhe funksionimin e këshillit të vlerësimit të propozimeve për emërim në strukturat e kufirit e migracionit dhe të vecanta;
- ✓ Procedura standarde për transferimin dhe emërimin e punonjësit të P.Shtetit, miratuar me urdhër nr. 1244 datë 24.10.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të P. Shtetit.

Në bazë dhe në zbatim të akteve administrative të mësipërme janë ngritur dhe funksionojnë Këshillat e vlerësimit të propozimeve për emërim në të gjithë strukturat e Policisë së Shtetit në nivel qendror dhe nivel vendor.

Të gjithë punonjësit e policisë që kanë fituar të drejtën me vendim gjyqësor të formës së prerë për tu rikthyer në punë paraqesin një kërkesë me shkrim së bashku me dokumentacionin përkatës ligjor, përkatësisht pranë strukturës vendore të policisë.

Këshilli i vlerësimit të propozimeve për emërim pasi shqyrton dokumentacionin përkatës dhe vlerëson se ky dokumentacion është në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore merr vendim për ripranim në Policinë e Shtetit të ish punonjësit të policisë dhe nga drejtuesi i strukturës vendore të policisë bëhet propozimi për emërimin në detyrë të ish punonjësit të policisë.

Email nr.2

Ju informoj se, zbatimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë është detyrim ligjor, për t'u zbatuar nga institucioni dhe ngritja e një komisioni enkas për zbatimin e tyre e konsideroj të panevojshëm, pasi ligji është i qartë dhe njëkohësisht institucioni njih detyrimet ligjore dhe i zbaton ato. Strukturat e policisë, në rastin në fjale apo të ngjashëm në zbatim të vendimit gjyqësor të formës së prerë, konkretisht Drejtoria Juridike, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Drejtoria e Financës bashkëveprojnë veprimet për zbatimin e detyrimeve ligjore dhe detyrave funksionale.

Janë percjellë për zbatim nga strukturat përgjegjëse (Dr.Financës, Dr.Bnj) vendimet gjyqësore të formës së prerë, konkretisht të gjyqfituesit: V. Sh.; S.A.dhe T. N.

Drejtoria Juridike percjell për çdo rast në strukturat përgjigjëse vendimet gjyqësore të formës së prerë, të cilat në zbatim të nenit 510 të Kodit Procedurës Civile, janë detyrim ligjor për t'u zbatuar.

Komenti i grupit të auditimit.

Nga ana e DPPSH është vendosur në dispozicionit të grupit të auditimit:

- shkresa përcjellëse për ekzekutim të vendimit gjyqësor nga ana e drejtorisë juridike në drejtorinë e financës dhe burimeve njerëzore për 3 raste konkretisht 304/7 prot., datë 17.05.2023 dhe nr.304/13 prot., datë 20.06.2023 Drejtoria Juridike për Drejtorinë e Financës dhe Burimeve Njerëzore për trajtim të praktikës S. A. , nr.58/9 datë 15.06.2023 dhe nr.58/16 prot., datë 19.07.2023 Tomor Noku, nr.765/4 prot., datë 24.08.2022 V. Sh.;
- Informacion (pa ekstremite) për znj. Vojsava Shllaku sipas së cilit:

Në përgjigje të Rekomandimit 8.1, në të cilin kërkohet që Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit , të marrë masa për nisjen e procedurave ligjore , me qëllim shqyrtimin e mundësisë së sitemimit të individëve, të cilët kanë fituar të drejtën e rikthimit në punë me vendim gjyqësor të formës së prerë, ju bëjmë me dije :

1. Për Znj . V. S.Sh., pas shqyrtimit të dokumentacionit , me qëllim ekzekutimin e vendimit gjyqësor rezulton se me datën e lindjes së drejtës 12.06.2020, ka mbushur moshën për pension pleqërie.

2.Në këto kushte vendimi i gjykatës së Apelit Administrativ, Nr 162 datë 23.05.2022, për të drejtën e rikthimit , në të njëjtin pozicion pune ose në një pozicion pune të të njëjtit nivel, nuk mund të zbatohet pasi Znj. V.S. Sh., trajtohet me pension pleqërie nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, (Dega Rajonale Tiranë), pasi ka mbushur moshën për pension pleqërie.

3.Për pjesen e pagesës së Znj.V. S.Sh., nga momenti i ndërprerjes së marrëdhënieve financiare, deri në rikthimin në detyrë, është rregjistruar në databazen e financave, po nuk është ekzekutuar akoma vendimi për mungesë fondesh (përgjigje më të detajuar për hapjen e fondeve , ju ka kthyer Drejtoria e Financave)

Grupi auditimit referuar përgjigjes së dytë të ardhur me email, si dhe mungesës së gjurmës dokumentare justifikuese lidhur me përgjigjen e parë me email (urdhërat e cituar në përgjigjen e parë dhe shkresat cituar nuk na janë vendosur në dispozicion) sa i takon Rekomandimit se

DPPSH duhet të marrë masa për nisjen e procedurave ligjore, si ngritja e një komisioni apo zhvillimin e një mbledhjeje, me qëllim shqyrtimin e mundësisë së sistemimit të individëve, të cilët kanë fituar të drejtën e rikthimit në punë me vendim gjyqësor të formës së prerë e cilëson pjesërisht të zbatuar. Pasi është vetëm shkresa përcjellëse e Departamentit Juridik dhe nuk ka asnjë gjurmë ndërveprimi nga Departamenti Financës dhe Burimet Njerëzore për 2 nga 3 rastet. Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe i zbatuar**.

9.1. Rekomandim: Njësia e prokurimit të marrë masa ku për çdo rast, hartimi i kritereve për kualifikim dhe specifikimet teknike duhet të argumentohen dhe të dokumentohen në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre, si dhe të nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e njësisë së prokurimit, që i kanë hartuar ato.

Në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Njësia e prokurimit ka argumentuar dhe dokumentuar në proces verbalin përkatës të nënshkruar nga anëtarët e njësisë që kanë hartuar specifikimet teknike dhe kriteret për kualifikim.

Komenti i grupit të auditimit.

Nga verifikimi me përzgjedhje që u krye mbi dosjet e prokurimeve u konstatua se ato ishin të plota referuar elementëve të cituar në Rekomandimn e lënë

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe i zbatuar**.

9.2. Rekomandim: Nga njësia e prokurimit të merren masa të menjëhershme, ku të inventarizohen dhe arkivohet të gjitha dosjet e prokurimeve publike të përfunduara për vitin 2019, 2020 si dhe për procedurat në vijimësi.

Menjëherë

Përgjigja e institucionit:

Spektori Shërbimeve të Apartatit ka argumentuar dhe dokumentuar në regjistrin e evidencës së regjistrave, konkretisht regjistri blerjeve të vogla, marr nga sekretaria dhe vendosur në dispozicion të grupit të auditimit për vitet 2019-2022 të gjitha dosjet e blerjeve të vogla të përfunduara.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe i zbatuar**.

10.1. Rekomandim: Njësia e prokurimit duhet të parashikojë edhe blerje shkresore nga ku për nevojat e rasteve të parashikuara, si procedure prokurimi “blerje shkresore” nën 100,000 lekë, duhet të mbajnë procesverbalin për vërtetimin e situatës emergjente apo domosdoshmërisë së kryerjes së shpenzimit.

Në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Për çdo rast mbahet procesverbalin për vërtetimin e situatës emergjente apo të domosdoshmërisë së kryerjes së shpenzimit.

Komenti i grupit të auditimit.

Nga verifikimi me përzgjedhje që u krye mbi procedurat e emergjencës u konstatua se ato ishin të plota referuar elementëve të cituar në Rekomandimn e lënë

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe i zbatuar**.

11.1. Rekomandim: Komisionet e ngritura për shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave të marrin

masa për vlerësimin me përgjegjësi dhe profesionalizëm të dokumentacionit të ofertuesve të ngarkuara në SEP, duke krahasuar pajtueshmërinë e tyre, sipas kritereve të përcaktuara në DST. me qëllim shmangien e rasteve të konstatuara nga auditimi i KLSH-së.

Në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave për procedurat në vijim, do të shqyrtojë me profesionalizëm dhe përgjegjësi sipas Rregullave të Prokurimit Publik të gjithë dokumentacionin e dorëzuar në SPE nga OE të ndryshëm, në raport me kriteret e veçanta të kualifikimit të miratuara nga Njësia e Prokurimit.

Komenti i grupit të auditimit.

Nga verifikimi me përzgjedhje që u krye mbi shkresat e hartuara nga sektori prokurimeve, (proces verbal, urdhër për ngritje e KVO, raport përmbledhës mbi procedurat respektive të prokurimit,) u konstatua se ato ishin të plota referuar elementëve të cituar në Rekomandimn e lënë

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe i zbatuar.**

12.1. Rekomandim: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, Njësia e Prokurimit në procedurat e prokurimit të mallrave/ shërbimeve dhe punëve që do të zhvillohen në vazhdimësi, të marrë masa që çdo kriter i veçantë duhet të jetë në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës. Vendorsja e çdo kriteri duhet të jetë e argumentuar dhe e dokumentuar.

Në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Sektori i Prokurimeve për procedurat në vijim do të dokumentojë argumentimin e kritereve të veçanta të kualifikimit nga specialisti i fushës në njësinë e prokurimit dhe të miratuara nga kjo e fundit.

Komenti i grupit të auditimit.

Nga verifikimi me përzgjedhje që u krye mbi proces verbalet e prokurimeve vendosur në dispozicion, u konstatua se, ato ishin të plota referuar elementëve të cituar në Rekomandimn e lënë

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe i zbatuar.**

13.1. Rekomandim: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, Njësia e Prokurimit në procedurat e prokurimit të punimeve që do të zhvillohen në vazhdimësi, të marrë masa që çdo kriter të veçantë të kërkuar në DST në lidhje me stafin, licencat, certifikatat që operatorët ekonomikë ofertues duhet të disponojnë, duhet të mbajnë në konsideratë faktin që këto kërkesa të përkojnë me tipologjinë e objektit të kontratës që prokurohet.

Në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Sektori i Prokurimeve për cdo procedurë dhe ato në vijimësi, dokumenton dhe do të dokumentojë, argumentimin e kritereve të veçanta të kualifikimit nga specialisti i fushës në njësinë e prokurimit si dhe do të ndjek procedurat e nënshkrimit nga të gjithë anëtarët e njësisë. Kërkesat e veçanta të kualifikimit, licencat, stafi etj., të jenë në proporcion dhe sipas tipologjisë së objektit të prokurimit.

Komenti i grupit të auditimit.

Nga verifikimi me përzgjedhje që u krye mbi proces verbalet e prokurimeve vendosur në dispozicion, u konstatua se, ato ishin të plota referuar elementëve të cituar në Rekomandimn e lënë

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe i zbatuar.**

14.1. Rekomandim: Nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit në rolin e AK të marra masa për ndjekjen e të gjitha procedurave të nevojshme për aplikimin dhe pajisjen me leje zhvillimore dhe leje ndërtimi në rastet e investimeve, në të cilat janë të përfshira punime ndërtimi.

Në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Ka përfunduar procedura për pajisjen me leje ndërtimi për DVP Elbasan., Vendimi Këshillit Kombëtar të Teritorit nr.18, datë 27.07.2022 “Për miratimin e lejes së ndërtimit për objektin Drejtoria Vendore e Policisë Elbasan”, me vendodhje në Bashkinë Elbasan”.

Aplikimi për KP Sarandë: Nr. i aplikimit: AN050920220029, Data e aplikimit: 05/09/2022, Ora:14.27

Lloji i kërkesës: Leje ndërtimi për shtesë në ndërtim ekzistues, me sipërfaqe më të madhe se 250 m2, për KKT

Vendimi Këshillit Kombëtar të Teritorit nr.38, date 14.12.2022 “Për miratimin e lejes së ndërtimit për objektin “Ndërtimi Institutit të Policisë Shkencore”, me vendodhje në Bashkinë Tiranë”.

Komenti i grupit të auditimit.

Referuar dokumentacionit të vendur në dispozicion grupit të auditimit u konstatua prania e, shkresës nr.4121/2 prot., datë 28.12.2022 ku dërgohet Vendimi Këshillit Kombëtar të Teritorit nr.18, datë 27.07.2022 “Për miratimin e lejes së ndërtimit për objektin Drejtoria Vendore e Policisë Elbasan”, me vendodhje në Bashkinë Elbasan, shkresa nr. 3036 prot., datë 07.07.2023 për përcjelljen e vendimit miratuar nga KKT, shkresa nr.6792 prot., datë 27.10.2020 Autorizim për z. R. P. për të përfaqësuar pranë Agjencisë së Zhvillimit të Territorit për objektin “Rikonstruksion i Godinës së DVP Dibër”, shkresa nr.8346 prot., datë 19.11.2021 Autorizim për z. R. P. për të përfaqësuar pranë Agjencisë së Zhvillimit të Territorit për objektin “Godinat e Drejtorisë dhe Komisionariatit të Policisë Elbasan”, shkresa nr.8345 prot., datë 19.11.2021 Autorizim për z. R.P. për të përfaqësuar pranë Agjencisë së Zhvillimit të Territorit për objektin “Godinat e Komisionariatit të Policisë Sarandë”, shkresa nr.4490 prot., datë 13.06.2022 Autorizim për z. D. H. për të përfaqësuar pranë Agjencisë së Zhvillimit të Territorit për objektin “Institut i Policisë Shkencore”.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe i zbatuar.**

15.1. Rekomandim: DPPSH, në cilësinë e Autoritetit Kontraktor, të marrë masat e menjëhershme për kthimin mbrapsht të pajisjes tek OE, si dhe mbajtjen e garancisë së kontratës në vlerën prej 176,400 lekë ndaj OE, si rezultat i mos përmbushjes së detyrimeve kontraktuale nga ana e tij.

Menjëherë

Përgjigjja e institucionit:

Me Urdhrin nr. 150, datë 10.12.2021, të Shefit të QFMT, “Për ngritjen e Komisionit të Rivlerësimit të pajisjes së prodhimit të vulave zyrtare”, u ngrit komisioni për rivlerësimin cilësor të mallit në zbatim të kontratës nr. 17/6 datë 25.03.2021 me objekt “Blerje e pajisjes së prodhimit të vulave zyrtare për zgjedhjet parlamentare të datës 25 Prill 2021”, i cili me procesverbalin nr. 25/3 prot., datë 16.12.2021 konkludoi se: “Pajisja e lëvruar nuk ishte në

përputhje me kontratën dhe konform kodeve dhe standardeve të parashikuara në specifikimet teknike dhe propozoi që pajisja të kthehej në OE të lëvruesit”.

- Me shkresën nr. 1403 prot., datë 22.12.2021 QFMT ka njoftuar operatorin ekonomik “L.-M.I” për tërheqjen e pajisjes.

- Me shkresat nr. 1420 prot., datë 24.12.2021 dhe nr. 218 prot., datë 24.02.2022 QFMT i është drejtuar kompanisë së sigurimit “S.” sh.a për konfiskimin e sigurimit të kontratës.

- Me shkresën nr. 34/19 prot., datë 14.04.2022, Departamenti i Shërbimeve Mbështetëse, në DPPSH, ka vënë në dispozicion të Agjencisë së Prokurimit Publik dokumentat e dosjes së prokurimit lidhur me procedurën.

- Nga ana e operatorit ekonomik “L.-M.” sh.p.k., rezulton të jetë depozituar kërkesë-padi pranë gjykatës kompetente më datë 21.02.2022, administruar nga ana e DPPSH me nr. 476/1 prot., datë 07.04.2022, e cila i është përcjellë APP me shkresën nr. 476/4 prot., datë 16.05.2022.

Komenti i grupit të auditimit.

Referuar dokumentacionit justifikues vendosur në dispozicion nga ana e institucionit, konkretisht

- shkresa nr. 1420 prot., datë 24.12.2021 dhe shkresa nr. 218 prot., datë 24.02.2022 QFMT drejtuar kompanisë së sigurimit “SIGAL” sh.a për konfiskimin e sigurimit të kontratës,
- proces verbali nr.25/3 datë 16.12.2021 për ngritjen e Komisionit të Rivlerësimit të pajisjes së prodhimit të vulave zyrtare,
- model faturë për arkëtim më datë 24.12.2021 dhe 24.02.2022

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe në proces zbatimi.**

16.1. Rekomandim: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë të marrë masat në vazhdimësi, që mallrat/ shërbimet të merren në dorëzim nga OE, pas verifikimit fizik të sasisë, cilësisë dhe çmimit, referuar kushteve të përcaktuara në kontratë.

Në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Në të gjitha rastet grupet e punës të ngarkuara me kryerjen e procedurave për marrjen në administrim të mallrave, kanë kryer verifikimin e treguesve sasiorë e cilësorë sipas kushteve të përcaktuara në kontratë.

Komenti i grupit të auditimit.

Nga verifikimi me përzgjedhje që u krye mbi praktikën e tre blerjeve, (konkretisht Blerje kompjutera, Blerje materiale për sistemin Datacom, Blerje platforma Mail Antispam), u konstatua se, ato përmbanin veç të tjerave relacionin pas përfundimit të vlerësimit sasior dhe cilësor realizuar në zbatim të urdhrave respektiv. Detajuar

- Procedura Blerje Kompjutera, relacioni me nr.24-R1 datë 16.06.2022 në përfundim të vlerësimit sasior dhe cilësor realizuar në zbatim të urdhrimit nr.35 datë 13.05.2022 të Shefit të QFMT.
- Procedura Blerje materiale për sistemin Datacom, relacioni me nr.25/14-R1 datë 20.09.2022 në përfundim të vlerësimit sasior dhe cilësor realizuar në zbatim të urdhrimit nr.67 datë 02.09.2022 të Shefit të QFMT.
- Procedura Platforma Mail Antispam, relacioni me nr.12/9-R1 datë 14.04.2023 në përfundim të vlerësimit sasior dhe cilësor realizuar në zbatim të urdhrimit nr.34 datë 05.04.2023 të Shefit të QFMT.

ato ishin të plota referuar elementëve të cituar në Rekomandimn e lënë.
Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe i zbatuar**.

17.1. Rekomandim: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, Drejtoria e Mbështetjes dhe Logjistikës të marrë masa në vazhdimësi, që para hartimit të nevojave për mallra/ shërbime të koordinojnë me të gjithë strukturat përkatëse, me qëllim që sasia e mallrave/ shërbimeve që do të prokurohen të përmbushë nevojat e institucionit.

- Titullari i AK, mbi bazën e problematikave të evidentuara nga auditimi i KLSH-së, të vlerësojë përgjegjësitë e hartuesve të nevojave për shërbime dhe grupeve të monitorimit dhe pastaj në varësi të këtij vlerësimi të marrë masa ndaj tyre.

Menjëherë

Përgjigjja e institucionit:

Janë marrë masa të menjëhershme për hartimin e nevojave për mallra/ shërbime, duke koordinuar kërkesat me të gjithë strukturat në DPPSH, për përmbushjen e nevojave të institucionit. Nga strukturat përkatëse në DPPSH do të vlerësohen përgjegjësitë individuale të punonjësve, sipas Rekomandimit.

Do të ndiqen të gjitha procedurat, në zbatim të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Drejtoria Juridike (Komisioni Disiplinor), në bashkëpunim me Drejtorinë e Standardeve dhe Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, ka ndjekur dhe do të ndjekë cdo praktikë të përcjellë nga strukturat, në zbatim të Ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar.

Komenti i grupit të auditimit.

Grupi auditimit në mungesë të një gjurme dokumentare të verifikimit të statusit të Rekomandimit nuk arrin të marr siguri të arsyeshme për tu shprehur mbi zbatueshmërinë e tij. Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe i pazbatuar**.

Observacion dërguar me shkresën nr.3853/1 prot., datë 06.10.2023 protokolluar me tonën me nr.613/59 prot., datë 09.10.2023

DPP, Drejtoria e Mbështetjes Logjistike, në planifikimin e nevojave për mallra, shërbime e investime përveç akteve të tjera bazohet edhe në Procedurat Standarte të Punës, miratuar me Urdhër të DPPSH nr.1277 datë 11.11.2019, “Për miratimin e Procedurat Standarte të Punës në shërbimet mbështetëse”, ku në kreun e III. Proceset për realizimin e shërbimeve ekonomike, dokumentatimi dhe menaxhimi, pika G. Llojet e procesve dhe dokumentimi i tyre janë përcaktuar të gjitha hapat që kryhen dhe dokumentat që hartohen në planifikimin e mallrave dhe shërbimeve dhe investimeve.

1. Procesi i identifikimit të nevojave dhe hartimit të projektplaneve për shpenzime, për mallra, shërbime e investime.
2. Procesi i unifikimit të kërkesave
3. Procesi i detajimit të buxhetit për mallra, shërbime e investime.
4. Procesi i prokurimit

Gjithashtu detajimi i buxhetit për mallra, shërbime e investime i nënshtrohet procedurave të përcaktuara në Procedurat Standarte për hartimin e PBA dhe PS për zbatimin e buxhetit të miratuara nga MFE. Në këtë kuadër në DPPSH janë ngritur grupet e punës, konkretisht:

- Urdhër nr.1231 datë 14.12.2021 “ Për detajimin e buxhetit për programin Policia e Shtetit për vitin 2022”;
- Urdhër nr.1463 datë 19.12.2022 “ Për detajimin e buxhetit për programin Policia e Shtetit për vitin 2023”;

Çdo strukturë policore me urdhër të titullarit ngre grupe pune për hartimin e nevojave për

mallra dhe shërbime dhe detajimin e buxhetit të akorduar për vitin ushtrimor dhe hartohet plani i nevojave për mallra dhe shërbime, të cilat dërgohen në Drejtorinë e Mbështetjes Logjistike ku dhe hartohet përmbledhsja për Policinë e Shtetit.

Në grupet e punës përfshihen të gjithë drejtuesi përgjegjës për strukturat përfituese për hartimin e nevojave për mallra e shërbime.

Me urdhët të titullarit AK, ngrihen grupet e punës për llogaritjen e sasisë, hartimin e specifikimeve teknike dhe përlllogaritjen e fondit limit për mallra dhe shërbime që do të proturohen për vitin ushtrimor,

- Urdhër nr.03 datë 27.01.2022 “Për krijimin e grupeve të punës, për hartimin e specifikimeve teknike, përlllogaritjen e fondit limit për mallra sge shërbimee, dhe investime që janë planifikuar të prokurohen të përqëndruara me buxhetin e vitit 2022”,

- Urdhër nr. 04, datë 23.01.2023 “Për krijimin e grupeve të punës, për hartimin e specifikimeve teknike, përlllogaritjen e fondit limit për mallra sge shërbimee, dhe investime që janë planifikuar të prokurohen të përqëndruara me buxhetin e vitit 2023”.

Grupet e punës janë në përbërje nga të gjitha strukturat përfituese të mallrave dhe shërbimeve që do të prokurohen sipas nevojave dhe kërkesave të bëra nga këto struktura dhe janë përgjegjës për përcaktimin e sasisë, hartimin e specifikimeve teknike dhe fondit limit për çdo praktikë.

Praktikat dhe dokumentacioni që përgatiten nga grupet e punës dhe dërgohen të argumentuar për prokurime si më poshtë:

- Kërkesa për mallra / shërbimet që kërkojnë të blejnë, i shoqëruar me specifikimet teknike termat e referencës dhe çmimet përkatëse të testuara në treg;

- Relacion të hollësishëm për nevojën, qëllimin dhe funksionin e përdorimit të çdo malli / shërbimi që kërkohet të blihet duke e shoqëruar me një analizë kosto përfitim dhe impaktin që do të ketë lkjo pajisje në realizimin e politikave, objektivave dhe programit të strukturës përkatëse.

Qëndrimi i grupit të auditimit

Sjellim në vëmendjen Tuaj se,

Së pari Rekomandim i lënë nga grupi i auditimit ka dy momente, i pari i referohet DPPSH, DML që para hartimit të nevojave për mallra/ shërbime të koordinojnë me të gjithë strukturat përkatëse, me qëllim që sasia e mallrave/ shërbimeve që do të prokurohen të përmbushë nevojat e institucionit; dhe i dyti që titullari i AK, mbi bazën e problematikave të evidentuara nga auditimi i KLSH-së, të vlerësojë përgjegjësitë e hartuesve të nevojave për shërbime dhe grupeve të monitorimit dhe pastaj në varësi të këtij vlerësimi të marrë masa ndaj tyre.

Me observacionin e sjell nga ana juaj, nga njëra anë specifikohen të dhënat narrative sikundër Procedurave Standarte të Punës dhe nga ana tjetër cituhet Urdhëra të cilat mungojnë të paraqitura bashkangjitur.

Në kushtet e mos paraqitjes së dokumentacionit të ri justifikues të situatës grupi auditimit nuk e pranon observacionin.

Sa më sipër observacioni nuk merret në konsideratë.

18.1. Rekomandim: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit të marrë masa për planifikimin dhe miratimin e trajnimeve për punonjësit, në lidhje me komponentët e MFK-së dhe veçanërisht për menaxhimin e riskut.

- Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit të marrë masa hartimin dhe miratimin e dokumentit institucional të gjurmës së auditimit.

Menjëherë

Përgjigja e institucionit:

Email 1.

Me shkresën tonë nr. 1497, datë 14.02.2023 “Kërkesë për zhvillimin e një trajnimi”, DPPSH i është drejtuar Departamentit të Administratës Publike, për zhvillimin e trajnimit të punonjësve, mbi komponentët e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit. Në vijim nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike, me shkresën nr.201, datë 07.03.2023 ka ardhur përgjigje mbi gatishmërinë e tyre për zhvillimin e trajnimit.

Në komunikimet me ASPA, nga DPPSH është kërkuar që trajnimi të mos organizohet online.

Email 2.

Referuar përgjigjes së dytë të ardhur me email, rezulton se prej institucionit specifikohet se ky trajnim do të zhvillohet fizikisht në muajin shtator 2023,

Komenti i grupit të auditimit.

Grupi auditimit referuar komunikimit nëpërmjet postës elektronike (email datë 19.07.2023 ora 11e34) si dhe diskutimeve verbale me përfaqësues të drejtorisë lidhur me trajnimet, referuar edhe korrespondencës së mbajtur me Shkolla Shqiptare e Administratës Publike e konsideron në proces këtë rekomanim. Pasi ende nuk është finalizuar outputi vendosur në gjetje/rekomanimin e grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe në proces zbatimi.**

C.1. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1.1. Rekomandim: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës 1,458,726 lekë pa TVSH ndaj sipërmarrësit BOE “J.” SHPK & “P.” SHPK & “P. GROUP” SHPK, këto të likuiduara në kontratën e sipërmarrjes së punimeve, të lidhur sipas aktit me nr.4/4 prot datë 10.10.2018, e ndryshuar me objekt “Ndërtim i objekteve të Drejtorisë Vendore të Policisë Shkodër”.

Menjëherë

Përgjigja e institucionit:

Shkresa e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë nr. 583/6, datë 14.04.2022 Njoftim për zbatim vullnetar të Rekomandimit të lënë nga KLSH sipas raportit përfundimtar nr.1020/8, datë 8.3.2022”, drejtuar BOE “J.” shpk ;...

Përgjigja e “J. shpk shkresa nr. 36/1 prot., datë 20.04.2022 “Përgjigje shkresës Tuaj nr.583/6 prot., datë 14.04.2022” ku shprehet “ne shprehim dakortësinë tonë për ekzekutimin vullnetar të kësaj vlere. Vlera mund të zbritet nga detyrimet e vlerës së garancisë së mbajtur nga DPPSH si garanci e punimeve të kryera “.

Urdhëri Drejtorit të Drejtorisë së Policisë Shkodër nr.1044, datë 08.11.2022 “Për likuidimin e garancisë së punimeve të depozituar në Degën e Thesarit Shkodër, nga Firma “J.” Shpk Lezhë”.

Fatura për arkëtim nr.15, datë 09.11.2022

Urdhër Shpenzimi nr.294, datë 09.11.2022

Komenti i grupit të auditimit.

Referuar dokumentacionit të vendosur në dispozicion nga ana e institucionit u konstatua prania e

- shkresës nr.583/6 prot., datë 14.04.2022” të DPPSH ku shprehet “..ne shprehim dakortësinë tonë për ekzekutimin vullnetar të kësaj vlere. Vlera mund të zbritet nga

detyrimet e vlerës së garancisë së mbajtur nga DPPSH si garanci e punimeve të kryera“.

- Shkresës nr.36/1, datë 20.04.2022 drejtuar DPPSH nga firma “J.” Shpk Lezhë”,ku shprehet dakortësia në ekzekutim vullnetar,
- Shkresa nr. 4377 prot., datë 02.11.2022 drejtuar Drejtorisë Vendore të Policisë Shkodër
- Urdhër i Brendshëm nr.1044 datë 08.11.2022 i DVP Shkodër,
- Procesverbal i marrjes së pajisjeve në dorëzim
- Fletë hyrje nr.2 datë 13.01.2022
- Fletë hyrje nr.1 datë 06.01.2022
- Faturë për arkëtim nr.15 datë 09.11.2022
- Urdhër shpenyim nr.294 datë 09.11.2022

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe i zbatuar.**

MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN DHE MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1.1. Rekomandim: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, për projektet e zbatimit që janë në proces dhe ato në të ardhmen, të kërkojë nga ana e supervisorëve përdorimin e fondeve me ekonomikitet, eficientë dhe efektivitet, duke propozuar zgjidhje teknike për realizimin e punimeve më pak të kushtueshme.

Në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Është dërguar shkresa nr.591/6, datë 23.05.2022 për supervisorin “Mbi kërkesën për miratimin e ndryshimit të volumeve në projektin “Rikonstruksioni/ndërtimi objekteve të DVP Dibër”

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe i zbatuar.**

D. MASA ADMINISTRATIVE

Referuar parregullsive dhe shkeljeve të konstatuara në zbatimin e kontratës nr.17/6, datë 25.03.2021 “Blerje e pajisjes së prodhimit të vulave zyrtare për zgjedhjet parlamentare të datës 25 Prill 2021”, të pasqyruar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, bazuar në nenin 23 dhe 78 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe bazuar në nenin 15 shkronjat (c dhe ç) dhe nenin 30 të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014, “Për Organizim in dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, i rekomandojmë Agjencisë së Prokurimit Publik, të vlerësojë shkeljen e konstatuar, me qëllim marrjen e masave për përjashtimin për një periudhë të caktuar të OE nga Agjencia e Prokurimit Publik, sipas përcaktimeve të Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, nenin 78, “Përjashtimi për një periudhë të caktuar nga Agjencia e Prokurimit Publik” pika 1, gërma “b”.

Përgjigja e institucionit:

Lidhur me zbatimin e Rekomandimt “D” Masa Administrative”, ju sqarojmë se zbatimi i këtij “Rekomandim” i adresohet Agjencisë së Prokurimit Publik.

Komenti i grupit të auditimit.

Grupi auditimit në mungesë të një përgjigje dhënë nga ana e institucionit në plan veprimi/masash për zbatimin e rekomandimeve (shkresa 20 ditore), u konsultua me dokumentacionin justifikues konkretisht,

- Shkresë nr.1779/5 prot., datë 01.06.2022 dërguar nga APP drejtuar DPPSH për dijeni KLSH nëpërmjet së cilës kërkohet informacion/dokumentacion për çështjen,
- Me shkresën nr.476/4 prot., datë 16.05.2022 DPPSH kthen përgjigje APP specifikisht kërkesë padinë me nr.476/1 datë 07.04.2022 depozituar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë (praktika nuk është bashkangjitur)
- Shkresën nr.1779/3 prot., datë 28.04.2022 dërguar nga APP drejtuar DPPSH për dijeni KLSH nëpërmjet së cilës kërkohet kërkesë padia për çështjen
- Me shkresën nr.34/19 prot., datë 14.04.2022 DPPSH kthen përgjigje APP me sqarim të situatës (specifikisht 34 shkresa cituar, të cilat nuk na janë bashkangjitur)
- Shkresë nr.1779/1 prot., datë 31.03.2022 dërguar nga APP drejtuar DPPSH për dijeni KLSH nëpërmjet së cilës kërkohet plotësim me informacion për çështjen,
- Shkresa nr. 1403 prot., datë 22.12.2021 njoftim për tërheqje malli drejtuar OE
- Fletë dalje nr.1/proviyore datë 24.12.2021

Referuar sa më sipër si dhe diskutimeve me përfaqësues të DPPSH, korrespondencës me email nga ana e institucionit specifikohet se ky rekomandim nuk është për DPPSH por për APP, megjithatë si palë e prekur drejtëpërdrejt DPPSH ka mbajtur korrespondencë të vazhdueshme me Agjencinë e Prokurimit Publik.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe në proces zbatimi.**

MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenet 58 dhe 59, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, **i rekomandohet** Titullarit të institucionit, që nëpërmjet një grupi pune, të bëjë vlerësimin dhe shqyrtimin e shkeljeve të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit sipas përgjegjësisë individuale dhe të nisë procedurat për dhënien e masave disiplinore përkatëse.

Menjëherë

Përgjigja e institucionit:

Drejtoria Juridike (Komisioni Disiplinor) ndjek të gjitha procedurat në zbatim të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” të ndryshuar, pas vlerësimit dhe përcjelljes së praktikave nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Drejtoria e Standardeve si dhe nga Sektori i Auditimit të DPPSH, në zbatim të rekomandimeve të dala nga raportet audituese

Komenti i grupit të auditimit.

Referuar përgjigjes së dhënë nga ana e institucionit sa i takon Rekomandim të lënë, sipas së cilit Titullari institucionit, nëpërmjet një grupi pune, të bëjë vlerësimin dhe shqyrtimin e shkeljeve të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit sipas përgjegjësisë individuale dhe të nisë procedurat për dhënien e masave disiplinore përkatëse, si dhe mungesës së gjurmës së auditit lidhur me zbatueshmërinë e tij, rezulton se ky proces nuk është kryer në DPPSH

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe i pazbatuar.**

Shënim: Referuar planit të veprimit dërguar më shkresën nr.583/2 datë 30.03.2022 “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH” personat e ngarkuar me trajtimin e rekomandimeve janë si vijon znj. Sh. L. në cilësinë e Drejtor i Financave të DPPSH-së; znj. E. P. në cilësinë e Drejtor Juridik; z. Z. L. në cilësinë e Drejtor i Burimeve Njerëzore; z. J. Xh. në cilësinë Drejtor i Mbeshtetjes Logjistike; z. B. C. në cilësinë e Drejtor i Standarteve Profesionale; znj. M.M. në cilësinë e Përgjigjes i Sektorit Ekonomik për Aparatin e DPPSH-së, z.K. H. në cilësinë Përgjigjes i Financave për Aparatin e DPPSH-së dhe z. K. K. në cilësinë e Përgjigjes i Sektorit të Prokurimeve.

KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit për Raportin Përfundimtar të Auditimit “Për auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” dërguar me shkresën nr.1020/1 prot., datë 04.10.2021, i ndryshuar, rezulton se subjekti i audituar ka respektuar afatin 20 ditor për hartimin e planit të masave për zbatimin e rekomandimeve në përputhje me kërkesat e nenit 15 shkronja (j) të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, por nuk ka njoftuar brenda 6 muajve mbi ecurinë e zbatimit të këtyre masave, në kundërshtim me kërkesat e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Konkretisht ecuria e zbatimit të rekomandimeve paraqitet sipas tabelës “Ecuria e zbatimit të rekomandimeve”

lekë

Rekomandime	Gjithsej		Pranuar		Zbatuar plotësisht		Pjesërisht		Në proces		Pa zbatuar	
	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë
Organizative	21	-	21	-	15	-	-	-	3	-	3	-
Shpërblim dëmi	1	1,458,726	1	1,458,726	1	1,458,726	-	-	-	-	-	-
Eliminim Efekteve Negative	1	-	1	-	1	-	-	-	-	-	-	-
Administrative	1	-	1	-	-	-	-	-	1	-	-	-
Disiplinore	1	-	1	-	-	-	-	-	-	-	1	-
Gjithsej	25	1,458,726	25	1,458,726	17	1,458,726	-	-	4	-	4	-

Sa sipër rezulton se janë dhënë gjithsej 25 rekomandime të cilët janë pranuar plotësisht (100 %), dhe rezultojnë të zbatuar plotësisht 17 masa (68 %).

Për të gjitha rekomandimet që konsiderohen në proces zbatimi, inkurajohet përshpejtimi i realizimit të plotë të tyre.

Për sa më sipër ri kërkojmë që Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit të marrë të gjitha masat e nevojshme me qëllim zbatimin e të gjitha rekomandimeve që rezultojnë të pazbatuara brenda 3-mujorit të parë të vitit 2024. Si dhe kërkojmë marrjen e masave disiplinore për zyrtarët përgjegjës, në lidhje me rekomandimet e KLSH të pranuar prej institucionit dhe që efektivisht rezultojnë të pa zbatuara.

3.11 FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT

PËRMBLEDHJE

Në zbatim të Programit të Auditimit nr. 613/21 prot., datë 06.07.2023 “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e evaduar në 6-mujorin e dytë të vitit 2022”, në ambientet e Fondit Shqiptar të Zhvillimit, më datë 25.07.2023 u mbajt akt-verifikimi nga audituesit e autorizuar të KLSH-së z. J.K dhe z. S.K, me përfaqësues nga subjekti z. D. A. në cilësinë e Titullarit të institucionit dhe znj. S. K. e autorizuar për trajtimin e rekomandimeve të KLSH-së.

Objekt i këtij akt verifikimi është:

Verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të KLSH të lëna me shkresën nr. 1419/20 prot., datë 05.10.2022 për Raportin Përfundimtar të Auditimit “Për auditimin financiar dhe përputhshmëri” të ushtruar në Fondin Shqiptar të Zhvillimit, sipas programit të auditimit nr. 1419/1 prot., datë, 17.01.2022, i ndryshuar, në lidhje mbi statusin e zbatimit të rekomandimeve, afateve dhe niveli i zbatueshmërisë së tyre, koherencën e tyre si dhe përgjegjshmërinë menaxheriale referuar standardeve të auditimit.

Auditimi u krye nga:

1. J.K

2. S.K

Auditimi ka filluar më datë 07.07.2023

Auditimi ka përfunduar më datë 25.07.2023

Auditimi është kryer në bazë të Programit të Auditimit të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit nr.613/21 prot., datë 06.07.2023 me objekt: “Mbi verifikimin e zbatimit të rekomandimeve”, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” si dhe në zbatim të Rregullores së Procedurave të Auditimit dhe të Manualit për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të auditimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe Regjistrit elektronik institucional, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 67, datë 13.06.2020.

TRAJTIMI I ÇËSHTJEVE TË AUDITIMIT

Nga auditimi i ushtruar në Fondin Shqiptar të Zhvillimit, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, “*Mbi auditimin financiar dhe të përputhshmërisë*” për periudhën e veprimtarisë nga data 01.08.2019 deri në 31.12.2021 trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin nr.191, datë 05.10.2022, të Kryetarit të KLSH-së të cilat janë përcjellë me shkresën nr. 1419/20 prot., datë 05.10.2022 rezulton se:

I. Hartimi i programit (Plan veprimit) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në nenin 15 shkronja (j) të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”.

Nga auditimi u konstatua se, Fondi Shqiptar i Zhvillimit ka *miratuar planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH*, duke e dërguar në KLSH me shkresën nr. 5/86 datë 26.10.2022, kjo në përputhje me ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” nenit 15, shkronja j.

Sa më sipër rezulton se është zbatuar afati 20 ditor për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve.

II. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Në lidhje mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve dhe afatet e përcaktuara, sipas strukturave përgjegjëse Fondi Shqiptar i Zhvillimit ka *përgatitur planin e masave të marra lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të miratuara nga titullari brenda afatit 6 muajsh*, duke e dërguar në KLSH me shkresën nr. 1308 datë 06.04.2023, kjo në përputhje me ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” nenit 30.

Sa më sipër rezulton se është zbatuar afati 6 muajsh për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve.

III. Realizimi i rekomandimeve

Nga ana e KLSH-së, me shkresat përcjellëse janë lënë 42 masa organizative, 18 masa për shpërblim dëmi, 6 masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet të fondeve publike, 9 masa administrative, 1 masë disiplinore.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

- a) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 42 Masa organizative nga ku 42 rekomandime, nuk janë pranuar 35, janë pranuar plotësisht 7, të cilat kanë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon, 3 në proces, 4 Zbatuar.
- b) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 18 Masa shpërblim dëmi në vlerën 23,729,475 lekë nga ku 21 rekomandime, nga të cilat nuk janë pranuar 2 në vlerën 12,744,278 lekë, janë pranuar plotësisht 19 të cilat kanë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon, 19 Zbatuar. Nga subjekti është arkëtuar vlera 2,452,000 lekë e rekomandimeve të pranuar.
- c) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 6 Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficence dhe efektivitet të fondeve publike në vlerën 303,365,996 lekë nga ku 12 rekomandime, të cilat janë papranuar.
- d) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 9 Masa administrative, të përmbledhura në 1 rekomandim, i cili rezultoi i papranuar.
- e) Për përmirësimin e gjendjes është lënë 1 Masë Disiplinore, e cila rezultoi e papranuar.

Më hollësisht, auditimi i ndjekjes së rekomandimeve në Fondin Shqiptar të Zhvillimit paraqitet si vijon:

MASA ORGANIZATIVE

1.1. Rekomandim: Për të siguruar paraqitjen sa më mirë të lidhjes midis realizimit të objektivave të politikës së programit me realizimin e treguesve të performancës, si në udhëzimin e mësipërm është e rëndësishme edhe plotësimi i komenteve për secilin tregues për të evidentuar si arrijtjet edhe problematikat. Këto rakordime duhet të mundësojnë kryerjen e monitorimit të performancës financiare të objektivave të politikës së programit të synuar dhe produkteve të parashikuara në buxhetin vjetor.

Pjesë e raportit të monitorimit duhet të jenë edhe shpenzimet e realizuara nga të ardhurat jashtë limitit, si edhe treguesit e performancës së realizimit të tyre.

- Nga struktura drejtuese dhe menaxhuese e këtij institucioni, të hartohen raporte monitorimi për të dy aktivitetet (si për fondet buxhetore dhe për fondet nga të tretët), në përputhje me përcaktimet e bëra në Udhëzimin nr.22, datë 17.11.2016 “*Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e Qeverisjes Qendrore*”, me qëllim përmirësimin e performancës së përdorimit të këtyre fondeve, ruajtjen dhe administrimin e tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Sipas shkresës së dërguar në KLSH, nr 5/86 prot., datë 26.10.2022, rikonfirmuar me shkresën nr. 1308 prot., datë 06.04.2023, ky rekomandim është i pazbatueshëm sepse nuk qëndron.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i papranuar**.

2.1. Rekomandim: Nga ana e institucionit dhe personave përgjegjës të merren masa, për të kryer planifikimin e buxhetit të pritshëm për t’u akorduar nëpërmjet një analize konsoliduese të mirë strukturuar të situatës faktike dhe nevojave të departamenteve.

- Nga ana e institucionit të merren masa për të dokumentuar procesin e kryerjes së planifikimit të buxhetit në përputhje me pikën 2 të nenit 16, ...“Detyrimi për përgatitjen dhe dokumentimin e gjurmës së auditimit”, të Ligjit nr.10296 datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”.

FSHZH të koordinoj veprimtarinë me institucionet e tjera që të shmangen problematikat e krijuara nga ri/alokimet e fondeve. Pavarësisht se alokimet e fondeve të kryera në vijimësi nuk janë përgjegjësi e vendimmarrjes së FSHZH-së, risku që vjen nga këto ri/alokime për mospërdorim të plotë apo në kohë të tyre ekziston dhe kjo mbetet një sfidë për FSHZH.

- Të merren masa që çdo ndryshim (transferim) i fondeve të kryhet duke pasur një analizë të detajuar argumentuese të situatës apo arsyeve që çojnë në këtë vendim-marrje.

- Nga ana e institucionit të merren masa për të plotësuar dosjen e buxhetit me të gjithë elementët përbërës të saj.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Sipas shkresës së dërguar në KLSH, nr 5/86 prot., datë 26.10.2022, rikonfirmuar me shkresën nr. 1308 prot., datë 06.04.2023, ky rekomandim është i pazbatueshëm sepse nuk qëndron.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i papranuar**.

3.1. Rekomandim: Nga ana e drejtorive respektive të projekteve e më tej nga Drejtoria e Menaxhimit të Projekteve të merren masa, për të kryer planifikimin e nevojave nëpërmjet një analize konsoliduese të mirëstrukturuar të situatës faktike.

Në vijimësi

Përgjigjja e institucionit: Sipas shkresës së dërguar në KLSH, nr 5/86 prot., datë 26.10.2022, rikonfirmuar me shkresën nr. 1308 prot., datë 06.04.2023, ky rekomandim është i pazbatueshëm sepse nuk qëndron.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i papranuar**.

4.1. Rekomandim: Nga ana e institucionit dhe drejtorive përgjegjëse të merren masa për të dokumentuar procesin e buxhetimit në përputhje me pikën 2, të nenit 16, ...“Detyrimi për përgatitjen dhe dokumentimin e gjurmës së auditimit”, të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, si dhe të merren masa të kryhet një planifikim real, i bazuar në nevoja dhe fakte duke shmangur praktikën e çeljes dhe pas zerimit të programeve.

- Të kryhet një analizë kosto/përfitim e detajuar dhe një analizë impakti e veprimeve që mund të vijnë nga zerimi i këtyre programeve.

Në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Sipas shkresës së dërguar në KLSH, nr 5/86 prot., datë 26.10.2022, rikonfirmuar me shkresën nr. 1308 prot., datë 06.04.2023, ky rekomandim është i pazbatueshëm sepse nuk qëndron.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i papranuar**.

5.1. Rekomandim: Nga ana e institucionit të merren masa të kryhet koordinim i veprimtarisë ndërinstucionale duke shmangur efektet negative të shkaktuara nga mos përmbushja në kohë e detyrimeve financiare. Proceset gjyqësore lidhur me mos pagesën në afat të detyrimeve si dhe mangësitë procedurale të FSHZH-së në këtë drejtim e ekspozojnë institucionin para një risku real për pagesa, ku përveç detyrimeve të prapambetura të paguhen dhe kamatëvonesat të

cilat do të rëndonin padrejtësisht Buxhetin e institucionit i cili merr fonde edhe nga buxheti shtetit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Sipas shkresës së dërguar në KLSH, nr 5/86 prot., datë 26.10.2022, rikonfirmuar me shkresën nr. 1308 prot., datë 06.04.2023, ky rekomandim është i pazbatueshëm sepse nuk qëndron.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i papranuar**.

6.1. Rekomandim: Nga ana e institucionit të merren masa të kryhet një koordinim i veprimtarisë institucionale si dhe të plotësohen dosjet e projekteve me të gjithë dokumentacionin justifikues përkatës me qëllim që të reflektohet transparenca e veprimtarisë së institucionit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Sipas shkresës së dërguar në KLSH, nr 5/86 prot., datë 26.10.2022, rikonfirmuar me shkresën nr. 1308 prot., datë 06.04.2023, ky rekomandim është i pazbatueshëm sepse nuk qëndron.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i papranuar**.

7.1. Rekomandim: Nga ana e FSHZH-së të merren masa që regjistri i aktiveve përveç hartimit të tij sipas llojit të aktiveve afatgjatë apo afatshkurtër si dhe grupit përkatës brenda llojit të përmirësohet dhe plotësohet me aspekte të tjera, me kërkesat minimale që duhet të përmbajë regjistri i aktiveve në vartësi të llojit, që lidhen me: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.

Menjëherë

Përgjigjja e institucionit:

Sipas shkresës së dërguar në KLSH, nr 5/86 prot., datë 26.10.2022, rikonfirmuar me shkresën nr. 1308 prot., datë 06.04.2023, ky rekomandim është i pazbatueshëm sepse nuk qëndron.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i papranuar**.

8.1. Rekomandim: Nëpunësi autorizues dhe nëpunësi zbatues të marrin masa të menjëhershme të kryejnë procesin e inventarizimit të aktiveve dhe të procedojnë në përputhje me kërkesat e UMF nr. 30, datë 27.12.2011“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

- Nëpunësi autorizues dhe nëpunësi zbatues të analizojnë rezultatet e grupeve të inventarizimit dhe të procedojnë në përputhje me kërkesat e UMF nr. 30, datë 27.12.2011, duke iniciuar procesin e vlerësimit të aktiveve të propozuara për dalje nga përdorimi në njësinë shpenzuese; listën e aktiveve të identifikuar dhe kriteret për vlerësim, procesverbalin për nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve si dhe përgjegjësitë për nxjerrjen nga përdorimi ose tjetërsimin e

aktiveve në referencë UMF nr. 30, datë 27.12.2011“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

- Nga strukturat drejtuese të FSHZH-së të merren masa që kryerja e inventarëve të aktiveve, nxjerrja jashtë përdorimit dhe asgjësimi i tyre, duhet të shoqërohen me procesverbalet e nxjerrjes jashtë përdorimit dhe asgjësimit të aktiveve, bashkëlidhur me dokumentacionin mbi procedurën e kryer për vlerësimin dhe ndarjen e materialeve sipas destinacionit të tyre, ... duke e dokumentuar nxjerrjen jashtë përdorimit dhe asgjësimin e materialeve në përputhje me UMF nr. 30, datë 27.12.2011“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

- Komisionet e Vlerësimit të Aktiveve për nxjerrjen jashtë përdorimit, në përfundim të procesit të inventarizimit të aktiveve të përpilojnë një raport përmbledhës të detajuar mbi procedurën e ndjekur për vlerësimin e aktiveve për nxjerrje nga përdorimi, arsyet, efektin ekonomik të masave për riaftësimin e tyre dhe propozimin përkatës.

- Drejtori Ekzekutiv i FSHZH-së duhet të forcojë kontrollet në menaxhimin e pasurisë, duke formuar komisionet për vlerësim të pasurive në mënyrë që të sigurojë informata të drejta dhe të sakta për pasurinë që posedojnë. Gjithashtu, Nëpunësi Zbatues detyrimisht para se të kryhet inventarizimi fizik i aktiveve nga komisionet përkatëse, është i detyruar që t’u vendosë në dispozicion regjistrat e aktiveve sipas gjendjeve kontabël, ku komisionet kanë për detyrë për të evidentuar sasinë fizike.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Sipas shkresës së dërguar në KLSH, nr 5/86 prot., datë 26.10.2022, rikonfirmuar me shkresën nr. 1308 prot., datë 06.04.2023, ky rekomandim është i pazbatueshëm sepse nuk qëndron.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i papranuar**.

9.1. Rekomandim: Të merren masat nga ana e FSHZH-së për kryerjen e procesit të rivlerësimit të ndërtesave, me ekspertë të fushës, për të siguruar një pasqyrim sa më real të vlerës së këtyre aktiveve. Mungesa e kryerjes së vlerësimeve dhe regjistrimit të pasurisë me vlerën e tyre të drejtë në kontabilitet shton rrezikun që informatat e prezantuara në regjistrin e pasurisë të mos përmbushin kërkesat e raportimit financiar. Për sa sipër, të ndërtohen kontrollet dhe procedurat e brendshme në përputhje me cilësimet e paragrafit 18, të Standardit Kombëtar Kontabël nr. 5, që nënvizojnë se, “Njësia ekonomike do të zgjedhë si politikë të saj kontabël modelin e kostos (i cili shpjegohet në paragrafin 19), ose modelin e rivlerësimit (i cili shpjegohet në paragrafët 20-28) dhe do të zbatojë atë model për të gjithë klasën e AAMve që vlerësohet”, nisur nga struktura e çdo prone, vlera e tyre efektive sipas çmimeve të tregut dhe masës së amortizimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Sipas shkresës së dërguar në KLSH, nr 5/86 prot., datë 26.10.2022, rikonfirmuar me shkresën nr. 1308 prot., datë 06.04.2023, ky rekomandim është i pazbatueshëm sepse nuk qëndron.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i papranuar**.

10.1. Rekomandim: Të merren masat nga ana e FSHZH-së që për pasuritë të cilat kanë në pronësi apo synohet të merren në të ardhmen të kryhet një proces verifikimi i të drejtave pasurore për të shmangur krijimin e situatave ku për një pronë kanë pretendime më tepër se një

pronar.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Sipas shkresës së dërguar në KLSH, nr 5/86 prot., datë 26.10.2022, rikonfirmuar me shkresën nr. 1308 prot., datë 06.04.2023, ky rekomandim është i pazbatueshëm sepse nuk qëndron.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i papranuar**.

11.1. Rekomandim: - Nga ana e Këshillit Drejtues të ndërmerren nismat e nevojshme ligjore për plotësimin e dy vendeve vakante për përfaqësuesit e pushtetit vendor, me qëllim që të plotësohet numri i anëtarëve të parashikuar në ligj dhe duke ruajtur raportin e përfaqësimit pushtet vendor/qëndror sipas përcaktimeve ligjore. Në këtë mënyrë nuk rrisohet në vazhdimësi filozofia (misioni dhe vizioni) e aktivitetit të FSHZH në dobi të komunitetit.

- Nga strukturat përgjegjëse të FSHZH, të merren masa që për anëtarët e Këshillit Drejtues të zbatohen përcaktimet ligjore duke u vënë drejtpërdrejtë në dijeni zyrtarisht FSHZH nga organet kompetente të përcaktuar në ligj.

- Strukturat përgjegjëse të FSHZH, të marrin masa për plotësimin e mangësive të evidentuara në bazën rregullatorë për funksionimin e Këshillit Drejtues, lidhur me dokumentimin e aktivitetit të Këshillit Drejtues konform përcaktimeve ligjore, për ta bërë atë efektiv për veprimtarinë institucionale dhe në dobi të komunitetit.

- Nga ana e Këshillit Drejtues grafiku i takimeve të hartohet duke u koordinuar me veprimtarinë e njësisë, me qëllim që vendimmarrja e KD të jetë në kohë për të mos sjellë vonesa në zbatim të procedurave të ndryshme të njësisë dhe ti përmbahet “Rregullores së Funksionimit të Këshillit Drejtues të Fondit Shqiptar të Zhvillimit” kreu I, pika 1.2 .

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Sipas shkresës së dërguar në KLSH, nr 5/86 prot., datë 26.10.2022, rikonfirmuar me shkresën nr. 1308 prot., datë 06.04.2023, ky rekomandim është i pazbatueshëm sepse nuk qëndron.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i papranuar**.

12.1. Rekomandim: Nga ana e institucionit të merren masa, të operohet në përputhje me legjislacionin përkatës duke koordinuar veprimtarinë sipas rregullave dhe udhëzimeve publikuar nga Banka e Shqipërisë. Nga ana e FSHZH të merren masa për plotësimin e dosjeve të Këshillit Drejtues me të gjithë dokumentacionin përkatës të detyrueshëm.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Sipas shkresës së dërguar në KLSH, nr 5/86 prot., datë 26.10.2022, rikonfirmuar me shkresën nr. 1308 prot., datë 06.04.2023, ky rekomandim është i pazbatueshëm sepse nuk qëndron.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i papranuar**.

13.1. Rekomandim: Strukturat përgjegjëse të FSHZH të marrin masa për forcimin e

komponentëve të sistemit të kontrollit duke respektuar përcaktimet ligjore dhe rregullatorë për raportimin periodik të të gjithë departamenteve dhe në veçanti Departamentit të Menaxhimit të Projekteve si bashkëpunim i Njesisë së Menaxhimit të Projekteve (NJMP) dhe Njësive Rajonale (NJR), për të mbajtur në mbikëqyrje eficienten ose jo të aktivitetit të tyre.

- Nga strukturat përgjegjësi të FSHZH të merren masa për të përmirësuar organigramën e institucionit në formë dhe përmbajtje, duke pasqyruar në departamentet dhe njësitë përbërëse edhe klasifikimin e pozicioneve të punës për çdo kategori.

- Nga strukturat përgjegjëse të FSHZH të merren masa për:

a) miratimin nga ana e Këshillit Drejtues të “Manualit të Përshkrimeve të Punës” dhe “Rregullores së Konfliktit të Interesave” dhe “Kodit të Etikës”

b) hartimin dhe miratimin e “Rregullores së Brendshme” duke krijuar një baze rregullatorë të plotë që t’i përgjigjet ndryshimeve në strukturën organizative dhe planeve strategjike të FSHZH.

c) Nga strukturat përgjegjëse të FSHZH të merren masa për të përmirësuar Manualit të Proceseve të Punës duke përcaktuar në detaje rolin dhe detyrat brenda Institucionit. Duke dhënë siguri se nuk ka asnjë aktivitet pa person përgjegjës dhe që të gjithë anëtarët e stafit kanë përgjegjësitë përkatëse dhe të drejtën për të nënshkruar dokumente.

- Nga Drejtori Ekzekutiv të merren masa për krijimin e KTA/GMS si një strukturë e rëndësishme e njësisë, me qëllim evidentimin e të metave, mangësive dhe menaxhimit të risqeve për sa i takon integritetit të informacionit financiar të njësisë publike, sistemit të saj të kontrollit të brendshëm, si dhe sjelljes etike. KTA/ GMS nevojitet të planifikojë dhe dokumentojë të gjitha takimet e kryera në funksion të objektivave të saj. Gjithashtu nevojitet që KTA/GMS të kontrollojë si janë menaxhuar risqet, me qëllim parandalimin e krijimit të situatave të paparashikuara, si dhe marrja e masave për parandalimin e tyre si dhe përgatitjen e një raport vjetor lidhur me këtë.

- FSHZH të marrë masa për hartimin e strategjisë së trajnimit për KTA/GMS, në funksion të realizimit të detyrave të parashikuara për këtë grup, në kuadrin ligjor dhe rregullator.

- Nga ana e FSHZH-së të merren masa për të kryer koordinim të zyrës qendrore me degët rajonale me qëllim përdorimin me eficientë të burimeve njerëzore.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Sipas shkresës së dërguar në KLSH, nr 5/86 prot., datë 26.10.2022, rikonfirmuar me shkresën nr. 1308 prot., datë 06.04.2023, ky rekomandim është i pazbatueshëm sepse nuk qëndron.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i papranuar**.

14.1. Rekomandim: Strukturat përgjegjëse të FSHZH, të marrin masa që procesi i vlerësimit të performancës së çdo punonjësi të jetë objektiv dhe realist, bazuar në analizën e punës mbi zbatimin e detyrave të përcaktuara në përshkrimet e punës së çdo pozicioni; formulari i vlerësimit të performancës së punonjësit të plotësohet dhe nënshkruhet nga personat përgjegjës dhe të vendoset fizikisht në dosjen personale të çdo punonjësi, për qëllim motivimin në punë dhe rritjen e përgjegjshmërisë së punonjësve; si dhe monitorimin për përdorimin me eficientë dhe efektivitet të burimeve njerëzore dhe financiare të njësisë në dobi të veprimtarisë institucionale.

- Nga ana e Drejtorit Ekzekutiv të FSHZH të propozohet në Këshillin Drejtues formalizimi i procedurës së shpërblimeve.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Sipas shkresës së dërguar në KLSH, nr 5/86 prot., datë 26.10.2022, rikonfirmuar me shkresën nr. 1308 prot., datë 06.04.2023, ky rekomandim është i pazbatueshëm sepse nuk qëndron.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i papranuar**.

15.1. Rekomandim: - Nga strukturat përgjegjëse të FSHZH të merren masa për të përmirësuar Manualin e Proceseve të Punës duke përcaktuar në detaje rolin dhe detyrat brenda Institucionit. Mbështetja në manualin e Procedurave duhet të jap siguri se nuk ka asnjë aktivitet pa person përgjegjës dhe që të gjithë anëtarët e stafit kanë përgjegjësitë përkatëse dhe të drejtën për të nënshkruar dokumente.

- Në Manualin e Procedurave të plotësohet me përshkrime procedura e punësimit për kategorinë e punonjësve në funksionet mbështetëse si: shoferë, punonjësit e mirëmbajtjes, punonjësit e pastrimit, recepsionist, magazinier, roje, për të mundësuar zbatueshmërinë e saj sipas një baze rregullatore hartuar konform ligjeve në fuqi.

- Të pasqyrohet me përshkrim praktika e procedurës së lëvizjeve të personelit në pozicione të ndryshme brenda të njëjtës kategori apo dhe institucionit si dhe e ngritjes në detyrë, si pjesë integrale e menaxhimit të burimeve njerëzore.

- Të merren masa që në MP të përshkruhen të gjitha etapat e procedurës nga dorëzimi i kërkesave të aplikantëve për punësim deri në fund me përzgjedhjen e atyre fitues, duke e plotësuar bazën rregullatorë me elementë të domosdoshëm të transparencës, barazisë dhe mos diskriminimit.

- Të përshkruhen etapat që duhet ndjekur në rastet e dorëheqjes së kandidatit fitues apo e ankimimeve që mund të paraqiten në përfundim të procesit.

- Të përshkruhet qartë listimi i dokumentacionit që nevojitet për çdo fazë të procedurës, nga aplikimi fillestar deri tek fazat përmbyllëse për kandidatët që do të intervistohen (short-lista) si dhe ata 3 (tre) të përzgjedhurit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Sipas shkresës së dërguar në KLSH, nr 5/86 prot., datë 26.10.2022, rikonfirmuar me shkresën nr. 1308 prot., datë 06.04.2023, ky rekomandim është i pazbatueshëm sepse nuk qëndron.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i papranuar**.

16.1. Rekomandim: - Nga strukturat përkatëse në FSHZH të merren masa, të plotësohen dosjet e personelit me të gjithë dokumentacionin e detyrueshëm, në zbatim të bazës ligjore.

- Fleta e inventarit të dosjes së personelit dhe Fleta Prezantuese e të Dhënave Teknike duhet të kenë të listuar dokumentet e domosdoshme të dosjes dhe te rubrika “të tjera” dokumente plotësuese që lidhen me ngritjen e nivelit profesional të punonjësit, sipas VKM nr. 117 dt 05.03.2014, kreu I, pika 3, lidhja 1 e 2.

- Fleta Prezantuese e Dosjes Teknike të Nëpunësit e cila përmban të dhënat sipas 23 (njëzetë e tre) përcaktimeve, sipas VKM nr.117/2014 kreu I pika 3, lidhja 2.

- Dokumentacioni nga kërkesa e drejtorit të departamentit për personel deri në emërim, kontrata e punës, vlerësimi mbi performancën në kundërshtim sipas Kodit të Punës në RSH dhe VKM nr.117/2014 kreu I pika 3, 4, dhe lidhja 1,2.

- Formulari i Deklarimit të Konfliktit të Interesit në kundërshtim të Ligjit. nr.9367/2005 dhe

Udhëzimit nr.1 dt.7.06.2014 të Inspektorit të Përgjithshëm të “Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave”.

- Dëshmia e penaltetit, vërtetim i gjendjes gjyqësore, dëshmia e gjykatës sipas VKM nr.117/2014 lidhja 1, 2.

Mbi largimet

- Nga ana e institucionit të merren masa t’i kushtohet rëndësi plotësimit të dosjeve të personelit që i ndërpriten marrëdhëniet e punës, me dokumentacionin përkatës të procedurës së largimit nga puna, duke respektuar përcaktimet ligjore dhe ato të akteve administrative të miratuara nga titullari.

- Nga ana e institucionit të merren masa për plotësimin e praktikës së largimit nga puna ku të përfshihet procesverbali i dorëzimit të inventarëve, pajisjeve që ka pasur në përdorim apo në ngarkim, gjithë dokumentacioni i punës me nënshkrimin e dorëzuesit dhe të marrësit në dorëzim në zbatim edhe të përcaktimeve në vendimin nr.7 dt.05.02.2020 dhe nr.7/1 të dt.7.02.2020 të [DE]. Për sa më sipër në kundërshtim këto me VKM nr.117/2014 kreu I pika 8 lidhja 1 e 2; nenit 144 ligji nr.7961/1995, i ndryshuar. Të merren masa për të përfshirë në çdo dosje shkresën e emërimit dhe largimit nga detyra të personelit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Sipas shkresës së dërguar në KLSH, nr 5/86 prot., datë 26.10.2022, rikonfirmuar me shkresën nr. 1308 prot., datë 06.04.2023, ky rekomandim është i pazbatueshëm sepse nuk qëndron.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i papranuar**.

17.1. Rekomandim: - Nga strukturat përgjegjëse të FSHZH të merren masa për të përmirësuar procesin e rekrutimit të punonjësve të rinj duke mbajtur në fokus transparencën me publikun, qysh nga inicimi përmes njoftimeve për vendet e lira të punës. E gjithë veprimtaria duhet të jetë e dokumentuar me gjurmën e auditit.

- Nga ana e FSHZH të merren masa për regjistrimin e procedurës së intervistimit të kandidatëve të përzgjedhur, të rasteve kur ka dorëheqje dhe ankimime.

- Nga strukturat përgjegjëse në FSHZH të fillojë regjistrimi manual i shkresave me objekt “Njoftim për vend të lirë pune”, duke e vlerësuar si çdo shkresë tjetër që i përket një procedure të caktuar.

- Nga ana e FSHZH të merren masa për regjistrimin manual dhe dokumentimin e gjithë praktikave të procedurës së kryer nga Komisioni i Vlerësimit për rekrutim personeli.

- Nga strukturat përgjegjëse të FSHZH-së të plotësohet me përshkrime: publikimi i listës emërore e aplikuesve apo kandidatëve për çdo fazë të procedurës së punësimit për vendin vakant; publikimi i emrave të përzgjedhur për çdo fazë si dhe mënyra e njoftimit të tyre për fazën tjetër, duke pasqyruar kështu transparencë, barazi dhe mos diskriminim.

- Nga strukturat përgjegjëse të FSHZH të merren masa për të plotësuar numrin e vendeve vakante sipas strukturës së miratuar me Vendime të Këshillit Drejtues, konform bazës ligjore dhe rregullatore me qëllim realizimin në kohë të objektivave pa cënuar performancën institucionale.

- E gjithë kjo veprimtari duhet shoqëruar me dokumentacionin justifikues konform formateve të shkresave zyrtare në Republikën e Shqipërisë dhe t’i nënshtrohet procesit të regjistrimit në regjistrin e protokollit si çdo akt administrativ.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Sipas shkresës së dërguar në KLSH, nr 5/86 prot., datë 26.10.2022, rikonfirmuar me shkresën nr. 1308 prot., datë 06.04.2023, ky rekomandim është i pazbatueshëm sepse nuk qëndron.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i papranuar**.

18.1. Rekomandim: Nga ana e strukturave drejtuese të FSHZH-së të merren masa për të shmangur në të ardhmen largime arbitrare dhe të pamotivuara të punonjësve duke shkaktuar efekte financiare negative për buxhetin e institucionit apo të buxhetin e shtetit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Sipas shkresës së dërguar në KLSH, nr 5/86 prot., datë 26.10.2022, rikonfirmuar me shkresën nr. 1308 prot., datë 06.04.2023, ky rekomandim është i pazbatueshëm sepse nuk qëndron.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i papranuar**.

19.1. Rekomandim: Nga ana e institucionit të merren masa për të plotësuar dokumentacionin justifikues në përputhje me bazën ligjore. Dokumentacioni duhet të përmbajë të gjitha eksterimetet dhe të specifikojë në mënyrë të qartë termat e kontratës.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Sipas shkresës së dërguar në KLSH, nr 5/86 prot., datë 26.10.2022, rikonfirmuar me shkresën nr. 1308 prot., datë 06.04.2023, ky rekomandim është i pazbatueshëm sepse nuk qëndron.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i papranuar**.

20.1. Rekomandim: Nga ana e institucionit të merren masa për të shmangur praktikën e lënies në ngarkim të asetëve vet punonjësve në zonat rajonale.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Sipas shkresës së dërguar në KLSH, nr 5/86 prot., datë 26.10.2022, rikonfirmuar me shkresën nr. 1308 prot., datë 06.04.2023, ky rekomandim është i pazbatueshëm sepse nuk qëndron.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i papranuar**.

21.1. Rekomandim: Nga Njësia e Auditimit të Brendshëm, në FSHZH të merren masat për të plotësuar bazën rregullatore të saj duke hartuar: “Rregulloren e Brendshme të organizimit dhe funksionimit të Auditit të Brendshëm”, “Kodi i Etikës”, me ekstremitet e nevojshme, si dhe “Gjurmën e Auditit” për veprimtaritë kryesore të këtij sektori.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Sipas shkresës së dërguar në KLSH, nr 5/86 prot., datë 26.10.2022, rikonfirmuar me shkresën nr. 1308 prot., datë 06.04.2023, ky rekomandim është i pazbatueshëm sepse nuk qëndron.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i papranuar**.

22.1. Rekomandim: NJAB në FSHZH të respektojë afatet ligjore për dërgimin e Planit Strategjik dhe Vjetor të Njësisë së Auditimit të Brendshëm në Drejtorinë e Harmonizimit të Auditit të Brendshëm në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Sipas shkresës së dërguar në KLSH, nr 5/86 prot., datë 26.10.2022, rikonfirmuar me shkresën nr. 1308 prot., datë 06.04.2023, ky rekomandim është i pazbatueshëm sepse nuk qëndron.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i papranuar**.

23.1. Rekomandim: NJAB të FSHZH të dërgojë Planin Strategjik dhe Vjetor të miratuar nga Këshilli Drejtues duke respektuar në kohë afatet dhe etapat përgatitore të tij para datës 20 tetor të çdo viti, sipas përcaktimeve të manualit të auditimit të brendshëm.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Sipas shkresës së dërguar në KLSH, nr 5/86 prot., datë 26.10.2022, rikonfirmuar me shkresën nr. 1308 prot., datë 06.04.2023, ky rekomandim është i pazbatueshëm sepse nuk qëndron.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i papranuar**.

24.1. Rekomandim: NJAB të FSHZH ti kushtojë rëndësi respektimit të afateve për hartimin, miratimin në Këshillin Drejtues të planit strategjik dhe vjetor, si dhe dorëzimin në kohë në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik në MF, duke u koordinuar me takimet e periodike të Këshillit Drejtues, për ta zbatuar procedurën sipas përcaktimeve ligjore.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Sipas shkresës së dërguar në KLSH, nr 5/86 prot., datë 26.10.2022, rikonfirmuar me shkresën nr. 1308 prot., datë 06.04.2023, ky rekomandim është i pazbatueshëm sepse nuk qëndron.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i papranuar**.

25.1. Rekomandim: Nga ana e NJAB të merren masa për një planifikim të drejtë të misioneve audituese në përputhje me përcaktimet ligjore, ku t'i kushtohet rëndësi komponentëve të Sistemeve të Kontrollit të Brendshëm, duke nisur me regjistrin e riskut dhe gjurmët e auditimit duke forcuar bazën e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë, por edhe në dhënien e sigurisë së objektivat e vendosura do të arrihen.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Sipas shkresës së dërguar në KLSH, nr 5/86 prot., datë 26.10.2022, rikonfirmuar me shkresën nr. 1308 prot., datë 06.04.2023, ky rekomandim është i pazbatueshëm sepse nuk qëndron.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i papranuar**.

26.1. Rekomandim: Nga ana e NJAB dhe FSHZH të merren masa për respektimin e afateve kohore për hartimin dhe miratimin e raporteve vjetore të auditit të brendshëm.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Sipas shkresës së dërguar në KLSH, nr 5/86 prot., datë 26.10.2022, rikonfirmuar me shkresën nr. 1308 prot., datë 06.04.2023, ky rekomandim është i pazbatueshëm sepse nuk qëndron.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i papranuar**.

27.1. Rekomandim: Nga ana e NJAB dhe FSHZH të merren masa për respektimin e etapave procedurale dhe kohore për shqyrtimin dhe konsultimin për ndryshimin e planit vjetor të auditimit të brendshëm në përputhje me bazën ligjore në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Sipas shkresës së dërguar në KLSH, nr 5/86 prot., datë 26.10.2022, rikonfirmuar me shkresën nr. 1308 prot., datë 06.04.2023, ky rekomandim është i pazbatueshëm sepse nuk qëndron.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i papranuar**.

28.1. Rekomandim: Nga ana e NJAB dhe FSHZH të merren masa për të reflektuar në kohë reale çdo ndryshim të bërë në planet e auditit, si dhe të lihet gjurmë lidhur me këto ndryshime

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Sipas shkresës së dërguar në KLSH, nr 5/86 prot., datë 26.10.2022, rikonfirmuar me shkresën nr. 1308 prot., datë 06.04.2023, ky rekomandim është i pazbatueshëm sepse nuk qëndron.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i papranuar**.

29.1. Rekomandim: NJAB të hartojë në mënyrë të plotë raportin vjetor të auditit duke përfshirë në to të gjithë komponentët përkatës.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Sipas shkresës së dërguar në KLSH, nr 5/86 prot., datë 26.10.2022, rikonfirmuar me shkresën nr. 1308 prot., datë 06.04.2023, ky rekomandim është i pazbatueshëm sepse nuk qëndron.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i papranuar**.

30.1. Rekomandim: NJAB të hartojë në mënyrë të plotë raportet vjetor të auditit duke përfshirë në to procesin i ndjekjes së rekomandimeve të lëna si dhe Planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna në përfundim të angazhimit të auditimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Sipas shkresës së dërguar në KLSH, nr 5/86 prot., datë 26.10.2022, rikonfirmuar me shkresën nr. 1308 prot., datë 06.04.2023, ky rekomandim është i pazbatueshëm sepse nuk qëndron.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i papranuar**.

31.1. Rekomandim: NJAB në FSHZH të koordinojë veprimtarinë audituese me institucionet e auditit të jashtëm për të shmangur mbivendojset në fushat audituese, si dhe të hartojë planet vjetore duke marrë në konsideratë nevojat reale të institucionit. Çdo ndryshim në këto plane duhet të arsyetohet me shkrim nga drejtuesi i NjAB dhe të miratohen nga titullari i njësisë dhe organet kompetente.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Sipas shkresës së dërguar në KLSH, nr 5/86 prot., datë 26.10.2022, rikonfirmuar me shkresën nr. 1308 prot., datë 06.04.2023, ky rekomandim është i pazbatueshëm sepse nuk qëndron.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i papranuar**.

32.1. Rekomandim: Nga ana e FSHZH të kryhen procedurat për marrjen e dokumentit të dhënies së dakortësisë nga NJQV për kalimin e përgjegjësisë së operimit/menaxhimit të Qendrës së Zhvillimit dhe Turizmit në Valbonë nga FSHZH tek Agjencia Ekonomike Mbështetëse; si dhe për kalimin e përgjegjësisë së operimit/menaxhimit të Qendrës së Zhvillimit dhe Turizmit në Vermosh nga FSHZH tek Agjencia Ekonomike Mbështetëse.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Sipas shkresës së dërguar në KLSH, nr 5/86 prot., datë 26.10.2022, rikonfirmuar me shkresën nr. 1308 prot., datë 06.04.2023, ky rekomandim është i pazbatueshëm sepse nuk qëndron.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i papranuar**.

33.1. Rekomandim: Nga ana e departamentit të NJAB të FSHZH të merren masa për të përfshirë në planin vjetor të auditimit si mission angazhimi me rëndësi të veçantë, për shkak të kompleksitetit të situatës.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Sipas shkresës së dërguar në KLSH, nr 5/86 prot., datë 26.10.2022, rikonfirmuar me shkresën nr. 1308 prot., datë 06.04.2023, ky rekomandim është i pazbatueshëm sepse nuk qëndron.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i papranuar**.

34.1. Rekomandim: Nga ana e AEM të merren masa për plotësimin e dokumentacionit sa i takon investimeve të kryera për llogari të QSUT, në përputhje me VKM nr. 688 datë 14.11.2018, i ndryshuar.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Sipas shkresës së dërguar në KLSH, nr 5/86 prot., datë 26.10.2022, rikonfirmuar me shkresën nr. 1308 prot., datë 06.04.2023, ky rekomandim është i pazbatueshëm sepse nuk qëndron.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i papranuar**.

35.1. Rekomandim: Nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe sipërmarësi BOE “U.N” Sh.p.k. & “G. C” Sh.p.k., të merren të gjitha masat e nevojshme, për të riparuar kaldajën me pelet me ngrohje uji, me fuqi termike 280 kË, brenda periudhës së garancisë së punime.

Menjëherë

Përgjigjja e institucionit:

I zbatuar, sipas Raporti i grupit të punës Nr. 550 Prot., datë 13.02.2023, të ngritur me Urdherin e brendshëm Nr. 48, datë 25.10.2022.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

36.1. Rekomandim: Fondi Shqiptar i Zhvillimit të marrë masa që të përcaktojë qartë pikët mbi metodologjinë dhe cilësinë, në mënyrë të matshme dhe objektive, duke shmangur subjektivitetet nga Komisionet, në mënyrë që çdo ofertues të ketë trajtim të barabartë në garë.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Sipas raportit të grupit të punës Nr. 550/1 Prot., datë 07.03.2023, të ngritur me Urdhrin e brendshëm Nr. 48, datë 25.10.2022, vëren se kriteret e vlerësimit janë të përcaktuara në ligj dhe autoriteti përgjegjës ka detyrimin të zbatojë dhe respektojë këto kritere bazuar në rregullat e prokurimit në kuadër të procesit të rindërtimit.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i papranuar**

37.1. Rekomandim: Në rastet eventuale të paraqitjes së një ankese pranë AK, duke konsideruar numrin relativisht të madh të stafit, titullari i institucionit, për shqyrtimin e ankesës, duhet të ngrejë një komision (KSHA) të përbërë nga 3 (tre) persona, ku të paktën njëri të jetë ekspert i fushës, kjo pasi përjashtimisht, në rast të mungesës së personelit, titullari i autoritetit kontraktor ia ngarkon çështjen për shqyrtim 1 (një) zyrtari të vetëm.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Sipas raportit të grupit të punës Nr. 550/1 Prot., datë 07.03.2023, të ngritur me Urdhrin e brendshëm Nr. 48, datë 25.10.2022, GP duke mbajtur parasysh Rekomandimn, konfirmon se do të respektohen kërkesat ligjore për caktimin e personit/ve për shqyrtimin e ankesave, duke mbajtur në konsideratë edhe ngritjen e komisionit sipas objektit të ankimit.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **është zbatuar**.

38.1. Rekomandim: AK (grupi i punës, njësia e prokurimit apo komisioni përkatës), në lidhje me procedurat e prokurimit që do të zhvillojë në vijim, gjatë përcaktimit të kërkesave dhe kritereve për kualifikim, duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP dhe në harmoni me rekomandimet e APP-së. Për çdo procedurë prokurimi Autoriteti Kontraktor të udhëhiqet nga parimi i ekonomicitetit, eficensës dhe efektivitetit, bazuar në kritere të vlerësimit që nxisin konkurrencën e lirë dhe trajtim të barabartë të operatorëve ekonomik, duke përfutur kështu kontrata me ndikim në mirëadministrimin e fonde buxhetore. Gjithashtu, kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, si dhe në çdo rast, ato duhet të argumentohen teknikisht dhe të gjejnë mbështetje ligjore.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Sipas raportit të grupit të punës Nr. 550/1 Prot., datë 07.03.2023, të ngritur me Urdhrin e brendshëm Nr. 48, datë 25.10.2022, Rekomandim do të merret në konsideratë në të gjitha procedurat e prokurimit që do të zhvillohen në të ardhmen, duke mbajtur në vëmendje që për çdo kriter vlerësimi të ketë argumentim më të thelluar.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet i pranuar nga subjekti dhe në **proces zbatimi**.

39.1. Rekomandim: AK (grupi i punës, njësia e prokurimit apo komisioni përkatës), në lidhje me procedurat e prokurimit që do të zhvillojë në vijim, gjatë përcaktimit të kërkesave dhe kritereve për kualifikim, duhet të argumentojë teknikisht dhe ligjërisht çdo kriter të vendosur duke i dokumentuar në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Sipas raportit të grupit të punës Nr. 550/1 Prot., datë 07.03.2023, të ngritur me Urdhrin e brendshëm Nr. 48, datë 25.10.2022, Rekomandim do të merret në konsideratë në të gjitha procedurat e prokurimit që do të zhvillohen në të ardhmen, duke mbajtur në vëmendje që për çdo kriter vlerësimi të ketë argumentim më të thelluar.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe në **proces zbatimi**.

40.1. Rekomandim: AK (grupi i punës apo komisioni përkatës), në lidhje me procedurat e prokurimit që do të zhvillojë në vijim, gjatë përcaktimit të kritereve për shpalljen e ofertës fituese, duhet të bazohet në “çmim” si i vetmi element i ndryshueshëm ndërmjet ofertave të cilat kanë të bëjnë me objekte prokurimi që kanë specifikime të thjeshta, standarde teknike të mirënjohura dhe janë lehtësisht të gjendura në treg.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Sipas raportit të grupit të punës Nr. 550/1 Prot., datë 07.03.2023, të ngritur me Urdhrin e brendshëm Nr. 48, datë 25.10.2022, për punët/mallrat/shërbimet që kanë specifikime të thjeshta, standarde teknike të mirënjohura dhe janë lehtësisht të gjendura në treg, kriter vlerësimi gjithmonë është përcaktuar oferta ekonomikisht më e favorshme e cila **bazohet në çmimin si i vetmi element i ndryshueshëm ndërmjet ofertave**. Për procedurat që do të

zhvillohen në të ardhmen, argumentimi ligjor i përzgjedhjes së Kriterit për shpalljen e ofertës fituese në varësi të kompleksitetit të kontratës.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **është zbatuar**.

41.1. Rekomandim: AK (grupi i punës apo komisioni përkatës), në lidhje me procedurat e prokurimit që do të zhvillojë në vijim, gjatë vlerësimit dhe shpalljes së ofertës fituese, duhet të bazohet në aktet ligjore e nënligjore të ligjit nr. nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”. Konkretisht, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhet të vlerësojë të vlefshme dhe të kualifikojë një ofertë vetëm kur ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe dokumentet e tenderit që autoriteti kontraktor ka vlerësuar të nevojshme, duke shpallur fituese ofertën me çmimin më të ulët, kur ky i fundit është kriteri përcaktues. Në rastet kur asnjë nga shoqëritë apo operatorët ekonomikë pjesëmarrës në garë nuk plotëson kërkesat e Dokumenteve Standarde të Tenderit, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhet të anulojë procedurën.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Sipas raportit të grupit të punës Nr. 550/1 Prot., datë 07.03.2023, të ngritur me Urdhrin e brendshëm Nr. 48, datë 25.10.2022, në të gjitha procedurat e prokurimit të zhvilluara nga FSHZH në vazhdim janë kualifikuar vetëm ofertat të cilat plotësojnë të gjitha kërkesat për kualifikim dhe specifikimet e parashikuara në dokumentet standarde të tenderit në përputhje me parashikimet e nenit 92 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” si dhe nenit 82 të VKM nr. 286, datë 19.5.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **është zbatuar**.

42.1. Rekomandim: AK (grupi i punës apo komisioni përkatës), në lidhje me procedurat e prokurimit që do të zhvillojë në vijim, gjatë përcaktimit të kriterëve për shpalljen e ofertës fituese, duhet të bazohet në “kriteret” sa më objektive të cilët të mund të shprehen në shifra, për vlerësimin e të cilëve është e mundur aplikimi i formulës që parashikohet në dokumentet standarde të tenderit sipas llojit të procedurës përkatëse.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Sipas raportit të grupit të punës Nr. 550/1 Prot., datë 07.03.2023, të ngritur me Urdhrin e brendshëm Nr. 48, datë 25.10.2022, Rekomandim do të mbahet në konsideratë, ku për procedurat e prokurimit të së njëjtës natyrë që do të zhvillohen në të ardhmen, vlera me pikë e çdo kriteri vlerësimi të jetë objektiv i matshëm me formulën e përcaktuar në dokumentet e tenderit.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Bazuar në ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15, germat b) dhe c) “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së” dhe mbështetur në nenet 98-102 të ligjit nr. 44, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, pikën 93 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, nga ana e Titullarit të njësisë publike (Fondi Shqiptar i Zhvillimit), të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit, në mënyrë të menjëhershme për të shmangur tejkalimin e afateve dhe parashkrimin e të drejtës për të kërkuar shumën monetare gjyqësisht, si dhe të ndiqet procesi, me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën 23,729,475 lekë pa TVSH si më poshtë:

1.1. Rekomandim: FSHZH të marrë masa e nevojshme, duke ngritur grup pune të veçantë me specialistë të fushës, të vlerësojnë e të analizojnë ndryshimet e projekt-zbatimit në sasi dhe në vlerë (duke realizuar tabelën e lëvizjes së volumeve), të cilat rezultuan në kundërshtim me termat e referencës nga projekti fillestar, në të kundërt vlera e grilave prej **8,894,278 lekë pa TVSH**, do të konsiderohet dëm ekonomik, për konviktet e Korçës dhe Shkodrës.

Menjëherë

1.2. Rekomandim: FSHZH të marrë masa, duke ngritur grup pune të veçantë me specialistë të fushës, të vlerësojnë efektivitetin e ndryshimit të fuqisë në zërin “Kaldajë me lëndë djegëse”, duke siguruar që kaldaja e vendosur garanton efektivitet dhe cilësi në konformitet me specifikimet teknike sipas projektit dhe llogaritjeve mbi fuqinë, brenda periudhës së garancisë së punimeve. Në të kundërt vlera prej 3,850,000 lekë pa TVSH, do të konsiderohet dëm ekonomik, deri në vendosjen e kaldajës me fuqinë, sipas projekt zbatimit.

Menjëherë

Përgjigjja e institucionit:

FSHZH e argumenton moszbatimin e këtij Rekomandim me faktin që kontratat e lidhura kanë qenë kontrata “me çelësa në dorë”, ku vëllimi i punëve i parashikuar në projekt mund të shërbejë vetëm si një orientim, pa asnjë detyrim për të respektuar vëllimin e punëve të projektit. FSHZH argumenton dhe mbron idenë që kontratat me çelësa në dorë janë më të vlefshme në aspektin ekonomik dhe shmang shtesa të kontratave që rëndom përdoren në prokurimet publike. Për këtë arsye, me urdhrin nr.24 datë 14.04.2023, është kërkuar nga Drejtoria e Garantimit të Financave pagesa e vlerës korresponduese, të mbajtur pezull në formën e penalitetit dhe/ose garanci të defekteve lidhur me rekomandimet përfundimtare të lëna nga KLSH. Rekomandim nuk mund të zbatohet. Raporti i grupit të punës Nr. 550 Prot., date 13.02.2023, të ngritur me Urdherin e brendshëm Nr. 48, datë 25.10.2022.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i papranuar**

2.1. Rekomandim: FSHZH të marrë masa, të ngrijë grup pune të veçantë me specialistë të fushës, të vlerësojnë efektivitetin e ndryshimit të fuqisë në zërin “Kaldajë me lëndë djegëse me pellet” nga 380 kW në 245 kW, duke siguruar që kaldaja e vendosur garanton efektivitet dhe cilësi në konformitet me specifikimet teknike sipas projektit dhe llogaritjeve mbi fuqinë, brenda periudhës së garancisë së punimeve. Në të kundërt vlera prej 4,000,000 lekë pa TVSH, do të konsiderohet dëm ekonomik, deri në vendosjen e kaldajës me fuqinë 380 kW, sipas projekt zbatimit.

Përgjigjia e institucionit:

FSHZH e argumenton moszbatimin e këtij Rekomandim me faktin që kontratat e lidhura kanë qenë kontrata “me çelësa në dorë”, ku vëllimi i punëve i parashikuar në projekt mund të shërbejë vetëm si një orientim, pa asnjë detyrim për të respektuar vëllimin e punëve të projektit. FSHZH argumenton dhe mbron idenë që kontratat me çelësa në dorë janë më të vlefshme në aspektin ekonomik dhe shmang shtesa të kontratave që rëndom përdoren në prokurimet publike. Për këtë arsye, me urdhrin nr.24 datë 14.04.2023, është kërkuar nga Drejtoria e Garantimit të Financave pagesa e vlerës korresponduese, të mbajtur pezull në formën e penaltetit dhe/ose garanci të defekteve lidhur me rekomandimet përfundimtare të lëna nga KLSH.

Rekomandim nuk mund të zbatohet. Raporti i grupit të punës Nr. 550 Prot., date 13.02.2023, të ngritur me Urdherin e brendshëm Nr. 48, datë 25.10.2022.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i papranuar**.

3.1. Rekomandim: FSHZH të marrë masa, të ngrëjë grup pune të veçantë me specialistë të fushës, të vlerësojë efektivitetin e ndryshimit të specifikimeve teknike për zërin “An 35/36 “Dysheme sportive e brendshme Taraflex tip TX Recreation – 6 mm (Palestra) (ose ekuivalente me të) përfshirë edhe vijëzimi i fushës së basketbollit (Palestra) KIT Taraflex LD Aqua Paint Volleyball (color blues) – 85 lm vijëzim KIT Taraflex LD Aqua Paint Volleyball (color Red) – 205 lm vijëzim, KIT Taraflex LD Aqua Paint Handball (color Yellow) – 230 lm vijëzim (ose ekuivalent me të)”, duke siguruar që materiali ekuivalent i përdorur garanton efektivitet dhe cilësi në konformitet me specifikimet teknike sipas projektit, brenda periudhës së garancisë së punimeve. Në të kundërt vlera prej 2,452,000 lekë pa TVSH (1,100,000 lekë + 1,352,000 lekë) do të konsiderohet dëm ekonomik, deri në plotësimin të specifikimeve teknike, sipas projekt zbatimit.

Menjëherë

Përgjigjia e institucionit:

Rekomandim u zbatua. Raporti i grupit të punës Nr. 550 Prot., date 13.02.2023, të ngritur me Urdherin e brendshëm Nr. 48, datë 25.10.2022

Komenti i grupit të auditimit.

Është ngritur grupi teknik me specialist të fushës, dhe ka arritur në konkluzion se materiali i përdorur është specifikisht ai që përshkruhet në projekt dhe në specifikime teknike.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

4.1. Rekomandim: FSHZH të marrë masa të arkëtojë vlerën prej 132,680 lekë pa TVSh nga OE “A T” sh.p.k., për punime të pakryera, parashikuar në kontratën me objekt “Rikonstruksion i rrugës Balldren - Bend, Bashkia Lezhë”.

Menjëherë

4.2. Rekomandim: FSHZH të kërkojë riparimin e rrugës së dëmtuar nga OE “A T” sh.p.k., në vlerën **130,320** lekë pa TVSH, brenda periudhës së garancisë së punimeve, në të kundërt do të konsiderohet dëm ekonomik, për punime të kryera pa cilësi dhe jo në përputhje me specifikimet teknike në segmentet përkatës, në të kundërt AK të marrë masa të arkëtojë vlerën e punimeve.

Menjëherë

Përgjigjia e institucionit:

Grupi i punës, i ngritur me Urdhrin e brendshëm Nr. 48, datë 25.10.2022, ka konstatuar që edhe pse kjo gjetje lidhet me kontratë me tipologji “me çelësa në dorë”, vëren se këto janë diferenca në volume për punime të deklaruar të kryera pasi është miratuar një projekt zbatim, dhe si të tillë duheshin kryer. Me urdhrin e brendshëm nr. 22, datë 27.03.2023, të drejtorit ekzekutiv, është urdhëruar ndjekja e të gjithë procedurave administrative dhe ligjore për kthimin në buxhetin e shtetit të vlerës së sipër përmendur.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **është zbatuar**.

5.1. Rekomandim: FSHZH të marrë masa të arkëtojë vlerën prej 254,420 lekë pa TVSh nga BOE “G K” Sh.p.k. & “Sh” Sh.p.k. & “F” Sh.p.k., për punime të pakryera, parashikuar në kontratën me nr. 2847 prot datë 17.11.2020 me objekt “Rikonstruksion i Rrugës Çamëria dhe i Unazës së qytetit Kavajë”.

Menjëherë

Përgjigjia e institucionit:

Grupi i punës, i ngritur me Urdhrin e brendshëm Nr. 48, datë 25.10.2022, ka konstatuar që edhe pse kjo gjetje lidhet me kontratë me tipologji “me çelësa në dorë”, vëren se këto janë diferenca në volume për punime të deklaruar të kryera pasi është miratuar një projekt zbatim, dhe si të tillë duheshin kryer. Me urdhrin e brendshëm nr. 22, datë 27.03.2023, të drejtorit ekzekutiv, është urdhëruar ndjekja e të gjithë procedurave administrative dhe ligjore për kthimin në buxhetin e shtetit të vlerës së sipër përmendur.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **është zbatuar**.

6.1 Rekomandim: FSHZH të marrë masa të arkëtojë vlerën prej 111,384 lekë pa TVSh nga OE “K” Sh.p.k., për punime të pakryera, parashikuar në kontratën me nr. 3071 prot datë 04.12.2020 me objekt “Rikonstruksion i Rrugës Rrëshen-Fshati Sheshaj, Bashkia Mirditë”.

Menjëherë

6.2 Rekomandim: FSHZH të kërkojë riparimin e rrugës së dëmtuar nga OE “K” Sh.p.k., në vlerën 255,353 lekë pa TVSH, brenda periudhës së garancisë së punimeve, në të kundërt do të konsiderohet dëm ekonomik, për punime të kryera pa cilësi dhe jo në përputhje me specifikimet teknike për: Kunetën Tip 1 e plotë, me gjatësi 200 ml dhe gjerësi 0.5 m si dhe të Shtresave asfaltike (Binder dhe asfaltobeton) në Piketën 13 progresivi 0+350 ml sipas kontratës nr. 3071 prot., datë 04.12.2020.

Menjëherë

Përgjigjia e institucionit:

Grupi i punës, i ngritur me Urdhrin e brendshëm Nr. 48, datë 25.10.2022, ka konstatuar që edhe pse kjo gjetje lidhet me kontratë me tipologji “me çelësa në dorë”, vëren se këto janë diferenca në volume për punime të deklaruar të kryera pasi është miratuar një projekt zbatim, dhe si të tillë duheshin kryer. Me urdhrin e brendshëm nr. 22, datë 27.03.2023, të drejtorit ekzekutiv, është urdhëruar ndjekja e të gjithë procedurave administrative dhe ligjore për kthimin në buxhetin e shtetit të vlerës së sipër përmendur.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **është zbatuar**.

7.1. Rekomandim: FSHZH të marrë masa të arkëtojë vlerën prej 263,778 lekë pa TVSh nga OE “A K” Sh.p.k., për punime të pakryera, parashikuar në kontratën me objekt “Ndërtimi i Stacionit të

Pompimit, tubacionit kryesor dhe rrjetit shpërndarës të Grabianit, Bashkia Divjakë”.

Menjëherë

Përgjigjia e institucionit:

Grupi i punës, i ngritur me Urdhrin e brendshëm Nr. 48, datë 25.10.2022, ka konstatuar që edhe pse kjo gjetje lidhet me kontratë me tipologji “me çelësa në dorë”, vëren se këto janë diferenca në volume për punime të deklaruar të kryera pasi është miratuar një projekt zbatim, dhe si të tillë duheshin kryer. Me urdhrin e brendshëm nr. 22, datë 27.03.2023, të drejtorit ekzekutiv, është urdhëruar ndjekja e të gjithë procedurave administrative dhe ligjore për kthimin në buxhetin e shtetit të vlerës së sipër përmendur.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **është zbatuar**.

8.1. Rekomandim: FSHZH të marrë masa të arkëtojë vlerën prej **260,679** lekë pa TVSh nga BOE “A B” Sh.p.k. & “L” Sh.p.k., për punime të pakryera, parashikuar në kontratën me nr. 1194, datë 09.06.2020 me objekt “Rindërtimi i objektit “Shkolla 9-vjeçare dhe kopshti “Ramazan Jangozi” Njësia Administrative Thumanë”.

Menjëherë

Përgjigjia e institucionit:

Grupi i punës, i ngritur me Urdhrin e brendshëm Nr. 48, datë 25.10.2022, ka konstatuar që edhe pse kjo gjetje lidhet me kontratë me tipologji “me çelësa në dorë”, vëren se këto janë diferenca në volume për punime të deklaruar të kryera pasi është miratuar një projekt zbatim, dhe si të tillë duheshin kryer. Me urdhrin e brendshëm nr. 22, datë 27.03.2023, të drejtorit ekzekutiv, është urdhëruar ndjekja e të gjithë procedurave administrative dhe ligjore për kthimin në buxhetin e shtetit të vlerës së sipër përmendur.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **është zbatuar**.

9.1. Rekomandim: FSHZH të marrë masa të arkëtojë vlerën prej 269,640 lekë pa TVSh nga BOE “A K” Sh.p.k. & “C” Sh.p.k., për punime të pakryera, parashikuar në kontratën me nr. 1332 prot., datë 22.06.2020 me objekt “Rindërtim i kopshtit “Halit Çoka” Bathore Bashkia Kamëz”.

Menjëherë

Përgjigjia e institucionit:

Grupi i punës, i ngritur me Urdhrin e brendshëm Nr. 48, datë 25.10.2022, ka konstatuar që edhe pse kjo gjetje lidhet me kontratë me tipologji “me çelësa në dorë”, vëren se këto janë diferenca në volume për punime të deklaruar të kryera pasi është miratuar një projekt zbatim, dhe si të tillë duheshin kryer. Me urdhrin e brendshëm nr. 22, datë 27.03.2023, të drejtorit ekzekutiv, është urdhëruar ndjekja e të gjithë procedurave administrative dhe ligjore për kthimin në buxhetin e shtetit të vlerës së sipër përmendur.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **është zbatuar**.

10.1. Rekomandim: FSHZH të marrë masa të arkëtojnë vlerën prej 693,174 lekë pa TVSh nga BOE “T B C” Sh.p.k. & “V H” Sh.p.k. & “C B” Sh.p.k. & “S” Sh.p.k., “M E” Sh.p.k. & “K A B” Sh.p.k, për punime të pakryera, parashikuar në kontratën me nr. 836/4 prot., datë 09.06.2020 me objekt “Shkolla 9-vjeçare dhe kopshti “Adem Gjeli” Ishëm, Durrës”.

Menjëherë

Përgjigjia e institucionit:

Grupi i punës, i ngritur me Urdhrin e brendshëm Nr. 48, datë 25.10.2022, ka konstatuar që edhe pse kjo gjetje lidhet me kontratë me tipologji “me çelësa në dorë”, vëren se këto janë diferenca në volume për punime të deklaruar të kryera pasi është miratuar një projekt zbatim, dhe si të tillë duheshin kryer. Me urdhrin e brendshëm nr. 22, datë 27.03.2023, të drejtorit ekzekutiv, është urdhëruar ndjekja e të gjithë procedurave administrative dhe ligjore për kthimin në buxhetin e shtetit të vlerës së sipër përmendur.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **është zbatuar**.

8.1. Rekomandim: FSHZH të marrë masa të arkëtojnë vlerën prej 157,065 lekë pa TVSh nga BOE “B” Sh.p.k. & “F” Sh.p.k. & “T” Sh.p.k., për punime të pakryera, parashikuar në kontratën datë 22.06.2020 me objekt “Rikonstruksioni Rrugëve të Brendshme dhe Rikualifikimi i Hapësirave Publike tek Zona e Plazhit të Shkëmbi i Kavajës, Bashkia Durrës”.

Menjëherë

Përgjigjia e institucionit:

Grupi i punës, i ngritur me Urdhrin e brendshëm Nr. 48, datë 25.10.2022, ka konstatuar që edhe pse kjo gjetje lidhet me kontratë me tipologji “me çelësa në dorë”, vëren se këto janë diferenca në volume për punime të deklaruar të kryera pasi është miratuar një projekt zbatim, dhe si të tillë duheshin kryer. Me urdhrin e brendshëm nr. 22, datë 27.03.2023, të drejtorit ekzekutiv, është urdhëruar ndjekja e të gjithë procedurave administrative dhe ligjore për kthimin në buxhetin e shtetit të vlerës së sipër përmendur.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **është zbatuar**.

9.1. Rekomandim: FSHZH të marrë masa të arkëtojnë vlerën prej 233,800 lekë pa TVSh nga OE “B I” Sh.p.k., për punime të pakryera, parashikuar në kontratën datë 29.01.2019 me objekt “Rivitalizim Urban i Bulevardit Maliq-Drithas”.

Menjëherë

Përgjigjia e institucionit:

Grupi i punës, i ngritur me Urdhrin e brendshëm Nr. 48, datë 25.10.2022, ka konstatuar që edhe pse kjo gjetje lidhet me kontratë me tipologji “me çelësa në dorë”, vëren se këto janë diferenca në volume për punime të deklaruar të kryera pasi është miratuar një projekt zbatim, dhe si të tillë duheshin kryer. Me urdhrin e brendshëm nr. 22, datë 27.03.2023, të drejtorit ekzekutiv, është urdhëruar ndjekja e të gjithë procedurave administrative dhe ligjore për kthimin në buxhetin e shtetit të vlerës së sipër përmendur.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **është zbatuar**.

10.1. Rekomandim: FSHZH të marrë masa të arkëtojë vlerën prej 187,995 lekë pa TVSh nga BOE “T B C” Sh.p.k. & “V H” Sh.p.k. & “C B” Sh.p.k. & “S” Sh.p.k., “M E” Sh.p.k. & “K A B” Sh.p.k, për punime të pakryera, parashikuar në kontratën me nr. 836/4, datë 09.06.2020 me objekt “Rindërtimi i objektit Shkolla 9 vjecare dhe kopështi Xhelal Shtufi”.

Menjëherë

Përgjigjia e institucionit:

Grupi i punës, i ngritur me Urdhrin e brendshëm Nr. 48, datë 25.10.2022, ka konstatuar që edhe pse kjo gjetje lidhet me kontratë me tipologji “me çelësa në dorë”, vëren se këto janë diferenca në volume për punime të deklaruar të kryera pasi është miratuar një projekt zbatim, dhe si të tillë duheshin kryer. Me urdhrin e brendshëm nr. 22, datë 27.03.2023, të drejtorit ekzekutiv, është urdhëruar ndjekja e të gjithë procedurave administrative dhe ligjore për kthimin në buxhetin e shtetit të vlerës së sipër përmendur.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe është **zbatuar**.

11.1. Rekomandim: FSHZH të marrë masa të arkëtojë vlerën prej 385,439 lekë pa TVSh nga BOE “A B” Sh.p.k. & “L” Sh.p.k., për punime të pakryera, parashikuar në kontratën me nr. 1194, datë 09.06.2020 me objekt “Rindërtimi i objekteve të reja me 2 kate mbi tokë të shkollës 9vjecare Kastrioti dhe kopshti, Derven”.

Menjëherë

Përgjigjia e institucionit:

Grupi i punës, i ngritur me Urdhrin e brendshëm Nr. 48, datë 25.10.2022, ka konstatuar që edhe pse kjo gjetje lidhet me kontratë me tipologji “me çelësa në dorë”, vëren se këto janë diferenca në volume për punime të deklaruar të kryera pasi është miratuar një projekt zbatim, dhe si të tillë duheshin kryer. Me urdhrin e brendshëm nr. 22, datë 27.03.2023, të drejtorit ekzekutiv, është urdhëruar ndjekja e të gjithë procedurave administrative dhe ligjore për kthimin në buxhetin e shtetit të vlerës së sipër përmendur.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe është **zbatuar**.

12.1. Rekomandim: FSHZH të marrë masa të arkëtojë vlerën prej 607,820 lekë pa TVSh nga BOE “A K” Sh.p.k. & “C” Sh.p.k., për punime të pakryera, parashikuar në kontratën me nr. 1332 prot., datë 22.06.2020 me objekt “Rindërtimi i objektit Kopshti “Lidhja e Prizrenit” Kamëz”.

Menjëherë

Përgjigjia e institucionit:

Grupi i punës, i ngritur me Urdhrin e brendshëm Nr. 48, datë 25.10.2022, ka konstatuar që edhe pse kjo gjetje lidhet me kontratë me tipologji “me çelësa në dorë”, vëren se këto janë diferenca në volume për punime të deklaruar të kryera pasi është miratuar një projekt zbatim, dhe si të tillë duheshin kryer. Me urdhrin e brendshëm nr. 22, datë 27.03.2023, të drejtorit ekzekutiv, është urdhëruar ndjekja e të gjithë procedurave administrative dhe ligjore për kthimin në buxhetin e shtetit të vlerës së sipër përmendur.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe është **zbatuar**.

13.1. Rekomandim: FSHZH të marrë masa të arkëtojnë vlerën prej 186,450 lekë pa TVSh nga OE “G C” Sh.p.k., për punime të pakryera, parashikuar në kontratën me nr. 2697 prot. Datë 02.11.2020 me objekt “Riveshje aksi rrugor Çermë-Divjak si dhe degëzimet për në fshatrat: Grabian, Çermë, Shkumbin-Bushcukas, Dushkecan-Hallvaxhias-Gërmenji i Madh”.

Menjëherë

Përgjigjia e institucionit:

Grupi i punës, i ngritur me Urdhrin e brendshëm Nr. 48, datë 25.10.2022, ka konstatuar që edhe pse kjo gjetje lidhet me kontratë me tipologji “me çelësa në dorë”, vëren se këto janë diferenca në volume për punime të deklaruar të kryera pasi është miratuar një projekt zbatim, dhe si të tillë duheshin kryer. Me urdhrin e brendshëm nr. 22, datë 27.03.2023, të drejtorit ekzekutiv, është urdhëruar ndjekja e të gjithë procedurave administrative dhe ligjore për kthimin në buxhetin e shtetit të vlerës së sipër përmendur.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **është zbatuar**.

14.1. Rekomandim: FSHZH të marrë masa që brenda periudhës së garancisë së punimeve, të realizojë vlerën e punimeve prej **255,200 lekë** pa TVSh nga BOE “G” sh.p.k. & “E K” sh.p.k., për punime të pjesërisht të kryera, në të kundërt do të konsiderohet dëm ekonomik parashikuar në kontratën me nr. 2326 prot., datë 02.10.2020 me objekt “Rikualifikimi urban i qendrës së qytetit Ballsh dhe krijimi hapësirave rekreative në zonën e liqenit artificial të qytetit Ballsh”.

Menjëherë

Përgjigjia e institucionit:

Grupi i punës, i ngritur me Urdhrin e brendshëm Nr. 48, datë 25.10.2022, ka konstatuar që edhe pse kjo gjetje lidhet me kontratë me tipologji “me çelësa në dorë”, vëren se këto janë diferenca në volume për punime të deklaruar të kryera pasi është miratuar një projekt zbatim, dhe si të tillë duheshin kryer. Me urdhrin e brendshëm nr. 22, datë 27.03.2023, të drejtorit ekzekutiv, është urdhëruar ndjekja e të gjithë procedurave administrative dhe ligjore për kthimin në buxhetin e shtetit të vlerës së sipër përmendur.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **është zbatuar**.

15.1. Rekomandim: FSHZH të marrë masa të arkëtojnë vlerën prej 148,000 lekë pa TVSh nga OE “V H” sh.p.k., për punime të pakryera, parashikuar në kontratën me nr. 1875 prot., datë 21.08.2020 me objekt “Rikonstruksioni i rrugës Polis dhe Babje në Bashkinë Librazhd”.

Menjëherë

Përgjigjia e institucionit:

Grupi i punës, i ngritur me Urdhrin e brendshëm Nr. 48, datë 25.10.2022, ka konstatuar që edhe pse kjo gjetje lidhet me kontratë me tipologji “me çelësa në dorë”, vëren se këto janë diferenca në volume për punime të deklaruar të kryera pasi është miratuar një projekt zbatim, dhe si të tillë duheshin kryer. Me urdhrin e brendshëm nr. 22, datë 27.03.2023, të drejtorit ekzekutiv, është urdhëruar ndjekja e të gjithë procedurave administrative dhe ligjore për kthimin në buxhetin e shtetit të vlerës së sipër përmendur.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **është zbatuar**.

MASA PËR ELEMENIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1.1. Rekomandim: FSHZH, të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për mos llogaritjen dhe arkëtimin e penalteteve në vlerën 3,651,136 lekë pa TVSH ndaj sipërmarrësit BOE “K C” Sh.p.k. & “C R ” Sh.p.k. & “M” Sh.p.k. & “P G” Sh.p.k. për vonesat në përfundimin e kontratave të sipërmarrjes së punimeve të ndërtimit me nr. 2174 prot., datë 23.09.2020 me objekt rindërtimi i 743 banesave individuale me pasojë përdorimin pa efektivitet dhe eficientë të fondeve publike.

Menjëherë

Përgjigjja e institucionit:

Në zbatim të parashikimeve të nenit 8 të Aktit Normativ 10/2022, për vonesat në zbatimin e kontratave publike, për të cilat shtrihet efektet ky akt normativ, si dhe vonesat në zbatimin e kontratave në kuadër të procesit të rindërtimit, që janë në proces zbatimi nga data 1 janar 2020, nuk do të konsiderohen si shkelje e kushteve kontraktore dhe nuk do të aplikohen penaltete ndaj OE. Raporti i grupit të punës Nr. 3830 Prot., datë 06.12.2022, të ngritur me Urdherin e brendshëm Nr. 48, datë 25.10.2022.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i papranuar**.

1.2. Rekomandim: FSHZH, të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për mos llogaritjen dhe arkëtimin e penalteteve në vlerën 41,034,000 lekë pa TVSH ndaj sipërmarrësit OE “Gj” Sh.p.k. për vonesat në përfundimin e kontratave të sipërmarrjes së punimeve të ndërtimit me nr. 2790 prot., datë 11.11.2020 me objekt rindërtimi i 148 banesave individuale me pasojë përdorimin pa efektivitet dhe eficientë të fondeve publike.

Menjëherë

Përgjigjja e institucionit:

Në zbatim të parashikimeve të nenit 8 të Aktit Normativ 10/2022, për vonesat në zbatimin e kontratave publike, për të cilat shtrihet efektet ky akt normativ, si dhe vonesat në zbatimin e kontratave në kuadër të procesit të rindërtimit, që janë në proces zbatimi nga data 1 janar 2020, nuk do të konsiderohen si shkelje e kushteve kontraktore dhe nuk do të aplikohen penaltete ndaj OE. Raporti i grupit të punës Nr. 3830 Prot., datë 06.12.2022, të ngritur me Urdherin e brendshëm Nr. 48, datë 25.10.2022.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i papranuar**.

2.1. Rekomandim: FSHZH, të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për mos llogaritjen dhe arkëtimin e penalteteve në vlerën 18,013,800 lekë pa TVSH ndaj sipërmarrësit BOE “K K C R & Xh & A & M” Sh.p.k. për vonesat në përfundimin e kontratës e sipërmarrjes së punimeve, të lidhur sipas aktit me nr.1189 prot., datë 09.06.2020 me objekt Rindërtimi i objektit të ri: shkollës së mesme "Arif Halil Sulaj".

Menjëherë

Përgjigjja e institucionit:

Në zbatim të parashikimeve të nenit 8 të Aktit Normativ 10/2022, për vonesat në zbatimin e kontratave publike, për të cilat shtrin efektet ky akt normativ, si dhe vonesat në zbatimin e kontratave në kuadër të procesit të rindërtimit, që janë në proces zbatimi nga data 1 janar 2020, nuk do të konsiderohen si shkelje e kushteve kontraktore dhe nuk do të aplikohen penaltete ndaj OE. Raporti i grupit të punës Nr. 3830 Prot., datë 06.12.2022, të ngritur me Urdherin e brendshëm Nr. 48, datë 25.10.2022.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i papranuar**.

2.2. Rekomandim: FSHZH, të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për mos llogaritjen dhe arkëtimin e penalteteve në vlerën 10,456,807 lekë pa TVSH ndaj sipërmarrësit BOE "RT" Sh.p.k. & "A.E. D" Sh.p.k. & "C M A" Sh.p.k." për vonesat në përfundimin e kontratës e sipërmarrjes së punimeve, të lidhur sipas aktit me nr. 1313 prot., datë 22.06.2020 me objekt rindërtimi i Rezidencës studentore kolektive: tipologjia "Konvikt".

Menjëherë

Përgjigjja e institucionit:

Në zbatim të parashikimeve të nenit 8 të Aktit Normativ 10/2022, për vonesat në zbatimin e kontratave publike, për të cilat shtrin efektet ky akt normativ, si dhe vonesat në zbatimin e kontratave në kuadër të procesit të rindërtimit, që janë në proces zbatimi nga data 1 janar 2020, nuk do të konsiderohen si shkelje e kushteve kontraktore dhe nuk do të aplikohen penaltete ndaj OE. Raporti i grupit të punës Nr. 3830 Prot., datë 06.12.2022, të ngritur me Urdherin e brendshëm Nr. 48, datë 25.10.2022.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i papranuar**.

3.1. Rekomandim: FSHZH, të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për mos llogaritjen dhe arkëtimin e penalteteve në vlerën 19,813,484 lekë pa TVSH ndaj sipërmarrësit BOE "Z" Sh.p.k., & "B N" Sh.p.k. për vonesat në përfundimin e kontratës e sipërmarrjes së punimeve, të lidhur sipas aktit me Nr.3224 Prot. datë 15.12.2020 me objekt rindërtimi e banesave kolektive (njësi banimi pallate).

Menjëherë

3.2. Rekomandim: FSHZH, të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për mos llogaritjen dhe arkëtimin e penalteteve në vlerën 14,114,000 lekë pa TVSH ndaj sipërmarrësit BOE "A K" Sh.p.k. & "B" Sh.p.k. & "R" Sh.p.k., për vonesat në përfundimin e kontratës e sipërmarrjes së punimeve, të lidhur sipas aktit me nr. 3073 prot., datë 04.12.2020 me objekt rindërtimi e banesave kolektive (njësi banimi pallate).

Menjëherë

3.3. Rekomandim: FSHZH, të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për mos llogaritjen dhe arkëtimin e penalteteve në vlerën 14,694,213 lekë pa TVSH ndaj sipërmarrësit BOE "J" Sh.p.k., & "C" Sh.p.k., për vonesat në përfundimin e kontratës e sipërmarrjes së punimeve, të lidhur sipas aktit me nr. 3221 prot., datë 15.12.2020 me objekt rindërtimi e banesave kolektive (njësi banimi pallate).

Menjëherë

3.4. Rekomandim: FSHZH, të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për mos llogaritjen dhe arkëtimin e penalteteve në vlerën 11,311,504 lekë pa TVSH ndaj sipërmarrësit BOE "A-G" Sh.p.k. & "F B & C C" Sh.p.k., për vonesat në përfundimin e kontratës e sipërmarrjes së

punimeve, të lidhur sipas aktit me nr.255 prot., datë 19.01.2021 me objekt rindërtimi e banesave kolektive (njësi banimi pallate).

Menjëherë

3.5. Rekomandim: FSHZH, të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për mos llogaritjen dhe arkëtimin e penalteteve në vlerën 6,975,214 lekë pa TVSH ndaj sipërmarrësit OE “A K” Sh.p.k., për vonesat në përfundimin e kontratës e sipërmarrjes së punimeve, të lidhur sipas aktit me nr. 256 prot., datë 19.01.2021 me objekt rindërtimi e banesave kolektive (njësi banimi pallate).

Menjëherë

Përgjigjja e institucionit:

Në zbatim të parashikimeve të nenit 8 të Aktit Normativ 10/2022, për vonesat në zbatimin e kontratave publike, për të cilat shtrin efektet ky akt normativ, si dhe vonesat në zbatimin e kontratave në kuadër të procesit të rindërtimit, që janë në proces zbatimi nga data 1 janar 2020, nuk do të konsiderohen si shkelje e kushteve kontraktore dhe nuk do të aplikohen penaltete ndaj OE. Raporti i grupit të punës Nr. 3830 Prot., datë 06.12.2022, të ngritur me Urdherin e brendshëm Nr. 48, datë 25.10.2022.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet i **papranuar**.

4.1. Rekomandim: FSHZH të kërkojë riparimin e shtresës me Tartan me vlerë 480,025 lekë pa TVSH nga BOE “U N” Sh.p.k. & “G C” Sh.p.k., për punime të kryera pa cilësi në përputhje me specifikimet teknike në terrenet sportive të shkollës sipas kontratës nr. 835/4 prot., datë 09.06.2020.

Menjëherë

Përgjigjja e institucionit:

Në zbatim të parashikimeve të nenit 8 të Aktit Normativ 10/2022, për vonesat në zbatimin e kontratave publike, për të cilat shtrin efektet ky akt normativ, si dhe vonesat në zbatimin e kontratave në kuadër të procesit të rindërtimit, që janë në proces zbatimi nga data 1 janar 2020, nuk do të konsiderohen si shkelje e kushteve kontraktore dhe nuk do të aplikohen penaltete ndaj OE. Raporti i grupit të punës Nr. 3830 Prot., datë 06.12.2022, të ngritur me Urdherin e brendshëm Nr. 48, datë 25.10.2022.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet i **papranuar**.

5.1. Rekomandim: AK (grupi i punës apo komisioni përkatës), në lidhje me procedurat e prokurimit që do të zhvillojë në vijim, gjatë vlerësimit të ofertave, duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP si dhe me qëllimin e këtij të fundit. Konkretisht, KVO-ja, përpara së të kryejë një skualifikim, në interes të AK, duhet të konsiderojë faktin nëse mangësia e konstatuar në përmbushjen e kriterit përkatës përbën një devijim të vogël, i cili nuk ndryshon thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, duke e kualifikuar në këtë rast si ofertë të vlefshme. FSHZH, të marrë masa dhe të analizojë me grup pune të veçantë, shkaqet dhe arsyet e përdorimit me efekt negativ të fondeve publike në vlerën totale 88,579,378 lekë, nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

I pazbatueshëm, sipas Raporti i grupit të punës Nr. 550/1 Prot., datë 07.03.2023, të ngritur me Urdherin e brendshëm Nr. 48, datë 25.10.2022, ku sqarohet në mënyre të detajuar nga faqja 8 deri në faqen 19 që FSHZH në procedurat e ndjekura ka zgjedhur gjithmonë ofertën më të mirë të kualifikuar dhe ligjore.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i papranuar**.

6.1. Rekomandim: AK (grupi i punës apo komisioni përkatës), në lidhje me procedurat e prokurimit që do të zhvillojë në vijim, gjatë vlerësimit dhe shpalljes së ofertës fituese, duhet të bazohet në aktet ligjore e nënligjore të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”. Konkretisht, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhet analizojë kriteret mbi të cilat kryen vlerësimin e një procedure prokurimi dhe, në rast konstatimi të kriterëve të papabazuar në ligj dhe cënues të mundësisë së konkurrencës efektive, t’i propozojë titullarit anulimin e procedurës për të bërë të mundur shmangien e përdorimit me efekt negativ të fondeve publike.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjia e institucionit:

I pazbatueshëm, sipas Raporti i grupit të punës Nr. 550/1 Prot., datë 07.03.2023, të ngritur me Urdherin e brendshëm Nr. 48, datë 25.10.2022, ku sqarohet në mënyre të detajuar nga faqja 19 deri në faqen 23 që FSHZH në procedurat e ndjekura ka zgjedhur gjithmonë ofertën më të mirë të kualifikuar dhe ligjore, dhe efekti i përdorimit të fondeve bazuar mbi kriteret e kualifikimit dhe vlerësimit, sikurse përcaktuar në DST, ka qenë më shumë se pozitiv.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i papranuar**.

MASA ADMINISTRATIVE

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e ndërtimit, përcaktuar në nenit 7/1 dhe 12, Kreu III, nenet 15 e 16 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar dhe UKM nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu II, Pika 3 (si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në pjesët takuese të Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe komentet e subjektit të audituar), mbështetur në nenin 5 shkronja (b) dhe nenin 9/1, shkronja (a) të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007, i ndryshuar, me nenin 12 të ligjit nr. 183/2014 datë 01.04.2013 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, bazuar në nenin 15 dhe nenin 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për shkelje të ligjshmërisë në mbikëqyrjen e zbatimit të punimeve të ndërtimit, i rekomandojmë Titullarit të Fondit Shqiptar të Zhvillimit (FSHZH), t’i kërkojë Kryeinspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor, sipas kontratave respektive, që të vlerësojë shkeljet e konstatuara:

1. Subjekti BOE “T” Sh.p.k. & “E G” Sh.p.k. & “H” Sh.p.k., përfaqësuar nga OE “T” Sh.p.k., me administrator z. E C me lic. MK, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve për shkeljet e konstatuara si vijon:

- Në kontratën me objekt: “Rikonstruksioni Rrugëve të Brendshme dhe Rikualifikimi i Hapësirave Publike tek Zona e Plazhit të Shkëmbi i Kavajës, Bashkia Durrës”, datë 23.07.2018, diferenca në volume për punime të deklaruara të kryera për zërin e punimeve: “Beton C20/25

për pilota me çimento antisulfat dhe aditiv të betonit për mpiksje të tij, për punime në prezencë uji”, në vlerën 157,065 lekë pa TVSH.

- Në kontratën me objekt “Rivitalizim Urban i Bulevardit Maliq-Drithas”, rezultuan diferenca në volume për punime të deklaruara të kryera në vlerën 233,800 lekë pa TVSH.

Në kontratën me objekt "Rikonstruksioni i Objekteve të Konvikteve në Qytetet: Shkodrës, Korçës Dhe Vlorës", u konstatua se nga ana e sipërmarrësit/kontraktorit nuk janë respektuar termat e referencës për realizimin e punimeve të tre objekteve, konviktit të Korçës, të Vlorës dhe të Shkodrës, në vendosjen e grilave në vlerën 8,894,278 lekë pa TVSH dhe në vendosjen e fuqisë së kaldajës në vlerë prej 3,850,000 lekë pa TVSH.

2. Subjekti BOE “A E” Sh.p.k. & “D P” Sh.p.k. & “M. K.” Sh.p.k., përfaqësuar nga OE “A E” Sh.p.k. me administrator Znj. E Ç, me Lic. MK., në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve në kontratën me objekt: “Rikonstruksioni i rrugës Balldren-Bende-Lezhë”, datë 27.03.2019, lidhur ndërmjet FSHZH dhe BOE “A E” Sh.p.k. “D P” Sh.p.k. & “M.K.” Sh.p.k., për shkeljet e konstatuara si vijon:

- Punime ndërtimi të kryera jo në përputhje me specifikimet teknike në vlerën 136,680 lekë pa TVSH. Kryerje punimesh me cilësi të dobët në vlerën 130,320 lekë pa TVSH, në një gjatësi rreth 825 ml dhe gjerësi 0.5 m, ku sipërmarrësi i punimeve në zbatim të kushteve të kontratës së sipërmarrjes duhet të kryejë riparimin e bankinës së rrugës së dëmtuar në disa segmentet të dëmtuara, duke siguruar realizimin e punimeve me cilësi dhe në përputhje me specifikimet teknike dhe KTZ duke garantuar siguri maksimale të lëvizjes së automjeteve, brenda periudhë së garancisë, në rast të kundërt vlera e mosrealizimit do të konsiderohet dëm ekonomik.

- Në kontratën me objekt: “Ndërtimi i Stacionit të Pompimit, tubacionit kryesor dhe rrjetit shpërndarës të Grabianit, Bashkia Divjakë”, datë 12.06.2019, lidhur ndërmjet ndërmjet FSHZH dhe BOE “A E” Sh.p.k. & “D P” Sh.p.k. & “M.K.” Sh.p.k., për punime ndërtimi të kryera jo në përputhje me specifikimet teknike në vlerë 263,778 lekë pa TVSH.

3. Subjekti BOE “T” Sh.p.k. me licence nr. MK. me administrator z. I K & “6DP” Sh.p.k. dhe nga z. S. K në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve në kontratën me objekt: “Shkolla 9-vjeçare & Kopshti “Dan Bajrami” Laç, Kurbin” në kontratën me Nr. 1273 Prot, Datë 17.06.2020, lidhur ndërmjet FSHZH dhe BOE “T” Sh.p.k. & “6DP” Sh.p.k., për shkeljen e konstatuar si vijon:

a) Punime ndërtimi të kryera jo në përputhje me specifikimet teknike në vlerë 480,025 lekë pa TVSH.

4. Subjekti OE “I D - A” Sh.p.k. me administrator z. D. H, me Lic. MK. në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve në kontratën me objekt: “Rikonstruksion i Rrugës Çamëria dhe i Unazës së qytetit Kavajë” me nr. 3106 prot., datë 07.12.2020, lidhur ndërmjet FSHZH dhe OE “I D - A” Sh.p.k., për shkeljen e konstatuar si diferenca në volume në punimet e ndërtimit të rrugës dhe të trotuarit krahasuar me volumet e situacionuara në vlerën 254,420 lekë pa TVSH.

5. Subjekti BOE “G B C E” Sh.p.k. & “S S” Sh.p.k. përfaqësuar nga “G B C E” Sh.p.k., me administrator z. G. B me nr. licence MK, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve për shkeljet e konstatuara si vijon:

- Në kontratën me objekt: “Rindërtimi i objektit “Shkolla 9-vjeçare dhe kopshti “Ramazan Jangozi” Njësia Administrative Thumanë” sipas aktit 1216 prot., datë 10.06.2020, lidhur ndërmjet FSHZH dhe BOE “G B C E” Sh.p.k. & “S S” Sh.p.k., diferenca në volume në punimet e ndërtimit të rrugës dhe të trotuarit krahasuar me volumet e situacionuara në vlerën 260,679 lekë pa TVSH.

- Në kontratën me objekt “Rindërtimi i objekteve të reja me 2 kate mbi tokë të shkollës 9-vjeçare Kastrioti dhe kopshti, Derven”, rezultuan diferenca në volume për punime të deklaruara të kryera për zërat e punimeve, në vlerën 385,439 lekë pa TVSH.

6. Subjektit BOE "I" Sh.p.k., me Lic. MK. me administratore Ing. F. V & "A" Sh.p.k., me Lic. MK. me administratore Ing. I. M, BOE përfaqësohet nga OE "I" Sh.p.k. me administratore Znj. F. V, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve për shkeljet e konstatuara si vijon:

- Në kontratën me objekt: "Rindërtimi i objektit "Rindërtim i kopshtit "Halit Çoka" Kamëz" sipas kontratës me nr. 1383 prot., datë 26.06.2020, lidhur ndërmjet FSHZH dhe BOE "I" Sh.p.k & "A" Sh.p.k, për shkeljet e konstatua diferenca në volume në punimet e ndërtimit të rrugës dhe të trotuarit krahasuar me volumet e situacionuara në vlerën 269,640 lekë pa TVSH. Punime të kryera jo sipas specifikimeve teknike, për zërin "Kaldajë me lëndë djegëse me pelet" në vlerën 4,000,000 lekë pa TVSH, duke mundësuar përdorimin e buxhetit të FSHZH jo në përputhje me parimin e 3-E me Eficencë, Efektivitet, Ekonomicitet, në kontratën nr. 1332 prot., datë 22.06.2020 me objekt "Rindërtimi i objektit "Rindërtim i kopshtit "Halit Çoka" Kamëz", me sipërmarrës punimesh BOE "A K" Sh.p.k. & "C" Sh.p.k. përfaqësuar nga OE "C" Sh.p.k..

- Në kontratën me objekt "Rindërtimi i objektit Kopshti "Lidhja e Prizrenit" Kamëz", rezultuan diferenca në volume për punime të deklaruara të kryera për zërin e punimeve: "Gjeneratori 25 KVA" dhe në "Impiantin e Ventilimit" në vlerën 607,820 lekë pa TVSH.

- Në kontratën me objekt "Rikualifikimi urban i qendrës së qytetit Ballsh dhe krijimi hapësirave rekreative në zonën e liqenit artificial të qytetit Ballsh", u konstatuan punime pjesërisht të kryera dhe jo sipas specifikimeve teknike në vlerën 255,200 lekë pa TVSH.

7. Subjektit BOE "S" Sh.p.k. & "A" Sh.p.k. & "I" Sh.p.k., me Lic. MK. me administrator Ing. A. T, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve për shkeljen e konstatuar si vijon:

- Në kontratën me objekt "Riveshje aksi rrugor Çermë-Divjak si dhe degëzimet për në fshatrat: Grabian, çermë, Shkumbin-Bushcukas, Dushkecan-Hallvaxhias-Gërmenji i Madh", rezultuan diferenca në volume për punime të deklaruara të kryera në vlerën 186,450 lekë pa TVSH.

8. Subjektit BOE "K" Sh.p.k. & "G R A", me Lic. MK. me administrator Ing. H. A, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve për shkeljen e konstatuar si vijon:

- Në kontratën me objekt "Rikonstruksioni i rrugës Polis dhe Babje në Bashkinë Librazhd", u konstatuan punime të pakryera në vlerën 148,000 lekë pa TVSH.

9. Subjekti BOE "N G" Sh.p.k. & "A" Sh.p.k., me nr. licence MK., përfaqësuar nga OE "N G" Sh.p.k., me administrator z. V. B, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve në kontratën me nr. 1277 prot., datë 17.06.2020 me objekt: "Shkolla 9-vjeçare dhe kopshti "Adem Gjeli" Ishëm, Durrës", lidhur ndërmjet FSHZH dhe BOE "N G" Sh.p.k. & "A" Sh.p.k., për shkeljet e konstatuara si vijon:

a) Diferenca në volume në punimet e ndërtimit të rrugës dhe të trotuarit krahasuar me volumet e situacionuara në vlerën 693,174 lekë pa TVSH me pasojë dëm ekonomik në kontratën nr. 836/4 prot., datë 09.06.2020 me objekt "Shkolla 9-vjeçare dhe kopshti "Adem Gjeli" Ishëm, Durrës", me sipërmarrës punimesh BOE "T B C" Sh.p.k. & "V H" Sh.p.k. & "C-B" Sh.p.k. & "S" Sh.p.k., "M E" Sh.p.k. & "K AB" Sh.p.k., përfaqësuar nga OE "T B C" Sh.p.k..

b) Punime të kryera jo sipas specifikimeve teknike, në vlerën prej 2,452,000 lekë pa TVSH, në shkollën Shkolla 9-vjeçare dhe kopshti "Adem Gjeli" Ishëm, Durrës" dhe Rindërtimi i objektit Shkolla 9 vjeçare dhe kopështi Xhelal Shtufi".

Përgjigjia e institucionit:

Sipas Raporti i grupit të punës të FSHZH, Nr. 550/1 Prot., datë 07.03.2023, të ngritur me Urdhrin e brendshëm Nr. 48, datë 25.10.2022, theksohet se mbështetur në kuadrin ligjor dhe rregullator mbi të cilin KLSH funksionon, specifikisht nenet 15-18 të ligjit nr. 154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", ky institucion ka të drejtën dhe detyrimin për t'iu drejtuar institucioneve shtetërore për referimin e shkeljeve të konstatuara në rastin e auditiveve sikurse mund të jetë rasti i adresimit dhe Rekomandimt të gjetjeve të Agjencia e Prokurimit Publik.

Në argumentim të këtij vlerësimi është e nevojshme të sqarojmë se FSHZH nuk ka marrëdhënie institucioni epror apo varësie me Kryeinspektorët e Inspektorateve të Mbrojtjes së Territorit Vendor (sipas ndarjeve përkatëse), dhe si e tillë, referimi (apo kërkimi) i këtij Rekomandim të kryeinspektorët e IMTV-e do të evidentonte gjetjen e bërë nga grupi i auditivit të KLSH (përfshirë kërkimin e informacioneve shtesë për këtë gjetje).

Përsa më sipër, duke pasur parasysh edhe kuadrin ligjor të mësipërm, GP vlerëson se ky rekomandim nuk bie tashmë mbi autoritetin kontraktor, i cili është vetëm institucion zbatues, por është plotësisht i mundshëm dhe në fakt detyrë e grupit të auditivit apo strukturave të tjera të KLSH për t'u ndjekur.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i papranuar**.

MASA DISIPLINORE

Mbështetur në ligjin nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës”, i ndryshuar, nenet 37, 141 e 153 pikat 1 dhe 2, kontratave individuale të punës, neni 13, pika 2.c dhe 2.d, për shkeljet e evidentuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, i rekomandojmë Drejtorit Ekzekutiv të Fondit Shqiptar të Zhvillimit, që t’i kërkojë Komisionit Disiplinor, pranë Institucionit Tuaj, që bazuar në performancën e secilit punonjës dhe të shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për çdo punonjës të atakuar dhe marrjen e masave disiplinore përkatëse.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i papranuar**.

KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve në Fondin Shqiptar të Zhvillimit për Raportin Përfundimtar të Auditimit “Për auditimin financiar dhe të përputhshmërisë” dërguar me shkresën nr. 1419/1 prot., datë 17.01.2022, i ndryshuar, rezulton se subjekti i audituar ka respektuar afatin 20 ditor për hartimin e planit të masave për zbatimin e rekomandimeve në përputhje me kërkesat e nenit 15 shkronja (j) të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, si dhe ka respektuar afatin për njoftimin brënda 6 muajve mbi ecurinë e zbatimit të këtyre masave, në përputhje me kërkesat e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Konkretisht ecuria e zbatimit të rekomandimeve paraqitet sipas tabelës “Ecuria e zbatimit të rekomandimeve”

lekë

Masa	Gjithsej		Pranuar		Zbatuar plotësisht		Pjesërisht		Në proces		Pa zbatuar	
	Nr	Vlerë	Nr	Vlerë	Nr	Vlerë	Nr	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr	Vlerë
Organizative	42	-	7	-	4	-	-	-	3	-	-	-
Shpërblim Dëmi	21	23,729,475	19	6,985,197	19	2,452,000	-	-	-	-	-	-
Eliminimi i efekteve financiare negative	12	303,365,996	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Administrative	1	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Disiplinore	1	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Gjithsej	77	327,095,471	26	6,985,197	23	2,452,000	-	-	3	-	-	-

Sa më sipër rezulton se janë dhënë gjithsej 77 rekomandime të cilët janë pranuar plotësisht 26 (34%) dhe rezultojnë të zbatuar plotësisht 23 masa (88.5%).

Për të gjitha rekomandimet që konsiderohen në proces zbatimi, inkurajohet përshpejtimi i realizimit të plotë të tyre.

3.12 CIRKU I TIRANËS

PËRMBLEDHJE

Në zbatim të Programit të Auditimit nr.613/16 prot., datë 06.07.2023, “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e evaduara në 6-mujorin e parë të vitit 2022”, në ambientet e institucionit, më datë 25.07.2023, u mbajt aktverifikimi nga audituesit e autorizuar të KLSH-së z. J.K dhe z. S.K, me përfaqësues nga subjekti z. K. Y. në cilësinë e Titullarit të institucionit dhe znj. M. D., e autorizuar për trajtimin e rekomandimeve të KLSH-së.

Objekt i këtij akt verifikimi është:

Verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të KLSH të lëna me shkresën nr. 1129/22 prot., datë 06.06.2022 për Raportin Përfundimtar të Auditimit “Për auditimin tematik” të ushtruar në Ministrinë e Kulturës dhe Cirkun Kombëtar, sipas programit të auditimit nr.1129/2 prot., datë 25.10.2021, për veprimtarinë nga data 01.01.2019 deri në 30.09.2021, në lidhje mbi statusin e zbatimit të rekomandimeve, afateve dhe niveli i zbatueshmërisë së tyre, koherencën e tyre si dhe përgjegjshmërinë menaxheriale referuar standardeve të auditimit.

Auditimi u krye nga:

1. J.K
2. S.K

Auditimi ka filluar më datë 07.07.2023

Auditimi ka përfunduar më datë 25.07.2023

Auditimi është kryer në bazë të Programit të Auditimit të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit nr.613/16 prot., datë 06.07.2023 me objekt: “Mbi verifikimin e zbatimit të rekomandimeve”, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” si dhe në zbatim të Rregullores së Procedurave të Auditimit dhe të Manualit për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të auditimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe Regjistrisë elektronik institucionale, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 67, datë 13.06.2020.

TRAJTIMI I ÇËSHTJEVE TË AUDITIMIT

Nga auditimi i ushtruar në Ministrinë e Kulturës dhe Cirkun Kombëtar, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, “Mbi auditimin tematik” për periudhën 01.01.2019 deri në 30.09.2021, trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin nr.89, datë 02.06.2022, të Kryetarit të KLSH-së të cilat janë përcjellë me shkresën nr 1129/22 prot., datë 06.06.2022, rezulton se:

I. Hartimi i programit (Plan veprimit) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në nenin 15 shkronja (j) të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Nga auditimi u konstatua se Ministria e Kulturës ka miratuar planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, duke e dërguar në KLSH me shkresë nr. 6661/3 prot., datë 24.06.2022, kjo në përputhje me ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” nenit 15, shkronja j.

Sa më sipër rezulton se është zbatuar afati 20 ditor përkthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve.

II. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Në lidhje mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve dhe afatet e përcaktuara, sipas strukturave përgjegjëse, Ministria e Kulturës ka përgatitur planin e masave të marra lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të miratuara nga titullari brenda afatit 6 mujor, duke e dërguar në KLSH me nr. 6742 prot., datë 09.12.2022, kjo në përputhje me ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” nenit 30, pika 2 e tij.

Sa më sipër rezulton se është zbatuar afati 6 mujor për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve.

III. Realizimi i rekomandimeve

Nga ana e KLSH-së, me shkresat përcjellëse janë lënë 6 masa organizative, 1 masë shpërblim dëmi, 2 masa disiplinore. Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

- a) Për përmirësimin e gjendjes është lënë 6 Masa organizative nga ku 6 rekomandime, të cilat kanë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon, 5 zbatuar, 1 në proces zbatimi.
- b) Për përmirësimin e gjendjes është lënë 1 Masë shpërblim dëmi në vlerën 957,659 lekë, nga ku 1 rekomandim, i cili ka statusin e ecurisë së zbatimit si vijon, 1 në proces zbatimi në vlerën 957,659 lekë.
- c) Për përmirësimin e gjendjes është lënë 2 Masa disiplinore nga ku 2 rekomandime, të cilat kanë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon, 1 zbatuar, 1 pa zbatuar

Rekomandim 1.1: Ministria e Kulturës dhe Cirku Kombëtar të marrin masa që të kenë informacion nga përfaqësuesit e autorizuar, për çdo seancë, në lidhje me ecurinë e proceseve gjyqësore dhe njëkohësisht të marrin masa që përfaqësuesit ligjor të institucionit të jenë prezent në çdo seancë gjyqësore në proceset në ndjekje

Në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Institucioni i Cirkut Kombëtar ka bërë autorizimet për ndjekjen e proceseve gjyqësore.

Autorizimi Nr.235 Prot, datë 16.05.2022, autorizon Znj.F. I.

Autorizimi Nr.113 Prot, datë 26.05.2023, autorizon Znj.F. I.

Proceset gjyqësore të Cirkut Kombëtar janë në ndjekje e sipër nga Znj.F. I.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

Rekomandim 2.1: Ministria e Kulturës dhe Cirku Kombëtar të marrin masa që qëndrimet në lidhje me proceset gjyqësore, ti nënshtrohen shqyrtimit të hallkave institucionale përgjegjëse, para se të dërgohen në gjykatë, me qëllim që përfaqësimi ligjor të jetë sa më i plotë dhe efektiv.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Proceset gjyqësore të Cirkut Kombëtar janë në ndjekje e sipër nga Znj. F.I., nr. 113 Prot., datë

26/05/2023.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

Rekomandim 3.1: Cirku Kombëtar të hartoj një metodologji për procedurën e dërgimit të praktikave protokollare te titullari i institucionit dhe kalimin e këtyre praktikave te strukturat përgjegjëse, me qëllim dokumentimin e procesit dhe përcaktimin e përgjegjësive.

Menjëherë

Përgjigjja e institucionit:

Cirku Kombëtar ka hartuar metodologjinë e duhur për dërgimin e praktikave protokollare tek strukturat përgjegjëse për trajtim, sipas bazës ligjore në fuqi, duke aplikuar kartelën shoqeruese. Modeli i kartelës shoqeruese.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **zbatuar**.

4.1. Rekomandim: Sektori i Shërbimeve Mbështetëse në Cirkun Kombëtar të marrë masa për plotësimin e dosjeve të personelit me dokumentacionin e nevojshëm (fleta prezantuese e dosjes së punonjësit) dhe përfshirjen e datës së dhënies së pagës në kontratat individuale të punës tip, sipas bazës ligjore në fuqi.

Përgjigjja e institucionit:

Në zbatim të marrjes së masave për rekomandimet e KLSH, ka dalë urdhri i brendshëm nr. 351 prot., më datë 11.11.2022, bazuar në të cilën Sektori i Shërbimeve Mbështetëse ka plotësuar dosjet e personelit me dokumentacionin e nevojshëm. Është përfshirë data e dhënies së pagës kur janë bërë kontrata individuale të punës.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **zbatuar**.

5.1. Rekomandim: Sektori Artistik në Cirkun Kombëtar të kryejë vlerësime në vijimësi nga Mjeshtrat e Profilit për akrobatët e rekrutuar rishtazi në institucion dhe çdo ndryshim në kategori të jetë i mbështetur në vlerësimet dhe relacionet e profesionistëve përkatës.

Në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Me shkresën nr. 352 prot., datë 11.11.2022, Sektori Artistik i cirkut ka kryer vlerësimet për akrobatët e rekrutuar rishtazi dhe çdo ndryshim në kategori është bërë në përputhje me vlerësimet dhe relacionet e mjeshtrave të cirkut. Procedura e plotë e vlerësimit të akrobatëve të rekrutuar rishtazi. Procedura e plotë e kategorizimit të akrobatëve.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **zbatuar**.

6.1. Rekomandim: Ministri i Kulturës të marrë masa për të çelur dhe zhvilluar procedurën e konkurrimit për zgjedhjen e Drejtorit të Cirkut Kombëtar dhe propozimin e kandidaturës

fituese pranë Këshillit të Ministrave për emërim, në përputhje me nenin 9/3 të Ligjit 10352, datë 18.11.2010 “Për artin dhe Kulturën”, i ndryshuar.

Menjëherë

Përgjigjja e institucionit: Është emëruar drejtori i ri i Cirkut Kombëtar me vendim nr.229, datë 13.04.2023 i përcjellur me shkresën nr.1672 prot., datë 14.04.2023, sipas praktikës së duhur.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **zbatuar**

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1.1. Rekomandim Ministria e Kulturës dhe Cirku Kombëtar të marrin të gjitha procedurat ligjore për evidentimin e vlerës së pjesës së djegies së karburantit, e cila mungon dhe arkëtimin e vlerës nga personat të cilët kanë pasur përgjegjësi për ruajtjen.

Menjëherë

Përgjigjja e institucionit:

Në proces ndjekjeje (me urdhrin e brendshëm të Drejtorit të Cirkut Kombëtar nr. 360 prot., datë 06.12.2022 është urdhëruar ngritja e komisionit për verifikimin e inventarit të materialeve të cirkut të zhvendosura.)

Komenti i grupit të auditimit:

Nuk është evidentuar vlera e pjesës së djegies së karburantit, e cila mungon, si dhe arkëtimin e kësaj vlere nga personat të cilat kanë pasur përgjegjësi për ruajtjen.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

MASA DISIPLINORE

PËR PUNONJËSIT NË MARRËDHENIE PUNE

C.1.1. Për punonjësit të cilët janë pjesë e shërbimit civil, mbështetur në nenet 57-60 të Ligjit nr. 153/2013 “Për nëpunësin civil” dhe VKM nr. 115, datë 5.3.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, kërkojmë të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore: - Për Znj. J.S., me detyrë Specialiste në Sektorin e Ankesave Administrative dhe Gjyqësore, në Ministrinë e Kulturës; Për moszbatim të përcaktimeve të pikës 3 të nenit 46 të Rregullores së Organizimit dhe Funksionimit të Brendshëm të Ministrisë së Kulturës, në lidhje me përfaqësimin në gjykatë për procesin gjyqësor me palë paditëse Shoqëria “U” shpk dhe palë e paditur Cirku Kombëtar.

Përgjigjja e institucionit:

Me shkresën nr.6147/1 datë 23.11.2022 është vendosur pezullimi nga shërbimi civil i znj. J.S

Komenti i grupit të auditimit:

Pezullimi nga shërbimi civil, ka ardhur si rezultat i kërkesës së znj. J.S për pezullim nga shërbimi civil për një periudhë 2 vjeçare, dhe jo si efekt i fillimit të procedurave për marrjen e masës disiplinore, siç është kërkuar nga Kontrolli i Lartë i Shtetit. Pavarësisht se znj. J.S ka

kërkuar pezullimin e statusit, institucioni përgjegjës duhej të dilte me masë disiplinore, bazuar nga gjetjet e auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pa zbatuar**.

PËR PUNONJËSIT E LARGUAR

Për ish punonjësit e mëposhtëm nuk rekomandojmë masa disiplinore edhe sepse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi personat e sipërpërmendur nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien e zbatimit të tyre. Nga ana jonë në bazë të shkeljeve të konstatuara masa disiplinore do të ishte ndërprerje e marrëdhënieve të punës përkatësisht:

- Për Z. I.GJ., me detyrë Drejtor i Cirkut Kombëtar, liruar nga detyra me VKM-në nr. 790, datë 15.12.2021, me propozim të Ministrit të Kulturës.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve në Ministrinë e Kulturës dhe Cirkun Kombëtar për Raportin Përfundimtar të Auditimit “Për auditimin tematik” dërguar me shkresën nr. 1129/2 prot., datë 25.10.2021, rezulton se subjekti i audituar ka respektuar afatin 20 ditor për hartimin e planit të masave për zbatimin e rekomandimeve në përputhje me kërkesat e nenit 15 shkronja (j) të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, si dhe ka respektuar afatin për njoftimin brënda 6 muajve mbi ecurinë e zbatimit të këtyre masave, në përputhje me kërkesat e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Konkretisht ecuria e zbatimit të rekomandimeve paraqitet sipas tabelës “Ecuria e zbatimit të rekomandimeve”

lekë

Masa	Gjithsej		Pranuar		Zbatuar plotësisht		Pjesërisht		Në proces		Pa zbatuar	
	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë
Organizative	6	-	6	-	5	-	-	-	1	-	-	-
Shpërblim dëmi	1	957,659	1	957,659	-	-	-	-	1	957,659	-	-
Disiplinore	2	-	2	-	1	-	-	-	-	-	1	-
Gjithsej	9	957,659	9	957,659	6	-	-	-	2	957,659	1	-

Sa sipër rezulton se janë dhënë gjithsej 9 rekomandime të cilët janë pranuar plotësisht (100 %), dhe rezultojnë të zbatuar plotësisht 6 masa (66.7 %).

Për të gjitha rekomandimet që konsiderohen në proces zbatimi, inkurajohet përshpejtimi i realizimit të plotë të tyre.

Për sa më sipër ri kërkojmë që Cirku Kombëtar në bashkëpunim ndërinstitucional me Ministrinë e Kulturës të marrë të gjitha masat e nevojshme me qëllim zbatimin e të gjitha rekomandimeve që rezultojnë të pazbatuara brenda 3-mujorit të parë të vitit 2024. Si dhe kërkojmë marrjen e masave disiplinore për zyrtarët përgjegjës, në lidhje me rekomandimet e KLSH të pranuar prej institucionit dhe që efektivisht rezultojnë të pa zbatuara.

3.13 DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMIT TË PROVËS

PËRMBLEDHJE

Në zbatim të Programit të Auditimit nr.613/28 prot., datë 06.07.2023 “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e evaduara në 6-mujorin e parë të vitit 2022”, në ambientet e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Provës, më datë 31.07.2023, u mbajt aktverifikimi nga audituesit e autorizuar të KLSH-së S.K dhe J.K anëtarë, me z. E. H.në cilësinë e Titullarit të institucionit, Drejtor i Përgjithshëm.

Objekt i këtij akt verifikimi është:

Verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të KLSH të lëna me shkresën nr. 935/13, datë 11.04.2022 për Raportin Përfundimtar të Auditimit me objekt “*Mbi auditimin e përputhshmërisë*” të ushtruar në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Provës, për veprimtarinë nga data 01.01.2020 deri më datë 31.12.2021, në lidhje mbi statusin e zbatimit të rekomandimeve, afateve dhe niveli i zbatueshmërisë së tyre, koherencën e tyre si dhe përgjegjshmërinë menaxheriale referuar standardeve të auditimit

Auditimi u krye nga:

1. S.K

2. J.K

Auditimi ka filluar më datë 07.07.2023

Auditimi ka përfunduar më datë 27.07.2023

Auditimi është kryer në bazë të Programit të Auditimit të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit nr.613/28 prot., datë 06.07.2023 me objekt: “Mbi verifikimin e zbatimit të rekomandimeve”, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” si dhe në zbatim të Rregullores së Procedurave të Auditimit dhe të Manualit për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të auditimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe Regjistrisë elektronike institucionale, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 67, datë 13.06.2020.

TRAJTIMI I ÇËSHTJEVE TË AUDITIMIT

Nga auditimi i ushtruar në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Provës, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, “*Mbi auditimin e përputhshmërisë*” për periudhën 01.01.2018 deri më datën 30.06.2021 trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin nr.57, datë 07.04.2022, të Kryetarit të KLSH-së të cilat janë përcjellë me shkresën nr.935/13, datë 11.04.2022, verifikohet se:

I. Hartimi i programit (Plan veprimit) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në nenin 15 shkronja (j) të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Nga auditimi u konstatua se, subjekti ka miratuar planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, duke e dërguar në KLSH me shkresë nr.701/1 datë 29.04.2022 kjo në përputhje me me ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” nenit 15, shkronja j.

Sa më sipër rezulton se është zbatuar afati 20 ditor për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve.

II. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Në lidhje mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve dhe afatet e përcaktuara, sipas strukturave përgjegjëse, DPSHP ka përgatitur planin e masave të marra lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të miratuara nga titullari brenda afatit 6 muaj por nuk e ka dërguar me shkresë pranë KLSH-së, në kundërshtim me ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për

organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” pika 2 e nenit 30.

Sa më sipër rezulton se nuk është zbatuar afati 6 mujor për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve.

III. Realizimi i rekomandimeve

Nga ana e KLSH-së, me shkresat përcjellëse janë 17 Masa Organizative, 1 Masë për shpërblim dëmi, 4 Masa për menaxhimin e Efektivitetit dhe Ekonomicitetit të Fondeve Buxhetore dhe 1 Masë Disiplinore. Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

- a) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 17 Masa organizative nga ku 28 rekomandime, janë pranuar plotësisht 28 rekomandimet, të cilat kanë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon, 27 Zbatuar, 1 pa zbatuar.
- b) Për përmirësimin e gjendjes është lënë 1 Masë shpërblim dëmi nga ku 1 rekomandim, i cili është pranuar plotësisht dhe ka statusin e ecurisë së zbatimit si vijon, 1 në proces zbatimi.
- c) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 3 Masa për menaxhimin e Efektivitetit dhe Ekonomicitetit të Fondeve Buxhetore nga ku 4 rekomandime, të cilat janë pranuar plotësisht dhe kanë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon, 4 zbatuar.
- d) Për përmirësimin e gjendjes është lënë 1 Masë Disiplinore, e cila është pranuar dhe është zbatuar plotësisht.

Më hollësisht, auditimi i ndjekjes së rekomandimeve paraqitet si vijon:

MASA ORGANIZATIVE

1.1. Rekomandim: Nëpunësi Zbatues i DPSHP të marrë masat të paraqesë në strukturën e thesarit dokumentacionin justifikues të shpenzimeve për rastet e pagesave ndaj operatorëve ekonomikë, brenda 30 ditëve nga data e faturës origjinale të OE, dhe jo ndryshe, me qëllim respektimin e disiplinës buxhetore dhe shmangien e riskut për krijimin e detyrimeve të prapambetura.

Në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës nuk ka likujduar fatura që kanë kaluar afatin 30 ditor dhe nuk ka detyrime të prapambetura të krijuara rishtazi.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

2.1. Rekomandim: DPSHP të marrë masa për nxjerrjen e një regjistri të plotë të aktiveve që zotëron, sipas llojit, grupit dhe formatit të dispozitave ligjore në fuqi në funksion të evidentimit të jetëgjatësisë së përdorimit të aktiveve nga institucioni dhe monitorimit të llogaritjes së amortizimit vjetor.

Menjëherë

Përgjigja e institucionit:

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës ka nxjerrë regjistër të plotë të aktiveve që zotëron. (Bashkëlidhur regjistri i aktiveve)

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

3.1. Rekomandim: DPSHP të marrë masat që përpara raportimit të pasqyrave financiare të institucionit, të bëjë rakordimin e gjendjes fizike me gjendjen kontabël, në funksion të ruajtjes dhe mbrojtjes së aktiveve në pronësi të saj.

Në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Drejtorja e Përgjithshme e Shërbimit të Provës ka rakorduar gjendjen fizike dhe asaj kontabile. (Bashkëlidhur memo nr. 231, datë 27.01.2023 dhe raport mbi inventarizimin fizik nga komisioni i inventarizimit).

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

3.2. Rekomandim: Titullari i institucionit të DPSHP-së të marrë masa në vazhdimësi, që menjëherë pas marrjes së relacionit nga Komisioni i inventarizimit, të nxjerrë urdhrat për ngritjen e komision për vlerësimin e aktiveve, si dhe nëse konstatohen aktive të dëmtuara ngritjen e komisionit të nxjerrjes jashtë përdorimi.

Në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Drejtorja e Përgjithshme e Shërbimit të Provës ka ngritur komision për vlerësimin e aktiveve. (Bashkëlidhur urdhri nr. 155, datë 15.11.2022 “Për ngritjen e komisionit të vlerësimit të mjetit të transportit jashtë përdorimit në DPSHP”).

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

4.1. Rekomandim: DPSHP të marrë masat që në ngritjen e komisionit të inventarizimit të verifikojë dhe vërtetojë mungesën e konfliktit të interesit, për të ruajtur plotësinë e aktiveve dhe regjistrimin e duhur në dokumentet kontabël.

Në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Drejtorja e Përgjithshme e Shërbimit të Provës ka ngritur urdherin nr.132, datë 20.09.2022 “Për inventarizimin e aktiveve. (Bashkëlidhur urdhri për ngritjen e komisionit të inventarizimit).

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

5.1. Rekomandim: Drejtorja e Financës së DPSHP-së të marrë masa në vijimësi për paraqitjen e saktë të llogarisë 601 “Kontribute të Sigurimeve Shoqërore” në akt-rakordimin me thesarin.

Menjëherë e në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Drejtorja e Përgjithshme e Shërbimit të Provës bën çdo muaj akt-rakordim me thesarin.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

5.2. Rekomandim: Drejtorja e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse së DPSHP-së të marrë masa për sistemimin e shumës 10,751,043 lekë, e cila është njohur dy herë në pasqyrat financiare.

Menjëherë e në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Drejtorja e Përgjithshme e Shërbimit të Provës e ka sistemuar shumën 10.751.043 lekë ne

bilancin e vitit 2021.(Bashkëlidhur aktivi-pasivi i bilancit të vitit 2021).

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

5.3. Rekomandim: Drejtorja e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse të DPSHP-së të marrë masa për sistemimin e shumës 828,000 lekë, në llogarinë 230 “Investime për Aktive Afatgjata jo materiale” dhe të mbahet në këtë llogari deri në momentin e kolaudit dhe të marrjes në dorëzim të “Ndërtimit të shtesës anësore dhe të shtesës së kati për Shërbimin e Provës”. Pasi DPSHP të marrë në dorëzim këtë investim, nga financa të bëhet veprimi kontabël dukë kredituar llogarinë 230 “Investime për Aktive Afatgjata jo materiale” dhe debituar llogarinë 212 “Ndërtesa dhe Konstruksiione”.

Menjëherë e në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Drejtorja e Përgjithshme e Shërbimit të Provës e ka sistemuar shumën 828.000 lekë në llogarinë 230 “Investime për Aktive Afatgjata jo materiale” dhe më pas tek llogaria 202 “Studime dhe kërkime” në bilancin e vitit 2021. (Bashkëlidhur aktivi-pasivi i bilancit të vitit 2021).

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

5.4. Rekomandim:Drejtorja e Financave dhe Shërbimeve Mbështetëse te marrë masa për evidentimin e saktë aktiveve, që nuk janë amortizuar sipas normave të lejuara kontabël, duke u analizuar arsyet dhe lidhur rezultatet e nxjerra me aktivet përkatëse, konform parimeve kontabël dhe dispozitave ligjore në fuqi.

Menjëherë e në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Drejtorja e Përgjithshme e Shërbimit të Provës ka nxjerrë regjistër të plotë të aktiveve që zotëron dhe ka llogaritur amortizim në bazë të normave ligjore. (Bashkëlidhur regjistri i aktiveve me amortizimin përkatës) .

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

5.5. Rekomandim: Drejtorja e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse së DPSHP-së të marrë për sistemimin e diferencave të konstatuara në zërat e pasqyrës së flukseve monetare dhe ndryshimeve të aktiveve neto të vitit 2020.

Menjëherë e në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Drejtorja e Përgjithshme e Shërbimit të Provës ka sistemuar diferencat e konstatuara në zërat e pasqyrës së flukseve monetare dhe ndryshimeve të aktiveve neto te vitit 2021. (Bashkëlidhur pasqyra e flukseve monetare të bilancit të vitit 2021).

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

6.1. Rekomandim: Ministria e Drejtësisë si organ qendror në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Provës, në cilësinë e institucionit të varësisë, të marrë masa për personat e ngarkuar me përgjegjësi, në lidhje me mangësitë e konstatuara gjatë procesit të

zbatimit të kontratës nr.01/7 prot., datë 13.06.2017 me objekt “Rikonstruksion, ndërtim shtese anësore si dhe shtesë kati në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Provës”, me qëllim menaxhimin me efektivitet, ekonomicitet dhe eficiencë të fondeve buxhetore dhe shmangien e risqeve financiare në Buxhetin e Shtetit.

Menjëherë

Përgjigja e institucionit:

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës e ka penalizuar OE“C.”shpk për dorëzim të vonuar të punimeve.(Bashkëlidhur memo nr.372, datë 01.03.2022).

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

6.2. Rekomandim: Të merren masat nga DPSHP dhe të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe ligjore për njoftimin e OE “C.” SHPK, për vendosjen penaltetit në vlerën prej 9,434,247.96 lekë, si pasojë e vonesave në dorëzimin në kohë të objektit, e cila do të mbahet nga pagesa e mbetur e pa realizuar ende nga DPSHP.

Menjëherë

Përgjigja e institucionit:

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës ka njoftuar OE “C.”shpk me shkresën 372/1, datë 01.03.2022 “Njoftim” për dorëzim të vonuar të punimeve dhe llogaritja e penaltiteve. (Bashkëlidhur shkresa 372/1, datë 01.03.2022 “Njoftim”)

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

6.3. Rekomandim: Të merren masa nga DPSHP që në të ardhmen të kërkojë pranë Agjencisë së Prokurimit Publik që të planifikojë trajnime të stafit që merret me prokurimet publike, me qëllim rritjen e nivelit profesional në zhvillimin e procedurave të prokurimit publik si dhe vendosjes së kriterëve të konkurrimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Pozicioni i punës Specialist i Çështjeve Ligjore dhe Prokurimeve në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Provës është vakant prandaj nuk janë kryer trajnime pranë Agjencisë së Prokurimit Publik.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pazbatuar**.

7.1. Rekomandim: DPSHP të marrë masa të menjëhershme për shfuqizimin e urdhrin nr.2477 datë 31.05.2018 dhe nxjerrjen urdhrin për përcaktimin e limitit të karburantit sipas dispozitave ligjore të mirë përcaktuara, me qëllim shmangien e menaxhimit jo efektiv të shpenzimeve financiare nga Buxheti i Shtetit.

Menjëherë

Përgjigja e institucionit:

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës ka kryer procedurat për vlerësim dhe nxjerrje jashtë përdorimit të mjetit tip Hunday (I-30). (Bashkëlidhur proces-verbaliv i nxjerrjes jashtë përdorimit me nr.720/3, datë 16.05.2023)

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

8.1. Rekomandim: Nga DPSHP, të merren masa, për të analizuar dhe vlerësuar saktë gjendjen teknike mbështetur në vlerën kontabël, në llogaritjen e amortizimit dhe në dokumentacionit teknik të çdo automjeti. Kjo analizë dhe vlerësim të bëhet me qëllim marrjen në konsideratë të raportit kosto-përfitim (leverdinë ekonomike)për shërbimet që kërkohet të kryhet për mjetin motorik.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Drejtorja e Përgjithshme e Shërbimit të Provës ka kryer procedurat për vlerësim dhe nxjerrje jashtë përdorimit të mjetit tip Hunday (I-30). Bashkëlidhur urdhri nr. 61, datë 29.05.203 ‘Për kalim kapital pa pagesë të mjetit të transportit të nxjerrë jashtë përdorimit nga DPSHP tek Drejtorja e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit’).

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

9.1.Rekomandim: Me qëllim respektimin e rregullave të parashikuara për ruajtjen dhe shfrytëzimin e pasurisë arkivore, nga ana e DPSHP, të merren masa për kryerjen e inventarizimit dhe arkivimit të dosjeve për të cilat janë përfunduar procedurat, në mënyrë që çdo dokument i administruar nga ky institucion të ketë të gjithë elementët e dokumenteve sipas normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Drejtorja e Përgjithshme e Shërbimit të Provës ka nxjerrë shkresën nr 534, datë 24.03.2022 “Kërkesë për dorëzimin në arkivë të dokumentave të prapambetura të viteve 2009-2013 që gjenden në Drejtorinë e Përgjithshme dhe Sektorët përkatës. (Bashkëlidhur shkresa).

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

10.1. Rekomandim: Të merren masa nga titullari i institucionit në bashkëpunim me Drejtorinë e Inspektimit dhe Shërbimeve Komunitare (DI&SHK), për inventarizimin e dosjeve të inspektimit konform ligjit “Për arkivat”.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Drejtorja e Inspektimit dhe Shërbimeve Komunitare ka realizuar inventarizimin e dosjeve të inspektimit për vitet 2018,2019,2020,2021,2022 e në vazhdim. (Bashkëlidhur inventari i dosjeve të inspektimit)

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

10.2. Rekomandim: Të merren masa nga titullari i institucionit që pas ushtrimit të inspektimit në zyrat rajonale të Shërbimit të Provës në ato raste kur janë konstatuar veprime që përbëjnë shkelje disiplinore për punonjësit, të rekomandojë masave disiplinore në raport me shkeljen e konstatuar e cila përcillet së bashku me Raportin e inspektimit/kontrollit, pasi të ketë analizuar më parë përgjegjësitë e tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Titullari i Institucionit, sipas rastit, kur janë konstatuar shkelje të dispozitave ligjore nga punonjësit e inspektuar ka rekomanduar marrjen e masave të nevojshme për shkeljet e konstatuara.(bashkëlidhur Vendimi nr 698 prot.,date 11.01.2022,vendimi nr 37/4 prot.,date 17.02.2023)

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

11.1.Rekomandim:Të analizohen nga DPSHP shkeljet dhe mangësitë e konstatuara nga KLSH trajtuar në këtë Raport auditimi rast pas rasti, me qëllim që në të ardhmen të rekomandohen masa disiplinore për rastet e konstatuara me shkelje nga inspektimi i kryer.

Në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Titullari i Institucionit, në bashkëpunim me strukturën e inspektimit në rastet kur janë konstatuar shkelje të dispozitave ligjore nga punonjësit e inspektuar ka rekomanduar marrjen e masave të nevojshme për shkeljet e konstatuara. (Bashkëlidhur raportet e inspektimit për marrjen e masave për punonjësit të cilët kanë kryer shkelje të dispozitave ligjore, Raport Përfundimtar Inspektimi Nr. 518/6 prot, datë 05.05.2022 “Inspektim i DTShP Lushnje”, Raport Përfundimtar Inspektimi Nr.1230/8 prot, datë 26.10.2022 “Inspektim i DTShP Shkodër”, Raport Përfundimtar Inspektimi Nr. 1443/10 prot, datë 02.12.2022 “Inspektim DTShP Kurbin”, Raport Përfundimtar Inspektimi Nr. 1030/7 prot, datë 14.10.2022 “Inspektim DTShP Tiranë”, Raport Përfundimtar Inspektimi Nr. 332 prot, datë 07.02.2023 “Inspektim DTShP Tiranë”).

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

12.1. Rekomandim: Nga titullari i DPSHP të merren masa që në fillim viti të miratohet Plani i Veprimit të Inspektimit si dhe të ngihet niveli i marrjes së masave disiplinore në rastet kur është e nevojshme, me qëllim arritjen e objektivave në funksion të planifikimit dhe drejtimit strategjik të veprimtarisë të institucionit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Me urdhrin nr. 3, datë 11.01.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm është miratuar plani vjetor i punës për vitin 2022 për drejtorinë e Inspektimit dhe Shërbimeve komunitare. Me urdhrin nr. 7, datë 10.01.2023 të Drejtorit të Përgjithshëm është miratuar plani vjetor i punës për vitin 2023 për drejtorinë e Inspektimit dhe Shërbimeve komunitare.(Bashkëlidhur urdhrat)

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

13.1. Rekomandim: Nga DPSHP, të merren masa për të analizuar dhe vlerësuar përmbushjen e detyrimeve për përditësimin në formatin elektronik të dosjeve aktive mbi ecurinë e personit nën mbikëqyrje deri në momentin e mbarimit të periudhës së provës, me qëllim arritjen e objektivave në funksion të planifikimit dhe drejtimit strategjik të veprimtarisë të institucionit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Me urdhrin nr. 27, datë 18.03.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm është miratuar rregullorja për

administrimin dhe përcaktimin e roleve që kanë të drejta akses në bazën e të dhënave të personave nën mbikëqyrje në sistemin e Shërbimit të Provës. (Bashkëlidhur urdhri dhe rregullorja)

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

14.1. Rekomandim: Sektori i Financës dhe i Buxhetit të marrë masa të menjëhershme në bashkëpunim me Sektorin e Shërbimeve Mbështetëse dhe Çështjeve ligjore, për rakordimin e informacionit të plotë të vendimeve të gjykatës të formës së prerë, të cilat duhet të njihen në vlerën e tyre të plotë, si detyrime për tu shlyer në periudhat e ardhshme dhe për të cilat duhet të provigjionohen shumat përkatëse. Njëkohësisht vlera e tyre duhet njohur edhe si shpenzim periudhe në pasqyrat financiare të institucionit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës gjatë kësaj periudhe nuk ka kryer likujdime të vendimeve të gjykatave.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

14.2. Rekomandim: Sektori i Financës dhe i Buxhetit në çdo rast të ndjekë dhe zbatojë me përpikmëri parimin FIFO, gjatë likuidimit të detyrimeve të prapambetura.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës gjatë kësaj periudhe nuk ka kryer likujdime të vendimeve të gjykatave.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

14.3. Rekomandim: Sektori i Shërbimeve Mbështetëse dhe Çështje ligjore, të marrë masa për ndjekjen proceseve gjyqësore në të gjitha shkallët e gjykimit duke dërguar në kohë reale informacion të plotë dhe të saktë në njësinë përkatëse përgjegjëse për financë/kontabilitetin, në mënyrë që kjo e fundit të mund të provigjionojë fonde për shpenzime të këtij lloji, si edhe të njohë dhe kontabilizojë në kohë vlerat që lidhen me këto shpenzime/detyrime, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës gjatë kësaj periudhe nuk ka kryer likujdime të vendimeve të gjykatave.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

15.1. Rekomandim: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë të marrë masa për miratimin e rregullores së brendshme, në mënyrë që çdo pozicion pune dhe punonjës të ketë të përcaktuar detyrat e tij funksionale.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës ka miratuar rregulloren e brendshme me urdhërin e Ministrit të Drejtësisë me nr.452, datë 31.12.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme të Shërbimit të Provës”. Bashkëlidhur urdhri nr.452, datë 31.12.2020.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

15.2. Rekomandim: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë të marrë masa për saktësimin e termit nga “Zyrat vendore” në “Drejtoritë territoriale” tek Urdhri i Kryeministrit nr.63, datë 07.05.2020 “Për disa ndryshime në urdhrin nr.55 datë 20.04.2017 të kryeministrit “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Shërbimit të Provës ” me qëllim që ndryshimet ligjore të reflektohen në aktet nënligjore që rregullojnë strukturën organike të DPSHP.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

VKM 325, datë 31.05.2023 në strukturë është Drejtori Territoriale dhe jo Zyrat Vendore. Bashkëlidhur urdhri nr 11, datë 03.02.2022 “Për ngritjen e grupit të punës për analizimin dhe riorganizimin e strukturës organike të Shërbimit të Provës”, shkresa me nr 874, datë 06.05.2022 “Relacion për ndryshime në strukturën organike të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Provës”.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

16.1. Rekomandim: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës në bashkëpunim me ministrinë e Drejtësisë të marrë masa të menjëhershme për të propozuar pranë Këshillit të Ministrave plotësimin e vendit të lirë/vakant në pozicionin “Drejtor i Përgjithshëm i Shërbimit të Provës.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit të Provës është emëruar me VKM 54, datë 26.01.2022 “Mbi emërimin në detyrë të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit të Provës”. Bashkëlidhur vkm nr.54, datë 26.01.2022.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

17.1. Rekomandim: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës/Nëpunësi Zbatues, të marrë masa për ngritjen e GMS-së dhe hartimin e Regjistrit të Riskut.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Me urdhër nr 138, datë 04.10.2022 “Për ngritjen dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit të rriskut dhe krijimin e grupit të menaxhimit strategjik ne DPSHP” si dhe me shkresën nr 1894, datë 04.10.2022 është përpiluar evidentimi dhe menaxhimi i rriskut (regjistri i Riskut). (Bashkëlidhur urdhri i ngritjes se GMS dhe regjistri i rriskut).

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1.1. Rekomandim: Nga DPSHP të merren masat dhe të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe ligjore, në të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës prej 144,926 lekë me TVSH e cila përbën dëm për buxhetin e shtetit për konsumin e karburantit në kundërshtim me bazën ligjore të sipër përmendur, konkretisht:

-vlera 47,970 lekë pa TVSH, nga znj. J.E. e cila nuk ka dokumentacion justifikues si dhe faturat e blerjes së karburantit në koherencë me lëvizjet e saj sipas datave të raportuara në autorizimet e lëshuara nga ish-titullari i DPSHP,

-vlera 130,055 lekë me TVSH nga z.Ë. H., z.B. D., z.A. K., znj.A. N. dhe znj.H. M., për miratimin e fletë-udhëtimeve në mospërputhje me lëvizjet e mjetit, i cili rezulton në të njëjtën datë në dy vendndodhje të ndryshme, për pasojë nuk kemi argumentim justifikues dhe dokumentues për konsumin e karburantit për 320 km ose për 32 litra gazoil.

Deri në Qershor 2022

Përgjigjja e institucionit: Janë nxjerrë urdhër zhdëmtimet me nr.79, datë 13.06.202 dhe me nr.80, datë 13.06.2022. Rekomandim është në proces realizimi. Është zhdëmtuar vlera që kishte në ngarkim Z. B.D. të cilit në momentin e largimit nga detyra i është mbajtur vlera që kishte për të zhdëmtuar. Për pjesën tjetër të urdhrin të zhdëmtimit nr. 80, datë 13.06.2022, Vendimi nr. 3446, datë 27.12.2022 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, protokolluar me tonën nr.791, datë 05.05.2023 “Ka shfuqizuar urdhrin e zhdëmtimit nr.80, datë 13.06.2022”. Do vazhdojmë procedurën për arkëtimin e vlerës në Gjykatën Civile të Shkallës së Parë Tiranë. Bashkëlidhur urdhër zhdëmtimet dhe Vendimin nr. 3446, datë 27.12.2022 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN DHE MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1.1. Rekomandim:Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës, të marrë masa të menjëhershme duke kërkuar nga organi qendror/ministria e Drejtësisë vënien në eficientë të DME dhe stafit të saj, me qëllim funksionimin e kësaj drejtorie.

Menjëherë

Përgjigjja e institucionit:

Është dërguar kërkesa nr.773, datë 22.04.2022 Ministrisë së Drejtësisë “Kërkesë për vlerësimin e infrastrukturës teknologjike dhe ambjenteve të brendshme të Drejtorisë së Mbikqyrjes Elektronike”. (Bashkëlidhur shkresa nr. 773, datë 22.04.2022).

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

2.1. Rekomandim: Të analizohen nga DPSHP shkeljet dhe mangësitë e konstatuara nga KLSH trajtuar në këtë Raport auditimi në lidhje me shkaqet e mos përdorimit të sistemit të dixhitalizimit të Shërbimit të Provës dhe në bashkëpunim me AKSHI-n, në të ardhmen të

sigurohet vazhdimësia e mirëmbajtjes së sistemit të dixhitalizimit të Shërbimit të Provës.

Menjëherë

Përgjigja e institucionit:

Me urdhrin nr. 27, datë 18.03.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm është miratuar rregullorja për administrimin dhe përcaktimin e roleve që kanë të drejta akses në bazën e të dhënave të personave nën mbikëqyrje në sistemin e Shërbimit të Provës. (Bashkëlidhur urdhri dhe rregullorja)

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

2.2. Rekomandim: Të merren masa nga Shërbimi i Provës për hedhjen e të dhënave të dosjeve për personat nën mbikëqyrje, sipas detyrimeve të përcaktuara në kontratën nr.1201, datë 25.02.2021 lidhur mes AKSHI-t dhe operatorit fitues për shërbimin e mirëmbajtjes së sistemit.

Menjëherë

Përgjigja e institucionit:

Me urdhrin nr. 27, datë 18.03.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm është miratuar rregullorja për administrimin dhe përcaktimin e roleve që kanë të drejta akses në bazën e të dhënave të personave nën mbikëqyrje në sistemin e Shërbimit të Provës. Rregullorja ka përcaktuar përdoruesit dhe akseset për secilin prej tyre.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

3.1. Rekomandim: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës të marrë masa për ekzekutimin vullnetar të vendimeve gjyqësore të formës së prerë menjëherë pas publikimit të vendimit të formës së prerë dhe kthimit të tij në titull ekzekutiv, me qëllim uljen e shpenzimeve të DPSHP-së.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Nuk kemi pasur vendime gjyqësore të formës së prerë për likuidim.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

MASA DISIPLINORE

Përgjigja e institucionit:

Me urdhrin nr.88, datë 17.06.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm është ngritur grupi i punës mbi ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve të raportit përfundimtar të auditimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit “Auditim Përputhshmërie”. Grupi i punës ka vendosur se nuk çmohet e arsyeshme marrja e masave disiplinore për mospërputhje të bazës ligjore, rekomandimeve të KLSH, si dhe mosvleresimin e observacioneve të inspektimit, pasi nuk kanë kompetencë marrjen përsipër të masave.(Bashkëlidhur urdhri Nr. 88 , date 17.06.2022 dhe procesverbali nr. 1239/1 Prot, datë 15.09.2022. urdhërat e zhdëmitmit nr.79 dhe 80, datë 13.06.2022 si dhe urdhëri nr.100, datë 12.07.2022 “Për ndërprerjen e mardhënive të punës dhe ato financiare të nëpunësit civil z. B. D.”) .

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti, dhe **i zbatuar**.

NJOFTIMI I DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Për punonjësit ndaj të cilëve sipas Rekomandimit të KLSH janë marrë masa disiplinore, nga DPSHP Tiranë të njoftohet Ministria e Drejtësisë, pasi të zbatohen procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimit të afateve ankimore, të ndërmarrë veprimet si më poshtë:

a. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr.152/2013 "Për Nëpunësin Civil", i ndryshuar.

b. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, mbi mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të Ligjit nr.152/2013 "Për Nëpunësin Civil", i ndryshuar.

Përgjigjja e institucionit:

Janë njoftuar DAP dhe Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil me shkresën nr.97, datë 16.01.2023 "Përcjellie dokumentacioni". Bashkëlidhur shkresa nr.97, datë 16.01.2023.

KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Provës për Raportin Përfundimtar të Auditimit "Mbi auditimin e përputhshmërisë" dërguar me shkresën 935/13, datë 11.04.2022 për veprimtarinë nga data 01.01.2020 deri më datë 31.12.2021, rezulton se subjekti i audituar ka respektuar afatin 20 ditor për hartimin e planit të masave për zbatimin e rekomandimeve në përputhje me kërkesat e nenit 15 shkronja (j) të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, nuk ka respektuar afatin për njoftimin brenda 6 muajve mbi ecurinë e zbatimit të këtyre masave në përputhje me kërkesat e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Konkretisht ecuria e zbatimit të rekomandimeve paraqitet sipas tabelës "Ecuria e zbatimit të rekomandimeve"

Rekomandime	Gjithsej		Pranuar		Zbatuar plotësisht		Pjesërisht		Në proces		Pa zbatuar	
	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë
Organizative	28	-	28	-	27	-	-	-	-	-	1	-
Shpërbllim Dëmi	1	322,951	1	322,951					1	322,951		
Menaxhimin e Efektivitetit dhe Ekonomicitetit të Fondeve Buxhetore	4		4		4							
Disiplinore	1		1		1							
Gjithsej	34	322,951	34	322,951	32	-	-	-	1	322,951	1	-

Sa sipër rezulton se janë dhënë gjithsej 34 rekomandime të cilët janë pranuar plotësisht (100 %), dhe rezultojnë të zbatuar plotësisht 32 masa (94.1 %).

Për të gjitha rekomandimet që konsiderohen në proces zbatimi, inkurajohet përsheptimi i realizimit të plotë të tyre.

Për sa më sipër ri kërkojmë që Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës të marrë të gjitha masat e nevojshme me qëllim zbatimin e të gjitha rekomandimeve që rezultojnë të pazbatuara brenda 3-mujorit të parë të vitit 2024. Si dhe kërkojmë marrjen e masave disiplinore për zyrtarët përgjegjës, në lidhje me rekomandimet e KLSH të pranuar prej institucionit dhe që efektivisht rezultojnë të pa zbatuara.

3.14 INSTITUCIONI REZIDENCIAL I PËRKUJDESIT SHOQËROR PËR FËMIJË, “ZYBER HALLULLI”.

PËRMBLEDHJE

Në zbatim të Programit të Auditimit nr. 613/17 prot., datë 06.07.2023, “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e evaduara në 6-mujorin e dytë të vitit 2022”, në ambientet e Institucionit të Përkujdesit për fëmijë, më datë 26.07.2023, u mbajt aktverifikimi nga audituesit e autorizuar të KLSH-së znj. A.Xh dhe z. G.H, me znj. V.I. në cilësinë e Titullarit të institucionit dhe z. A. R.

Objekt i këtij akt verifikimi është:

Verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të KLSH të lëna me shkresën nr. 381/7 prot. datë 20.09.2022 për Raportin Përfundimtar të Auditimit me objekt “Përputhshmërinë e Veprimtarisë dhe Auditimin Financiar”, të ushtruar në Shtëpinë e Fëmijëve Shkollorë Tiranë, “Zyber Hallulli”, sipas programit të auditimit nr. 381/1, datë 30.04.2022, i ndryshuar me nr. 381/2, datë 07.06.2022, për veprimtarinë nga data 01.09.2019 deri në 31.12.2021, në lidhje mbi statusin e zbatimit të rekomandimeve, afateve dhe niveli i zbatueshmërisë së tyre, koherencën e tyre si dhe përgjegjshmërinë menaxheriale referuar standardeve të auditimit.

Auditimi u krye nga:

1. A.Xh
2. G.H

Auditimi ka filluar më datë 10.07.2023

Auditimi ka përfunduar më datë 26.07.2023

Auditimi është kryer në bazë të Programit të Auditimit të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit nr.613/17 prot., datë 06.07.2023 me objekt: “Mbi verifikimin e zbatimi të rekomandimeve”, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” si dhe në zbatim të Rregullores së Procedurave të Auditimit dhe të Manualit për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të auditimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe Regjistrisë elektronik institucionale, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 67, datë 13.06.2020.

TRAJTIMI I ÇËSHTJEVE TË AUDITIMIT

Nga auditimi i ushtruar në Shtëpinë e Fëmijëve Shkollorë Tiranë, “Zyber Hallulli”, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, “Mbi Përputhshmërinë e Veprimtarisë dhe Auditimin Financiar” për periudhën 01.09.2019 deri në 31.12.2021 trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin nr. 170, datë 20.09.2022, të Kryetarit të KLSH-së, të cilat janë përcjellë me shkresën nr. 381/7 prot., datë 20.09.2022, verifikohet se:

I. Hartimi i programit (Plan veprimtarisë) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në nenin 15 shkronja (j) të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Nga auditimi u konstatua se, subjekti ka miratuar planin e veprimtarisë për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, duke e dërguar në KLSH me shkresë nr. 292 datë

07.10.2022 kjo në përputhje me ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” nenit 15, shkronja j.

Sa më sipër rezulton se është zbatuar afati 20 ditor përkthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve.

II. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Në lidhje mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve dhe afatet e përcaktuara, sipas strukturave përgjegjëse, SHFSH nuk ka dërguar në KLSH planin e masave të marra lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të miratuara nga titullari brenda afatit 6 mujor, në kundërshtim me ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” nenit 30.

Sa më sipër rezulton se nuk është zbatuar afati 6 mujor për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve.

III. Realizimi i rekomandimeve

Nga ana e KLSH-së, me shkresat përcjellëse janë lënë 28 masa në total për të cilat janë dhënë 35 rekomandime. Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

- a) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë, 1 masë për ndryshime apo përmirësime në legjislacionin në fuqi nga ku 1 rekomandim, i cili pranuar dhe zbatuar.
- b) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 21 Masa organizative nga ku 27 rekomandime, nga të cilat: 27 rekomandime janë pranuar plotësisht të cilat kanë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon: 13 zbatuar dhe 11 në proces zbatimi, 1 është i pazbatuar, 2 janë zbatuar pjesërisht.
- c) Për përmirësimin e gjendjes është lënë 5 Masa për menaxhimin e Efektivitetit dhe Ekonomicitetit të Fondeve Buxhetore nga ku 6 rekomandime, të cilat janë pranuar dhe kanë statusin: 5 janë pazbatuar dhe 1 është në proces zbatimi.
- d) Për përmirësimin e gjendjes është lënë 1 Masë Disiplinore nga ku 1 rekomandim, i cili është i pranuar dhe i pazbatuar.

Më hollësisht, auditimi i ndjekjes së rekomandimeve paraqitet si vijon:

PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI.

1.1. Rekomandim: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në bashkëpunim me njësitë e varësisë në Shërbimin Social Shtetëror të marrin masa, për përmirësimin e VKM nr.518 datë 04.09.2018 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar”, duke përcaktuar sasi të kalorive që duhet të konsumojë çdo fëmijë sipas grup moshës si dhe në bashkëpunim me INSTAT të bëjë përditësimin e ndryshimeve mesatare vjetore të indeksit të çmimeve të konsumit nëpërmjet Udhëzimit të Ministrisë të MSHMS, me qëllimsaktësimin e mënyrës së përcaktimit të vlerës ditore të shpenzimeve për secilin fëmijë në përputhje me nevojat për ushqim.

Brenda vitit 2022

Përgjigjja e institucionit:

Shërbimi Social Shtetëror nëpërmjet shkresës nr. 5336 prot., datë 19.05.2023 ka dërguar në SHFSH normat e reja ushqimore për grupmoshat 0-18 vjec. Kuotat ushqimore ditore për secilën grupmoshë kanë ndryshuar si më poshtë vijon:

Grupmosha	Kuota /Dite-ishte	Kuota /Ditë-Bëhet
6-11 vjec	440 lekë	490 lekë
11-15 vjec	480 lekë	600 lekë
15-18 vjec	500 lekë	600 lekë

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe i zbatuar.**

MASA ORGANIZATIVE

1.1. Rekomandim: Shtëpia e Fëmijëve Shkollorë të marrë masa të menjëhershme që hartimi i menysë ditore të fëmijëve të kryhet nga ekipi multidisiplinar dhe të udhëhiqet nga standardet në fuqi të ushqyerjes, referuar grup moshës së fëmijëve, llojit të produktit ushqimor për konsum, normës ditore, vlerës në k/kalori, dhe në fund vlerësimi në vlerë duke respektuar kuotën ditore të miratuar nga MSHMS.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Shtëpia e Fëmijëve Shkollorë nëpërmjet ekipit multidisiplinar ka marrë masat për hartimin e menuve të reja javore, të cilat janë firmosur nga anëtarët e ekipit.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe i zbatuar.**

1.2. Rekomandim: Lidhur me zbatimin e standardeve të kërkuara për të promovuar ushqyerjen e shëndetshme të fëmijëve, deri në përmirësimin e kuadrit rregullator nga MSHMS, ekipi multidisiplinar i Shtëpia e Fëmijëve Shkollorë Tiranë, duhet të udhëhiqet nga Manuali “Bazat e ushqyerjes, ushqyerja e gruas shtatzënë, ushqyerja e fëmijës” modul i përgatitur nga Ministria e Shëndetësisë në vitin 2011, në bashkëpunim me rekomandimet e UNICEF (Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët), OBSH (Organizata Botërore e Shëndetësisë) dhe FAO, (Organizata e Kombeve të Bashkuara për Ushqimin dhe Bujqësinë).

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Shtëpia e Fëmijëve Shkollorë nëpërmjet shkresës nr. 383 prot., datë 05.02.2022 ka kërkuar bashkëpunimin e Shërbimit Social Shtetëror për zbatimin e këtij Rekomandim. Në vijim SHSSH ka përcjellë manualin “Fëmijët, ushqimi, dhe nutricioni”, i cili shërben si udhëzues për SHFSH në procesin e hartimit të menuve javore.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe i zbatuar.**

Rekomandim 1.3: Shërbimi Social Shtetëror të marrë masa për trajnimin e stafit të Shtëpisë së Fëmijëve Zyber Hallulli Tiranë (ekipit multidisiplinar), mbi njohjen dhe zbatimin e “Manualit mbi bazat e Ushqyerjes” deri në nxjerrjen e akteve nënligjore nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

SHSSH me urdhërin nr. 2595/1 dt. 10.01.2023 ka ngritur grupet e punës të cilët kanë hartuar “Manualin e normave ushqimore” dhe ka zhvilluar sesione konsultuese në SHFSH me qëllim njohjen dhe implementimin e praktikave të përshkruara në manual.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe i zbatuar.**

2.1. Rekomandim: Shtëpia e Fëmijëve Shkollorë në bashkëpunim me Shërbimin Social Shtetëror, ti drejtohen Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të marrin masat e duhura për indeksimin e shpenzimeve personale mujore për fëmijë, në funksion të rritjes së mirëqenies e fëmijëve që kanë nevojë për kujdes shoqëror.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Shtëpia e Fëmijëve Shkollorë nëpërmjet shkresës nr. 383 prot., datë 05.02.2022 ka kërkuar bashkëpunimin e Shërbimit Social Shtetëror për zbatimin e këtij Rekomandim.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe në proces zbatimi.**

3.1. Rekomandim: Shtëpia e Fëmijëve Shkollorë, në bashkëpunim me Shërbimin Social Shtetëror, përpara miratimit të buxhetit vjetor për çeljen e fondeve buxhetore, të vlerësojë rëndësinë dhe prioritetin e kërkesës për zërin “Investime” në llogarinë 231, në funksion të shëndetit, sigurisë dhe mirëqenien e fëmijëve rezident në institucion.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Shtëpia e Fëmijëve Shkollorë nëpërmjet shkresës nr. 405 prot., datë 30.12.2022 i është drejtuar SHSSH për kryerjen e rikonstruksionit të godinës.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe në proces zbatimi.**

4.1. Rekomandim: Shtëpia e Fëmijëve Shkollorë, të marrë masa, që të përpilojë raportet e monitorimit 4, 8, 12 mujore, ku të raportohet në lidhje me realizimin e treguesve në raport me parashikimin. Në raportet 8-mujore të paraqesë informacion shtesë për parashikimin e realizimeve të pritshëm deri në fund të vitit, për të evidentuar nëse ky parashikim është më i lartë apo më i ulët se plani fillestar i parashikuar, me qëllim menaxhimin sa më efektiv të fondeve buxhetore.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

SHFSH dërgon evidenca mujore të shpenzimeve të zërave përkatës pranë SHSSH, si dhe evidenca të ndryshme statistikore. Ky rekomandim do të mbahet në konsideratë dhe do të zbatohet në vijimësi.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe në proces zbatimi.**

5.1. Rekomandim: Titullari i institucionit të Shtëpisë së Fëmijëve Shkollorë Tiranë në bashkëpunim me Përgjegjësen e Sektorit të Administratës (financiere), të marrë masat e duhura që në çdo urdhër për ngritjen e komisionit/ve të inventarizimit, vlerësimit dhe nxjerrjet jashtë përdorimi të aktiveve, të përmirësojë të metat dhe mangësitë e konstatuara lidhur me zbatimin me përpikëri procedurës për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik, duke eliminuar mungesën e urdhrit për ngritje komisioni, mungesën e deklaratës së shmangies se konfliktit të interesit, mungesën e mbajtjes së proces verbalit në formën e duhur, duke shmangur vendosjen e të njëjtëve anëtar komisioni për dy vite të njëpasnjëshëm, mungesën e firmosjes nga personat e ngarkuar me përgjegjësi materiale, mungesën e relacionit për titullarin, etj.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Me urdhërat e Titullarit janë ngritur grupet e punës për kryerjen e procesit të inventarizimit, konkretisht:

- Me urdhërin nr. 41 prot., datë 13.09.2022 është ngritur komisioni për inventarizimin dhe vlerësimin e aktiveve dhe detyrimeve.

- Me urdhërin nr. 44 prot., datë 15.09.2022 është ngritur komisioni për nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve gjendje.

- Me urdhërin nr. 45 prot., datë 15.09.2022 është ngritur komisioni për asgjësimin e aktiveve gjendje.

Procesi i inventarizimit nuk ka përfunduar ende dhe do të kryhet në vijimësi.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe në proces zbatimi.**

5.2. Rekomandim: Nëpunësi zbatues të marrë masa të menjëhershme për krijimin e Regjistrit të Aktiveve të Shtëpisë së Fëmijëve Shkollorë Tiranë.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Institucioni ka marrë masat dhe ka hartuar Rregjistrin e Aktiveve, i cili do të vijojë të plotësohet me elementët e nevojshëm.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe i zbatuar.**

6.1. Rekomandim: Shtëpia e Fëmijëve Shkollorë, në bashkëpunim me Shërbimin Social Shtetëror, të marrin masa për plotësimin e dosjeve të personelit me dokumentacionin që mungon, në përputhje me aktet nënligjore në fuqi.

Menjëherë

Përgjigja e institucionit:

Shtëpia e Fëmijëve Shkollorë nëpërmjet shkresës nr. 383 prot., datë 05.02.2022 ka kërkuar bashkëpunimin e Shërbimit Social Shtetëror për zbatimin e këtij Rekomandim.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe në proces zbatimi.**

7.1. Rekomandim: Shërbimi Social Shtetëror të aplikojë sistemin e krediteve sipas programit të certifikimit të profesionistëve të shërbimeve të kujdesit shoqëror në rekrutimet e punonjësve, të cilët janë subjekt i VKM nr. 624, datë 29.07.2020.

Përgjigja e institucionit:

Në përputhje me Ligjin 121/2016 “ Për shërbimet e kujdesit shoqëror “ Kreu II neni 39 është krijuar Agjencia e Sigurimit të Cilësisë dhe Kujdesit Shëndetësor dhe Shoqëror”, një institucion që ka mekanizmat për të monitoruar dhe akredituar strukturat e ofrimit të shërbimit shëndetësor dhe shoqëror, publike dhe jopublike, si dhe për çertifikimin e edukimit në vazhdim të profesionistëve shëndetësorë dhe shoqërorë.

Shërbimi Social Shtetëror në rekrutimet e stafit të profesionisteve të institucioneve ka përfshirë në rekrutimin e stafit social urdhërat për Psikologun dhe Punonjës Social.

Në bashkëpunim me MSHMS, SHSSH ka hartuar listën e Punonësve Sociale të cilët janë pjesë e stafit të strukturave të SHSSH dhe IPSH-ve. Lista është dërguar në MSHMS për urdhërin e Punonjësve Social i cili u promovua dhe filloi në Mars 2023 licensimet e para. Deri tani ky proces po vijon për regjistrimin dhe aplikimin e të gjithë profesionisteve Punonjës Social për të përfituar Licensën sipas udhëzimeve. Aplikimi si dhe regjistrimi i profesionisteve në Urdhërin i Punonjësve Social ka filluar në periudhën Mars 2023. Për zhvillimin dhe trajnimin e punonjësve të IPSH-ve, SHSSH periodikisht ka organizuar trajnime të ndryshme të cilat nuk janë të kredituara por janë ofruar nga partnere/eksperte të organizatave që kanë fokus të punës shërbimet sociale. Në vijim të punës SHSSH në bashkëpunim me Agjencinë e Akreditimit do të organizojë trajnime me sistemin e kredive sipas fushave të profesionisteve për edukimin e vazhdueshëm.

Në zbatim të planit të veprimit të Drejtorisë së Shërbimit Social , gjatë vitit 2022 dhe në vazhdim në bashkëpunim me institucionet e përkujdesit rezidencial dhe Drejtoritë Sociale në Bashki kanë realizuar trajnime të ndryshme me temat si më poshtë: *(përmendur edhe në raportimin e zbatimit të rekomandimeve pas 6 muaj)*

-Në bashkëpunim me organizatën UNICEF janë realizuar një cikël trajnimesh me stafin e IPSH-ve për fëmijë përfshirë edhe staf të Bashkisë Korçë, Vlorë dhe Drejtoritë Rajonale të Shërbimit Social mbi Procesin e Deinstitutionalizimit të fëmijëve nga ekspertet e organizatave “Bethany” Fshati SOS dhe “Organizata Nisma “ viti 2021-2022 .

-Trajnim për Zbatimin e VKM 327/2021” Për mekanizmin e bashkërendimit të dhunës ndërmjet autoriteve përgjegjëse për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhënie familjare. Janë trajnuar të gjithë punonjësit e QKTDHF dhe koordinatorët e dhunës në nivel vendor . viti 2022

- Janë trajnuar punonjës në 19 Bashki dhe punonjësit e Drejtorive Rajonale të SHSSH për funksionimin e regjistrimit elektronik të shërbimeve sociale. Objektivi kryesor i trajnimit ishte ngritja e aftësive të duhura të përdoruesit të regjistrimit elektronik, në mënyrë që ata të mund të përmbushin nevojat e qytetarëve. Nga aktivitetet e trajnimit në Bashki kanë përfituar katër grupe kryesore: viti 2022.

- *Punonjësit social të bashkisë;*
- *Administratorët social të bashkisë;*
- *Punonjësit social të institucioneve qendrore ashtu edhe atyre lokale, si edhe ata të institucioneve jo qeveritare partner me bashkitë.*
- *Stafi drejtues i bashkive.*

-Trajnim i stafit të Shtëpisë Rinore – Shkodër në bashkëpunim me organizatën “Key Adveser “ *Transformimi i përgjigjes kombëtare ndaj trafikimit të qënieve njerëzore në dhe nga Shqipëria” vit 2022.*

SHSSH në bashkëpunim me “Organizatën Save the Children “ do të realizojnë planin e trajnimeve për IPSH- të e fëmijëve “ Metodologjia HEART në trajtimin e fëmijëve “.

-SHSSH në Bashkëpunim me Fondacionin “Alo mik“ ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi për përmirësimin e mirëqënies psikosociale së fëmijëve dhe familjeve

vulnerabël, Nr Prot 5946 prot dt 08 06.2023. Në kuadër të kësaj marrëveshje janë parashikuar edhe trajnime për stafet e IPSH- ve në varësi të SHSSH.

-Trajnime mbi efektet e Institucionalizimit dhe procesi i riintegritimit në familje biologjike – realizuar nga fshati SOS për IPSH- të rezidenciale për fëmijë në bashkëpunim me SHSSH.

-Program trajnimi në kuadër të deinstitutionalizimit të realizuar nga specialistët e SHSSH për stafet e shtëpive të fëmijës dhe punonjësit e Bashkisë Korçë dhe Vlorë, sipas kalendarit në dosje.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe në proces zbatimi.**

8.1. Rekomandim: Të bëhet sistemimi dhe pasqyrimi i saktë në pasqyrën “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike) dhe asaj neto” dhe për aktivet e nxjerra jashtë përdorimi të bëhet sqarimi për këto aktive nëse është vlerë e mbetur apo vlerë bruto në pasqyrimin e bilancit për vitin 2022.

Me mbylljen e pasqyrave të vitit 2022

Përgjigjja e institucionit:

Institucioni ka përgatitur pasqyrat financiare për vitin 2022 dhe ka pasqyruar gjendjen dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata në formatin 7/a, por nuk ka plotësuar shënimet shpjeguese të cilat shoqërojnë pasqyrat financiare dhe japin sqarime mbi llogaritë e tyre.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe i zbatuar pjesërisht.**

9.1. Rekomandim: Të bëhet sistemimi dhe përllogaritja e saktë e amortizimit vjetor të “Mjeteve të transportit” me normën 20% në pasqyrimin e bilancit për vitin 2022.

Me mbylljen e pasqyrave të vitit 2022

Përgjigjja e institucionit:

SHFSH ka pasqyruar në Pasqyrat Financiare të vitit 2022 përllogaritjen e amortizimit vjetor për aktivin “Mjete transporti” me normën 20%”.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe i zbatuar.**

10.1. Rekomandim: Të bëhet sistemimi dhe pasqyrimi i saktë në pasqyrën “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike) dhe asaj neto” dhe për aktivet e nxjerra jashtë përdorimi të bëhet sqarimi për këto aktive nëse është vlerë e mbetur apo vlerë bruto në pasqyrimin e bilancit për vitin 2022.

Me mbylljen e pasqyrave të vitit 2022

Përgjigjja e institucionit:

Institucioni ka përgatitur pasqyrat financiare për vitin 2022 dhe ka pasqyruar gjendjen dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata në formatin 7/a, por nuk ka plotësuar shënimet shpjeguese të cilat shoqërojnë pasqyrat financiare dhe japin sqarime mbi llogaritë e tyre.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe i zbatuar pjesërisht.**

10.2. Rekomandim: Të bëhet sistemimi dhe përllogaritja e saktë e amortizimit vjetor për aktivet në llogarinë 218 “Inventar ekonomik” në pasqyrimin e bilancit për vitin 2022.

Me mbylljen e pasqyrave të vitit 2022

Përgjigjja e institucionit:

SHFSH ka pasqyruar në Pasqyrat Financiare të vitit 2022 përlllogaritjen e amortizimit vjetor për aktivet në llogarinë 218 “Inventar ekonomik”.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe i zbatuar.**

11.1. Rekomandim:Të bëhet një klasifikim i saktë në llogaritë përkatëse për çdo aktiv që në momentin e hyrjes në magazine si dhe të bëhet një sistemim në llogaritë përkatëse për të gjitha aktivet e institucionit.

Me mbylljen e pasqyrave të vitit 2022

Përgjigjja e institucionit:

Institucioni ka kryer sistemimet e aktiveve duke i klasifikuar në llogaritë përkatëse.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe i zbatuar.**

12.1. Rekomandim:Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në bashkëpunim me Shërbimin Social Shtetëror dhe Shtëpinë e Fëmijëve Shkollorë Tiranë “Zyber Hallulli”, në cilësinë e institucioneve të varësisë, të marrë masa për personat të cilët do të angazhohen në realizimin, monitorimin e procedurave të prokurimeve publike, për trajnimin e tyre të vazhdueshëm pranë Agjencisë së Prokurimeve Publike, për të marrë përgjegjësinë dhe detyrat, për realizimin e hartimit të kërkesave dhe kriterëve në përzgjedhjen e operatorit fitues konform kuadrit ligjor dhe rregullator të procedurave tenderuese, për ekzekutimin dhe monitorimin e kontratave, duke synuar forcimin e kontrollit të brendshëm, për të mirë menaxhuar fondet buxhetore.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

SHFSH gjatë kësaj periudhe nuk ka realizuar proceduara prokurimi në vlerë të madhe, por ky rekomandim do të zbatohet për çdo rast në vijim.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe në proces zbatimi.**

13.1. Rekomandim:Shërbimi Social Shtetëror në bashkëpunim me MSHMS të marrë masa për ngritjen një grup pune për të analizuar veprimet, shkaqet, arsyet për nxjerrjen e përgjegjësive, në lidhje me mangësitë e konstatuara në për llogaritjen e fondit limit për produkte ushqimore, me qëllim menaxhimin me efektivitet, ekonomikitet dhe efincencë të fondeve buxhetore, në plotësimin e nevojave ushqimore për fëmijët sipas standardeve kohore.

Menjëherë

Përgjigjja e institucionit:

Nga institucioni nuk janë paraqitur evidenca për vënien në dijeni të institucioneve përkatëse për zbatimin e këtij Rekomandim.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe i pazbatuar.**

14.1. Rekomandim: Shtëpia e Fëmijëve Shkollorë Tiranë “Zyber Hallulli”, në cilësinë e

autoritetit kontraktor, të marrë masa që strukturat përgjegjëse tenderuese, të caktojnë kriteret e veçanta, për hartimin e kontratave me objekt furnizimin me produkte ushqimore, në përputhje me natyrën dhe përmasat e objektit të prokurimit, për të siguruar forcimin e kontrolleve në të gjitha hallkat, me qëllim shmangien e risqeve për abuzime në sigurinë ushqimore dhe përfitimin e mallrave sipas cilësisë së kërkuar.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

SHFSH gjatë kësaj periudhe nuk ka realizuar proceduara prokurimi në vlerë të madhe, por ky rekomandim do të zbatohet për çdo rast në vijim.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe në proces zbatimi.**

15.1. Rekomandim: Njësia e prokurimit në Shtëpinë e Fëmijëve Shkollorë Tiranë në bashkëpunim me Shërbimin Social Shtetëror të marrin të gjitha masat e duhura, me qëllim argumentimin e kriterëve në DST, të cilat duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

SHFSH gjatë kësaj periudhe nuk ka realizuar proceduara prokurimi në vlerë të madhe, por ky rekomandim do të zbatohet për çdo rast në vijim.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe në proces zbatimi.**

16.1. Rekomandim: Me qëllim respektimin e rregullave të parashikuara për ruajtjen dhe shfrytëzimin e pasurisë arkivore, nga ana e Shtëpisë së Fëmijëve Shkollorë Tiranë “Zyber Hallulli”, të merren masa për kryerjen e inventarizimit dhe arkivimit të dosjeve për të cilat janë përfunduar procedurat, në mënyrë që çdo dokument i administruar nga ky institucion të ketë të gjithë elementët e dokumenteve sipas normave profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Institucioni ka marrë masat për kryerjen e inventarizimit dhe arkivimit të dosjeve për të cilat janë përfunduar procedurat, në mënyrë që çdo dokument i administruar nga ky institucion të ketë të gjithë elementët e dokumenteve sipas normave profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe i zbatuar.**

17.1. Rekomandim: Autoriteti Kontraktor, duhet të mbajë një Proces Verbal (përmbledhës) me Kontraktorin për gjithë sasinë e mallit të pranuar mbi të cilën është pranuar fatura tatimore. Gjatë zbatimit të kontratës duhet të mbajë në konsideratë jo vetëm hartimin e kriterit për kualifikim mbi paraqitjen e certifikatë/ve që vërtetojnë kërkesat e cilësisë gjatë procesit të vlerësimit të ofertave të paraqitura në një procedurë prokurimi, por duhet të ndjekë me

rigorozitet plotësimin e tyre nëpërmjet dokumenteve vërtetues mbi plotësimin e kërkesave të cilësisë sipas dokumentacionit të prokurimit, bazuar në përputhje me standardet shtetërorë të cilësisë dhe kritereve të kualifikimit të OE.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

Përgjigjja e institucionit:

Institucioni ka mbajtur procesverbale me kontraktorët për pranimin e mallit të furnizuar. Gjithashtu SHFSH me shkresat nr. 291/2 prot., datë 12.10.2022 dhe nr. 288/2 prot., datë 12.10.2022 i është drejtuar Agjencisë Shtetërorë të Prokurimeve të Përqëndruara për dhënie informacioni mbi specifikimet teknike për produktet objekt kontrate.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe i zbatuar.**

17.2. Rekomandim: Dokumentacioni i pranimit të mallit të prokuruar duhet të evidentohet në proces verbalin e pranimit të mallit dhe të bëhen pjesë e dosjes së prokurimit. Proces verbali të hartohet në tre kopje, njëra prej të cilave të behet pjesë e dosjes së prokurimit.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

Përgjigjja e institucionit:

Institucioni ka mbajtur procesverbale me kontraktorët për pranimin e mallit të furnizuar. Gjithashtu SHFSH me shkresat nr. 291/2 prot., datë 12.10.2022 dhe nr. 288/2 prot., datë 12.10.2022 i është drejtuar Agjencisë Shtetërorë të Prokurimeve të Përqëndruara për dhënie informacioni mbi specifikimet teknike për produktet objekt kontrate.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe i zbatuar.**

17.3. Rekomandim: Autoriteti Kontraktor për kontratat e përfunduara të hartojë Raport Përmbledhës në të cilin të evidentojë cilësinë e zbatimit të kontratës, problemet e hasura gjatë zbatimit të saj në rast se ka, masat e marra për zgjidhjen e tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Institucioni ka hartuar Raportet Përmbledhës për kontratat e përfunduara.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe i zbatuar.**

18.1. Rekomandim: Nga ana e Autoriteti Kontraktor, të merren masa që në çdo procedurë prokurimi me vlerë nën 100 mijë lekë, Komisioni i Blerjeve të Vogla duhet të dokumentojë me anë të një procesverbali domosdoshmërinë e blerjes së medikamenteve duke përcaktuar nëse ato janë të parashikuara për rimbursim ose janë të detyrueshme për tu blerë sipas Rekomandimit mjekësor nga mjeku specialist sipas nevojës imediate për medikament, përveç të rasteve të sëmundjeve kronike ose atyre që mund të konsiderohen medikamente ose pajisje mjekësore që duhet të mbahen në kutinë e ndihmës së shpejte. Për çdo blerje medikamenti duhet të verifikohet dhe evidentohet afati i skadencës së medikamentit, sipas i cili minimalisht duhet të jetë mbi një vit nga data e blerjes së tij. Të ndërpritet përfundimisht mbajtja e medikamenteve nga mjeku i institucionit dhe mbajtja e tij të bëhet sipas rregullave të Udhëzimit nr.30/2011.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Institucioni ka evidentuar në procesverbalet e marrjes në dorëzim afatin e skadencës për çdo medikament të blerë. Blerja e tyre është bërë sipas recetave apo nevojave të institucionit nga mjekja e familjes ose e institucionit. Dalja e medikamenteve bëhet sipas rregullores tek kryekujdestari i cili më pas kryen dhe shpërndarjen në apartamentet përkatës.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe i zbatuar.**

19.1. Rekomandim: Shtëpia e Fëmijëve Shkollorë dhe Shërbimi Social Shtetëror të bëjnë vlerësimin periodik të kapaciteteve dhe nevojave për trajnim të stafit të Shtëpisë së Fëmijëve Shkollorë Tiranë, në mënyrë që procesi i edukimit të vazhdueshëm të jetë në formën e duhur.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Shtëpia e Fëmijëve Shkollorë nëpërmjet shkresës nr. 383 prot., datë 05.02.2022 ka kërkuar bashkëpunimin e Shërbimit Social Shtetëror për zbatimin e këtij Rekomandim.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe në proces zbatimi.**

20.1. Rekomandim: Shërbimi Social Shtetëror, në bashkëpunim me Shtëpinë e Fëmijëve Shkollorë të miratojnë një dokument të Kodit Etik për veprimtarinë e Shtëpisë së fëmijëve.

Menjëherë

Përgjigjja e institucionit:

Shtëpia e Fëmijëve Shkollorë nëpërmjet shkresës nr. 383 prot., datë 05.02.2022 ka kërkuar bashkëpunimin e Shërbimit Social Shtetëror për zbatimin e këtij Rekomandim. Me urdhër të Titullarit të SHSSH nr. 372, datë 27.06.2023 është miratuar Kodi i Etikës së SHSSH, i cili do të zbatohet dhe nga SHFSH.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe i zbatuar.**

21.1. Rekomandim: Shtëpia e Fëmijëve Shkollorë, në bashkëpunim me Shërbimin Social Shtetëror të bëjnë pjesë të dosjeve përkatëse të personelit, vlerësimet periodike që kryhen për punonjësit e Shtëpisë së Fëmijëve Shkollorë Tiranë.

Në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Shtëpia e Fëmijëve Shkollorë nëpërmjet shkresës nr. 383 prot., datë 05.02.2022 ka kërkuar bashkëpunimin e Shërbimit Social Shtetëror për zbatimin e këtij Rekomandim.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe në proces zbatimi.**

MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN DHE MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi ekzekutimin dhe monitorimin e kontratave përgjatë viteve 2019, 2020 dhe 2021, me objekt furnizimin me produkte ushqimore, u konstatua, si më poshtë vijon:

1.1 Në faturat e thjeshta të shoqërimit të lëshuara nga operatori ekonomik fitues, për çdo furnizim me produkte ushqimore të freskëta, kanë munguar kritere që lidhen me specifikimin e llojit të makinave apo targa e tyre, të cilat janë të ndryshëm nga kriteret e veçanta të kualifikimit në DT., Këto veprime kanë sjellë që komisionet e pritjes së mallit në Shtëpinë e Fëmijëve Shkollorë Tiranë “Zyber Hallulli”, kanë pranuar dërgesat e produkteve ushqimore nga palë të treta, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin erregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 75 pika 1, pasi në DT. nuk është i lejuar nënkontraktimi.

1.2 Certifikatat shëndetësore veterinarë dhe/ose raport analizat e kryera nga AKU, nuk janë paraqitur në emër të operatorit ekonomik fitues, sikundër përcaktohen në kriterëve të veçanta të kualifikimit në DT., të plotësuar nga fituesi në tender, por janë të paraqitur nga persona fizikë ose operatorë ekonomikë të tjerë, të cilët nuk kanë qenë pjesë e procedurës tenderuese.

1.3 Për rastet e konstatuara, nuk është paraqitur fatura tatimore e blerjes së mallrave për të verifikuar nëse produkti është blerë nga të tretët.

1.4 Sistemi i magazinës funksionon me fatura të thjeshta, pa asnjë element sigurie, kjo si pasojë, e mungesës së sistemit të informatizuar të përqendruar nga lart-poshtë dhe anasjelltas. Sa më sipër, në Shtëpinë e Fëmijëve Shkollorë Tiranë “Zyber Hallulli” rezultuan: (i) kontrole të dobëta si pasojë e mosngritjes së strukturave të dedikuara për monitorimin e kontratave; (ii) mosparashikimi si detyrime kontraktore për OE-të, të elementeve, llojin e automjeteve me targa, certifikatat ushqimore, kushtet e transportit me qëllim ruajtjen e sigurisë ushqimore; (iii) komisionet në Shtëpinë e Fëmijëve Shkollorë Tiranë “Zyber Hallulli” të miratuara në fillim viti buxhetor, kanë rrezikuar që, duke mos u informuar në kohë mbi OE-në fitues, si dhe mbi kriteret e veçanta të kontratave, të kenë marrë në dorëzim mallranga palë të treta, pa verifikuar nëse plotësojnë ose jo kriteret e kërkuara (pasi është e pamundur të kryhet mbikëqyrje, në mungesë të elementëve për tu mbikëqyrur);

Pra në total nga Shtëpia e Fëmijëve Shkollorë Tiranë “Zyber Hallulli”, **vlëra 3,936,834 lekë** është paguar në kundërshtim me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, Udhëzimi nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pika 35 dhe 36, me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 59, 60, me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 75 pika 1 dhe neni 77, me Kontratë pika V (Afati i zbatimit) pika 5.

1.1. Rekomandim: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale si institucioni epror në bashkëpunim me Shërbimin Social Shtetëror të marrë masa për ngritjen e grupit të punës, për të analizuar veprimet, shkaqet, arsyet dhe të dalin përgjegjësitë, në lidhje me monitorimin dhe ekzekutimin e kontratave me objekt furnizim me produkte ushqimore, me qëllim menaxhimin me efektivitet, ekonomikitet dhe eficiencë të fondeve buxhetore, dhe shmangien e risqeve financiare, në disfavor të Buxhetit të Shtetit.

Menjëherë

Përgjigja e institucionit:

Nga institucioni nuk janë paraqitur evidenca për vënien në dijeni të institucioneve përkatëse për zbatimin e këtij Rekomandim.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe i pazbatuar.**

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të kërkesave ligjore në hartimin e Dokumenteve Standarde të Tenderit, konstatohet se në 3 rastet e procedurave të llojit “Negocim pa shpallje paraprake të njoftimit” për “Blerje Ushqimesh”, të kryera nga Shtëpia e Fëmijëve Shkollorë Tiranë për periudhën 2019-2021, janë lidhur Kontratat e Furnizimit me nr. 119/9, datë 24.04.2019; Kontrata e Furnizimit “Blerje Ushqimesh” me nr. 153/5 prot, datë 27.08.2020; si dhe Kontrata me nr. 281/3 prot, datë 18.01.2021. Nga Njësia e Prokurimit nuk është justifikuar përzgjedhja e të njëjtëve operatorë ekonomikë pjesëmarrës, është lënë një afat shumë i shkurtër në sjelljen e ofertave nga OE të ftuar për pjesëmarrje, dhe në DST nuk është përcaktuar grafiku i lëvrimit në shkëlqje të përcaktimeve të nenit 36, pika 4 si dhe nenit 11, pika 3 shkronja (b) të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar dhe me pikën 7 të Udhëzimit nr. 2, datë 08.01.2018 “Mbi përdorimin e procedurës me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike” duke krijuar një proces konkurrimi jo transparent. Në DST, në rubrikën “Kriteret e veçanta të kualifikimit” nga Autoriteti Kontraktor është kërkuar që operatori ekonomik pjesëmarrës, për çdo mjet motorik (ATV) dhe ambientin që e përdor për kryerjen e aktivitetit, duhet të paraqesë akt miratimin higjieno –sanitar (AMHS) të lëshuar nga institucioni shtetëror, referuar ligjit nr.7643 datë 01.12.1992 “Për inspektimin sanitar” i ndryshuar, **neni 12.** Operatorët Ekonomikë kanë paraqitur aktet higjieno sanitare të lëshuara nga Inspektorati Shtetëror Shëndetësor, kohë përpara dhe pa afat vlefshmërie, veprime jo në koherencë me realizimin e procedurës dhe në pa pajtueshmëri me ndryshimet ligjoretë përcaktuara në ligjin nr.54/2020 datë 30.04.2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.7643 datë 01.12.1992 “Për inspektim sanitar”, i cili ka shfuqizuar nenin 12. Për rrjedhojë, mbas datës 30.04.2020, KVO nuk duhet të pranonte aktet higjieno-sanitare, pasi ato kanë humbur efektin juridik për shkak të shfuqizimit të dispozitës ligjore. Sa më sipër përzgjedhja e OE fitues është bërë në mospërputhje me VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar neni 66. **Vlera prej 3,936,834 lekë** përbën shpenzim pa ekonomikitet, pa eficientë dhe pa efektivitet të fondeve të Buxhetit të Shtetit.

2.1. Rekomandim: Ministria e Shëndetësisë si institucioni epror në bashkëpunim me Shërbimin Social Shtetëror, në cilësinë e institucionit të varësisë, të marrin masa, për ngritjen e grupit të punës, për të analizuar veprimet, shkaqet, arsyet si dhe për nxjerrjen e përgjegjësive, në lidhje me mangësitë e konstatuara në kontratat me objekt furnizim me produkte ushqimore, me qëllim menaxhimin me efektivitet, ekonomikitet dhe eficientë të fondeve buxhetore, dhe shmangien e risqeve financiare në disfavor të Buxhetit të Shtetit.

Menjëherë

Përgjigja e institucionit:

Nga institucioni nuk janë paraqitur evidenca për vënien në dijeni të institucioneve përkatëse për zbatimin e këtij Rekomandim.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe i pazbatuar.**

2.2. Rekomandim: Titullari i AK të marrë masa që t'i kushtojë vëmendjen e duhur institucionale procesit të hartimit të kërkesave për kualifikim nga grupet e punës/njësia e prokurimit dhe procesit të shqyrtimit e vlerësimit të dokumentacionit ligjor dhe administrativ të operatorëve ekonomik dhe ofertave të ofertuesve nga komisionet e vlerësimit të ofertave, pasi në të gjitha procedurat hartimi i kërkesave për kualifikim dhe vlerësimi i ofertave, konstatohet jo korrekt.

Përgjigjja e institucionit:

Institucioni ka hartuar formularin me kërkesat kualifikuese për grupet e punës/njësitë e prokurimit dhe do të vijojë me zbatimin e Rekomandimit në procedurat e ardhshme.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe në proces zbatimi.**

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dosjes fizike, mbi mënyrën e përlllogaritjes së fondit limit, të procedurës me objekt “Shërbim roje civile për Shtëpinë e Fëmijëve Shkollor Tiranë”, për periudhën 01.04.2020-01.06.2020, sipas Urdhër Prokurimi nr.61/prot, datë 09.04.2020, rezultoi se: grupi për hartimin e fondit limit nuk ka kryer saktë llogaritjen e tij në një vlerë prej 951,91 lekë më pak, fakt ky që nuk është konstatuar nga KVO e ngritur sipas Urdhrit nr. 24, prot. nr. 60, datë 09.04.2020. Grupi i punës ka përlllogaritur vlerën e fondit limit 310,825.60 lekë ndërkohë që kjo vlerë duhet të ishte 311,777.51 lekë, fakt ky që shoqërohet edhe me një ofertë ekonomike e paraqitur më e vogël nga OE N. e cila ka ardhur po si pasojë e përlllogaritjes gabim të kostos ditore/roje dhe konkretisht në llogaritjen e shtesës së vështirësisë së pagës për roje për turnin e II, të cilën nuk e ka pjesëtuar me koeficientin e zëvendësimit që është 3,32 roje, por me një koeficient më të lartë me 4,98 roje, ose me 1,66 më shumë, pra është llogaritur për një turn më shumë ose një vendroje më shumë. Rritja e këtij koeficienti ka sjellë zvogëlimin me pa të drejtë të kostos së vështirësisë duke e ulur atë, eparaqitur në vijim:

OE $1 \times 3 \times 224.13 \times 20\% = 4.98 = 27$ lekë/roje/ditë shtesë për turnin e II-të.

Grupi i auditimit:

$1 \times 3 \times 224.13 \times 20\% = 3.32 = 40,5$ lekë/roje/ditë shtesë për turnin e II-të.

OE Paga bazë lekë /roje/ditë **1278,68**+27 lekë / roje / ditë, turni i II-të=1,305.68 lekë/ roje/ditë x 16.7 % sigurime shoqërore dhe shëndetësore = 218.04 lekë/roje/ ditë.

Grupi i auditimit:

Paga bazë lekë /roje/ditë **1278,68**+40,5 lekë / roje / ditë, turni i II-të=1,319.18 lekë/ roje/ditë x 16.7 % sigurime shoqërore dhe shëndetësore = 220,30 lekë/roje/ ditë.

OE Paga ditore = 1,305.68 +218,04= 1523.72 lekë/roje/ditë, *3,32= 5,058.75 lekë për një vendroje/ditë.

Grupi i auditimit:

Paga ditore = 1,319.18 +220,30= 1539,48 lekë/roje/ditë, *3,32= 5,111.07 lekë për një vendroje/ditë.

4OE/Kosto 61 ditë $5,058.75 \times 61 = 308,583.77 + 20\%$ tvsh= 370,300.50 lekë.

Grupi i auditimit:

$5,111.07 \times 61 = 311,775.49 + 20\%$ *311,775.49 =311,775.49 +62,355.09= **374,130.58** lekë pra 3830,08 lekë më pak llogaritur nga OE.

Ky gabim në llogaritjen e fondit limit nuk është konstatuar nga KVO pasi në përbërjen e KVO-së nuk ka asnjë specialist të fushës, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 58, duke kualifikuar në mënyrë të padrejtë një ofertë të llogaritur gabim të cilat sjellin kosto në pagesa të gabuara të kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore për çdo individ të deklaruar në liste pagesënë kundërshtim me ligjin nr. 9136, datë 11.9.2003 i ndryshuar “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë” si dhe në shmangie të detyrimeve fiskale tatimore në kundërshtim me Ligjin 9920, dt. 19.05.2008 “Për procedurat Tatimore në RSH”, i ndryshuar, nenin 71/2, pika /d.

Sa më sipër, KVO ka pranuar një ofertë ekonomike (e vetmja e paraqitur) pa e analizuar saktë,

duke arsyetuar thjesht si oferta më e ulët se fondi limit. Ndërkohë që nisur nga tipologjia dhe standardi i miratuar mbi mënyrën e përlllogaritjes së vlerës së kontratës, për procedurat e prokurimit me objekt “Shërbim roje civile”, koeficientet e marrë për bazë llogaritje janë të mirëpërcaktuara. Nisur nga ky fakt, duhet që KVO-ja të kontrollojë përlllogaritjen e ofertës fituese si dhe të arsyetonte, pse OE paraqitet në vlerë shumë ulët krahasuar me fondin limit.

Këto risqe shtohen edhe më tepër në mungesë të strukturave të dedikuara dhe njohurive apo kompetencave të stafit të angazhuar në këto procedura, i cili nga auditimi rezultoi konfuz mbi fazat e caktuara të procesit të prokurimit, si pasojë e mos njohjes së kuadrit ligjor dhe rregullator përkatës, si dhe mos ndjekjes së trajnimeve që organizon APP në bashkëpunim me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike, mbi prokurimet publike, veprime që sjellin një përdorim pa ekonomikitet, efektivitet dhe efikasitet të fondeve të buxhetit të shtetit në vlerën **310,825.6 lekë**.

3.1. Rekomandim: Nga Shërbimi Social Shtetëror në bashkëpunim me MSHMS të ngrihet një grup pune për të analizuar veprimet, shkaqet, arsyet si dhe për nxjerrjen e përgjegjësive, në lidhje me mangësitë e konstatuara në përlllogaritjen e fondit limit për shërbim roje civile, si dhe për mos konstatim të KVO të një oferte jo të saktë të paraqitur nga OE fitues, me qëllim menaxhimin me efektivitet, ekonomikitet dhe efikasitet të fondeve buxhetore, dhe shmangien e risqeve financiare në disfavor të Buxhetit të Shtetit.

Menjëherë

Përgjigjja e institucionit:

Nga institucioni nuk janë paraqitur evidencat për vënien në dijeni të institucioneve përkatëse për zbatimin e këtij Rekomandimi.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe i pazbatuar**.

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit të llojit “Marrëveshje kuadër me një OE ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara me një afat 12 muaj”, “Shërbim roje civile për Shtëpinë e Fëmijëve Shkollor Tiranë”, sipas Urdhrit të Prokurimit nr. 189/3 datë 18.09.2020, me fond limit 1,870,910.13 lekë pa TVSH, grupi i punës i ngritur për përlllogaritjen e fondit limit ka përcaktuar vlerën prej 1,870,910.13 lekë pa TVSH dhe një vlerë prej 46,950.46 lekë/roje/muaj. Në këtë procedurë kanë paraqitur ofertë 13 ofertues ku 12 prej tyre kanë dhënë të njëjtën ofertë mujore prej një vëndroje në muaj në vlerën **46,950.46 lekë/roje/muaj** dhe vetëm OE “S.” ka dhënë vlerën prej 46,939.94 lekë/roje/muaj ose 10,52 lekë më pak dhe si rrjedhim është shpallur fitues për vlerën më të ulët. Por KVO nuk ka vlerësuar saktë këtë ofertë pasi në të njëjtën mënyrë llogaritje vepron edhe OE “S.”, por ai nuk ndjek të njëjtin standard në llogaritje pasi diferenca për të cilën ai është shpallur fitues është vetëm 10,52 lekë më pak në koston mujore dhe kjo ka ardhur si pasojë e mos llogaritjes me të njëjtin standard matematikor, dhe konkretisht:

OE, Koston mujore e llogarit: $1543,57 * 30,41 \text{ ditë} = 46,939.96 \text{ lekë}$, ndërkohë që duhet ta llogarisë sikurse ka llogaritur normën ditore të një roje pa shtesën e vështirësisë dhe kontributet e sigurimeve shoqërore që do të ishte:

$1543.57 * 365 / 12 = 46,950,25 \text{ lekë}$, pra subjekti ka kryer gabim veprimin me dashje pasi kur nxjerr pagën ditore (pa shtesa) e për llogarit pa rrumbullakosur numrin $12/365$, ndërsa kur ka llogaritur koston përfundimtare mujore merr mesataren e rrumbullakosur të ditëve të muajit 30,41. Pikërisht rrumbullakimi i numrit sjell efektin e diferencës prej $46,950.25 - 46,939.96 = 10,29 \text{ lekë}$ më pak, për vëndroje/muaj duke e shpallur fitues OE.

Pra AK (KVO), ka vepruar në mospërputhje ligjore duke përzgjedhur fitues OE “S” si çmimi

më i ulët, pasi ky OE ka pasur të njëjtën vlerë oferte, por ka përlogaritur gabim numrin e ditëve mujor/vjetorë duke e shprehur në njërin rast 30,41 ditë dhe në llogaritjen tjetër 12/365 duke llogaritur një kosto mujore/ditore për një vend/roje për vetëm 10.29 lekë më pak, vlerë e pasaktë. Nisur edhe nga Udhëzimi i APP nr. 15, datë 26.11.2018” Për një ndryshim në Udhëzimin nr. 6, datë 16.01.2018 “Për përdorimin e marrëveshjes kuadër dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, pika 1, paragrafi i fundit citon se “Vlerësimi i ofertave bëhet mbi bazën e vlerës së ofertës së dhënë për 1 (një), vendroje në muaj, nga ku AK ka bërë vlerësim për operatorët pjesëmarrës për çmimin mujor për 1 roje dhe jo vlerën e ofertës për një vendroje në muaj. Duke ecur në të njëjtën logjikë citon se oferta e S. është jo ligjore pasi nuk ka zbatuar bazën ligjore të sipërcituar duke nxjerre një kosto mujore për një roje prej 46,939.94 lekë duke paguar më pak sigurime shoqërore në shkelje të ligjit.”.

Nisur nga sa më sipër KVO, duhet të kishte analizuar diferencën për 10 lekë më pak të ofertës se paraqitur, cila shpalli fitues OE, pasi standardi mbi mënyrën e llogaritjes së fondit limit në procedurat e prokurimit për “Shërbim Roje” përcakton të njëjtët koeficientë të vështirësisë të koston ditore/vendroje dhe të njëjtën pagë minimale në vlerën 39,000 lekë. Në këtë mënyrë AK, grupi i ngritur për përlogaritjen e fondit limit dhe shqyrtimit të ankesave vlerëson të saktë, koston mujore për një roje/muaj të sjellë nga OE “S.” duke “mohuar veten”, pra duke pranuar që fondi limit nuk është në vlerën e duhur ose ka gabime në përlogaritje, kjo në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, i ndryshuar "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 66 "Shqyrtimi i ofertave" pika 3. Kualifikimi i OE S. fitues është bërë në kundërshtim Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 55, pika 3.

Për sa më sipër arrijmë në përfundimin që fondi prej **2,547,853 lekë** është përdorur pa ekonomikitet, efikasitet dhe ekonomikitet nga Shtëpia e Fëmijës Zyber Hallulli, Tiranë.

4.1. Rekomandim: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes sociale në bashkëpunim me Shërbimin Social Shtetëror të marrë masa në ngritjen e një grupi pune për të analizuar veprimet, shkaqet, arsyet dhe nxjerrjen e përgjegjësive, në lidhje me mangësitë e konstatuara në përzgjedhjen e ofertës më të mirë ekonomike, duke siguruar që Autoriteti Kontraktor të pranojë oferta të cilat janë të përballueshme, të qëndrueshme dhe të pakushtëzuara, për rritjen e efikasitetit në shpenzimet publike, duke zhvilluar procedura prokurimi në përmbushje të kriterëve ligjore, kapaciteteve ekonomike, financiare dhe profesionale, pasi në disa raste hartimi i kërkesave për kualifikim dhe vlerësimi i ofertave, konstatohet jo korrekt.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Nga institucioni nuk janë paraqitur evidenca për vënien në dijeni të institucioneve përkatëse për zbatimin e këtij Rekomandim.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe i pazbatuar.**

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi ekzekutimin dhe monitorimin e kontratave përgjatë vitit 2020 për tre procedurat “Shërbim roje civile për Shtëpinë e Fëmijëve Shkollor Tiranë”, përkatësisht:

1. Me fond limit në vlerën 310,825.6 lekë pa TVSH, është lidhur kontrata me nr. 65, datë 23.04. 2020, ndërmjet Shtëpisë së Fëmijëve Shkollorë Tiranë me “N.”, me Nipt JXX.
2. Me fond limit 306,666,4 lekë pa TVSH është lidhur kontrata ndërmjet “NXx me Nipt JXX dhe Shtëpisë së Fëmijës me nr. prot 217, datë 09.10.2020.
3. Me fond limit 1,870,910.13 lekë pa TVSH, është lidhur kontrata ndërmjet “S.” me Nipt: KXXdhe Shtëpisë së Fëmijës me nr. prot 247, datë 16.11.2020, u konstatua se:

1- Në asnjë nga faturat e sjella nga OE fitues nuk shënohen sasia e ditëve për të cilat subjekti, ka kryer shërbimin, duke mos qenë transparent në zbatimin korrekt të ditëve që paguhen si dhe këto fatura janë pranuar nga përgjegjësi i sektorit të administratës, pa kryer asnjë verifikim përkatës, veprime në kundërshtim me Ligjin 110/2015 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, neni 12, pika 3, gërma “dh” dhe “e”.

2- U konstatua se, proces verbalet janë mujore dhe përmbajnë një grafik me emrat e rojeve që kryejnë turnet, për të cilët, grupi i auditimit, nuk mundi të verifikonte, a janë ose jo të siguruarnë listëpagesat përkatëse të muajve përkatës punonjësit që kryenin shërbimin e rojës, pasi nga verifikimi i listëpagesave të paraqitura nga OE fitues, për muajt janar –mars 2020, kishte mospërputhshmëri në emrat e deklaruar krahasuar me proces verbalet, duke rrishtuar zbatimin korrekt të kontratës.

Grupi i auditimit, vlerëson se, listëpagesat e muajve koherentë për të cilët kryhet shërbimi i rojës duhet të ishin pjesë e proces verbaleve për çdo muaj shërbimi për të siguruar zbatimin e kontratës me efikasitet, veprime këto në kundërshtim me nenin 77/mbikëqyrja e kontratës, pika 3, 4, e VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

3- Në përfundim të kontratës, autoriteti kontraktor nuk ka përgatitur një raport përmbledhës për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës. Për sa më sipër arrijmë në përfundimin që vlera prej **3,154,550.22 lekë** për Shërbim roje civile në Shtëpinë e Fëmijëve shkollorë Tiranë, është përdorur pa ekonomikitet, efektivitet dhe efikasitet.

5.1. Rekomandim: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale si institucioni epror në bashkëpunim me Shërbimin Social Shtetëror të marrë masa për ngritjen e grupit të punës, për të analizuar veprimet, shkaqet, arsyet dhe të dalin përgjegjësitë, në lidhje mbi monitorimin dhe ekzekutimin e kontratave me objekt “Shërbim roje civile”, me qëllim menaxhimin me efektivitet, ekonomikitet dhe efikasitet të fondeve të Buxhetit të Shtetit.

Menjëherë

Përgjigjja e institucionit:

Nga institucioni nuk janë paraqitur evidenca për vënien në dijeni të institucioneve përkatëse për zbatimin e këtij Rekomandim.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe i pazbatuar.**

MASA DISIPLINORE PËR PUNONJËSIT NË MARRËDHENIE PUNE

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH” neni 15 pika (b) dhe (c), ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe kontratës individuale të punës, pasi të jenë shqyrtuar dhe vlerësuar shkeljet e evidentuara dhe të jenë identifikuar përgjegjësit në lidhje me këto shkelje, i rekomandojmë Drejtorit të Shërbimit Social Shtetëror, që referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e prokurimeve, menaxhimit financiar dhe kontrolli, si dhe përgjegjësive individuale të evidentuara dhe pasqyruar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, të vlerësojë shkeljet dhe të vendosë marrjen e masave disiplinore “Vërejte” deri në “Largim nga puna”, për personat si vijon, lidhur me konstatimet:

(i) mungesa e raporteve të monitorimit 4-8-12 mujore të buxhetit të Shtëpisë së Fëmijëve Shkollorë Tiranë, në kundërshtim me pikën 42 kapitulli III të 41.2 kapitulli III, të Udhëzimit nr. 22, datë 17.11.2016, “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e Qeverisjes Qendrore”, të mungesës së urdhrave për ngritje komisioni të inventarizimit, të

shmangies së të njëjtëve anëtarë komisioni për dy vite të njëpasnjëshëm, mungesës së firmosjes nga personat e ngarkuar me përgjegjësi materiale në proces verbalet përkatëse, në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”;

(ii) në fushën e prokurimeve, për procedurat me objekt “Blerje ushqimesh për fëmijë” duke miratuar, jo në mënyrë të saktë përlllogaritjen e fondit limit dhe si rrjedhim, janë shpenzuar më pak lekë të vlerës ditore ose e ose e thënë ndryshe 409 lekë më pak të vlerës ditore për secilin fëmijë, duke cenuar detyrimin bazë të Shtëpisë së Fëmijëve Shkollorë Tiranë, mbi përkujdesjen, respektin dhe përkushtimin ndaj fëmijëve, në kundërshtim me VKM nr.518 datë 04.09.2018 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar” dhe Udhëzimin e Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr.689 datë 02.10.2018 “Për nivelin e kuotave të shpenzimeve për Ushqime, në institucionet publike rezidenciale e komunitare të përkujdesit shoqëror”.

Përzgjedhja dhe miratimi i operatorit ekonomik fitues, të cilët kanë paraqitur aktet administrative AMHS të lëshuara nga Ministria e Shëndetësisë (Inspektorati Shtetëror Shëndetësor) Dega Rajonale/Qarku përkatës, sipas ligjit nr.7643 datë 01.12.1992 “Për inspektimin sanitar” i ndryshuar, neni 12, ndonëse neni në fjalë është shfuqizuar më datë 30.04.2020), për rrjedhojë janë pranuar akte të panevojshme, të kundraligjshme si dhe akte të lëshuara disa vite përpara, jo në koherencë me realizimin e procedurës me aktualitetin, duke humbur seriozitetin e kriterit të higjienës, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, i ndryshuar “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 66 “Shqyrtimi i ofertave” pika 3 dhe me DST për rrjedhojë, vlera prej 3,936,834 lekë, përbën shpenzim financiar, pa ekonomikitet, pa eficientë dhe pa efektivitet të fondeve të Buxhetit të Shtetit.

Vendosja e të njëjtit punonjës pjesëmarrës në strukturat prokuruese, në kundërshtim të përcaktimeve të nenit 56 të, të LPP, 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, të cilët kanë njohuri të dobëta së kuadrit ligjor dhe rregullator përkatës, si dhe mos hartimit dhe ndjekjes së trajnimeve që organizon APP mbi prokurimet publike, si dhe nuk rezulton të jetë përpiluar raport përmbledhës, në kundërshtim të përcaktimeve të nenit 68 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Në lidhje mbi monitorimin e kontratave të ushqimeve, u konstatuan kontrole të dobëta si pasojë e mosngritjes së strukturave të dedikuara për monitorimin e tyre, komisionet e pritjes së ushqimeve të miratuara në fillim viti buxhetor, kanë rrezikuar që, duke mos u informuar në kohë mbi OE-në fitues, si dhe mbi kriteret e veçanta të kontratave, të kenë marrë në dorëzim mallra nga palë të treta, pa verifikuar nëse plotësojnë ose jo kriteret e kërkuara (pasi është e pamundur të kryhet mbikëqyrje, në mungesë të elementëve për tu mbikëqyruar.)

(iii) në fushën e prokurimeve me objekt “Shërbim Roje”, në cilësinë e titullarit të AK, duke miratuar veprimet e punonjësve të institucionit që drejton, duke konstatuar se:

Përlllogaritjen e fondit limit jo të saktë të vlerës së kontratës, në kundërshtim me ligjin 75/2014” Për ofrimin e shërbimit privat të sigurisë fizike”, me ligjin nr. 74/2014 “Për armët”, Udhëzimit të Ministrit të Brendshëm nr.157, datë 01.04.2016 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike”, me VKM nr. 809, datë 26.12.2018 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi” dhe me VKM nr.77, datë 28.01.2015 “Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor” ;

Të anëtarëve të njësisë së prokurimit duke vendosur kriteret, në kundërshtim me ligjin 75/2014” Për ofrimin e shërbimit privat të sigurisë fizike”, me ligjin nr. 74/2014 “Për armët”, Udhëzimit të Ministrit të Brendshëm nr.157, datë 01.04.2016 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike”, me VKM nr. 809, datë 26.12.2018 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi” dhe me VKM nr.77, datë 28.01.2015 “Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i

sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor”;

Të anëtarëve të komisionit të vlerësimit të ofertave, duke përzgjedhur operatorin ekonomik fitues në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, i ndryshuar "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 66 "Shqyrtimi i ofertave" pika 3.

Znj.S.L, me detyrë Drejtor i Shtëpisë së Fëmijëve Shkollorë “Zyber Hallulli” Tiranë dhe në cilësinë e Nëpunësit Autorizues (NA) dhe Titullar i Autoritetit Kontraktor;

1. Znj.A.H, me detyrë përgjegjës i sektorit të administratës në cilësinë e Nëpunësit Zbatues (NZ)/ anëtare e përllogaritjes së fondit limit/anëtare e njësisë së prokurimit/ anëtare e KVO;
2. Znj.E.L, me detyrë kujdestare në Shtëpinë e Fëmijëve Shkollorë Tiranë, në cilësinë e anëtarit të grupit për përllogaritjen e fondit limit, të procedurave me objekt “Blerje ushqimesh”, kryetare e komisionit të shqyrtimit të ankesave për procedurën me objekt “Shërbim roje civile”
3. Znj.S.H, me detyrë kujdestare në Shtëpinë e Fëmijëve Shkollorë Tiranë, në cilësinë e anëtarit të grupit për përllogaritjen e fondit limit, të procedurave me objekt “Blerje ushqimesh” dhe “Shërbim roje civile”;
4. Znj.E.K, me detyrë juriste, në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit, të procedurave me objekt “Blerje ushqimesh”;
5. Znj.D.N, me detyrë kujdestare në Shtëpinë e Fëmijëve Shkollorë Tiranë, në cilësinë e anëtarit të komisionit të shqyrtimit të ankesave për procedurën me objekt “Shërbim roje civile”;
6. Znj.L.Aj, me detyrë kujdestare në Shtëpinë e Fëmijëve Shkollorë Tiranë, në cilësinë e anëtarit të komisionit të shqyrtimit të ankesave për procedurën me objekt “Shërbim roje civile”;
7. Znj.A.Zh, me detyrë me detyrë kujdestare në Shtëpinë e Fëmijëve Shkollorë Tiranë, në cilësinë e anëtarit të komisionit të pritjes së ushqimeve dhe anëtare e KVO me objekt “Shërbim roje civile”;
8. Znj.E.D, me detyrë përgjegjëse e sektorit social në Shtëpinë e Fëmijëve Shkollorë Tiranë, në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit;
9. Znj.M.I, me detyrë psikologe në Shtëpinë e Fëmijëve Shkollorë Tiranë, në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit me objekt “Shërbim roje civile”.

B. PËR PUNONJËSIT E LARGUAR

Për ish punonjësit e mëposhtëm nuk rekomandojmë masa disiplinore edhe sepse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë, nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi personat e sipërpërmendur nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien e zbatimit të tyre.

1. Znj. F.A, ish-kujdestare larguar nga Shtëpinë e Fëmijëve Shkollorë Tiranë, në cilësinë e anëtarit të grupit për përllogaritjen e fondit limit të procedurave me objekt “Blerje ushqimesh” dhe “Shërbim Roje”, anëtare e komisionit të inventarizimit;
2. Znj.K.L, ish-ish-mjeke në detyrë në Shtëpinë e Fëmijëve Shkollorë Tiranë, ndërprerë marrëdhëniet e punës në datë 01.12.2021, në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit për procedurën me objekt “Blerje ushqimesh”, anëtare e komisionit të pritjes së ushqimeve;
3. Znj.B.B, ish- edukatore në Shtëpinë e Fëmijëve Shkollorë Tiranë larguar nga puna në datë 14.09.2020, në cilësinë e anëtarit të KVO për procedurën me objekt “Blerje ushqimesh”;
4. Znj.Xh.F, me detyrë ish-kryekujdestare në Shtëpinë e Fëmijëve Shkollorë Tiranë ndërprerë marrëdhëniet e punës në datë 10.11.2020, në cilësinë e anëtarit të KVO për procedurën me objekt “Blerje ushqimesh”;
5. Znj.B.Gj, me detyrë ish-punonjëse sociale në Shtëpinë e Fëmijëve Shkollorë Tiranë, me arsim të lartë, profile juridik (ndërprerë marrëdhëniet e punës në datë 15.07.2020, në cilësinë e kryetare e KVO me objekt “Shërbim roje civile”.

Përgjigjja e institucionit:

Nga institucioni nuk janë paraqitur evidenca për vënien në dijeni të institucioneve përkatëse për zbatimin e këtij Rekomandim.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe i pazbatuar.**

KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve në Shtëpinë e Fëmijëve Shkollorë Tiranë, “Zyber Hallulli” për Raportin Përfundimtar të Auditimit me objekt “Përputhshmërinë e Veprimtarisë dhe Auditimin Financiar” dërguar me shkresën nr. 381/7 prot. datë 20.09.2022 për veprimtarinë nga data 01.09.2019 deri në 31.12.2021, rezulton se subjekti i audituar ka respektuar afatin 20 ditor për hartimin e planit të masave për zbatimin e rekomandimeve në përputhje me kërkesat e nenit 15 shkronja (j) të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, nuk ka respektuar afatin për njoftimin brenda 6 muajve mbi ecurinë e zbatimit të këtyre masave në përputhje me kërkesat e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Konkretisht ecuria e zbatimit të rekomandimeve paraqitet sipas tabelës “Ecuria e zbatimit të rekomandimeve”

lekë

Rekomandime	Gjithsej		Pranuar		Zbatuar plotësisht		Pjesërisht		Në proces		Pa zbatuar	
	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë
Ndryshime apo përmirësime në legjislacionin në fuqi	1	-	1	-	1	-	-	-	-	-	-	-
Organizative	27	-	27	-	13	-	2	-	11	-	1	-
Menaxhimin e Efektivitetit dhe Ekonomicitetit të Fondeve Buxhetore	6	9,950,063	6	9,950,063	-	-	-	-	1	-	5	9,950,063
Disiplinore	1	-	1	-	-	-	-	-	-	-	1	-
Gjithsej	35	9,950,063	35	9,950,063	14	-	2	-	12	-	7	9,950,063

Për të gjitha rekomandimet që konsiderohen në proces zbatimi, inkurajohet përshpejtimi i realizimit të plotë të tyre.

Për sa më sipër ri kërkojmë që Shtëpia e Fëmijëve Shkollorë Tiranë, “Zyber Hallulli” të marrë të gjitha masat e nevojshme me qëllim zbatimin e të gjitha rekomandimeve që rezultojnë të zbatuara pjesërisht dhe të pazbatuara brenda 3-mujorit të parë të vitit 2024. Si dhe kërkojmë marrjen e masave disiplinore për zyrtarët përgjegjës, në lidhje me rekomandimet e KLSH të pranuar prej institucionit dhe që efektivisht rezultojnë të pa zbatuara.

3.15 BASHKIA VLORË (Deinstitutionalizimi)

PËRMBLEDHJE

Në zbatim të Programit të Auditimit nr. 613/30 prot., datë 10.07.2023, “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e evaduar në 6-mujorin e parë të vitit 2022”, në ambientet e Bashkisë Vlorë, më datë 27.07.2023, u mbajt aktverifikimi nga audituesit e autorizuar të KLSH-së znj. A.K dhe znj. A.Xh me përfaqësues të institucionit z. E. D. në cilësinë e Titullarit të Institucionit, z. O. D. në cilësinë e personit të autorizuar për trajtimin e rekomandimeve të KLSH-së, znj. I. S. në cilësinë e Drejtor i Drejtorisë së Ndihmës Ekonomike dhe Shërbimit Social dhe znj. L. B. në cilësinë e Drejtor i Burmieve Njerëzore.

Objekti i këtij aktverifikimi është:

Verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të KLSH të lëna me shkresën nr. 1267/23 datë 07.06.2022 për Raportin Përfundimtar të Auditimit me objekt “Auditim përputhshmërie dhe

Vlerësues me fokus Plani Kombëtar të Deinstitutionalizimit të Fëmijëve 2020 – 2022”, të ushtruar në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Shërbimin Social Shtetëror, Bashkinë Vlorë, Bashkinë Korçë, sipas programit të auditimit nr. 1267/1 prot., datë 22.11.2021, i ndryshuar, për veprimtarinë nga data 01.09.2020 deri në datën 30.11.2021, në lidhje mbi statusin e zbatimit të rekomandimeve, afateve dhe niveli i zbatueshmërisë së tyre, koherencën e tyre si dhe përgjegjshmërinë menaxheriale referuar standardeve të auditimit.

Auditimi u krye nga:

1. A.K

2. A.Xh, anëtar

Auditimi ka filluar më datë 13.07.2023

Auditimi ka përfunduar më datë 27.07.2023

Auditimi është kryer në bazë të programit të auditimit nr. 613/30 prot., datë 10.07.2023 me objekt: “Mbi verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH, në auditimet e vitit 2022”, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” dhe në zbatim të Rregullores së Procedurave të Auditimit dhe të Manualit për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të auditimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe Regjistrit elektronik institucional, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 67, datë 13.06.2020.

TRAJTIMI I ÇËSHTJEVE TË AUDITIMIT

Nga auditimi i ushtruar në Bashkinë Vlorë, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, “Mbi Auditimin e Përputhshmërisë dhe Vlerësues me fokus Plani Kombëtar të Deinstitutionalizimit të Fëmijëve 2020 – 2022” për periudhën 01.09.2020 deri më 30.11.2021 trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin nr. 93, datë 03.06.2022, të Kryetarit të KLSH-së të cilat janë përcjellë me shkresën nr. 1267/23 datë 07.06.2022, rezulton se:

I. Hartimi i programit (Plan veprimit) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në nenin 15 shkronja (j) të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”.

Nga auditimi u konstatua se, Bashkia Vlorë nuk ka miratuar planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15, shkronja j.

II. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Në lidhje mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve dhe afatet e përcaktuara, sipas strukturave përgjegjëse, Bashkia Vlorë nuk ka përgatitur planin e masave të marra lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6 mujor, në kundërshtim me ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 30.

III. Realizimi i rekomandimeve

Nga ana e KLSH-së, janë lënë 4 Masa Organizative, 2 Masa për shpërblim dëmi, 1 Masë disiplinore.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

a) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 4 Masa organizative nga ku 5 rekomandime, janë pranuar plotësisht 5 të cilat kanë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon, 5 Zbatuar.

b) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 2 Masa shpërblim dëmi nga ku 3 rekomandime, janë

pranuar plotësisht 3 të cilat kanë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon, 1 Zbatuar dhe 2 të pazbatuar.

c) Për përmirësimin e gjendjes është lënë 1 Masë disiplinore nga ku 1 rekomandim, i cili nuk është zbatuar.

Më hollësisht, auditimi i ndjekjes së rekomandimeve paraqitet si vijon:

MASA ORGANIZATIVE

1.1. Rekomandim: Bashkia Vlorë të marrë masa për përpilimin e seteve të plota, të qarta dhe të sakta të dokumentacionit dhe korrespondencave zyrtare mes institucioneve, duke përfshirë autorizimet për personat e ngarkuar me nënshkrimin e dokumentacionit në emër të titullarit, si dhe garantimin e të gjithë elementëve shkresore zyrtare në shkëmbimet mes njërive.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigja e institucionit (BV):

Institucioni në vijimësi të procesit ka ruajtur një komunikim të rregullt e zyrtar me të gjitha njësitë e aktorët e përfshirë në procesin e Deinstitutionalizimit, duke komunikuar vetëm nëpërmjet shkresave zyrtare, të firmosura nga Kryetari i Bashkisë Vlorë. Për referencë keni marrëveshjen e bashkëpunimit me SOS, Fshatrat e fëmijëve Shqipëri, nr. 10894 prot., datë 30.09.2022 dhe shkresën nr.4437 prot., datë 13.04.2023 drejtuar IPSH Vlorë por gjithashtu të gjitha dokumentat referuar rekomandimeve të mëposhtme janë dokumenta e korrespondenca zyrtare midis institucioneve të përfshira në procesin e DI.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe i zbatuar**

2.1. Rekomandim: Bashkia Vlorë, të marrë masa për hartimin e përshkrimeve të punës për secilin nga pozicionet e strukturës së ShMFF, duke përcaktuar qartë dallimet dhe ndarjen e kompetencave me PMF, si dhe të përfshijë këto ndryshime në Rregulloren e Brendshme të Funkcionimit.

Menjëherë

Përgjigja e institucionit (BV):

Bashkia Vlorë ka marrë masa për plotësimin e Drejtorisë së Ndhmës e Shërbimit Social me punonjës për Mbrojtjen e Fëmijës, si dhe ka përfshirë në strukturën e Bashkisë Vlorë edhe stafin e SHMFF. Gjithashtu është realizuar përshkrimi i punës për gjithë stafin e strukturës së SHMFF dhe përfshirjen e tyre në Rregulloren e Brendshme të Funkcionimit.

Komenti i grupit të auditimit.

Referuar dokumentacionit të vendosur në dispozicion nga ana e institucionit, u konstatua prania e shkresës së emërimit të znj. Miri në pozicionin e specialiste e mbrojtjes së fëmijëve PMF Vlorë. U konstatua prania e gjurmës së marrjes së masave për hartimin e përshkrimeve të punës për secilin nga pozicionet e strukturës së ShMFF, dhe reflektimi i këtyre ndryshimeve në Rregulloren e Brendshme të Funkcionimit (draft).

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe i zbatuar**.

3.1. Rekomandim: Bashkia Vlorë, Drejtoria e Ndhmës dhe Shërbimit Social dhe ShMFF, të marrin masa për fuqizimin dhe angazhimin me seriozitet në rolin e strukturave kyçe në procesin e deinstitutionalizimit, duke analizuar shkaqet e zvarritjes së këtij procesi dhe duke hartuar plane specifike pune me veprime konkrete për zgjidhjen e këtyre pengesave, si dhe duke i

mbështetur këto veprime me fushata intensive sensibilizimi për rëndësinë e këtij procesi.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigja e institucionit (BV):

Në lidhje me mungesën e bashkëpunimit të Shtëpisë së Foshnjës dhe SHMFF ju vëmë në dispozicion kërkesat zyrtare dhe me email (2465/2 datë 19.05.2022 dhe 6892 datë 16.06.2022), të SHMFF drejtuar Shërbimit Social Shtetëror e Rajonal , dhe IPSH Vlorë për tu koordinuar me këtë strukturë për Interesin më të lartë të fëmijës (si dhe minuta takimi nga mbledhjet që janë realizuar më pas për tu njohur me dosjet e fëmijëve e mundësitë e deinstitutionalizimit të tyre (ju lutem mbani në konsideratë konfidencialitetin e tyre).

Së dyti, në lidhje me institucionalizimin e dy fëmijëve të vendosur në kushte emergjence me Vendim të Kryetarit të Bashkisë, ju bëjmë më dije se, fëmija E.V është rikthyer në familjen biologjike (Vendimi i gjykatës nr.1110 i regj, nr 724 i vendimit datë 15.12.2022) ndërsa fëmija K.SH është birësuar .

Së treti, në lidhje me kujdestarinë alternative ju informojmë se, Bashkia Vlorë me shkresë nr.5736 prot., datë 23.05.2022 ka ngritur Komisionin Multidisiplinar të Kujdestarisë Alternative me Urdhër të Brendshëm nr 126 datë 23.05.2022 dhe rregjistrin e Familjeve Kujdestare Alternative ku janë miratuar 2 familje kujdestare alternative.

Ne lidhje me Rekomandim tuaj ju vëmë në dispozicion edhe planet e punës së Shërbimit Mbështetës për Fëmijën e Familjen për vitin 2022 dhe 2023 (nr.4406 prot., datë 26.04.2022 dhe nr.2592 prot., datë 28.02.2023)

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe i zbatuar**

4.1. Rekomandim : Bashkia Vlorë dhe Drejtoria e Ndhmës dhe Shërbimit Social të marrin masa për angazhimin me seriozitet dhe mbështetjen me të gjithë kapacitetet apo logjistikën e nevojshme në përmbushje të detyrimeve të marrëveshjes. Duke qenë se në dokumentet e politikave flitet për transformim të shërbimit, këto struktura të marrin masa për gjetjen e një zgjidhje së pari sa i takon ambienteve, duke integruar brenda hapësirave të rezidencës aktuale të ISHP dhe zyrave të SHMFF, të gjitha shërbimet që parashikon mbështetja për fuqizimin e fëmijës dhe familjes.

Menjëherë

Përgjigja e institucionit (BV):

Struktura e SHMFF është integruar shumë mirë në sistemin aktual të shërbimeve sociale. Ritheksojmë se PMF është strukturë koordinuese ndërsa SHMFF është shërbim ofrues dhe nuk ka mbivendosje të roleve të tyre. Të dyja strukturat koordinohen mjaft mirë në menaxhimin e rasteve. Ju vëmë në dispozicion edhe minuta takimi nga mbledhjet e shpeshta të realizuara.

Së dyti, për arsye të mungesave në logjistikë, Bashkia Vlorë ka bërë të mundur vendosjen e përkohshme të strukturës së SHMFF në dy zyra të marra me qera (kontrata nr.3128/2 datë 30.03.2022 dhe kontrata nr.1142 datë 27.01.2023.)

Së treti, në lidhje me rishikimin e dokumentacionit të hartuar nga Nisma ARSIS, kemi marrë me shkresë zyrtare (nr 23 prot., datë 08.03.2022 dhe me tonën nr.2588 prot., datë 10.03.2022; nr 65 prot., datë 19.05.2022 dhe me tonën nr.5781 prot., datë 23.05.2022; nr.112 prot., datë 20.07.2022 dhe me tonën nr.8374 prot., datë 25.07.2022) të gjitha dokumentat e realizuara në bashkëpunim. Më pas kemi kërkuar bashkëpunimin për miratimin e gjithë paketës së dokumentave në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me shkresë nr.11291 prot., datë 06.10.2022 dhe kemi marrë përgjigje konfirmuese nga Ministria me shkresë nr.3894/1 prot., datë 05.12.2022.

Me Vendim të Këshillit Bashkiak nr.9 datë 24.02.2023 është miratuar e gjithë paketa e

dokumentave të funksionimit të SHMFF.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe i zbatuar**

4.2. Rekomandim: Bashkia Vlorë të marrë masa për shqyrtimin dhe miratimin e të gjithë setit të manualeve, udhëzuesve, apo protokolleve të paraqitur nga Nisma ARSIS, duke i bërë ato të aplikueshme sa më parë.

Menjëherë

Përgjigjja e institucionit (BV):

Sikurse edhe më lart, gjithë paketa e dokumentacionit është miratuar sipas procedurave zyrtare dhe është e aplikueshme nga stafi i SHMFF.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe i zbatuar**

MASA SHPËRBLIM DËMI

5.2. Rekomandim: Nga Bashkia Vlorë, të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **902,000 lekë**, si pasojë e pagesave të kryera padrejtësisht për shërbimin e trajnimeve, supervizimit dhe mentorimit ndaj organizatës Nisma ARSIS.

Deri më datë 30.07.2022

Përgjigjja e institucionit (BV):

Bashkia Vlorë do të marrë masa për fillimin e procedurave administrative e gjyqësore nëpërmjet Drejtorisë Juridike të saj , për arkëtimin e vlerës së dëmit.

Komenti i grupit të auditimit.

Përsa i përket Rekomandimt të mësipërm nga ana e institucionit nuk disponohej gjurmë justifikuese e zbatimit të tij. Po ashtu, referuar përgjigjes konstatohet se ky rekomandim ende nuk është zbatuar.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe i pazbatuar.**

Observacion dërguar me shkresën nr.8503/2 prot., datë 11.10.2023 protokolluar me tonën me nr.613/60 prot., datë 13.10.2023

Në lidhje me pikën Masë Shpërblim Dëmi, për arkëtimin e vlerës 902,000 lekë, si pasojë e pagesave të kryera padrejtësisht për shërbimin e trajnimeve, supervizimit dhe mentorimit ndaj organizatës Nisma ARSIS, Bashkia Vlorë do të marr masa për fillimin e procedurave administrative e gjyqësore nëpërmjet Drejtorisë Juridike, për arkëtimin e vlerës së dëmit.

Qendrimi i grupit të auditimit

Njohur me observacionin e paraqitur prej Bashkisë Vlorë sikundër si më sipër cituar, sjellim në vëmendjen tuaj se, jemi në kushtet e pranimit të konstatimit të nxjerr prej grupit të auditimit dhe nuk paraqiten fakte/evidenca për kundërshtim të tij. Viojmë të mbajmë të njëjtin qëndrim sa i takon zbatueshmërisë së Rekomandimt.

Sa më sipër observacioni nuk merret në konsideratë.

6.2. Rekomandim: Nga Bashkia Vlorë, të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **325,000 lekë**, si pasojë e pagesave të kryera padrejtësisht për “Hartimi i procedurave,

rregulloreve dhe manualeve të shërbimit “ndaj organizatës Nisma ARSIS.

Deri më datë 30.07.2022

Përgjigja e institucionit (BV):

Bashkia Vlorë do të marrë masa për fillimin e procedurave administrative e gjyqësore nëpërmjet Drejtorisë Juridike të saj, për arkëtimin e vlerës së dëmit.

Komenti i grupit të auditimit.

Përsa i përket Rekomandim të mësipërm nga ana e institucionit nuk disponohej gjurmë justifikuese e zbatimit të tij. Po ashtu, referuar përgjigjes konstatohet se ky rekomandim ende nuk është zbatuar.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe i pazbatuar.**

Observacion dërguar me shkresën nr.8503/2 prot., datë 11.10.2023 protokolluar me tonën me nr.613/60 prot., datë 13.10.2023

Në lidhje me pikën MASë Shpërblim Dëmi, për arkëtimin e vlerës 325,000 lekë, si pasojë e pagesave të kryera padrejtësisht për “Hartimin e procedurave, rregulloreve dhe manualeve të shërbimit”, ndaj organizatës Nisma ARSIS, Bashkia Vlorë do të marr masa për fillimin e procedurave administrative e gjyqësore nëpërmjet Drejtorisë Juridike, për arkëtimin e vlerës së dëmit.

Qendrimi i grupit të auditimit

Njohur me observacionin e paraqitur prej Bashkisë Vlorë sikundër si më sipër cituar, sjellim në vëmendjen tuaj se, jemi në kushtet e pranimit të konstatimit të nxjerr prej grupit të auditimit dhe nuk paraqiten fakte/evidenca për kundërshtim të tij. Viojmë të mbajmë të njëjtin qëndrim sa i takon zbatueshmërisë së Rekomandim.

Sa më sipër observacioni nuk merret në konsideratë.

6.3. Rekomandim: Nga Bashkia Korçë, Bashkia Vlorë, Grupi Teknik i Punës dhe Komiteti Drejtues të merren për rishikimin dhe miratimin e dokumenteve të nevojshme për procedurat e punës për zbatimin e planit të deinstitutionalizimit. Hartimi dhe miratimi i procedurave dhe manualeve të shërbimit duhet të jetë i unifikuar për të dy bashkitë pilot, në mënyrë të tillë, që nëse ky plan rezulton i suksesshëm në dy bashkitë pilot të vijojë të ndiqet në nivel kombëtar. Prandaj përfshirja e anëtarëve të GTP në hartimin e këtyre dokumenteve dhe miratimi i dokumenteve nga Komiteti Drejtues është proces shumë i rëndësishëm.

Menjëherë

Përgjigja e institucionit (BV):

Bashkia Vlorë është pjesë e Komitetit Drejtues për DI dhe merr pjesë aktive në aplikimin e gjithë planeve të punës që synojnë suksesin e Planit Kombëtar të Deinstitutionalizimit. Ju vëmë në dispozicion vendimin nr.01 datë 31.01.2023 Për miratimin e vijimësisë së planit të veprimit për zbatimin e planit Kombëtar të Deinstitutionalizimit 2020-2022, për vitin 2023. Ky vendim është i miratuar nga anëtarët e Komitetit Drejtues, parashikon gjithë punën dhe aktivitetet në kuadër të vazhdimin të këtij procesi, si dhe detyrat për secilin prej institucioneve.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe i zbatuar**

MASA DISIPLINORE

D.2 Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin e Punës.

D.2.2 Në mbështetje të shkronjës (c) neni 15 - Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”,

nenin 37 të ligjit nr. 7691, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar si dhe kontratës individuale, i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Vlorë, pasi të jenë shqyrtuar dhe vlerësuar shkeljet e evidentuara dhe të jenë identifikuar përgjegjësit në lidhje me këto shkelje, kërkojmë fillimin e dhënies së masave disiplinore nga “Vërejtje” deri në “Largim nga puna” për të gjithë punonjësit e konstatuar me përgjegjësi sipas çështjeve të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

Përgjigjja e institucionit:

Mungon

Komenti i grupit të auditimit

Përsa i përket Rekomandimit të mësipërm nga ana e Bashkisë Vlorë nuk disponohej gjurmë justifikuese lidhur me qëndrimin sa i takon kësaj pike Rekomandim.

Për këtë shkak, Rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe i pazbatuar**.

KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve në Bashkinë Vlorë për Raportin Përfundimtar të Auditimit me objekt “Auditim përputhshmërie dhe Vlerësues me fokus Plani Kombëtar të Deinstitutionalizimit të Fëmijëve 2020 – 2022”, të ushtruar në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Shërbimin Social Shtetëror, Bashkinë Vlorë, Bashkinë Korçë, sipas programit të auditimit nr. 1267/1 prot., datë 22.11.2021, i ndryshuar, rezulton se subjekti i audituar nuk ka respektuar afatin 20 ditor për hartimin e planit të masave për zbatimin e rekomandimeve në kundërshtim me kërkesat e nenit 15 shkronja (j) të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, si dhe nuk ka njoftuar brenda 6 muajve mbi ecurinë e zbatimit të këtyre masave, në kundërshtim me kërkesat e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Konkretisht ecuria e zbatimit të rekomandimeve paraqitet sipas tabelës “*Ecuria e zbatimit të rekomandimeve*”

lekë

Rekomandime	Gjithsej		Pranuar		Zbatuar plotësisht		Pjesërisht		Në proces		Pa zbatuar	
	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë
Organizative	5	-	5	-	5	-	-	-	-	-	-	-
Shpërblim dëmi	3	1,227,000	3	1,227,000	1	-	-	-	-	-	2	1,227,000
Disiplinore	1	-	1	-	-	-	-	-	-	-	1	-
Gjithsej	9	1,227,000	9	1,227,000	6	-	-	-	-	-	3	1,227,000

Sa sipër rezulton se janë dhënë gjithsej 9 rekomandime të cilët janë pranuar plotësisht (100 %), dhe rezultojnë të zbatuar plotësisht 6 masa (67 %).

Për të gjitha rekomandimet që konsiderohen në proces zbatimi, inkurajohet përshpejtimi i realizimit të plotë të tyre.

Për sa më sipër ri kërkojmë që Bashkia Vlorë të marrë të gjitha masat e nevojshme me qëllim zbatimin e të gjitha rekomandimeve që rezultojnë të pazbatuara brenda 3-mujorit të parë të vitit 2024. Si dhe kërkojmë marrjen e masave disiplinore për zyrtarët përgjegjës, në lidhje me rekomandimet e KLSH të pranuar prej institucionit dhe që efektivisht rezultojnë të pazbatuara.

3.16 BASHKIA KORÇË (Deinstitutionalizimi)

PËRMBLEDHJE

Në zbatim të Programit të Auditimit nr. 613/22 prot., datë 06.07.2023 “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e evaduara në 6-mujorin e parë të vitit 2022”, në ambientet e Bashkisë Korçë, më datë 27.07.2023 u mbajt akt-verifikimi nga audituesit e autorizuar të KLSH-së J.K dhe S.K, me përfaqësues nga subjekti z. S. F. në cilësinë e Titullarit të institucionit dhe znj. A. D. e autorizuar për trajtimin e rekomandimeve të KLSH-së.

Objekt i këtij akt verifikimi është:

Verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të KLSH të lëna me shkresën nr. 1267/24 prot., datë 07.06.2022, për Raportin Përfundimtar të Auditimit “Për auditimin financiar dhe përputhshmëri” të ushtruar në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Shërbimin Social Shtetëror, Bashkinë Vlorë, Bashkinë Korçë, sipas programit të auditimit nr. 1267/1 prot., datë 22.11.2021, i ndryshuar, për veprimtarinë nga data 01.09.2019 deri në 30.11.2021, në lidhje mbi statusin e zbatimit të rekomandimeve, afateve dhe niveli i zbatueshmërisë së tyre, koherencën e tyre si dhe përgjegjshmërinë menaxheriale referuar standardeve të auditimit.

Auditimi u krye nga:

1. J.K
2. S.K

Auditimi ka filluar më datë 07.07.2023

Auditimi ka përfunduar më datë 27.07.2023

Auditimi është kryer në bazë të Programit të Auditimit të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit nr.613/22 prot., datë 06.07.2023 me objekt: “Mbi verifikimin e zbatimit të rekomandimeve”, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” si dhe në zbatim të Rregullores së Procedurave të Auditimit dhe të Manualit për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të auditimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe Regjistrit elektronik institucional, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 67, datë 13.06.2020.

TRAJTIMI I ÇËSHTJEVE TË AUDITIMIT

Nga auditimi i ushtruar në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Shërbimin Social Shtetëror, Bashkinë Vlorë, Bashkinë Korçë, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, “Mbi auditimin financiar dhe përputhshmëri” për periudhën e veprimtarisë nga data 01.09.2020 deri në 30.11.2021 trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin nr.93 datë 03.06.2022, të Kryetarit të KLSH-së, të cilat janë përcjellë me shkresën nr 1267/24 prot., datë 07.06.2022, rezulton se:

I. Hartimi i programit (Plan veprimit) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në nenin 15 shkronja (j) të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”.

Nga auditimi u konstatua se, Bashkia Korçë ka miratuar planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, duke e dërguar në KLSH me shkresë nr. 3/10 prot., datë 27.06.2022, kjo në përputhje me ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” nenit 15, shkronja j.

Sa më sipër rezulton se është zbatuar afati 20 ditor për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve.

II. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga

auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Në lidhje mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve dhe afatet e përcaktuara, sipas strukturave përgjegjëse Bashkia Korçë ka përgatitur planin e masave të marra lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të miratuara nga titullari brenda afatit 6 mujor me nr 8081/1 prot., datë 14.11.2022, dërguar në KLSH, kjo në përputhje me ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” nenit 30, pika 2 e tij.

Sa më sipër rezulton se është zbatuar afati 6 mujor për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve.

III. Realizimi i rekomandimeve

Nga ana e KLSH-së, janë lënë 3 masa organizative, 3 masa shpërblim dëmi, 1 masë disiplinore. Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

- a) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 3 Masa Organizative, nga ku 3 rekomandime, të pranuar plotësisht, të cilat kanë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon, 3 Zbatuar.
- b) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 3 Masa shpërblim dëmi në vlerën 1,612,000 lekë nga ku 4 rekomandime, të pranuar plotësisht, të cilat kanë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon, 4 zbatuar.
- c) Për përmirësimin e gjendjes është lënë 1 Masë disiplinore nga ku 1 rekomandim, i pranuar plotësisht, i cili ka statusin e ecurisë së zbatimit si vijon, 1 zbatuar.

Më hollësisht, auditimi i ndjekjes së rekomandimeve në Bashkinë Korçë paraqitet si vijon:

MASA ORGANIZATIVE

1.1. Rekomandim: Bashkia Korçë të marrë masa për përpilimin e seteve të plota, të qarta dhe të sakta të dokumentacionit dhe korrespondencave zyrtare mes institucioneve, duke përfshirë autorizimet për personat e ngarkuar me nënshkrimin e dokumentacionit në emër të titullarit, si dhe garantimin e të gjithë elementëve shkresorë zyrtare në shkëmbimet mes njëjësive.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e institucionit: Nga ana e Bashkisë Korçë në vazhdim të punës me organizatën Nisma për Ndryshim Shoqëror, ARSIS, ka përfunduar përpilimin e setit të plotë të dokumentacionit të punës të SHMFF-së . Korrespondenca midis dy institucioneve, si dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është realizuar nëpërmjet shkresave zyrtare. Bashkia Korçë me vendimi të Këshillit Bashkiak Korçë Nr 8 datë 25.01.2023, ka miratuar paketën e plotë të dokumenteve të punës, për ofrimin e shërbimeve mbështetëse për fëmijën dhe familjen. Konfirmimi i bazueshmërisë ligjore Prefektit të Qarkut Korçë datë 03.02.2023 nr 104/1 Prot.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **zbatuar**.

2.1. Rekomandim: Bashkia Korçë të marrë masa të menjëhershme për të reflektuar sa më shpejt termat e referencës së SHMFF në Rregulloren e Brendshme, pasi ato të kenë marrë miratimet përkatëse për këtë qëllim.

Menjëherë

Përgjigjja e institucionit: Nga ana e Bashkisë Korçë me urdhrin e Kryetarit nr. 142/1 datë

11.07.2022 “Për disa shtesa dhe ndryshime në rregulloren për organizimin e funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës së Bashkisë Korçë” janë reflektuar termat e referencës për SHMFF.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **zbatuar**.

3.1. Rekomandim: Bashkia Korçë të marrë masat për zyrtarizmin e komunikimeve me partnerin e projektit, duke përcaktuar personin e kontaktit për bashkinë dhe duke kërkuar nga NISMA përcaktimin zyrtar të personit të kontaktit, si dhe duke proceduar me miratimet dhe diskutimet përkatëse për çdo dokument të prodhuar nga partneri në përfitim të bashkisë.

Menjëherë

Përgjigjja e institucionit: Nga ana e Bashkisë Korçë në vijim të komunikimit me organizatën NISMA, ARSIS korespondenca është mbajtur në mënyrë shkresor:

Datë 08.03.2022 nr 24 prot. Dërgim dokumentacioni :

1. Kalendar i punës për realizimin e aktiviteteve për vitin 2022
 2. Dokumentin e punës për mekanizimin e mentorimit dhe supervizimit nga NISMA. ARSIS Kthim përgjigje Drejtorja e Kujdesit Social për dakortësimin e dokumentave datë 18.03.2022.
- Datë 19.05.2022 dërgim dokumentacioni:

- 1 Dokumenti mbi Politikën e Mbrojtjes
2. Dokument mbi termat e referencës për shërbimet e specializuara.
3. Dokument mbi Kodin e Etikës
4. Dokument mbi termat e referencës për shërbim të specializuar.
5. Dokument mbi mirtaimin e infomuar
6. Dokument mbi marrëveshjen tip për ofrimin e Shërbimeve.

Kthim përgjigje Drejtorja e Kujdesit Social për dakortësimin e dokumentave datë 2.6.2022 nr 4615/1 prot., datë 20.7.2022 nr 113. Prot dërgimi dokumentacionit :

1. Dokument mbi Protokollin e punës së SHMFF
 2. Dokument mbi procedurat e ofrimit të shërbimit kujdesit në familje.
 3. Dokument mbi procedurat e ofrimit të Klasave të Prindërimit.
 4. Dokument mbi rregulloren dhe administrimin e bankës së veshmbathjeve dhe mjeteve higjienosanitre.
 5. Dokument mbi mekanizmin e llogaridhënies së SHMFF.
 6. Dokument për monitorimin të Shërbimit KAP
- Kthim përgjigje Drejtorja e Kujdesit Social për dakortësimin e dokumentave datë 29.07.2022.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **zbatuar**.

MASA SHPËRBLIM DËMI

4.1. Rekomandim: Nga Bashkia Korçë, të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës 877,000 lekë, si pasojë e pagesave të kryera padrejtësisht për shërbimin e trajnimeve, supervizimit dhe mentorimit ndaj organizatës Nisma ARSIS.

Deri më datë 30.07.2022

Përgjigjja e institucionit:

Nga ana e Bashkisë Korçë me urdhrin nr.642 datë 29.06.2022 është bërë kontabilizimi i detyrimit në vlerën 877,000 lekë. Me njoftimin nr.6371 prot datë 18.07.2022 nga ana jonë është vënë në dijeni Nisma Arsis për likuidimin në mënyrë vullnetare në favor të Bashkisë Korçë shumën e sipërcituar. Kjo shumë nuk u likuidua vullnetarisht.

Pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë u depozitua kërkesë padia datë 7.12.2022 për përmbushjen e detyrimit në rrugë gjyqësore.

Jane zhvilluar disa seanca ne Gjykatën Administrative te shkalles se pare Korce por per shkak te ndarjes se re territoriale te gjykatave ceshtja u dergua ne Gjykatën Administrative te shkalles se pare Tirane. Aty nuk eshte zhvilluar asnje seance deri tani

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti, dhe është **zbatuar**.

5.1. Rekomandim: Nga Bashkia Korçë, të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës 325,000 lekë, si pasojë e pagesave të kryera padrejtësisht për “Hartimi i procedurave, rregulloreve dhe manualeve të shërbimit “ndaj organizatës Nisma ARSIS.

Deri më datë 30.07.2022

Përgjigjja e institucionit: Nga ana e Bashkisë Korçë me urdhrin nr.642 datë 29.06.2022 është bërë kontabilizimi i detyrimit në vlerën 325,000 lekë. Me njoftimin nr.6371 prot., datë 18.07.2022 nga ana jonë është vënë në dijeni Nisma Arsis për likuidimin në mënyrë vullnetare në favor të Bashkisë Korçë shumën e sipërcituar. Kjo shumë nuk u likuidua vullnetarisht .

Pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë u depozitua kërkesë padia datë 07.12.2022 për përmbushjen e detyrimit në rrugë gjyqësore.

Janë zhvilluar disa seanca ne Gjykatën Administrative të shkallës së parë Korçë por për shkak të ndarjes së re territoriale të gjykatave çështja u dërgua në Gjykatën Administrative të shkallës së parë, Tiranë. Aty nuk është zhvilluar asnjë seancë deri tani.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti, dhe është **zbatuar**.

5.2. Rekomandim: Nga Bashkia Korçë, Bashkia Vlorë, Grupi Teknik i Punës dhe Komiteti Drejtues të merren për rishikimin dhe miratimin e dokumenteve të nevojshme për procedurat e punës për zbatimin e planit të deinstitutionalizimit. Hartimi dhe miratimi i procedurave dhe manualeve të shërbimit duhet të jetë i unifikuar për të dy bashkitë pilot, në mënyrë të tillë, që nëse ky plan rezulton i suksesshëm në dy bashkitë pilot të vijojë të ndiqet në nivel kombëtar. Prandaj përfshirja e anëtarëve të GTP në hartimin e këtyre dokumenteve dhe miratimi i dokumenteve nga Komiteti Drejtues është proces shumë i rëndësishëm.

Menjëherë

Përgjigjja e institucionit: Nga ana e Bashkisë Korçë me shkresë datë 28.08.2022 i është kërkuar Komitetit Drejtues miratimi i procedurave dhe manualeve të shërbimit. Kthimi përgjigje e Komitetit Drejtues datë 05.12.2022 nr 3382/1 Prot “Miratimin e paketës së dokumenteve të punës, për ofrimin e Shërbimit Mbështetës për Fëmijën dhe Familjen.

Komenti i grupit të auditimit

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti, dhe është **zbatuar**.

6.1. Rekomandim: Nga Bashkia Korçë, të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës 410,000 lekë, si pasojë e pagesave të kryera padrejtësisht për “menaxhim shërbimi”, “oficer finance” dhe “shofer” ndaj organizatës Nisma ARSIS.

Menjëherë

Përgjigja e institucionit: Nga ana e Bashkisë Korçë me urdhrin nr.642 datë 29.06.2022 është bërë kontabilizimi i detyrimit në vlerën 410,000 lekë. Me njoftimin nr.6371 prot., datë 18.07.2022 nga ana jonë është vënë në dijeni Nisma Arsis për likuidimin në mënyrë vullnetare në favor të Bashkisë Korçë shumë e sipërcituar. Kjo shumë nuk u likuidua vullnetarisht. Pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë u depozitua kërkesë padia datë 7.12.2022 për përmbushjen e detyrimit në rrugë gjyqësore. Janë zhvilluar disa seanca në Gjykatën Administrative të shkallës së parë Korçë por për shkak të ndarjes së re territoriale të gjykatave çështja u dërgua në Gjykatën Administrative të shkallës së parë, Tiranë. Aty nuk është zhvilluar asnjë seancë deri tani.

Komenti i grupit të auditimit

Për sa më sipër trajtuar Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti, dhe është **zbatuar**.

MASA DISIPLINORE

D.2 Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin e Punës.

D.2.2 Në mbështetje të shkronjës (c) neni 15 -Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, nenin 37 të ligjit nr. 7691, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar si dhe kontratës individuale, i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Korçë, pasi të jenë shqyrtuar dhe vlerësuar shkeljet e evidentuara dhe të jenë identifikuar përgjegjësit në lidhje me këto shkelje, kërkojmë fillimin e dhënies së masave disiplinore nga “Vërejtje” deri në “Largim nga puna” për të gjithë punonjësit e konstatuar me përgjegjësi sipas çështjeve të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

Përgjigja e institucionit:

Kryetari i Bashkisë Korçë do shqyrtojë dhe vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave disiplinore në raport me shkeljet nga “vërejtje” deri në “largim nga puna”.

Komenti i grupit të auditimit:

Grupi i auditimit konstaton se, Bashkia Korçë ka miratuar planin e veprimit për të zbatuar këtë rekomandim, me shkresën nr. 3/9 prot., datë 20.06.2022, por në planin e masave të marra lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të miratuara nga titullari brenda afatit 6 mujor me nr 8081/1 prot., datë 14.11.2022, dërguar në KLSH, nuk figuron më si një pikë Rekomandim Për këtë shkak, Rekomandim konsiderohet **i pranuar** nga subjekti, dhe **i zbatuar**.

KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve në Bashkinë Korçë për Raportin Përfundimtar të Auditimit “Për auditimin financiar dhe përputhshmëri” dërguar me shkresën nr. 1267/1 prot, datë 22.11.2021, rezulton se subjekti i audituar ka respektuar afatin 20 ditor për hartimin e planit të masave për zbatimin e rekomandimeve në përputhje me kërkesat e nenit 15 shkronja (j) të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të

Lartë të Shtetit, ka respektuar afatin për njoftimin brenda 6 muajve mbi ecurinë e zbatimit të këtyre masave, në përputhje me kërkesat e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Konkretisht ecuria e zbatimit të rekomandimeve paraqitet sipas tabelës “Ecuria e zbatimit të rekomandimeve”

lekë

Masa	Gjithsej		Pranuar		Zbatuar plotësisht		Pjesërisht		Në proces		Pa zbatuar	
	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë
Organizative	3	-	3	-	3	-	-	-	-	-	-	-
Shpërblim dëmi	4	1,612,000	4	1,612,000	4	-	-	-	-	-	-	-
Disiplinore	1	-	1	-	1	-	-	-	-	-	-	-
Gjithsej	8	1,612,000	8	1,612,000	8	1,612,000	-	-	-	-	-	-

Sa sipër rezulton se janë dhënë gjithsej 8 rekomandime të cilët janë pranuar plotësisht (100 %), dhe rezultojnë të zbatuar plotësisht 8 masa (100 %).

4. ANEKSE

ANEKS 1 EVIDENCA PËR NDRYSHIMET LIGJORE DHE MASAT ORGANIZATIVE

Formulari nr.1

Subjekti	Respektimi afatit		Gjithsej	Ndryshime e përmirësime ligjore						Gjithsej	Masa organizative					
	20 ditë	6 muaj		Nga këto			Nga rekomandimet e pranuar				Nga këto			Nga rekomandimet e pranuar		
				Pranuar	Pa pranuar	Zbatuar	Zbatuar pjesërisht	Në proces	Pa zbatuar		Pranuar	Pa pranuar	Zbatuar	Zbatuar pjesërisht	Në proces	Pa zbatuar
Kuvendi Shqipërisë	PO	PO	2	2	-	-	2	-	-	11	11	-	9	-	2	-
Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare	PO	PO	-	-	-	-	-	-	-	8	8	-	8	-	-	-
Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit	PO	JO	-	-	-	-	-	-	-	21	21	-	15	-	3	3
Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore	PO	JO	2	2	-	-	1	-	-	41	36	5	16	4	14	2
Bashkia Vlorë (Deinstitucionalizimi)	JO	JO	-	-	-	-	-	-	-	5	5	-	5	-	-	-
Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	PO	JO	-	-	-	-	-	-	-	3	3	-	2	-	1	-
Bashkia Korçë	PO	PO	-	-	-	-	-	-	-	3	3	-	3	-	-	-
Ministria e Arsimit	PO	PO	-	-	-	-	-	-	-	25	25	-	13	-	9	3
Ministria e Arsimit (tematik)	PO	PO	3	3	-	-	1	-	2	5	5	-	4	-	-	1
Ministria e Kulturës	PO	JO	1	1	-	-	1	-	-	15	15	-	5	-	5	5
AKBN	PO	PO	1	1	-	-	1	-	-	52	52	-	36	4	10	2
AZHBR	PO	PO	-	-	-	-	-	-	-	40	40	-	28	2	7	3
QKTGJ	PO	PO	-	-	-	-	-	-	-	4	4	-	4	-	-	-
FSHZH	PO	PO	-	-	-	-	-	-	-	42	7	35	4	-	3	-
Cirku Tiranës	PO	PO	-	-	-	-	-	-	-	6	6	-	5	-	1	-
DPSHP	PO	JO	-	-	-	-	-	-	-	28	28	-	27	-	-	1
Shtëpia Fëmijës Zyber Hallulli	PO	JO	1	1	-	-	1	-	-	27	27	-	13	2	11	1
Totali			10	10	-	-	7	-	3	336	296	40	196	13	66	21

ANEKS 2 EVIDENCA PËR MASAT SHPËRBLIM DËMI

Formulari nr.2

Masa për shpërblim dëmi në mijë lekë														
Subjekti	Gjithsej		Nga këto				Nga rekomandimet e pranuar							
	Nr.	Vlerë	Pranuar		Pa pranuar		Zbatuar plotësisht		Pjesërisht		Në proces		Pa zbatuar	
			Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë
Kuvendi i Shqipërisë	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Drejtoria Shërbimeve Qeveritare	2	420,746	2	420,746	-	-	2	420,746	-	-	-	-	-	-
Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit	1	1,458,726	1	1,458,726	-	-	1	1,458,726	-	-	-	-	-	-

Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore	2	4,504,376	1	4,154,363	1	350,013	-	-	-	-	1	4,154,363	-	-
Bashkia Vlorë (Deinstitucionalizimi)	3	1,227,000	3	1,227,000	-	-	1	-	-	-	-	-	2	1,227,000
Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Cirku Tiranës	1	957,659	1	957,659	-	-	-	-	-	-	1	957,659	-	-
Bashkia Korçë	4	1,612,000	4	1,612,000	-	-	4	1,612,000	-	-	-	-	-	-
Ministria e Arsimit	3	2,840,960	3	2,840,960	-	-	1	132,577	-	-	2	2,840,960	-	-
Ministria e Arsimit (tematik)	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Ministria e Kulturës	2	947,476	2	947,476	-	-	2	947,476	-	-	-	-	-	-
AKBN	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
AZHBR	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
QKTGJ	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
FSHZH	21	23,729,475	19	6,985,197	2	16,744,278	19	2,452,000	-	-	-	4,533,197	-	-
DPSHP	1	322,951	1	322,951	-	-	-	-	-	-	1	322,951	-	-
Shtëpia Fëmijës Zyber Hallulli	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Totali	40	38,021,369	37	20,927,078	3	17,094,291	30	7,023,525	-	-	5	12,809,130	2	1,227,000

ANEKS 3

EVIDENCA PËR MASAT PËR ELEMENIMIN E EFEKTEVE FINANCIARE NEGATIVE

Formulari nr.3

Subjekti	Masa për eliminimin e efekteve financiare negative në mijë lekë														
	Gjithsej		Nga këto				Nga rekomandimet e pranuar								
	Nr.	Vlerë	Pranuar		Pa pranuar		Zbatuar plotësisht		Pjesërisht		Në proces		Pa zbatuar		
		Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë
Kuvendi Shqipërisë	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Drejtorja Shërbimeve Qeveritare	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Drejtorja e Përgjithshme e Policisë së Shtetit	1	-	1	-	-	-	1	-	-	-	-	-	-	-	-
Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore	2	26,948,923	2	26,948,923	-	-	-	-	-	-	2	26,948,923	-	-	
Bashkia Vlorë (Deinstitucionalizimi)	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	
Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	
Bashkia Korçë	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	
Ministria e Arsimit	9	279,973,334	9	279,973,334	-	-	9	279,973,334	-	-	-	-	-	-	
Ministria e Arsimit (Tematik)	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	
Ministria e Kulturës	7	17,290,708	7	17,290,708	-	-	-	-	-	-	6	15,407,254	1	1,883,454	
AKBN	1	4,720,000	1	4,720,000	-	-	-	-	1	320,000	-	-	-	-	
AZHBR	2	10,000,000	2	10,000,000	-	-	-	-	-	-	2	10,000,000	-	-	
QKTGJ	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	
FSHZH	12	303,365,996	-	-	12	303,365,996	-	-	-	-	-	-	-	-	
Cirku Tiranës	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	
DPSHP	4	-	4	-	-	-	4	-	-	-	-	-	-	-	
Shtëpia Fëmijës Zyber Hallulli	6	9,950,063	6	9,950,063	-	-	-	-	-	-	1	-	5	9,950,063	
Totali	44	652,249,024	32	348,883,028	12	303,365,996	13	279,973,334	2	320,000	11	52,356,177	6	11,833,517	

ANEKS 4

EVIDENCA E MASAVE DISIPLINORE DHE ADMINSTRATIVE

Formulari nr.4

Subjekti	Gjithsej	Masa Disiplinore						Gjithsej	Masa Administrative						
		Nga këto		Nga rekomandimet e pranuar					Nga këto		Nga rekomandimet e pranuar				
		Pranuar	Pa pranuar	Zbatuar	Zbatuar pjesërisht	Në proces	Pa zbatuar		Pranuar	Pa pranuar	Zbatuar	Zbatuar pjesërisht	Në proces	Pa zbatuar	
Kuvendi Shqipërisë	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Drejtorja e Shërbimeve Qeveritare	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Drejtorja e Përgjithshme e Policisë së Shtetit	1	1	-	-	-	1	1	1	1	-	-	-	1	-	
Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore	1	-	1	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	
Bashkia Vlorë (Deinstitucionalizimi)	1	1	-	-	-	1	-	-	-	-	-	-	-	-	

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	1	-	1	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Cirku Tiranës	2	2	-	1	-	-	1	-	-	-	-	-	-	-
Bashkia Korçë	1	1	-	1	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Ministria e Arsimit	1	1	-	-	-	-	1	-	-	-	-	-	-	-
Ministria e Arsimit (Tematik)	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Ministria e Kulturës	1	1	-	-	-	1	-	-	-	-	-	-	-	-
AKBN	1	1	-	1	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
AZHBR	1	1	-	1	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
QKTGJ	1	1	-	1	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Shtëpia Fëmijës Zyber Hallulli	1	1	-	-	-	-	1	-	-	-	-	-	-	-
FSHZH	1	-	1	-	-	-	-	1	-	1	-	-	-	-
DPSHP	1	1	-	1	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Totali	15	12	3	6	0	1	5	2	1	1	-	1	-	-

Aneksi 5

Shkalla e pranueshmërisë dhe zbatimit të rekomandimeve sipas llojit të masës për secilin subjekt të audituar

Formulari nr.5

Nr.	Subjektet dhe lloji i masave	Gjithsej	Nga këto		Nga rekomandimet e pranuar			
			Pranuar	Pa pranuar	Zbatuar	Zbatuar pjesërisht	Në proces	Pa zbatuar
	Totali	447	388	59	255	12	87	34
	<i>Përmirësimet për ndryshime ligjore</i>	10	10	-	7	-	3	-
	<i>Masa organizative</i>	336	296	40	197	12	66	21
	<i>Masa Administrative</i>	2	1	1	-	-	1	-
	<i>Masa për shpërblim dëmi</i>	40	37	3	30	-	5	2
	<i>Masa për eliminimin e efekteve financiare negative</i>	44	32	12	15	-	11	6
	<i>Masa disiplinore</i>	15	12	3	6	-	1	5
1	Kuvendi i Shqipërisë	13	13	-	11	-	2	-
	<i>Përmirësimet për ndryshime ligjore</i>	2	2	-	2	-	-	-
	<i>Masa organizative</i>	11	11	-	9	-	2	-
	<i>Masa Administrative</i>	-	-	-	-	-	-	-
	<i>Masa për shpërblim dëmi</i>	-	-	-	-	-	-	-
	<i>Masa për eliminimin e efekteve financiare negative</i>	-	-	-	-	-	-	-
	<i>Masa disiplinore</i>	-	-	-	-	-	-	-
2	Drejtoria Shërbimeve Qeveritare	10	10	-	10	-	-	-
	<i>Përmirësimet për ndryshime ligjore</i>	-	-	-	-	-	-	-
	<i>Masa organizative</i>	8	8	-	8	-	-	-
	<i>Masa Administrative</i>	-	-	-	-	-	-	-
	<i>Masa për shpërblim dëmi</i>	2	2	-	2	-	-	-
	<i>Masa për eliminimin e efekteve financiare negative</i>	-	-	-	-	-	-	-
	<i>Masa disiplinore</i>	-	-	-	-	-	-	-
3	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (Deinstitutionalizimi)	4	3	1	2	-	1	1
	<i>Përmirësimet për ndryshime ligjore</i>	-	-	-	-	-	-	-
	<i>Masa organizative</i>	3	3	-	2	-	1	-
	<i>Masa Administrative</i>	-	-	-	-	-	-	-
	<i>Masa për shpërblim dëmi</i>	-	-	-	-	-	-	-
	<i>Masa për eliminimin e efekteve financiare negative</i>	-	-	-	-	-	-	-
	<i>Masa disiplinore</i>	1	-	1	-	-	-	-
4	Ministria e Arsimit	38	38	-	23	-	11	4
	<i>Përmirësimet për ndryshime ligjore</i>	-	-	-	-	-	-	-
	<i>Masa organizative</i>	25	25	-	13	-	9	3
	<i>Masa Administrative</i>	-	-	-	-	-	-	-
	<i>Masa për shpërblim dëmi</i>	3	3	-	1	-	2	-
	<i>Masa për eliminimin e efekteve financiare negative</i>	9	9	-	9	-	-	-
	<i>Masa disiplinore</i>	1	1	-	-	-	-	1
5	Ministria e Arsimit (Tematik)	8	8	-	5	-	2	1
	<i>Përmirësimet për ndryshime ligjore</i>	3	3	-	1	-	2	-
	<i>Masa organizative</i>	5	5	-	4	-	-	1
	<i>Masa Administrative</i>	-	-	-	-	-	-	-
	<i>Masa për shpërblim dëmi</i>	-	-	-	-	-	-	-
	<i>Masa për eliminimin e efekteve financiare negative</i>	-	-	-	-	-	-	-
	<i>Masa disiplinore</i>	-	-	-	-	-	-	-
6	Ministria e Kulturës	26	26	-	8	-	12	6

	Përmirësime për ndryshime ligjore	1	1	-	1	-	-	-
	Masa organizative	15	15	-	5	-	5	5
	Masa Administrative	-	-	-	-	-	-	-
	Masa për shpërblim dëmi	2	2	-	2	-	-	-
	Masa për eliminimin e efekteve financiare negative	7	7	-	-	-	6	1
	Masa disiplinore	1	1	-	-	-	1	-
7	Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore	48	41	7	17	4	18	2
	Përmirësime për ndryshime ligjore	2	2	-	1	-	1	-
	Masa organizative	41	36	5	16	4	14	2
	Masa Administrative	-	-	-	-	-	-	-
	Masa për shpërblim dëmi	2	1	1	-	-	1	-
	Masa për eliminimin e efekteve financiare negative	2	2	-	-	-	2	-
	Masa disiplinore	1	-	1	-	-	-	-
8	Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore	55	55	0	39	4	10	2
	Përmirësime për ndryshime ligjore	1	1	-	1	-	-	-
	Masa organizative	52	52	-	36	4	10	2
	Masa Administrative	-	-	-	-	-	-	-
	Masa për shpërblim dëmi	-	-	-	-	-	-	-
	Masa për eliminimin e efekteve financiare negative	1	1	-	1	-	-	-
	Masa disiplinore	1	1	-	1	-	-	-
9	Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural	43	43	-	29	2	9	3
	Përmirësime për ndryshime ligjore	-	-	-	-	-	-	-
	Masa organizative	40	40	-	28	2	7	3
	Masa Administrative	-	-	-	-	-	-	-
	Masa për shpërblim dëmi	-	-	-	-	-	-	-
	Masa për eliminimin e efekteve financiare negative	2	2	-	-	-	2	-
	Masa disiplinore	1	1	-	1	-	-	-
10	Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut	5	5	-	5	-	-	-
	Përmirësime për ndryshime ligjore	-	-	-	-	-	-	-
	Masa organizative	4	4	-	4	-	-	-
	Masa Administrative	-	-	-	-	-	-	-
	Masa për shpërblim dëmi	-	-	-	-	-	-	-
	Masa për eliminimin e efekteve financiare negative	-	-	-	-	-	-	-
	Masa disiplinore	1	1	-	1	-	-	-
11	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit	25	25	-	17	-	4	4
	Përmirësime për ndryshime ligjore	-	-	-	-	-	-	-
	Masa organizative	21	21	-	15	-	3	3
	Masa Administrative	1	1	-	-	-	1	-
	Masa për shpërblim dëmi	1	1	-	1	-	-	-
	Masa për eliminimin e efekteve financiare negative	1	1	-	1	-	-	-
	Masa disiplinore	1	1	-	-	-	-	1
12	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	77	26	51	23	-	3	-
	Përmirësime për ndryshime ligjore	-	-	-	-	-	-	-
	Masa organizative	42	7	35	4	-	3	-
	Masa Administrative	1	-	1	-	-	-	-
	Masa për shpërblim dëmi	21	19	2	19	-	-	-
	Masa për eliminimin e efekteve financiare negative	12	-	12	-	-	-	-
	Masa disiplinore	1	-	1	-	-	-	-
13	Cirku Kombëtar	9	9	-	6	-	2	1
	Përmirësime për ndryshime ligjore	-	-	-	-	-	-	-
	Masa organizative	6	6	-	5	-	1	-
	Masa Administrative	-	-	-	-	-	-	-
	Masa për shpërblim dëmi	1	1	-	-	-	1	-
	Masa për eliminimin e efekteve financiare negative	-	-	-	-	-	-	-
	Masa disiplinore	2	2	-	1	-	-	1
14	Institucioni Rezidencial i Përkujdesit Shoqëror për Fëmijë, Zyber Hallulli	35	35	-	14	2	12	7
	Përmirësime për ndryshime ligjore	1	1	-	1	-	-	-
	Masa organizative	27	27	-	13	2	11	1
	Masa Administrative	-	-	-	-	-	-	-
	Masa për shpërblim dëmi	-	-	-	-	-	-	-
	Masa për eliminimin e efekteve financiare negative	6	6	-	-	-	1	5
	Masa disiplinore	1	1	-	-	-	-	1

15	Bashkia Vlorë (deinstitucionalizimi)	9	9	-	6	-	-	3
	<i>Përmirësime për ndryshime ligjore</i>	-	-	-	-	-	-	-
	<i>Masa organizative</i>	5	5	-	5	-	-	-
	<i>Masa Administrative</i>	-	-	-	-	-	-	-
	<i>Masa për shpërblim dëmi</i>	3	3	-	1	-	-	2
	<i>Masa për eliminimin e efekteve financiare negative</i>	-	-	-	-	-	-	-
	<i>Masa disiplinore</i>	1	1	-	-	-	-	1
16	Bashkia Korçë (deinstitucionalizimi)	8	8	-	8	-	-	-
	<i>Përmirësime për ndryshime ligjore</i>	-	-	-	-	-	-	-
	<i>Masa organizative</i>	3	3	-	3	-	-	-
	<i>Masa Administrative</i>	-	-	-	-	-	-	-
	<i>Masa për shpërblim dëmi</i>	4	4	-	4	-	-	-
	<i>Masa për eliminimin e efekteve financiare negative</i>	-	-	-	-	-	-	-
	<i>Masa disiplinore</i>	1	1	-	1	-	-	-
17	Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës	34	34	-	32	-	1	1
	<i>Përmirësime për ndryshime ligjore</i>	-	-	-	-	-	-	-
	<i>Masa organizative</i>	28	28	-	27	-	-	1
	<i>Masa Administrative</i>	-	-	-	-	-	-	-
	<i>Masa për shpërblim dëmi</i>	1	1	-	-	-	1	-
	<i>Masa për eliminimin e efekteve financiare negative</i>	4	4	-	4	-	-	-
	<i>Masa disiplinore</i>	1	1	-	1	-	-	-

5. DOKUMENTACIONI SHOQËRUES

-Akt Verifikim nr.1 datë 18.07.2023 “Zbatimi i rekomandimeve në Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare (DSHQ)”

-Akt Verifikim nr.2 datë 19.07.2022 “Zbatimi i rekomandimeve në Kuvendi Shqipërisë”

-Akt Verifikim nr.3 datë 07.2023 “Zbatim i rekomandimeve në Agjencinë e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural (AZHBR)”

-Akt Verifikim nr.4 datë 07.2023 “Zbatim i rekomandimeve në Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut (QKTGJ)”

-Akt Verifikim nr.5 datë 07.2023 “Zbatim i rekomandimeve në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Provës (DPSHP)”

-Akt Verifikim nr.6 datë 27.07.2023 “Zbatim i rekomandimeve në Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN)”

-Akt Verifikim nr.7 datë 27.07.2023 “Zbatim i rekomandimeve në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS)”

-Akt Verifikim nr.8 datë 26.07.2023 “Zbatim i rekomandimeve në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit (DPPSH)”

-Akt Verifikim nr.9 datë 07.2023 “Zbatim rekomandimesh në Ministrinë e Arsimit”

-Akt Verifikim nr.10 datë 25.07.2023 “Zbatim rekomandimesh në Ministrinë e Kulturës”

-Akt Verifikim nr.11 datë 07.2023 “Zbatim rekomandimesh në Cirku Tiranës”

-Akt Verifikim nr.12 datë 07.2023 “Zbatim rekomandimesh në Fondin Shqiptar të Zhvillimit (FSHZH)”

-Akt Verifikim nr.13 datë 07.2023 “Zbatim rekomandimesh në Bashkinë Korçë (Deinstitucionalizimi)”

-Akt Verifikim nr.14 datë 27.07.2023 “Zbatim rekomandimesh në Bashkinë Vlorë (Deinstitucionalizimi)”

-Akt Verifikim nr.15 datë 31.07.2023 “Zbatim rekomandimesh në Agjencinë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore (AKBPM)”

-Akt Verifikim nr.16 datë 26.07.2023 “Zbatim rekomandimesh në Institucioni Rezidencial i Përkujdesit Shoqëror për Fëmijë, Zyber Hallulli”

Anekse AKBN:

Tabela nr.1

Nr.	PALËT NDËRGJYQËSE	STATUSI I PALEVE	OBJEKTI PADISE	FAZA E GJYKIMIT
1	AKBN- "N. S.En." shpk. (Hec- Iballë)	AKBN – Padiës "N.S. E."shpk – e Paditur Kërkesë Padia me nr. 238 Prot., datë 14.01.2022	Detyrimin e palës së paditur "N. Sa.E." sh.p.k të shlyej diferencën e detyrimit financiar të tarifës së oponencës teknike të projektit të zbatimit për ndërtimin e HEC-eve "Kaskada e Iballë 1 Iballë 2, Sapac 1 Sapac 2, Liqeni dhe Berishë" në vlerën 3,575,559 Lekë. Pagimin e shpenzimeve gjyqësore nga ana e palës së paditur.	Po zhvillohet procesi gjyqësor në Gjykatën e Shkallës së Parë, Tirane, séanca e rradhës në Shtator 2023
2	AKBN-"S. AK"sh.p.k dhe"E."sh.p.k (Hec- Pashtresh)	AKBN – Padiës S. AK"sh.p.k" dhe "E."sh.p.k – e Paditur Kërkesë Padia me nr. 241 Prot. datë 14.01.2022	Detyrimin e palës së paditur "E."sh.p.k dhe "S. AK"sh.p.k të kryejë pagesën në vlerën 866,808 lekë të kryerjes së Oponencës Teknike. Pagimin e shpenzimeve gjyqësore nga ana e palës së paditur.	Çështja ndodhet në Gjykatën e Shkallës së Parë Elbasan, presim njoftimin nga gjykata për zhvillimin e procesit gjyqësor.
3	AKBN- "H.H." sh.p.k. (Hec- Hotolisht)	AKBN-Padiës Hec "Hotolisht" sh.p.k.- e Paditur Kërkesë Padia me nr. 241 Prot., datë 14.01.2022	Detyrimin e palës së paditur "H. H." sh.p.k. të kryejë pjesën e pagesës së mbetur në vlerën 1,088,155 lekë të pagesës së Oponencës Teknike. Pagimin e shpenzimeve gjyqësore nga ana e palës së paditur.	Pritet gjykimi në Gjykatën e Rrethit Tiranë (nuk është zhvilluar asnjë seancë gjyqësore)
4	AKBN- "E.V." sh.p.k. (Hec –Mesmal)	AKBN-Padiës "E. V." sh.p.k.- e Paditur Kërkesë Padia me nr. 241 Prot., datë 14.01.2022	Detyrimin e palës së paditur "E. V.a" sh.p.k.të kryejë pjesën e pagesës së mbetur në vlerën 983,643 lekë të pagesës së Oponencës Teknike Pagimin e shpenzimeve gjyqësore nga ana e palës së paditur.	Pritet gjykimi në Gjykatën e Rrethit Tiranë (nuk është zhvilluar asnjë seancë gjyqësore)

Tabela nr.2

Lista me masat administrative për vitin 2022 dhe vazhdimësi Qershor 2023.

Nr.	Nr lejes	Subjekti	Konstatimi dhe njoftimi i parregullsive			
			Akt Konstatim		Shkaku i kundërvajtjes	Masa e gjobes
			nr.prot.	dt.		
1	1830	E. shpk	1754	12.04.2022	Marrje mase administrative për mosdorëzim të planit vjetor të punës	250,000
2	1157	H.	1753	12.04.2022	Marrje mase administrative për mosdorëzim të planit vjetor të punës	250,000
3	1889	V.	1752	12.04.2022	Marrje mase administrative për mosdorëzim të planit vjetor të punës	250,000
4	1616	M.	1751	12.04.2022	Marrje mase administrative për mosdorëzim të planit vjetor të punës	250,000
5	1540	O.R.SH	1749	12.04.2022	Marrje mase administrative për mosdorëzim të planit vjetor të punës	250,000
6	1605	TMC T. & M. C.	1748	12.04.2022	Marrje mase administrative për mosdorëzim të planit vjetor të punës	250,000
7	1757	P.	2886	27.06.2022	Marrje mase administrative për mosdorëzim të planit vjetor të punës	250,000
8	1891	S.	2134/2	27.06.2022	Marrje mase administrative për mosdorëzim të planit vjetor të punës	250,000
9	1911	Gj. K.	2887	27.06.2022	Marrje mase administrative për mosdorëzim të planit vjetor të punës	250,000
10	778-1	R.	3362	10.08.2022	Marrje mase administrative për mosdorëzim të planit vjetor të punës	250,000
11	1915	K. 2018	3363	10.08.2022	Marrje mase administrative për mosdorëzim të planit vjetor të punës	250,000
12	1357	J. 2008	3658	26.08.2022	Marrje mase administrative për mosdorëzim të planit vjetor të punës	250,000
13	1812	S. G.A.shpk	3376	11.08.2022	Marrje mase administrative për mosdorëzim të planit vjetor të punës	250,000

14	1924	K.	4275	11.10.2022	Marrje mase administrative për mosdorëzim të planit vjetor të punës	250,000
15	1582	T.A.K.	4273	11.10.2022	Marrje mase administrative për mosdorëzim të planit vjetor të punës	250,000
16	1731	E. C. & E. M. I. Shpk	4275	11.10.2022	Marrje mase administrative për mosdorëzim të planit vjetor të punës	250,000
17	1450/1*	I.-I shpk (NK I Rruga ura asfaltim nr.2 Elbasan	411	19.01.2023	Marrje mase administrative për mosdorëzim të planit vjetor të punës	250,000
18	464/1	J. M. shpk	412	19.01.2023	Marrje mase administrative për mosdorëzim të planit vjetor të punës	250,000
19	1451/1	K. shpk	410	19.01.2023	Marrje mase administrative për mosdorëzim të planit vjetor të punës	250,000
20	450	K. shpk	1092	13.02.2023	Marrje mase administrative për mosdorëzim të planit vjetor të punës	250,000
21	839	L. BL shpk	1091	13.02.2023	Marrje mase administrative për mosdorëzim të planit vjetor të punës	250,000
22	1742	Ch. I. shpk	1090	13.02.2023	Marrje mase administrative për mosdorëzim të planit vjetor të punës	250,000
23	1743	D. shpk	1089	13.02.2023	Marrje mase administrative për mosdorëzim të planit vjetor të punës	250,000
24	607/1	L. shpk	1638	21.03.2023	Marrje mase administrative për mosdorëzim të planit vjetor të punës	250,000
25	847/2	A. shpk	2105	20.04.2023	Marrje mase administrative për mosdorëzim të planit vjetor të punës	250,000
26	657/2	R. 1 shpk	2587	23.05.2023	Marrje mase administrative për mosdorëzim të planit vjetor të punës	250,000
27	1353/1	Fabrika e P. te K. B.shpk	2588	23.05.2023	Marrje mase administrative për mosdorëzim të planit vjetor të punës	250,000
28	1833	B. & B. shpk	2589	23.05.2023	Marrje mase administrative për mosdorëzim të planit vjetor të punës	250,000
29	1891	S. shpk	2590	23.05.2023	Marrje mase administrative për mosdorëzim të planit vjetor të punës	250,000
30	771/1	K.shpk	3141	29.06.2023	Marrje mase administrative për mosdorëzim të planit vjetor të punës	250,000
31	1806	K. shpk	3142	29.06.2023	Marrje mase administrative për mosdorëzim të planit vjetor të punës	250,000
32	1718	V. D.I. E. shpk	3143	29.06.2023	Marrje mase administrative për mosdorëzim të planit vjetor të punës	250,000

Tabela nr.3

Viti	Nr	Nr minerare	lejes	Subjekti	Konstatimi dhe njoftimi i parregullsisve		Shkaku i kundërvajtjes
					Akt Konstatim		
					nr.prot.	dt.	
2018	1	1607	K.	3476	11.08.2022	Marrje mase administrative për mosparaqitjen e informacionit vjetor 2018	
	2	1076/1	N.-3	3473	11.08.2022	Marrje mase administrative për mosparaqitjen e informacionit vjetor 2018	
	3	1631	S. B. M.	3477	11.08.2022	Marrje mase administrative për mosparaqitjen e informacionit vjetor 2018	
	4	463	Sh.	3472	11.08.2022	Marrje mase administrative për mosparaqitjen e informacionit vjetor 2018	
	5	1329/1	B.2011	3474	11.08.2022	Marrje mase administrative për mosparaqitjen e informacionit vjetor 2018	
	6	1499	M.e D.	3475	11.08.2022	Marrje mase administrative për mosparaqitjen e informacionit vjetor 2018	
	7	1738	As M. LTD	3478	11.08.2022	Marrje mase administrative për mosparaqitjen e informacionit vjetor 2018	
	8	1758	A. A.G.	3479	11.08.2022	Marrje mase administrative për mosparaqitjen e informacionit vjetor 2018	
	9	1655	I.	3483	11.08.2022	Marrje mase administrative për mosparaqitjen e informacionit vjetor 2018	
	10	1397	I.	3484	11.08.2022	Marrje mase administrative për mosparaqitjen e informacionit vjetor 2018	
	11	545	K.	3485	11.08.2022	Marrje mase administrative për mosparaqitjen e informacionit vjetor 2018	
	12	768/1	N.	3486	11.08.2022	Marrje mase administrative për mosparaqitjen e informacionit vjetor 2018	
	13	1076/1	N.-3	3463	11.08.2022	Marrje mase administrative për mosparaqitjen e informacionit 3	
	14	768/1	N.	3462	11.08.2022	Marrje mase administrative për mosparaqitjen e informacionit 3	

	15	1296	A.	3464	11.08.2022	Marrje mase administrative për mosparaqitjen e informacionit 3
	16	1329/1	Be. 2011	3465	11.08.2022	Marrje mase administrative për mosparaqitjen e informacionit 3
	17	1389	G.Xh.Albania	3466	11.08.2022	Marrje mase administrative për mosparaqitjen e informacionit 3
	18	1490	A.	3467	11.08.2022	Marrje mase administrative për mosparaqitjen e informacionit 3
	19	1713	A. M.	3468	11.08.2022	Marrje mase administrative për mosparaqitjen e informacionit 3
	20	1738	As Mineral LTD	3469	11.08.2022	Marrje mase administrative për mosparaqitjen e informacionit 3
	21	1761	A.N.&Chrome	3470	11.08.2022	Marrje mase administrative për mosparaqitjen e informacionit 3
	22	1846	Ç.	3471	11.08.2022	Marrje mase administrative për mosparaqitjen e informacionit 3
	23	922	U.Q.	3487	11.08.2022	Marrje mase administrative për mosparaqitjen e informacionit 3
	24	923	E.C.F.	3488	11.08.2022	Marrje mase administrative për mosparaqitjen e informacionit 3
	25	1838	A. & S.	3459	11.08.2022	Marrje mase administrative për mosparaqitjen e informacionit 3-mujori i IV 2018
	26	1607	K.	3457	11.08.2022	Marrje mase administrative për mosparaqitjen e informacionit 3-mujori i IV 2018
	27	232	M.I.	3453	11.08.2022	Marrje mase administrative për mosparaqitjen e informacionit 3-mujori i IV 2018
	28	768/1	N.	3454	11.08.2022	Marrje mase administrative për mosparaqitjen e informacionit 3-mujori i IV 2018
	29	1389	G.-Xh.A.	3455	11.08.2022	Marrje mase administrative për mosparaqitjen e informacionit 3-mujori i IV 2018
	30	1499	M. e D.	3456	11.08.2022	Marrje mase administrative për mosparaqitjen e informacionit 3-mujori i IV 2018
	31	1738	As M. LTD	3458	11.08.2022	Marrje mase administrative për mosparaqitjen e informacionit 3-mujori i IV 2018
	32	1843	K.-Tr. L82 Bulqize	3460	11.08.2022	Marrje mase administrative për mosparaqitjen e informacionit 3-mujori i IV 2018
	33	1846	Ç.	3461	11.08.2022	Marrje mase administrative për mosparaqitjen e informacionit 3-mujori i IV 2018
	34	1242	R.	3489	11.08.2022	Marrje mase administrative për mosparaqitjen në afat e informacionit 3-mujori i IV 2018
2019	35	1867	Bashkia Poliçan	3403	11.08.2022	Marrje mase administrative për mosparaqitjen e informacionit vjetor 2019
	36	1846	Ç.	3402	11.08.2022	Marrje mase administrative për mosparaqitjen e informacionit vjetor 2019
	37	1831	Ti. E.	3401	11.08.2022	Marrje mase administrative për mosparaqitjen e informacionit vjetor 2019
	38	1738	As M.LTD	3400	11.08.2022	Marrje mase administrative për mosparaqitjen e informacionit vjetor 2019
	39	1538/1	A. S.	3399	11.08.2022	Marrje mase administrative për mosparaqitjen e informacionit vjetor 2019
	40	1252/1	A.	3409	11.08.2022	Marrje mase administrative për mosparaqitjen në afat e informacionit vjetor 2019
	41	496	A.	3404	11.08.2022	Marrje mase administrative për mosparaqitjen në afat e informacionit vjetor 2019
	42	1771	M. F. N.	3412	11.08.2022	Marrje mase administrative për mosparaqitjen në afat e informacionit vjetor 2019
	43	1725	M. F. N.	3411	11.08.2022	Marrje mase administrative për mosparaqitjen në afat e informacionit vjetor 2019
	44	1076/1	N.-3	3408	11.08.2022	Marrje mase administrative për mosparaqitjen në afat e informacionit vjetor 2019
	45	1778/1	Y.	3413	11.08.2022	Marrje mase administrative për mosparaqitjen në afat e informacionit vjetor 2019
	46	946	D.	3406	11.08.2022	Marrje mase administrative për mosparaqitjen në afat e informacionit vjetor 2019
	47	1866	T. A.T.&M.	3417	11.08.2022	Marrje mase administrative për mosparaqitjen në afat e informacionit vjetor 2019
	48	1871	T. A.T.&M.	3419	11.08.2022	Marrje mase administrative për mosparaqitjen në afat e informacionit vjetor 2019
	49	1870	T. A. T.&M.	3418	11.08.2022	Marrje mase administrative për mosparaqitjen në afat e informacionit vjetor 2019
	50	1865	T. A. T.&M.	3416	11.08.2022	Marrje mase administrative për mosparaqitjen në afat e informacionit vjetor 2019
	51	1823/1	C.&E.	3415	11.08.2022	Marrje mase administrative për mosparaqitjen në afat e informacionit vjetor 2019
	52	1813	A.T.A Ea. E.	3414	11.08.2022	Marrje mase administrative për mosparaqitjen në afat e informacionit vjetor 2019
	53	1655	I.	3410	11.08.2022	Marrje mase administrative për mosparaqitjen në afat e informacionit vjetor 2019
	54	1068	T. A. T.&Mi.	3407	11.08.2022	Marrje mase administrative për mosparaqitjen në afat e informacionit vjetor 2019
	55	607	L.	3405	11.08.2022	Marrje mase administrative për mosparaqitjen në afat e informacionit vjetor 2019
	56	1738	As M.LTD	3397	11.08.2022	Marrje mase administrative për mosparaqitjen e informacionit 3-mujori i I 2019
	57	1588	A.	3396	11.08.2022	Marrje mase administrative për mosparaqitjen e informacionit 3-mujori i I 2019
	58	1499	M. e D.	3395	11.08.2022	Marrje mase administrative për mosparaqitjen e informacionit 3-mujori i I 2019

	59	1442	M. 2011	3394	11.08.2022	Marrje mase administrative për mosparaqitjen e informacionit 3-mujori i I 2019
	60	1846	Ç.	3398	11.08.2022	Marrje mase administrative për mosparaqitjen e informacionit 3-mujori i I 2019
	61	862/2	S.Pr.	3420	11.08.2022	Marrje mase administrative për mosparaqitjen në afat e informacionit 3-mujori i I 2019
	62	1214	I.	3421	11.08.2022	Marrje mase administrative për mosparaqitjen në afat e informacionit 3-mujori i I 2019
	63	1483	K.	3422	11.08.2022	Marrje mase administrative për mosparaqitjen në afat e informacionit 3-mujori i I 2019
	64	1295	M. 2011	3423	11.08.2022	Marrje mase administrative për mosparaqitjen në afat e informacionit 3-mujori i I 2019
	65	1821	A.M.	3426	11.08.2022	Marrje mase administrative për mosparaqitjen në afat e informacionit 3-mujori i I 2019
	66	1808	SS&R	3425	11.08.2022	Marrje mase administrative për mosparaqitjen në afat e informacionit 3-mujori i I 2019
	67	1442	M. 2011	3424	11.08.2022	Marrje mase administrative për mosparaqitjen në afat e informacionit 3-mujori i I 2019
	68	1860	V. M.	3427	11.08.2022	Marrje mase administrative për mosparaqitjen në afat e informacionit 3-mujori i I 2019
	69	768/1	N.	3388	11.08.2022	Marrje mase administrative për mosparaqitjen e informacionit 3-mujori i II 2019
	70	1499	M. e D.	3389	11.08.2022	Marrje mase administrative për mosparaqitjen e informacionit 3-mujori i II 2019
	71	1738	A.M. LTD	3390	11.08.2022	Marrje mase administrative për mosparaqitjen e informacionit 3-mujori i II 2019
	72	1630	N N T.Pro-ing	3432	11.08.2022	Marrje mase administrative për mosparaqitjen e informacionit 3-mujori i II 2019
	73	1846	Ç.	3391	11.08.2022	Marrje mase administrative për mosparaqitjen e informacionit 3-mujori i II 2019
	74	480	D.	3428	11.08.2022	Marrje mase administrative për mosparaqitjen ne afat e informacionit 3-mujori i II 2019
	75	1500	J.M.	3431	11.08.2022	Marrje mase administrative për mosparaqitjen ne afat e informacionit 3-mujori i II 2019
	76	570	J. M.	3430	11.08.2022	Marrje mase administrative për mosparaqitjen ne afat e informacionit 3-mujori i II 2019
	77	464	J. M.	3429	11.08.2022	Marrje mase administrative për mosparaqitjen ne afat e informacionit 3-mujori i II 2019
	78	1846	Ç.	3386	11.08.2022	Marrje mase administrative për mosparaqitjen e informacionit 3-mujori i III 2019
	79	1867*	B.P.	3387	11.08.2022	Marrje mase administrative për mosparaqitjen e informacionit 3-mujori i III 2019
	80	1738	As M.LTD	3385	11.08.2022	Marrje mase administrative për mosparaqitjen e informacionit 3-mujori i III 2019
	81	768/1	N.	3384	11.08.2022	Marrje mase administrative për mosparaqitjen e informacionit 3-mujori i III 2019
	82	1538	A.S.	3382	11.08.2022	Marrje mase administrative për mosparaqitjen e informacionit 3-mujori i III 2019
	83	1738	As M.LTD	3381	11.08.2022	Marrje mase administrative për mosparaqitjen e informacionit 3-mujori i III 2019
	84	1831	T.E.	3380	11.08.2022	Marrje mase administrative për mosparaqitjen e informacionit 3-mujori i III 2019
	85	1846	Ç.	3379	11.08.2022	Marrje mase administrative për mosparaqitjen e informacionit 3-mujori i III 2019
	86	1867*	Bashkia Poliçan	3383	11.08.2022	Marrje mase administrative për mosparaqitjen e informacionit 3-mujori i IV 2019
	87	1680	K.Chr.M.	3433	11.08.2022	Marrje mase administrative per mosparaqitjen ne afat e informacionit 3-mujori i IV 2019
	2020	88	349/2	G.i A.	3516	12.08.2022
89		768/1	N.	3517	12.08.2022	Marrje mase administrative për mosparaqitjen e informacionit vjetor 2020
90		1197/1	IHD	3519	12.08.2022	Marrje mase administrative per mosparaqitjen e informacionit vjetor 2020
91		1401/2	B.	3520	12.08.2022	Marrje mase administrative për mosparaqitjen e informacionit vjetor 2020
92		1703	H. F	3521	12.08.2022	Marrje mase administrative për mosparaqitjen e informacionit vjetor 2020
93		1738	As M. LTD	3522	12.08.2022	Marrje mase administrative për mosparaqitjen e informacionit vjetor 2020
94		1867	Bashkia Poliçan	3523	12.08.2022	Marrje mase administrative për mosparaqitjen e informacionit vjetor 2020
95		847/1	A.	3518	12.08.2022	Marrje mase administrative për mosparaqitjen e informacionit vjetor 2020
96		1538	A.S.	3509	12.08.2022	Marrje mase administrative për mosparaqitjen e informacionit 3-mujori i I 2020
97		1576	S. A.	3510	12.08.2022	Marrje mase administrative per mosparaqitjen e informacionit 3-mujori i I 2020
98		1738	As Mi. LTD	3511	12.08.2022	Marrje mase administrative për mosparaqitjen e informacionit 3-mujori i I 2020
99		1831	T.Ex.	3512	12.08.2022	Marrje mase administrative për mosparaqitjen e informacionit 3-mujori i I 2020
100		1846	Ç.	3513	12.08.2022	Marrje mase administrative për mosparaqitjen e informacionit 3-mujori i I 2020

	101	1867*	Bashkia Poliçan	3514	12.08.2022	Marrje mase administrative për mosparaqitjen e informacionit 3-mujori i I 2020
	102	1442	M. 2011	3515	12.08.2022	Marrje mase administrative për mosparaqitjen e informacionit 3-mujori i I 2020
	103	1738	As M. LTD	3505	12.08.2022	Marrje mase administrative për mosparaqitjen e informacionit 3-mujori i II 2020
	104	1867*	Bashkia Poliçan	3506	12.08.2022	Marrje mase administrative për mosparaqitjen e informacionit 3-mujori i II 2020
	105	1442	M.2011	3507	12.08.2022	Marrje mase administrative për mosparaqitjen e informacionit 3-mujori i II 2020
	106	1703	H. F	3504	12.08.2022	Marrje mase administrative për mosparaqitjen e informacionit 3-mujori i II 2020
	107	768/1	N.	3502	12.08.2022	Marrje mase administrative për mosparaqitjen e informacionit 3-mujori i II 2020
	108	847/1	A.	3503	12.08.2022	Marrje mase administrative për mosparaqitjen e informacionit 3-mujori i II 2020
	109	1703	H. F	3499	12.08.2022	Marrje mase administrative për mosparaqitjen e informacionit 3-mujori i III 2020
	110	1738	As Mineral LTD	3500	12.08.2022	Marrje mase administrative për mosparaqitjen e informacionit 3-mujori i III 2020
	111	1867*	Bashkia Poliçan	3501	12.08.2022	Marrje mase administrative për mosparaqitjen e informacionit 3-mujori i III 2020
	112	349/2	G.i A.	3496	12.08.2022	Marrje mase administrative për mosparaqitjen e informacionit 3-mujori i III 2020
	113	768/1	N.	3497	12.08.2022	Marrje mase administrative për mosparaqitjen e informacionit 3-mujori i III 2020
	114	1401/2	B.&K.	3498	12.08.2022	Marrje mase administrative për mosparaqitjen e informacionit 3-mujori i III 2020
	115	349/2	G. i A.	3490	12.08.2022	Marrje mase administrative për mosparaqitjen e informacionit 3-mujori i IV 2020
	116	768/1	N.	3491	12.08.2022	Marrje mase administrative për mosparaqitjen e informacionit 3-mujori i IV 2020
	117	1867*	Bashkia Poliçan	3495	12.08.2022	Marrje mase administrative për mosparaqitjen e informacionit 3-mujori i IV 2020
	118	1738	A.M.LTD	3494	12.08.2022	Marrje mase administrative për mosparaqitjen e informacionit 3-mujori i IV 2020
	119	847/1	A.	3492	12.08.2022	Marrje mase administrative për mosparaqitjen e informacionit 3-mujori i IV 2020
	120	1703	H.F	3493	12.08.2022	Marrje mase administrative për mosparaqitjen e informacionit 3-mujori i IV 2020
2021	121	847/1	A.	3437	11.08.2022	Marrje mase administrative për mosparaqitjen e informacionit vjetor 2021
	122	768/1	N.	3438	11.08.2022	Marrje mase administrative për mosparaqitjen e informacionit vjetor 2021
	123	1197/1	I.	3439	11.08.2022	Marrje mase administrative për mosparaqitjen e informacionit vjetor 2021
	124	1769	L.	3441	11.08.2022	Marrje mase administrative për mosparaqitjen e informacionit vjetor 2021
	125	1340	Info M.AI	3440	11.08.2022	Marrje mase administrative për mosparaqitjen e informacionit vjetor 2021
	126	847/1	A.	3444	11.08.2022	Marrje mase administrative për mosparaqitjen e informacionit 3-mujori i I 2021
	127	349/2	G. i A.	3442	11.08.2022	Marrje mase administrative për mosparaqitjen e informacionit 3-mujori i I 2021
	128	768/1	N.	3443	11.08.2022	Marrje mase administrative për mosparaqitjen e informacionit 3-mujori i I 2021
	129	1849	V.M.A.	3446	11.08.2022	Marrje mase administrative për mosparaqitjen e informacionit 3-mujori i I 2021
	130	1088/1	M. I.	3445	11.08.2022	Marrje mase administrative për mosparaqitjen e informacionit 3-mujori i I 2021
	131	1401/2	B.&K.	3435	11.08.2022	Marrje mase administrative për mosparaqitjen ne afat e informacionit 3-mujori i I 2021
	132	1382	N.-BL	3436	11.08.2022	Marrje mase administrative për mosparaqitjen ne afat e informacionit 3-mujori i I 2021
	133	847/1	A.	3448	11.08.2022	Marrje mase administrative për mosparaqitjen e informacionit 3-mujori i II 2021
	134	1849	V.M..	3452	11.08.2022	Marrje mase administrative për mosparaqitjen e informacionit 3-mujori i II 2021
	135	349/2	G. i A.	3447	11.08.2022	Marrje mase administrative për mosparaqitjen e informacionit 3-mujori i II 2021
	136	1197/1	IHD	3449	11.08.2022	Marrje mase administrative për mosparaqitjen e informacionit 3-mujori i II 2021

137	1729	Ch.A. and N.C.Enterprise	3450	11.08.2022	Marrje mase administrative për mosparaqitjen e informacionit 3-mujori i II 2021
138	1738	As Mineral LTD	3451	11.08.2022	Marrje mase administrative për mosparaqitjen e informacionit 3-mujori i II 2021
139	1874	B.C.	3434	11.08.2022	Marrje mase administrative për mosparaqitjen e informacionit 3-mujori i II 2021

Tabela nr.4

Totali	Shfuqizuar nga MIE	Janë depozituar në gjykatë për nxjerrjen e Urdhërave të Ekzekutimit	Përgjigje nga Posta Shqiptare	Përgjigje nga MIE	Problematika	Janë ekzekutuar vullnetarisht	Proces gjyqësor humbur	Proces gjyqësor fituar	Ne proces gjyqësor	Urdhëra Ekzekutimi
139 Masa Administrative	7 Masa Administrative	7 Kërkesa për nxjerrjen e urdhërave të ekzekutimit	Për 99 masa 27 subjekte nuk kanë marrë dënimin 41-kanë marrë dënimin 30-posta nuk ka informacion Shkresë postës shqiptare me nr.prot.782, datë 02.02.2023. Marrë përgjigje me shkresën Nr.269/1 datë 10.03.2023 Korrespondencë e vazhdueshme me postën shqiptare: AKBN Shkresat; Nr.prot.216/61,datë 18.11.2022,Nr.prot.216/72, datë 12.12.2022. Posta Shkresat; Nr.prot.216/71, datë 01.02.2022, Nr.prot.2628/1, datë 30.11.2022, Nr.prot.216/78, datë 30.12.2022.	Për 99 masa 97 nuk janë ankimuar 1 masë është ankimuar Shkresë MIE nr.prot.2295, date 04.05.2023 Përgjigje nga MIE shkresa nr.prot 2295/1, datë 16.06.2023		10 masa administrative	3 Masa administrative	1 Masë administrative	1 Masë administrative	9 Urdhëra ekzekutimi

Tabela nr.5

	Numer		Data fillestare	Subjekti	Bashkia	Minerali	Vlera garancie se rehabilitimit	Vitet e papaguara	Shenime	Prot AKBN	Prot MIE
	Lejes	Data re									
1	1211/1	26.06.2012	26.06.2012	B. – P.(Pezullim i perkohshem)	Mat	Krom	172,296	2020-2021	Fillim procedurash per revokim	Nr. Prot AKBN 1309 dt.27.02.2023	Nr. Prot MIE 2412/1, dt. 14.06.2023
2	1240/1	09.10.2017	16.09.2008	Q.A.	Fier	Argjillë	567,725	2022	Revokuar ne 2023 pas propozimit per revokim nga AKBN	Nr. Prot AKBN 1281, dt.27.02.2023	Nr. Prot MIE 2315/2, dt. 31.05.2023
3	1346	20.05.2009	20.05.2009	E. 06, (Pezullim i perkohshem) SHPK	Has	Krom	110,592	2021-2022	I beri pagesat	Nr. Prot AKBN 1319, dt.28.02.2023	
4	1398	20.08.2009	20.08.2009	G. sh.p.k (ish-SHPRESA AL),	Lezhe	Krom	40,606	2022	E beri pagesen	Nr. Prot AKBN 1327, dt.28.02.2023	
5	1523	22.11.2010	22.11.2010	B., SHPK(Pezullim i perkohshem)	Bulqize	Krom	22,270	2022	Fillim procedurash per revokim	Nr. Prot AKBN 1694, dt.24.03.2023	Nr. Prot MIE 3080/1, dt. 14.06.2023
6	1668		05.09.2013	C.SH.P.K (Pezulluar)	Kukes	Krom		2022	I beri pagesat	Nr. Prot AKBN 1323, dt.28.02.2023	
7	1731/1		13.10.2014	E. CONSTR. & E.MINERAL INVEST	Kukes	Krom	28333	2022	Fillim procedurash per revokim	Nr. Prot AKBN 1321, dt.28.02.2023	Nr. Prot MIE 2411/1, dt. 24.03.2023
8	1756		21.05.2015	F. -Kruje C.F.shpk (Nuk eshte hequr nga fondi pyjor)	Kruje	Gur gëlqeror	1,028,927	2017-2022	Fillim procedurash per revokim	Nr. Prot AKBN 1284, dt.27.02.2023	Nr. Prot MIE 2317/1, dt. 20.03.2023

9	1772		15.10.2015	M.(ish "L."sh.p.k)	Bulqize	Krom	154,163	2022	Propozim per revokim	Nr. Prot AKBN 1695, dt.24.03.2023	
10	1782		18.11.2015	L.-06-ShPK (Nderprerje procedurash Revokimi)	Korce	Hekur Nikel	706,100	2021-2022	I beri pagesat	Nr. Prot AKBN 1693, dt.24.03.2023	
11	1802		26.05.2016	"T.-A.-K.", (Pezullim i perkohshem)	Kukes	Krom	200,451	2021-2022	Revokuar ne 2023 pas propozimit per revokim nga AKBN	Nr. Prot AKBN 1325, dt.28.02.2023	Nr. Prot MIE 2415/2, dt. 31.05.2023
12	1817		26.09.2016	"M.-XH-2014"sh.p.k (Pezullim i perkohshem)	Kukes	Krom	343,165	2021-2022	I beri pagesat	Nr. Prot AKBN 1324, dt.28.02.2023	
13	1834		13.06.2017	"G. M. M."	Berat	Gëlqeror i mermerizuar	390,000	2022	Revokuar ne 2023 pas propozimit per revokim nga AKBN	Nr. Prot AKBN 1283, dt.27.02.2023	Nr. Prot MIE 2316/2, dt. 31.05.2023
14	1875		18.11.2019	E.C.& E. M.	Kukes	krom	87648	2021-2022	Fillim procedurash per revokim	Nr. Prot AKBN 1326, dt.28.02.2023	Nr. Prot MIE 2416/2, dt. 24.03.2023
15	1911		04.06.2021	"G.J. K."(3 vjet leje)	Klos	Gelqeror	381,355	2022	Revokuar ne 2023 pas propozimit per revokim nga AKBN	Nr. Prot AKBN 1285, dt.27.02.2023	Nr. Prot MIE 2318/2, dt. 31.05.2023
16	1915		12.07.2021	"K.2018"	Gjirokaster	Gelqeror pllakor	65,582	2022	Revokuar ne 2023 pas propozimit per revokim nga AKBN	Nr. Prot AKBN 1279, dt.27.02.2023	Nr. Prot MIE 537/2, dt. 31.05.2023

KONTROLI I LARTË I SHTETIT